

**UNIVERSITETI I PRISHTINËS
“HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI I FILOLOGJISË**

dhe

**UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI HISTORI-FILOLOGJI**

**SEMINARI XXXIV NDËRKOMBËTAR PËR GJUHËN, LETËRSINË
DHE KULTURËN SHQIPTARE**

34/1

**Materialet e punimeve të Seminarit XXXIV Ndërkombëtar për Gjuhën,
Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare
Prishtinë, 17-28.08.2015**

FAKULTETI I FILOLOGJISË – PRISHTINË

FAKULTETI HISTORI-FILOLOGJI – TIRANË

SEMINARI XXXIV NDËRKOMBËTAR PËR GJUHËN, LETËRSINË
DHE KULTURËN SHQIPTARE

THE XXXIV INTERNATIONAL SEMINAR FOR ALBANIAN LANGUAGE,
LITERATURE AND CULTURE

PRISHTINË, 2015

Fakulteti i Filologjisë – Prishtinë
Fakulteti Histori-Filologji – Tiranë

SEMINARI XXXIV NDËRKOMBËTAR PËR GJUHËN, LETËRSINË
DHE KULTURËN SHQIPTARE

Prishtinë, 17-28.08.2015

THE XXXIV INTERNATIONAL SEMINAR FOR ALBANIAN LANGUAGE,
LITERATURE AND CULTURE

Kryeredaktor: Rrahman Paçarizi

Redaksia: Rrahman Paçarizi (Prishtinë), Qibrije Demiri-Frangu (Prishtinë), Bardh Rugova (Prishtinë), Nysret Krasniqi (Prishtinë), Milazim Krasniqi (Prishtinë), Muhamet Hamiti (Prishtinë), Teuta Abrashi (Prishtinë), Suzana Canhasi (Prishtinë), Isa Memishi (Prishtinë), Fehmi Ismajli (Prishtinë), Shezai Rrokaj (Tiranë), Aljula Jubani (Tiranë), Ymer Çiraku (Tiranë), Dhurata Shehri (Tiranë), Mimoza Kore (Tiranë), Vjollca Osja (Tiranë), Bardhyl Demiraj (Munich), Maksimilijana Barančić (Zarë), Aleksandar Novik (Shën Peterburg), Premysl Vins (Pragë), Ibrahim Berisha (Prishtinë), Ardian Gola (Prishtinë), Emilia Conforti (Kalabri), Agron Tufa (Tiranë), Anton Panchev (Sofje), Robert Austin (Toronto)

Drejtor: Rrahman Paçarizi

Bashkëdrejtor: Aljula Jubani

Sekretar: Qibrije Demiri-Frangu

Bashkësekretar: Viola Isufaj

Sekretarë profesionalë: Kadire Binaj & Alban Zeneli

Drejtor nderi: Akademik Idriz Ajeti

Përgjegjëse për kurset e gjuhës: Sala Ahmetaj

Botues: Fakulteti i Filologjisë, Prishtinë

GJUHËSI

Sedat KUÇI, dekan i Fakultetit të Filologjisë

**FJALA PËRSHËNDETËSE NË HAPJEN E PUNIMEVE TË
SEMINARIT XXXIV NDËRKOMBËTAR PËR GJUHËN,
LETËRSINË DHE KULTURËN SHQIPTARE**

E nderuara kryetare e Republikës së Kosovës, Zonja Atifete Jahjaga,
I nderuari kryeministër i Republikës së Kosovës, akademik Isa Mustafa,
I nderuari ambassador i Republikës së Shqipërisë, zoti Qemal Minxhozi,
I nderuari drejtor nderi i Seminarit, akademik Idriz Ajeti,
I nderuari ministër i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, prof. Arsim Bajrami,
E nderuara Kryetare e Këshillit Drejtues të Universitetit të Prishtinës prof.
Shefkije Islamaj,

I nderuari Drejtor i Seminarit, prof. Rrahman Paçarizi,

Të nderuar dekanë, anëtarë të Këshillit Drejtues, senatorë, seminaristë,
përfaqësues të mediave, mysafirë, zonja dhe zotërinj, në emrin tim dhe në emër të
Fakultetit të Filologjisë të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” ju falenderoj
për ardhjen tuaj në hapjen solemne të punimeve të Seminarit të 34 Ndërkombëtar për
Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare.

Të nderuar të pranishëm,

Ja erdhi java e tretë e muajit gusht, java kur tashmë tradicionalisht në Fakultetin
tonë fillon ngjarja më e madhe ndërkombëtare për gjuhën, letërsinë dhe kulturën
shqiptare.

Për Fakultetin e Filologjisë dhe Universitetin tonë sot është një ditë e shënuar.

Ky Seminar, siç është thënë edhe herave të tjera, është bërë shenjë dalluese,
emblemë jo vetëm e Fakultetit të Filologjisë, e Universitetit të Prishtinës, por edhe e
qytetit të Prishtinës dhe e mbarë Kosovës.

Vitin e kaluar e shënuam dizetyjetorin e themelimit të Seminarit Ndërkombëtar
për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare. Seminari i themeluar në vitin 1974 me
emrin Qendra e Gjuhës Shqipe për të Huaj, nuk e pati të lehtë rrugëtimin e tij deri në
ditët e sotme. Gjatë historikut të vet e përjetoj fatin e Kosovës, për ç’arsye pati një
diskontinuitet në organizimin e tij. Nga themelimi i tij e deri në vitin 1990 Seminari u
organizua 16 herë në Prishtinë, në Fakultetin tonë, ndërsa në periudhën 1990 – 2000,

atëherë kur shteti i Serbisë i mbylli dhunshëm institucionet e arsimit në Kosovë, Seminari u organizua dy herë në Tiranë, në vitin 1995 dhe 1996. Me çlirimin e Kosovës nga Serbia u krijuan kushtet për kthimin e institucioneve arsimore në objektet e veta, pra edhe të vazhdimit të organizimit të Seminarit në Prishtinë.

Të dashur miq,

Fakulteti i Filologjisë është me fat, është i nderuar dhe krenar që ka trashëguar nga të parët e vet, profesorët largpamës, një institucion kaq të rëndësishëm arsimor, shkencor e kulturor të përmasave ndërkombëtare. Konsideroj që sa herë që të përmendet historiku i Seminarit Ndërkombëtar për Gjuhën Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, duhet t'i falënderojmë profesorët – themeluesit e tij, akademikët Idriz Ajetin, Rexhep Ismajlin e kolegët e tyre të Departamentit të Gjuhës Shqipe, të Departamentit të Letërsisë Shqipe e të Departamenteve të tjera, për relizimin e kësaj ideje brilante.

Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, përveç rolit arsimor, shkencor e kulturor po vazhdon t'i përmbushë edhe

1. Misionin e afirmimit të vlerave të kulturës shqiptare në botë;
2. Misionin e përhapjes së mendimit intelektual shqiptar për probleme të caktuara gjuhësore, letrare e kulturore;
3. Misionin e njohjes reciproke me rezultatet e studiuesve shqiptarë dhe të huaj në fusha të ndryshme të albanologjisë;
4. Misionin e krijimit të miqësive të reja midis studiuesve shqiptarë dhe atyre të huaj që ka një rëndësi të madhe në aspektin e bashkëpunimit ndërnjerëzor dhe ndërkombëtar midis kulturave e popujve. Duhet te theksojme se sivjet pjesëmarrës të Seminarit do të jenë edhe përfaqësuesit e arbnesheve të Zarës.
5. Misionin e krijimit të mundësive të reja për mobilitete të studentëve, të pedagogëve dhe të hulumtuesve shkencorë.

Të dashur seminaristë, që vini nga vende të ndryshme të botës, të gjitha këto realizohen falë pranisë tuaj në këtë Seminar.

Më lejoni që për ndihmën e dhënë t'i falënderoj:

Rektoratin e Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”;

Ministrinë e Arsimit të Shkencës dhe të Teknologjisë të Republikës së Kosovës;

Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit të Republikës së Kosovës;

Drejtorin, Drejtorinë dhe Këshillin Drejtues të Seminarit që e bartin barrën kryesore në realizimin e programit të Seminarit. Me këtë rast falenderoj edhe bashkëdrejtorinë në Tiranë.

Të nderuar pjesëmarrës të Seminarit të sivjetëm ju dëshiroj punë të mbarë dhe sukses.

Ju faleminderit

Prishtinë, 17.08.2015

Rrahman PAÇARIZI, Drejtor i Seminarit

FJALA E HAPJES E DREJTORIT TË SEMINARIT XXXIV

E nderuara presidente e Kosovës, zonja Atifete Jahjaga

I nderuari kryeministër, Isa Mustafa

I nderuari ambasador Minxhozi

I dashuri drejtor nderi i Seminarit, profesor Idriz Ajeti

I nderuari kryetar i ASHAK, akademik Hivzi Islami

Të nderuar akademikë, Rexhep Ismajli, Sabri Hamiti, Mehmet Kraja

I nderuari ministër Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, z. Arsim Bajrami

Të nderuar prorektorë, Tahiri e Podvorica

I nderuari dekan, Kuçi

Të nderuar pjesëmarrës, profesorë e studentë

Të dashur seminaristë

Është një nder i madh dhe përgjegjësi që më frikëson, t'i drejtohem një auditori si ky, sidomos duke pasur mbi supe një institucion kaq të rëndësishëm, me një traditë kaq të gjatë e të suksesshme, me një mision kaq shkencor e kaq nacional, kur e di se në këtë tribunë kanë parakaluar përgjatë 34 edicioneve emrat më prominentë të shkencave albanologjike.

Një ndjenjë të veçantë më krijon edhe fakti se mijëra studentë nga vende të ndryshme të botës përgjatë 34 edicioneve kanë ardhur këtu për të mësuar shqipen, qindra prej tyre sot janë emra të njohur albanologjisë e shumë prej tyre kanë kontribuar për hapjen e katedrave të shqipes në Universitete prestigjioze në botë.

Natyrisht, ashtu siç një numër impresive studentësh e studiuesisht të rinj i bashkohen seminarit përvjet, një institucion kaq gjithëpërfshirës përjeton edhe humbjet e veta. Sivjet u nda nga ne profesoresha Hava Shala-Qyqalla, e cila për shumë vjet përveç se prezantoi në seminar rezultatet e punës së saj hulumtuese, mbajti mësim me shumë seminaristë.

Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, sivjet edhe formalisht po e përmbush një komponent të rëndësishëm, jo vetëm të emrit, por edhe të misionit të tij. Përveç sesioneve në fushë të gjuhësisë dhe të letërsisë, sivjet

nisim edhe sesionin e veçantë për kulturën shqiptare, në të gjitha dimensionet e saj. Gjithashtu, punimet e sivjetme botohen brenda këtij viti.

Dua t'i falënderoj, institucionet që mbështetën me zemërgjerësi këtë ngjarje të madhe të shkencës albanologjike. Rektoratit të Universitetit të Prishtinës, Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve. Mbështetja juaj në çdo drejtim, ka bërë që ne të merremi me të gjitha kapacitetet tona me përmbajtjen e seminarit.

Duke e falënderuar kryeministrin për praninë e tij dhe për fjalët që tha, nga kjo tribunë dua t'i ftoj institucionet shtetërore që të sigurojnë infrastrukturën e nevojshme për komunikimin e rezultateve shkencore të albanologjisë dhe të fushave të tjera, me shkencën dhe dijen globale, përmes krijimit të mundësive për anëtarësim në sistemet dhe mekanizmat e botimit, si në UNESCO etj. Ndërkaq, Ministrisë së Arsimit dhe rektoratit i kërkojmë të njohë dhe të pranojë rezultatet e punës hulumtuese dhe shkencore që bëhet në institucionin e Seminarit, pasi në botë nuk ka një institucion më serioz që merret me shkencat albanologjike dhe nuk ka një revistë më përfaqësuese se kjo e Seminarit, ku botohen të arriturat në këto fusha. Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare është tubimi më i madh dhe më i rëndësishëm i shkencave albanologjike, të cilat janë shumëdimensionale dhe multidisiplinare.

Të dashur seminaristë, që edhe sivjet vini nga anë të ndryshme të botës, mësoni edhe shqip, lexoni edhe shqip, shijojeni kulturën e Prishtinës dhe të Kosovës. Do të gjeni në shpirt të madh brenda. Kënaquni!

Ju faleminderit

LIGJËRATAT

Bardhyl DEMIRAJ

SHQIPËRIA DHE SHQIPTARËT NË OBORRIN E HABSBUURGUT – NJË RAST I PARË I NDËRLIKJES SE SHKENCËS ME POLITIKËN

Në këtë ligjëratë kemi bërë objekt studimi një letër-memorandum, me autor enciklopedistin dhe filozofin gjerman Gottfried Wilhelm Leibniz që i drejtohet në shtator 1688 Leopold-it I, perandor i Derës së Habsburgut. Edhe pse ky memorandum ka marrë prej vetë autorit titullin *Leopoldus Primus Austriacus Imperator turcas Europa divulsos opprimet armis*¹ (= Leopold-i I, perandor i Austrisë, dëbon turqit prej Europës me forcën e armëve), ai është pagëzuar ndërkohë prej botuesve të veprës së tij epistolare me një titull më domethënës *De Albania occupanda* (= Mbi pushtimin e Shqipërisë). Duke paraqitur në detaj përmbajtjen e këtij shkrimi, synojmë të përcjellim njëherësh tri qëllime kryesore:

- a) Njohjen me një aspekt deri para do kohësh të pavënëre në qerthullin e interesave të Leibniz-it për shqiptarët, gjuhën dhe hapësirën e tyre jetike në Ballkanin Perëndimor, përkatësisht ridimensionimin e vendit të tij në historinë e albanologjisë.
- b) Rolin e tij të mundshëm në zhvillimet historike-politike që përjetoj sidomos Kosova në fund të shek. XVII, sa i përket rrjedhës si edhe pasojave që përcolli kryesisht në këtë rajon “Lufta e Madhe Turke” midis Ligës së Shenjtë (= *Lega Sacra*) dhe Portës së Lartë (1683 - 1699) e në bashkëlidhje me këtë:
- c) Ngërthimin e aktivitetit shkencor-intelektual të Leibniz-it së bashku me angazhimin e tij politik në debatin e sotëm shkencor që ka rrokur sidomos studiues austriakë lidhur me një instrumentalizim të mundshëm të së ashtuquajturës ‘albanologji austro-hungareze’ në kontekstin e politikës hegjemoniste të Monarkisë së Dyfishtë në trevat shqiptare në Ballkan gjysmën e dytë të shek. XIX deri në shpërbërjen e saj menjëherë pas përfundimit të Luftës së Parë Botërore.²

¹ Leibniz: *Sammelwerke*, seria IV, bl. 3, f. 27 – 38.

² Gostentschnigg: 1999 221vv.; 2006/7 313vv; 2012, 31vv;

Ad a)

Nëse lejojmë të mëtoj që në fillim për një aspekt të pavënere në qerthullin e interesave të Leibniz-it për shqiptarët, gjuhën dhe hapësirën e tyre jetike, për këtë mjafton të përqasim ato kumte që mësojmë edhe prej botimit të fundit të Fjalorit Enciklopedik Shqiptar, ku personaliteti i Leibniz-it dhe vendi i tij në historinë e albanologjisë përshkruhet shprehimisht:

“LAJBNIC Gotfrid (Gottfried Wilhelm, LEIBNITZ, 1646-1716). Filozof e shkencëtar gjerman. Shfaqti interes edhe për gjuhën shqipe. Në pesë letra shkruar nga 24.06.1704 deri më 15.03.1715 mikut të tij M. V. La Kroze (La Crose), kryebibliotekar në Berlin. Shtroi problemet e prejardhjes së gjuhës shqipe, të përkimeve, takimeve dhe të marrëdhënieve të saj me gjuhë të tjera indoeuropiane; theksoi nevojën e dallimit të fjalëve me burim vendës nga huazimet. Vuri në dukje përkime e analogji të fjalëve shqipe me fjalë të gjuhëve gjermanike, latine etj. Tërhoqi vëmendjen te mëvetësia dhe individualiteti i gjuhës shqipe si gjuhë e veçantë, e dallueshme nga sllavishtja, hungarishtja, greqishtja, turqishtja. U interesua për të pasur Fjalorin latinisht-shqip të F. Bardhit dhe një vepër të P. Budit.” (M.D – FESH II, Tiranë 2008, f. 1451)

Siç na kumton edhe ky fjalor, sikurse edhe studimet shqiptare mbi historinë e albanologjisë³, Leibniz-in jemi mësuar ta lexojmë dhe citojmë shpesh si filozofin gjeni apo gjenin filozof, i cili me intuitën e vet të pazakonshme përsiati prejardhjen ilire të gjuhës shqipe; më tej si nxitësin e hulumtimit historik të shqipes, sidomos të shtresave të saj leksikut; dhe po në cilësinë e gjuhëtarit historian edhe si debutuesin e suksesshëm në studimin etimologjik të kësaj gjuhe. Sigurisht që për gjithë këto vlerësime i detyrohemi së pari Faik Konicës⁴, i cili atëbotë (1897) nuk u mjaftua vetëm të përcjellë në shqip vjeljet e mëhershme të albanologëve të huaj, por me ambicien dhe përkushtimin e tij të zakonshëm qëntoi dhe plotësoi analet e historisë së albanologjisë me aktivitetin epistolar të eruditit gjerman. Kjo trashëgimi i ka zgjeruar ndërkohë përmasat e saj, edhe sepse përkon me rrethanën fatlume që fondi i shkrimeve të tij sa vjen e plotësohet gjithnjë e më shterueshëm, duke u bërë në kohën tonë pronë e rretheve intelektuale e shkencore⁵. Është pikërisht kjo rrethanë që na lejon tash me marrë në analizë dhe hetuar këtë pamje deri vonë të panjohur në qerthullin e

³ Shih ndër të tjerë Shuteriqi 1976 101; 2005 233vv; Çabej, N.: 1990 41vv.; Gosturani 1999; Kastrati 2000 171vv. Ndër studiues të huaj dallojmë këtu studimet e Reiter 1980 82vv. dhe Hamp 1981 35; Hetzer 1985 184v.; 1996 77; më të hershëm: Masci 1807 14; Jokl: 1917 118, 127v. etj.;

⁴ Konica: 1897 41-3.

⁵ Shih më hollësisht për këtë temë Demiraj 2001 359vv.; 2005 13vv.

interesave të shumanshme të Gottfried Wilhelm Leibniz-it, bash me syzimet e tij lidhur me çështjen shqiptare në fund të shek. XVII.⁶

Të dhëna sporadike mbi Shqipërinë dhe shqiptarët i hasim në fakt në ndonjë shkrim të mëhershëm të Leibniz-it (mars 1672), e këto lidhen kryekëput me interesin e tij enciklopedik. Këto informacione i përcjellim të shpërndara në shkrimet e tij politike me temën: “Perandoria Turke dhe mënjanimi rrezikut turk për Evropën”, në cilën përfshihet studimi me titull “Consilium Aegyptianum” (= Plani Egjyptian), sidomos në rubrikën „De christianis in Turcico Imperio agentibus“ (= Të krishterët që veprojnë në Perandorinë Turke)⁷, ku autori, duke bërë një përqasje të përmbledhur mbi popujt e krishterë në perandorinë osmane, nuk ngurron të vërë theksin mbi popullsinë katolike shqiptare në zonat malore të Epirit dhe të Ilirisë, e cila mund dhe duhej të fokusohet në luftën ballore të Perëndimit kundër Portës së Lartë⁸. Sipas tij, kjo popullsi – falë edhe konfiguracionit të ashpër të terrenit e jo më pak në sajë të karakterit të saj luftarak – nuk i ishte nënshtruar ende sa e siç duhej sundimit osman, madje priste vetëm një sinjal prej Perëndimit për të ngritur krye ndaj pushtuesit turk.

Të dhënat mbi popullsinë shqiptare Leibniz-i i fitoi gjatë leximit të një traktati mbi beglerbegun e dikurshëm të Rumelisë që e paskësh hartuar dikur Gjon Bruni (= Johannes Brunius). Sipas Leibniz-it, ky autor me origjinë shqiptare⁹ i cilëson bashkatdhetarët e tij si të regjur tashmë në punë armësh, por edhe me një shpirt gjithherë të ashpër e kryengritës, aq sa vetë turqit iu frikuakan atyre për më të keqen. Kjo sepse ata nuk lënë rast pa kundërshtuar, madje nuk mungojnë të sajojnë vetë shkase spontane për të ngritur krye, duke justifikuar në këtë mënyrë edhe ndërmarrjet plaçkitëse me armë. Gjithsesi Bruni nuk heziton të shtojë në traktatin e vet se do të gaboheshin rëndë të gjithë ata që do të besonin se kjo popullsi do të mund t’ia dilte mbanë vetë asaj lufte, pa pasur mbështetjen e duhur prej perëndimit. Sipas Leibniz-it, kjo premisë vlen përgjithësisht për gjithë popujt e nënshtruar prej turqve, të cilët janë

⁶ Ky aspekt i interesave të Leibniz-it është trajtuar gjerësisht prej shkruarit të këtyre radhëve në 2005 13vv.; 2007 62vv.

⁷ Leibniz: *Sammelwerke*, seria IV, bl. 1, f. 331-7; *Consilium Aegyptianum*; Nr. 15: *Justa dissertatio*, II. Teil: Rubrik „De christianis in Turcico Imperio agentibus“ (ca. Mitte März 1672)

⁸ Po në këtë shkrim, në rubrikën „De primo Visiro“ (f. 324-6) bëhet një paraqitje të gardës së jeniçerëve, që drejtohej atëherë prej kryevezirit Qyprilliu „me kombësi shqiptare ose bosnjake“ dhe që kishte në përbërjen e vet kryesisht mercenarë shqiptarë.

⁹ Autori i këtyre radhëve nuk ka mundur deri sot të sigurojë informacion plotësues si për traktatin në fjalë ashtu edhe për autorin e tij. Gjithsesi lejohemi të shtrojmë këtu për diskutim emrin e arqipeshkvit të Tivarit Joannes Brunius Olchiniu (mesi i shek. XVI), i cili mori pjesë edhe në Koncilin e Trientit (shih Farlatius, *Illyrici sacri*, t. VII, 1817 102vv.).

zhveshur prej çdo lloj pasurie, por që do të mund të mobilizohen menjëherë, sapo të vërejnë se si shkëlqejnë armët e Perëndimit të krishterë në logun e perandorisë¹⁰.

Ndërmarrje intensive dhe të drejtpërdrejta me çështjen shqiptare arrijmë t'i izolojmë gjithsesi rreth 16 vjet më pas, pikërisht në periudhën e qëndrimit të tij në Vjenë (maj 1688 – shkurt 1689), kur Leibniz-i rreket të ngadhënjejë vëmendjen, dhe të fitojë kështu një pozicion të përshtatshëm në oborrin perandorak të Habsburgut¹¹, si këshilltar personal i perandorit Lepold I. Siç mësojmë prej biografëve të tij, ishte kjo një dëshirë e zjarhtë që e brente Leibniz-in prej thujtje 20 vjetësh, sepse – dhe e këtë e mësojmë prej tij – “bey einem grossen Potentaten sich weit andere Gelegenheiten zu nützlichen Verrichtungen finden.” (= tek të plotfuqishmit e mëdhenj gjenden mundësi nga më të ndryshmet për ndërmarrje të dobishme”)¹²

Pikërisht gjatë qëndrimit në Vjenë Leibniz-i hedh në letër memorandumun në fjalë. Shkas për të i jep rënia e Beogradit (më 6 shtator 1688) në duart e ushtrisë perandorake¹³. Në memorandum, krahas këshillës për të vijuar ofensivën ushtarake deri në dëbimin përfundimtar të turqve prej Ballkanit, Leibniz-i shtjellon me argumente mbushamendëse si pozitën e favorshme strategjike ashtu edhe përparësitë politike-ekonomike që do të mundësonte marrja në zotërim e pjesës perëndimore të gadishullit prej Perandorisë Austro-Hungareze, e cila do të pritej si çliruese e jo si pushtuese e atyre trevave. Është pikërisht kjo arsyeja që edhe botuesi i këtij vëllimi epistolar i jep këtij shkrimi emërtimin *De Albania occupanda*, meqë aty bëhet fjalë pikërisht për çështjen shqiptare, përkatësisht për trevat shqiptare, të cilat duhej të përfshiheshin herët a vonë brenda kufijve të perandorisë.

¹⁰ Teksti i plotë latinisht: “... Constat Albanos aliosque montanorum Serviae, Epiri, Illyrici incolae ob asperam locorum naturam satis domitos, caeterum natura feroces et Turcis infestos esse. [...] Ioh. Brunius natione Albanus tractatu de Beglerbegatu Graeciae refert hos Albanos religione Latinos esse, armis instructos, strenuos haberi, et propter continuos motus Turcas sibi ab ijs pessimè timere: propter causas minimas eos tumultuari. Sangiacos quoque saepe ijs occasiones tumultuandi sponte praeberere, ut praedarum praetextum habeant. Sed falli eos addit Brunius, qui has gentes sine exterorum subsidijs egregij aliquid praestituras autument, quinque putent famam tantum Italicis, Hispanicis auxilijs velut vexillo sublato ad sedionem illis sufficere. Quod de omnibus in uniuersum Turcarum subditis dicendum est, eos per se nihil posse, at cum arma Christianorum in imperij medio fulgere cernent, tum demum Elateria illa hactenus tensa momentaneo impetu laxabuntur.” (f. 337)

¹¹ Hollësisht për ambiciet e Leibniz-it për të bërë karrierë në oborrin e Habsburgut në Hirsh 2000 221vv.

¹² Hollësi për te Hirsch 2000 216ff.

¹³ Ky memorial ruhet sot në dy versione, të cilat përcjellin në instancë të fundit një qëllim të përbashkët, veçse në strukturë dhe përmbajtje nuk përkojnë thujtje aspak me njëri-tjetrin.

Pas një operacioni të qëlluar gjuhësor lidhur me etimologjinë e toponimit <Beograd> (= Bello|grad **“qytet i bardhë”*¹⁴) Leibniz-i përqendrohet që në fillim me paraqitjen e historisë së larmishme të hapësirës së ashtuquajtur <Albania>, duke bërë një digresion kronologjik që ngërthen gjithë periudhën e antikitetit e vijon deri në mesjetë, kur gjëllinte atëbotë në trojet shqiptare heroj legjendar Skënderbeu. Vetëm pas vdekjes së tij, në gjysmën e dytë të shek. të 15-të, ky vend nuk ia doli më mbanë t’u bënte ballë hordhive turke, duke rënë kështu përfundimisht nën sundimin osman. Tashmë – përsiat Leibniz-i – Habsburgu duhet ta shfrytëzojë rastin fatlum të thyerjes së ushtrisë turke në portat e Beogradit për të përfshirë në trevat e perandorisë edhe këtë “vend të mrekullueshëm” përgjatë brigjeve të Adriatikut dhe të Jonit. Një ndërmarrje të tillë e motivon, sipas tij, ndër të tjera¹⁵:

¹⁴ „... Imo hinc nomen hodiernum habere arbitratur, quasi Pulchrigrod, est enim Grod Slavonis urbs. Sed mea opinione nihil aliud est Belgrad quam Bialogrod (cuius nominis etiam urbs est in Russia) id est Alba urbs, Biala enim Slavonis est, quod album Latinis, Albam vero Graecam appellari omnes scimus. ...“

¹⁵ „Sed dextrae ripae miles, facile omnia Sophiam usque summittet prona Rasciorum et Bulgarorum Christianorum voluntate usus, qui insueta plus quam a seculo arma resumentes, gens natura acris et bellicosa, Turcas invisos dudum et graves Dominos, ubique profligant, sternunt, caedunt. Bosnia et Servia patent victori, et his subactis, id proximum esse videtur, ut maturato in vicinam Albaniam transitu nostri vocantes dudum populos recipiant magis quam redigant in potestatem. Itaque florentissimus exercitus videtur novae adhuc expeditioni sufficere, si modo expeditionem vocare oportet, quod nihil aliud esse putandum est, quam itio in hyberna.

Sed quanti futura sit Augustissimae Domui Albaniae possessio, operae pretium videtur, paulo distinctius explicare. (S. 35) [.....] „Albania igitur in potestatem redacta, ingens Austriae potentiae accessio erit, et milites inde lecti, robore et agilitate et audacia praestantes, ubi semel ad nostrum morem servare ordines et disciplinae obedire discent, nullis aliis facile concedent. Accedit situs Regionis secundum Hadriaticum mare protensae ex adverso Italiae; ubi sinus Venetus sese in Jonium mare effundit. Illic ergo potentiae maritimae nova merito fundamenta jacentur. Cum enim ab alia parte mari propinquare nequeant Austriaca arma sine injuria aut suspicionibus certe Venetorum qui omnem fere Istriae atque Illyrici oram praeoccupavere; hac tamen in parte relictus est vacuus primo capienti locus. Eoque magis festinandum est, ne ab amicis paria cupientibus praeveniamur. Nisi peculiari cum Venetis tractatu hanc sibi fortasse libertatem majoris sive sui sive rei Christianae boni causa sapientissimus Caesar adimere consultum putavit. De quo mihi nil constat.

Aperietur [sipas mendimit tim duhet të jetë forma e ardhme dhe jo Ind. Praes. *aperitur!*] etiam per Albaniam novum commerciis maritimis iter, nam Tergestum, et vicina litoralia Austriacarum terram loca nimis intra sinum Hadriaticum abscondita difficiliter et vix nisi aliorum venia mari acceduntur [edhe ketu, sipas kontekstit besoj se duhet te behet fjale per foljen *accedere* dhe jo *accendere*]. Sed Albania ad ipsum sinus introitum sita, apertum exitum, nec contemnendas navium stationes habet et praetera mare propemodum Danubio copulat, et, si Hungariae vicinisque regionibus adjungatur, pro portu illis erit, multumque et coloniis allectis, et commerciis auctis, [me duket se mungon nje presje!] populositati ac divitiis fertilissimarum per se, ac pulcherrimarum regionum addet. Audio etiam lanam Albanam praestantissimam esse, nec concedere Hispanicae, quae sola tamen hactenus in Europa regnat, ut sine illa nulli

- Pushtimi do t'i shërbente jo thjesht dhe vetëm interesave të Habsburgut, por fateve të krishterimit në përgjithësi.
- Në atë ridimensionim që pritej të përjetonte gjeografia politike e Europës, ngadhënjimi i trojeve shqiptare do t'i mundësonte superfuqisë austro-hungareze të kohës një pozitë të përshtatshme strategjike, meqë ky vend jo rastësisht shtrihej përballë Italisë, përkatësisht shumë më në jug se sa trevat e republikës detare të Venedikut. Shqipëria mundësonte kështu kushte optimale për përfitim të një fuqie të re detare, e cila do të vinte nën kontroll qarkullimin e flotës perandorake nga Gadishulli i Istriës deri në jug të bregdetit dalmat.
- Bregdeti shqiptar ofronte gjithashtu hapjen e rrugëve të reja detare në shkëmbimet tregtare, veprime që atëherë kufizoheshin në portin e Triestes, i cili për vetë pozitën e tij, të fshehur në skajin më verior të gjirit të Adriatikut, e pengonte atë liri të nevojshme komunikimi tregtar që do ta mundësonin portet në bregdetin shqiptar. Për më tepër, brigjet shqiptare të Adriatikut do të mund të shfrytëzoheshin edhe nga zona të tjera të perandorisë, si p.sh. Hungaria, duke bërë kështu të mundur intensifikimin e lidhjeve të brendshme tregtare me Danubin.
- Zhvillimi i tregtisë e sidomos popullimi i gjithë rajonit me kolonë të huaj do ta shndërronte këtë zonë në një ndër rajonet më të tërheqëse e të pëlleshme në gjithë perandorinë.
- Leshi i bagëtive në Shqipëri si lëndë e parë e shumëkërkuar në tregjet e Europës nuk mbetej prapa në cilësi ndaj atij spanjoll, andaj duhej shfrytëzuar edhe kjo rrethanë që të normalizohej tregtia i këtij malli me vlerë në tregjet europiane.
- Shqiptarët ishin ndërkohë të mirënjohur si luftëtarë besnikë dhe të zotë. Mercenarët që do të mund të rekrutoheshin aty – pasi të kishin mësuar artin dhe disiplinën ushtarake të perëndimit – do të bëheshin një faktor vendimtar në ndërmarrjet e ushtrisë perandorake.

panni nobiliores confici posse credantur. Eoque magis Austriacis ditionibus adjicienda regio est, tum ut manuficiis utilibus serviat, tum ne ab aliis praerepta nocere possit.

Sed major alia superest Albaniae occupandae ratio, quam nunc exponere operae pretium videtur. Nimirum ut paucis dicam, Albania ex adverso Italiae, et maxime Neapolitani Regni sita, si teneatur Imperatoris nostri armis, novam Austriacae potentiae communicationem dabit, et Caesareas Regiones Hispanicis inexpectato vinculo connectet..." (f. 37).

Memoriali përmbyllet me parashtrimin e disa argumenteve që do të çonin në rrëgjimin e mbretërisë spanjolle si edhe duke shtjelluar shkurt situatën politike në Evropën Qendrore (f. 38).

Ad a/b)

Gjithë këto përsiatje, të cilat shumëkush sot i percepton në mënyrë spontane si pjellë e politikës kolonialiste europiane të kohës, kërkojnë padyshim një hulumtim shterues në rrafshin historik, sepse i paraprijnë në kohë atyre zhvillimeve politike-ushtarake që përjetoi Ballkani Qendror dhe Perëndimor në fund të shek. XVII përgjatë Luftës së Lidhjes së Shenjtë kundër Portës së Lartë. Prekim kështu synimin e dytë të kumtesës sonë, meqë ndoshta nuk është rastësi që pikërisht një vit pas këtij memorandumit (shtator 1689) trupat e Austro-Hungarisë vendosën kampin ushtarak kryesor (nën drejtimin e gjeneral Piccolomini-t) pikërisht në Kosovë¹⁶, sikurse nuk është rastësi që këtyre trupave iu bashkua edhe popullsia katolike shqiptare e Veriut nën drejtimin e Imz. Pjetër Bogdanit. Ndërkohë janë bërë të njohura pasojat e kësaj lufte (edhe) për popullsinë katolike shqiptare në Kosovë dhe Rrafshin e Dukagjinit, përkatësisht shpërnguljet masive edhe të popullsisë shqiptare (= “kelmendasit”) drejt kufijve jugorë të Austro-Hungarisë¹⁷.

Në pamundësi të shtjellojmë më tej këtë rrethanë, çka parakupton edhe punën e autoritetin e historianit specialist të fushës, lejohe mi që në vijim të kësaj parashprese të përqendrohemi kryesisht në njohuritë enciklopedike të Leibniz-it mbi Shqipërinë dhe shqiptarët, të cilat ai e parashtron përmbledhtas bash në hyrje të memorialit¹⁸: Kështu:

¹⁶ Bartl: 1995 71v.; Weithmann 1997 176vv.

¹⁷ Shih Malcolm: 1998 139vv.; Oliver Jens-Schmitt: 2008 146f.

¹⁸ „Sed quanti futura sit Augustissimae Domui Albaniae possessio, operae pretium videtur, paulo distinctius explicare. Albania ejusque caput Albanopolis jam veteribus Geographis (Geographis: ndoshta me të vogël???) memorantur. Sed tunc exiguum tractum significabat in montanis. Postea vergente Constantinopolitano Imperio, gens bellicosa sese latius extendit, et sive armis, sive fama vicinis nomen suum communicavit, atque etiam in Peloponnesum sive Moream irrupisse memoratur. Et quam graves fuerint Graecis narrat Imperator Cantacuzenus, usque adeo ut Turcarum auxilia domandis ipsis evocarentur, quae res cum aliis similibus postea in Graecorum perniciem vertit. Hodie igitur Macedoniae pars nobis propior, et portio Epiri, sed illa potissimum, quam Romani (presja me duket se ishte e tepert) cum Illyriis ademtam in provinciam redegissent, novam Epirum vocabant, sub Albania censentur. Urbes Durazzo quod est veterum Dyrrhachium, Scodra vel Scutari, Croja sedes Scanderbegi, Valona, aliaeque plures.

Hos populos militari fama ab omni memoria floruisse constat. Hinc egressi sunt, qui sub Alexandro M. Persarum ingens imperium everterunt, et victorias in ipsam usque Indiam protulerunt. His regionibus imperitavit Pyrrhus Rex, qui Alexandri aemulator nec nisi occasionibus inferior fuit, et in Italiam transgressus Romanos percudit, vix demum difficili bello repulsus. Cum vero postea Romani omnia imperio complexi essent nihil amplius publice agebant submissi populi et confusis atque obumbratis Romana magnitudine nationibus vix nomina audiebantur. Ast ubi Turcae (edhe ketu presja me duket se nuk ka kuptim!) Graecis (qui se Romanos adhuc vocabant) successere, in hoc rerum transitu movere sese Albani iterum, nunc Graecis afflictis infesti, nunc Turcis victoribus resistentes, quorum odio novissime Georgius Castriota inclaruit, Turcis ab Alexandri imitatione Scanderbeg appellatus. Hunc Georgium Johannes pater Amurati II. (kontrolloje njehere ne original Bardhi, se me duket cudi qe numeroret romake te shoqerohen me pike... ndoshta eshte IL???) Turcarum Tyranno

- Leibniz-i shkruan se <Albania> (= Shqipëria) me kryeqendrën e saj urbane Albanopolis-in përmendet si e tillë qysh në kohën gjeografëve të vjetër¹⁹ (= pas gjase Ptolemeus – shek. II e.j.), por atëbotë ky toponim emërtonte një krahinë të vogël malore. Duke iu referuar historianit bizantin Johannes Cantacuzenus (= gr. \square $\omega\acute{\alpha}\nu\nu\eta\varsigma$ $\Sigma\Gamma$ Καντακουζηνός - (?)1292 - 15.06.1386) Leibniz-i shton më tej se populli luftarak i shqiptarëve gjatë periudhës së sundimit bizantin i zgjerohet kufijtë e vet, duke e përhapur këtë emër sa me forcën e armëve aq edhe me famën e tij luftarake edhe mbi popujt fqinjë. Ky emër ngërtheu pjesë të Maqedonisë antike që shtrihet atëbotë deri në Adriatik, gjithashtu edhe në një pjesë të Epirit, e sidomos në atë zonë që romakët e emërtuan dikur Epirus Nova, pasi ua kishin shkëputur më parë ilirëve, duke e shpallur atë patëkeq si provincë romake. Ndër qendrat kryesore urbane që ngërthejnë ndërkohë këto troje, Leibniz-i numëron ndër të tjera: Durrësin (Dyrrachium), Shkodrën (Scodra), Krujën (Croja – si selia e dikurshme e Skënderbeut), Vlorën (Valona) etj.
- Sipas Leibniz-it është fjala këtu shi për atë popullsi që u dallua në shekuj për famën e saj luftarake. Këtu gjëllinin pikërisht ata popuj që nën Aleksandrin e Madh ngadhënjyen ushtrinë perse, duke i shtyrë kufijtë e perandorisë deri në Indi. Në këtë krahinë sundoi për do kohë edhe mbreti i Epirit, Pirro, i cili imitoi pararendësin e tij, Aleksandrin e Madh, duke luftuar me sukses kundër romakëve. Por më vonë, kur e gjithë kjo zonë u

obsidem cum fratribus dederat. Periere quatuor fratres fraude et crudelitate Turcarum, unus Georgius forma, fortitudine et aliis dotibus commendatus exitium evasit. Sed cum adolevisset captata occasione fugit ab aula Turcae, et in patriam reversus Crojam sedem principatus stratagemate recepit, et reliquis occupatis, omnem potentiam Ottomannicam (mos eshte me nje –n-?) feliciter sustinuit, ipso Amurate II, (ketu presja me duket e pavend; ose pike ose II; kontrolloje njehere ne origjinal) sub Crojae moenibus extincto. Eadem fortuna et virtute restitit Mahumeti eius filio qui Constantinopoli capta primus Turcarum imperator habetur. Sed mortuo Castriota anno 1467, filii et paternae magnitudini et immensae hostis potentiae impares postremo succubuere. Vitam Scanderbegi popularis sui peculiari opere persecutus est Marinus Barletius Albanus Scodra oriundus. Unde alii hausere quae de tanto viro narrantur. Subacti Albani Turcis postea peritiles fuere, et quemadmodum omnes fatentur Europaeos Turcarum milites Asiaticis praestare, ita constat inter ipsos Europaeos praecipui nominis Albanos haberi. Inde equites insignes, nec minus janissari fortissimi prodire. Jam olim Virgillii testimonio *Miserat Heliadum palmas Epirus equarum*. Et hodie Albani equites etiam Venetis usurpati, aut repraesentati, sub Capeletorum appellatione censentur. Bassae etiam fortissimi Albaniam patriam habuere, et inde ortus est inter alios Kiuperli primus Visirius, qui auctoritatem maximam non nisi cum vita posuit, vel potius in filio conservavit, quem Bellum Hungaricum superius gessisse, et Candia Venetis admata diuturnae obsidioni finem fecisse recenti memoria omnes tenent.” (S. 35-37)

¹⁹ Bëhet fjalë këtu padyshim për gjeografin aleksandrin Ptolemeus në veprën e tij „Geographia“, T. I, Lib. III, Kap. 13, § 23.

bë pjesë e perandorisë romake, ra heshtja e rëndë për popujt e saj të nënshtruar, aq sa edhe emrat e tyre nuk u përmendën më. Emri i shqiptarëve erdhi e u rishfaq në historinë europiane sidomos kur në Ballkan ia behën turqit, kundër të cilëve u dallua Gjergj Kastrioti, që turqit e njohën si <Scanderbeg>, sipas emrit të Aleksandrit të Madh.

Pjesa hyrëse e këtij memoriali përmbillet me informacione deri diku të hollësishme mbi: a) historinë e lavdishme të Gjergj Kastriotit, të cilën Leibniz-i e kish lexuar në “veprën e jashtëzakonshme” të humanistit shqiptar Marin Barleti; b) karrierën e shkëlqyer ushtarake të dy shqiptarëve: Mehmet Qyprilliu (kryevezir i perandorisë më 1656) dhe djali i tij Ahmeti, i cili në vitet 1663-1664 pushtoi Hungarinë; si edhe c) famën e mercenarëve shqiptarë që shërbenin si kalorës në gardën perandorake osmane (*jeniçerët*), ose në ushtrinë e Republikës së Venedikut (it. *capelletti*).

Njohja me këto shkrime deri vonë ende „të panjohura“ mundëson rivlerësimin e vendit të eruditit gjerman Gottfried Wilhelm Leibniz në historinë e albanologjisë, duke përfshirë këtu edhe një dimension të ri: interesimin e tij për shqiptarët, historinë dhe vendbanimet e tyre. Ndryshe nga interesimi i tij për shqipen, i bërë thjesht nga perspektiva e historianit të gjuhës, në këtë dimension të dytë ai vepron në pamje të parë si enciklopedist, por ndërmerr në të njëjtën kohë vullnetarisht – më saktë: për të fituar simpatinë e oborrit perandorak të Habsburgut – edhe rolin e këshilltarit politik, duke vënë në pah pozitën e përshtatshme gjeostrategjike dhe përfitimin e madh politik e ekonomik të derës së Habsburgut, në rast se kjo superfuqi e kohës do të orientonte ekspansionin e vet drejt hapësirës jetike shqipfolëse në Ballkan, së cilës – sipas tij – i sigurohej gjithsesi si kompensim liria dhe prosperiteti i shumëkërkuar.

Ad c)

Ky dimension i ri ndërmjetëson njëherazi edhe ndonjë tipar të karakterit njerëzor të Leibniz-it, siç është p.sh. rasti me synimin e tij për të arritur një pikë kulmore në karrierën personale si këshilltar i sunduesit të plotfuqishëm të asaj kohe, e në bashkëlidhje me këtë të ngadhënje sukses, emër e famë në aktivitetin e vet intelektual-shkencor, meqë siç mëton vetë “tek të plotfuqishmit e mëdhenj gjenden mundësi nga më të ndryshmet për ndërmarrje të dobishme”.

Prekim në këtë rast si synim të tretë të kumtesës sonë, qoftë edhe me stil telegrafik: një temë, e cila po fiton gjithnjë e më shumë terren në debatin shkencor të kohës sonë, pikërisht atë ndërvarësi të supozuar në marrëdhëniet midis kërkimit shkencor (albanologjik) dhe politikës së një vendi që ka mbështetur apo mbështet me

rrugë institucionale këtë kërkim. Fokusin e këtij diskursi shkencor-historik e përjetojmë ndërkohë sidomos në disa analiza të studiuesve austriakë lidhur me marrëdhëniet ndërmjet albanologjisë austro-hungareze dhe një lloj planifikimi të mundshëm për ekspansion politik, ekonomik e kulturor të Derës së Habsburgut në Shqipëri në gjysmën e dytë të shek. XIX deri në fund të Luftës së Parë Botërore²⁰, një periudhë kjo që u shoqërua me mbështetjen dhe mbarëvajtjen në vazhdimësi të kërimit shkencor albanologjik në disa universitete si në Vjenë, Grac (= Graz), Budapest e Pragë, apo me themelimin Komisionit Ballkanik në Vjenë (Balkan-Kommission – 1897) dhe të Institutit Ballkanik në Sarajevë (Balkan-Institut – 1908). Bëhet fjalë gjithashtu për një periudhë, kur sidomos Shqipëria e Veriut me bashkësinë katolike shqiptare u ngërtheu në suazën e të ashtuquajturit Protektorat Kulturor të Monarkisë së Dyfishtë; një periudhë pra, kur u formëzua në kuptimin e mirëfilltë të fjalës albanologjia (austro-hungareze) si shkencë komplekse në thuajse të gjitha disiplinat e saj (: gjuhësi, histori, gjeografi, e drejtë zakonore, kulturë popullore, arekologji etj.), e për më tepër një periudhë, kur studiuesit e mirëfilltë, përpos kërimit shkencor mund dhe duhet t'i kenë shërbyer në një mënyrë a një tjetër edhe interesit politik, ushtarak, ekonomik dhe kulturor të të ashtuquajturit 'imperializëm (in)formal' në kuadrin e posëashtuquajturës 'dhunë strukturore' që mund a duhet të ketë ushtruar sistemi shtetëror, në të cilin dhe për të cilin shërbenin. Bëhet fjalë pra për një strategji politike-ushtarake dhe ekonomike apo një ndikim të programuar kulturor afatgjatë të Austro-Hungarisë në trevat shqiptare, të cilët u shoqëruan më pas me pushtimin e pjesës më të madhe të trevave shqiptare prej Austro-Hungarisë gjatë Luftës së Parë Botërore (1916 - 1918).

Në fokusin e kësaj perspektive studimi janë përfshirë ndërkohë prurjet e studiuesve të mirënjohur në albanologji si: Johann G. v. Hahn (konsull në Janinë), Theodor A. Ippen (konsull në Shkodër), Milan Šufflay, Josef Konstandin Jireček, Ludwig v. Thallóczy, Franz Baron Nopcsa, Maximilian Lamberz, Gjergj Pekmezi, R. Nahtigal, Franz Seiner etj. Sa kanë qenë këta studiues të vetëdijshëm për këtë ndërlikë të shkencës me politikën, përkatësisht në ç'masë i ka shërbyer njëri apo tjetri me ose pa vetëdije kësaj politike, janë këto çështje që i kapërcejnë caqet e debatit të mirëfilltë albanologjik, sa kohë që angazhimi social dhe aktiviteti intelektual i njërit apo tjetrit studiues ruan parametrat e kodit moral dhe etik të kërimit shkencor për kohën, në të cilën dhe për të cilën kanë vepruar. Parë nga kjo perspektivë edhe kjo aktiviteti shkencor-intelektual dhe angazhimi social-politik i Leibniz-it për Shqipërinë, shqiptarët dhe gjuhën e tyre fiton edhe me shumë kuptim, edhe pse memorandumit e tij e përcjellim sot me titullin e pagëzuar për herë të dytë "De Albania occupanda".

²⁰ Paraqitje e detajuar e këtij debati prej Gostentschnigg 1999 221vv.; 2006/7 328vv.

Bibliografi

Burime dokumentare

- Leibniz, Gottfried Wilfred: Sammelchriften und Briefe; seria IV: Politische Schriften, bl. 1. (1667 –1676), botuar prej Preußische Akademie der Wissenschaften, Otto Reichl Verlag, Darmstadt 1931.
- Sammelchriften und Briefe; seria IV: Politische Schriften, bl. 3. (1677–1689), botuar prej Zentralinstitut für Philosophie an der Akademie der Wissenschaften der DDR, Akademie Verlag, Berlin 1986.

Literaturë shkencore

- Bartl, Peter (1995): Albanien - Vom Mittelalter bis zur Gegenwart, Regensburg.
- Çabej, Nelson (1990): Autoktonia e shqiptarëve në studimet gjermane, Tiranë.
- Demiraj, Bardhyl (2001): Si të lexojmë Leibniz-in, në: Seminari ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare (Prishtinë-Prizren, gusht 2000), Prishtinë 2001, f. 359-371.
- (2005) Leibniz' Stellung in der Geschichte der Albanologie, në: Festschrift für Wilfried Fiedler, Hamburg 2005, f. 13 – 31.
- (2007) De Albania Occupanda” – çështja shqiptare në Memorialin e një eruditi, in: “Hylli i Dritës” 4 [2007] 62-70.
- Gostentschnigg, Kurt (1999): Die Verflechtung von Wissenschaft und Politik am Beispiel der österreichisch-ungarischen Albanologie, në: “Südost-Forschungen” 58 [1999] 221-245.
- (2006/7): Albanerkonvikt und Albanienkomitee. Instrumente der Handels- und Verkehrspolitik -Österreich-Ungarns gegenüber Albanien im Dienste des informellen Imperialismus, në: “Südost-Forschungen” 65/66 [2006/7] 313-337.
- (2012): Johann Georg von Hahn dhe albanologjia austro-hungareze midis shkencës dhe politikës, në: Johann Georg von Hahn. Akten der Internationalen Konferenz “Nga Gjermanistika në Albanologji: Johann Georg von Hahn, themeluesi i albanologjisë me rastin e 200-vjetorit të lindjes”; seria “Albanische Universitätsstudien (vormals Elbasaner Universitätsstudien)” Sonderband 1; Oberhausen.
- Gosturani, Xheladin (1999): Historia e albanologjisë, Tiranë.
- Hamp, Eric (1981): On Leibniz's Third Albanian Letter, në: "Zeitschrift für Balkanologie" 17 [1981] 35.

- Hetzer, Armin (1985): Zur Geschichte der deutschsprachigen Albanologie. 150 Jahre seit Erscheinen von Josef Ritter von Xylanders Handbuch des Albanischen (1835), në: „Balkan-Archiv“ N.F. 10 [1985] 181-217.
- (1996): Kontributi i Josef fon Ksilanderit për albanologjinë, në: Kontribute të albanologëve të huaj për studimin e gjuhës shqipe, Shkodër, *passim*.
- Hirsch, Eike Christian (2000): Der berühmte Herr Leibniz. Eine Biographie, München.
- Jokl, Norbert (1917): Albanisch, në: Geschichte der idg. Sprachwissenschaft, bl. II, pjesa 3, Straßburg.
- Kastrati, Jup (2000): Historia e albanologjisë, bl. I, Tiranë 2000.
- Konica, Faik (1897): L'opinion de Leibniz sur la langue albanaise, në: "Albania" 3 [1897] 41-3.
- Masci, Angelo (1807): Discorso sull'origine, costumi, e stato attuale della nazione albanese, Napoli 1807.
- Malcolm, Noel: Kosovo. A Short History, London – New York 1998;
- Reiter, Norbert (1980): Leibniz'ens Albanerbriefe, në: "Zeitschrift für Balkanologie" 16 [1980] 82-8.
- Schmitt, Oliver Jens (2008): Kosovo - Kurze Geschichte einer zentralbalkanischen Landschaft, Wien - Köln - Weimar.
- Shuteriqi, Dhimitër S. (1976): Shkrimet shqipe në vitet 1332-1850, Tiranë.
- (2005): Tekstet shqipe dhe shkrimi i shqipes në vitet 879 - 1800, Tiranë.
- Weithmann, Michael W. (1997): Balkanchronik - 2000 Jahre zwischen Orient und Okzident, Darmstadt (bot. i dytë).

Maximiljana BARANČIĆ

LEXIS OF ZADAR ALBANIAN SPEECH AS REFLECTION OF LANGUAGES IN CONTACT

Abstract

This work represents an attempt to analyse etymologically the lexis belonging to the Zadar Albanian idiom, gheg speech, today still spoken in Zadar by 150 to 300 mostly elderly people, descendants of the Albanians, who moved to Zadar during the first half of the 18th century, from the villages around Lake Skadar. The total of 1779 lexical units of the Zadar Albanian speech were analysed. Our corpus was collected during field researches in 2009, based on the questionnaire prepared for Linguistic Atlas of Istrian idioms by Goran Filipi. The corpus consists of twenty-three semantic fields: *weather, geomorphology, customs, church, body and senses, perceptions and impressions, time and calendar, life, marriage and family, home and possessions, clothes and accessories, food and drink, birds, insects, other wild animals, works and tools, viticulture, animal farming, olive and fruit growing, vegetable growing, trees, shrubs and wild plants, sea and coastal geomorphology and meteorology, maritime affairs and vessels and marine flora and fauna: fishing*. Etymological analysis showed that from a total of 1779 lexical units 598 (Albanian lexis) were brought from the old country which makes 33,24 %, whereas the number of 1161 lexical units or 65 % belong to the lexis Arbanasi borrowed after settling in Zadar. The number of direct Veneto-Roman loan-words is 265 or 14,47 %, while the number of Croatian loan-words, including Croatian Romanisms, Germanisms and other alloglotic elements in Croatian is 797 loan-words or 44,3 %. Italian and Venetian influences are explained by prestige of the two idioms in the past and Italianisation in the period between the two world wars, and Croatian by common economic framework (primarily agriculture and livestock) of the Croatian and Albanian population in Zadar, and sociolinguistic position of Croatian since the end of the Second World War until today.

Key words: Chakavian, Croatian, etymology, Italian, language contacts, lexis, Zadar Albanian

1. INTRODUCTION

I wanted as a native speaker of the Zadar Albanian speech and woman member of the Zadar Albanian language community, with my own efforts and knowledge, to contribute to the research and preserving of the Zadar Albanian speech, as my professional and formal educational background made it possible for me. Many distinguished linguists such as Miklosich, Weigand, Tagliavini, Ajeti, Krstić, or Orel, contributed significantly to the research of the Zadar Albanian speech, first of all, from Albanological perspective, whereas they were engaged to a lesser degree in contacts of the Zadar Albanian speech with other idioms in Zadar. This work represents an attempt to complement the mentioned emptiness and contribution to the study of the history of the Croato-Zadar Albanian and Italian- Zadar Albanian languages in contact in the field of lexis. The Zadar Albanian speech is the representative of the Albanian speeches physically separated from their mother tongue area, and as such represents a first-class linguistic and ethnological preciousness.

The Zadar Albanian speech from its very appearance on the Zadar territory was included in complex sociolinguistic relationships which existed in the city at that time. At the level of the spoken language it was subordinated to the local variant of Venetian, the Zadar type of the language (so called *zaratinski*), and Chakavian type of Croatian, which was used by the Croatophone inhabitants of the city and suburban villages of that time, such as Stanovi, because they had to resort to both idioms in everyday communication outside their narrower community; as spoken idiom, without its institutional support (administration, education system, church), the Zadar Albanian, of course, could never meet the needs of its speakers for the standard language, which were used for those purposes in Italian and Croatian (differently in different periods) and depending on political situations. Arbanasi from Zadar were from the very settling directed to borrowing from the four mentioned systems which formed the complex language picture of Zadar.

Purpose of this work was dual: on one side to give the synchronic survey of the Zadar Albanian speech, in terms of corpus, collected by implementation of the unique questionnaire in a shorter period of time, and make possible the comparison, even though quantitatively limited, of a praiseworthy Krstić's corpus with the situation from the beginning of the 21st century; on the other side, however, to show on the collected corpus contacts of the Zadar Albanian with other idioms in Zadar in the field of lexis, establishing the ratio and relation of the lexis brought from the old country, and the lexis borrowed in a new country by semantic fields.

2. METHODOLOGY OF RESEARCH AND MATERIAL ANALYSIS

Theoretical basis of the work make the contemporary fundamental elements of the theory of languages in contact and contact dialectology. The research work is connected with the theory of languages in contact, whose main representative in Croatia was academician Rudolf Filipović. On the other, practical side, the main foothold for us were the questionnaires which the academician Goran Filipi, within the scope of contact dialectology, made for the researching the Istrian and Istrio-Romanian languages.

When it is about the past notions about the Zadar Albanian speech, as a starting point we used Ajeti's and Tagliavini's description of the Zadar Albanian speech, and Krstić's *Rječnik govora zadarskih Arbanasa (Dictionary of the Zadar Albanian Speech)*. But, we have to emphasize that the focus of all mentioned works is in the Albanian component of the Zadar Albanian speech, and not in the lexicological aspects of the language contact of the Zadar Albanian with the Croatian, Venetian and Italian, which have not been researched enough.

Source of our material is the corpus collected during field researches among the speakers of the Zadar Albanian in Zadar. The suggested questionnaire had to be reduced in relation to Filipi's because semantic fields as for example *apiculture and mushroom growing* do not take part in the lexis of the Zadar Albanian speech at all, whereas some, as *maritime affairs and fishing*, are represented on a very small scale. At etymological analysis of the collected corpus it was necessary because of qualitative and quantitative reasons to rearrange the semantic fields in relation to the Filipi's questionnaire. The questionnaire reduced in such a way, along with insignificant variations and rearranged names of particular semantic fields, consists of twenty-three semantic fields, or about one thousand seven hundred and seventy-nine concepts.

The second basic difference according to Filipi's questionnaire is the absence of a bigger number of points. Namely, Zadar Albanian stopped being spoken in Zemunik and Ploče long ago. Therefore, the only point where the relevant research has been implemented is precisely the Zadar district Arbanasi. The data were collected from twenty-two examinees of all ages, but mostly of those older than 60 years. My own answers were included in the questionnaire. Presentation of answers to each question included lexical and/or phonological variant if it was noted down in a specific case. The questions to the examinees were asked in the Croatian language, but if it was necessary, especially when descriptive explanations were needed, we used Zadar Albanian. Namely, the investigations carried out so far showed, that some, especially older examinees, do not understand a considerable number of Croatian

words. The person without whose help this corpus would be substantially poorer is Petar (Uči) Perović, who with his knowledge of the Zadar Albanian speech, especially the semantic field *works and tools*, semantic field *viticulture*, and semantic field *animal farming*, contributed a great deal in explanation of a great number of lexical units which for the very woman writer represented an unknown. Besides, he is the only examinee who preserved the phoneme /θ/ in which place other examinees use the phoneme /s/. Three examinees which have to be taken separately are brothers Darijo and Franko Bajlo, and Nado Bajlo, as representatives of the part of the Zadar Albanian language community who are not lineal descendants of the settlers from original homeland, but are (partly) linguistically assimilated Croatian inhabitants. Their vocabulary, on the whole, is significantly poorer and richer in Chakavian and Italian loan-words.

In material analysis we did not engage in a detail etymological corpus analysis, but relying to the available etymological dictionaries – Albanian, Croatian and Italian – we were satisfied with resumed defining closer to the origin of lexeme (*etimologia proxima*). Besides that, dialectal dictionaries were unvaluable to us: for Venetian Boerio's and Miotto's, and for Chakavian especially Maričić's dictionary of the speech from Kukljica, the speech with which Arbanasi were in tightest contact. As for the speech of Stanovi and coastal Chakavian speeches of the Zadar surroundings we do not have dictionaries to the present day, as proof for Chakavian forms we used unpublished field data by associate professor Nikola Vuletić.

All lexical units which belong to the Albanian lexis, without regard to their proto Albanian, Slavic, Romance or Latin/Early Roman etymology, we treated as a part of Albanian lexis. Aloglotemes were considered only those lexical units for which we could determine with a greater or lesser certainty to be borrowed at the time when Arbanasi came to Zadar until today. We were interested, in the first place, in *etimologia proxima* as the most relevant for the history of languages in contact from the first half of the 18th century on.

• **Example of etymological analysis of a semantic field**

Weather conditions:

- 'âkul, 'âkuli *m* 'ice'. Geg. *âkull-i*. • AD 68, s.v. *âkul*; AED 3, s.v. *akull*
- 'ân, âna *f* 'moon'. Geg. *hânë*, from *praalb.* **ksandâ*. • AD 69, s.v. *an*; AED 146, s.v. *hënë ~ hanë*
- *arkoba'lêno m* 'rainbow'. Direct loanword from Ital. *arcobaléno* 'rainbow'. • DELI 123, s.v. *arcobaléno*

3. DISTRIBUTION OF ALBANIAN LEXIS AND LEXIS BORROWED AFTER SETTLING BY SEMANTIC FIELDS

After etymological analysis, we started with analysis of Albanian lexis distribution and distribution of lexis borrowed after settling by semantic fields. Each semantic field was analyzed according to the number and percentage of Albanian lexis and lexis borrowed after settling, and the latter was divided into two sub-categories: direct Italo-Roman (Venetian and Italian) loan-words and loan-words from Croatian (Chakavian or Štokavian), including Croatian Romanisms as well, those for which on the basis of sound criteria it is possible to determine Croatian mediation. Precisely about the importance of those criteria, when it is about Croatian transphonemisation of Italo-Roman closed vocals warned lately F. Cugno (2008). Finally, here are also romanisms for which on the basis of sound criteria it was difficult or impossible to define whether they represent direct romanisms or, however, they have been received through Croatian mediation. Special category belongs to those lexical units for which we could not define the origin, closer or further, and which are only about twenty.

4. PAST DESCRIPTIONS OF THE ZADAR ALBANIAN SPEECH AND ITS BASIC CHARACTERISTICS

The most significant contribution to etymological research of the Zadar Albanian lexis gave Carlo Tagliavini in his work in 1937, which represents a small etymological glossary written on the corpus of the Zadar Albanian texts, and what is more significant is that he was the first to turn to the problems of aloglotic (Italian and Croatian influences) on the Zadar Albanian lexis. The most detailed description accessible until this day of the Zadar Albanian speech gave Idriz Ajeti (1961), first of all oriented towards the issues of the Zadar Albanian historical phonetics and morphology, and comparison of the Zadar Albanian with the gheg speeches in the old country of Albanians (Arbanasi) around the lake Shkodra (so called *Krajina*). In 1987 the Albanian Kruno Krstić published *Rječnik govora zadarskih Arbanasa*, the most detailed available lexical repertoire of that idiom to this day. After that there were no significant works about the Zadar Albanian speech. Orel in his AED (1996) for the Zadar Albanian for the most part uses Tagliavini's materials.

At the end of the summer 1929 Ugo Pellis carried out a poll in Arbanasi for *Atlante Linguistico Italiano*, using the reduced version of the questionnaire consisting of 775 questions. That material has not been published till today, even though only part of it, but very precious one, was brought by Federica Cugno in 2008. The authors

Atlasi Dialektologjik i gjuhës shqipe (in 2008), which unfortunately we did not have the opportunity to use, decided as says Cugno (2008) to use for Zadar Albanian Ajeti's data, without undertaking new field researches. All past works about Zadar Albanian, whether they were more detailed, as Tagliavini's and Ajeti's, whether easy-to-survey, where introductory pages of Krstić's dictionary are stressed out (Krstić 1987: 13-20) and the work of F. Cugno (2008), lay emphasis on historical development of the Zadar Albanian speech. To this day we do not have at our disposal rigorous synchronic description of the Zadar Albanian, especially its phonological system, whether in structuralist key, or from the perspective of more recent linguistic schools. Ajeti was closest to the defining of the phonological inventory of the Zadar Albanian speech (1961: 103-123), but he is more interested in diachronic questions, than in synchronic description, as, after all, certifies the title of his work.

Based on the corpus which we collected, we tried to bring several more recent news about the phonology of the contemporary Zadar Albanian speech. That corpus, due to the nature of the questionnaire, which we undertook from Filipi, theoretically organized for studying the languages in contact in the field of lexis, does not allow to say something more content-related about morphology and especially about syntax from what Ajeti (1961: 123-148) and Krstić (1987: 15-20) already said. When it is about intonation, Krstić (1987: 22) indicates that the „stresses“ are always » descending«. At individual level, however, we came across, very often, to the ascending intonation on long vowels, which is probably the consequence of the Croatian influence. That phenomenon is particularly frequent with nouns of masculine gender. Contemporary Zadar Albanian speech, as results from our corpus, possesses seven oral vocal phonemes: three front unrounded, low /a/, medium /e/ and high /i/; one front round high. As Ajeti warned (1961: 104), criticizing Tagliavini, those vocals, with the exception of /ɔ/, can be long and short, as in other gegh speeches. From diachronic perspective, it is important to mention that long /ā/ in many cases passed to /ō/, for example /'brāda/ > /'brōda/. But that /o/ today is not so open. Very frequent are double possibilities: /bu'lāri/, /bu'lōri/, /'brājda/, /'brōjda/, /gu'θāri/, /gu'sōri/, /'k'āpci/, /kōpku/, /li'vāda/, /li'vōda/. Besides these, we entered also other variants with vocals. So we have /a/ - /e/: /ča'kīci/ - /če'kīci/, /a/ - /i/: /an'gīri/ - /in'gīri/. That change covered not only loanwords but also the hereditary Albanian lexis, and Cugno (2008: 23) puts it down to the Croatian influence: (e/- /i/: /pete'rōšo/ - /peti'rōši/; /e/ - /o/: /peve'rūni/ - /pove'rūni/; /ɔ/ - /u/: /r'lūca/ - /ur'lūca/, /vɔ' - /vū'nēšta/ - /vu'nēšta/; /ɔ/ - /ü/: /'mbɔl/ - /mbül/; /o/ - /u/: /a'gōšti/ - /a'gūšti/, /pan'tófole/ - /pan'tófule/.

From our corpus it, however, results that today in the speech of the people from Arbanasi there is duality in pronunciation of infinitive suffixes, whereas with the nouns we usually have the diphthong [uo].¹ Phonem /θ/, strange to the Croatian system, preserves from all our examinees only Petar Uči Perović.

As with vowels, we registered variants with consonants either, from which some are no doubt the consequence of languages in contact, others, however, the consequence of internal development: /b/ - /v/: /ba'pôr/ - /va'pôr/; /b/ - /p/: /ben'čûrea/ - /pen'čûrea/; /c/ - /dz/: /brun'cîni/ - /brun'dzîni/; /c/ and /s/: /'klêpci/ - /'klêpsi/; /j/ - /ń/: /dim'jôku/ - /dim'ńôku/; /g/ - /k/: /g□ s'küje/ - /k□ s'küje/, /g□ r'čêle/ - /k□ r'čêle/.

5. PLACE OF LEXIS IN THE LAST RESEARCHES OF THE ZADAR ALBANIAN SPEECH

We owe the first more significant step forward in studying the Zadar Albanian lexis to Carlo Tagliavini.² His study in 1937, which, apart from introductory remarks about phonetics and morphology, can be characterized as a real small etymological glossary of the Zadar Albanian speech, the analyses which the Italian linguist dedicates to the languages in contact as reflected in lexis. Tagliavini places at our disposal a valuable criterion for determining penetration of aloglotic lexemes in the Zadar Albanian, when speaking of verbs.

In the main part of his work Tagliavini has scientifically properly analyzed the collected lexis, always giving notice to the fact that some Veneto-Roman loanword exists also in Zadar Albanian and in Croatian either, often recognizing old Croatian romanisms. However, in Italianisms and Venetians, in which, in Zadar Albanian appears /u/ instead of Veneto-Roman /o/ or /i/ instead of Veneto-Roman /e/, Tagliavini often could not recognize the Croatian influence. Only when the Italian linguist Federica Cugno, having published in 2008 her work about the poll which in 1929 for *Atlante Linguistico Italiano* in Arbanasi conducted Ugo Pellis, warned about the importance and depth of the Croatian influence. As it is clear, Cugno tried, on the corpus from 1929, to determine the qualitative dimensions of aloglotic influences in the Zadar Albanian lexis, emphasizing not only the importance of Zadar Albanian contact with other idioms in Zadar, but also with previous Croato-Roman language contacts. Data about the linguistic picture of Zadar that Cugno has at her disposal, originate from the period between two world wars, period of forced italianisation and

¹ Usp. i Ajeti 1061: 106.

² Tagliavini 1934 i 1937.

of elimination of the Croatian language, but also from some emphasized irredentistic surveys on the linguistic past of the town. Pellis's corpus has not been published until today, so our most important task is on the contemporary corpus to document and explain the phenomena on which Cugno quite pertinently warned.

All the more because to the present day the richest Zadar Albanian repertoire, that Krstić's, in fact the only real Zadar Albanian dictionary, almost programmatically excludes all aloglotemes which the author did not consider to be older. Far from his intention to albanize the Zadar Albanian lexis, Krstić archaized it consciously in his dictionary, stressing out that the majority of words derive from his mother and that »[...] in the dictionary [...] are the words which today, probably, nobody in the community uses any more» (*loc. cit.*).

6. CONTACTS OF THE ZADAR ALBANIAN WITH OTHER IDIOMS IN ZADAR: SOCIOLINGUISTIC CONTEXT

Albanofone population, which settled in Zemunik and Ploče, very fast forgot and gave up their Albanian language. But under the influence of more prestigious speaking and standard idioms, even in the Arbanasi district, the Zadar Albanian speech happened to be in gradual retreating. In the absence of any kind of institutional support, the Zadar Albanian is today, at those individuals who are preserving it, first of all, the language of immediate family environment. In this respect its sociolinguistic position may be compared with the position of Istrian-Rumenian at the time of field researches of A. Kovačec in the sixties of the 20th century. Especially when Borgo Erizzo started functioning as one part of the district of the city of Zadar, each family from Arbanasi, depending on different socio-economic factors, found itself included in different dynamics of languages in contact. Therefore, it is important to emphasize that, except general aloglotic influence at the level of the entire community, contact between Zadar Albanian and other idioms, which formed the language picture of Zadar, was realized differently from family to family. About it in our corpus testifies relatively a great number of variants, not only sound, but lexical as well, for particular items, in which process, it is obvious that one variant is used by one family, another by another etc. In the course of centuries changes appeared in the speech of Arbanasi from Zadar at all levels: phonological, morphological, syntactical and lexical. However, it would be wrong to consider that those changes took place only because of the "prestige" of "superior idioms" over Zadar Albanian, in the past and nowadays. Especially when it is about lexical borrowing, it is about a number of other factors: meeting with a new surroundings and its characteristics, some new activities, or the

same activities but in a substantially different context, and new material culture, in short, new reality which in the area of settlement has already been linguistically formed in the systems of idioms which the newcomers came along.

7. POLYMORPHISM AND SYNONYMY AS CONSEQUENCE OF LANGUAGES IN CONTACT

Special value in illustrating the depth of languages in contact between Zadar Albanian, on one, and Croatian and Zaratinski and Italian on the other side, have the analyzed number of synonyms. After the conducted analysis, we noticed that Arbanasi from Zadar for particular referents in their speech use two or more synonymous forms. Often, even though they know the form that their ancestors brought from the old country, they resort to the use of a loan-word, depending on situation, ambience etc. It is quite a unique situation that one and the same speaker for one lexical item knows even six synonyms.

In our survey we put at first the Albanian form, if as such has been registered, and then loan-words in alphabetical order.

Some examples of analyzed synonyms:

- **Two variants in the speech of Arbanasi from Zadar:**
 - patch: 'ârna, pëca
 - week: 'jáva, 'seti'mána
- **Three variants in the speech of Arbanasi from Zadar:**
 - hail: 'brêšni, 'krápa, 'túča
- **Four variants in the speech of Arbanasi from Zadar:**
 - rock: 'kârma, mo'cîra, 'grôta, 'škrápa
- **Five variants in the speech of Arbanasi from Zadar:**
 - snail: kara'kôčë, kara'gúci, ba'lóvci, lu'máka, 'próvci
- **Six variants in the speech of Arbanasi from Zadar:**
 - fiery (horse): 'drêçit, 'zjármit, 'bîsno, 'pápreno, ušti'nátum, žes'tóko

Total number of variants in the speech of Arbanasi from Zadar in our corpus is 680 out of which on 215 lexemes with two meanings are 430 variants or 63%, on 66 lexemes with three meanings are 198 variants or 30%; on 9 lexemes with four meanings are 36 variants or 5%; on 2 lexemes with five meanings are 10 variants or 1,4%, and 1 lexeme with six meanings has 6 variants or 0,6%.

8. CONCLUSION

Zadar Albanian borrowing of the Croatian lexis from the very beginnings can be characterized dual: as cultural borrowing, in the context of linguistic mastering with the new territory, its characteristics, and in its dominant activities; as intimate borrowing, due to deep-rooted bilingualism which took place in the context of economic activities which in the past connected Croatian and Albanian population in Zadar. Arbanasi, well, were naturally directed towards the inhabitants of the former suburban villages, among which, even today, with a relative preservation of the Chakavian speech stand out Stanovi, and people from Kukljica, who settled in Punta Bajlo, in the nearest vicinity of Arbanasi, and partly albanized.

In spite of strengthening the role of Croatian in the revival period, there is no doubt that Zaratinski, as a spoken language, and Italian, as the language of culture, through all periods from the time of settling of Arbanasi to the end of World War II, in the city itself, were prestigious idioms apart from Croatian, especially in the period of Italianisation by force between two world wars. Under such circumstances, it appears to us that Zadar Albanian undertaking of Italo-Roman lexis should be characterized in the first place as cultural borrowing, about which testifies also representation of direct Italian and Venetian loan-words in particular semantic fields (gastronomy, marriage and family life), even though it is completely clear that instances of intimate borrowing neither can nor should be excluded.

Today's sociolinguistic situation, in which Chakavian is no more, but still is unclearly defined Zadar regional variant of Croatian, a dominant spoken language of the city, and standard Croatian is the only standard variety in which the inhabitants of Zadar can satisfy their sociolinguistic needs, is relevant for interpretation only of the part of collected corpus. Zadar Albanian and Zaratinski are today driven back in innermost feelings of communication situations, and more often intragenerational, than those family and intergenerational.

With this work we endeavoured to contribute to studying of Croato-Albanian and Italo-Albanian language in contact in the field of lexis after almost two decades of a long interval in the development of Zadar Albanian studies, and we hope, also preservation of Zadar Albanian speech.

References

1. AD = Tagliavini, Carlo (1937). *L'albanese di Dalmazia. Contributi alla conoscenza del dialetto ghego di Borgo Erizzo presso Zara*. Firenze: Olschki.

2. AED = Orel, Vladimir (1998). *Albanian Ethymological Dictionary*. Leiden: Brill.
3. Ajeti, Idriz (1961). *Istorijski razvitak gegijskog govora Arbanasa kod Zadra*. Sarajevo: Akademija nauka Bosne i hercegovine [Djela XVI, knj. 3].
4. Ajeti, Idriz (1961). «Sitni etimološki prilozii». *Godišnjak Centra za balkanološka istraživanja* 2, str. 195-198.
5. Anić, Vladimir (1991). *Rječnik hrvatskoga jezika*. Zagreb: Novi Liber.
6. Anić, Vladimir / Goldstein, Ivo (2000). *Rječnik stranih riječi*. Zagreb: Novi Liber.
7. Aronoff, Mark / Rees-Miller, Janie (2000). *The Handbook of Linguistics*. Oxford / Malden, Mass.: Blackwell.
8. Babić, Stjepan (1991). *Tvorba riječi u hrvatskom književnom jeziku: nacrt za gramatiku* (2. izdanje). Zagreb: Nakladni zavod Globus / HAZU.
9. Barančić, Maximiljana (2008). «Arbanasi i etnojezični identitet». *Croatica et Slavica Iadertina* IV, str. 551-568.
10. Barić, Henrik (1937). *O uzajamnim odnosima balkanskih jezika I. Ilirsko-romanska jezička grupa*. Beograd: Arbanološki seminar Univerziteta.
11. Barić, Henrik (1950). *Fjalor i gjuhës sërbishte ose kroatishite dhe i shqipës / Rēčnik srpskoga ili hrvatskoga i arbanaskoga jezika*. Zagreb: Izdavački zavod Jugoslavenske akademije.
12. Berko-Gleason, Jean (1993). *The Development of Language*. New York: MacMillan Publishing Co.
13. Boerio = Boerio, Giuseppe (1856). *Dizionario del dialetto veneziano*. Giovanni Cecchini Editore, Venezia [Ristampa anastatica Giunti Martello, Firenze, 1983].
14. Buzolić, Stjepan (1868). «Zadarski Arbanasi i prabiskup Zmajević». *Narodni koledar* 6, str. 76-84.
15. Çabej, Eqrem (1976). *Studime etimologjike në fushë të sqipes*, sv. I-III. Tiranë: Akademia e shkencave e RPS të Sqipërisë.
16. Chomsky, Noam (2002). *On Nature and Language*. Cambridge: Cambridge University Press.
17. Comrie, Bernard (2000). «Language contact, lexical borrowing, and semantic fields». Gilbers, Dicky / Nerbonne, John / Schaecken, Jos (eds.): *Languages in Contact*. Amsterdam: Rodopi, str. 73-86.
18. Coulmas, Florian (1998). *The Handbook of Sociolinguistics*. Oxford / Malden, Mass.: Blackwell.
19. Crystal, David (2000). *Language Death*. Cambridge: Cambridge University Press.
20. Cugno, Federica (2008). «La varietà albanese di Borgo Èrizzo in Dalmazia nell'inchiesta di Ugo Pellis per l'Atlante Linguistico Italiano». *Bollettino dell'atlante linguistico italiano*, 32, str. 15-35.

21. Ćurković, Mijo (1922). *Povijest Arbanasa kod Zadra*. Šibenik: Nagr. tiskara E. Vitaliani.
22. DEI = Battisti, Carlo / Alessio, Giovanni (1950-1957). *Dizionario etimologico italiano*, sv. I-V. Firenze: Università degli Studi di Firenze – G. Barberà Editore.
23. DELI = Cortelazzo, Manlio / Zolli, Paolo (1979-1988). *Dizionario etimologico della lingua italiana*, sv. I-V. Bologna: Zanichelli.
24. Demiraj, Bardhyl (1997). *Albanische Etymologien*. Amsterdam / Atlanta: Rodopi.
25. Doria = Doria, Mario (1991). *Grande dizionario del dialetto triestino storico etimologico fraseologico*. Trieste: Trieste Oggi.
26. Erber, Tullio (1883). *La colonia albanese di Borgo Erizzo presso Zara. Cenni storici raccolti dai documenti del R. Archivio Luogotenenziale*. Ragusa: Tipografia Flori.
27. ERSHJ = Skok, Petar (1971-1974). *Etimologijski rječnik hrvatskog ili srpskog jezika* (ur. M. Deanović i Lj. Jonke), sv. I–IV. Zagreb: JAZU.
28. Filipi, Goran (2007). *Istrorumunjske etimologije: ornitonimi. Knjiga 2*. Pula-Koper: Znanstvena udruga Mediteran.
29. Filipović, Rudolf (1986). *Teorija jezika u kontaktu: uvod u lingvistiku jezičnih dodira*, Zagreb: Jugoslavenska akademija znanosti i umjetnosti / Školska knjiga [Djela JAZU; Razred za filološke znanosti; knj. 59. – 322.str].
30. Gjinari, Jordji (1970). *Dialektologija Shqiptare*. Pristina: Universiteti.
31. Goebel, Hans et alii (eds.) (1996). *Kontaktlinguistik: ein internationales Handbuch zeitgenössischer Forschung / Contact linguistics: an international handbook of contemporary research / Linguistique de contact: manuel international des recherches contemporaines*. Berlin/New York: Walter de Gruyter.
32. Grosjean, François (1982). *Life with Two Languages*. Harvard: Harvard University Press.
33. Grosjean, François (1985). «The Bilingual as a Competent but Specific Speaker-hearer». *Journal of Multilingual and Multicultural Development* 6. str. 467-479.
34. Grzega, Joachim (2003). «Borrowing as a Word-Finding Process in Cognitive Historical Onomasiology». *Onomasiology Online* 4, str. 22-42.
35. Guerra, Paola / Spagnoli, Alberto (2006). *Dizionario italiano albanese - albanese italiano*. Milano Antonio Vallardi Editore.
36. Hamers, Josiane F. / Blanc, Michael H. A. (1990). *Bilinguality and Bilingualism*. Cambridge: Cambridge University Press.
37. Haugen, Einar (1950). «The Analysis of Linguistic Borrowing». *Language* 26/2, str. 210-231.
38. *Hrvatski enciklopedijski rječnik* (2003). Zagreb: Novi Liber.

39. ILA = Filipi, Goran / Buršić Giudici, Barbara (1998). *Istriotski lingvistički atlas*. Pula: Znanstvena udruga Mediteran.
40. ImLa = Filipi, Goran / Buršić Giudici, Barbara (2012). *Istromletački lingvistički atlas*. Zagreb / Pula: Dominović / Znanstvena udruga Mediteran / Sveučilište Jurja Dobrile u Puli.
41. IO = Filipi, Goran (1994). *Istarska ornitonimija: etimologijski rječnik pučkog nazivlja*. Rijeka: Izdavački centar Rijeka.
42. IrE II = Filipi, Goran (2007). *Istrorumunjske etimologije: ornitonimi. Knjiga 2*. Pula-Koper: Znanstvena udruga Mediteran.
43. IrE III = Filipi, Goran (2008). *Istrorumunjske etimologije: zoonimi: poljske i šumske životinje; mikonimi; bačvarska terminologija. Knjiga 3*. Pula-Koper: Znanstvena udruga Mediteran.
44. IrLA = Filipi, Goran (2004). *Istrorumunjski lingvistički atlas*. Pula: Znanstvena udruga Mediteran.
45. JaFa = Vinja, Vojmir (1986). *Jadranska fauna. Etimologija i struktura naziva*, sv. I-II. Zagreb / Split: JAZU / Logos.
46. JE = Vinja, Vojmir (1998–2004). *Jadranske etimologije. Jadranske dopune Skokovu etimologijskom rječniku* sv. I–III. Zagreb: HAZU / Školska knjiga.
47. Jokl, Norbert (1911). *Studien zur albanesischen Etymologie und Wortbildung*. Wien: A. Hölder.
48. Karuc, Niko (1985). *O zadarskim Arbanasima*. Zadar: Mjesna zajednica Arbanasi.
49. Kovačec, August (2006). «Arbanasi-Albanisch». Okuka, Miloš (Hrgb.): *Lexikon der Sprachen des Europäischen Ostens*. Klagenfurt: Wieser, str. 67-70.
50. Krstić, Kruno (1987). *Rječnik govora zadarskih Arbanasa*. Zadar: Mjesna zajednica Arbanasi.
51. Krstić, Kruno (1988). *Doseljenje Arbanasa u Zadar*. Zadar: Mjesna zajednica Arbanasi.
52. Landi, Addolorata (1989). *Gli elementi latini nella lingua albanese*. Napoli: Edizioni Scientifiche Italiane / Pubblicazioni dell'Università degli Studi di Salerno.
53. Lewis, M. Paul. (2001). «Language Development in Contact Languages and Language Contact Situations». *Notes on Sociolinguistics* 6, str. 65-76.
54. Marković, Irena (2013). *Usporedba Pellisove istočno-jadranske građe za ALI sa suvremenim mletaciizmima u zadarskom govoru*. Doktorska disertacija (neobjavljena).
55. Martinet, André (1982). *Osnove opće lingvistike*. Zagreb: GZH.
56. Mezulić, Hrvoje / Jelić, Roman (2005). *O talijanskoj upravi u Istri i Dalmaciji 1918.-1943. Nasilno potalijančivanje prezimena, imena i mjesta*. Zagreb: Dom i svijet.

57. Meyer = Meyer, Gustav (1891): *Etymologisches Wörterbuch der albanesischen Sprache*. Straßburg: Trübner.
58. Meyer, Gustav (1883). «Albanesische Studien I. Die Pluralbildung der Albanesische Nomina». *Sitzungsberichte der philosophischen-historischen Classe der Kaiserlichen Akademie der Wissenschaften* CIV, str. 257-362.
59. Meyer, Gustav (1884). «Albanesische Studien II. Die albanesischen Zahlwörter». *Sitzungsberichte der philosophischen-historischen Classe der Kaiserlichen Akademie der Wissenschaften* CVII, str. 259-338.
60. Meyer, Gustav (1892). «Albanesische Studien III. Lautlehre des indogermanischen Bestandteile des Albanesischen». *Sitzungsberichte der philosophischen-historischen Classe der Kaiserlichen Akademie der Wissenschaften* CXXV/11, str. 1-93.
61. Meyer-Lübke, Wilhelm (1935). *Romanisches etymologisches Wörterbuch. 3 Auflage*. Heidelberg: Carl Winters Universitätsbuchhandlung.
62. Miklosich, Franz (1870-1871). *Albanische Forschungen*, Bde. I-III, Wien: Kaiserliche Akademie der Wissenschaften.
63. Mohorovičić-Maričin, Franjo (2001). *Rječnik čakavskog govora Rukavca i bliže okolice*. Rijeka – Opatija – Matulji.
64. Muljačić, Željko (1972). *Opća fonologija i fonologija suvremenoga talijanskog jezika*. Zagreb: Školska knjiga.
65. Pedersen, Holger (1895). *Albanesische Texte mit Glossar*. Leipzig: S. Hirzel.
66. Pellegrini, Giovanni Battista (1977). *Introduzione allo studio della lingua albanese*. Padova: Istituto di glottologia – Seminario di filologia balcanica.
67. Peričić, Šime (1993). *Pregled gospodarstva Arbanasa u prošlosti*. Zadar: Mjesna zajednica Arbanasi.
68. Peričić, Šime (2011). »Povijest Zadra u XIX. stoljeću«. Peričić, Šime / Stagličić, Marija / Travirka, Antun / Rados, Zvezdana / Rabac-Čondrić, Glorija: *Zadar za austrijske uprave*. Zadar: Matica Hrvatska – Ogranak u Zadru [Prošlost Zadra, knjiga IV], str. 13-257.
69. RGMK = Maričić Kuklićanin, Tomislav (2000). *Rječnik govora mjesta Kukljica na otoku Ugljanu*. Zadar, Matica hrvatska Zadar.
70. RGOO = Valčić, Ante Toni (2012): *Rječnik govora otoka Ošljaka*, Zadar: Matica hrvatska – Ogranak Zadar.
71. Sala, Marius (1998). *Lenguas en contacto*. Madrid: Gredos.
72. Simeon, Rikard (1969). *Enciklopedijski rječnik lingvističkih naziva*, sv. I-II. Zagreb: Matica Hrvatska.
73. Skračić, Vladimir (1996). *Toponimija vanjskog i srednjeg niza zadarskih otoka*, Split.

74. Skračić, Vladimir (ur.) (2006). *Toponimija otoka Pašmana*, Sveučilište u Zadru, Centar za onomastička istraživanja, Zadar, str. 117-122.
75. Sočanac, Lelija (2004). *Hrvatsko-talijanski jezični dodiri*. Zagreb: Nakladni zavod globus.
76. Stipčević, Aleksandar (2011). *Tradicijska kultura zadržarskih Arbanasa*. Zagreb: Ibis grafika d.o.o.
77. Tagiavini, Carlo (1934). «Penetrazione e adattamento delle voci italiane e croate nel dialetto albanese di Borgo Erizzo (Zara)». *Studi albanesi* III-IV, str. 214-242.
78. Tagliavini, Carlo (1965 [1943]). *Stratificazione del lessico albanese. Elementi indoeuropei*. Bologna: Pàtron [Ristampa anastatica].
79. Thomason, Sarah (2001). *Language Contact: An Introduction*. Edinburgh: Edinburgh University Press.
80. Topalli, Kolec (2006). «Për kronologjinë e disa dukurive fonetike në të folmen e arbëneshëve të Zarës». *Studime Filologjike* 3-4, str. 133-141.
81. Trask, Lawrence Robert (2005). *Temeljni lingvistički pojmovi*. Zagreb: Školska knjiga.
82. VDVD = Miotto, Luigi (1984). *Vocabolario del Dialetto Veneto-Dalmata. Seconda edizione riveduta e ampliata*. Trieste: Edizioni LINT.
83. VG = Rosamani, Enrico (1999). *Vocabolario giuliano dei dialetti parlati nella Venezia Giulia, in Istria, in Dalmazia, a Grado e nel Monfalconese. Seconda edizione*. Trieste: Edizioni LINT.
84. Wardhaugh, Ronald (2002). *An Introduction to Sociolinguistics*. Oxford: Blackwell Publishing.
85. Wei, Li (2000). *The Bilingualism Reader*. London: Routledge.
86. Weigand, Gustav (1911). «Der gegische Dialekt von Borgo Erizzo in Dalmatien». *Jahresbericht des Instituts für rumänische Sprache* XVII-XVIII, str. 177-239.
87. Weigand, Gustav (1913). *Albanesische Grammatik im südgeegischen Dialekt*. Leipzig: Johann Ambrosius Bath.
88. Weigand, Gustav (1926). «Das Albanische in Attika». *Balkan-Archiv* II, str. 167-220.
89. Weinreich, Uriel (1963). *Languges in Contact. Findings and Problems*. The Hague: Mouton.
90. Zajmi, Abdullah et alii (1974). *Srpskobrvtasko – albanski rječnik / Fjalor serbokroatisht shqip*. Prishtinë/Priština: Instituti albanologjik i Prishtinës.
91. Zajmi, Abdullah et alii (1981). *Fjalor shqip – serbokroatisht / Albansko – srpskobrvtaski rečnik*. Prishtinë/Priština: Instituti albanologjik i Prishtinës.
92. Zingarelli, Nicola (2004). *Vocabolario della lingua italiana*. Bologna: Zanichelli.
93. *Zbornik radova o Krunu Krstiću* (1998). Zadar: Društvo zadržarskih Arbanasa.

ABSTRAKT

Ky punim paraqet një pjesë etimologjike, trajtimin e veprave, idiomen e leksikut të shprehjeve të arbnesheve të Zarës, të folmen gegnishte të cilët sot në Zarë e flasin ende afersisht 150 dhe 300 individ, kryesisht të moshuar, pasardhësit e shqiptarëve të cilët gjatë gjysmës së parë të shekullit XVIII u shpërngulen në Zarë nga vendbanimet përreth liqenit të Shkodrës. Studimi përfshiu 1779 njësi leksikore nga e folmja e arbnesheve të Zarës. Korpusi jonë është mbledhur gjatë hulumtimeve në terren në vitin 2009, bazuar në një pyetësor i cili ishte përgaditur nga Goran Filipi për Atlasin e idiomave të Istres. Korpusi u krijua në njëzet e tre fusha semantike: rrethanave kohore, gjeomorfologjisë, zakonet, kisha, trupit dhe shqisat, perceptimet dhe përshtypjet, koha dhe kalendari, jeta martesë dhe familja, shtëpia dhe zotërimet, veshjet dhe aksesoret, ushqim dhe pije, zogjtë, insektet, kafshë të tjera të egra, puna dhe mjetet, vreshtaria, kultivimin e kafshëve, ullirin, frutat, perime, pemë, shkurre dhe bimë të egra deti dhe gjeomorfologjia bregdetare dhe meteorologjia, çështjet detare dhe anijet, flora dhe fauna detare: peshkimi. Analiza etimologjike tregoi se nga një total prej 1779 njësi leksikore në leksikon e vjetër (leksiku i sjellë nga atdheu i vjetër) ka rënë në 598 njësi leksikore që don të thotë 33.24%, ndërsa fjalori i huazuar në Zarë pas emigracionit të Arbnesheve ka rënë në 1161, ose 65%. Ndërsa nën ndikimin direkt të romanizimit italian ka rënë në 265 njësi leksikore ose 14.47%, dhe fjalët e kredisë nga kroatishja, duke përfshirë romanizimin, gjermanizimin kroat dhe ato elemente aloglotic në kroatishte, 797 njësi leksikore, ose 44.3%. Ndikimet italiane dhe veneciane shpjegojnë prestigjin e dy shprehjeve (idiomave) në të kaluarën dhe Italianizimin në periudhën midis dy luftërave botërore, si dhe kornizën e përbashkët ekonomike kroate (kryesisht bujqësi dhe blegtori) kroatofone dhe popullsia albanofone e Zadarit në të kaluarën dhe pozitën sociolinguistike kroate që nga fundi i Luftës së Dytë Botërore e deri më sot.

Zef CHIARAMONTE

**ÇËSHËTJA E GJUHËVE AMTARE NË SHËRBESEËN E SHENJTË
MESHARI I GJON BUZUKUT (1555) NË KONTEKSTIN E KONCILIT TË
TRENTOS (1545-1563)**

Më lejoni të përmend Ak. Prof. Jorgo Bulo-n si shkencëtarin dhe mikun e mirë që më pati nxitur që të merrem me hulumtimin e *deliberata*-ve të Koncilit të Trentos dhe me aplikimin e mëpastajshëm të tyre nga ana e Papatit, me qëllim që të sqarohen disa aspekte jo sekundare të veprës së Buzukut.

Status quæstionis

Vendosja e turqve osmanë në Ballkan, që kishte filluar që nga gjysma e dytë e shekullit XIV, mbartte në vete një tjetër ndarje fetare, përveç asaj ndërmjet Konstantinopojës dhe Romës, që tashmë ishte bërë tradicionale: pushteti i ri, *hyqimeti*, e favorizonte, kur nuk e impononte, konvertimin e *miletit* të krishterë në Islam.

Ndërsa grekët dhe sllavët ortodoksë - hierarkitë kishtarë të të cilëve gjetën menjëherë një marrëveshje me Sulltanin - do të rezistojnë duke u mbështetur në liturgjinë bizantine të kremtuar në gjuhët e tyre përkatëse, shqiptarët katolikë, të shtypur në shtëpinë e vet nga turqit dhe të izoluar nga Roma, do të mundohen në mënyra të ndryshme të bëjnë qëndresë, duke kultivuar gjuhën e vet dhe duke bërë çmos për ta futur atë në kontekstin liturgjik.

Vepra më e gjerë dhe më e plotë prej orvatjeve të sprovuara për të futur gjuhën amë në liturgjinë katolike është padyshim ajo e Gjon Buzukut, *Meshari* i të cilit, në të vetmin ekzemplar¹ që ka mbetur, e që gjendet sot në Bibliotekën Apostolike të Vatikanit, u zbulua herën e parë nga gjysma e '700 dhe u ri-zbulua më 1909.

Nga kjo datë e fundit fillojnë edhe studimet mbi të, përveç dy botimeve kritike nga Namik Resuli (1958) dhe nga Eqrem Çabej (1968).

Ky studim që po paraqesim sot, i mbështetur edhe në kërkime pranë arkivave të Vatikanit, ka për qëllim të ndriçojë aspekte të Buzukut që kanë të bëjnë me historinë e liturgjisë dhe me historinë e Koncilit dhe të pas-Koncilit të Trentos, dmth. kanë të

¹ Rreth një kopjeje tjetër në dorëshkrim për të cilën flet Kolë Keta, krh. Demiraj, 2007.

bëjnë me Reformën Protestante dhe me Reformën e Kishës së Romës ose me të ashtuquajturën Kundërreformë.

Shërbesa e shenjtë ose, me fjalë greke, liturgjia

Në lashtësinë greke ambasadorët quheshin liturgë dhe detyra e tyre quhej liturgji: kemi të bëjmë me ushtrimin e një detyre përfaqësuese publike, shtetërore dhe zyrtare, të kryer si përfaqësues të mbarë një kolektiviteti.

Në mënyrë analoge, në fushën e Krishtëritimit, lutjet publike të zyrtarizuara, të caktuara për nga koha e nga rituali, do të quhen liturgji.

Ashtu si edhe te Hebraizmi dhe më vonë tek Islami, lutjet publike të krishtera ndahen sipas kohëve të kryerjes dhe me fjalë latine gjithpërfshirëse quhen edhe *officia*. Mbi të gjitha gëzon epërsi Mesha ose Liturgjia Hyjinore, e cila zakonisht celebrohet paradite.

Lutjet personale, qofshin me fjalë apo në heshtje, ato bëhen gjithmonë dhe vetvetiu në gjuhën amtare, sepse edhe mendimet bazike njeriu i ka në gjuhën e vet.

Por në ç'marrëdhënie janë gjuhët amtare me liturgjinë, dmth. me lutjen zyrtare publike? Gjuhët amtare, deri para disa shekujsh - dhe diku diku edhe sot - ishin vetëm gjuhë të folura dhe jo edhe të shkruara, prandaj quheshin "vulgare", popullore, si p. sh. arbërishtja për shumicën dërrmuese të Arbëreshëve.

Jo vetëm në antikitet, pra, por edhe sot ndeshemi me qytetërime dhe komunitete analfabete, ku shkrimi është diçka magjike, sakrale dhe mbetet në domenin e pak personave, të cilët i përkasin një klase të veçuar, të sofistikuara, priftërore e cila, duke trajtuar sende sakrale, nxjerr prej tyre një pushtet të madh mbi popull dhe pothuaj edhe mbi klasën sunduese.

Kujtojmë këtu shkrimin e hieroglifëve, të shpikur në Egjiptin antik nga klasa priftërore, dhe atë të gjuhës etruske, të përdorur deri vonë në Romën antike nga priftërinjtë "aruspicinë".

Në periudhën e mëvonshme, me monoteizmin, disa gjëra fillojnë të ndryshojnë.

Për shembull: komuniteti hebrej i zhvendosur në Aleksandri, liturgjinë e ruante në gjuhën e prejardhjes, ndërsa në sh. III para Krishtit Bibla përkthehet në greqishten e kohës së Lekës së Madh, pra helenishtja, sepse të rinjtë e komunitetit nuk e kuptonin më hebraishten. Kemi të bëjmë me Biblën e 70-ve, *Septuaginta*.

Në zanafillën e Krishtëritimit, liturgjia ndërtohej në gjuhët e kuptueshme nga popujt që të parët e përqaftuan Krishtëritimin, për të vazhduar me greqishten dhe latinishten si gjuhë më të përhapura në Perandorinë Romake.

Ndonëse Shën Vasili i Madh (329-379) i këshillonte ipeshkëvjtë që ta çojnë liturgjinë në gjuhët e popullit, megjithatë me stabilizimin (sh. VIII-IX) e Pentarkisë midis kishave-amë ose 5 Patriarkatëve (Roma, Konstantinopoja, Antiokia, Aleksandria dhe Jerusalem), edhe gjuhët stabilizohen dhe formojnë një grupim i ashtuquajtur - pa u mbështetur te asnjë ligj, por de fakto - “gjuhë liturgjike”.

Në trevat e Siujdhesës së atëhershme ilirike, gjuhët liturgjike polarizohen rreth greqishtes dhe latinishtes, sipas frymës së Bizantit a të Romës, ndërsa me ardhjen e sllavëve ndeshim edhe një gjuhë tjetër, e cila së shpejti ngryhet në rangun liturgjik.

Me kalimin e kohës, kishat e zgjeruan aq shumë rolin e tyre arsimor dhe kulturor sa që kufijtë midis religjionit dhe kombësisë u mjegulluan.

Na del pra, se “gjuhët liturgjike” tani janë gjuhë të shkruara, të përpunuara, të zyrtarizuara, të kristalizuara dhe të politizuara, deri sa edhe sakralizohen dhe bëjnë çmos t’i lenë jashtë tempullit gjuhët e tjera. Të cilat, megjithatë, aty këtu ngrenë krye dhe, sidomos te trevat “kufitare”, ndikojnë mbi aspektin baritor të religjionit, i cili e ka vështirë frytdhënien pa përdorimin e mjetit gjuhësor amtar.

Meshari i Buzukut, ashtu si edhe vepra të tjera të ngjashme të asaj kohe në botën kishtare, lidhet drejtpërsëdrejti me këtë problematikë, pikërisht në një Ballkan të “kolonizuar” nga greqishtja dhe sllavishtja.

Por, po qe se ende mendojmë se Kisha Katolike, duke ndjekur deri në fund teorinë e gabuar të gjuhëve liturgjike, pati ndaluar njëherë e përgjithmonë dhe kudo përdorimin e gjuhëve amtare përbrenda liturgjisë së saj, së paku do ta gjejmë *Mesharin* tonë si vepër apokrifë dhe Buzukun si prift rebel kundër kishës së cilës i takonte!

Duke marrë hua një shprehje e Umberto Eco-s rreth rolit që luajnë në letërsi disa vende a disa vepra, do të thoshim se *Meshari* i Buzukut ngërthen në vetvete kapacitetin për të lindur lexime gjithnjë të reja, pa u sosur e pa u tretur kurrë.

Kështu, duke i pasur parasysh studimet e bëra deri më sot mbi *Mesharin* nga studjues të mëdhenj e të apasionuar, dhe duke u mbështetur te dokumentacioni i Koncilit të Trentos, rileximi ynë nisët nga këto bindje personale:

- Buzuku, prift dhe jo ipeshkëv², për nga mënyra e të shkruarit, rrjedh e vjen nga pellgu verior i Shkodrës, me gjasa nga Shestani;
- ai do të ketë ndjekur fatin e Arbërve të arratisur, duke shkuar me ta në Friuli, në tokat e Republikës Venedikase;
- prej aty ndoqi së afërmi punët e Koncilit të Trentos;
- veprën e tij e ndërtoi sipas parimeve të Kishës Katolike dhe të njëjtit koncil, asokohe ende në zhvillim e sipër, dhe e botoi në Venedik.

² Berisha, 2014. Po të kishte qenë ipeshkëv, kishte marrë pjesë te Koncili i Trentos.

Sigurisht se me bindjet tona mund të ketë mospajtime, por dihet se shumë probleme lidhur me *Mesharin* mbeten ende të hapura, ashtu që studime të tjera do jenë gjithnjë të mirëseardhura në botën shkencore.

Meshari libër-mit

Pas mitit të krijuar rreth figurës së Skënderbeut në traditën shqiptare, një tjetër mit e ka karakterizuar jetën intelektuale të shqiptarve andej e këndej Adriatikut: kërkimi i një libri të shtypur, i pari i këtij lloji në gjuhën shqipe deri më sot i njohur, ku për ekzistencën e tij bëhej fjalë në një dokument epistolar të shekullit XVIII, të ruajtur në arkivin e Seminarit Arbëresh të Palermos. Dokumenti në fjalë, pa datë³, njofton për një vepër liturgjike në gjuhën shqipe, të quajtur *Meshar*, të shkruar ndërmjet viteve 1554 e 1555, nga një prift katolik i ritit latino-roman, emri i të cilit bëhet i njohur nga *colophon*-i, të shtypur në një vend të panjohur e për të cilën nuk kishin mbetur kujtime në jetën e bashkësisë kishtarë.

Siç dihet, të njëjtin fat pati edhe vepra e dytë të shtypur në gjuhën shqipe, kësaj here fryt i një përpjekjeje të një arbëreshi nga Siçilia, që kishte qenë një nga nxënësit e parë të Kolegjit Grek të Romës: *Katekizmi* i Lekë Matrangës, Romë, 1591⁴.

Gjithashtu edhe kjo vepër ra në humnerën e harresës dhe u rizbulua vetëm në fillim të shekullit XX nga Marco La Piana (1912).

Situata tragjike e katolikëve në trevat shqiptare

Autorët e veprave të sipërpërmendura, megjithëse bëjnë pjesë në të njëjtin areal gjuhësor, iu referohen dy traditave kishtarë të ndryshme, që të dyja të pranishme ndër shqiptarë, prejardhja e të cilave rrjedh nga ndarja e Perandorisë Romake, nga “vija e Theodosit”, e cila e ndante në mes territorin e tyre.

Shqiptarët, si trashëgimtarët e predikimit apostolik të shën Palit drejtuar ilirëve, do t’i nënshtrohen një inkulturimi të dyfishtë të Krishterimit: lindor në gjuhën greke dhe roman në gjuhën latine, jo gjithmonë me një vijueshmëri kronologjike, por patjetër nën të njëjtin juridiksion administrativ të Papës së Romës, nëpërmjet Vikarit Papnor në Selanik, së paku deri më 732 (Gjini, 1992).

³ Mendohej gjithnjë më 1740, por vitin e saktë të zbulimit -1743- ka arritur ta rindëronte Bardhyl Demiraj nëpërmjet interpretimit filologjik-historik të tekstit. Krh. Demiraj, 2007.

⁴ Kemi të bëjmë me një përkthim nga italishtja në gjuhën arbëreshe (*E mbësname e krështerë*) të *Dottrina Christiana* të jezuitit spanjoll Ledesma, vepër kjo që në përkthimin nga spanjishtja në italisht ishte afirmuar qysh nga viti 1571, por - si thotë Matranga - nuk ishte kuptuar mirë nga Arbëreshët e Italisë.

Pas kësaj date, Iliriku - ashtu sikundër dhe Siçilia dhe Kalabria si pjesë të të njëjtës perandori me traditë kishtarë bizantine por që vareshin nga Roma - u detyrua me forcë nga perandori Luani III Izauriku të lidhej me Konstantinopojën, për ta goditur Papën i cili kishte marrë pjesë me ikonofilët në krizën ikonoklaste⁵.

Prej kësaj date, në këtë trevë do të mbizotërojë tradita bizantine, por tradita latine mbijetoi gjithnjë, sidomos në të ashtuquajturin "*trekëndësh katolik shqiptar*" (Shkodër, Drisht, Danjë, Shas, Ulqin, Tivar) e në manastiret benediktine e domenikane.

Pushtimi otoman, i filluar në pjesën e fundit të shekullit XIV dhe i përfunduar më 1912, do të ndryshojë tërësisht asetet fetare dhe shoqërore të mëparshme.

Katolikët shqiptarë që, së bashku me shqiptarët ortodoksë për një kohë të gjatë kishin pësuar shtypjen e perandorive bullgare dhe serbe dhe të kishave të tyre përkatëse, siç e vë në pah Iljaz Rexha (2005) në veprën e tij mbi onomastikën e Dardanisë, tani mbetën krejtësisht të izoluar nga Roma, të shkëputur nga trangu i katolicizmit, të vështruar me sy të keq nga Sulltani e nga hierarkitë ortodokse greke dhe sllave të cilat në sajë të tij kishin gjetur një status të ri privilegjesh dhe epërsie.

E megjithatë shpirti shqiptar mbeti gjithnjë i orientuar kah Perëndimi, si thekson shumë herë Fan Noli⁶.

Aspiratat politike dhe kulturore ndaj Perëndimit e gjegjësisht ato konfesionale ndaj Romës, nuk munguan asnjeherë, sikur edhe dëshmojnë historia personale dhe familjare e heroit kombëtar Skënderbeut, vendosja e Parisë shqiptare nëpër oborret e fiznikëve italianë, prania e një *Shkollë të shqiptarëve* në Venedik, aktiviteti i humanistëve dhe artistëve shqiptarë në Italinë veriore, diaspora e shkodranëve në Friuli (Kamsi, 2005) dhe e Arbëreshëve⁷ në pjesën jugore të Italisë e deri në Siçili.

Pasi refugjatët shqiptarë që u vendosën në veriun e Italisë u asimiluan, vetëm Arbëreshët do të vazhdojnë deri më sot të mbijetojnë, duke u mbështetur te tradita kishtarë bizantine, dhe te ruajtja e gjuhës dhe e folklorit të zanafillës.

⁵ Vështruar nga prizma e krizës ikonoklaste, historia e Shqipërisë merr përmasat e një kthese të civilizimit. Prandaj kjo epokë do studjuar më shumë nga historianët.

⁶ "Në sh. XV Shqipëria ishte me shumicë katolike romane me 18 seli ipeshkvnore. Feja (katolike) ka shërbyer po ashtu si një lidhje me Perëndimin" (Noli), cit. nga Berisha, 2014, fq.73.

⁷ Emërtimi i vjetër i Shqiptarëve, i ruajtur më vonë, duke filluar nga shekulli XV, nga Shqiptarët që deri në ditët e sotme jetojnë në Itali. Nga pikëpamja kishtarë Arbëreshët janë dëshmia e "vijës romane" antike të ortodoksëve (bizantinëve) shqiptarë, kundrejt atyre të "vijës konstantinopolitane" dhe, më vonë, "moskovite". Vija romane haset edhe sot në disa vise të Myzaqesë. Po e rikujtojmë, me këtë rast, edhe faktin se vet Theofan Stiljan Noli, qysh në fillim të ndërtimit të Kishës Shqiptare autonome -sot Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë - mendonte seriozisht ta rregullonte atë sipas modelit të Kishës Arbëreshe, dmth. ai ëndërronte një Kishë lindore shqiptare të lidhur me Romën, siç ishte para vitit 732, pra jo uniate.

Megjithatë, u desh që këto zakone të bëjnë një qëndresë të fortë pas Koncilit të Trentos, kundrejt mentalitetit kundërshtor të ipeshkvijve latinë, prej të cilëve vareshin kolonitë arbëreshe, vetëm e vetëm sepse në to flitej një gjuhë tjetër dhe meshohej në gjuhën greke.

Buzuku në Indeks?

Si shkak i ndërprerjes së përdorimit të *Mesbarit*, është fajësuar prej shumëkujt dhe për një kohë të gjatë - së fundmi edhe nga studjuesi i shquar Robert Elsie (2006) - veprimi bllokues i Kishës Katolike kundrejt përkthimit të Biblës dhe përdorimit të gjuhëve amtare në liturgji. Veprim ky, gjoja i intesifikuar pas Koncilit të Trentos nëpërmjet botimeve të ripërsëritura të *Index librorum prohibitorum (Indeksi i librave të ndaluar)* dhe të *10 Rregullave*.

Në të vërtetë, e vetmja kopje e *Mesbarit* të ruajtur i ka të gjitha karakteristikat që të mund mendojmë se Buzuku pati hyrë në procesin paraprak të Indeksit në Romë.

Siç dihet, kopjes i mungojnë ballina dhe disa faqe nga mesi i librit: këto janë elementet indiciale që tregojnë se *Mesbari* do t'i jetë nënshtruar procesit fillestar të komisionit përkatës, i cili i jepte në dorë një lektori të besuar pikërisht ballinën dhe disa faqe të veprës objekt ndëshkimi. Qofë se lektori, duke u betuar dhe me anë të një shënimi përbledhës, nuk e konsideronte të rrezikshme veprën, ajo nuk kalonte në fazën e dytë ndëshkimore dhe nuk radhitej në Indeks.

Megjithatë, dosja e hapur duhet të kishte mbetur në arkiv, së bashku me faqet që i mungojnë *Mesbarit*

Por, me gjithë hulumtimet të bëra, dosjen nuk e kemi gjetur.

Na duhet pra të pajtohemi me faktin që ajo do të ketë mbetur, dhe pastaj u dogj, në Francë, ku gjithë arkivi i Sant'Ufficio-s dhe arkivat e tjerë të Vatikanit u zhvendosën nën perandorinë e Napoleon Bonapartit. Mbas rënies së tij, arkivat u kthyen në Romë, përveç materialit të konsideruar pa interes, i cili u asgjësua në vend.

Mbetet për t'u hulumtuar arkivi i Indeksit të Venedikut, ku ka gjasa të bazuara se vepra të jetë botuar. Po që se edhe atje *Mesbari* iu nënshtrua ndëshkimeve paraprake, dosja përkatëse mund të jetë ruajtur dhe mund të na japë ndonjë surprizë!

Ndërkaq, aksioma e ndalimit të veprës buzukjane me anë të Indeksit nuk vërtetohet në përgjithësi, ngase veprat e futura në Indeks ishin vetëm ato që konsideroheshin kundërshtare ndaj doktrinës dhe moralit katolik.

Por as në veçanti kjo aksiomë nuk vërtetohet: ajo është vënë qëmoti në dyshim nga Çabej (1968) dhe nga Kamsi (1995), pikërisht për sa i përket veprës së Buzukut.

Kjo aksiomë, në fakt, nuk vërtetohet as nga botimi i parë i Indeksit (1559)⁸, botim që sot çdokush mundet lehtësisht ta konsultojë në internet në zërin *Index librorum prohibitorum*. Në të nuk rezulton e rreshtuar vepra e Buzukut.

Për më shumë, vepra monumentale në 11 vëllime e Jezus Martinez De Butanda (1984-2002), *Index des livres interdits*⁹, na jep fjalën përfundimtare: Buzuku nuk hyri kurrë në Indeksin e librave të ndaluara as nga Inkuizicioni i Sorbonës, as nga ai i Venedikut, as nga ai i Maltës dhe as nga ai i Romës.

Në fakt, nëse e pranojmë që Reforma Protestante i ka inkurajuar përkthimet e Biblës dhe të liturgjisë në gjuhët amtare, jo gjithmonë është e vërtetë që Kisha Katolike dhe Reforma e saj t'i kenë ndaluar me akte formale dhe me futjen e tyre në Indeks. Duket, përkundrazi, që për krahinat "kufitare", edhe pas Koncilit të Trentos, Kisha Katolike t'i ketë pranuar dhe këshilluar për arsye pastorale, baritore.

Arsyet e rënies në mospërdorim të *Mesharit*, nëse turqit do ta kenë lejuar qarkullimin e tij të lirë në territoret shqiptare të zaptuara, do t'i kërkojmë, ndërkaq, duke parashtruar një ekskurs historiko-liturgjik dhe, mbi të gjitha, duke u hedhur një shikim sa më të thellë dokumentëve zyrtarë që pasuan Koncilin e Trentos, sidomos tek ato pjesë që lidhen me problemin e përdorimit të gjuhëve amtare në Shërbesën e shenjtë.

Pal Sqirò-i (1866-1941): zbuluesi dhe studjuesi i parë i Buzukut

Si dihet, merita e rizbulimit të këtij *inkunabulum*-i të letërsisë shqiptare i detyrohet Mons. Pal Sqirò-it, ipeshkvit të Arbëreshëve të Sicilisë, një arbëresh që nga kjo vepër e rigjetur mori frymëzimin për ta futur arbërishten në praktikën liturgjike të Kishës Arbëreshe në Itali më parë se kjo të ndodhte në Kishën Ortodokse në Shqipëri.

⁸ Botimit të parë të Indeksit i parapriu hartimi i një liste të publikimeve të ndaluara, e renditur në mënyrë alfabetike për mbiemër dhe emër të autorit. Ajo është fryt i një pune të përfunduar gjatë Koncilit nga një komision i themeluar *ad hoc*. Titujt në listë "për shumëllojloshmërinë dhe numrin e madh të librave, (Koncili) nuk mund t'i gjykojë një nga një, ndërkaq, urdhëron që krejt materiali i përgatitur t'i prezantohet Atit të Shenjtë, me qëllim që të përfundohet dhe publikohet sipas gjykimit të tij" (krh. *Conciliorum oecumenicorum decreta*, Sessio XXV, 1563, fq. 797. Perkt. ynë). Lista, në dorëshkrim, gjëndët në arkivin e Kongregatës për Doktrinën e Fesë (A.K.D.F. – INDEX LIBR. XVI, 1, viti 1595). Aty nuk rezulton i përfshirë emri i Buzukut. Duhët vënë në dukje se, edhe pse gezonte *imprimatur* (të drëjten e publikimit), lista e tillë nuk qe publikuar, por e plotësuar, mbeti në bazë të botimit të parë të Indeksit.

⁹ Vëllimi i 11-të (vitet 1600-1996) mund të konsultohet në internet.

Lajmi i rizbulimit u dha nga Faik Konica në revistën “*Dielli*” të Bostonit të datës 18 mars 1910, i ndjekur nga lajmi që i njëjti monsinjor po përvishet për të përgatitur një ribotim të shoqëruar nga një studim i tij.

Studimet e para mbi veprën e Buzukut, megjithatë, janë botuar nga Justin Rrota në vitin 1930.

Rrota pothuajse e fajëson Sqirò-in që nuk e ka mbajtur besën e fjalës së dhënë rreth ribotimit të veprës buzukiane. Në të vërtetë, nuk është pavend, ndërkaq, për të pyetur veten, pse vallë Pal Sqirò-i nuk e ribotoi Buzukun dhe as e botoi studimin¹⁰ e tij të paralajmëruar rreth kësaj vepre, e cila mbetet deri më tani dorëshkrim pranë trashëgimtarëve të tij.

Përgjigjja qëndron në ndodhitë e rrëmujshme që karakterizuan jetën e tij në dhjetëvjeçarin e mëpashtëm të zbulimit të Buzukut¹¹.

¹⁰ Shiko transkribimin fonetik të *Mesharit* nga Pal Sqirò-i me shënime gramatikore, në: Petrotta-Schrò, 1932-33.

¹¹ Papasi arbëresh, Paolo Schirò, pasi ushtroi me nder detyrën e profesorit të greqishtes në Seminarin e Bitonto-s (Bari), në vitin 1904 emërohet Ipeshkëv Shugurues për Arbëreshët e Siçilisë. Kthehet në Siçili, ku kryen edhe detyrën e rektorit të Seminarit Arbëresh të Palermos, nxënës i të cilit ishte më parë së bashku me poetin Giuseppe Schirò, që të dy të ushqyer me veprat albanologjike të bashkëvendasit Dhimitër Kamarda. Në Palermo, sipas një tradite të konsoliduar, kryen edhe detyrën e famullitarit të Kishës së Shën Kollit të ngjitur me Seminarin. Kjo kishë, e themeluar më parë nga grekët autoktonë, u ishte ofruar arbëreshëve të ardhur nga Korona e Moresë, tani të vendosur në qytetin e Palermos, duke konsideruar ko incidencën e traditës kishtare e të gjuhës liturgjike të të dy bashkësive: ajo greke dhe ajo arbëreshe. I zellshëm ndaj gjuhës amtare, deri tek hapja në selinë e Seminarit e një shtypshkronje për të shtypur në gjuhën shqipe, duket të ketë lënë pakëz nën hije administrimin ordinar të Institutit edhe atë të edukimit ndaj studentëve. Rreth këtyre mungesave të Sqiroit, regjistrohet në fakt një ankesë nga ana e një grupi *papasësh* të bashkësisë arbëreshe të Siçilisë që i bëjnë apel Benediktit XV. Mbi arsyet e kësaj anekse mund të ushqejmë më shumë se një dyshim, se Sqiroi, përveç që merrej me gjërat sakrale e me kultivimin e studimeve albanologjike, ngarkohej edhe me probleme sociale dhe politike. Në një epokë ku katolikët italianë ishin akoma të obliguar të qëndrojnë jashtë sferës politike për shkak të “çështjes romane”, Pal Sqiroi na del si bashkëthemelues i Partisë Popullore të don Sturzo-s dhe merrej me çështjet e kontratave agrare, duke i bërë ato me të drejta nëpërmjet marrëveshjeve me pronarët e latifondeve. Kjo lëvizje, e quajtur edhe “Kooperativat e bardha”, vinte radikalisht në krizë sistemin e “gabeloteve”, në fuqi në Siçili edhe pas bashkimit nacional. Rezultatet e reformës që vinte pas konfiskimit të “dorës së vdekur kishtare” (1886), kishin falimentuar në dëm të fshatarësisë. Pa dyshim që vepra shumëformëshe e Sqiroit në fushën e traditës së krishterë dhe arbëreshe e lirive personale, nuk mund të mos shkaktonte konflikt, si një konkurruese e rrezikshme kundrejt predikimit social-komunist të personifikuar në Siçili nga Nicola Barbato, një tjetër arbëresh. Nga ana tjetër, një rol të rëndësishëm kundër Sqiroit e luante Masoneria, në të cilën merrnin pjesë edhe disa eksponentë të shoqërisë arbëreshe të kohës, që më vonë kaluan në fashizëm. Atyre u atribuohet ekzekutimi i një atentati, edhe pse i kufizuar në plagosjen e ipeshkëvit. Në vitin 1919 ai u largua nga detyra e rektorit e për ushtrimin e detyrës së ipeshkëvit, u përhoq në Piana degli Albanesi, ku, i ngushëlluar nga vëllimet e bibliotekës së pasur private, përfundoi një përkthim të çmueshëm të Liturgjisë Hyjnore të Shën Jan Gojartit e dha një

Vepra e zbuluar: “*Mesbar*”?

Vepra që Mons. Squirò-i zbuloi ndër vëllimet e pakataloguara të Bibliotekës Apostolike Vatikane, kishte tashmë një titull: *Mesbar*.

Mesbar e quajti Mons. Kazazi, argjipeshkvi i Shkupit, kur për këtë e njoftonte Atë Gjergj Guxetën, dhe *Mesbar* vazhduan ta quanin si Guxeta (1682-1765) ashtu dhe pasardhësit e tij në rektoratin e Seminarit Arbëresh të Palermos, përveç Ketës i cili e quante *Ritual*, nga një burim tjetër dorëshkrim (Demiraj, 2007).

Duke ndjekur këtë udhëzim, të gjithë e kanë quajtur *Mesbar*, duke u mbështetur, ndoshta, tek terminologjia që u bë e zakonshme pas botimit të *Mesbarit Roman* i botuar më vonë (1570) nga Papa Piu V.

Ky meshar, që përfshinte dhe sistemonte disa libra liturgjike të përparshëm, ishte bërë tashmë meshari zyrtar - në gjuhën latine - për ritin roman, dmth. për pjesën dërrmuese e katolicizmit.

Prandaj, sinjalizimi për pasaktësinë e emërtimit nuk është i padobishëm, nëse konsiderohet që vëllimi i botuar së fundmi nën përkujdesjen e UNESCO-s mbi *Kodikët e Shqipërisë* (2003) përdor dy herë të njëjtin term “meshar” për të treguar gjëra tepër të ndryshme nga vepra e Buzukut.

Termi “meshar” është përdorur këtu për *kodikunn 70 të Beratit*¹² dhe për *kodikunn 80 të Gjirokastrës*¹³, të cilët rezultojnë me këto përmbajtje:

i pari me tekstet e *Liturgjisë Hyjnore të Shën Gjoni Gojartit* dhe të *Liturgjisë së Parasbenjtëruarëve*, kurse i dyti me *Liturgjinë Hyjnore të Shën Vasilit të Madh*.

Tekstet e përmbajtura në veprën e Buzukut, në të kundërtën, janë të shumta¹⁴.

Ndërsa *kodikët* e lartërmendur përmbajnë vetëm lëndën e palëvizshme të liturgjive përkatëse, te vepra e Buzukut mungojnë pikërisht *ordo missae* (pjesa e palëvizshme e Meshës), si edhe *canon*-i dhe *prefatio*. Kurse gjejmë *sequentia* pothuajse të plota me pjesët neotestamentare (*epistula* dhe ungjilli) dhe, gjatë kreshmëve, *postcommunio* dhe *oratio super populum*.

kontribut të çmuar në pasurimin e traditave paraliturgjike arbërisht. Mbajti edhe një korrespondencë të rregullt me albanologët e kohës, si Çabej, dhe vazhdoi të punonte mbi Buzukun deri në prag të vdekjes.

¹² Krh. *Kodikët e Shqipërisë*, 2003, fq.155.

¹³ *Ibidem.*, fq. 163.

¹⁴ Ufici i Vogël i Shën Marisë Virgjër, shtatë Psalmet pendestare, Litanitë e shenjtërve, disa pjesë të Ritualit (Pagëzimi dhe Martesa), Urdhërimet, pjesë të Katekizmit, fjali dhe tekste të bashkërenditura nga vetë Autori, me një vlerë të madhe demo-etno-antropologjike, dhe, mbi të gjitha, *Meshari* i mirëfilltë, ndonëse jo plenar, jo i plotë. Për më shumë, krh. Sorci, 2011.

E gjithë kjo, referuar meshave të të dielave dhe të festave të vitit liturgjik të rritit latino-roman, duke i kushtuar vemendje të veçantë meshave pëkujtimore të shenjtërve të urdhërit françeskan dhe të shenjtërve më popullorë të botës shqiptare.

Të përdorësh, pra, të njëjtën fjalë për të treguar vepra kaq të largëta ndërmjet tyre, të çon jashtë rruge, ngase për të dy *kodikët* e cituara (që i përkasin traditës bizantine), nuk gjendemi në praninë e një meshari.

Më e pëlqyeshme, ndërkaq, do të ishte që të emërtoheshin *kodikët* me emrin e përmbajtjes së tyre efektive, sikur është traditë pranë Arbëreshëve dhe pranë Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë, dhe të ruhet termi “meshar” për veprën e Buzukut. Por kjo thjesht vetëm pse tashmë ka hyrë në përdorim, ani se nuk kemi të bëjmë me një meshar, në atë kuptim që i jepet kësaj fjale sidomos që nga aplikimi i Koncilit të Trentos e këndej.

Origjina e Mesharit në Kishën e Romës

Kur Papa Piu V e publikoi Mesharin Roman, *Missale Romanum*¹⁵, libri që botuar sipas *editio princeps* (botimit fillestar) të një *Meshari Roman* të vitit 1474, i cili, që në kohën e vet, ndiqte tipologjinë e një libri liturgjik që zë fill me shekullin XIII, me emrin *Liber missalis secundum consuetudinem Romanae Curiae*. Ky libër ishte shumë i përhapur në botën katolike, veçanërisht nëpërmjet fretërve françeskanë¹⁶, të cilët, ndër të tjera, rezultojnë mjaft të pranishëm në krahinat shqiptare të veriut.

Libri i Buzukut, të paktën, për sa i përket pjesës në lidhje me meshët, i përgjigjet një lloji të tillë. Përkundrazi, materiali i ngelur liturgjiko-katekistik, e largon, duke e zhvendosur drejt *comes*-it: një tipologji që i përket akoma Mesjetës, kur për Shërbesën e shenjtë ekzistonin një mori librash të ndryshëm që do të gjenin sistemim përfundimtar vetëm me hyrjen në fuqi të vendimeve të Koncilit të Trentos dhe me ardhjen në epërsi të rritit roman.

Buzuku krijon një *comes*¹⁷ anti-osman

Comes ose *Liber comitis* ishte në fillim një libër leximesh të përsëritshme që përmbante një përmbledhje të Shkrimit të shenjtë dhe një antologji të autorëve shpirtërorë.

¹⁵ Me bullën *Quo primum* të datës 15 korrik 1570. Krh. Coquelines, 1730.

¹⁶ Krh. *La Piccola Treccani, dizionario enciclopedico*, 1995, fq.496.

¹⁷ Falenderoj don David Gjurgjën, përgjegjësin e Radio Vatikanit, programi në gjuhën shqipe, që më ka sugjeruar *comes*-in si një fushë të mundshme hulumtimi, e aplikueshme edhe për veprën e Buzukut

Fjala *comes*, shoqërues, përdorej pra për të treguar njerëz dhe sende. Romakët perdornin një emër të tillë për shoqëruesin e gjykatësit e më vonë për dhe atë të Perandorit; por edhe pedagogu quhej *comes*, sepse ishte i detyruar që të shoqëronte kudo nxënësin që i ishte besuar.

Në të njëjtën mënyrë, libri që shoqëronte të krishterin përgjatë gjithë harkut të jetës, pra *vademecum*-i shpirtëror, u quajt *comes*.

Më vonë fjala tregoi përmbledhjen e perikopeve nga *epistulae* ose edhe nga *epistulae* dhe Ungjijtë së bashku (*lectionarium*).

Në njërin rast dhe në tjetrin, ndonëse i vonshëm, libri i Buzukut na del si *comes*.

Nuk do të na dilte i tillë nëse për *comes* përdorim termin teknik specifik që u përdor më vonë në fushën e liturgjisë romane për të shënuar librin i cili përmbante *incipit* dhe *explicit* të perikopeve biblike që lexoheshin *per annum* gjatë meshës (*capitularia*)¹⁸.

Por nuk është ky rasti i Buzukut.

Në tërësinë e saj, vepra e Buzukut rezulton një doracak i fesë katolike, një shoqërues, jo vetëm i besimtarëve, që në pjesën më të madhe do të ishin analfabetë, por, mbi të gjitha, i klerit dhe i priftërinjve, sidomos të atyre “endacakë”, e me sa duket i tillë ishte edhe vetë Buzuku¹⁹.

Shpërbërja e sistemit tradicional të famullive, e shkaktuar nga zgjerimi i Otomanëve në Ballkan, e bënte tmerrësisht të vështirë veprimin baritor.

Cili ilaç, pra, do t’ishte më i mirë ndaj rrënimin fetar dhe kulturor, se sa oferta e “përmbledhjeve” në gjuhën shqipe?

Edhe pranë katolikëve ballkanas të tjerë latinë ndjehej kjo nevojë. *Meshari*, në fakt, ndjek publikimet e ngjashme në gjuhët serbe e kroate të kohës, sikur na informon Martin Camaj (1960).

Së këndejmi, vrejme që edhe pas Koncilit të Trentos sllavët katolikë vazhduan të kryenin Shërbesat në gjuhën “ilirike”²⁰.

¹⁸ Du Cange, 1866 dhe botime të mëtutjeshme, *ad vocem*; shiko edhe *Enciclopedia Cattolica, ad vocem*.

¹⁹ “Si pasojë e ikjeve masive dhe evakuimeve të konkorduara, një pjesë e madhe e popullit shqiptar zhvendosej në Kroaci apo gjetiu, e në veçanti në Itali. Shumë famullitarë ndiqnin fatin e tyre, kur nuk ishin drejtëpërdrejt në drejtimin e tyre”, Kamsi, 2005.

²⁰ Krh. Arkivin e Kongregatës për Doktrinën e Fesë: AKDF, S.O.C.L. 1607-1625, nr.2. Kemi të bëjmë me një shkëmbim epistolar ndërmjet nuncit të Gratzit, at Jeronimi nga Shibeniku, e Sant’Ufficio, në të cilin jepet lajmi për ekzistencën e Mesharit dhe Breviarit në gjuhën “ilyrica alias schiaua o serbiana” në përdorim nga pjesa dërrmuese e klerit dalmat. Përdorimi i tyre, ende në formën prekonciliare, qe justifikuar nga kleri si një privilegj i lëshuar *ab antiquo* Shën Jeronimit. Nunci kontrollon tekstat me anë të personit kompetent dhe lindi paragjykime mbi ortodoksinë e fesë. Nunci atëherë ia propozon këtij dikasteri që të bëhet një përkthim latinisht dhe sipas teksteve të reja të dalë nga Koncili, duke i dhënë edhe referenca mbi një njeri të

E çmojmë pra Buzukun për atë që e ka marrë përsipër barrën për të shërbyer hapësirën shqiptare me një *hapax*, një *unicum*, duke shfrytëzuar lirinë e mbetur, do të thosha ende mesjetare, në përpilimin e librave liturgjikë dhe duke e parandjerë, ndoshta, njëtrajtshmërinë, uniformitetin e afërt që do të buronte nga aplikimi i Koncilit.

Duket qartë, megjithatë, se Buzuku i kishte bërë një vlerësim të saktë rrezikut që i kanosej popullit të tij nga apostazia, si pasojë e të cilës do të humbej automatikisht edhe individualiteti kulturor dhe gjuhësor shqiptar.

Prandaj, më shumë se sa të druante apo t'i mbante në kosideratë pengesat ipotetike tridentine, ai i vë në veprim forcat e shpirtit për të kundërshtuar një armik tejet të tmerrshëm.

Nga kjo pikëpamje, Buzuku mbetet plotësisht në hullinë baritore të Kishës Katolike dhe të Koncilit të Trentos.

Koncili i Trentos (1545-1563)

Nuk duket e rastësishme, në të vertetë, që vepra e Buzukut të gjendet midis fazës së dytë (1551-1552) dhe fazës së tretë (1562-63) të Koncilit të Trentos.

Koncili, i cili nuk kishte tjetër qëllim përveç se t'u përgjigjej pikë për pikë tezave të Martin Luterit, qysh në fillim, në sesionin e katërt, më 8 prill të vitit 1546, kishte miratuar *Decretum de vulgata editione Bibliorum et de modo interpretandi s. Scripturam*²¹, me të

pasur, i cili do të angazhohej që t'i mbulonte shpenzimet e botimit, duke e shtyrë kësisoji vetë Selinë e Shenjtë si dhe klerin dalmat që të blejne nga ai. Ndodhia përfundoi në vitin 1679 në këto rrethana: "Relinquitur arbitrio sacerdotum illyricorum celebrare missam illyrico vel latino idiomate" (krh. DF, S.O. Ench. 1603-1788, N.30).

²¹ Ann. 1546: Cc. Tridentinum: Sess. IV-: *Decr. De Scriptura. Decretum de vulgata editione Bibliorum et de modo interpretandi s. Scripturam.*

"Insuper eadem sacrosanta Synodus considerans, non parum utilitatis accedere posse. Ecclesiae Dei, si ex omnibus latinis editionibus, quae circumferuntur sacrorum librorum, quoniam pro autentica habenda sit: innotescat, statuit et declarat, ut haec ipsa vetus et vulgata editio, quae longo tot saeculorum usu in ipsa Ecclesia probata est, in publicis lectionibus, disputationibus praedicationibus et expositionibus pro autentica habeatur, et quod nemo illam reicere quovis praetextu audeat vel presumat" (Denzinger, 1506).

"Praetera ad coerenda petulantia ingenia decernit, ut nemo, suae prudentiae innixus, in rebus fidei et morum, ad aedificationem doctrinae christianae pertinentium, sacram scripturam ad suos sensus contorquens, contra eum sensum, quem tenuit et tenet sancta mater Ecclesia, cuius est iudicare de vero sensu et interpretatione scripturarum sanctarum, aut etiam contra unanimem consensum Patrum ipsam scripturam sacram interpretari audeat, etiamsi huismodo interpretationes nullo umquam tempore in lucem edendae forent" (Denzinger, 1507).

"Sed et impressoribus modum in hac parte, ut par est, imponere volens ... statuit, ut posthac sacra scriptura, potissimum vero haec ipsa vetus et Vulgata editio quam emendatissime imprimere vel imprimi facere quosvis libros de rebus sacris sine nomine auctoris, neque illos in

cilin përcaktohej teksti kanonik i Biblës latine, sipas Vulgatës së Shën Jeronimit, aso kohe në fuqi, i cili nuk duhej ndryshuar në asnjë mënyrë, qoftë në shtyp e qoftë në interpretim.

Në të njëjtin sesion, etërit konciliarë kishin shprehur edhe dëshirën që të formulohej një katekizëm²². Buzuku duket sikur e përmbush këtë dëshirë me rreshtimin e pjesëve katekistike në veprën e tij.

Po në çfarë mënyre vihet ai përballë tekstit biblik zyrtar?

Përveç Pal Sqi-ro-it dhe Gaetano Petrotta-s, etj., edhe dy botimet kritike, të përkujdesura respektivisht nga Namik Resuli (1958) dhe nga Eqrem Çabej (1968), kanë vënë në dukje përkthimet e ndryshme të po të njëjtave tekste biblike, si *Lmka 1, 26-38*²³ dhe *Psalmi 130 (129)* i cili figuron në *Meshar* në tri përkthime²⁴!

Fryt i një qëndrimi të rastësishëm, që do të kishte mundur të ndodhte për mungesë të tekstit të plotë ndërsa shtypshkronja shkonte përpara në botim, si shkruan papa Tani Petrotta²⁵? Ose është fryt i një tradite të mëpërparshme tekstesh të përkthyer në gjuhën shqipe²⁶? Sidoqoftë, nëse Buzuku ishte i arratisur me besimtarët e vet nuk ka dyshim se ai nuk ka dashur që të humbiste as një drudhe nga traditat e ndryshme tashmë të formuara dhe të pranishme në popullin për të cilin e kishte marrë përsipër përkujdesjen baritore: kjo është në psikologjinë e të arratisurit!

Prandaj, mënyra më e bukur dhe më e mençur për t'i ruajtur ato, ka qenë mu ajo që t'i ketë sistemuar në vende të ndryshme të Shërbesës së shenjtë hartuar nga ai vetë.

Në seksionin XXII, të 17 shtatorit 1562, shtatë vjet nga botimi i Buzukut, Koncili miratoi *Doctrina de S.tae Missae Sacrificio*. Kapitulli VIII, *De Missa vulgari lingua*

futurum vendere aut etiam apud se reteneri, nisi primum (prius) examinati probatique fuerint ab Ordinario” (Denzinger, 1508).

²² Krh. Storia dei concili ecumenici, 1990, fq. 355.

²³ Camaj, 1960, fq. 36-42.

²⁴ Loria Rivel, 2004.

²⁵ Petrotta, 1932- 33, fq. 46, e nxjerr një gjë të tillë nga *colophon*-i, ku Buzuku ankohet që “kujdesja për kishën e tij e pengon që të merrej përkushtimisht me shtypjen e librit”.

²⁶ Është e ditur se Shën Jeronimi shpeshherë ka përshtatur përkthimet biblike ekzistuese në latinisht para tij, si për shembull *Vetus Latina*, të ardhura nga versionet latine të *Septuaginta* greke e nga *Esapla* o nga teksti ebraik. Në përkthimin e psalmeve, në veçanti, ai pati shumë vështirësi për shkak të zhanrit letrar poetik së cilit i përkisnin. Kështu, në Romë, rreth viteve 383-384, rishikoi përkthimin e vjetër latin të psalmeve, duke u bazuar në tekstin grek *Septuaginta praeesaplarë*, nga edhe rrjedh i ashtu quajtura *Psalterium romanum*. Në Lindje, mandej, rreth viteve 387-388, rishikoi prapë këtë version latin duke u mbështetur, kësaj here, mbi recensionin *Esapla* të *Septuaginta*, që do të ishte bërë e njohur pastaj në Gali, kështu që u quajt *Psalterium gallicum*. Në fund, pas vitit 390, në Bethlem, përktheu psalterin, së bashku me librat e tjerë të Besëlidhjes së Vjetër, drejtpërdrejt nga teksti hebraik, dhe për këtë arsye edhe merr titullin *Psalterium hebraicum*.

*passim*²⁷ non celebranda, lë të kuptohet se në botën katolike kishte hedhur rrënjë zakoni për të kremtuar në gjuhën e popullit.

Një praktikë e këtillë, Koncili nuk e ndalon kudo, *passim*, dhe mbi të gjitha, nuk do të kishte kuptim ta ndalonte në vendet “kufitare” të kulturave të ndryshme.

Për katolicizmin, në të vërtetë, problemi i gjuhës liturgjike, në atë kontekst të veçantë, fitoi një rëndësi absolute teologjike. Qëllimi ishte që të ripohohej se frytdhënia e Meshës dhe e sakramenteve qëndron në vetvete dhe nuk varet nga përdorimi i gjuhës së kuptuar nga besimtarët, sikur pohonte Martin Luteri dhe Reforma Protestante²⁸.

Prandaj, një pjesë e etërve të Koncilit ngulte këmbë për adoptimin gjithasajtna të latinishtes, kurse kundërshtimi i një pjese tjetër jo të vogël nga ta, dhe sidomos të ipeshkvit të qytetit ku mbahej Koncili, nuk lejoi që të merreshin masa kundër përdorimit të gjuhëve amtare²⁹.

Koncili, ndërkohë, i la të lira dhe të qeta hapësirat tashmë të formuara me tradita rituale dhe gjuhësore lokale (kemi parasysh këtu traditën glkolike, traditën e komuniteteve lindore të bashkuara me Romën ku bëjnë pjesë Arbëreshët, etj), si dhe

²⁷ Kapitulli VIII. *De Missa vulgari lingua non celebranda, et mysteriis ejus populo explicandis.*

“Etsi Missa magnam contineat populi fidelis eruditionem, non tamen expedire visum est Patribus, ut vulgari **passim** lingua celebraretur (can. 9). Quamobrem, retento ubique cuisque ecclesiae antiquo et a sancta Romana Ecclesia, omnium ecclesiarum matre et magistra, probato ritu, ne oves Christi esuriant, neve *parvuli panem petant et non sit, qui frangat eis* (cf. Thr 4,4): mandat sancta Synodus pastoribus et singulis curam animarum gerentibus, ut frequenter inter missarum celebrationem vel per se vel per alios, ex his, quae in Missa leguntur, exponant atque inter cetera sanctissimi huius sacrificii mysterium aliquod declarent, diebus peaesertim Dominicis est Festis” (Denzinger, 1749).

²⁸ “Si quis dixerit...linguam tantum vulgari Missam celebrari debere, an.(athema) s.(it)”. (Denzinger, 1759).

²⁹ Kështu ankohej brenda koncilit kardinal Madruzzo, ipeshkvi i Trentos: “Non posso soffrire che si consideri alla stregua degli abusi la traduzione della Bibbia nella nostra lingua materna. Che non direbbero i nostri avversari... se venissero a sapere che noi vogliamo togliere dalle mani degli uomini quella Scrittura santa che così spesso San Paolo prescrive di non separare mai dalla nostra bocca! Quello che io so, è che noi abbiamo imparato da nostra madre, nella nostra lingua tedesca, l'orazione domenicale, il simbolo della fede e la maggior parte delle altre verità religiose che tutti i padri di famiglia sono usi, in Germania, insegnare ai loro figli: e da questa formazione religiosa, a memoria d'uomo, non è mai venuto nessuno scandalo. Piacesse al cielo che mai professori di lingua latina e greca fossero venuti in Germania: saremmo indenni dai guai presenti e la povera Germania non sarebbe caduta sì miserevolmente in tante eresie. Perché le eresie e i semi perversi non sono mai usciti da uomini privi d'istruzione e che si esprimono nella lingua materna: essi vengono da coloro che si proclamano eruditi. Per questo, padri, ve ne prego, non vi venga in mente non dico di annoverare una tale pratica tra gli abusi, ma neanche di discutere se si può in un caso come questo parlare di abuso”. Krh. *Storia dei concili ecumenici*, vep. cit. fq. 347.

format e tjera liturgjike latine, por jo romane, si ajo ambroziane në Milano, ajo lioneze në Francë, ajo mozarabike në Spanjë, ajo galikane - normane në Sicili, etj.

Gjithashtu Koncili, më se disa herë i detyron ipeshkëvinjtë dhe barinjtë shpirtërorë, të shpjegojnë në gjuhën e vendit (*vulgari lingua*) frytdhënien dhe dobinë e sakramentëve përpara se t'i mbarështrajnë. Dhe, "po qe nevoja dhe është e mundur, t'i mbarështrajnë edhe në gjuhën amtare".³⁰

I detyron po ashtu që ata vetë, ose nëpërmjet të deleguarve të tyre, të mbajnë pretkun në gjuhën e popullit, duke u mbështetur te pjesët e Besëlidhjes së Re të lexuara gjatë meshës, të paktën të dielave dhe festave.

Në hapësirën shqiptare, ku feja katolike rezultonte minoritare kundrejt Ortodoksisë greke dhe sllave dhe përballë rrezikut të islamizimit masiv, një arsye e fortë baritore këshillonte një shpjegim të parë të pjesëve të Besëlidhjes së Re nëpërmjet leximit të po atyre në gjuhën amtare, ndërsa *kanon*-i dhe pjesët fikse të meshës qëndronin latinisht: te *Mesbari*, në fakt, siç e kemi thënë, pjesët fikse mungojnë.

Falë Buzukut, ndërkaq, populli shqiptar pati një tekst organik në gjuhën e vet për pjesën dërmuese të shërbesës së shenjtë dhe për njohuritë fillestare të doktrinës së krishterë.

Do të jenë udhëzimet post-konciliare që do ta ngushtojnë fushën e gjuhëve lokale, përmes veprës së ipeshkvijve, të obliguar tash e tutje të banojnë në dioqezat e tyre dhe të sillen porsì "delegatë" të Selisë së Shenjtë.

Pasi mbaroi koncili, filloi vepra e zbatimit të vendimeve të tij, zbatim gjithnjë e më shtrëngues nga ana e Papatit.

Kështu, me dispozitën *Dominici gregis custodiae* e 24 majit 1564, dolën në dritë 10 *Rregullat* mbi librat e ndaluar.

Vepra e Buzukut, së paku për tekstet shkrimore, binte nën ndikimin e *rregullave* III dhe IV³¹.

³⁰ Ann.1563: Cc.Trident.: sess. XXJV, 11. Nov. 1563, *Decretum de reformatione*, Canon VII.

"Ut fidelis populus ad suscipienda sacramenta maiore cum reverentia atque animi devotione accedat: paecipit sancta synodus episcopis omnibus, ut non solum, cum haec per se ipsos erunt populo administranda, prius illorum vim et usum pro suscipientium captu explicant, sed etiam idem a singulis parochis pie prudenterque, etiam lingua vernacula, si opus sit et commode fieri poterit, servari studeant, iuxta formam a santa synodo in catechesi singulis sacramentis praescribendam, quam episcopi in vulgarem linguam fideliter verti atque a parochis omnibus populo exponi curabunt; necnon ut inter missarum solemniam aut divinorum celebrationem sacra eloquia et salutis monita eadem vernacula lingua singulis diebus festis vel solemnibus explanent, eademque in omnium cordibus (postpositis inutilibus quaestionibus) inserere, atque eos in lege Domini erudire studeant". (Cfr. *Conciliorum Ecumenicorum Decreta*, fq. 764).

³¹ Ann. 1564; Pius IV; *Regulae Trident. De libris prohibitis: "Regulae Tridentinae" de libris prohibitis, confirmatae in Const. Dominici gregis custodiae, 24 mart, 1564.* (omissis).

Kjo nuk do të thotë, megjithatë, që libra si *Meshari* ynë, të botuar para dhe pas koncilit, të mos mund të përdoreshin, por e drejta për t'i lejuar tani u takon ipeshkvijve apo Inkuizicionit.

Përforcohet, kështu, vepra e censurës parandaluese ose e pas botimit, që do të ketë për qëllim pastërtinë e doktrinës katolike kundër Protestantizmit dhe kundër përdorimit të Biblës për shortari ose në mënyrë të gabuar.

Buzuku i harruar

Libri i Buzukut pra duhet të shikohet si kulmi i një lloji letrar liturgjik, lloj që kemi arsye të bazuar ta konsiderojmë të lëvruar qëmoti te shqiptarët, jo vetëm në dorëshkrim por ndoshta edhe në botim.

Përdorimi i gjuhëve amtare në fushën kishtare, sigurisht jo në mënyrë të përgjithësuar, kishte marrë hov qysh nga shekullin XII në Evropën perëndimore. Nuk ka arsye të përjashtohet mundësia që e njëjta gjë të ketë ndodhur edhe në Evropën lindore, ku, ndër të tjera, përdorimi i sllavishtes kishtare, si zëvendësim i greqishtes dhe i latinishtes, daton qysh prej shekullit IX.

Si dëshmi të mëtejshme, le t'i kujtojmë rastet tashmë të njohura, pranë kroatëve dhe serbëve katolikë, por edhe pranë shqiptarëve me formulën e Pagëzimit të vitit 1462, për katolikët romanë, dhe me troparin e me ungjillin e Pashkëve të shekullit XIV, për ndjekësit e traditës bizantine.

Shpikja e shtypit me shkronja të lëvizshme, lehtësoi përhapjen e teksteve, kështu që në kohën e Buzukut i jepet më shumë rëndësi mësimi fetar tek populli

Regula III: «Versiones scriptorum etiam ecclesiasticorum, quae hactenus editae sunt a damantis auctoribus, modo nihil contra sanam doctrinam contineant, permittuntur. Librorum autem Veteris Testamenti versiones viris tantum doctis et piis iudicio episcopi concedi poterunt, modo huiusmodi versionibus tamquam elucidationibus vulgatae editionis ad intelligendam sacram Scripturam, non autem tamquam sano textu utantur. Versiones vero Novi Testamenti ab auctoribus primae classis huius Indices facta nemini concedantur, quia utilitatis parum, periculi vero plurimum lectoribus ex earum lectione manare solet. Si quae vero annotationes cum huiusmodi quae permittuntur versionibus vel cum vulgata editione circumferuntur, expunctis locis suspectis a facultate theologica alicuius Universitatis catholicae aut Inquisitione generali, permitti eisdem poterunt, quibus et versiones...» (Denzinger, 1853).

Regula IV: “Cum experimento manifestum sit, si sacra Biblia vulgari lingua **passim** sine discrimine permittantur, plus inde ob hominum temeritatem detrimenti quam utilitatis oriri, hac in parte iudicio episcopi aut inquisitoris stetur, ut cum consilio parochi vel confessari biblorum a catholicis auctoribus versorum lectionem in vulgari lingua eis concedere possint, quos intellexerint ex huiusmodi lectione non damnum, sed fidei atque pietatis augmentum capere potest” (Denzinger, 1854).

nëpërmjet fjalës së shkruar dhe të shtypur: Bibla e përkthyer merrte vendin e parë, e pastaj rreshtojë Mesha³².

Ndalimet, të cilat edhe përpara Koncilit ngriheshin herë pas here në lidhje me leximin e Biblës në gjuhën vulgare, edhe pse të ngjashme me klithmat e Manxonit, ishin të diktuar nga shpërdorimi që i bëhej.

Reagimi i Kishës Romane, në një epokë në të cilën Papatë është akoma i implikuar në ambicie politike dhe ndjekës i relativizmit të pranishëm në humanizmin e perjudhës së Rilindjes evropiane, ndoshta nuk do të vinte në dritë me seriozitetin e reformave - sikur dëshirohej nga shpirtat më të ndërgjegjshëm - pa leksionin e Luterit.

S'ka dyshim që ngujimi, mbyllja e Kishës si në një fortesë, me qëllim që t'i ruajë ata që i kishin mbetur besnikë prej çdo kontaminimi me Protestantizmin, kërkonte rregulla të sakta dhe reforma jo indiferente në mjedisin katolik.

Të kërkuara nga koncili, ato u shtjelluan me tej, duke filluar nga Papa Pio IV.

Në fushën e liturgjisë ky qëndrim pati si rrjedhojë të menjëhershme uniformitetin e librave për Shërbesën e shenjtë, uniformitet që pati mundësi të përhapet botërisht me zhvillimin e shpejtë të artit tipografik.

Shumë vepra, ndërkohë, si ajo e Buzukut, zunë të mos përdreshin më. Jo pse ishin të vëna në Indeks ose në kundërshtim me *Rregullat*, por sepse ishin jo të plota dhe jo të përputhshme me daljen në dritë të botimeve tipike³³, zyrtare për krejt Kishën të ritit latino-roman, rit ky që doli fitimtar nga koncili dhe ia grisi apo ia ngushtoi hapësirën riteve të tjera edhe pse po ashtu latine edhe ato.

Botimet, sigurisht në latinisht, ishin me tirazhe praktikisht të pakufizuara dhe lehtësisht të pranueshme, kështu që ku nuk kishte një traditë të fortë dhe të pakontestueshme të përdorimit të gjuhës amtare, latinishtja fitonte dhe i mbyste traditat dhe gjuhët lokale në liturgji.

Ndër arsyt e tjera të ndërprerjes së përdorimit të *Mesharit*, disa prej tyre tashmë të vëna në pah edhe nga Çabej, po radhisim botimet zyrtare: *Catechismus ex decreto concilii tridentini*, ose *Katekizmi Roman*, 1556; *Breviarum Romanum*, 1568; *Missale Romanum*, 1570; adoptimi i Kalendarit të ri, 1582; *Martyrologium Romanum*, 1584; *Pontificale Romanum*, 1595/96; *Rituale Romanum*, 1614.

Faktori, pra, që na duket më së shumti i implikuar për t'i katandisur në heshtje, duke i vënë jashtë përdorimit, tekstet dhe përkthimet të mëpërparshme, jo vetëm në

³² Krh. Bihlmeyer-Tuechle, 1960, v.III, fq. 147

³³ Me zbulimin e shtypit edhe kishat ortodokse vendosën edicione tipike. Venediku, që rezultoi vendi më i akredituar si vend i shtypjes së *Mesharit*, ishte qendra e këtij aktiviteti në favor të grekëve, slavëve, armenëve, por edhe të hebrenjëve.

shqip por edhe në gjuhë të tjera, është rishikimi i *Vulgatës* së Shën Jeronimit³⁴, rishikim, ndër të tjera, jo i drejtë e i destinuar, për afërsisht rreth vitit 1592, që të rishikohet përsëri.

Përsa i përket pikërisht *Mesbarit*, ndonëse mendimi dhe dëshira e Autorit ka qenë përhapja e tij në hapësirën mbarëshqiptare, për arsye kontingjente ai do të ketë shërbyer vetëm brenda komunitetit të shqiptarve të arratisur, ku përdorimi u shua me asimilimin e tyre.

Qoftë edhe se kopje të librit do të kenë mbërritur në Shqipëri, faktorët e ndryshëm të lartpërmendur dhe situata katastrofale e katolicizmit atje, nuk do t'i kenë lejuar *Mesbarit* përhapjen e dëshiruar në mesin e besimtarëve.

Mos të harrojmë pra se në trojet shqiptare të zaptuara nga turku, rolin e Inkuizionit, më shumë se sa Roma e largët, e luante *hyqimeti* osman i ndihmuar nga Kisha Ortodokse greke dhe serbe.

Megjithatë, nga vazhdimësia e gjuhës së shkruar mund supozojmë se në mesin e klerikëve, sidomos të atyre përkohësisht jashtë atdheut, për studime o për arsye baritore, vepra e Buzukut do jetë përdorur dhe ruajtur për njëfarë kohe, duke luajtur rolin e udhërrëfyesit për botimet e autorëve të ardhshëm.

Në rizbulimin e Buzukut

Shekulli XVIII me të mirat dhe këqijat që i dihen, pati një rëndësi të madhe për botën shqiptare dhe arbëreshe.

Papa Klementi XI, Albani (1700-1721) e drejtoi interesin e Kishës Katolike drejt Ballkanit e dukshmërisht drejt Shqipërisë, nga e cila ishte i vetëdijshëm që rridhte familja e tij. Më 1703 do të kremtojë Koncilin provincial shqiptar, *Kuvendin e Arbënit*, aktet e të cilit, të shkruara në shqip, përbëjnë një dëshmi të çmueshme të zhvillimit të kësaj gjuhe në krahasim me Buzukun.

Papa Klementi XII, Corsini (1730-1740) krijoi dy kolegjet për Arbëreshët, në Kalabri dhe Siçili, dhe emëroi në Kalabri një ipeshkëv tjetër për shugurimin e priftërinjve të ritit lindor, pas atij të Romës, për hir të traditës bizantine të Arbëreshëve.

Benedikti XIV, Lambertini (1740-1758), hodhi themelet e një të drejte kanonike për Italo-Shqiptarët³⁵, duke ndikuar, në të mirë apo në të keq, mbi fatet e bashkësisë arbëreshe në Itali.

³⁴ Kemi të bëjmë me botimin e Biblës së quajtur *Sisto-Clementina*.

³⁵ Khs. Bullën *Etsi pastoralis* të datës 26 maj 1742.

Oborri papnor, prandaj, dhe Selia e Shenjtë, ushtruan për më shumë se një gjysmë shekulli një filo-albanizëm të frytshëm, në kuadër të të cilit mons. Kazazi argjipeshkëvi i Shkupit, në vizitë në Romë, pati rastin të zbulonte kopjen e vetme të Buzukut, atëherë të ruajtur në Propaganda Fide, dhe t'ia komunikonte këtë at Gjergj Guxetës, themelues më 1734, e pastaj rektor, i Seminarit Arbëresh të Palermos.

Letra e Kazazit, që nxjerrte gjithnjë kokën midis letrave të arkivit të Seminarit, kërkonte përgjigje kohë mbas kohe nga mjedisi kulturor arbëresh, deri sa Pal Sqirò-i e gjurmoi dhe me durim e qëndrueshmëri e nxori më në fund në dritë *Mesharin*.

Frytet e vonshme të *Mesharit*

Vendimmarrjet e pas-Koncilit të Trentos, rreth përdorimit të gjuhës latine në liturgji, qëndruan në fuqi në Kishën Perëndimore deri më 1963³⁶.

Nuk besojmë të jemi larg nga e vërteta, nëse mendojmë se Pal Sqirò-i të jetë frymëzuar nga vepra e Buzukut kur, duke u nisur nga viti 1912, domethënë 3 vjet pas zbulimit të *Mesharit*, filloi të shtypte dhe shpërndante për bashkësitë arbëreshe të Siçilisë *Fjala e t'In Zoti*, përkthimin arbërisht të pjesëve të Besëlidhjes së Re për ta lexuar ose kënduar gjatë Liturgjisë Hyjnore, Meshës së të dielave.

Edhe për veprën tjetër të Sqirò-it, përkthimin arbërisht *Mesha e Shën Jan Gojartit* (Schirò, P., 1964) nuk është e vështirë të ngjitemi deri tek mësimi i Buzukut.

Megjithëse Kisha Lindore teorikisht lejonte përdorimin e gjuhëve kombëtare në liturgji, dihet sa vështirësi pati për hyrjen e gjuhës shqipe në Kishën Ortodokse³⁷.

Ndërmjet Arbëreshëve, në të kundërtën, nuk pati, para Sqirò-it, ndonjë lëvizje për ta përkrahur përdorimin liturgjik të arbërishtes (Chiaramonte, 2004).

Zbulimi i Buzukut dhe zelli i Pal Sqirò-it, ndërsa aktivizuan këtë lëvizje tek Arbëreshët, u bënë edhe një shërbim ortodoksëve të Shqipërisë duke i përcaktuar drejt autoqefalisë së Kishës së tyre dhe drejt promovimit të shqipes në gjuhë liturgjike.

³⁶ Koncili i Dytë Vatikanas, Dekreti mbi liturgjinë *Sacrosanctum Concilium*, më 4 dhjetor 1963. Krh. Schmidt, 1966.

³⁷ Khs. Historia e Popullit Shqiptar, v.III, 2007.

KONSULTIME NGA BURIMET ARKIVORE

Arkivi i Kongregatës për Doktrinën e Fesë (ish Sant'Ufficio):

AKDF, S.O.C.L. 1607-1625, N.2.

AKDF, S.O. Ench. 1603-1788, N.30.

AKDF, Index Libr. XVI, 1

Bibliografia

1. BARBIELLINI AMIDEI, D., *Il Seminario Italo-Albanese di Palermo e i Monaci Basiliani*. Lugaro, Palermo 1924.
2. BERISHA, N. A., "Meshari" *vepër e hartuar nga Gjon Buzuku: studim*. Marzi (CS), Comet Editor Press, 2014.
3. BIHLMeyer K. - TUECHLE H., *Storia della Chiesa*. Brescia, Morcelliana, 1960, vol. IV. (*Kirchengeschichte*. Paderborn).
4. BORGIA, N., *Pericope evangelica in lingua albanese del sec. XIV da un manoscritto greco della Biblioteca Ambrosiana*. Grottaferrata, Tip. San Nilo, 1930.
5. BULO, J., "Meshari" i Gjon Buzukut midis reformës dhe kundërreformës. Në: <Konferenca Jubilarë 450-vjetori i Mesharit të don Gjon Buzukut>, Ulqin 27-28 maj 2005. Në: <Dija>, nr. 3/2005, f. 205-210.
6. CAMAJ, M., *Il "Messale" di Gjon Buzuku: contributi linguistici allo studio della genesi*. Në: <Shëjzat - Le Pleiadi>, 1960, nr. 3.
7. ÇABEJ, E., *Meshari i Gjon Buzukut: (1555) I-II*. Botim kritik punuar nga Eqrem Çabej, Universiteti Shtetëror; Instituti i Historisë e i Gjuhësisë. Tiranë, 1968.
8. CHIARAMONTE, Z., *Arbëreshët dhe përkthimi i Biblës në shqipen standarde*. Në: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Bibla shqip dhe tradita*. Akte të Seminarit shkencor për 10-vjetorin e përkthimit integral të Biblës në shqipen standarde nga don Simon Filipaj, Tiranë, 24.05.2004. Tiranë, Toena, 2004, fq. 62-69.
9. CHIARAMONTE, Z. G., *Il Messale di Gjon Buzuku (1555): un hapax in lingua albanese tra Riforma, Controriforma e Islam*. Në: <Rivista Liturgica>, terza serie, anno XCVIII, fascicolo, 6, nov.-dic. 20011, p. 98-157.
10. *CONCILIORUM OECUMENICORUM DECRETA*, a cura dell'Istituto per le scienze religiose. Bologna, ed dehoniane, 1991.
11. COQUELINES, C., *Bullarum ... Romanorum Pontificum ... Collectio*. Roma, 1730.
12. DEMIRAJ, B., "Un manoscritto rituale in nostra lingua". Në: <Biblos>, 2007, nr.

13. DENZINGER-SCHÖNMETZER, *Enchiridion Symbolorum definitionum et declarationum de rebus fidei et morum*. Editio XXXIV, Romae, Herder, 1967.
14. DU CANGE - DU FRESNE, *Glossarium ad scriptores mediae et infimae latinitatis*. Niort, L. Fabre, 1886.
15. ELSIE, R., *Fati i Gjon Buzukut* Në: <Shekulli> e përditshmja tiranase, 14.06.2006.
16. FRANCEV, F. – GIANELLI, C., *Vatikanski Hrvatski molitvenik i Dubrovački Psaltiri*, Zagreb 1934.
17. GJINI, G., *Ipshekëvia Shkup-Prizren nëpër shekuj*. Ferizaj, Drita. 1992.
18. *HISTORIA E POPULLIT SHQIPTAR*, vol III. Tiranë, Toena, 2002-2007.
19. ISTITUTO DELL'ENCICLOPEDIA ITALIANA, *La piccola Treccani: Dizionario enciclopedico italiano*, vol. XII, Roma, Treccani, 1995.
20. KAMSI, V., *Gjon Buzuku e Konçili i Trentit*. Në: *Seminari Ndërkombëtar për Gjubën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare*. Tiranë, 1995.
21. KAMSI, V., *Buzuku dhe botimi i "Mesharit"*. Në: <Dija> Bashkimi i Krijuesve Shqiptarë në Mal të Zi, *Konferenca jubilarë 450-vjetori i Mesharit të don Gjon Buzukut*, Ulqin 27-28 maj 2005, fq. 129-134.
22. *KODIKËT E SHQIPËRIS*. Drejtorja e Përgjithshme e Arkivave, Tiranë, 2003.
23. KONICA, F., *Ma i vjetri shkronjës shqiptar i njohur*. Në: <Dielli>, 1910. viti II, nr. 51.
24. LA PIANA, M., *Il Catechismo albanese di Luca Matranga da un manoscritto vaticano*. Tipografia italo-orientale "S. Nilo", Grottaferrata 1912.
25. LORIA, R., *Psalmi 130 (129) në Mesharin e Buzukut dhe tradita e humbur e teksteve fetare shqiptare të Mesjetës*. Në: Universiteti i Prishtinës - Fakulteti i Filologjisë, *Seminari Ndërkombëtar për Gjubën Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare*, 22/1. Prishtinë, 2004, fq. 67-76.
26. MANDALÀ, M., *E mbsuame e krështerë* a cura di Matteo Mandalà. Caltanissetta, Sciascia, 2004.
27. MARLEKAJ, G., *La più antica pubblicazione in lingua albanese*. Në: <Quaderni dell'Istituto di Filologia>, 1958, nr. III, fq. 35-52. Bologna, Università di Bologna, 1959.
28. MARTINEZ DE BUTANDA, J., *Index des livres interdits*. Sherbrooke-Genève, Centre d'Etudes de la Renaissance, Université de Sherbrooke-Droz, 1984-2002.
29. PETROTTA, G., - SCHIRÓ, P., *Il più antico testo di lingua albanese: trascrizione fonetica con note e osservazioni grammaticali di Mons. Paolo Schiró e riproduzione dell'Editio Princeps con introduzione di G. Petrotta*. Në: <Rivista indo-greco-italica>, Napoli 1932-1933.
30. RESSULI, N., *Il Messale di Giovanni Buzuku*. Riproduzione e trascrizione a cura di Namik Ressuli. Città del Vaticano, Biblioteca Apostolica Vaticana, 1958.
31. REŠETAR, M. - GIANELLI, C., *Dva Dubrovačka iezična spomenika iz XVI vijeka*. Beograd, 1938.

32. REXHA, I., *Onomastica mesjetare arbane në arealin e Dardanisë*. Prishtinë, Europrint, 2005.
33. RROTA, J., *Monumenti ma i vjetri i gjuhës shqipe (Buzuku 1555)*. Në: <Ylli i Drites>, vjeti 1, Shkodër, 1930, fq. 33-55.
34. RROTA, J., *Don Gjon Buzuku (1555): pjesë të zgjedhuna e të komentueme për shkollë të mjesme*. Shkodër, 1930.
35. SCHIRÓ, G. (†1927), *Canti tradizionali e altri saggi delle Colonie albanesi di Sicilia*. Napoli, Tip. Pierro e Figlio, 1923, f. 487-531.
36. SCHIRÓ, P., *Mesha e Shën Jan Gojartit përkthyer shqip nga imz. Pal Schiroi botuar me kujdesin e prof. Zef Schiroit* (†1965). Palermo, Tip. Boccone del Povero, 1964.
37. SCHIRÒ, Z. (†1965), *Pal Schiroi*. Në: Pal Schiroi, *Mesha e Shën Jan Gojartit ...* Palermo, 1965, fq.1-16.
38. SCHMIDT, H., *La Costituzione sulla Sacra Liturgia*. Roma Herder, 1965.
39. SCIAMBRA M., *Indagini storiche sulla comunità greco-albanese di Palermo*. Grottaferrata, Tip. "S. Nilo", 1963.
40. SORCI, P., *La liturgia del Messale di Buzuku: nota aggiuntiva*. Në: <Rivista Liturgica>, terza serie, anno XCVIII, fascicolo, 6, nov.-dic. 20011, p.158-160.
41. *STORIA DEI CONCILII ECUMENICI*, con la collaborazione di Giuseppe Alberigo et alii. Brescia, Queriniana, 1990.

REFERIME

Alexandra CHIVARZINA

SISTEMI I NGJYRAVE NË GJUHËN MAQEDONASE DHE SHQIPE NJËSITË KRAHASIMTARE ME KUSHTET E NGJYRËS SË VERDHË DHE TË GJELBËR

Sistemi i ngjyrave është një element kryesor i fjalorit të gjuhës. Raporti vëzhgon disa gjëra të përgjithshme dhe të veçanta në gjuhën maqedonase dhe shqipe në njësitë krahasimtare me termat e ngjyrës së verdhë dhe të gjelbër. Vëzhgoj gjithashtu rëndësinë e tyre në modelin mitologjik të botës dhe disa konotacione të tyre. Baza teorike e studimit është veprat nga Berlin e Kay (Berlin, Kay 1969), Lakoff e Johnson (Lakoff, Johnson 2003), Wierzbicka (Wierzbicka 1999). Raporti është vetëm një pjesë e studimit të madh në këtë fushë. Ne propozojmë të përqëndrohemi në njësitë krahasimtare, sepse ata janë një lidhje kalimtare nga fraza me drejtkuptim deri faza frazeologjike. Shembuj mbi të cilat bëjmë analizën, janë marrë nga letërsia, folklori, fjalorët, nga komentet në rrjetet sociale dhe forumet në internet (në tekstin e mëtejshëm *burimet*). Drejtshkrimi i autorëve është ruajtur.

Në analizën krahasimtare dallojmë subjektin e krahasimit (gjëja që krahasohet), bazën, mjetin (lidhjen) dhe objektin (gjëja me të cilën bëhet krahasimi) – prej metodës së Ogotjcevit (Ogotjcev 1978, Iljasova 2009).

<i>subjekti i krahasimit</i>	<i>baza</i>	<i>mjeti</i>	<i>objekti i krahasimit</i>
лице fytyrë	ЖОЛТО e verdhë	како/ко/небаре si	лимон limon

Është i njohur një mendim që në fillim ngjyrat vërtetoheshin në një menyrë të tërthortë, në krahasim me objektet dhe fenomenet e natyrës me të njëjtën ngjyrë: e bardhë si qumësht, i zi si qymyr, i kuq si gjaku, blu si qielli.

Një karakteristikë e përbashkët e gjuhës maqedonase dhe shqipe është predominimi i krahasimeve me fjalët nga faza e parë dhe e dytë të evolucionit të ngjyrave (*i bardhë/ i zi, i kuq*). Kjo karakterizohet me numrin e madh të përdorimeve dhe konotacioneve.

Ngjyra e verdhë dhe e gjelbër paraqiten në fazën e tretë, fillimisht si një fjalë.

Më tej ato ndryshojnë. Këto ngjyra korrespondojnë me diell (*i verdhë si dielli*) dhe me faunë (*i gjelbër si bari*) – elementat e rëndësishme për njeriun.

Për interpretimin e ngjyrave *të verdhë/ жолт* në fjalor ka një komponentë të përbashkët për dy gjuhët – një krahasim me limon ose ari.

Жолт *adj* Protoslav. **žьlъ*, н.-е. **g^hel-* «yellow, green» (Pokorny 1959: 429–434) 1. *што има боја на зрел лимон, жолчка од јајце, или злато.* (Мургоски 2005: 200–201) the colour of a ripe lemon, egg yolk or gold;

Verdhë (i,e) *mb.* Lat. *viridis* «green» (Orel 1998: 499) 1. *Që ka ngjyrën e kashtës, të limonit të pjekur, të squfurit a të arit.* (FGjSSh: 2132–2133) the straw colour, the colour of a ripe lemon, sulfur or gold.

Sipas mendimit popullor dielli është një objekt reference me i mirë për ngjyrën e verdhë, sepse është në mjedisin e njeriut, për të cilin ai harton perceptimin e tij të ngjyrave. Por ngjyra e diellit mund të perceptohet si e ndryshme. Në mengjes dielli është i kuq, në mbrëmje – rozë ose vjollcë, në mesditë shkëlqimi i tij duket i bardhë. Megjithatë shprehja ‘diell i verdhë’ gjithashtu si edhe krahasimet me diellin ekzistojnë në të dy gjuhët.

- *Смилот! / Цвет со карактер. Нема друг таков цвет. Цвет беспоредба, цути само на високи планински пасишта. Бара многу сонце. Жолт како сонце отскокнато колку за дланка над хоризонтот. Жолт како алтан. И како што златото од алтанот не рѓосува, така миризбата од смилот не исчезнува.* [Ф. Мухич. Дневник/ СМЛОТ 18.03.06]¹ *Immortelle! / Flower with its character. There is no one like this. A flower with nothing to compare, blooms only on the high pastures in the mountains. It needs lots of sun. Yellow like the sun high above the horizon. Yellow as gold. And like the gold never rusts and immortal aroma never vanishes.*
- *Flokë të verdhë si dielli, ja si të kujdesemi për to.* [Noa.al 10.07.13] *Hair yellow like the sun, that's how we care about it.*

Këto krahasime orientohen mbi ngjyrën e diellit në mes të ditës. Për ta sqaruar përkufizimin në fjalor përdoren krahasime me të qëndrueshme: *i verdhë si limon, si ari.*

Për të njëjtën arsye, në interpretimin e fjalës maqedonase s’ka krahasim me kashtë: tipari kryesor i kullosave kashtë nuk është ngjyra e verdhë, ajo nuk është

¹ Në kllapa katrore janë burimet.

intensive. I rëndësishëm është fakti që kullosat janë të thata dhe boshe. Por krahasimet me kashtë përdoren shpesh duke përshkruar ngjyrën e flokëve.

- *A deluxe u brillant ne se voopшто лоши фарби убаво го покриваат коренот, не останува портокалов или **ЖОЛТ КАКО СЛАМА**.* [Forum.femina.mk 24.02.11] «Deluxe» and «Brillant» are rather good colours, they colour well over the roots, without leaving them red or **yellow as straw**.
- *Te mbash ngjyren e flokeve te shkëlqyeshme nuk eshte e thjeshte per te gjitha tonalitetet, ngjyra geshtenje humb shkëlqimin, e kuqja kthehet ne ngjyre te bronzte, ndersa e **verdha** bebet **si kashte**.* [Ikub.al 13.12] It is not so easy to keep the radiant brightness of the colour, chestnut colour fades, red becomes bronze and **yellow** becomes **like straw**.

Kur njerëzit duhet të japin disa shembuj me mbiemrin ‘i gjelbër’ si bazë, zakonisht ata përmendin barin, gjethet dhe bimët e freskëta. Bari është një objekt kognitiv që ndihmon për të lidhur idetë me realitetin. Prandaj në fjalor ka fjalë *bar* në interpretimin e ngjyrë së gjelbër.

Зелен Old Slav. зеленъ, I.-e. **g^hel-* «yellow, green» (Pokorny 1959: 429-434) *adj*
1. a) *што има боја меѓу сина и жолта или како трева што расте, смарагд, итн.* (Myroски 2005: 235) the colour between blue and yellow, or like the growing grass, emerald, etc;

Gjëlber (i, e) *mb.* I.-e. **g^hel-* «yellow, green» (Orel 1998: 131) 1. *Që ka ngjyrën e barit të njomë a të gjetheve të bimëve, i blertë.* (FGjSSh: 606-607) the colour of the fresh grass and leaves of the plants, a reference to *i blertë*;

Blertë (i,e) *mb.* I.-e. **bhloros* «brilliant, bright» (Orel 1998: 29) *Që ka ngjyrën e barit dhe të gjetheve të njoma, i gjelbër.* (FGjSSh: 156) the colour of the grass and fresh leaves, a reference to *i gjelbër*;

Jeshil,-e *mb.* Tur. *yeşil* «green» 1. *I gjelbër.* (FGjSSh: 742) Interpreted through synonymous *i gjelbër*.

Sistemi i ngjyrave në shqipe është i veçantë sepse në të njëjtën kohë ka tri fjalë për ngjyrën e gjelbër: *i gjelbër, jeshil, i blertë*. Të tretë janë të aftë në veprimin si bazë për krahasim, por në pergjithësi përdoren fjalët *i gjelbër* dhe *jeshil*.

Në disa të folmet të shqipes, në fazën e tretë, në të cilën ato perceptohen si e njëjta ngjyrë, përdoret edhe tani.

- *Kur ka dalë Lujje t'verdha/ ateherë hanën nana ka mallkue:/ -T'u shkëmtë drita ty, o mori han-e,/ Qi s'ma çove at natë një fjalë,/ N'Lujje t'verdha shpejt me dalë,/ bashkë me hi n'nji vorr me djalë!* [Songs of the Frontier Warriors 2004: 342, translation see in Elsie, Mathie-Heck 2004: 343] When she got to the Green Valleys, / Did she cursed the moon above her: / “May your beams of moonlight wither,/ For you did not send a message, / Call me up to **the Green Valley** / That I bury myself with him!

Në kohën e tashme ngjyrat e verdhë dhe e gjelbër janë të ndara, në secilën prej tyre ka shumë kuptime figurative, por disa përdorime takohen.

1) Krahasimet më të shpeshta dhe të qëndrueshme për ngjyrën e verdhë në kuptimin drejtpërdrejtë për të dy gjyhet janë: *како сонце/ si diell, како злато/ si ar, како лимон/ si limon, како жито/ si grurë, како слама/ si kashtë, како смил/ si trëndelinë, како восок/ si dyll.*

Objektet krahasimi janë ngjyrat e flokëve apo flokët e kafshëve, fenomenet natyrore, ushqimet.

- *Овој сандак е дрвен и стар, но за мене е златен бидејќи во него има шишиња со ракија **жолта како растопено злато.*** [Dnevnik.mk 05.06.13] This chest is wooden and old, but for me it is gold, because it keeps a bottle of rakia, **yellow like melted gold.**
- *Piqet gruri/ **I verdh si ar/** Korrë kombaji / Arë në arë.* [S. Adili “Korriku” 23.11.12] The **wheat** is ripe, **yellow like gold**, it's time to reap field by field.
- *Куките се одеднаш **жолти како узреано жито.*** [В. Урошевски «Летен дожд. Попладне по дождот» 1967: 4] The houses suddenly turned **yellow like ripe wheat.**
- *Тë dyja nuset, me flokët e tyre **të verdhë si trëndelinë,** me sytë e tyre të kaltër si deti dhe me bukurinë e ballit të lartë e me trupin e derdhur si të sehvisë, i ngjishin njëra-tjetrës posi lotët që rrjedhin nga të njëjtët sy.* [S. Luarasi “Ç’kam parë e ç’kam dëgjuar” 07.06.09] Two brides, with hair **yellow as immortelle**, with eyes as blue as the sea, and high foreheads, beautiful, slender as spruces, stood one beside another (similar) so as the tears were flowing from one eye.
- *На тешката, лакирана маса во дневната соба стои штотуку измиено грозје, **жолто како килбар.*** [Macedonian-cause.blogspot.ru 01.01.11] On the heavy, lacquered table in the living room there is just washed grape, **yellow as amber.**

Me ngjyrën e gjelbër ka më shumë krahasime të qëndrueshme me bar dhe gjethe.

Ne rolin e subjektit të krahasimit në materialin tonë gjetëm sytë, veshje.

- *На листата на омилени бои за ова лето, освен белата се и жолтата боја како ванила, розовата како пудра и неизбежната зелена како нане.* [Republika.mk 16.08.13] Among the fashionable colors of this summer there are white, yellow, vanilla, pink as powder, and the inevitable **green as mint**;
- *Qe një gjatovilë me sy të gjelbër si kumbullat e pranverës dhe me flokë në ngjyrën e kashtës së grurit.* [N. Prifti “Zhapiu” 13.09.12] He was a big man with eyes **as green as a spring plum**, and with hair of the colour of wheat straw.
- *Коа ќе помините тие и тие планиње и ќе дојдите при едно езеро, до едно убаа поле, зелено како јагурида, при едни сенки од секакви дрва, и тамо ќе ве стемни, немојте тамо да останите да спиеете, оти ќе загините.* [M. Цепенков. Македонски народни приказни. Кн. 1, № 69 “Четириесетте царски синои и четириесетте снаи, големата змија, ламјата, арапо, царо и дервишот” 1989: 318.] When you pass such a mountain and approach the lake, and there is a beautiful meadow, **green as unripe grapes**, in the shade of various trees, and there you will be overtaken by the night, do not you dare to stay there for the night, or you will die.
- *Floriri ndrinte, guri rrëzëllente me refleksë të gjelbra si një livadh pranveror nën dritën e diellit.* [R. Osmani “Dhurata e vitit të ri” 25.12.14] Gold glittered, stones gleamed **green as a spring meadow** in the sun.

2) Krahasimet me komponentin ‘i verdhë’ mund t’i referohen ngjyrës së lekurës së përfaqesuesve të racës mongoloide.

- *Кинезите жолти како смир, со очи одвај да им ги видиш, Индијците ем црни, ем жолти, и домородците како брави во косиштата. За сите Пејо нашол опис према неговите знаења и умења.* [Г. Огненовски «Фолклорот и етнологијата во Мариново и Меглен» 1994 - itarpejo.org] The Chinese - **yellow as immortelle**, with eyes that barely can be seen, Indians - black and yellow, and the natives with hair like sheep wool. For all of them Itar Peyo found a description according to his knowledge and experience;

- *Ministri Edi Rama: i kuq si indianet, i zj si afrikanet dhe i verdhe si kinezet.* [Gazeta 55 05.09.99] Minister Edi Rama: red as Indians, black as Africans and **yellow as the Chinese**.

Ngjyra e gjelbër mund të përcaktojë përfaqësuesit e kulturës islame, duke i kundërshtuar pjesën tjetër të popullsisë.

- *Kemi ene tufen e internacionalistave, here e kuqe si Sonjetet, here e verdhe si Kinezet, here **jeshile si Islamiket** e here tufe pa identitet si postmaterialistet.* [Peshkupauje.com 03.15] We have a whole crowd of internationalists: red as Soviets, then yellow as the Chinese, then **green as Islamists**, and there are some without self-determination as a crowd of postmaterialists.

3) Ngjyra e verdhë është një shenjë që merr në kulturë kuptimin kryesisht negativ, kështu në një kuptim figurativ kjo ngjyrë shpesh vepron si një simbol i vdekjes, është përdorur në emrat e sëmundjeve, ndjenjat e keqija, frikë (Usacheva 1999: 202).

- *Gishtërinjtë e tij të hollë, **të verdhë si limoni**, qenë mbërthyer fort pas cepave të tryezës.* [I. Kadare “Intermexo. Komisioni i festës, fiction short story prose” 1978]² His thin fingers **yellow as a lemon** gripped the edge of the table.
- *Сите имаваме трема. Кога ги погледнав деветмина играорци беа **ЖОЛТИ КАКО КРПИ**, и јас се плашев да не ми испадне прачката од рака со која удирав по тапанот.* [A. Сариевски - republika.mk 02.12.13] All of us were very worried. When I looked at the nine dancers, they were **yellow like rags**, and I was afraid to lose my drum stick out of my hands.

Perveç ‘njeriut’, të verdhë mund të jenë fenomenet që lidhen me jetën e njeriut: një ditë e trishtuar, kohë e dhimbshme.

- *Минаа години/ **ЖОЛТИ КАКО ЛИМОНИТЕ** на/ Баба ми Софка.* [B. Тапковски «Носталгија» 25.05.13] The years passed / **yellow like lemons** / of my grandmother Sofka;

I gjelbër në folklorin maqedonas dhe me gjerë – në folklorin sllav, shpesh ka një konotacion gjithashtu negativ, që është e lidhur me sëmundje, dhimbje, rraskapitje.

² http://web-corpora.net/AlbanianCorpus/search/?interface_language=ru

(Tsvijan 2013: 100–105) Të njëjtën mund ta vëzhgojmë edhe në gjuhën shqipe. (Novik 2013: 154–179). Konotacionet negative shihen në krahasimet që janë të përbashkëta për të dy popujt, dhe si objekt vepron kënetat, gjarpërinjtë, hardhuca si zvarranike dhe gjërat të tjera të rrezikshme.

- **Зелен како зелка, и тоа кисела.** [Bluebird.blog.mk «Смртта на Гад мувата» 23.03.10] He [man] is **green like cabbage**, and even sour;
- *Edhe ju jeni me ngjyre ashtu si edhe une: i zbehte ngjyre bezhe ose i bardh.. na ndysbon ngjyra 1000000 here ne dite.. kur jemi te smure pershembull behemi verdh ose **jeshil si bardhuca**...* [Facebook.com 07.05.13] You and me, we have the same skin colour: light beige or white colour ... It changes 1000000 times a day... when we, for example, feel sick, we become yellow or **green as a lizard** ...

4) Në kuptimin figurativ ‘e gjelbër’, e lidhur me faunën dhe si ngjyra e frutave të papjekur, kuptohet si diçka e re, e freskët.

- [На која книга сте плачеле..] *ко бев мал и зелен (како вонземјанин) на нешто од Едгар Алан По... Наравоучение, По не е за мали и зелени...* [Silence.heavenforum.org 23.02.13] [what book made you crying ...] when I was young and **green (like an alien)** something from Edgar Allan Poe ... The moral: Po is not for young and green.
- *Poezija «Нарма дерен Кумановë» на флет për lidhjet shpirtërore të shqiptarëve, për atë ndienjë brilante e të pastër si bardhësia e borës së maleve. Dëshira e shqiptarëve për t'u bashkuar fort me njëri-tjetrin kudo që ndodhen, mbetet përherë **e blertë si ullinjë** e vendlindjes së poetit, e zjarhtë si vetë shpirti luftarak që është shenja jonë dalluese.* [K. Mateli “Një udhëtim në të gjitha trevat shqiptare” 25.10.12] Poetry "Open the door for me, Kumanovo" tells us about the spiritual links with Albanians, the feeling pure and bright as the whiteness of the snow in the mountains. The desire of Albanians to be together, no matter where they are, is **green like olives** of the poet's homeland and it is burning like a brave spirit, which is remarkable, itself.

Papjekuria e personit mund të kuptohej si një cilesi negative, ndersa i gjelbër behet konotacion negativ, humbi butësi për papjekuri.

- *Нека се освести! Розова коса...ужас... што не зема да ја направи **ЗЕЛЕНА** како нејзиниот **МОЗОК**. Кога ќе сфати дека не треба толку да експериментира.*

[Signal.bg 14.05.11] She is nuts! Pink hair ... horror ... Why didn't she paint them **green as her brain**. When will she finally realize that it is not necessary to experiment so much.

Nga kjo mund të shihet që fjalët e të dyja gjuhëve kanë njëjtën rrënjë. Për këtë arsye ka tendenca të përgjithshme në shprehëdarjen e kuptimeve: percaktimi i çehrës, lekurës, ndeshet në konotacionet negative.

Kjo ngjashmëri është jo vetëm në mes të ngjyrave, por edhe në mes të gjuhët maqedonase dhe shqipe.

Në dritën antropocentrike është natyrshme që ka një numër të madh të kontekstve kur subjekti i krahasimit është njëri apo çehre e tuj. I verdhë dhe i gjelbër mund të përdoren për karakteristikat e ngjyrës së lekurës (zakonisht fytyrë), kur është i sëmurë ose i rraskapitur.

Tonët e gjelbër dhe i verdhë në fytyrë nuk ndryshojnë si ndryshojnë ngjyrat e ndritshme të trëndelinit dhe e barit. Por këto objekte, qe e rendesishme, e kryejnë standardet të ngjyrave në krahasime të qëndrueshme. Përveç krahasimit me trendilinë janë shpesh edhe krahasimet me dyll për 'i verdhë' dhe me hardhucë për 'i gjelbër', si këto elemente janë të përbashkëta për të dy kulturat dhe për naturën e territoreve të këtyre popujve. Në zgjedhjen e objektit të krahasimit është treguar edhe një marrdhënie e subjekteve të autorit, ajo mund të jetë pozitive (*e gjelbër > e ri > e freskëi*) apo negative (*i gjelbër > i ri > i papjekur*).

Bibliografi

Berlin, Kay 1969 – *Berlin B., Kay P.* Basic color terms: their universality and evolution. Los Angeles, 1969.

FGjSSh – Fjalor i gjuhës së sotme shqipe. Kryeredaktor Androkli Kostallari. Tiranë, 1980.

Пјасова 2009 – *Пљасова Л.П.* Устойчивые сравнения с колоративным компонентом в английском и русском языках. Казань, 2009.

Lakoff, Johnson 2003 – *Lakoff G., Johnson M.* Metaphors We Live By. London: University of Chicago Press, 2003.

Murgoski 2005 – *Мургоски З.* Речник на македонскиот јазик. Скопје, 2005.

Novik 2013 – *Новик А.А.* Зелёный цвет – свет – мир в традициях албанцев // Троица. Rusalii. Певтѣхостѣ. Rrëshajët... К мотиву зелёного цвета в балканском спектре (Материалы круглого стола 2012). М., 2013. С. 154–179.

- Ogoljcev 1978 – *Огольцев В.М.* Устойчивые сравнения в системе русской фразеологии. Л., 1978.
- Orel 1998 – *Orel V.* Albanian Etymological Dictionary. Leiden; Boston; Köln, 1998.
- Pokorny 1956 – *Pokorny J.* Indogermanisches Etymologisches Wörterbuch, 1959: № 637 (<http://www.proto-indo-european.ru/dic-pokorny/iew-gh.htm>)
- Tsivjan 2013 – *Цивьян Т.В.* К амбивалентности зелёного цвета // Троица. Rusalië. Πεντηκοστή. Rrëshajët... К мотиву зелёного цвета в балканском спектре (Материалы круглого стола 2012). М., 2013. С. 100–105.
- Usacheva 1999 – *Усачева В.В.* Жёлтый цвет // Славянские древности. Этимологический словарь. Том 2 (Д–К). М., 1999. С. 202.
- Wierzbicka 1996 – *Вельбицкая А.* Обозначение цвета и универсалии зрительного восприятия // Язык. Культура. Познание. М., 1996. С. 231–291.

Tanja TRAJKOVIĆ

ANALIZA E FRAZEOLOGJIZMAVE NË GJUHËN SHQIPE DHE BARASVLERËSVE PËRKTHIMORË TË TYRE NË GJUHËN SERBE NË FJALORIN FRAZEOLGJIK BALLKANIK TË JANI THOMAIT

Duke u nisur nga fakti që zhvillimi i kompetencës frazeologjike është shumë i rëndësishëm në procesin e të mësuarit të një gjuhe të huaj (L2), qëllimi themelor i këtij referimi do të jetë analiza gramatikore të frazeologjizmeve në gjuhën shqipe dhe barasvlerësve përkthimorë të tyre në gjuhën serbe, në një nga materialet e disponueshme – në Fjalorin frazeologjik ballkanik. Korpusi i analizuar përfshin (40) frazeologjizma, të organizuar në katër grupe: frazeologjizmat pjesërisht të saktë (13), të gabuar (20) frazeologjizma për të cilët nga ndonjë arsye e panjohur nuk i janë dhënë barasvlerësit përkthimorë (7), që nuk do të thotë se disa prej tyre nuk i kanë. Katër (4) njësi frazeologjike nga grupi i fundit në të vërtetë kanë barasvlerësit frazeologjikë, kurse (3) janë pa barasvlerësit përkatësë. Analiza është bërë njëdrejtimëshe nga shqipja në serbishten, ku për secilin grup pranë barasvlerësve përkthimorë merret parasysh edhe struktura e tyre gramatikore dhe semantike kurse përbërje leksikore, kuptimi i tyre, niveli i mospërputhjes si edhe forma me përputje analoge nuk do të shqyrtohen. Në pjesën e fundit konsiderohet edhe aftësia e veçantë e përkthimit të frazeologjizmeve në bazë të shembujve të parashtruar në kontekste të ndryshme. Referimi mund të konsiderohet edhe si material shtesë gjatë përdorimit të fjalorit nga ana e studentëve, pedagogëve, dhe të gjithë të interesuarve të tjerë që mësojnë gjuhën shqipe.

Fjalët kyçe: frazeologjizma, gjuha shqipe, gjuha serbe, kompetenca frazeologjike, barasvlerësit përkthimorë

1. Hyrje

Deri ditët e sotme nuk është dhënë një përkufizim gjithëpërfshirës i frazeologjizmit. Shumë autorë flasin për kolokacione frazeologjike, idioma, njësi frazeologjike, frazeologjizma, fjalë të urta, proverba si për fjalë sinonimike në kundërshtim me ata të cilët bëjnë dallim të qartë midis tyre dhe i përkufizojnë në mënyrë të ndryshme. Pa marr parasysh që këto mendime herë janë të ngjashme, herë të ndryshme, të gjithë pajtohen që karakteristika gjuhësore, kulturore, fetare, historike, gjeografike të popujve

kanë kushtëzuar paraqitjen e këtyre njësisve leksikore me karakterin e shprehjes idiomatike, të cilat me ekspresivitetin e tyre pasurojnë gjuhën, përbëhen nga dy apo tri fjalë dhe kanë funksion të përbërësve të ndryshme në fjali. Për të ndërtuar bazën e mirë fillestare, dhe për të kuptuar në mënyrë të drejtë fondin frazeologjik të një gjuhe të huaj, së pari duhet të merret parasysh afria gjeneologjike dhe tipologjike e sistemave gjuhësore.

Duke qenë se Ballkani paraqet një rajon në të cilin përzihen shumë kombe, religjone, kulturë, gjuhë, në këtë zone kontaktesh pranë të gjitha dallimeve ekziston edhe një thelb të përbashkët, thelb historik, kulturor dhe gjuhësor. Kujtim kolektiv si fryti i së kaluarës së përbashkët shpesh gjen shprehjen e vet në frazeologji, e cila në atë rast është mbartësi i karakteristikave kulturore, identiteve të ndryshme, por edhe mbartësi i hartës mendore dhe emocionale të këtij mjedisi multikultural. Në dritë të integriteteve evropiane, studimi i këtij rajoni është interesant dhe i rëndësishëm, kurse korpus i përbashkët frazeologjik ofron sërë informacionesh latente mbi zhvillim, jetën dhe marrëdhëniet në një mjedis multinacional në të cilin prekin dhe përzihen kulturë të shumta (Golubović, 2009:45).

Pasurinë e një gjuhe duhet të kërkohet jo vetëm në kuadër të fondit leksikor gjithëpërfshirës prej të cilit është përbërë fjalor i tij, por edhe në frazeologjinë e cila vërehet si pjesë përbërëse e kulturës dhe shoqërisë së një populli nga një anë, dhe folklorit të tij nga ana tjetër. Prandaj mund të thuhet se frazeologjia është një fryt i përbashkët i cili u zhvillua si pasojë e vërejtjes gjithëpërfshirëse të vendit, rolit, rëndësisë së njeriut në mjedisin e tij të afërt – natyrë dhe shoqëri, por edhe si pasojë të kuptuarit e marrëdhënieve të ndryshme që ekzistojnë midis njeriut dhe mjedisit të tij dhe midis njeriut me njeriun. Në këtë mënyrë mund të vijmë deri zhvillimin e niveleve ekspresive dhe semantiko-fuksionale të gjuhës por edhe deri zhvillimin e stileve të saj. Siç ka vërejtur Kosheriu, për të shpjeguar dhe për të kuptuar në mënyrë të drejtë vlerën e njësisë frazeologjike brenda gjuhës duhet të shihet mjedis i tërë gjuhësor në të cilin fjalë kryesore kanë “korniza” të cilat hyjnë në çdo kreativitet gjuhësor, duke qenë se asnjë diskurs nuk zhvillohet jashtë rrethanave të caktuara dhe sigurisht jo pa prapaskenë. (Mutavdžić, Sivački, Kolesar 2014:59).

Sipas Burgerit, frazeologjizmat janë pjesë e veçantë e leksikonit tonë mendor në të cilin janë bashkëlidhur njësitë e shoqëruar në një apo disa hapësira konceptuale, të formuara në bazë të njohurisë sonë mbi botë. Nga këto arsye ata janë pjesë përbërëse të fjalorit dhe pjesë e rëndësishme gjatë të mësuarit dhe përvetësimit të një gjuhe të huaj. Të kuptuarit e drejtë të tyre dhe të përkthuarit nga një gjuhë në gjuhë tjetër është një aftësi të veçantë përkthimore e cila me kalimin e kohës përvetësohet dhe zhvillohet. Për ta zhvilluar në mënyrë të drejtë nuk është vetëm e domosdoshme

njohja e gjuhës/gjuhëve së/të huaj/huaja por duhet të ekzistojë një ndjenjë e holluar për frymën e shprehjes gjuhësore. Prandaj mund të thuhet që studimi i frazeologjizmeve është një proces filologjik, i cili në kuadër të shqyrtimeve të sotme teorike paraqet një element përbërës të komunikimit interkultural, duke qenë se jep kontribut përforcimit të saj (Mutavdžić, Kampouris 2013:83).

Nga këto arsye, vëmendje të veçantë duhet të përkushtohet përvetësimit të drejtë të frazeologjisë, si një nga mënyra më të mira për të pëmirësuar kompetencën interkulturale. Krahasimi i sistemeve frazeologjike, me anë të shkallës trigradëshe na ndihmon në ndërtimin e qasjes adekuate kulturologjike ndaj vlerave të ndryshme njerëzore, kulturore, ndaj filozofisë, mënyrës së jetesës, dimensioneve shpirtërore të popujve të ndryshëm. Është e rëndësishme të theksohet se me anë të zbulimit e frazeologjizmeve analogë, por edhe me anë të zbulimit e atyre njësive të cilët ekziston zbraçeti leksikore ku duhet të kërkohet frazeologjizëm më i afërt semantik, kuptohen në mënyrë më të mirë kategoritë e sipërpërmendura. Duke i falënderuar këtyre njësive, procesi i të mësuarit është më interesant dhe nxënësit bëjnë një përpjekje shtesë për të zbuluar metaforën e thënë, e cila është karakteristike për një kulturë tjetër, përkatësisht për popullin e të cilit gjuhë mësohet. Njëkohësisht, nga pikëpamja metodike, mësimdhënia e organizuar mirë, maksimumi dhe minimumi frazeologjik, mënyra kreative dhe ritmi i barabartë i përvetësimit të këtyre njësive, na çon deri kapërcimin e pengesave gjuhësore, përmirësimin e shkatësive komunikative dhe perceptimeve tona, ku njëkohësisht ndërtohet personalitet të vërtet kulturor dhe gjuhësor.

2. Qëllimi dhe metodologjia e punimit

Duke marr parasysh faktin që kompetenca frazeologjike gjatë të mësuarit të gjuhës së huaj mund të zhvillohet jo vetëm me shtënien e hershme të kesaj discipline gjuhësore në procesin e të mësuarit, me qasje adekuate didaktike "siç janë materialet e mësimdhënësve të shumëllojshme, të cilat përfshijnë këngë, filma, pjesë nga revistat dhe gazetatat, audio programe që janë në përputhje me nivelin e njohurive të nxënësve në të cilat nëpër shembuj dhe situata konkrete komunikuese mundësohet nxënësve të zgjerojnë fjalorin e tyre në mënyrë interesante dhe të integrohen në kulturën dhe procesin e përvetësimit të gjuhës, rëndësine më të madhe për përvetësim të shpejtë dhe të lehtë të frazeologjizmeve kanë fjalorë" (Jasmina Bučevac Nerić 2013:275). Në lidhje me këtë, autor dëshiron të theksojë që Fjalor frazeologjik ballkanik¹ ka mbetur

¹ Fjalorë frazeologjik ballkanik të Jani Thomait është pesëgjuhësh (shqipja, rumanishtja, greqishtja, bullgarishtja dhe serbokroatishtja).

deri ditët e sotme i vetmi fjalor shumëgjuhësh në të cilin për herë të parë trajtohen frazeologjizmat në gjuhën shqipe dhe barasvlerësit frazeologjikë të tyre në gjuhën serbokroate, përkatësisht serbe, njëkohësisht dëshiron të lavdërojë autorët të cilët kanë parë para gjashtëmbëdhjetë vitesh nevojën për një material të tillë, dhe kanë parashikuar rëndësinë dhe vlerën e studimeve të sotme komparative dhe krahasuese.

Pas rishikimit sistematik teorik të 4 846 frazeologjizmave të përfshirë në fjalor, me qasje metodike të shqyrtimit të tyre, posaçërisht është veçuar (40) njësi të organizuara në katër grupe: frazeologjizmat pjesërisht të saktë (13), të gabuar (20) frazeologjizma për të cilët nga ndonjë arsye e panjohur nuk i janë dhënë barasvlerësit përkthimorë (7), që nuk do të thotë se disa prej tyre nuk i kanë. Katër (4) njësi frazeologjike nga grupi i fundit me të vërtet kanë barasvlerësit frazeologjikë, kurse (3) janë pa barasvlerësit përkatësë.

Ky material tematikisht i shumëllojshëm është dhënë procentualisht dhe numerikisht për secilin grup ku së pari, me anë të Fjalorit frazeologjik të gjuhës kroate apo serbe (*Frazeološki rječnik hrvatskoga ili srpskoga jezika*) analizohen njësitë për të vërtetuar hipotezë mbi çrregullsitë të disa barasvlerësve përkthimorë dhe pastaj krahasohen në Fjalor frazeologjik të gjuhës serbe për të dhënë format e sakta të tyre, të cilat përkasin frazeologjisë së sotme. Analiza është bërë njëdrejtimëshe nga shqipja në serbishten, ku pranë barasvlerësve përkthimorë merret parasysh edhe struktura e tyre gramatikore dhe semantike, kurse përbërje leksikore, kuptimi i tyre, niveli i mospërputhjes si edhe forma me përputje analoge nuk do të shqyrtohen më tej. Pjesa e fundit do të përkushtohet frazeologjizmave në kontekste të ndryshme nga pikëpamja e ekuivalencës përkthimore ku autor tregon situata të mundshme gjatë përkthimit të tyre dhe jep zgjidhjet.

3. Analiza e materialit të shtrua

3.1 Grupit të parë i takojnë frazeologjizma pjesërisht të saktë, përkatësisht ata të cilët baza kuptimore dhe konceptuale nga pikëpamja e frazeologjisë serbokroate, përkatësisht së sotme serbe nuk është mjaft e qartë. Ka 512 njësi të tilla, që është 10.56% nga korpusi i tërë. Dukë analizuar strukturën e tyre semantike dhe gramatikore veçohen frazeologjizma komponentë dhe globalë, më saktësisht, ata që kanë strukturën e fjalisë së tjeshtë dhe përbërë, këtu janë edhe frazeologjizma mbiemrorë, sintagmatikë si edhe ndërtime krahasuese, kurse frazeologjizma parafjalorë nuk ka.

<i>Është jashtë mendjes</i>	! Biti bez izgleda, bezrazložan	<i>Van svake pameti / van zdravog razuma</i>
<i>Është bythë e brekë</i>	! Biti u dosluhu s kim	<i>Biti sa kim kao nokat i meso</i>
<i>Nuk dëgjohet (ndihet) as miza</i>	! Čuje se kako muha leti	<i>Ni muva se ne čuje</i>
<i>E ka mbylluar (e ka kyçur në zemër)</i>	! Zatvarati u pamet	<i>Čuvati koga u srcu</i>
<i>E fut në vallë</i>	! Pozvati koga u kolo	<i>Ući / ubaciti koga u igru</i>
<i>I boqi (i vuri) vizë</i>	! Povuci crtom	<i>Staviti tačku na šta</i>
<i>U bë bisht</i>	! Mršav kao kesa	<i>Postati kost i koža</i>
<i>Thikë pas shpine</i>	! Bočni udar	<i>Zabiti kome nož u ledja</i>
<i>E tërheq për kapistalli</i>	! Držati koga na uzdi	<i>Vući koga za nos</i>
<i>Me duar në xhëpa</i>	! Objesiti ruke	<i>Držati ruke u džepove (bespolsličiti, ne raditi ništa)</i>
<i>Sbkoi (u dogj) edhe njomi bashkë me thatin</i>	! Umesto suha izgorelo sirovo	<i>Pored suvog gori i sirovo</i>
<i>Mbeti kokoshi një thelë</i>	! Umanjivati se do ništa	<i>Spala knjiga na dva slova</i>
<i>E mat detin me filxban</i>	! Trpljiv čovek	<i>Imati sve vreme ovoga sveta</i>

3.2 *Grupit të dytë* i takojnë 211 frazeologjizma, që është 4.35%. Si edhe në rastin e parë bëhet fjalë për frazeologjizma globale dhe komponentë, numërorë, sintagmatikë, ka ndërtime krahasuese të cilët baza konceptuale dhe kuptimore është krejt e paqartë dhe gabuar.

<i>Nuk di si të fshijë hundët</i>	! Da nema nosa travu bi pasao	<i>Ne zna još ni nos da obriše / jos nije zmiju na rep nagazio</i>
<i>Dhentë e dhitë e Zeres, nami i Kapllan Qeres</i>	! Platiti za tudje greške	<i>Kititi se tudjim perjem</i>
<i>E ndez zjarrin në ujë</i>	! Biti jake petlje	<i>Dolivati ulje na vatru</i>
<i>E zë (e kap) demin (kaun) për brirësh</i>	! Početi s debelog kraja	<i>Hvatati bika za rogove</i>

<i>I mbyllur në kuti</i>	! Brisati ispred svoje kuće	<i>Biti zatvoren u četiri zida</i>
<i>Ia ka zënë sytë ballukët</i>	! Uzdignuti nos	<i>Imati maglu pred očima</i>
<i>Gjallë a vdekur</i>	! Iz oka ili iz boka / otkud bilo	<i>Živ ili mrtav</i>
<i>Sa një e një që bëjnë dy</i>	! Kao jedanput jedan / pošto poto	<i>Kao što su jedan i jedan – dva</i>
<i>I kteu potkonjtë nga dielli</i>	! Ispružiti sve četiri	<i>Otegnuti papke</i>
<i>I lulëzon pjepri në shendere</i>	! Biti srećne ruke, more je komu do kolena	<i>Idu kome poslovi dobro</i>
<i>E tremb arushin me shoshë</i>	! Raditi što nepodesnim sredstvima	<i>Plašiti mečku rešetom</i>
<i>Mbytet në një filxhan ujë</i>	! Izgubiti obraz ni za šta	<i>Prvi se mačići u vodu bacaju</i>
<i>Mbaje gjubën pas dhëmbëve</i>	! Ne obeliti ni zuba	<i>Držati jezik za zubima</i>
<i>Nuk e ke marrë (s'ke) me tapi</i>	! Nije to s tvoje njive	<i>Nije tapija stavljena na koga / šta</i>
<i>E hëngri livadhin</i>	! Odigrati svoje, otpjevati pesmu, dodje mu kraj	<i>Obrati zelen bostan</i>
<i>Shkoi si qeni në vresht</i>	! Propasti uzalud, umreti slučajno	<i>Provesti se kao bos po trnju</i>
<i>Ia vuri (ia futi) të dyja këmbët në një këpucë (në një opingë)</i>	! Utjerati koga u rog	<i>Staviti se na čije mesto, poziciju</i>
<i>Si zhaba në të thatë</i>	! Gladan ne izvrši posao	<i>Biti kao riba na svom</i>
<i>I mblodhi plaçkat</i>	! Uzeti utrenik	<i>Pokupiti prnje, svoje stvari</i>
<i>Ca të nënës ca të njerksës</i>	! Kome opanci kome obojci	<i>Biti nekome majka a nekome maćeha</i>

3.3 *Grupit të tretë* i takojnë njësi të cilat janë pa barasvlerësit frazeologjikë, për të cilat nga ndonjë arsye e panjohur nuk janë dhënë, që nuk do të thotë se nuk i kanë. Bëhet fjalë për 17 frazeologjizma të tilla, prej të cilëve 5 kanë barasvlerës frazeologjikë

që është 0,10% nga korpusi i tërë. Nga pikëpamja gramatikore dhe semantike, këtij grupi i takon një fjalë të urtë, një frazeologjizëm global, një urim dhe një nominal verbal.

<i>Po i dhe gishtin të rremben dorën</i>	/	<i>Dati čoveku jedan prst, uzme celu šaku</i>
<i>Hëngri dajak</i>	/	<i>Odrati koga od batina</i>
<i>M'u bë zemra gropë</i>	/	<i>Srce mi se slomio</i>
<i>U bëfsh plak!</i>	/	<i>Živeo 100 godina!</i>

3.3.1 Në kuadër të grupit të tretë 0.24 %, përkatësisht 12 njësi frazeologjike të cilat sipas përkufizimit janë pa barasvlerësit frazeologjikë dhe janë bazuar në karakteristika të veçanta të shtetit, në mënyrën e jetesës, ngjarje historike, nocione gjeografike etj. (Krstić, Hornjak 2013:253).

<i>Mbjell misër e korr tallë</i>	/
<i>I rëntë (i ardbtë) pas veshit</i>	/
<i>I dalshin sytë</i>	/

4. Frazeologjizma nga pikëpamja e ekuivalencës përkthimore

Identifikimi i frazeologjizmit si njësi e veçantë leksikore në tekst është relativisht lehtë jo vetëm për shkak të strukturës por edhe për shkak të kuptimit të tij të veçantë, të veçuar nga llojet e tjera të fjalisë. Por, ndonjëherë edhe vetë konteksti nuk është mjaft i qartë. Kjo është arsyeshme, duke qenë se pengesë kryesore në njohjen e tyre të drejtë është në mënyrat e shprehjes së metaforës (kuptimit metaforik) në secilën gjuhë veçmas. (Mutavdžić, Kampouris 2013:84,85). Pikërisht këto njësi frazeologjike paraqesin shkaqe kryesore të keqkuptimit në komunikim duke qenë se struktura e tyre dhe tipi i metaforës së përdorur janë kushtëzuar kulturalisht, kështu që kuptimi nuk mund të zbulohet me anë të përkthimit të fjalëve të cilat i përbëjnë. Me krahasimin dhe të menduarin mbi procesin komunikativ i cili realizohet edhe në gjuhë amëtare por edhe në gjuhë të huaj, pjesëmarrësit do të zhvillohen pranë kompetencës komunikative edhe kompetencën interkulturale. (Krstić, Hornjak 2013:259).

Folësit e gjuhës amëtare të një gjuhe kanë në leksikon mendor të tyre fraza të shumta, shprehje, proverba, fjalë të urta që u mundësojnë të formulojnë në mënyrë të shpejtë dhe efikase ide dhe koncepte të cilat janë të përbashkëta dhe njëkohësisht të kuptueshme për folësit dhe bashkëbiseduesit e tjerë në komunikim. Por, te nxënësit e

gjuhës së huaj kjo përbërje e formulave dhe shprehjeve gjuhësore nuk nënkupton asnjë ndërtim të parashikuar dhe në shumë raste nxënësit s'mund të shohin që gjenden para një strukture të tillë në tekst apo në shprehje gojore ku as vetë mekanizmi i përkthimit i secilës fjalë në gjuhë amëtare nuk ua mundëson të kuptojnë përbërjen të cilën transferon një strukturë të tillë. Nga kjo arsye, në mësimdhënien e gjuhëve të huaja ka shumë rëndësi zhvillimi i mekanizmave të cilët do të lehtësojnë nxënësve procesin e përvetësimit të njëjësive frazeologjike dhe prezantimi i tyre në mënyrë interesante dhe motivuese. Konsiderojmë që është e rëndësishme shtënie e këtyre ndërtimeve nga faza fillestare e të mësuarit të gjuhës së huaj kur nxënësi fillon të krijojë leksikonin e tij mendor, duke i pranuar si strukturat e kuptimit të veçantë. Nga ana tjetër, shtënie e njëjësive frazeologjike duhet të zhvillohet në përputhje me nivelin e njohurive të nxënësve dhe me aftësinë e tyre komunikative për të kuptuar mesazh kuptimor, të cilin ajo transferon, por edhe ta përdorin në mënyrë adekuate dhe me gramatikë të mire në komunikim të caktuar komunikativ (Bučevac Nerić: 2013:270, 271).

Sipas mendimit të Tegelbergovës, në çdo gjuhë ekziston një fjalor në të cilin reflektohen elementet e veçanta kulturore të një populli, të cilat nga një anë mund të kenë barasvlerësit përkthimorë identikë apo të afërt të tyre në tjetër gjuhë, apo nga ana tjetër është e pamundur të përkthehen fare. Kjo tregon se frazeologjizmat e secilës gjuhë janë krijuar në bazë të karakteristikave të veçanta të zhvillimit shoqëror-qytetëruar të çdo populli dhe në bazë të kulturave materiale dhe shpirtërore të tyre. Në të njëjtën mënyrë, nuk ka asnjë dyshim në vërtetësinë e faktit që frazeologjizmat në gjuhën amëtare përvetësohen me atë shpejtësi me të cilën zhvillohet mendim apstrakt. Pa marr parasysh që folësit e gjuhës amëtare kanë zhvilluar kompetencën e plotë frazeologjike, ata megjithatë kanë problem në përvetësimin dhe zhvillimin e kompetencës frazeologjike në gjuhë të huaj. Kjo është shumë arsyeshme duke qenë se është e nevojshme një përpjekje shtesë për të hyrë në një botë realitivist e panjohur dhe e pazbuluar të apstragimit dhe metaforës (Mutavdzic, Kampouris 2013:90).

Meqë të përkthyerit, në këtë rast i frazeologjizmave është një operacion i përbërë nga dy pjesë, ku qëllimi themelor është të kuptuarit e përbërjes së thënë në gjuhë amëtare dhe formulimi i saj në gjuhë në të cilën përkthehet, është e rëndësishme të theksohet që gjatë përkthimit të këtyre njëjësive duhet:

- a) Të veçohet kuptim formal nga kuptimi metaforik i frazeologjizmave siç janë: *lë dikë në baltë, lë dikë në arkiv, nga ana tjetër të barrikadës*,²

² Kur frazeologjizmi *lë dikë në arkiv* ka kuptim formal, përkthehet si: *staviti šta u arhiv*, kurse me kuptim metaforik përkthehet si: *pasti u zaborav*; E njëjta gjë ndodhet edhe me njësi 84

Por duhet të bëjme keta basdarde "ceco", që të shpëtojmë e lulëzojmë Vlorën dhe gjithë atëdheun tonë, perle mesdhetare e lënë në baltë .	Moramo vratiti ovim gadovima, kako bismo spasili Vljoru i celu našu otadžbinu, mediteransko blago napušteno u blatu .
Gjendja e financave nuk do jetë e mirë, megjithatë disa te afërm nuk do t'ju lënë asnjë moment në baltë .	Finansijsko stanje neće biti dobro, ali vas bližnji neće ostaviti na cedilu .

- b) Të njihen situata në të cilat një shprehje joidiomatike mund të përkthehet me frazeologjizëm vetëm nëse ai është në përputhje me kontekst të dhënë; Shembujt e këtij tipit janë: **situata u bë serioze, rrethuar me rreziqe, sulmoj nga te gjitha anët**³.

Pas futjes së shqiptarëve brenda në ndërtesë (rreth 1000 veta) dhe brenda oborrit të rrethuar me murë (2000-2500 veta) dhe në një pjesë tjetër të mbetur në rrugë para oborrit, rreth orës 14.00, ata do të sulmohen nga të gjitha anët .	Nakon smeštanja Albanaca u jednu zgradu (oko 1000 lica), i u dvorište okruženo zidom (2000-2500), i u jedan drugi preostali deo na ulici ispred dvorišta, oko 14.00, oni će biti napadnuti sa svih strana .
Mësimdhënësit po sulmohen nga të gjitha anët .	Nastavnici/predavači vrše pritisak sa svih strana .

- c) Të dihet kuptimi i të gjitha fjalëve prej të cilave është përbërë shprehje idiomatike, sepse shpesh mund të arrihet në përkthim të gabuar. Frazeologjizmat e këtij tipi janë: **s'ka sy / mjekër për Qabe, e njihet si parja e kuqe, kërkon dardha në shendere** ku njësia e pare shpesh kuptohet në serbisht si: *za Rajka kapa nema* kurse përkthim i vërtet është: **nemati nikakve izglede / šanse**; Në rastin e dytë, frazeologjizëm **e njihet si parja e kuqe** përkthehet gabimisht si *poznavati se sa kim kao zle pare*, kurse përkthim i saktë është: **upadati kome u oči**; Në rastin e tretë, frazeologjizëm **kërkon dardha në shendere** përkthehet si *tražiti iglu u plasti*

frazeologjike **nga ana tjetër të barrikadës (sa druge strane barikade)** ku ajo në kontekst metaforik ka kuptimin e armikut i cili është në anë tjetër të barrikadës.

³ Sa i përket frazeologjizmeve të përmendura pa shembuj, i pari - **situata u bë serioze** mund të përkthehet si: **situacija je postala ozbiljna** dhe me shprehje idiomatike **vrag je odneo šalu**; I dyti ka barasvlerësit frazeologjikë vijuesë: **biti okružen opasnositima** apo **biti u osinjem, zmijskom gnezdu**.

sena, kurse barasvlerës frazeologjik është **tražiti / zabtevat** *nemoguće, imati hirove, bubice*;

- d) Të dihet se njësi frazeologjike pa kontekst mund të ketë një barasvlerës frazeologjik, kurse në kontekst letrar një kuptim tjetër, siç është rast me frazeologjizma: **delen që ndahet nga tufa e ha ujku, agjëron ditën e vjedh natën, e lë në dorë të fatit**; Në rastin e njësisë së pare, në kontekste të ndryshme mund të shihet përkthim: **ko se ovcom učini, kurjaci ga pojedu** por edhe përkthim: **izložiti se opasnosti, rizikovati život**; Në rastin e dytë barasvlerësit e mundshëm mund të jenë: **biti danju andjeo, a noću djavo**, apo **skrivati svoje pravo lice, nositi masku, ispod mire sto vruga vire**; Frazeologjizmi i tretë në kontekste të ndryshme ka barasvlerësit frazeologjikë siç janë: **prepustiti koga / šta sudbini / slučaju, staviti koga / šta u božje ruke**;
- e) Vëmendje e veçantë duhet të përkushtohet frazeologjizmave të cilët në shikim të parë s'përkthehen dot; Njësitë e këtij tipi janë: **ko o čemu baba o ušticipima, lezi lebu da te jedem, podilaze koga žmarci**; Në situatën e tillë duhet të kërkohet një shprehje idiomatike, që është e afër kuptimit të frazeologjizmit të dhënë. Duke marr parasysh se kuptimi i njësisë së parë referohet një personi që vazhdimisht flet në mënyrë të bezdishme për të njëjtën gjë, barasvlerës më i afërt këtij frazeologjizmi do të jetë: **këndoj avaz vjetër (pevati staru pesmu)**; Shprehja idiomatike e dyte referohet një personi që është përtac, debel, nuk punon, pret gjithçka prej të tjerëve, barasvlerës më i afërt do të jetë: **jap dikujt llokum në gojë (dati kome sve na gotovo)**. Frazeologjizmi i tretë referohet një personi që ndjen frikë dhe është në siklet, kështu që barasvlerës frazeologjik më i afërt do të jetë: **I kalojnë mornica në trup (podilazi koga jeza)**;

5. Përfundim

Të mësuarit e gjuhës së huaj (L2) është një proces shumë i ndërlikuar gjatë të cilit është i rëndësishëm edhe zhvillimi i kompetencës frazeologjike. Sipas Kornizës së Përbashkët Evropiane e Referencës për Gjuhët shumë lloje dhe nënllloje të ndryshme të njësisve frazeologjike duhet të përvetësohen nga faza fillestare: kolokacione frazeologjike nga niveli A1, A2, fraza nga niveli A1, A2, B1, B2, C1, C2 kurse proverba dhe fjalë të urta nga nivele të larta – B1, B2, C1, C2, ku në çdo nivel duhet të caktohet dhe plotësohet minimumi dhe maksimumi frazeologjik. Pranë metodave adekuate didaktike në mësimdhënien e gjuhëve të huaja, nxënësit duhet të

mësojnë të mendojnë në mënyrë asprakte, të zhvillojnë aftësinë e zbulimit të metaforës së thënë në gjuhë të huaj, dhe duke përvetësuar frazeologjizma me përputhje analogë zhvillojnë edhe kompetencën interkulturale. Duke theksuar faktin që në frazeologjinë shihet "filozofia më e thellë dhe gjithanshme të njeriut", "nxënësit kanë mundësi të njohin jo vetëm me aspekte gjuhësore dhe sociokulturore të gjuhës dhe popullit, meqë nga frazeologjia dhe leksikologjia e një populli mund të mësohet historia, kultura, jeta familjare dhe shoqërore, si edhe tiparet e njerëzve. Me përvetësimin e njësisive frazeologjike nxënësit zhvillojnë kompetencën e madhe komunikative, rrjedhshmëri dhe saktësi në komunikim, përmirësojnë interakcion shoqërore dhe në komunikim me bashkëbiseduesit zgjerojnë njohuritë e tyre mbi kulturën e popullit e të cilit gjuhë mësojnë" (Bučevac Nerić 2013: 275).

Nga kjo arsye është bërë analiza komponentiale në një prej materialeve të disponueshme ku 740 frazeologjizma nga pamja strukturore dhe semantike ishin pjesërisht të saktë, apo të gabuar, që është 15.27% nga korpusi i tërë. Në pjesën e fundit janë shqyrtuar frazeologjizma nga pikpamja e ekuivalencës përkthimore, situata të shpeshta gjatë përkthimit të tyre dhe në disa shembuj konkretë janë dhënë edhe propozime për trajtimin e tyre. Referimi mund të konsiderohet edhe si material shtesë gjatë përdorimit të fjalorit në mësimdhënien e frazodidaktikës. Njëkohësisht ai ka treguar nevojën më të madhe për një fjalor frazeologjik shqip-serbisht por edhe nevojën për hulumtime të frazeologjisë në mësimdhënien e gjuhës shqipe në Fakultet Filologjik të Beogradit.

Referenca

- Bučevac Nerić, Jasmina (2013). *Frazeološke jedinice u komunikativnoj nastavi španskog kao stranog jezika*. Savremena proučavanja jezika i knjizevnosti (1). 267-276.
- Golubović, Biljana (2009). *Balkanska frazeologija – problemi određivanja arealnih granica*. <http://www.suedslavistik-online.de/01/golubovic.pdf> (pristupljeno 10. avgusta 2015.)
- Krstić, Katarina., Hornjak, Sonja (2013). *Frazeologija u nastavi španskog jezika*. Savremena proučavanja jezika i knjizevnosti (1). 249-260.
- Mutavdžić, Predrag (2013). *O nekim specifičnostima prenošenja srpske frazeologije na savremeni grčki jezik i grčke frazeologije na srpski*. Slavistika (17). 83-92.
- Mutavdžić, Predrag., Sivački Ana., Kolesar, Marina. (2014). *Frazeologizmi sa komponentom zemër/zemra (srce) u savremenom albanskom i njihovi ekvivalenti u srpskom i rumunskom jeziku*. Jezici i kulture u vremenu i prostoru (3). 59-76.

Fjalorë

- Matešić J. (1982). *Frazeološki rječnik hrvatskoga ili srpskoga jezika*. Zagreb: Školska knjiga.
- Otašević, Đorđe. (2012). *Frazeološki rečnik srpskog jezika*. Novi Sad: Prometej.
- Thomai, Jani (1999). *Fjalor frazeologjik ballkanik*. Tiranë: Dituria.

Uebografi

<http://almakos.com/lajme/maqedoni/67621-mesimdhenesit-ankohen-na-bejne-presion-me-kontrolle.html> (pristupljeno 10. avgusta 2015.)

<http://www.pasqyra.com/faqe/masakriitivarit.htm> (pristupljeno 10. avgusta 2015.)

<https://europass.cedefop.europa.eu/hr/resources/european-language-levels-cefr>

<http://www.peshkupauje.com/2014/11/album/nga-vlora-eshte-per-te-ikur-naten-e-jo-me-diten>

<http://lajmpress.com/lifestyle/74914-horoskopi-23-shtator-2015.html>

Giovanna NANJI

PËRKTHIMET NË GJUHËN ITALIANE TË ROMANIT *KËSHJTJELLA* TË ISMAIL KADARESË: PËRFUNDIMET E ANALIZËS KRITIKE

Hyrje

Ky punim është vazhdimi i artikullit tim me titullin “Romani *Këshjtjella* i Ismail Kadaresë në gjuhën italiane: disa vërejtje nga analiza e përkthimit”, i cili u botua në vitin 2011 në materialet e punimeve të Seminarit XXX Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare të Prishtinës (2011:133-152).

Në punimin e lartpërmendur kam paraqitur disa vërejtje në kuadrin e analizës traduktologjike të përkthimeve italisht të romanit kadarean *Këshjtjella* (Naim Frashëri, Tiranë, 1970), duke marrë në shqyrtim dy botime të posaçme: *La fortezza* (8 Nëntori, Tiranë, 1975) dhe *I tamburi della pioggia* (Longanesi, Milano, 1981), pa injoruar botimin frëngjisht *Les tambours de la pluie* (Hachette, Paris, 1972), tekst ndërmjetësues për përkthimin italian të vitit 1981.

Aspekti teorik i analizës traduktologjike u trajtua gjerësisht në atë punim paraardhës, ku kam paraqitur lëndën e *kritikës së përkthimit*, kam përshkruar metodologjinë e zbatuar për të analizuar dy përkthimet të përzgjedhura dhe kam caktuar objektivet e punimit tim.

Me shkrimin e tanishëm synoj të prezantoj përfundimet e asaj analize, e cila ka qenë tema kyçe e punës sime të doktoratës, të mbrojtur në Universitetin e Kalabrisë në muajin e prillit 2015, me titull: *Problematika traduktologjike në kontekstin ndërgjuhësor të romanit ‘Këshjtjella’ të Ismail Kadaresë: analizë krahasimtare dhe përçapje të reja përkthimi*.

Përfundimet në fjalë vijojnë nga zbatimi i fazës së fundit të metodologjisë analitike të përzgjedhur, dhe rrjedhin nga përcaktimi i tipit të përkthimit në bazën e kategorive të caktuara nga autori i asaj metodologjie, prof. Lance Hewson, nga Universiteti i Gjenezës¹.

¹ Shtjellimin e kësaj metodologjie të analizës së përkthimit mund ta gjeni në vëllimin e Lance Hewson-it, *An Approach To Translation Criticism*, John Benjamins Publishing Company, Amsterdam&Philadelphia, 2011.

Shkalla e matjes së përkthimit

Faza e fundit të analizës kritike të konceptuar nga Hewsoni synon të identifikojë tiparet dalluese të përkthimit të vëzhguar, duke u mbështetur te të dhënat të dala nga analiza traduktologjike e përpunuar në katër nivele (makrotekstual, mikrotekstual, mesostrukturor dhe makrostrukturor). Për të qenë sa më shumë objektiv, kritiku i përkthimit, që ndjek metodën në fjalë, ka mundësinë të llogarisë në mënyrë sistematike ndryshimet që dallojnë tekstin e përkthyer nga origjinali. Në këtë fazë të analizës, kritikun i hynë në punë vërejtjet e shënuara gjatë fazave paraprake krahasimtare, kur janë vënë në pah dhe janë komentuar të ashtuquajturat efekte përkthimore, që sipas Hewsonit mund të jenë efekte interpretative apo efekte të zërit. Llogaria numerike e rasteve, që secili efekt përkthimor është regjistruar në çdo tekst të përkthyer, e lejon kritikun ta inkadrojë atë përkthim në njërin prej kategorive të vendosura nga Hewsoni për të përcaktuar cilindo përkthim të teksteve letrare në prozë.

Kategoritë në fjalë janë paracaktuara me anë të një shkalle matjeje prej katër nivelesh, duke u nisur me formën më optimale të përkthimit deri te mënyra përkthimore më distancuese nga origjinali.

Këto nivele janë:

- a. similariteti divergjent;
- b. divergjenca relative;
- c. divergjenca radikale;
- d. adaptimi.

Siç është e qartë në fazën përfundimtare të analizës, kriteri, që udhëheq kritikun drejt përcaktimit të tipit të saktë të përkthimit, bazohet mbi dallimin midis efekteve interpretative dhe efekteve të zërit. Atëherë, duke marrë parasysh nëse përkthimi i analizuar sjell me vete më shumë efekte interpretative apo të zërit, dhe duke shqyrtuar ndikimin e këtyre efekteve, rrjedhimet dhe pasojat e tyre, kritiku është i aftë të vendosë përkthimin nën analizë në njërin prej këtyre kategorive.

Për t'i dhënë lexuesit mundësinë që të orientohet në logjikën teorike e këtyre përcaktime, jap në vijim një përshkrim të përmblendhur të secilës kategorie, duke thjeshtësuar, për arsye shkurtësie, përkufizimet e autorit të modelit teorik të përdorur.

Sipas Hewsonit, pra, sa më shumë teksti i përkthyer i jep lexuesit pista interpretative që përputhen me leximet e mundshme të tekstit origjinal, aq më shumë bëhet fjalë për një similaritet divergjent, e cila konsiderohet si arritja ideale e çdo përkthimi.

Përkundrazi, kur ndryshimet përkthimore e çojnë lexuesin te pista interpretative të panjohura në origjinalin, atëherë flitet për një adaptim, sepse përkthimi lejon interpretime false kundrejt origjinalit.

Në nivelin e mesëm gjejmë kategoritë e divergjencës, e cila mund të jetë divergjencë relative, kur interpretimet false ndërhyjnë pa i prishur thellë vijat thelbëore e pistave interpretative, apo divergjencë radikale, kur pesha e interpretimeve false ndikon mbi kuptimin e veprës.

Brenda kategorisë së divergjencës radikale dallohen katër ndarje të tjera, në bazë të arsyes prej së cilës varet divergjenca:

- a. në përkthimin ontologjik, interpretimet false kanë të bëjnë me efektet e zërit;
- b. në përkthimin ideologjik, interpretimet varen prej efekteve interpretative;
- c. përkthimi hibrid është i tillë sepse përmban dukuri të ndryshme që ndikojnë edhe interpretimin edhe zërat;
- d. në përkthimin metamorfizues, qoftë interpretimet, qoftë zërat mbeten po ato të origjinalit, vetëm se verifikohen dukuri të tjera në nivelin makrostruktural, të cilat krijojnë një divergjencë radikale me origjinalin.

Meqenëse përçapja analitike e themeluar nga Hewsoni, që është përdorur në punimin tim, ka si qëllim përfundimtar të japë një vlerësim gjithëpërfshirës për ndikimin e mundshëm të një përkthimi në kulturën e mbërritjes, duke zbrëthyer natyrën – “e drejtë” apo “e gabuar” – të interpretimeve të inkurajuara nga zgjedhjet përkthimore të përkthyesit në krahasim me interpretimet që vepra origjinale mund të inkurajojë te lexuesi i saj, kriteret vlerësuese të vendosura nga profesori i Gjenezës na ofrojnë mundësinë t’i shmangemi dallimit bipolar “përkthim i mirë” kundër “përkthimi të keq”, që nuk mbështetet të parimi i objektivitetit.

Përveç kësaj, modeli i Hewsonit ngrihet si alternativë për kriterin e “ekuivalencës”, shumë të debatuar dhe të polemizuar, në lidhje me vlerësimin e cilësisë së përkthimit. Pas zhvillimeve teorike të arritura në fushën e traduktologjisë me kthesën kulturore të *Translention Studies* të natyrës deskriptive dhe jo më preskriptive², është anakronike çdo përpjekje për të debatuar rreth pamundësisë që përkthimi të jetë identik me origjinalin, kështu që koncepti i “divergjencës”, që mbështjell gjithë teorinë e Hewsonit, na çon në drejtim të duhur.

² G. Toury, *Descriptive Translation Studies – And Beyond*, John Benjamins, Amsterdam & Philadelphia, 1995.

Matja e efekteve përkthimore

Për të vendosur secilin përkthim në gjuhën italiane të romanit kadarean *Kështjella* në kategorinë që pasqyron cilësitë e tij, duhet t'u referohemi të dhënave të nxjerra nga analiza meso- dhe makrostrukturale.

Më anë të tabelave të mëposhtme i tregoj numrat që evidentojnë përmasën e efekteve përkthimore të zbuluara gjatë analizës krahasuese.

Tabela e parë përmbledh efektet mesostrukturore. Me akronimin F nënkuptohet titulli *La fortezza*, ndërsa T-ja i referohet përkthimit *I tamburi della pioggia*. Ndarja kryesore është ajo fillestare midis efekteve të zërit dhe efekteve interpretative.³

EFEKTE TË ZËRIT						EFEKTE INTERPRETATIVE					
SHTIM		REDUKTIM		DEFORMIM		ZGJERIM		TKURRJE		TRANS-FORMIM	
F	T	F	T	F	T	F	T	F	T	F	T
2	17	18	27	19	36	2	8	28	39	13	27

Tabela 1. Efekte mesostrukturore.

Duke llogaritur numrat e efekteve përkthimore për secilin përkthim, del se përkthimi i ndërmjetësuar nga frëngjishtja, pra *I tamburi della pioggia* (T), mbart një sasi më të madhe dukurish sesa përkthimi i drejtpërdrejtë, d.m.th. *La fortezza* (F), edhe pse bëhet fjalë për një punë jo profesionale. Më saktë, në F numërohen 39 efekte të zërit dhe 43 efekte interpretative; ndërsa në T numri dyfishohet: 80 efekte e zërit dhe 74 efekte interpretative.

Nga shikimi i parë vërehet se dukuria më e pranishme është efekti i tkurrjes i ndodhur në përkthimin e ndërmjetësuar (39 raste), të cilit i vjen pas efekti i deformimit (36 raste), po ashtu në të njëjtin përkthim, i cili karakterizohet gjithashtu për efektin e reduktimit (27 raste) dhe të transformimit (27 raste). Për sa i përket *La fortezza*, efekti më i dukshëm është tkurrja (28 raste), ndjekur nga reduktimi (18 raste) dhe deformimi (19 raste). Dallohet, në fund, se shumë pak është prekur, në rastin e këtij përkthimi, efekti i shtimit dhe i zgjerimit, më gjasë si pasojë e problemeve gjuhësore që karakterizojnë përkthimin e realizuar nga përkthyes të huaj, pra që nuk kanë italishten si gjuhë amtare.

³ Vihet re se terminologjia e përdorur në tabelat për t'i emëruar efektet e ndryshme është një përpjekje personale adaptimi në bazën e termave në gjuhën angleze të përdorura nga autori në librin e tij të përmendur paraprakisht (Hewson, 2011).

Siç duket qartë, përkthimi i drejtpërdrejtë përmban më shumë ndërhyrje në nivelin e interpretimeve sesa në efektet e zërit; përkundrazi, përkthimi i Donaudy-it tregohet më i ndikuar në planin e efekteve të zërit sesa në efektet interpretative. Ky fakt, bashkë me shqyrtime të mëtejshme në nivelin makrostrukturor, do të na shërbejë për të zgjedhur kategorinë e llojit të përkthimit sipas përcaktimit të Hewsonit, që kam përshkruar më lartë.

Tabela, që vijon, pasqyron efektet e zërit dhe efektet interpretative në nivelin makrostrukturor.

		<i>La fortezza</i>	<i>I tamburi</i>
EFEKTE E ZËRIT	DAMKOSJE	2	2
	NGJESHJE	1	5
	ANAMORFOZË		4
	PËRKTHIM ONTOLOGJIK	2	1
	PËRKTHIM HIBRID	9	2
EFEKTE INTERPRETATIVE	FRYRJE	1	1
	RRËGJIM	7	14
	SHNDËRRIM	1	7
	PËRKTHIM IDEOLOGJIK		1
	PËRKTHIM METAMORFIZUES	1	4

Tabela 2. Efekte makrostrukturore.

Llogaritja e të dhënave tregon se ndikimi i efekteve përkthimore është më i fuqishëm mbi përkthimin e ndërmjetësuar nga frëngjishtja sesa në përkthimin e drejtpërdrejtë nga shqipja në italishten.

Dukuria më e pranishme është rrëgjimi i interpretimeve, që është numëruar 14 herë në përkthimin e Donaudy-it. Pas asaj vjen dukuria e shndërrimit (7 raste), gjë që dëshmon që përkthimi italian ka transformuar disi interpretimet. Ndërsa, për sa i përket përkthimit që u bë në Tiranë, dukuria më e dallueshme është përkthimi hibrid (9 raste), pra ka të bëjë me zërat e romanit, por ka edhe mjaft rrëgjime interpretimesh (7 raste).

Ndikimi i zgjedhjeve përkthimore në *I tamburi* rezulton më i fortë për kategorinë e efekteve interpretative, ku regjistrohen 27 raste, kundër 14 rasteve të efekteve të zërit. Ky lexim i parë i të dhënave makrostrukturore na bën të përcaktojmë natyrën e përkthimit të ndërmjetësuar nën dritën e humbjes dhe të shndërrimit të sferës së çelësave të mundshëm të leximit të romanit. Megjithatë, entiteti i ndryshimeve është i tillë sa që përfshin edhe aspekte të tjera të pritjes së veprës.

Në rastin e përkthimit në italishten që u bë nga shqiptarët, efektet e zërit, me 14 raste, tejkalojnë numrin e efekteve interpretative, me 10 raste. Priorja kryesore e *La fortezza* është përkthimi hibrid, bashkë me rrëgjimin e potencialit interpretativ, ndërsa sinjalizohet mungesa e dy kategorive: anamorfozë dhe përkthim ideologjik, gjë që do të thotë se ky përkthim nuk deformon efektet e zërit të origjinalit, as nuk prezantohet si një farë rishkrimi të tekstit origjinal. Megjithatë, efekte të ndryshme kombinohen dhe i shtohen problemit thelbësor, përkatësisht papërshtatshmëria e nivelit të përgjithshëm gjuhësor, kështu që leximi dhe kuptimi i tekstit të përkthyer nuk ndejnë vetëm pasojat e zgjedhjeve përkthimore që krijojnë efekte të shumëllojshme, por një rol të rëndësishëm luhet nga mungesa e natyrshmërisë dhe të korrektesisë së gjuhës italiane, që përdoret shumë artificialisht nga përkthyesit të “improvizuar” shqiptarë.

Nga ana tjetër, *I tamburi*, një përkthimi i dorës së dytë, rezulton i rrezikshëm për ruajtjen e tërësisë së potencialit interpretativ, sepse subjektiviteti i përkthyesit vepron dy herë, duke e distancuar dyfishtë përkthimin përfundimtar nga origjinali.

Duke u kthyer te shkalla e Hewsonit, përkthimi i Tiranës klasifikohet si divergjencë radikale e tipit hibrid, ndërsa përkthimi i dorës së dytë cilësohet si përkthim metamorfizues, po në kategorinë e divergjencës radikale.

Në paragrafin që vijon, do të përmenden elemente tekstuale konkrete, që zbulojnë përmasën e divergjencave dhe sqarojnë përcaktimet e vendosura.

***La fortezza*: përkthim hibrid**

Përkthimi i Tiranës karakterizohet për problemet e tij gjuhësore, për faktin se përkthyesit, që kanë pasur shqipen si gjuhë amtare, nuk kanë zotëruar italishten aq shumë sa për të shkruar pa gabime të llojllojshme. Papërshtatshmëria e nivelit gjuhësor vështirëson leximin dhe, si rrjedhojë, edhe kuptimin e elementeve të ndryshme tekstuale. Edhe pse pistat interpretative nuk falsifikohen, as nuk deformohen, ato reduktohen në mënyrë të ndjeshme, duke pasur shumë inkoherenca gjuhësore, që janë pasoja e kalkeve të shumta nga strukturat gramatikore dhe elemente leksikore të gjuhës shqipe. Sidomos aspekti stilistik pëson dëmet më të mëdha, duke u varfëruar në mënyrë të konsiderueshme: konotacioni, apelativët, përsëritjet, ligjërimi i zhdrejtë i lirë

rezultojnë të rrafshuar apo të banalizuar, duke u hequr tekstit të përkthyer një pjesë të madhe të fuqisë shprehëse dhe të potencialit interpretativ të origjinalit.

Më shumë se një përkthim i mirëfilltë, siç pretendohet nga studiuesit dhe profesionistët e kësaj fushe, teksti i prodhuar nga funksionarët shqiptarë, të angazhuar nga regjimi i asaj kohe për qëllimet kulturore të Partisë, prezantohet si kthimi i një aparati tekstual prej njëri sistemi gjuhësor në një tjetër. Por, duhet vërejtur se as ky operacion teknik nuk është arritur në masë të kënaqshme, sepse në shumë raste haset ndikimi i strukturave gramatikore dhe frazeologjike të gjuhës së nisjes mbi fjalitë në gjuhën e mbërritjes. Këto inkoherenca gjuhësore ngadalësojnë dhe shtrembërojnë ritmin e leximit.

Dobësia e përkthimit ka të bëjë, gjithashtu, me mungesën e një strategjie globale përkthimi, ndërkohë që zgjidhjet përkthimore lokale japin rezultate dishomogjene. Një shembull domethënës mund të jetë terminologjia turke e përfshirë në roman në lidhje me ushtrinë osmane që rrethon kështjellën. Po të vëzhgohen zgjedhjet përkthimore të ndërmarra në kapitujt e ndryshëm, del në pah se nuk ka një vendim sistematik: herëherë termat e hierarkisë ushtarake, apo fetare, janë ruajtur sipas fjalës turke specifike, e cila është adaptuar në shqipen me anë të alfabetit përkatës (është i tillë rasti kur përmenden trupat osmane: “akënxhinj”, “azapë”, “eshkynxhinj”, “dallkëllëçë”, “serdengjeshlerë”, “myselemë”, “spahi”); në raste të tjera, përkundrazi, përkthyesit kanë përdorur ndonjë adaptim kulturor apo ndonjë parafrazë (“intendente generale” për “kryeveqilharxhi”, “capo del servizio di informazioni dell’esercito” për “kryehafi”), zgjidhje kjo, që rrafshon efektin e krijuar nga Kadareja për të prezantuar dy kulturat, atë shqiptare të sunduar dhe atë turke sunduese, njërën pranë dhe përballë tjetrës. Si rrjedhojë, meqenëse, sipas këtij lloji interpretimi të romanit, prania e elementeve turke është pjesë përbërëse, që rikrijon ambientin dhe rrethanat në të cilat u zhvillua ngjarja, zgjedhjet përkthimore të hasura në *La fortezza* kanë reduktuar potencialin interpretativ.

Një tjetër element i denjë për t’u vënë në pah është rezultati i përkthimit të apelativit për heroin kombëtar. Në origjinalin Skënderbeu përmendet nga pala shqiptare si “Gjergji ynë”, duke kujtuar lutjen e krishterimit, “Ati ynë”. Në përkthimin e botuar në Tiranë ky konotacion humbet, sepse përkthyesit përdorin një apelativ të banalizuar, që rrafshon potencialin interpretativ. Më saktë, përdorin shprehjen “il nostro Giorgio”, dhe jo, pra “Giorgio nostro”.

Shumë i prekur nga cilësia e gjuhës është aspekti artistik i stilit kadarean, i cili nuk pasqyrohet në përkthimin në fjalë. Për shembull, po të konsiderojmë ligjërimin figurativ dhe poetik, që Kadareja ka përdorur në përshkrime plot me similituda dhe metafora, si edhe metanarracionin e kronistit Mevla Çelebiut, i ngarkuar me detyrën që të shkruajë kronikën e fushatës ushtarake turke kundër kështjellës shqiptare, pjesët e të

cilët citohen në romanin, atëherë hasemi me përpjekje të pasuksesshme të përkthyesve shqiptarë, për të ngritur nivelin e gjuhës, me anë të shprehjeve artificiale dhe të papërshtatshme, që ngjajnë herë-herë të çuditshme. Lë të konsiderohet, si shembull i kësaj problematike, pasazhi në vijim: “Tursun pashai nuk i hiqte sytë nga masa amorfe e gjigante e ushtrisë së tij, që dyndej e pulsonte si një organizëm i gjallë e me mishra të përgjakur, rreth e rrotull kështjellës” (Kadare, 1970:63). Foljet “dyndej” dhe “pulsonte”, që mbajnë me vete emfazën e organizmit të përcudnuar me të cilin krahasohet ushtria turke, janë përkthyer me dy shprehje të pafuqishme dhe të rëndomta, “si muoveva” dhe “pulsava” (Kadare, 1975:75), që zvogëlojnë shprehësinë e theksuar emocionale të pranishme në origjinalin. Interesant duket, gjithashtu, një pasazh tjetër, i përbërë nga një segment metanarrativ, ku Çelebiu rrëfen çfarë do të shkruante në kronikën e tij: “Në kronikën time mendoj të shkruaj se ata, domethënë shqiptarët, kaq nuk durojnë të kenë njeri mbi kokë, saqë, ashtu si tigrat kthetrafortë, grinden edhe me retë që kalojnë rastësisht sipër kokës së tyre” (Kadare, 1970:107). Lirizmi që përshkon këtë pasazh zbehët në përkthimin, sepse përkthyesit nuk arrijnë të përdorin mjetet shprehëse që gjuha italiane u ofron, dhe mbeten peng të formulimit në gjuhën e tyre amtare, si dallohet nga ky citim: “Nella mia cronaca penso di scrivere che essi, ossia gli albanesi, tanto non possono tollerare d’averne qualcuno sul loro capo, che, come le tigri dai forti artigli, sono pronti ad accapigliarsi anche con le nubi che passano per caso sopra la loro testa.” (Kadare, 1975:129).

Disa paqartësi dhe inkoherenca zbulohen gjithashtu kur merremi me regjistrin e zërave të personazheve. Për shembull, niveli i ngritur i bisedimeve midis kronistit dhe kryeveqilharxhiut pëson në përkthim një ulje të dukshme, përsëri për shkak se përpjekja e përkthyesve, për t’i afruar një regjistër më të ngritur, dështojnë.

Për mungesë sigurie në terminologjinë, shpesh edhe ritmi i narracionit është i ndryshëm nga origjinali, sepse në vend të një termi të caktuar, përkthyesit fusin një parafrazë që të shpjegojë termin që ata në italisht nuk njohin. Në shembullin që vijon mund të vihet re ngadalësimi i ritmit në gjuhën italiane, sepse përkthyesit riprodhojnë fjalë për fjalë tekstin në shqipen, duke rënduar shumë fleksibilitetin e italishtes: “Tutti gli esperti, con i quali il comandante in capo si era consultato prima dell’inizio dell’attacco, erano unanimi nel parere che dieci giorni fossero assolutamente sufficienti per consumare le ultime riserve d’acqua che i difensori della fortezza avessero potuto raccogliere nei relativi recipienti.” (Kadare, 1975:217). E çuditshme ngjan shprehja “relativi recipienti”, me të cilën është dashur të përkthehet “kazane dhe gjyme”, sendet për të cilat përkthyesit shqiptarë nuk kanë gjetur termin në gjuhën italiane.

Nuk mungojnë as raste kur pasazhe të tëra janë eliminuar në përkthimin, duke i hequr narracionit disa nuanca stilistikore ose konotacione psikologjike. Nuk dallohen,

përkundrazi, dukuri domethënëse të shtimit të elementeve që mund të zgjerohin potencialin e interpretimeve apo të pasuronin vargun e zërave të romanit.

Për shkak të llojlojshmërisë së efekteve të identifikuar në përkthimin e analizuar, të cilët nuk varin nga një plan i paracaktuar përkthimor, por janë fryti i përballimit të çastit të problemeve të shumta të përkthimit, caktimi si përkthim hibrid pasqyron saktë tiparet e tekstit në gjuhën italiane *La fortezza*.

I tamburi della pioggia: përkthim metamorfizues

Analiza krahasuese ka dëshmuar se përkthimi në gjuhën italiane i realizuar nga Donaudy riprodhon krejtësisht tekstin ndërmjetësues në gjuhën frënge. Zgjedhjet përkthimore të Vrionit paraqiten edhe në përkthimin e Donaudy-it, si tregon edhe shtesa leksikore, edhe sintaksa, edhe aspektet stilistikore, por sidomos dukuria e eliminimit apo shtesës së disa fragmenteve tekstuale. Pra, është e qartë se Donaudy nuk ka përdorur as tekstin origjinal në gjuhën shqipe, as përkthimin e parë në gjuhën italiane. Dëshmia e padiskutueshme është përdorimi, në një rast të vetëm, i mbiemrit “schipetaro” dhe jo “albanese”, atje ku Vrioni e ka shtuar në mënyrë autonome. Pra, normalisht në frëngjisht thuhet “albanais”, në italisht themi “albanese”, e kur duam të theksojmë etninë bashkëkohore, ekziston ky variacion “schipetaro”, por në origjinalin e Kadaresë kjo nuk gjen arsye të ekzistojë.

Siç kam parë gjatë analizës, përkthimi në gjuhën frënge ka treguar një nivel autonomie mjaft të dukshëm nga origjinali shqip, dhe të gjitha këto ndërhyrje të Vrionit janë paraqitur te përkthimi italian.

Ndërhyrjet e Vrionit prekin elemente të ndryshme tekstuale: a) leksikon, i cili bëhet më i ngritur dhe i specializuar sesa në *Kështjellë*; b) zërin e narratorit, i cili shpjegon dhe komenton më shumë sesa narratori kadarean; c) regjistrin e personazheve, të cilat, herë-herë, tregojnë një nivel kulturor të ndryshëm. Ka edhe sqarime shtesë që reduktojnë mundësinë e interpretimeve, si edhe eliminime përshkrimesh që zvogëlojnë ndikimin psikologjik mbi lektorin. Lë të përmendim si shembull disa fragmente, ku autori është përqendruar shumë te vrulli i sulmeve kundër mureve dhe bedeneve të kështjellës, me përshkrime plot më gjak, zjarr, lëndime, vuajtje, djersë, pluhur... ka raste ku Vrioni ka hequr disa elemente të këtij brutaliteti, duke dobësuar emfazën emocionale. Si pasojë, Donaudy, i cili nuk ka përdorur asnjë burim tjetër sesa përkthimin në frëngjishten, ka injoruar të tilla pasazhe në përkthimin e tij.

Ka raste ku ndikimi i leksikut më teknik, të zgjedhur nga Vrioni dhe të përsëritur nga Donaudy, krijon ndryshime në përfytyrimin e skenës, ku ngjarje

zhvillohen. Lë të përmendet një shembull. Në përshkrimin e mbërritjes së trupave dhe të përgatitjes së kampit të tyre, Kadare shkruan: “Që këndej dukeshin flamurët e bardhë si dëborë të jeniçerëve dhe kazani i tyre prej bakri që po e lidhnin në një pemë të madhe.” (Kadare: 1970:6). Pamja e “pemës së madhe” zëvendësohet në përkthim nga “alte pertiche”, d.m.th. nga “hunj të gjatë”, sipas modifikimit të hasur në përkthimin e Vrionit. I papërshtatshëm duket, gjithashtu, mbiemri i zgjedhur për të përkthyer sintagmën “çadrat e bukura të spahinjve” (Kadare: 1970:6), ku mbiemri “e bukura” i lë vend mbiemrit “civettuole”, që fjalë për fjalë do të thotë “lozonjare, të lezetshme”, duke shtuar një nuancë kuptimore që mbiemri të përgjithshëm “i bukur” nuk mbart.

Kështu si në *La fortexxa*, edhe në *I tamburi*, një pjesë e emrave të lidhur me kulturën turke është huazuar dhe adaptuar grafikisht, ndërsa një pjesë tjetër ka pësuar ndonjë adaptim në gjuhën e mbërritjes. Edhe në këtë rast, prania e fuqishme e shtresës leksikore osmane dhe myslimane reduktohet disi.

Për t’u shmangur përsëritjeve leksikore, shumë shpesh fjalët kyçe “kështjellë”, “mure”, “bedene”, “kështjellarë”, janë zëvendësuar nga ndonjë sinonim, apo parafrazë, apo metonimi, që krijojnë divergjencë në interpretimin e veprës origjinale. Për shembull, kur në vend të “kështjellarëve” përdoret “gli assediati”, d.m.th. “të rrethuarit”, përkthyesi shton një përfshirje emocionale në konceptin e thjeshtë të banorëve të kështjellës, dhe narracioni anon nga njëra prej dy palëve që marrin pjesë në ngjarjen e romanit. Përsëritja e shpeshtë e këtij modifikimi lë një shenjë të thellë në tekstin e përkthyer (në italishten si pasojë nga përkthimi frëng). Duke rrëguar përsëritjet, për më tepër, zgjedhjet përkthimore të trashëguara nga Vrioni bëjnë të dobësohet edhe kundërvënia hapësimore që luan një rol figurativ në romanin kadarean: hapësira e brendshme kundër hapësirës së jashtme, e para e rrethuara nga e dyta, me aluzionin që disa interpretime historiko-politike inkurajojnë të shihet në lidhje me situatën e izolimit të Shqipërisë totalitare të rrethuar nga armiq dhe kërcënime të huaja. Nëse përsëritja e këtyre elementeve leksikore tkurret, edhe perceptimi i kësaj piste interpretative nga ana e lexuesit bëhet më të vështirë.

Si pasojë e zgjedhjeve të Vrionit, në përkthimin italian lexuesi percepton me një zbutje të dukshme tonin e kërcënimeve, që turqit u drejtojnë shqiptarëve në fazën e negociatave paraprake. Ky element, bashkë me uljen e nivelit të tensionit dhe të tmerrit të përmbajtur nga përshkrimet dhe narracioni në veprën origjinale, i heqin përkthimit atë ngjyresë emfatike që Kadare i ka shtuar romanit të tij. Zbutja në fjalë prodhohet me anë të përdorimit të mënyrës kushtore në vend të kohës së ardhme të mënyrës dëftore në segmentin e mëposhtme: “*Ju u besoni shumë mureve të kështjellave tuaja, na thanë ata, por edhe në qoftë se ato mure janë vërtet të papushtueshme, atëherë ne do t’i*

rrethojmë ato me unazën e hekurt të bllokadës. Ne do të bëjmë që ju të dorëzoheni nga uria.” (Kadare, 1970:3). Përdorimi i kushtores në foljet si “*accercieremmo*” dhe “*costringeremmo*”, përkatësisht të përdorura në vend të “do të rrethojmë” dhe “do të bëjmë”, ka ndikim te efektet interpretative.

Një tkurrje e dukshme e pistave interpretative regjistohet në lidhje me shndërrimit e një fjalie me konotacion fetar të krishterë në një fjalie asnjane. “Mjerë ata që nuk dinë ç’bëjnë – tha Mevla Çelebiu.”, kështu shkruan Kadare, ndërsa në *I tamburi*, si rrjedhojë nga përkthimi frëng, lexohet: “*Poveri insensati*”, d.m.th. “të mjerë të pamend”, duke u distancuar shumë nga thirrja që fjalia origjinale mund të veprojë mbi lexuesin.

Edhe karakterizimi i personazheve pëson ndonjë modifikim në *I tamburi*, për shkak të prirjes së përgjithshme të Vrionit, të trashëguar nga Donaudy, që të ngrië nivelin e regjistrimit të bisedave të tyre. Pra edhe Donaudy u cakton personazheve fjalë të zgjedhura që normalisht nuk do të kishin përdorur, si në rastin e ushtarëve të thjeshtë, pa kulturë dhe mjaft të ashpër. Përkundrazi, ligjërimi i ashpër dhe i shkujdesur i kryemekanikut fiton, në disa momente, një ton zbutës të papranishëm në origjinalin. Po të konsiderohet segmenti që vijon: “Topi që s’ha mjalte? E pse? □ pyeti kryeveqilharxhi. □ Domethënë që ha kokë njerëzish □ tha Saruxhai.” (Kadare, 1970:24-25), në përkthimin italian dallohet një shtim që deformat krejtësisht mënyrën e ashpër të komunikimit të kryemekanikut me cilindo personazh tjetër të romanit. Ja si rezultojnë përkthimi i ndërmjetësuar nga frëngjishtja: “*Il cannone che non mangia miele? E perché questo strano nome?*» domandò Muhedin. «*Intendono dire scherzosamente che, rimpinzandosi di uomini, questo cannone disdegna il miele*», spiegò Sarugia.”. Zgjedhja e ndajfoljes “*scherzosamente*” (shq. me shaka), nuk duket e përshtatshme për narracionin e *Kështjellës*, sepse ushtarët turq karakterizohen për natyrën gjakatar, kështu që është e vështirë të supozojmë ironi dhe shaka në mendimin e tyre kur kanë prodhuar një armë që synohet të rrëzonte kështjellën e armikut. Përveç kësaj, Saruxha njihet si njeri fjalëpakë, i nxehur, që nuk merret me biseda të gjata, kështu që shtimi i fjalëve në krahasim me origjinalin nuk rezultojnë i arsyeshëm.

Ndërhyrjet e procesit përkthimor, në *I tamburi*, kanë të bëjnë, në radhë të parë, me kategorinë e rrëgjimit të efekteve interpretative; në vend të dytë, hasen shumë ndikime në kategorinë e shndërrimit të efekteve interpretative; gjithashtu, luajnë një rol të rëndësishëm edhe ngjeshja dhe anamorfoza e efekteve të zërit, si edhe kategoria e përkthimit metamorfizues.

Kjo përzierje e efekteve interpretative dhe efekteve të zërit kualifikon përkthimin si një divergjencë radikale të tipit metamorfizues, sepse ndryshimi nga origjinali u takon aspekteve tekstuale të ndryshme dhe mbart me vete jo vetëm

humbjen e çelësive të mundshëm të leximit, por edhe transformimin e pistave interpretative, së bashku me disa deformime dhe banalizime të zërave të personazheve. Pra, edhe pse teksti i përkthyer nuk udhëheq lexuesin drejt pistave interpretative false, vargu i interpretimeve të mundësuar nga vepra origjinale rezulton i ngushtuar dhe i varfëruar. Arsyeja e kësaj problematike nuk qëndron te procesi i brendshëm i përkthimit, por varet nga kushti paraprak i projektit përkthimor: zgjedhja e tekstit burimor.

Rezultatet e kritikës së përkthimit, në këtë rast, dëshmojnë qartë se ndërmjetësimi i përkthimit në gjuhën frënge është i dëmshëm për përkthimin në gjuhën italiane, sepse me këtë pasazh të dyfishë shëmtohen tiparet stilistikore dhe shtrembërohen nuancat e përmbajtjes së veprës origjinale.

Bibliografia

Kadare, Ismail, *Kështjella*, Naim Frashëri, Tiranë, 1970.

Kadare, Ismail, *Les tambours de la pluie*, Hachette Littérature, Paris, 1972.

Kadare, Ismail, *La fortezza*, 8 Nëntori, Tiranë, 1975.

Kadare, Ismail, *I tamburi della pioggia*, Longanesi, Milano, 1981.

Hewson, Lance, *An Approach to Translation Criticism, "Emma" and "Madame Bovary" in translation*, John Benjamins, Amsterdam/Philadelphia, 2011.

Toury, Gideon, *Descriptive Translation Studies – And Beyond*, John Benjamins, Amsterdam & Philadelphia, 1995.

Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, Materialet e punimeve të Seminarit XXX, Prishtinë, 2011.

Emilia CONFORTI

SISTEMI EMËROR I TË FOLMES ARBËRESHE TË SHËN BENEDHITIT

Emri në të folmen e Shën Benedhitit paraqitet në tri gjini, ashtu si në të gjitha të folmet arbëreshe: mashkullore, femërore dhe asnjëanëse, i shënuar nga artikulli i prapavendosur që i shtohet trajtës së pashquar të emrit. Në shqipen bashkëkohore ka tendencë për zhdukjen e gjinisë asnjëanëse, e cila zëvendësohet më shumë nga mashkullorja. Edhe në të folmen tonë emrat që fillimisht ishin të gjinisë asnjëanëse bëhen të gjinisë mashkullore.

Emrat e gjinisë mashkullore në rasën emërore të shquar njëjës marrin –i dhe –u
Burr –i Kal –i Fik –u Shok -u

Emrat e gjinisë femërore në rasën emërore të shquar njëjës marrin –a ose –ja:
Vajz-a Grua-ja

Ndërsa emrat e gjinisë asnjëanëse në rasën emërore të shquar njëjës marrin –t:
Mish-t Grur-t

Tregues të gjinisë janë edhe nyjet e paravendosura i, e, t'. Në vijim japim një tabelë të kategorisë së gjinisë: Gjinia Nyja e prapavendosur Nyja e paravendosur Shembull Mashkullore -i, -u i- i nipi Femërore -a, -ja e- e mbesa Asnjëanëse -t, -it t'ngjënt

Numri si kategori gramatikore është veti e emrit dhe zgjerohet edhe te kategoritë e mbiemrave, e përemrave dhe kategoria e foljes në trajtë finite. Por ekziston një seri emrash që kanë vetëm një numër gramatikor, njëjës ose shumës. Siç mund të shohim nga shembujt e mëposhtëm, disa emra kanë vetëm formën njëjës: bimët, pjesët e trupit, disa fenomene atmosferike, sëmundjet, muajt, nocionet metereologjike, individët dhe trupat qiellor: Ajr Hënza Dialli Kucjet

Kanë vetëm shumësin:

Musteqet Brekët

Disa emra të gjinisë mashkullore ndahen në dy grupe: - Disa emra në shumës modifikojnë zanoren e rrënjës, metafoini, është proces morfofonematik tipik për kundërvënien njëjës shumës: Cjap > Cjep Dash > Desh - Emrat e gjinisë mashkullore që ndryshojnë si bashkëtingëlloren ashtu edhe zanoren e rrënjës së njëjës, metafoini

(ose umlauti) dhe palatalizim (ose qiellzorëzim): Njëjës Shumës Kundërvënia Pjak Pjeq
a/e k/q Ka Qe a/e k/q Derk Dirq e/i k/q

- Emrat e gjinisë mashkullore që kanë kundërvënien qiellzor/joqiellzor dallojnë
shumësin nga njëjësi: Njëjës Shumës Kundërvënia Ujk Ujq k/q Fik Fiq k/q Zog Zogj
k/q

Disa emra formojnë shumësin me mbaresën –e: Njëjës Shumës Kundërvënia
Mal Male ø/e Viç Viçe ø/e

Disa emra formojnë shumësin me mbaresën –ra: Njëjës Shumës Kundërvënia
Karkalec Karkalecra ø/ra

Disa emra kanë shumësin si njëjësin: Njëjës Shumës Bri Bri Si Si Vesh Vesh

Disa emra shumësin e formojnë me mbaresën –a: Burr Burra Gjëmb Gjëmbe

Ashtu si për emrat e gjinisë mashkullore, ekzistojnë nënklasa edhe për emrat e
gjinisë femërore që formojnë shumësin me mbaresën –a:

- emrat që në formën e pashquar mbarojnë me bashkëtingëllore Njëjës Shumës
Fjet Fjeta

- ata që mbarojnë me –r, -z, dhe –l Buz Buza Arr Arra Pul Pula

Disa forma të shumësit të pashquar krijohen duke shtuar mbaresën –e: Njëjës
Shumës Kundërvënia Djep Djepe ø / e

Disa emra nuk shfaqin elemente morfologjike të kundërvënies midis njëjësit
dhe shumësit: Njëjës Shumës Kundërvënia Lule Lule ø/ø Shpi Shpi ø/ø

Disa emra bëjnë dallimin njëjës shumës përmes ndryshimeve morfofonologjike:
Njëjës Shumës Kundërvënia Vashëz Vashaz ë/a

Shumësi i pashquar i emrave asnjëanës formohet duke ia shtuar mbaresën –ra
formës së njëjësit të pashquar: Njëjës Shumës Kundërvënia Ujë Ujëra ø/ra

Përgjithësisht këto forma që mbarojnë me –ra përdoren kur tregojnë sasinë ose
cilësinë e lëndës.

Forma e shquar krijohet duke ia shtuar nyjen e prapavendosur formës së
pashquar të emrit; -i është nyja e gjinisë mashkullore, përveç te emrat që mbarojnë me
velaret -k, -g, -h ose te emrat që kanë zanore të theksuar –u: E pashquar E shquar
Kundërvënia Furr Furri ø/i Qiall Qialli ø/i Dushk Dushku ø/u

Disa emra që kanë në formën e pashquar diftongun –ua- karakterizohen me
shëndrrimin e tij në zanoren –o në formën e shquar: E pashquar E shquar Krua Kroi
Thua Thoi

Grupi tjetër i emrave të gjinisë mashkullore dallon formën e shquar nga e
pashquara përmes kundërvënies ø/ri: E pashquar E shquar Kundërvënia Dru Druri
ø/ri

Forma e shquar e emrave femëror ka mbaresën –a ose –ja. Emrat e gjinisë femërore që në të pashquarën mbarojnë me –ë, në formën e shquar marrin nyjën –a: E pashquar E shquar Kundërvënia Bukë Buka ë/a Derë Dera ë/a Motër Motra ë/a

Emrat e gjinisë femërore që mbarojnë me rrokjen e theksuar në formën e shquar marrin mbaresën –a: E pashquar E shquar Kundërvënia Shpi Shpia ø/a Fole Folea ø/a

Forma e shquar e emrave të gjinisë femërore që mbarojnë me bashkëtingëllore likuide monodridhëse –r ose me bashkëtingëllore shtegore postdentale sonante –z ose me bashkëtingëllore likuide anësore të palatalizuar –l merr mbaresën –a: E pashquar E shquar Er Era Fjal Fjala

Emrat, mbiemrat e emëruar, pjesoret e emëruara të gjinisë asnjëanëse shtojnë –t ose –it: E pashquar E shquar Kundërvënia Djath Djatht ø/t Ar Art ø/t Ball Ballt ø/t Grur Grurt ø/t T’itim T’itimit ø/it T’ngrën T’ngrënt ø/t Përjashtim është emri Qumësht që merr mbaresën e gjinisë mashkullore.

Emrat për raportet familjare nuk kanë nyje të paravendosur në formën e pashquar, ndërsa në formën e shquar marrin nyje të paravendosur dhe të prapavendosur: E pashquar E shquar Bijë E bija Nip I nipi

Emrat kanë dy lakime, një për trajtën e shquar dhe tjetrin për trajtën e pashquar që mundësojnë nëndarjen e emrave në dy grupe:

- Klasa e parë përfshinë emrat që kanë vetëm një nyje të prapavendosur - Klasa e dytë përfshinë emrat që kanë një nyje të prapavendosur dhe një të paravendosur.

E folmja e Shën Benedhit ka shtatë rasa që karakterizohen nga funksionet sintaksore: - Emërorja është rasa që përdoret për kryefjalën; - Gjinatorja është në radhë të parë rasa e përcaktorit; tregon edhe posedimin dhe shumë më rallë vendin dhe kohën, karakterizohet nga mbaresat e veta, ka pjesëz; - Dhanorja është rasa e kundrinës së zhdrejtë, ka mbaresat e njëjta si rasa gjinore dhe ndryshon sepse nuk ka pjesëz; - Kallëzorja është rasa e kundrinës e drejtë, nuk ka mbaresat e vetës dhe në formën e pashquar është si emërorja; - vokativi është rasa e rrethanorit të vokacionit, nuk ka mbaresat e veta, koïncidon me emëroren; prandaj edhe mungon në tabelat e lakimit; - Rrjedhorja është rasa që tregon prejardhjen, shkakun, kohën, lëndën, ka mbaresat e njëjta si dhanorja dhe gjinatorja, përveç në trajtën e shumësit të pashquar; - Lokativi është rasa e rrethanorit të vendit, përdoret në formën njëjës të pashquar, mashkullore dhe femërore, është e karakterizuar nga prapashtesa –t, në formën e pashquar përputhet me kallëzoren.

Lakimi i pashquar i emrit (njëjës) Rasa m. f. a. Emërore ø ø ø Gjinatorja i/u i e/e Dhanore i/u i e/e Kallëzore ø ø ø/e Rrjedhore i/u i e/e

Lakimi i pashquar i emrit (shumës) Rasa m. f. a. Emërore *o/a/ra/e o/a/e ra*
Gjinore *ve ve ve* Dhanore *ve ve ve* Kallëzore *o/ra/a/e o/a/e ra* Rrjedhore *sh sh sh*

Lakimi i shquar i emrit (Klasa e parë, njëjës) Rasa m. f. a. Emërore *i/u a/ja t*
Gjinore *it/ut s/es/is it* Dhanore *it/ut s/es/is it* Kallëzore *in/un n/en/in t* Rrjedhore
it/ut s/es/is t Lokativ *t t*

Këta emra formojnë shumësin duke ia shtuar mbaresën –t formës së shumësit të pashquar: *djathra – djathrat*.

Lakimi i shquar i emrit (Klasa e dytë, njëjës) Rasa m. f. a. Emërore *i- t-* Gjinore *t- s- t-* Dhanore *t- s- t-* Kallëzore *t- t- t-* Rrjedhore *t- s- t-*

Këta emra në shumësin marrin afiksin t' të paravendosur në të gjitha rasat: e motra – t' motrat.

Nga analiza e teksteve dhe nga kërkimi në terren duket se lakimi i emrit ka disa variacione, p.sh. format e rasës gjinore, të dhanores dhe të rrjedhores nuk dalin gjithmonë me mbaresën e shquar –t, disa herë neutralizohet forma e shquar –t dhe përdoret mbaresa -vet si në shumësin e shquar ashtu edhe në të pashquarin.

Bibliografi

- Altimari, F. (1984). Rassegna bibliografica degli studi sui dialetti albanesi dell'Italia Meridionale (1970/1983). *Zjarri*, XVI(28), 22-30. Altimari, F. (1988). Studi linguistici arbëreshë. *Quaderni di Zjarri*, 12. Altimari, F., & Albanci V. (1984) Albanci, ed. J. Stani č, Ljubljana, Cankarjeva založba, pp. 105-125. Camaj, M. (1971). La parlata albanese di Greci in provincia di Avellino. Olschki, Firenze. Camaj, M. (1971). Zur albanischen Mundart von Barile in der Provinz Potenza. *Dissertationes albanicae*, in Honorem J. Valentini ey E. Koliqi, München, pp. 127-140. Camaj, M. (1977). Die albanischen Mundart von Falconara Albanese in der Provinz Potenza. München, Tröfenik. Camaj, M. (1993). La parlata albanese di San Costantino Albanese in provincia di Potenza. Centro Universitario e librario dell'Università della Calabria, Rende. Guzzetta, A. (1978). La parlata di Piana degli Albanesi. *Fonologia*, Palermo. Hamp, E. P. (1972). Current Trends in Linguistics. 9.2, Mouton, 1626-92, *Encyclopedia Britannica*, s.v. "Language of the world" *Macropedia*. Jacobson, R., Fant, C. G. M., & Halle, M. (1952). *Preliminaries to Speech Analysis*. Massachusetts Institute of Technology, Cambridge. Jubani, A., & Conforti, E. (2004). Tiparet akustike të theksit – krahasim i sistemit zanor të shqipes standarde dhe i të folmes së Shën Benëdhinit, në Calabri, *Studime filologjike – Tiranë*. Lambertz, M., (1924). *Italoalbanische Dialektstudien*. *Kuhns Zeitschrift* 51.259-90 (1923), 52.43-90.

- Rada, G. D. (1871). Grammatica della lingua Albanese. Firenze. Savoia, L. M. (1981). La parlata Albanese di San Marzano di San Giuseppe, appunti fonologici e morfologici. *Zjarri* XII(27), 8-26. Solano, F. (1972). Manuale della lingua Albanese. Corigliano Calabro. Solano, F. (1983). Le parlate albanesi di San Basile e Plataci. Quaderni di *Zjarri*, Castrovillari. Turano, G. (2015), Quando caso e accordo sono disgiunti: soggetti accusative e dative nell'albanese e nei dialetti arbwrshw in *Hylli i Dritws*, vol. 1-2, pp. 129-154 (ISSN 1816-5885)

Aleksandër NOVIK, Marina SULLOEVA

**DASMA NDËR SHQIPTARËT E DEVOLLIT: MATERIALET
ETNOLINGUISTIKE TË STUDIMEVE SHKENCORE NË TERREN TË
VITEVE 2011 – 2014**

Gjatë viteve 2011 – 2014 janë organizuar studimet shkencore në terren në juglindje të Shqipërisë (krahinat Korça, Devolli, Kolonja), në zonat me popullsinë polikonfesionale dhe multietnike: këtu jetojnë shqiptarët e fesë ortodokse, shqiptarët myslimanë, arumunët (të gjithë të krishterë), jevgjit (në masën e tyre myslimanë), grekët ortodoksë. Islami është përhapur në këtë zonë në dy forma: suni dhe bektashi. Studimet etnolinguistike në terren janë kryer nga kolektivi shkencor: Andrej Sobolev, Aleksandër Novik, Denis Ermolin, Maria Morozova, Aleksandra Dugushina, Marina Sulloeva [АМАЭ: Ермолин 2011А; АМАЭ: Ермолин 2011Б; АМАЭ: Новик 2011А; АМАЭ: Новик 2011Б; АМАЭ: Новик 2012А; АМАЭ: Новик 2012Б; АМАЭ: Новик 2013А; АМАЭ: Новик 2013Б; АМАЭ: Новик 2014А; АМАЭ: Новик 2014Б].

Një nga qëllimet kryesore të ekspeditave tona ishte të gjejmë paralelet në gjuhën dialektore dhe kulturën tradicionale të popullsisë vendase me ato të pasardhësve të kolonistëve shqiptarë në Buxhak dhe në rajonin e Azovit (për shkak të dëshmimeve të shumta linguistike dhe historike që kanë të bëjnë me hipotezën e ardhjes së shqiptarëve në Bullgari dhe më vonë në Perandorinë Ruse pikërisht nga krahina e Korçës). Për organizimin e ekspeditave është përgatitur metodika e re e mbledhjes dhe grumbullimit të materialeve e cila lejon të fiksojmë faktet nga më të ndyshmet që kanë të bëjnë me kujtesën kulturore të popullsisë së krahinave në studim dhe që kanë lidhje me historinë e mërgimit të pjesës së popullsisë në fund të shekullit XVI – fillim të shekullit XVII.

Një nga ritet kryesore në fushën e traditës etnokulturore në krahinën e Devollit është ai i dasmës. Ritet dhe zakonet e dasmës që fiksohen gjatë punës shkencore në terren dëshmojnë për ruajtjen e kodit të personazheve (këtu mund të themi për paralelet në terminologjinë e grupeve të veçanta leksiko-semantike me dasmën tek shqiptarët e Ukrainës në Buxhak dhe në rajonin e Azovit: *nuse, nun* etj.) [Shiko: Tab. Nr. 1]. Në kodin e lëndëve të riteve të dasmës fiksohen shumë denotate që emërtojnë bukën rituale dhe gatimet e guzhinës: *bakellava me njëqind pete* etj. Kodi akcional i riteve

të dasmës tek shqiptarët e Devollit ka shumë paralele me praktikat rituale që janë të përbashkëta për tërë Toskërinë. Megjithatë këto praktika rituale kanë shumë tipare të përbashkëta edhe me ato të maqedonasve, bullgarëve dhe grekëve [krahaso: Иванова 2006; Соколов 2005; Tirta 2006].

Veshjet popullore janë marker i rëndësishëm të grupeve të ndryshme të popullsisë së Devollit. Varianti më i pasur nga pikëpamja e zbulimeve është varianti i kostumit të dasmës [АОЕ: Новик, Сулоева 2014: Зичишт_свадьба].

Kodi aksional: skenari i dasmës

Fshati Ziçisht i ruan traditat e tij të lashta edhe sot e kësaj dite, ndoshta më shumë sesa fshatrat e tjera në këtë zonë. Dasma fillon një javë përpara darkës kryesore, të hënën. Në shtëpitë e nuses dhe të dhëndërit fillojnë përgatitjet, vijnë njerëzit për vizitë dhe çdo natë familjarët organizojnë darkë për mysafirët. Të mërkurën merret paja e nusës dhe në shumicën e rasteve të gjithë fëmijët e fshatit marrin pjesë në këtë rit të rëndësishëm. Më pas vijon riti i zënjes së bukës me qiqra [krahaso: Tirta 2006]. Të gjitha gratë e pranishme në këtë akt këndojnë e shtypin qiqrat dhe pastaj fillojnë të zënë bukën dhe e lënë të vijë deri të nesërmen në mëngjes. Të enjten pjesëtarët e familjeve të nuses dhe të dhëndërit i ftojnë mysafirët në dasmë. Të premten zakonisht nusja mbledh shoqet e saj dhe ato festojnë përfundmin e ditëve të rinisë. Gjithashtu të premten shpihet kungulli me verë nga nusja. Pastaj të shtunën organizohet dasma në shtëpinë e nusës dhe të djelën dasma ka vend në shtëpinë e dhëndërit [Сулоева 2014].

Gjatë javës së dasmës bëhen vizitat e para mes të dyja palëve të krushqve të ardhshëm. Nga ana e dhëndërit vijnë xhaxhai dhe daja i tij bashkë me kryefamiljarin, domëthënë të afërmit e tij. Krushqit e dhëndërit bëjnë vizitën në rradhën e parë në shtëpinë e nuses, ku kërkojnë dorën e vajzës për djalin e tyre [АОЕ: Новик, Сулоева 2014: Зичишт_свадьба]. Ata duhet të rrinë jo më tepër se dy orë në shtëpinë e nuses dhe pas urimeve dhe gostisë, kthehen në shtëpi. Nganjëherë, sipas rastit, shkojnë edhe për darkë. Si dhurata fejeje, zakonisht çohet bukë me qiqër, çorape, këmishë etj. Kurse nusja, sipas zakonisht, u jep ëmbëlsira fëmijëve, dërgon dhurata për dhëndërin dhe për të afërmit e tij [krahaso: Хаџка 1959].

Në të kaluarën në zonën e Korçës një zakon i veçantë ishte ai i krushqve, kur ata duhej të luanin rolin e hajdutëve kur shkonin për vizitë në shtëpinë e nuses me rastin e shpalljes së fejesës së çiftit të ri [Mani 1958]. Edhe në fshatin Ziçisht kjo traditë ka mbijetuar dhe mund të shohim zbatimin e kësaj tradite edhe ditët e sotme.

Është ruajtur edhe riti që kryhet te shtëpia e dhëndërit kur i vënë nuses nën sqetull dy bukë me qiqra (që të jetë nusja pjellore). Pastaj vjehrra ia lyen gishtin nuses me mjaltë, dhe nusja bën shënja me mjaltë në derën e shtëpisë për të bekuar shtëpinë.

Kodi i personazheve: protagonistët e dasmës

Dasma është një rrit shoqëror, në të cilin rolin aktiv luajnë personazhet e dasmës, kështu që emërtimi i pjesëmarrësve të dasmës përbën një grup të rëndësishëm leksikor dhe semantik. Në përputhje me funksionet e caktuara për çdo pjesëmarrës të ceremonisë, mund të dallojmë personazhet kryesore dhe ata të rëndësishëm të dytë. Personazhet kryesore i përfshijnë nusen, dhëndërin, prindërit dhe disa të afërmit e tyre; grupin e dytë përbëjnë miqtë e afërtë e të largët dhe njerëzit që janë ftuar për të ndihmuar në përgatitjet e dasmës. Në këtë studim është e pamundur të përshkruajmë të gjitha pasuritë leksikore dhe etnolinguistike që janë fiksuar gjatë ekspeditave tona, prandaj do të koncentrohemi rreth disa shembujve që janë më interesantë.

Në fillim të shekullit të kaluar edhe krahina e Devollit nuk ishte përjashtim në sfondin e fenomenit të martesave nëpërmjet mblesërive. Zakonisht mardhëniet midis dy familjave lidheshin me ndihmën e një ndërmjetësi, njeriu që i njëjti të dyja familjet mirë dhe bënte bisedimet, duke i bindur palët që martesa do të ishte e mirë, si për njërin familje, ashtu dhe për tjetrën. Në krainën e Devollit në fshatin Ziçisht për këtë ndërmjetës është fiksuar denotati *mbles*, *-i*. Emërtimet e fiksuara për këtë personazh të dasmës në të folmet e ndryshme janë: *lajmës*, *-i* (Skrapar) [Zojzi 1958], *krushqar*, *-i* (Gjirokastër), *shkalbalt*, *-i* (Vlorë), *mbles*, *-i* (Korçë), *vles*, *-i* (Kolonjë) [Shiko: Tab. Nr. 1].

Pas mbarimit të përgatitjeve të para për dasmën i zoti i shtëpisë përcakton njerëzit që kanë për detyrë të ftojnë mysafirët. Në Ziçisht me këtë qëllim zakonisht dërgohen fëmijët (shpesh vajza të vogla). Ato çupa vizitojnë shtëpitë e të ftuarve me një bukë të pjekur e të zbukuruar në mënyrë të vecantë. Denotatët e fiksuara në të folme të ndryshme të shqipërisë janë: *thirrës*, *-i*, *grishës*, *-i*, *lajmës*, *-i*, *lajmëtar*, *-i*, *ftonjës*, *-i*, *dërgues*, *-i* [Shiko: Tab. Nr. 1].

Një nga të ftuarit më të ndëruar është *kumbari*. Kumbari [krahaso: Fjalor 1980: 912] merr ftesë që të enjten, tri ditë para se të organizohet ceremonia kryesore e dasmës. Dëtyra kryesore e kumbarit është të shoqërojë çiftin e ri në kishë dhe të ndërrojë kurorën e dhëndërit dhe të nuses. Kur krushqit e dhëndërit nisen për të marrë nusen, ata duhet që të flasin në fillim me kumbarin e të bien dakord me të dhe së bashku shkojnë e marrin nusen që të vënë kurorën. Gjithashtu, kumbari kujdeset që gjithçka të shkojë sipas rregullave [AOE: Новик, Сулоева 2014: Зичишт_свадьба].

Një nga protagonistët e dasmës është *vëllami*. Në Korçë rolin e vllamit kryen burri i motrës së dhëndërit ose një mik i ngushtë. Vëllami merr nusen nga shtëpia e prindërit e saj për ta çuar te dhëndëri.

Ndër personazhet kryesore të dasmës mund të dallojmë edhe *daiun*. Por në krahinën e Devollit kemi fiksuar leksemët: *dajo* ose *daike* [Shiko: Tab. Nr. 1].

Një nga shembujt më interesante të emërimit të personazheve të rëndësisë së dytë është ai i *akë eshtës* [Shiko: Tab. Nr. 1]. Kjo leksemë përdorej më shumë në të kaluarën [Mani 1958]. Akçesha ishte gruaja që dinte të gatuar mirë. Atë e ftonin disa ditë para dasmës, zakonisht të premtën për të ndihmuar me gatimin e gjellëve të ndryshme për darkën solemne të së shtunës. Një nga detyrat e saj kryesore ishte pjekja e bukës së dasmës.

Konkluzione

Materialet gjuhësore dhe etnografike nga krahina e Devollit [shiko: Ермолин 2015: 101-120] na japin shumë shembuj të kontinuitetit kulturor të trevave shqiptare (për ne rëndësi të veçantë kanë faktet e ruajtjes së leksikut dhe riteve të dasmës tradicionale që kanë të bëjnë me të folmen dhe zakonet e shqiptarëve të Ukrainës). Materialet të mbledhura në terren (audiofajlet me inçizim të intervistave, tekstet e narativave, fotografitë etj.), objektet e kulturës tradicionale janë grumbulluar në Muzeun e Antropologjisë dhe Etnografisë (Kunstkamera) të Akademisë së Shkencave të Rusisë. Fondi i materialeve nga Devolli është pjesë e Fondit të Atlasit të Vogël Dialektologjik të Gjuhëve Ballkanike të arkivuar në Kunstkamerë në Sankt Peterburg. Kemi plane të vazhdojmë studimet tona në terren dhe në analizë të mëtejshme të fakteve linguistike dhe etnografike të fenomenit të dasmës shqiptare.

Burimet dhe literatura:

Arkivat:

Arkivi i Muzeut të Antropologjisë dhe Etnografisë (Kunstkamera) të Akademisë së Shkencave të Rusisë (Sankt Peterburg, Rusi)

АМАЭ: Ермолин 2011А – *Ермолин Д.С.* Экспедиция в Косово, Албанию 13.08 – 10.10.2011 г. Полевая тетрадь. Ксерокопия // Архив МАЭ РАН. К. I оп. 2, д. № 2025.

АМАЭ: Ермолин 2011Б – *Ермолин Д.С.* Экспедиция в Албанию и Косово. Балканские экспедиции Российской Академии наук. Отчет о научной

- поездке 2011 г. Принтерный вывод // Архив МАЭ РАН. К. I оп. 2, л. № 2026.
- АМАЭ: Новик 2011А – *Новик А.А.* Тоскерия – 2011. Изучение традиционной культуры албанцев Тоскерии (области: Корча, Колёнья, Дэвол), черногорцев Черногории, сербов Черногории. Полевая тетрадь. Ксерокопия. Сентябрь 2011 // Архив МАЭ РАН. К-1, оп. 2. № 2049. 123 л.
- АМАЭ: Новик 2011Б – *Новик А.А.* Отчет об экспедиционных исследованиях в Тоскерии (Албания) в сентябре 2011 г. Принтерный вывод. Сентябрь 2011 // Архив МАЭ РАН. К-1, оп. 2. № 2050. 11 л.
- АМАЭ: Новик 2012А – *Новик А.А.* Изучение традиционной культуры албанцев, влахов в Центральной и Юго-Восточной Албании. Полевая тетрадь. Ксерокопия тетради. 26.08. – 24.09.2012. // Архив МАЭ РАН. К-1, оп. 2. № 2115. 52 л.
- АМАЭ: Новик 2012Б – *Новик А.А.* Отчет об экспедиционных исследованиях в Тоскерии (Албания) в августе-сентябре 2012 г. Принтерный вывод. 27.08. – 10.09.2012. // Архив МАЭ РАН. К-1, оп. 2. № 2116. 10 л.
- АМАЭ: Новик 2013А – *Новик А.А.* Экспедиция в Тоскерию (Юго-Восточная Албания) к православным албанцам, албанцам-мусульманам, в места бывшего расселения арумун (пограничье Албании и Греции). Полевые записи. Автограф. 10.08. – 18.08.2013., 19.09. – 25.09.2013. // Архив МАЭ РАН. К-1, оп. 2. № 2177. 68 л.
- АМАЭ: Новик 2013Б – *Новик А.А.* Отчет об экспедиционных исследованиях в Тоскерии (Юго-Восточная Албания) в августе и сентябре 2013 г. Принтерный вывод. 10.08. – 18.08.2013., 19.09. – 25.09.2013. // Архив МАЭ РАН. К-1, оп. 2. № 2178. 15 л.
- АМАЭ: Новик 2014А – *Новик А.А.* Экспедиция в Тоскерию (Юго-Восточная Албания) к православным албанцам, албанцам-мусульманам, в места бывшего расселения арумун (Пограничье Албании и Греции) в августе 2014 г. Полевая тетрадь. Автограф. 10.08. – 16.08.2014. // Архив МАЭ РАН. К-1, оп. 2. № б/н. 42 л.
- АМАЭ: Новик 2014Б – *Новик А.А.* Отчет об экспедиционных исследованиях в Тоскерии (Юго-Восточная Албания) в августе 2014 г. Принтерный вывод. 10.08. – 16.08.2014. // Архив МАЭ РАН. К-1, оп. 2. № б/н. 12 л.

Arkivi i Departamentit të Europeistikës të Muzeut të Antropologjisë dhe Etnografisë (Kunstkamera) të Akademisë së Shkencave të Rusisë (Sankt Peterburg, Rusi)

АОЕ: Новик, Сулоева 2014: Зичишт_свадьба – *Новик А. А., Сулоева М.А.* Зичишт_свадьба. Цифровая аудиозапись. 2014 // Архив отдела европеистики МАЭ. Зичишт. 2014. Новик А.А., Сулоева М.А.

Сулоева 2014 – *Сулоева М. А.* Материалы экспедиционной поездки в с. Зичишт, р-н Корча, Албания (12.08.2014.—15.08.2014). Полевая тетрадь.

Arkivi i Institutit të Antropologjisë Kulturore dhe të Studimit të Artit (Tiranë, Shqipëri)

Mani 1958 – *Mani V.* Pasqyrë mbi zakonet e kohës kaluar. Кор□ ë. 1958. 90/12.

Bibliografia:

Ермолин 2015 – *Ермолин Д.* Границы конфессионального, этнического и регионального в погребальном обряде албанцев // Археология русской смерти. 2015. № 1. С. 101 – 120.

Иванова 2006 – *Иванова Ю. В.* Албанцы и их соседи. Москва: Наука, 2006.

Соболев 2005 – *Соболев А. Н.* Малый диалектологический атлас балканских языков. Лексика духовной культуры. Мюнхен: Biblion Verlag, 2005.

Fjalor 1980 – Falor i gjuhës së sotme shqipe / Kryeredaktor A. Kostallari. – Tiranë, 1980.

Tirta 2006 – *Tirta M.* Etnologjia e shqiptarëve. Tiranë: Geer, 2006.

Xhaçka 1959 – *Xhaçka V.* Lindja dhe martesja në Devoll // Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës. Seria Shkencat Shoqërore. 1959.

Zojzi 1958 – *Zojzi Rr.* Dasma në krahinën e Skraparit // Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës. Seria Shkencat Shoqërore. 1958.

DASMA NDËR SHQIPTARËT E DEVOLLIT: MATERIALET...

AKÇESH/Ë, A f. sh. ~A, ~AT ¹	Gjellëbërëse.	akçesh/ë, -a (Gjirokastrë) [Koço 2013] akshes/ë, -a (Korçë) [Mani 1958]
BAJRAKTAR,~ I m. sh. ~Ë, ~ËT	Krushku që mbante bajrakun e dasmës, kur shkonin të merrnin nusen; krushku i parë.	barjaktar, -i (Devoll) [Xhaçka 1959], [AOE: Novik, Sulloeva 2014]
DAROV/Ë, A f. sh. ~A, ~AT	Dhuratë që i jepej dikujt (zakonisht nuses); peshqesh.	darov/ë, -a (Skrapar) [Zojzi 1958] paj/ë, -a (Devoll) [Xhaçka 1959]
DASM/Ë, A f. sh. ~A, ~AT	Festë që bëhet me rastin e martesës, e shoqëruar me një ceremoni të gëzueshme; festa e martesës; dita kur bëhet kjo festë.	dasm/ë, -a [AOE: Novik, Sulloeva 2014]
DHËND/ËR, ~RI m. sh. ~URË, ~URËT	1. Djali që po martohet ose që sapo është martuar; djali që është fejuar e që do të martohet së shpejti. 2. Burri i vajzës a i motrës së dikujt.	dhënd/ër, -ri [AOE: Novik, Sulloeva 2014]
DUVAK,~U m. sh. ~Ë, ~ËT	Vel i hollë që përdorej për të	vello,-ja (Devoll) [Xhaçka 1959]

¹ Format e fjalëve në gjuhën e sotme shqipe. Burimi: Fjalor 1980.

	mbuluar fytyrën e nuses ditën e martesës.	dullak, -u (Korçë) [Mani 1958] duvak, -u [AOE: Novik, Sulloeva 2014]
FEJES/Ë, A f. sh. ~ A, ~AT	1. Lidhje ndërmjet djalit e vajzës, që i premtojnë njëritjetrit se do të martohen e që e shpallin këtë edhe në familjet e tyre e për të njohurit; ceremonia që bëhet kur shpallet kjo lidhje. 2. Koha që nga dhënia e fjalës për t'u martuar deri në ditën e martesës.	fejes/ë, -a [AOE: Novik, Sulloeva 2014]
FTUAR,~I (i) m. sh. ~, ~ IT (të)	Ai që është grishur për drekë a për darkë, për të marrë pjesë në një festë, në një pritje, në një mbledhje ose në një ceremoni me rastin e një dite të shënuar; ai që ka marrë ftesë	të ftuar të thirrur [AOE: Novik, Sulloeva 2014] të lajmëruar
KUL/AÇ, ~AÇI m. sh. ~ EÇ, EÇTË	Bukë e ngjeshur, zakonisht e rrumbullakët, e zënë pa tharm,	bukuval/ë, -a, turt/ë, -a, panespan, -i, buksheqer, -i (Korçë) [Mani 1958]

DASMA NDËR SHQIPTARËT E DEVOLLIT: MATERIALET...

	që piqet në saç, në shpuza e në furrë.	kulaç, -i [AOE: Novik, Sulloeva 2014]
LAJMËS, ~I m. sh. ~, ~IT	1. Ai që shkonte te njerëzit e vajzës për ta kërkuar nuse për dikë, shkues, mblesës.	mbles, -i (Korçë) [Mani 1958] thirrës, -i, grishës, -i, lajmës, -i, lajmëtar, -i, ftonjës, -i, dërgues, -i [Tirta 2006]
MBLES, ~ I m. sh. ~Ë, ~ËT	Lajmës, shkues.	
NIGJAH, ~U m. sh. ~Ë, ~ËT	1. Përfundimi i martesës sipas kërkesave të dogmës fetare myslimane. <i>I hodhi nigjabun lidhi martesën.</i> 2. Shumë të hollash, që duhej t'i jepte burri gruas në rast se e ndante, sipas rregullave fetare myslimane. <i>I jepte nigjabun.</i>	nixhah, -u / (Korçë) [Mani 1958]
NUN, ~ I m. sh. ~E, ~ET	1. Ai që mbante foshnjën gjatë pagëzimit dhe që i vinte emrin. 2. Ai që i merrte flokët fëmijës së porsalindur, kumbarë. 3. Ai që ndërronte kurorat e dhëndrit e të nuses. 4. Kumbarë	nun, -i (Devoll) [Xhaçka 1959]. kumbar, -i [AOE: Novik, Sulloeva 2014]

NUS/E,~ JA f. sh. ~E, ~ET	1. Vajza që po martohet, vajza në ditët e dasmës; grua e re e sapomartuar. 2. Gruaja e djalit (në marrëdhënie me prindërit dhe njerëzit e tjerë të dhëndrit), e reja.	nus/e, -ja [AOE: Novik, Sulloeva 2014]
PAJ/Ë,~A f. sh. ~A, ~AT	Plaçkat dhe pasuria që merrte me vete nusja e i çonte në shtëpinë e dhëndrit kur martohet.	paj/ë, -a (Devoll) [Xhaçka 1959] [AOE: Novik, Sulloeva 2014]
POGAÇ/E,~ JA f. sh. ~E, ~ET	1. Kulaç i grunjtë.	pogaç/e, -ja (Devoll) [Xhaçka 1959]
PRIK/Ë, A f. sh. ~A, ~AT	Pasuri e patundshme a shumë të hollash që i jepnin dhëndrit prindërit e vajzës përpara martesës.	prik/ë, -a [AOE: Novik, Sulloeva 2014]
SHKUES, ~I m. sh. ~, ~IT	Ai që dërgohej te njerëzit e vajzës për ta kërkuar nuse për dikë, ai që ndërmjetësonte për të bërë një fejesë; lajmës, mblesës.	mbles, -i (Korçë) [Mani 1958]
VELLO, ~A f. sh. ~, ~T	Pëlhurë e hollë	vello, -ja

DASMA NDËR SHQIPTARËT E DEVOLLIT: MATERIALET...

	dhe e tejdukshme (zakonisht një copë tyli), me të cilën mbulohej nusja ditën e dasmës kur nusëronte ose kur e çonin te shtëpia e dhëndrit; duvak.	(Devoll) [Xhaçka 1959] dullak, -u (Korçë) [Mani 1958]
--	---	---

Tabela Nr. 1. Grupi leksiko-semantik "Dasma".

Oğuzhan DURMUŞ, Rijetë SIMITÇIU

EMËRTIMET GJEOGRAFIKE OSE TOPONIMET NË VILAJETIN E BERATIT SIPAS “SÛRET-I DEFTER-I SANCAK-I ARVANID” TË VITIT 835 TË HIXHRIT

Librat e parë që gjenden në arkivat Osmane u dedikohen shqiptarëve (İnalçık 1987), ndër ta duhet përmendur librin “Regjistri i Sanxhakut Arvanid” (Sûret-i Defter-i Sancak-i Arvanid) i vitit 835 të hixhrit, që i përkon vitit 1431-1432 dhe është më i vjetri i njohur deri më tani. Libri në fjalë përmban të dhëna mjaft me vlerë si për historinë shqiptare, ashtu edhe për gjuhësinë historike të shqipes me të dhënat toponomastike, studimi i këtyre të dhënave do të jetë temë kryesore në këtë punim.

Një fakt mjaft i rëndësishëm se në këtë libër që është i shkruar në osmanishten e vjetër në shekullin e XV shqiptarët quheshin *arvanitas* e jo *arnaut*, emër i cili e paraqet vazhdimësinë e po të njëjtit emërtim *Arbanites*, që sipas Çabejt (1987:163) është i njohur që në shekullin II nga emëri i fisit Albanoi me qytetin e tyre Albanopolis. Para shekullit XVIII shqiptarët veten e quanin me emrat *arbënë*, *arbërë*, *arbënesh*, *arbëresh*, *albresh*, ndërsa vendin *Arbënë*, *Arbëni*, *Arbëri* (Çabej 1988; Ismajli 1985; Demiraj 1988).

Emërtimi mbi bazat *arb-*, *alb-* është i vetmi që shërbeu si mbështetje për fqinjët e shqiptarëve me shekuj. Grekët emrin për shqiptarët e krijuan nga baza *arbanë*, *arbënë*, formë e përgjithshme deri në kohën e veprimit të rotacizmit, dukuri që u ndal së vepruari para ambientimit të sllavëve në Ballkan. Prandaj, te grekët emri *Arbanites* vjen në shprehje para shekullit V (Ismajli 1985:225). Nëpër dokumente ai del për herë të parë në shekujt XI-XII në trajtën *Arbanon* (më saktë, *Arvanon*)¹ (Demiraj 1988:224).

Pothuajse të njëjta forma *Arbanites*, *Arbanon*, *Albanon* dalin edhe te kronistët bizantin në shekullin XI e më vonë, mirëpo këtu haset një formë e mbështetur në variantin toskë me rotacizëm². Pra, nga forma greke emrin për shqiptarët e krijuan

¹ Trajta fonetike-gramatikore që ishte në përputhje me sistemin gjuhësor të greqishtes, si rrjedhim tingulli *-b-* duhet të jetë shqiptuar *-v-*, në greqishte ndërrimi *b > v* është përfutur qysh herët. Në dokumentet greke ky emër del zakonisht me rrokjen nistore *ar-* e kështu del edhe sot në greqishten popullore (khs. *arvanitis*, *arvanitika* etj.). Por nuk mungojnë nëpër dokumentet greke edhe trajta me rrokjen nistore *al-*, ashtu si te Ptolemeu i Aleksandrisë në shekullin II të erës sonë (Demiraj 1988:224).

² Ismajli procesin e krijimit të rotacizmit në gjuhën shqipe në mbështetje të kundërvënies së *n-* së geminate me atë jogeminante thotë se krijonte kundërvënie funksionalisht të ngatërruar,

turqit vazhdon Rexhep Ismajli te “Gjuha shqipe e Kuvendi të Arbënit” (Ismajli 1985:225-226; Pedersen 2003:148), si: <arβanit – arvanit – arnavit – arnavut>. Emërtim ky që në vete përmban shenja të metatezës, si dhe ndryshim të zanoreve *i/u* që vjen si rezultat i veprimit të harmonisë së zanoreve të turqishtes.

Ky ndryshimi i zanoreve *i/u* ka ardhur për arsye se forma e osmanishtes *arvanit*, është në kundërshtim me rregullat fonetike të turqishtes. Turqishtja ka një harmonizim të rrokjeve brenda fjalës përkatëse, nëse rrokja e parë përfundon me zanore të drejtë po ashtu duhet të vazhdojnë edhe rrokjet e tjera. Ndikimi i tingullit labial ka rezultuar në dhënien e zanores së rrumbullakët *i>u* (turq. *avuç > avuç; kavın > kavun*).³ Forma *arvanid*, te libri “Registri i Sanxhakut Arvanid” që i përket gjysmës së parë të shek. XV, është e shkruar me dhëmboren mbylltore të zëshme *-d*⁴, përdërisa në çdo dokument apo vepër tjetër e gjejmë me dhëmboren mbylltore të pazëshme *-t*. Një formë të tillë me *-d*, si *arvanid*, nuk ekziston në fonologjinë e gjuhës turke. Kjo vjen si pasojë e transkriptimit prej osmanishtes në turqishte ku kemi raste kur shkruhet dhëmborja mbylltore e zëshme *-d* ndërsa shqiptohet si dhëmbore mbylltore e pazëshme *-t* (p.sh.: fjalën turke *kurd* kur e shkruajmë në osmanishte e shqiptojmë si *kurt*).

Historiani Johann Thunmann në punimin monografik të tij që i përket gjysmës së dytë të shekullit XVIII thekson se vetëm te turqit e gjejmë emërtimin arnaut (sh.: arnautlar) për shqiptarët (B. Demiraj 2014:62). Sllavët emërtimin për shqiptarët e krijuan me formën *Arbanas, Arbanaia*, pastaj me veprimin e metatezës në sllavishtet e jugut u krijuan forma *Rabanija, Rabanas*.⁵ Gjuhët romane krijuan vetëm një emër mbi bazën *alb-*: *Albanenses, Albanese, Albania*. Te dy variantet e kësaj forme: *arb-*, *alb-* variacioni *r/l* shpjegohet përmes disimilimit ose përmes origjinave të ndryshme të rrënjëve të tyre⁶ (Ismajli 1985:226).

duke nxitur që *n*-ja jogeminante të shqiptohet e labërguar sa për të mos u ngatërruar me *n*-në geminate (nënna, hëna). Po ashtu, kemi fonologjizimin e variantit ekspresiv kuantitativisht më të gjatë të dridhëses *r*, që u ndihmua edhe nga asimilimi i grupit konsonantik *rn*- (Shih Ismajli 1972, te Rugova 2013:126-127).

³ Një ndryshim të ngjashëm të zanoreve e jep Pedersen (2003:92) se *ñ*-ja mund të ketë lindur nga *i*-ja nën ndikimin e një tingulli labial (*dñer > dier*; për shkak të *dhv* origjinale nistore etj.), duke e pranuar se rrumbullakosja e labialeve në shqipen e lashtë (protoshqipen) nuk kishte humbur por ishte zhvilluar në një □ të plotë të pazëshme.

⁴ Në të folmet jugore të Shqipërisë kemi formën *-nd > -nt* (*vënd > vënt; argjend > argjënt* etj.), kjo dukuri përdoret te ato të folme për t'i shqiptuar bashkëtingëlloret e zëshme në pozicion fundor si të pazëshme (Demiraj 1996:204).

⁵ Format slave Albanija, Albanac dhe Arnavut (Arnavutluk) u krijuan më vonë nën ndikimin e gjuhëve në kontakt, të gjuhëve romane dhe të turqishtes (Ismajli 1985:226).

⁶ Rrënja *arb-* nga Pedersen shpjegohet si indoeuropiane dhe primare, ndërsa Jokli e Tombetti e shohin paraindoeuropiane (shih Çabej 1960; te Ismajli 1985:226).

Libri “Regjistri i Sanxhakut Arvanid” flet për regjistrimin e popullatës shqipëtare të asaj kohe duke qenë një dokument zyrtar për trojet shqipëtare. Aty dalin të regjistruara nga kadastra osmane viset e banuara me shqiptar ky libër është edhe një tjetër fakt se shqiptarët janë autokton, ata kanë banuar gjithnjë dhe vazhdojnë të banojnë aty edhe në shekullin XV. Hamp (2007:77) toponomastika ka rëndësi të madhe për çështjen e vendndodhjes prehistorike dhe gjurmimit të origjinës së shqiptarëve. Nëse këto emra vendbanimesh thotë Çabej (1987:147-154) dëshmojnë një kronologji të emrave të vjetër sipas zhvillimit historik të fonetikës shqipe, në aspektin gjuhësor të vazhdueshëm, rezulton se shqiptarët janë autokton në vendbanimet e tyre së paku që prej kohës antike. Kjo na bën që të bëhet edhe një trajtim i aspektit gjuhësor të ndryshimit të emërtimeve të vjetra me ato të sotëm të këtyre toponimeve që shpjegohen nëpërmjet fonetikës historike të shqipes e shmangieve dialektore të cilat janë të pakta.

Organizimin më të hershëm administrativ të Shqipërisë ne e njohim përmes regjistrimit të vitit 1431-1432 të bërë nga osmanët. Sipas këtij regjistrimi osman u formua Sanxhaku Shqiptar me kryeqendër Gjirokastrën. Sanxhaku ishte njësi feudale administrative më vete që varej drejtpërdrejt nga administrata qendrore e perandorisë. Nga të dhënat e këtij regjistri (i cili nuk është i plotë) prandaj edhe kryeqendra e Sanxhakut del në zonën më jugore të tij, dhe kjo nënkupton se edhe vise të tjera shqiptare më në jug duhet të ishin përfshirë në të, del se Sanxhaku Shqiptar përfshinte Çamërinë dhe vise të tjera shqiptare deri në brigjet e lumit Mat.⁷ Vilajetet e tij ishin: 1) Vilajeti i Gjirokastrës; 2) i Kërçyrës; 3) i Kaninës; 4) i Beratit, 5) i Tomoricës; 6) i Skarparit; 7) Pavllo Kurtikut (Tiranë); 8) i Çartollozit (Në mes të Elbasanit, Beratit dhe Tomoricës); 9) i Krujës; si dhe 10) i Vajonetës (Delvinës). Vilajetet ishin të ndarë në prona feudale ushtarake, në timare, që formoheshin nga shumë fshatra, nga një fshat po nga një pjesë e një fshati. Sipas madhësisë që kishin këto prona emërtoheshin timare, ziamete dhe hase.

⁷ Libri “Regjistri i Sanxhakut Arvanid” i vitit 1431-1432 është një burim historik me vlerë për tokat shqiptare që i përkasin pjesës jugore dhe të mesme të Shqipërisë në gjymën e pare të shekullit XV. Për krahinat e Shqipërisë veriore u botua libri: Defteri i hollësishtëm (mufassal) i regjistrimit të tokave dhe të popullsisë në sanxhakun e Shkodrës në vitin 1485 (Pulhana 1974:3).

Sanxhaku i Beratit

Sipas Evlia Çelebiut (Sejihatnamesi 2010:500) në Perandorinë Osmane ekzistonin katër kështjella të përmendura me emrin Belgrad, e para është Belgradi i Tunës, që ndodhet pranë bregut të lumit Danub, e dyta gjendet në kufirin e Budinit (Hungari) që quhet Belgradi Stoln, e treta është Belgradi i Ardelit (Transilvani), dhe e katërta është Belgradi i Shqipërisë.

Qyteti i Beratit u themelua më 313-310 para erës sonë, si qytet kështjellë i Dasartisë, i quajtur Antipatrea nga mbreti Kassandër. Pas pushtimit romak në shekullin II para erës sonë u quajt Albanorum Oppidum (Fortesa e Arbërve). Në vitet 408-450 nga Teodosi i Ri mori emrin Pulcheriopolis (Pulheriopolis; Qytet i bukur) e quajti ky i fundit sipas emrit të së motrës Pulcheria. I pushtuar nga bullgarët në shekullin IX u quajt Belgrad (Белград, Белиград: Kala e bardhë). Berat vjen nga fjala Bart (i bardhë) më vonë i quajtur si Peterabla (Gur i bardhë). Në gjuhën sllave quhet Bellagrita, Belgrata. Berati në greqishten popullore nga autorët e Perandorisë së hershme Bizantine u quajt Velégrad (Βελήγορᾶδα) (Myzeqari 2012:6-25). Hampi (2007:126) jep si ilustrim emërtimin e qytetit të Beratit që e ka humbur –g-ën e tij sllave, duke bërë një përmirësim të paraqitjes së emrit të lumit Buna (*barbanna = /bar□anna/ > *borja(n)a > *bojana (përmes përshtatjes sllave); në shqipen e hershme: ujë < *udjā) nga ana e Bariçit. Belgrad > Berat, studiuesi bullgar Ivanov⁸ është i mendimit se fjala *barbh* vjen nga paraindoeuropianishtja *bhezg (shkëlqim) > ‘блж, блестящ, një formë e tillë del për arsye të mos transformimit të r-ës në l-ë.

Pasqyra e fshatrave të Vilajetit të Beratit sipas librit “Regjistri i Sanxhakut Arvanid” (Sûret-i Defter-i Sancak-i Arvanid) të vitit 835 të hixhrit:

- Fshati Zhitom (Jitomi)⁹ > Zhitomi i Madh dhe Zhitomi i Vogël / Tërpan / Berat;
- Fshati Brashtani (Braštani) > Broshtan / Elbasan;
- Fshati Kamçishte (Kamçishte) > Kamçishtë / Fier;
- Fshati Bahtal > Pahtal /?;

⁸ <http://www.protobulgarians.com/Kniga%20za%20etnonima/13-Dokazatelstva%20toponi mni.htm>

⁹ Emërtimi i fshatit *Zhitom* në gjuhën turke është *Jitom* sepse shkronja “j” në gjuhën turke korespondon me shkronjën “zh” të shqipes. Fshatrat *Broshtan*, *Kamçishtë*, *Velište*, *Krushovë*, *Mashkullorë*, *Vlosh*, *Shalë* e *Kreştanë* në gjuhën turke dalin në formën *Broshtan*, *Kamçishte*, *Velište*, *Krişove*, *Maşkullore*, *Vloş*, *Şales* e *Kreştan* ngase shkronja “ş” e turqishtes korespondon me shkronjën “sh” të gjuhës shqipes. Përderisa shkronja “j” e shqipes korespondon me shkronjën “y” të turqishtes atëherë emrat e fshatrave *Kurjan*, *Grabjan*, *Peskopije* dhe *Novanij* shfaqen me formën *Kuryan*, *Grabyan*, *Peskopije* dhe *Novany*.

- Fshati Pindarhundiye > Perhondia¹⁰ > Perondi / Perondi / Kuçovë / Berat;
- Fshati Kuçe > Kuç / Gjerbë / Skrapar / Berat;
- Fshati Hottove > Hotovë / Përmet;
- Fshati Rozhnik (Rojnik) > Roshnik / Roshnik; Berat;
- Fshati Velishte (Velište) / Korçë;
- Fshati Bobza > Bubëz¹¹ / Përmet;
- Fshati Istruman > Strum / Fier;
- Fshati Drenove > Dranove / Vertop / Berat;
- Fshati Krushove (Krušove) > Kurshovë / Korçë;
- Fshati Verbe > Verbas / Fier;
- Fshati Lavdani > Lavdanj > Lavdan / Mallakastër / Fier;
- Fshati Odričani > Odrican / Përmet;
- Fshati Ribani > Ribanj > Ribanj / Përmet;
- Fshati Polani > Bolani¹²;?
- Fshati Kurjan (Kuryani) / Fier;
- Fshati Luveri > Luar / Fier;
- Fshati Korican > Goričan¹³ / Kutalli / Berat;
- Fshati Hlamerzi? > Hallambres > Allambres / Cukalat / Berat;
- Fshati Kigan > Gjeqar? > Ngjeqar / Fier;
- Fshati Pistovice > Bestrovicë? (-) / Kuçovë / Berat;
- Fshati Dranovice > Dranovicë / Elbasan;
- Fshati Klos / Elbasan;
- Fshati Apanahore > Panahor / Mallakastër / Fier;
- Fshati Rahove > Rehovë / Gjerbë / Skrapar / Berat;
- Fshati Vokopoli > Vokopolë / Terpan / Berat;
- Fshati Novasilo > Novosel > Novosellë / Kërçovë;
- Fshati Viçeni > Viçen / Korçë;
- Fshati Mashkullori (Maşkullori) > Mashkullorë / Cepo / Gjirokastër;
- Fshati Grabjan (Grabyan) / Lushnje / Fier;

¹⁰ Derisa në defter është i regjistruar me emrin *Pindarbundiye* sipas transkriptimit të autorit Halil İnançık (1987) në hartë e gjejmë me emrin *Perhondia*. Ami Boué, udhëtar francez, po të njëjtin fshat e paraqet me format: *Prékonandrisë* > *Perbondisë* (Myzeqari 2012:74).

¹¹ Fshati i bashkuar *Bubëz* prishet dhe fshatrat e tij: Beqaraj, Bubësi i dhe Bubësi II lidhen me fshatin e bashkuar me qendër në Ballaban (Dekret / Nr.5131/ Datë: 4.12.1973).

¹² Në defter thuhet se nuk është gjetur një fshat i tillë (İnanılcık 1987:60).

¹³ Në regjistër të fshatrave të komunës së Kutallit të Beratit ekzistojnë dy fshatra Goričan dhe Goričan Çlirim.

- Fshati Kakosi > Kakos / Çepan / Skarpar / Berat;
- Fshati Mavromat / Janinë;
- Fshati Krushove (Kruşove) > Krashovë / Gjirokastër;
- Fshati Dobronik > Dobrenik > Dobronik / Velabisht / Berat;
- Fshati Velkoplaz > Vokopolë / Terpan / Berat;
- Fshati Bushine (Buşine)¹⁴ > Poshnjë / Poshnjë / Berat;
- Fshati Vlosh (Vloş) / Fier;
- Fshati Karkanos > Karkanjoz / Roshnik / Berat;
- Fshati Peskopije (Peskopiye) / Skrapar / Berat;
- Fshati Livan / Levani Plakut > Levan¹⁵ / Sinje / Berat;
- Fshati Shalë (Şales) / Tepelenë;
- Fshati Syrzi (Sürzi) > Syzez / Poshnje / Berat;
- Fshati Kreshtani (Kreştani) / Kreshtan / Çamëri;
- Fshati Frate > Bratilë / Korçë;
- Fshati Novanij (Novaniy) / Kurvelesh.

Fshati *Syzez* do të thotë sy zi (Myzeqari 2012:104); po i njëjti fshat në shek. XV quhej *Syrzi* (syr-i > sy nga trajta e shquar e emërores ka kaluar në të pashquarën, si dhe mbiemri i është përshtatur emrit syr-i i zi > sy zezë). Disa fshatra që e ekzistojnë edhe sot i takojnë onomastikës greke si: *Petrobondi* (Pendahondia; vjen nga gr. pend = pesë dhe arkond = shenjtore), *Mallakastër* (Omalokastra; omalos = e mirëmbajtur dhe kástro = kala), *Ballsbi* (Bylis) etj. (Myzeqari 2012:154). Fshati *Roshnik* e ka marrë emrin prej një lloj fikut që e solli nga Turqia Liko Qypriliu (1620), fik i cili kultivohet edhe sot e asaj dite. Mirëpo një emërtim i tillë, i fshatit Roshnik, nuk mund të qëndroj derisa ky fshat e kishte po këtë emër edhe në vitet 1431-1432. Fshati *Dobronik* e ka marrë emrin në bazë të rrethanave të vendit që ka, vend me dushqe - dushkajë (Nallbani 2009:79).

Në vitet 1431-1432 numëri i fshatrave të Vilajetit të Beratit sipas librit të “Regjistrin të Sanxhakut Arvanid” është 122 fshatra, nuk dihet nëse që të gjitha janë fshatra apo vetëm pjesë e një fshati. Prej numrit të përgjithshëm që janë të regjistruar në libër, 48 fshatra na shfaqen edhe sot, numri i tyre mund të jetë edhe më i madh. Faktorët që ndikuan që t’i fitojmë këto rezultate janë pamundësia e transkriptimit të disa prej fshatrave që janë në regjistrin e vitit 1431-1432, ndikimi i rotacizmit, si dhe

¹⁴ Autori İnanıcık (1987:69) shton si shënim se emërtimin e këtij fshati e gjejmë edhe si *Pistrovic* dhe *Pishova*.

¹⁵ Sipas Dekretit (Nr.5131/ Datë: 4.12.1973) qyteti i Beratit ndahet në 9 lagje. Fshati *Mali-bardhë* prishet dhe banorët e tij lidhet me fshatin *Velçan* të fshatit të bashkuar *Levan-Park*.

disa elemente sllave që kanë pasur ndikim që i njëjti fshat të na del me dy trajta (p.sh.: Ismokina dhe Ismoktina). Në anën tjetër gjatë studimit ndikim të madh ka pasur mungesa e shumë fshatrave që janë përmendur në librin e regjistrit por që kanë munguar në hartën e Herbet Louis-it, e cila është përdorur për verifikim nga transkriptuesi Halil Inalcik.

Qarku i Beratit	Rrethi i Beratit	12 fshatra apo 25%	18 fshatra apo 37.5%
	Rrethi i Skarparit	4 fshatra apo 8.33%	
	Rrethi i Kuçovës	2 fshatra apo 4.16%	
Qarku i Fierit	Rrethi i Fierit	10 fshatra apo 20 %	10 fshatra apo 20%
Qarku i Gjirokastrës	Rrethi i Gjirokastrës	2 fshatra apo 4.16 %	8 fshatra apo 16.17%
	Rrethi i Përmetit	4 fshatra apo 8.33%	
	Rrethi i Tepelenës	1 fshat apo 2.08%	
	Rrethi i Kurveleshit	1 fshat apo 2.08%	
Qarku i Korçës	Rrethi i Korçës	4 fshatra apo 8.33%	4 fshatra apo 8.33%
Qarku i Elbasanit	Rrethi i Elbasanit	3 fshatra apo 6.25%	3 fshatra apo 6.25%
Qarku i Kërçovës	Rrethi i Kërçovës	1 fshat apo 2.08%	1 fshat apo 2.08%
Qarku i Çamërisë	Rrethi i Çamërisë	1 fshat apo 2.08%	1 fshat apo 2.08%
Qarku i Janinës	Rrethi i Janinës	1 fshat apo 2.08%	1 fshat apo 2.08%
Gjithsej			47 fshatra¹⁶

Tabela 1. Fshatrat e gjetur sot në qarkun e Beratit dhe në qarqet e tjera përreth (sipas të dbënave të vitit 2013)

Bibliografia:

Çabej Eqrem. 1987. Studime gjuhësore IV. Prishtinë. Rilindja.

Çabej Eqrem. 1988. Studime gjuhësore V. Prishtinë. Rilindja

Çelebi Evliyâ. 2010. Günümüz Türkçesiyle Evliyâ Çelebi Seyhatnâmesi V. Stamboll. YKY.

¹⁶ Dy prej fshatrave (Polani dhe Peskopije) janë të verifikuar se sot nuk ekzistojnë më, ndërsa për fshatrat Bahtal dhe Pistovice autori Inalcik ka vënë shënjen e pikëpyetjes, mirëpo që të katërta gjenden edhe në hartën e vitit 1431.

- Demiraj Bardhyl. 2014. Shqiptar dhe shqa (Histori popujsh përmes dy emrave etnikë). Tiranë. Naimi.
- Demiraj Shaban. 1988. Gjuha shqipe dhe historia e saj. Tiranë. Mihal Duri.
- Demiraj Shaban. 1996. Fonologjia historike e gjuhës shqipe. Tiranë. TOENA.
- Hamp Eric P. 2007. Studime krahasuese për shqipen. Prishtinë. ASHAK.
- Ismajli Rexhep. 1985. Gjuha shqipe e Kuvendit të Arbënit (1706). Prishtinë. Rilindja.
- İnalçık Halil. 1987. Sûret-i Defter-i Sancak-i Arvanid (Hicrî 835 Tahili). Ankara. TTKB.
- Myzeqari Dhimitër. T. 2012. Qyteti që magjepsi udhëtarët. Tiranë. West Print.
- Nallbani Ajeti. 2009. Berati, kronika e jetës qytetare. Berat. AEDA.
- Pedersen Holger. 2003. Studime për gjuhën shqipe. Prishtinë. ASHAK.
- Pulaha Selami. 1974. Defteri i Regjistrimit të Sanxhankut të Shkodrës i Vitit 1485. Tiranë. ASHSHA.
- Rugova Bardh. 2013. *Ndikimi i shumëfjshhtë i Rexhep Ismajlit në gjuhësinë shqiptare*. Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare XXXII. Prishtinë.
- Иванов Иван Танев. Топоними Доказательства за Етимологията на Българския Етноним, marrë në: <http://www.protobulgarians.com>

SESIONE

Shkumbin MUNISHI

SHQIPJA DHE ANGLISHTJA NË PEIZAZHIN LINGUISTIK TË PRISHTINËS

Abstrakt

Raportet gjuhësore si manifestime të dukurisë së shumëgjuhësisë shprehen edhe në fushën e asaj që është quajtur peizazh gjuhësor ose panoramë gjuhësore. Padyshim, peizazhi gjuhësor jo vetëm që pasqyron përdorimin e gjuhëve në hapësira publike, por njëkohësisht shpërfaq edhe thellësinë e perceptimit publik të gjuhëve të ndryshme, varësisht prej funksionit dhe prej prestigjit të tyre. Në këtë punim, do t'i trajtojmë raportet e shqipes dhe të anglishtes nëpërmjet pasqyrimit të tyre në peizazhin linguiistik të Prishtinës, duke u përqendruar në përdorimin e këtyre dy gjuhëve në hapësirat reklamuese në qytetin e Prishtinës dhe në tabelat e tjera që kryejnë funksione semiotike indeksore në këtë qytet. Po ashtu, në kuadër të reflektimit të planifikimit të gjuhëve në peizazhin gjuhësor të Prishtinës do të trajtohet edhe përdorimi i serbishtes në tabelat zyrtare. Ky studim rasti do t'i pasqyrojë edhe tiparet e politikës gjuhësore dhe ndikimin e dukurisë së globalizimit në gjuhët e ndryshme. Rezultat e paraqitura në këtë punim do ta reflektojnë hulumtimin e kryer në terren në brenda një prerjeje kohore të caktuar. Hulumtimi ka dëshmuar se në peizazhin gjuhësor të Prishtinës, krahas gjuhës shqipe, edhe anglishtja ka një përdorim të dendur, ndërkaq përdorimi i serbishtes është i kufizuar kryesisht në tabela zyrtare që i emërtojnë rrugët e qytetit dhe nuk gjendet në tabela e reklama private.

Fjalët kryesore: *peizazh gjuhësor, njësi të peizazhit gjuhësor, politikë gjuhësore, planifikim i gjuhëve, shqipja, serbishtja, anglishtja.*

Hyrje

Përdorimi i gjuhëve në funksione të ndryshme dhe raportet gjuhësore si manifestime të dukurisë së shumëgjuhësisë dhe të kontakteve të gjuhëve, shprehen edhe në peizazhin gjuhësor të bashkësive shoqërore të ndryshme që jetojnë brenda një territori të caktuar. Sa i përket përkufizimit të konceptit të peizazhit gjuhësor, Laundry dhe Bourhis kanë dhënë këtë përkufizim që është gjerësisht i përmendur: “Gjuha e


shenjave publike të rrugëve, tabelat e mëdha reklamuese, emrat e rrugëve, emrat e vendeve, shenjat e dyqaneve tregtare dhe shenjat publike në ndërtesat qeveritare kombinohen për të formësuar peizazhin gjuhësor të një territori, regjioni ose zone urbane të caktuar” (Laundry dhe Bourhis 1997: 25). Autorët e përmendur theksojnë më tej se peizazhi gjuhësor i një territori kryen dy funksione themelore: funksionin informues dhe atë simbolik (ibid.) Një karakteristikë e rëndësishme e peizazhit gjuhësor është se ai është i përbërë edhe nga shenjat "private", edhe ato "publike": shenjat e lëshuara nga autoritetet publike (si qeveria, komunat apo agjencitë publike), në njëërën anë, dhe, në anën tjetër, shenja të lëshuara nga individë, shoqata apo firmat që veprojnë pak a shumë në mënyrë autonome në kufijtë e autorizuar nga rregulloret zyrtare (Leclerc 1989, cit sipas Laundry dhe Bourhis 1997; Ben Rafael dhe Shohamy, f 8). Në këtë kuptim, Backhaus bën dallimin midis shenjave zyrtare dhe jozyrtare (Backhaus 2006: 53), ndërsa Calvet (cit, sipas Backhaus ibid.) i ka quajtur këto dy lloje të shenjave si përbërës ‘in vitro’ dhe ‘in vivo’ të peizazhit gjuhësor.

Peizazhi gjuhësor ndërtohet me mjete gjuhësore që janë në përdorim brenda një territori të caktuar dhe që mund t’u takojnë sistemeve të ndryshme gjuhësore. Njësitë e peizazhit gjuhësore mund të gjenden në tabela që emërtojnë rrugët, në tabela që emërtojnë institucionet, në reklama që publikohen në afishe e në pllakate, në tabela të ndryshme elektronike të ndriçueshme e madje edhe në grafitë që janë të shkruara në muret e ndërtesave të ndryshme. Me fjalë të tjera, me të dalë në rrugë, njësitë e peizazhit gjuhësor të një hapësire a territori, janë menjëherë të vërejtura nga syri i njeriut. Në përgjithësi, peizazhi gjuhësor jo vetëm që pasqyron përdorimin dhe vendin e gjuhëve në hapësira publike, por njëkohësisht shpërfaq edhe thellësinë e perceptimit publik të gjuhëve të ndryshme dhe qëndrimet ndaj tyre, varësisht prej funksionit dhe prej prestigjit të hapur a të mbuluar të tyre. Ai njëkohësisht reflekton përdorimin e gjuhëve në sferën publike. Ndryshe, sipas Cenoz dhe Gurter (2006), peizazhi gjuhësor e reflekton marrëdhënien me kontekstin sociolinguistik të një hapësire të caktuar. Kjo marrëdhënie sipas tyre është dydrejtëshe. Në njëërën anë, peizazhi gjuhësor reflekton fuqinë relative dhe statusin e gjuhëve në një kontekst specifik sociolinguistik. Në anën tjetër, peizazhi gjuhësor kontribuon në ndërtimin e kontekstit sociolinguistik, sepse njerëzit i përpunojnë informatat vizuale që vijnë tek ata dhe gjuha me të cilën janë të shkruara shenjat mund të ndikojë në perceptimin e tyre të statusit të gjuhëve të ndryshme e madje të ndikojë në sjelljen e tyre gjuhësore. Studimi i peizazhit gjuhësor mund të jetë me interes edhe për arsye se mund të japë informata lidhur me dallimet midis politikës gjuhësore zyrtare, e cila mund të reflektohet në shenjat nga lart-poshtë (shenjat publike, sh.m.), siç janë emrat e rrugëve ose emërtimet në ndërtesat zyrtare, dhe ndikimin e kësaj politike tek individët, siç reflektohet në shenjat nga poshtë-lart që

mund të jenë emrat e dyqaneve dhe pllakatet dhe afishet në rrugë (shenjat private, sh.m.) (f. 67-68).

Në këtë punim do të trajtojmë përdorimin dhe raportet e shqipes dhe të anglishtes nëpërmjet pasqyrit të tyre në peizazhin linguiistik të Prishtinës në sferën publike dhe në atë private. Në vëzhgim është përfshirë po ashtu edhe gjuha serbe si gjuhë që ka status zyrtar në Kosovë bashkë me shqipen. Përdorimi, raportet dhe funksionet e shqipes dhe të anglishtes do të trajtohen në dritë të dukurisë së globalizimit dhe të politikës gjuhësore në Kosovë, ndërkaq përdorimi i serbishtes, kryesisht në tabela publike, do të trajtohet brenda kuadrit të politikës dhe të planifikimit të statusit të gjuhëve në Kosovë. Një punim që trajton mospërputhjen ndërmjet politikës gjuhësore dhe përdorimin e gjuhëve në peizazhin gjuhësor në Prishtinë e kemi nga Demaj dhe Vandembroucke (2013). Në këtë punim çështja e reflektimit të politikës gjuhësore në peizazhin gjuhësor të Prishtinës do të jetë në plan të dytë dhe do të merret parasysh vetëm në rastet që ndërlidhen me përdorimin dhe me raportet midis shqipes dhe serbishtes, pasi interesimi ynë ka qenë të shihet përdorimi i shqipes dhe i anglishtes. Hulumtimi është bazuar mbi hipotezën se anglishtja si gjuhë e proceseve të globalizimit do të dalë e përdorur dendur edhe në peizazhin gjuhësor të Prishtinës.

Duhet theksuar se në këtë hulumtim njësitë e peizazhit gjuhësor janë ndarë në dy kategori të përgjithshme, në njësi publike të peizazhit gjuhësor dhe në njësi private të peizazhit gjuhësor, dhe në bazë të kësaj ndarjeje është kryer hulumtimi. Hulumtimi është kryer nga mesi i muajit korrik deri në mes të gushtit 2015 dhe si mostër janë marrë të gjitha reklamat e dukshme, tabelat e komunikacionit dhe tabelat e tjera, si dhe të gjitha njësitë e dukshme të shkruara të dyqaneve dhe të hapësirave të tjera në anën e djathtë përgjatë Bulevardit Dëshmorët e Kombit, Bulevardit Xhorxh Bush, Sheshit Zahir Pajaziti dhe Bulevardit Nëza Terezë. Për ta bërë hulumtimin është përdorur kamera e iPhone 6+ për t'i fotografuar njësitë e peizazhit gjuhësor në Prishtinë. Në përgjithësi janë bërë 226 fotografi me të cilat i kemi shënuar 214 njësi të peizazhit gjuhësor (PGJ).



Harta e shtirjes së rrugëve ku janë mbledhur mostrat


1. Njësitë publike të peizazhit gjuhësor të Prishtinës

Në kategorinë e njësive publike të peizazhit gjuhësor të Prishtinës kemi shënuar në tërësi 31 njësi të PGJ-së. Nga kjo shumë e përgjithshme, 5 njësi kanë qenë të shkruara vetëm në gjuhën shqipe ose 16.1%, 18 ose 58% kanë qenë të shkruara në shqipe dhe në serbishte, 4 njësi ose 12.9% kanë qenë të shënuara në shqipe dhe në anglishte, ndërkaq 2 njësi ose 6.4% kanë qenë të shkruara në të tri gjuhët shqip-serbisht-anglisht. Në kuadër të njësive publike të PGJ-së kemi gjetur vetëm 2 njësi ose 6.4% që kanë qenë të shkruara vetëm në gjuhën angleze dhe ç'është e vërteta këto njësi kanë qenë tabela komunikacioni që ka treguar drejtimin e vendndodhjes së hotelit privat.

Shqip	Shqip-Serbisht	Shqip-Anglisht	Shqip-Serbisht-Anglisht	Anglisht
5	18	4	2	2
16.1%	58%	12.9%	6.4%	6.4%

Tabela 1: njësitë publike të PGJ

Në bazë të të dhënave të mësipërme mund të konstatojmë se pjesa më e madhe e njësive publike të PGJ janë shënuar në dy gjuhët zyrtare të Kosovës, pra në shqipe dhe në serbishte. Kjo është bërë në përputhje me statusin juridik të këtyre gjuhëve (Munishi 2006) dhe me politikën e hapur gjuhësore (overt language policy) që mbretëron në Kosovë. Duhet theksuar se në të gjitha rastet e tabelave dygjuhëshe shqip-serbisht, në të dy gjuhët kanë qenë të shënuara vetëm shkurtesat *Rr./Ul.* (rruga, ulica) dhe emërtimet *Bulevardi/Bulevar*, ndërkaq emërtimet duke qenë se kanë qenë në shqipe janë shkruar me grafi të shqipes, por konsiderojmë se janë të kuptueshme edhe në gjuhën serbe.



Grafiku 1

Dy njësitë e vetme të PGJ, të cilat kanë qenë të shkruara në të tri gjuhët kanë qenë tabelat zyrtare me emërtimet e institucioneve të Qeverisë së Kosovës. Bëhet fjalë për emërtimet zyrtare të shënuara në tabela të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural. Çështje e vërteta në të dy këto tabela zyrtare emërtimi “*Republika e Kosovës*” ka qenë i shënuar me shkronja më të mëdha sesa emërtimet në gjuhën serbe dhe në gjuhën angleze. Nën këtë emërtim kanë qenë pastaj të shënuara emërtimet e ministrive në shqipe, në serbishte dhe në anglishte me shkronja të barabarta. Njësitë në shqipe dhe në anglishte janë gjetur vetëm në tabela të Universitetit të Prishtinës.

2. Njësitë private të peizazhit gjuhësor të Prishtinës


Në kategorinë e njërive private të peizazhit gjuhësor janë përfshirë gjithsej 183 njësi të ndryshme. Nga kjo shumë 18 njësi kanë qenë emra firmash (brand names), të cilat kur kanë qenë fjalë të vetme pa shpjegime shtesë nuk janë përfshirë në analizë gjuhësore.

Shqip	Anglisht	Shqip-Anglisht	Firma
53	30	82	18
28.9%	16.3%	44.8%	0.98%

Tabela 2: njësitë private të PGJ

Në bazë të këtyre të dhënave të mbledhura kemi konstatuar se nga 183 njësi të PGJ, 53 ose 28.9% kanë qenë njësi të shkruara vetëm në shqipe, ndërkaq 30 ose 16.3 njësi kanë qenë të shkruara vetëm në anglishte. Pjesa më e madhe e njësive të PGJ-së kanë qenë të shkruara në shqipe dhe në anglishte, pra ka ndodhur përzierja e kodeve (Huebner 2006). Në këtë kategori kemi përshirë të gjitha ato njësi në të cilat ka pasur së paku një element të shqipes apo të anglishtes. P.sh. si njësi e përzier është konstatuar edhe ndonjë njësi që në tekstin e shkruar në gjuhën shqipe ka pasur qoftë edhe një logogram *apersand* & që është karakteristik për anglishten (zëvendëson përdorimin e lidhëzës *and*) dhe anasjelltas, njësi e përzier është konsideruar edhe ndonjë njësi që ka qenë e shkruar në anglishte, por që ka pasur një pjesë në shqipe, qoftë edhe në formë të nofkës së ndonjë personi. Së këndejmi, në 183 njësi të PGJ kemi gjetur 82 që kanë qenë të shkruara në shqipe dhe në anglishte ose 44.8%. Këtu të shtojmë se për 2 njësi gjuhësore nuk kemi arritur të kuptojmë se çfarë shënojnë dhe i kemi kategorizuar në fushën e emërtimeve të firmave.

Në përgjithësi, këto të dhëna janë dëshmi e qartë e përdorimit shumë të madh të anglishtes në njësitë e PGJ, të cilat ndërtojnë sferën publike në Prishtinë. Duhet theksuar se sa i përket gjuhës shqipe, në njësitë e PGJ-së të shkruara në shqipe janë përdorur edhe gjuha standarde, edhe vernakulari i bazuar në dialektin lokal të gegërishtes. Ky i fundit është përdorur sidomos në reklama të caktuara. Në përgjithësi, nuk mund të thuhet se ka pasur një zbatim konciz të normës së shqipes standarde.




Grafiku 2

Më tej, njësitë e PGJ i kemi klasifikuar në katër kategori të përgjithshme. Në kategorinë e parë, të cilën e kemi quajtur “*ushqime dhe kafeteri*”, kemi përfshirë restorantet, kafeterit, hotelet e kështu me radhë. Në kategorinë e dytë, që e kemi quajtur “*shërbime*”, kemi përfshirë një gamë të gjerë të dyqaneve të veprimtarive të ndryshme të karakterit shërbyes. Në këtë kategori janë përfshirë: bankat, kompanitë e sigurimeve, dyqanet e veshmbathjeve, shërbimet e avokatëve, shërbimet e ndërtimit, zyrat për shitblerjen e pronave dhe të pasurive të paluajtshme e kështu me radhë. Në kategorinë e tretë, të cilën e kemi quajtur “*komunikim dhe teknologji informacioni*”, kemi përfshirë të gjitha ato dyqane që shesim dhe ofrojnë shërbime nga fusha e teknologjisë së informacionit dhe të telefonisë mobile. Ndërkaq, në kategorinë e katërt, që e kemi quajtur “*mjekësi*”, kemi përfshirë ato hapësira që ofrojnë shërbime mjekësore.

Në kategorinë e parë “*ushqime dhe kafeteri*” janë përfshirë 38 njësi të PGJ-së. Nga këto 38 njësi, numri më i madh i tyre ose 18 (47.3%) kanë qenë në shqipe edhe në anglishte. 10 njësi ose 26.3% kanë qenë të shkruara vetëm në anglishte, 7 ose 18.4% kanë qenë vetëm në shqipe, ndërsa 3 kanë qenë emërtime të firmave. Këto të dhëna dëshmojnë qartë që në fushën e ushqimeve, kafeterive dhe argëtimit anglishtja është gjuhë dominuese në raport me shqipen.

Shqip	Anglisht	Shqip-Anglisht	Firma
7	10	18	3
18.4%	26.3%	47.3%	7.8%

Tabela 3: ushqime dhe kafeteri




Grafiku 3

Në kategorinë e “shërbimeve” kanë qëlluar për ko incidencë të jenë të përfshira 100 njësi të PGJ-së. Nga kjo shumë e përgjithshme, 28 kanë qenë në gjuhën shqipe (28%), 18 (18%) kanë qenë në anglishte, 42 kanë qenë në shqipe dhe në anglishte dhe 12 kanë qenë emërtime të firmave që nuk i kemi marrë në konsideratë.

Shqip	Anglisht	Shqip-Anglisht	Firma
28	18	42	12
28%	18%	42%	12%

Tabela 4: shërbime

Edhe në këtë kategori vërehet qartazi se pjesën më të madhe e përbëjnë njësitë dygjuhëshe shqip-anglisht, pastaj vijnë njësitë një gjuhën shqipe dhe në fund njësitë një gjuhën angleze. Në këtë fushë shqipja dhe anglishtja na paraqiten në përdorim pothuajse të barabarta.




Grafiku 4

Në kategorinë e tretë “komunikim dhe teknologji e informacionit” kemi gjetur këto të dhëna. Nga shuma e përgjithshme prej 22 njësish që i kemi veçuar në këtë kategori, vetëm nga një njësi kanë qenë të shkruara në gjuhën shqipe dhe në gjuhën angleze, ndërkaq 20 të tjera kanë qenë njësi ku janë gjetur të shënuara dhe të kombinuara të dyja gjuhët.

Shqip	Anglisht	Shqip-Anglisht
1	1	20
4.54%	4.54%	90.9%

Tabela 5: komunikim dhe teknologji e informacionit

Kjo fushë ka qenë njëra nga fushat në të cilat shqipja dhe anglishtja janë paraqitur të përdorura edhe në forma hibride, qoftë në formë të kompozitave hibride, qoftë në formë të sintagmave hibride. Aq më tepër, në këtë fushë janë gjetur mjaft raste të kombinimit të kodeve të shqipes dhe të anglishtes dhe në fjali, por edhe përdorime paralele. Pra, kjo ka qenë kategoria në të cilën përzjerja e kodeve është shfaqur si dukuri e qëndrueshme.




Grafiku 5

Në kategorinë e fundit “mjekësi” kemi përfshirë ato njësi të PGJ-së që janë gjendur në hapësira që ofrojnë shërbime mjekësore. Në përgjithësi, kemi gjetur 21 njësi të tilla të peizazhit gjuhësor, nga të cilat pjesa më e madhe e tyre (15 ose 71.4%) kanë qenë në gjuhën shqipe, ndërsa 5 ose 23.8% kanë qenë në dy gjuhë shqip dhe anglisht dhe vetëm një ka qenë emërtim i një firme. Në këtë kategori nuk kemi gjetur asnjë rast të ndonjë njësie të PGJ që ishte vetëm në gjuhën angleze.

Shqip	Anglisht	Shqip-Anglisht	Firma
15	0	5	1
71.4%	0%	23.8%	4.7%

Tabela 6: mjekësi

Të dhënat nga fusha mjekësisë e njësive të PGJ-së tregojnë një mbizotërim të gjuhës shqipe dhe për një numër relativ të njësive dygjuhëshe. Çështje e vërteta edhe në këtë fushë shqipja nuk del krejtësisht e vetme, pasi edhe në ndërtime që janë në shqipe ka përdorime të njësive gjuhësore latine, të cilat shpeshherë dalin si shkurtesa terminologjike. Por, është e qartë që anglishtja në këtë kategori nuk na del të jetë e përdorur si gjuhë e vetme, për dallim nga kategoritë e mësipërme ku gjejmë mjaft raste të tilla.



Grafiku 6

Përfundime

Hulumtimi i peizazhit gjuhësor të Prishtinës ka pasqyruar një përdorim pothuajse paralel të shqipes dhe të anglishtes në njësitë e peizazhit gjuhësor, sidomos në ato private. Dukuria e globalizimit, e cila përveç karakterit ekonomik, mund të konsiderohet edhe si dukuri shoqërore e kulturore, padyshim ka ndikuar në përhapjen dhe në përdorimin e anglishtes nëpër botë dhe për rrjedhojë edhe në Kosovë (Munishi 2015). Në bazë të njërive të trajtuara në hulumtim kemi konstatuar se anglishtja përdoret sidomos në ato fusha që janë të prekura nga dukuria e globalizimit, siç janë: teknologjia e informacionit dhe komunikimi, shërbimet financiare, bankare e ligjore, ushqimet, kateterit dhe argëtimi, veshmbathjet dhe moda, si dhe shërbime të tjera të natyrës estetike. Po ashtu, në bazë të këtij hulumtimi kemi konstatuar se përdorimi i anglishtes është më i kufizuar në shërbimet mjekësore. Në bazë të këtyre gjetjeve mund të konstatojmë se ndikimi i anglishtes si gjuhë e globalizimit është jashtëzakonisht i theksuar në sferën publike, gjë që reflektohet edhe me përdorimin e dendur të saj, krahas shqipes, në peizazhin gjuhësor.

Në anën tjetër, në njësitë publike të peizazhit gjuhësor është reflektuar më shumë politika gjuhësore e hapur dhe janë zbatuar dispozitat që ndërlidhen me zbatimin e funksioneve të gjuhëve në kuadër të planifikimit të statusit të gjuhëve në Kosovë, ndonëse edhe në këtë fushë shqipja duket me dominuese. Në këtë fushë ka

një përdorim edhe të serbishtes, ndërkaq përdorimi i anglishtes del si rezultat i një statusi ekstraterritorial që ka anglishtja jo vetëm në Kosovë, por edhe në shumë vende të tjera të botës, si gjuhë dominuese dhe një *lingua franca* e rangut botëror.

Sa i përket shqipes, ajo del e përdorur në dy varietete të saj, edhe në shqipen standarde, edhe në vernakularin lokal, dhe nuk mund të thuhet se ka një zbatim konciz të normës drejtshkrimore. Ndryshe, ka hapësirë për hulumtime të mëtejme të strukturës gjuhësore të njësisë të peizazhit gjuhësor jo vetëm në Prishtinë, por edhe në qytetet e tjera shqiptare.

Krejt në fund, mund të thuhet se hulumtimi ka dëshmuar se në peizazhin gjuhësor të Prishtinës janë realizuar edhe funksionet informuese edhe ato simbolike të gjuhëve të përdorura. Po ashtu, hulumtimi ka pasqyruar dhe raportin e fuqisë shoqërore të gjuhëve që janë ndeshur në PGJ. Në këtë kuadër, statusi shoqëror i shqipes del i konsoliduar, anglishtja del e fuqizuar falë statusit të gjuhës globale që e ka, ndërkaq serbishtja del me një status më pak të favorshëm. Në raportet midis shqipes dhe serbishtes kanë dominuar faktorët demografik dhe përbërja e popullsisë së qytetit të Prishtinës, sidomos e pjesës qendrore të tij.

Referencat

- Backhaus, Peter (2006). Multilingualism in Tokyo: A Look into the Linguistic Landscape. *Linguistic Landscape. A New Approach to Multilingualism*. Edited by Durk Gorter. Multilingual matters LTD. Clevedon. Buffalo. Toronto.
- Cenoz, Jasone and Gorter, Durk (2006). *Linguistic Landscape and Minority Languages*. *Linguistic Landscape. A New Approach to Multilingualism*. Edited by Durk Gorter. Multilingual matters LTD. Clevedon. Buffalo. Toronto.
- Demaj, Urela dhe Vandenbroucke, Mieke (2013). *Linguistic Landscapes and Language Visibility: The Discrepancy between the Official Language Policy and the Linguistic Reality in the case of Pristina, Kosovo*. Masterproef. Universiteit Gent. Faculteit Letteren & Wijsbegeerte. Academiejaar 2012-2013. Në internet: http://www.google.com/url?sa=t&rct=j&q=&esrc=s&source=web&cd=1&ved=0ahUKEwjY9ImcgsLJAhWJwHIKHQbKBm8QFggcMAA&url=http%3A%2F%2Flib.ugent.be%2Ffulltxt%2FRUG01%2F002%2F060%2F283%2FRUG01-002060283_2013_0001_AC.pdf&usq=AFQjCNF2YBrmD3XbFRhRFrjkbhjYMkJIw, qasja e fundit më 2 dhjetor 2015.
- Huebner, Thom (2006). *Bangkok's Linguistic Landscape: Environmental Print, Codemixing and Language Change*. *Linguistic Landscape. A New Approach to*

- Multilingualism. Edited by Durk Gorter. Multilingual matters LTD. Clevedon. Buffalo. Toronto.
- Linguistic Landscape. A New Approach to Multilingualism (2006). Edited by Durk Gorter. Multilingual matters LTD. Cleedon. Buffalo. Toronto. 2006.
- Rodrigue, Landry and Bourhis, Richard Y. (1997). Linguistic Landscape and Ethnolinguistic Vitality. *Journal of Language and Social Psychology* 16:23. Mar 1, 1997. <http://jls.sagepub.com>
- Munishi, Shkumbin (2006). Probleme të shqipes standarde në Kosovë. ZeroPrint. Prishtinë. 2013.
- Munishi, Shkumbin (2015). Shqipja në epokën e globalizimit. ZeroPrint. Prishtinë.

Milote SADIKU

MODIFIKIMET E NJËSIVE FRAZEOLGJIKE ME EMËRTIME TË KAFSHËVE NË TEKSTET E GAZETAVE DITORE

1. Hyrje

Objekt studimi i këtij punimi janë frazeologjizmat me emërtime të kafshëve¹ të gjuhës shqipe. Ky punim ka për qëllim hulumtimin e shpërndarjes së njësive frazeologjike në tekstet e gazetave të përditshme dhe modifikimet që i pësojnë ato gjatë përdorimit. Korpusin për këtë hulumtim e përbëjnë frazeologjizmat me emërtime të kafshëve, të cilët janë nxjerrë nga tekstet e gazetave ditore për periudhën e caktuar kohore dhe janë klasifikuar në frazeologjizma me përdorim uzual (të zakonshëm, “*usuell*”) dhe në ata të modifikuar. Frazeologjizmat e modifikuar pastaj do të klasifikohen më tutje sipas llojit dhe tipit të modifikimit.

Korpusi është nxjerrë nga gazetave ditore “ZËRI” dhe “GAZETA SHQIP”, nga tekstet që kishin qasje të lirë në internet. Si është gjetur njësia frazeologjike në tekstet publicistikë? Është dhënë një fjalë nga njësia frazeologjike, p.sh. fjala *macja* dhe fjala *miu* për të kërkuar për njësinë *luan me të si macja me miun* në tekst. Vëmendje më e madhe i është kushtuar tipave dhe llojeve të modifikimit të këtyre njësive frazeologjike, si dhe përdorimit më të shpeshtë të emërtimeve të kafshëve në njësitë frazeologjike.

Burger (1999:77-78) thekson që është vërtetuar përmes gjetjeve statistikore që tekstet e gazetave janë posaçërisht të pasura me frazeologjizma, por që numri i tyre

¹ Grupi i “emërtimeve të kafshëve” është një grupim tematik, që ndahet sipas një parimi onomasiologjik. Në materialin hulumtues të këtij punimi është futur edhe leksiku animal me karakter të mbirenditur, p.sh. *kafshë-a*, *zog-u*, *peshk-u*, Kafshët që bëjnë pjesë në frazeologjinë shqipe – si edhe në gjuhët tjera – nga aspekti zoologjik i përkasin kategorive të ndryshme sistematike (p.sh. bagëtisë, maceve, zogjve, qenve, zvarranikëve, insekteve etj.). Ndërsa në lidhje me „hapësirën e tyre (natyrore) jetësore“, varësisht nga afërsia gjegjësisht largësia ndaj hapësirës jetësore të njerëzve, do të mund të ndaheshin në „kafshë shtëpiake“, „kafshë të pyllit e të fushës“, „kafshë ekzotike“, bile edhe në „kafshë mitologjike“ (krh. Schauer-Trampusch 2002: 58). Për shkak të vëllimit të madh dhe të shumëllojshmërisë së njësive frazeologjike me emërtime të kafshëve, nuk është për t'u çuditur që në frazeologjinë e gjuhëve të ndryshme ekziston një interesim i vazhdueshëm për t'u hulumtuar këto njësi.

ndryshon varësisht prej gazetave dhe prej llojit të teksteve. Ndërsa, sa i përket funksionit të frazeologjizmave, ai bën dallim në mes të funksioneve që mund të kenë frazeologjizmat në tekste dhe të atyre që janë karakteristike dhe specifike për tekstet e gazetave. Dihet që njësitë frazeologjike kanë komponentë me karakter ekspresiv dhe “mu për shkak të komponentëve të tyre ekspresivë, vlerësues e emocionalë, frazeologjizmat janë të përshtatshëm për përdorim stilistik” (Vajičková 2010:180). Frazeologjizmat nuk shihen vetëm si pjesë përbërëse të zakonshme të tekstit, por ata, sipas Sabban-it (2007:237), shpesh përdoren për ta zgjuar interesimin rreth atij teksti.

Në literaturën mbi frazeologjinë si funksione të frazeologjizmave në tekstet publicistike numërohen: stimulimi i leximit, të zgjuarit e interesimit, emocionalizimi, konkretizimi dhe ngritja e ekspresivitetit përmes figurshmërisë dhe konotacionit.

Vendi më i preferuar për përdorimin e frazeologjizmave në gazeta, sipas Burger-it (2010:156), janë titujt e artikujve (**“Schlagzeilen”**). Burger pohon që në historinë më të re të gazetave gjithnjë e më tepër po përdoren titujt e artikujve që para së gjithash kanë për qëllim që të tërheqin vëmendjen e lexuesit. Për këtë qëllim janë të përshtatshme posaçërisht idiomat metaforike dhe fjalët e urta. Po ashtu edhe Jashari mendon që frazeologjia me burim popullor zë vendin kryesor në ligjërimin e shkruar, ndërsa, sipas tij, sidomos në shkrimet publicistike dhe ato tekniko-shkencore hasen “kalket dhe shprehjet e papërkthyer²” (Jashari 2000:6).

2. Modifikimet e frazeologjizmave

Modifikimet paraqesin ndoshta aspektin më interesant të përdorimit të frazeologjisë në tekst (krh. Burger 2010:159). Në hulumtimet frazeologjike të deritanishme të bazuara në tekste shumë herë është theksuar që në ligjërim konkret njësitë frazeologjike përveç realizimit uzual (të zakonshëm “*usuell*”) pësojnë edhe ndryshime të posaçme, të formuara ad hoc, ose mund të përdoren në një mënyrë kreative. Deri te kjo ndryshueshmëri (leksikore) vihet “kryesisht që njësia frazeologjike t’i përgjigjet situatës konkrete të ligjërimin, specifikes kontekstuale” (Jashari 2000:33).

Të gjitha ndryshimet që prekin semantikën, strukturën apo komponentët e njësisë frazeologjike (uzuale), në literaturën mbi frazeologjinë quhen “përdorim okazional³ i frazeologjizmave”, “variante okazionale” (“*okkasionelle Variationen*”) (Ptashnyk 2009:44) gjegjësisht “përdorime që bien në sy” (“*auffälliger Gebrauch*”) (Wotjak 1992:100). Me modifikime, për dallim nga variantet, nënkuptohen të gjithë togfjalëshat e paleksikalizuar që lindin nga një frazeologjizëm. Pra, “modifikimi lind

² “Shprehjet e papërkthyer” Jashari i quan huazimet frazeologjike.

³ “*okkasionell*” – ‘përdorim i rastësishëm, jo i zakonshëm’

kryesisht gjatë një përdorimi si një njësi okazionale, individuale dhe për qëllime të caktuara, për të arritur një efekt të veçantë, komik, ironik” Balsliemke (2001:68). Përdorimi okazional i frazeologjizmave paraqet shmangie nga përdorimi i zakonshëm dhe “në shikim të parë duket që është në kundërshtim me kriteret e përshkuara teorike të qëndrueshmërisë frazeologjike (semantike e strukturore)”. (Ptashnyk 2009:44). Derisa tek variantet frazeologjike kemi të bëjmë me dy njësi uzuele frazeologjike të ngjashme për nga struktura dhe semantika, modifikacionet janë formulime okazionale që formohen në ligjërime për shkak të një njësie tanimë ekzistuese frazeologjike (të kodifikuara) (e cila quhet edhe si bazë frazeologjike).

Ndryshimet e frazeologjizmave që më nuk hyjnë në kuadër të “varianteve” Burger/Buhofer/Sialm (1982:69) i quajmë “modifikime”. Sipas tyre, dallimi në mes të varianteve dhe modifikimeve është i vështirë dhe jo gjithmonë i qartë. Burger (2010:159) pohon që modifikacioni është një proces tekstformues, që në të vërtetë buron nga “potenca” imanente semantike e frazeologjizmit, por që manifestohet vetëm në kontekste konkrete dhe kuptohet vetëm kontekstualisht. Modifikimi nuk duhet të shihet si shkelje e normave të përdorimit dhe tipareve të frazeologjizmave, por si një përdorim tipik i frazeologjizmit. Modifikimi nuk ndikon në prishjen e identitetit gjegjësisht stabilitetit të njësisë frazeologjike. Përkundrazi, baza e modifikimit duhet të jetë e njohur për recipientët, sepse vetëm në këtë mënyrë vjen në shprehje efekti që synon folësi (krh. Ptashnyk 2009:53).

Përkundër modifikimeve, frazeologjizmat njihen si të tillë, pasi që parimisht secili frazeologjizëm e ka një “thelb të fortë” (*harter Kern*) që nuk ndryshon lehtë dhe një “periferi të butë” (*weiche Peripherie*) që mund të ndryshohet në mënyra të ndryshme (Burger/Buhofer/Sialm 1982:69). Edhe prodhuesi i tekstit por edhe recipienti duhet të tregojnë një kompetencë gjuhësore për t’i krijuar dhe për t’i kuptuar modifikimet. Kompetenca gjuhësore në fushën e frazeologjisë duhet ta përfshijë njohurinë rreth skemave të zakonshme sintaksore dhe semantike për frazeologjizmat, me ç’rast në këtë proces të komunikimit prodhuesi i tekstit duhet t’i përdorë aftësitë e tij kreative, ndërsa recipienti aftësitë e tij kognitive dhe asociative (krh. Balsliemke 2001:69).

3. Klasifikimi i modifikimeve

Në studimet që merren me hulumtimin e modifikimit të frazeologjizmave (Burger 2010; Ptashnyk 2009; Pociask 2007, 2010; Balsliemke 2001; Burger/Buhofer/Sialm 1982) në përgjithësi si parime themelore të modifikacionit frazeologjik shihen substitiuimi, shkurtimi dhe zgjerimi i frazeologjizmave, edhe nëse këto modifikime emërtohen me nocione të tjera. Por përveç modifikimeve që prekin

formën e jashtme të frazeologjizmit, d.m.th. përbërjen e tij leksikore dhe strukturën e tij morfosintaksore, autorët e shumtë i dallojnë edhe modifikimet që e prekin vetëm kuptimin e frazeologjizmit, pa ndërrim të dukshëm të formës së jashtme.

Në këtë punim nuk do përshkruhet modifikimi semantik, por duke u mbështetur te Wotjak (1992), këtu bëhet dallim në mes të dy llojeve të modifikimit: modifikimet brenda gjymtyrëve të njësisë frazeologjike dhe modifikimet e elementeve jashtë njësisë frazeologjike. Frazeologjizmat me emërtime të kafshëve të përdorur në tekstet e gazetave ditore janë nxjerrë dhe janë klasifikuar në frazeologjizmat me përdorim uzual dhe në ata të modifikuar, duke e krijuar kështu korpusin për hulumtim. Frazeologjizmat e modifikuar pastaj janë klasifikuar më tutje sipas llojit dhe tipit të modifikimit.

Në vijim dua të paraqes një pasqyrë të tipave të modifikimit të hasura në korpusin e krijuar nga shembujt e nxjerrë nga gazetave ditore shqipe.

3.1. Modifikimet brenda gjymtyrëve të njësisë frazeologjike

I. Substitucioni (zëvendësimi)

Me substitucion duke u mbështetur te Wotjak (1992) kuptojmë zëvendësimin e një a më shumë komponentëve brenda njësisë frazeologjike me leksema të tjera gjegjësisht leksema të huaja për njësinë frazeologjike, me ç'rast elementet e të njëjtës bazë frazeologjike mund të zëvendësohen / modifikohen në mënyrë të ndryshme. Gjatë analizës janë hasur këta shembuj të zëvendësimit të komponentëve frazeologjikë:

Zëvendësim i një konstituenti frazeologjik:

- (1) *Dhëlpër plakë / e vjetër* - Si një dhëlpër me përvojë, [...]
- (2) *Peshku në det e tigani në zjarr* - Peshku në pishinë, tigani në zjarr.
- (3) *(është) ujk i vjetër / plak* - [...] një ujku të golit
- (4) *Me një të shtënë / gur vret dy zogj* - [...] goditen dy zogj me një gur; [...] të vrisnin me një gur, disa zogj

II. Zgjerimi

Zgjerimi i një njësie frazeologjike, si njësi uzuale e kodifikuar, është zgjerimi i bazës frazeologjike përmes një konstituenti apo më shumë konstituentëve. Në korpusin e këtij punimi janë hasur këta shembuj që mund të klasifikohen si njësi të zgjeruara frazeologjike:

Zgjerim përmes atributit mbiemëror:

(5) *peshkë i madh* - peshqit e mëdhenj mishngrënës

Zgjerim përmes atributit emëror:

(6) (*është*) *ujkë i vjetër / plak* - [...] ujkë i vjetër i politikës

Zgjerim përmes një rrethbanori:

(7) *Peshkë i vogël* - peshkë i vogël në liqenin e madh serb

III. Reduksioni (rrudhja, shkurtimi)

Me reduksion, duke u mbështetur te Wotjak (1992:146), kuptojmë mospërdorimet e komponentëve të njësisë frazeologjike. Lëshimi apo heqja e këtyre gjymtyrëve varet nga konteksti. Rrudhjet (reduksionet), sipas Burger/Buhofer/Sialm (1982:77), përdoren posaçërisht në titujt e artikujve si mjet i modifikimit, me ç'rast njësisë frazeologjike ju mbetet kryesisht vetëm pjesa nominale. “Reduksioni bashkë me substitutionin dhe me ekspansionin (zgjerimin) bën pjesë në mekanizmat më të shpeshtë të modifikacionit” (Ptashnyk 2009:95).

(8) *Ç'len prej macës, gjuan minj*- Macja do të gjuajë minj, [...]

(9) *ka mizën pas veshi / nën kësulë* - [...]“miza nën kapuç”

IV. Modifikimi gramatikor

Modifikime formale të këtij tipi kemi kur komponentët nominalë apo foljorë brenda njësisë frazeologjike pësojnë ndryshime gramatikore të cilat nuk janë uzuale (të zakonshme). Këto ndryshime mund të prekin përdorimin e nyjës, numrin e komponentëve emra brenda njësisë frazeologjike (krh. Pociask 2007:106). Gjatë analizës së korpusit të këtij punimi janë vërejtur këto modifikime gramatikore: Ndërrim i numrit njëjës me numrin shumës, ndërrim i nyjës së shquar me nyjën e pashquar, transpozicion i komponentëve frazeologjikë. Me transpozicion nënkuptojmë kalimin nga një pjesë e ligjëratës në një pjesë tjetër të ligjëratës të një apo më shumë gjymtyrëve.

Ndërrimi i numrit njëjës me numrin shumës:

(10) *peshkë i madh* - peshqit e mëdhenj

Ndërrim i nyjës së shquar me nyjën e pashquar:

(11) *dele e zezë* - delja e zezë

(12) (*kapardiset*) *si gjeli / kaposhi / këndesi majë plehut* - krekoset si gjeli majë plehut

Transpozicioni i komponentëve frazeologjikë:

(13) *E tremb ariun me shoshë* - [...] është një trembje e arushës me shoshë

(14) *Ra / zbriti nga kali* - [...], por thjesht po përshpejton rënicen e vet nga kali

V. Ndërrimi prej pohimit në mohim dhe anasjelltas

Ky proces, sipas Burger/Buhofer/Sialm, “do të duhej të kishte një efekt të theksimit” (1982:79) dhe se ndërrimi i frazeologjizmit nga mënyra mohuese në atë pohuese dhe anasjelltas karakterizohet përmes “kundërdëshmisë” (“Widerlegung”) apo “dobësimi” (“Entkräftung”) të përmbajtjes së frazeologjizmit. Efekti i këtij procesi vërehet më qartë te fjalët e urta dhe togfjalëshat e ngjashëm me vlerë fjalie.

(15) *Për një plesht djeg jorganin* - për një plesht nuk digjet jorgani

(16) *S'm'i ka ngrënë /pi sorra mendtë* - Por, nëse, helbete, ia ka pirë sorra mendtë [...]

VI. Kontaminimi / Shkrirja e frazeologjizmave

Jashari (2000:60), termin kontaminin frazeologjik e përdor “për çdo lloj shkrirjeje, ndërthurjeje ose këmbimi të ndërsjelltë gjymtyrësh të njësisve frazeologjike, zakonisht me kuptim të afërt a me gjymtyrë të përbashkët, që bëhet për arsye të rrudhjes së frazës ose për qëllime të tjera stilistike”.

Te ky tip i modifikimit në këtë punim hyjnë shembujt nga teksti, te të cilët janë shkrirë dy njësi frazeologjike, si p.sh.:

(17) *Ka lepurin në bark + Nuk nxjerr lepur nga strofulla:*

- [...] nxirre lepurin nga barku (edhe modifikimi: ndërrim negacion↔afirmacion)
- “Ju nuk ia nxirri dot lepurin nga barku mister 20%, [...]
- Këtë mund ta bëj, po lepurin nga barku, zotit Rama, nuk mund t'ia heq, [...]
- [...], për ta nxjerrë nga barku atë lepurin e frikës, [...]

(18) *I djeg miza + ka mizën nën kësulë:*

- Nëse të djeg miza nën kësulë, sqaro qytetarët.
- Nëse ty të djeg ndonjë mizë nën kësulë, [...]

VII. Kombinimet e më shumë tipave të modifikimit e gjymtyrëve brenda njësisë frazeologjike

Ky tip i modifikimit përfshinë grupin më të madh të shembujve të analizuar për këtë pjesë të hulumtimit. Nëse e vlerësojmë numrin e madh të njësisve me kombinim të

disa tipave të modifikimit, duket se modifikimi i shumëfishtë është një mjet gjuhësor i preferuar në gazetari. Në këtë grup hyjnë vetëm modifikimet që i prekin gjymtyrët brenda njësisë frazeologjike.

Në korpusin e analizuar janë vërejtur shembuj me dy tipa të modifikimit dhe me tre tipa të modifikimit:

Dy tipa të modifikimit:

(19) *Dele e zezë*: [...] delja e zezë e kopesë [...] (zgjerim (atribut emëror), modifikim gramatikor (ndërrim nyje e shquar ↔ nyje e pashquar))

(20) *Shkeli mbi gjarpërinj (dikush)*: [...] ranë në një fole gjarpërinjsh. (zëvendësim (i komponentit foljor), zgjerim)

(21) *Ra / zbriti nga kali*: nuk do të zbresë vetë kurrë nga kali i pushtetit (ndërrim mohim↔pohim, zgjerim (atribut emëror))

(22) *luan (me të) si macja me miun*: - Angelina dhe Depp, si “macja e miu” (reduksion, zëvendësim (një komponent))

(23) *Nuk i bën dëm as një mizë*: [...] t’i bëj keq një mize. (reduksion, zëvendësim (një komponent))

(24) *Peshkë i madh*: peshqit e mëdhenj mishngrënës (modifikim gramatikor (ndërrim numri njëjës↔numri shumës), zgjerim (atribut mbiemëror)); - peshqit e mëdhenj të politikës (modifikim gramatikor (ndërrim numri njëjës↔numri shumës), ekspansion (atribut emëror))

(25) *Peshkë i vogël*: peshq shumë të vegjël (modifikim gramatikor (ndërrim numri njëjës↔numri shumës), zgjerim (përcaktor ndajfoljor)); - peshqit e vegjël (modifikime gramatikore (ndërrim numri njëjës↔numri shumës + nyje e pashquar↔nyje e shquar))

(26) *Peshku qelbet nga koka*: - LDK është e kalbur nga koka! (zëvendësim (një komponent), modifikim gramatikor (ndërrim i aspektit))

(27) *(është) ujk i vjetër / plak*: - ujqit e vjetër (modifikime gramatikore (ndërrim numri njëjës↔numri shumës + nyje e pashquar↔nyje e shquar)); - ujk i fuqishëm politik (zëvendësim (një komponent), zgjerim (atribut mbiemëror))

(28) *Edhe zogjtë e malit e dinë*: Edhe zogjtë në degë cicëruan (zëvendësim (një komponent), modifikim gramatikor (ndërrim i aspektit))

(29) *i fortë si luan*: [...] një forcë prej luani. (transpozicion i një komponenti, zëvendësim (një komponent))

(30) *ka mizën pas veshi*: Ashtu në panik e me miza pas veshëve (zëvendësim, modifikim gramatikor (ndërrim numri njëjës↔numri shumës))

Tre tipa të modifikimit:

(31) *Peshku qelbet nga koka:* [...] pse peshku është i kalbur nga bishti, po jo edhe nga *koka!* (modifikime gramatikore (ndërrim i aspektit), zgjerim, ndarje)

(32) (*është, rri*) si *lepuri në vresht:* është strukur si lepur (modifikime gramatikore (ndërrim i aspektit + nyje e shquar ↔ nyje e pashquar), reduksion)

3.2. Modifikimet e elementeve jashtë njësisë frazeologjike⁴

Në vijim do të paraqiten frazeologjizmat e nxjerrë nga tekstet e gazetave që shfaqin një modifikim në elementet e jashtme obligative të njësisë frazeologjike, funksioni i të cilave është që të mundësojnë koherencën e tekstit, por edhe që të përforcojnë gjegjësisht dobësojnë apo konkretizojnë kuptimin e njësisë frazeologjike.

Përdorimi i njësive frazeologjike mundëson të luash me fjalë duke u ndërthurur në shumë mënyra në kontekst. Se njësitë frazeologjike mund të jenë pjesë përbërëse e tekstit dhe se mund të marrin një funksion të ndërthurjes në tekst, mund të vërehet edhe në shembullin vijues nga korpusi i nxjerrë nga tekstet publicistike:

(33) **Peshku i Madh!** [...] Të shtunën Lëvizja “Vetëvendosje” shënonte një ditë feste. Këtu u arrestua ”*Peshku i madh*”, Albin Kurti. [...] Ata si duket e kanë marrë shumë seriozisht ose e kanë stërmadhuar rolin e tyre, duke marrë përsipër deklaratat e EULEX-it se do të arrestojnë “*Peshqit e mëdhenj*”. Duke marrë parasysh përvojën e vogël që e kanë qoftë në politikë por edhe në jetën publike, dhe posaçërisht duke konsideruar të mirat që iu sollti pushteti tash e atëherë, nuk është për t’u çuditur që e kanë konsideruar veten të mëdhenj, *peshq të mëdhenj*, asi që e destabilizojnë jetën politike. [...] Java e paralajmëruar e arrestimeve të *peshqve të mëdhenj* së pari nga mediet e pastaj edhe nga kryeministri me fjalimin e tij “zemërthyes”, konkludoi me hetime e arrestime të zyrtarëve komunalë gjatë javës dhe liderit të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Albin Kurtit. Pa marrë parasysh se si i duket EULEX-it dhe Policisë së Kosovës, Albin Kurti nuk është lloji i “*Peshkut të madh*” që kosovarët prisnin të arrestohej kësaj jave. Sa u përket medieve, ai madje nuk ishte *peshk* i veturave të saj nga Lëvizja “Vetëvendosje”. [...] Askush nuk e ka pritur që Kurti do të jetë “*Peshku i madh*” që si rezultat i luftës për sundimin e ligjit të hënën do t’i dorëzohet në tryezë Grupit

⁴ Wotjak-u (1992:160) thekson që njësoj sikur foljet edhe frazeologjizmat foljorë, nga pikëvështrimi i valencës dhe distribuimit, kanë aftësi që të lidhin rreth vetës partnerë të caktuar kontekstual, d.m.th. kanë aftësi për të hapur vende të zbrazëta të cilat duhet apo mund të zihen me plotësi të caktuar.

Ptashnyk-u (2009:109) ndërkaq “ndryshimet në potencialin e aktantëve jashtë njësisë frazeologjike” i numëron si modifikime morfologjike, pasi që këto ndryshime “i prekin tiparet morfositaksore të konstituentëve foljorë të frazeologjizmeve edhe atë valencën e tyre”.

Ndërkombëtar për Kosovën. [...] Kurti padyshim se nuk ishte dhe as nuk është “*Peshkë i madh*” i korrupsionit, krimit të organizuar. Madje ai nuk ka notuar fare në ato ujëra. [...] Arrestimi i tij në kohën kur kjo pritej të bëhej ndaj “*Peshqve të mëdhenj*” të korrupsionit dhe krimit, dhe në ditën që paralajmëroi hyrjen në politikë i dha Kurtit atributet e *Peshkut të Madh* politik [...].

Ky funksion i frazeologjizmit në këtë shembull vërehet posaçërisht përmes përdorimit të shpesh të (“grumbullimit të dukshëm të frazeologjizmit”) të frazeologjizmit *peshkë i madh* ose të vetëm njëres komponentë (në këtë rast *peshkë-u*).

Gjatë analizës së korpusit të këtij punimi janë vërejtur këto modifikime të jashtme: Referenca në kontekst, radhitje / grumbullim i dukshëm i frazeologjizmave, komentim metagjuhësor dhe shmangie nga normat leksikore-semantike. Te këta tipa të modifikimit mund të përfshihen gjithashtu edhe modifikime brenda gjymtyrëve të njësisë frazeologjike.

VIII. Referenca në kontekst

Burger/Buhofer/Sialm përfshijnë nën këtë tip të modifikimit një spektër të gjerë të mënyrave, përmes të cilave frazeologjizmi lidhet me një apo më shumë elemente të kontekstit. Sipas tyre, deiktikët anaforikë ose kataforikë, në veçanti referencat pronominale, por edhe leksemat që janë identike me ndonjë element të frazeologjizmit, sinonimet ose antonimet etj., mundësojnë lidhjen e frazeologjizmit në mënyra të ndryshme me kontekstin. Ky tipi i modifikimit mundëson koherencën në tekst.

Shembujt në vijim hyjnë në kuadër të këtij tipi të modifikimit:

(34) “Sa për Skënderbeun, ai ishte kalorës i Krishtit, por Berisha është një kalorës që nuk *zëbret nga kali*, Skënderbeu e donte ullirin, por Berisha po na jep vetëm kokrrën...”.

(35) Duket shumë dhe shpesh se ata kanë krijuar një hendek, në anën tjetër të së cilit populli dhe artistët e tij kanë mbetur qyqë vetëm, dhe as s’ka kush që e kupton nevojën e tyre kolektive që bile në një mënyrë dhe me diçka të ndodhur t’i flasin e t’ia hapin sytë botës. Por kur macet flenë, minjtë bëjnë dasmë, dhe derisa artistët, regjisorët e pushtetarët tanë kanë punë të tjera, të tjerët po krijojnë për ne.

(36) Shumë zhurmë për asgjë. Ose: U dridh mali, polli miu. Kështu, përafërsisht, mund të karakterizohet java e shkuar politike në Kosovë. Nisi me pompë nga AAK për ato që ajo i quajti bisedime sekrete ndërmjet Qeverisë së Kosovës dhe asaj të Serbisë. Dhe përfundoi me trumbetë nga Qeveria mosekzistimi, si tha ajo, i këtyre bisedimeve.

(37) [...] së pari brenda radhëve ka përballë Blushin me grupin e tij, së dyti, brenda kampit ka liderë të partive të vogla aleate që për "një plesht janë gati të djegin jo vetëm *jorganin*, por edhe *krepatin bashkë me shtëpinë*" mjaft të ketë pak zjarr se "është ftohtë".

(38) Duke mos pasur alternativë tjetër, sistemi i vetëm mbetet ai bipartizan. "*Kur s'ke pulën, do hash sorrën!*" Çështja është nëse do ta kemi makar edhe *sorrën!* Besimi naiv opozitar te konspiracioni perfekt është në thelb mosbesim te dy shtyllat ku mbahet në këmbë vetë sistemi bipartizan i balancuar [...]

IX. Radhitje / grumbullim i dukshëm i frazeologjizmave

Radhitja gjegjësisht grumbullimi i frazeologjizmave në të njëjtin kontekst është një formë tjetër e modifikacionit jashtë njësisë frazeologjike. Me grumbullim të frazeologjizmave, Pociask (2010:160) nënkupton përdorimin e së paku dy frazeologjizmave brenda një fjalie apo një pjese të shkurtër të tekstit. Sipas tij, frazeologjizmat paraqiten të grumbulluar në të gjitha segmentet e tekstit (në titull, në nëntitull, në mestitull, në pjesën kryesore të tekstit), por kuantiteti i tyre nuk është i njëjtë. Më së shumti frazeologjizmat përdoren të grumbulluar në pjesën kryesore të tekstit edhe atë në fund të paragrafit ose të tekstit. „Grumbullimi i frazeologjizmave ekspresivë shërben për ta sjellë në pah tërë paragrafin“ (Pociask 2010:162). Pociask mendon që është interesante që frazeologjizmat përdoren të grumbulluar më shpesh në mestitull se në titujt kryesorë. Në rrafshin semantik me grumbullim të frazeologjizmave në përgjithësi arrihet një efekt më intensiv, përmes të cilit teksti bëhet më ekspresiv e më dinamik.

Në shembullin në vijim haset procesi i grumbullimit të frazeologjizmave:

(39) **Programi politik i “pulës pa krye”.** Fakti që PDK-ja akoma nuk ka publikuar ndonjë program elektorale dhe po shërbehet në mënyrë ad-hoc me idetë e partive të tjera, tregon se kjo parti nuk ka ndonjë vizion koherent zhvillimor dhe vazhdon të prihet nga filozofia e “*pulës pa krye*”, të cilën e kemi parë gjatë tre vjetëve të fundit. [...] Ka ardhur koha që vlerat dhe parimet e përgjegjësive që dominojnë në një familje kosovare t'i bartim në nivel të shtetit. Që kjo të mund të ndodhë, familja jonë fillimisht duhet ta largojë “*pulën pa krye*” nga kreu i odës...

X. Komentim metagjuhësor

Te ky grup i modifikacionit jashtë njësisë frazeologjike hyjnë shembujt e nxjerrë nga teksti, te të cilët komentimi i qëllimshëm metagjuhësor e orienton lexuesin te

frazeologjizmi gjegjësisht e shënjon frazeologjizmin. Këtë funksion në gjuhën shqipe e kryejnë sinjalet vijuese: *një fjalë e urtë thotë, thonë, thubet, si thotë shprehja* etj.

(40) **Peshku prishet nga koka, edhe LDK po ashtu.** Zëri: Thonë se *peshku prishet nga koka?* Bukoshi: *Pikërisht vlen kjo fjalë e urtë. E vërtetë është ajo se problemi gjithmonë zgjidhet prej koke.*

(41) Një fjalë e urtë thotë se “*qeveria e kap lepurin me qerre*”, por në Poliçan shteti është duke bërë edhe më tepër – po tenton ta kapë “*lepurin*” me vrap. Posta e Policisë në Poliçan, e cila përgjigjet për rendin dhe sigurinë e një komuniteti prej më shumë se 12 mijë banorësh, nuk ka në dispozicion asnjë mjet motorik.

3.3. Kombinimet e modifikimeve brenda dhe jashtë njësisë frazeologjike

Në shembujt e nxjerrë nga tekstet e gazetave hasen kombinime të tipave të ndryshëm të modifikimeve brenda dhe jashtë njësisë frazeologjike. P.sh.:

(42) **Delja e zezë, dita e zezë!** Dhe, unë, po të kisha mundësi, apo po të më pyeste kush, atë ditë, kur mbetëm *dele e zezë* e Evropës, do ta kisha shpallur ditë zie në Kosovë! (Referenca në kontekst, modifikim gramatikor (ndërrim nyje e pashquar ↔ nyje e shquar))

(43) “Calciopoli”, Moxhi në kundërsulm: Nuk jam *delja e zezë* e futbollit. Moxhi e ndjen veten më shumë kurban, se sa *dele të zezë*. “Unë nuk kam qenë kurrë *delja e zezë*. (Radhitje/grumbullim dukshëm i frazeologjizmave, modifikim gramatikor (ndërrim nyje e pashquar ↔ nyje e shquar))

(44) Është një nga ato raste për të cilat Prof. Schützi thoshte se duhet përdorur fjala e urtë “*Unë të them ja ujku, ti më thua ku janë gjurmët!*” *Gjurmët e ujkut* Craciun, si edhe shumë përkime të tjera gjuhësore rumune-shqiptare, të çojnë te përfundimi i G. Schrammit dhe i të tjerëve para tij, se në mesjetën e hershme parasllave të parët e rumunëve dhe të parët e shqiptarëve kanë jetuar në fqinjësi e, ndoshta vende-vende, edhe në njëfarë simbioze, ku dygjuhësia ka qenë dukuri e zakonshme, të paktën ndërmjet burrave. (Referenca në kontekst, komentim metagjuhësor)

(45) Dhe nuk do të zbrisë nga kali derisa të dalë një opozitë e aftë të shkatërrojë mekanizmin e korrupsionit, dhunës dhe vjedhjes që e mban atë mbi shalën e kalit. Kryetari i grupit të PS-së, Gramoz Ruçi i bëri me dije Kryeministrit Berisha se “shumë shpejt *do biesh nga kali ku ke hipur*. Shumë shpejt Edi Rama do vijë aty ku je ti”. (Radhitje/grumbullim dukshëm i frazeologjizmave, ndërrim afirmacion ↔ negacion)

(46) **Lopa e korrupsionit dhe kali i anti-korrupsionit.** [...] Në një mënyrë a në një tjetër, të gjitha pushtetet në Shqipëri kanë ditur *ta shalojnë kalin e anti-korrupsionit*. Duke nisur që nga Komandanti, që nuk u lodh së na përsërituri vjershën e “Zogut që

kish vjedhur florinjte e popullit nga Banka kur ja mbathi”, e deri te gjyqi i gruas së Komandantit, gjysëm shekulli më pas, që u bë për kafet e pira me tepicë dhe tortat e ngrëna pa faturë. [...] Saliu vërtet është mësues i keq, por është nxënës i shkëlqyer ama. Kuptoi se, në donte ta shihte edhe një herë vehten në pushtet, këtë mund ta bënte vetëm duke lënë mënjane *kalin* e ngordhur të lirive dhe duke *i hipur kalit të furishmë të anti-korrupsionit*. [...] Tash së fundit, shenjat janë se edhe Rama ka vendosur më në fund që *t’i hipë kalit të anti-korrupsionit*. Pasi e provoi për vite me radhë që ta arrinte pushtetin duke i hipur gomarkës së lirive, që në Shqipëri nuk gjen bar të hajë, pastaj duke i hipur mushkës së “politikës së re” e cila edhe kjo mbeti mb’udhë, tash së fundi vendosi të shalojë kalin qimendritur të anti-korrupsionit [...] Kështu funksionon secila akuzë e secilit akuzues të secilës palë dhe të gjithë bashkë i mbledh vetëm një gjë: Në këto akuza denoncohet fakti por asnjëherë fenomeni, pasi e njëjta gjë do ndodhë edhe kur Saliu ta lëshojë lopën e pushtetit dhe Rama *të zbresë nga kali i antikorrupsionit* të cilin tani e ka shaluar si gjithë të tjerët para tij. (Radhitje/grumbullim dukshëm i frazeologjizmave, ekspansion (atribut emëror))

(47) “Do i shkojmë deri në fund dhe jo vetëm do bëjmë çmos që *të nxjerrim nga strofkulla lepurin e lepujt*, por *do nxjerrim nga pylli i kësaj politike* në dritën e transparencës çakejtë, hienat, urithët, dhelprat dhe vetë arushën e madhe që mban peng Shqipërinë”, deklaroi Edi Rama në një shprehje të tensionit të fortë që ka përfshirë vendin. (Referenca në kontekst, ndërrim afirmacion↔ negacion)

(48) Këtë e bëj se unë udhëhiqem nga respekti për opozitën. Këtë mund ta bëj, po lepurin nga barku, zotit Rama, nuk mund t’ia heq, të jem i singertë”, përfundoi komenti i Berishës për letrën e zotit Stefan Fule. [...] Pse jo, ndoshta kemi pasur nevojë për një shkundje të përgjithshme të shoqërisë, të shoqërisë dhe të individit, *për ta nxjerrë nga barku atë lepurin e frikës*, që e kemi trashëguar nga regjimi komunist dhe që shumëkënd ende nuk e lejon për ta përjetuar lirinë si akt dinjiteti. (Referenca në kontekst, kontaminim i dy frazeologjizmave, zgjerim (atribut emëror))

(49) **Macja e zezë dhe zgjedhjet e vjeshtës.** Një besëtytni thotë se nëse ta pret rrugën *një mace e zezë*, atëherë punët nuk të shkojnë mirë, por të shkojnë mbrapsht. E nisa kolonën time duke aluduar në *macen e zezë* si një simbol i asaj çka po ndodh me ne dhe rreth e përreth nesh. Nuk do të thotë se duhet të të kalojë realisht *macja e zezë*, që punët të të shkojnë keq, ka mundësi edhe pa të kaluar *macja e zezë* që punët të të shkojnë ters. (Radhitje/grumbullim dukshëm i frazeologjizmave, Komentim metagjuhësor, modifikim gramatikor (ndërrim njeje e pashquar↔ njeje e shquar))

4. Përfundim

Në tërësi janë analizuar 134 shembuj nga tekstet publicistike njësi të ligjërimit të shkruar. Nëse i shikojmë shembujt e nxjerrë nga tekstet publicistike nga aspekti i frekuencës së përdorimit të emërtimeve të kafshëve si komponentë të njësisë frazeologjike, vërejmë se më së shpeshti janë përdorur këto emërtime të kafshëve:

Peshkë (44 shembuj), *Kalë* (11 shembuj), *Mizë* (11 shembuj), *Ujkë* (9 shembuj), *Mave*, (8 shembuj), *Lëpur* (8 shembuj), *Zog* (7 shembuj), *Qen* (5 shembuj), *Dele* (5 shembuj).

Ndërsa njësitë frazeologjike me emërtime të kafshëve që janë përdorur më së shpeshti në tekstet publicistike janë:

peshkë i madh (26 shembuj), *peshkë i vogël* (10 shembuj), *(është) ujke i vjetër* (6 shembuj), *dele e zezë* (5 shembuj), *ru / zbriti nga kali* (5 shembuj), *ka lëpurin në bark* (5 shembuj), *ka mizën pas veshi / nën kësulë* (5 shembuj), *peshku qelbet nga koka* (5 shembuj), *me një të shtënë / gur vret dy zogj* (4 shembuj), *luan (me të) si macja me miun* (3 shembuj).

Ky hulumtim ka nxjerrë në pah një përqindje të madhe të njësisë të modifikuara në gjuhën shqipe, por ky rezultat nuk duhet të merret si absolut, sepse korpusi i hulumtuar nuk mund të jetë reprezentativ për të gjitha llojet e teksteve pasi që rrjedh prej vetëm një pjese të vogël të përdorimit gjuhësor, prej gjuhës së publicistikës.

Në figurën 1 është pasqyruar përdorimi dhe shpërndarja e këtij grupi tematik të frazeologjizmave (frazeologjizmat me emërtime të kafshëve) në rubrikat e gazetave të hulumtuara ditore në gjuhën shqipe:




Fig. 1. Shpërndarja e frazeologjizmave me emërtime të kafshëve dhe shpërndarja e modifikacioneve nëpër rubrikat e veçanta të gazetave ditore "Zëri" dhe "Shqip"

Analiza e korpusit tregon që frazeologjizmat me emërtime të kafshëve përdoren më së shpeshti në rubrikën “*Opinion*” me 50%, pastaj vijojnë rubrika “*Politikë*”⁵ me 25% dhe metarubrika “*Extra*” (që përfshinë në vete edhe rubrikat *Zip, Yjet, Lifestyle, BB, Ndryshe, Reportazh*) me 9%. Ndërsa sa i përket shpërndarjes së modifikacioneve në rubrikat e veçanta, në korpusin e përbërë nga njësitë e nxjerra nga tekste publicistike vërehet një tendencë e madhe e modifikimit në të njëjtat rubrika që dominojnë me shpërndarjen e frazeologjizmave, pra rubrika “*Opinion*” me 51%, e përcjellë nga rubrika “*Politikë*” me 26% dhe metarubrika “*Extra*” me 7%.

5. Literatura

- Balsliemke, Petra (2001): “*Da sieht die Welt schon anders aus.*” *Phraseologismen in der Anzeigenwerbung: Modifikation und Funktion in Text-Bild-Beziehungen.* Phraseologie und Parömiologie; 7. Baltmannsweiler.
- Burger, H. /Buhofer, A. /Sialm, A. (1982): *Handbuch der Phraseologie.* Berlin. New York.
- Burger, Harald (1999): *Phraseologie in der Presse.* Në: Bravo, N.F./ Behr, I. /Roziar, C. (Ed.): *Phraseme und typisierte Rede.* Tübingen. 77-89
- Burger, Harald (2010): *Phraseologie. Eine Einführung am Beispiel des Deutschen.* Berlin.
- Jashari, Ali (2000): *Rreth përdorimit të frazeologjisë në ligjërimin e shkruar.* Korçë.
- Jashari, Ali (2007): *Fjalor me shprehje të huazuara në gjuhën shqipe.* Korçë
- Pociask, Janusz (2007): *Zu Status und Funktion der idiomatischen Einbeit in Presstexten.* Dargestellt an Textbeispielen aus der Neuen Zürcher Zeitung. Frankfurt am Main etc.
- Pociask, Janusz (2010): „*Wenn schon, denn schon*“. *Zur Häufung von Phraseologismen in Presstexten.* Në: EUROPHRAS 2008. Helsinki. 160-168.
- Ptashnyk, Stefaniya (2009): *Phraseologiosche Modifikationen und ihre Funktionen im Text. Eine Studie am Beispiel der deutschsprachigen Presse.* Phraseologie und Parömiologie; Bd. 24. Baltmannsweiler.
- Sabban, Annette (2007): *Textbildende Potenzen von Phrasemen.* Në: Burger et al. *Phraseologie/Phraseology.* 237-253.
- Schauer-Trampusch, Tatjana (2002): *Klein aber oho! Symbole und Metaphern in der slovenischen Tierphraseologie am Beispiel der Konzepte AMEISE, BIENE, WESPE und FLIEGE.* Në: Piirainen, E. /Piirainen I. T. (2002): *Phraseologie in Raum und Zeit.* 57-75.
- Thomai, Jani (1981): *Çështje të frazeologjisë së gjuhës shqipe.* Tiranë.

⁵ Nën emërtimin “*Politikë*” po e përfshij edhe rubrikën “*Ditari*” të gazetës “*Zëri*”.

Thomai, Jani (1999): *Fjalor frazeologjik i gjuhës shqipe*. Tiranë.

Thomai, Jani et. al. (1999): *Fjalor frazeologjik ballkanik*. Dituria. Tiranë

Vajičková, Mária (2010): *Textgestaltende Funktionen von Phrasemen in der Presse*. Nö: Europhras 2008. Helsinki.180-190.

Wotjak, Barbara (1992): *Verbale Phraseolexeme in System und Text*. Niemeyer. Tübingen.

Gaz BERLAJOLLI

SHQIPJA SOT: SHPËRBËRJE APO RIRREGULLIM?

Domeni publik i gjuhës dikur kishte raviza më të prera e të dallueshme. Sot këto dalin të vagullta, meqë shumë veprimtari, dikur gjysmëpublike, jopublike, private e intime madje, tashmë depërtojnë e nguliten madje fare në domenin publik. Me përhapjen virale të komunikimit virtual, dëshmojmë tek diktohet përherë më fort edhe gjuha prej kodeve të tij. Tek shkrihen njëra me tjetrën virtualja dhe realja, nis e tret kufiri edhe mes gjuhës së shkruar dhe të folurës. Vetë hapësira shqipfolëse vjen më e vetëdijësuar për përmasat e veta duke e shtri rrjedhimisht ndërkomunikimin mes pjesëve. Duke qenë domeni publik larg më ndërveprues e i larmishëm, vërejmë në këtë epokë prirje më të shumta drejt divergjencave në shqipen e përdorur publikisht se ç'njihnim në periudhën socialiste. Ligjësitë e komunikimit janë njëherësh ligjësi të gjuhës, ndaj modat e sotme të komunikimit bëhen moda të gjuhës. A po dëshmojmë, prandaj, shpërbërje të normave që njiheshin e zbatoheshin dikur, apo po i farkojmë edhe vetë rirregullimet në gjuhën shqipe?

Të mendojmë si planifikues të gjuhës

Një standard sa më i kapshëm për përdoruesin e sa më i përhapur në përdorim nëpër jetën publike mbetet në interesin e planifikimi gjuhësor. Prandaj modifikimet eventuale në varietetin standard kanë sukses kur bëhen jo veç *ex cathedra* (prej të diturish për punë gjuhe që vendosin për trajtat korrekte), por kur kjo dijeni ushqehet me informacion që marrim drejtpërdrejt nga matjet e përdorimit. Një kujdes të veçantë në matje i duhet kushtu faktit se secila njësi gjuhësore që vendosim ta masim ka tiparet e veta, shtrirje krejt idiosinkratike në sistemin e gjuhës, e prandaj duhet trajtu si e tillë.

Me e lehtësu argumentimin, ta konkretizojmë me një shembull të thjeshtë krejt. Qe p.sh., prirje e hetueshme sot në shqipen që dëgjomë edhe publikisht e jo veç në mjedise miqësore e familjare, është me e pasu foljen e ngurtësuar 'do' nga lidhore që e bjerrin pjesëzën *të* (do [të] vij). Kjo ndodh qoftë lidhorja e tashme, e pakryer, e kryer a më se e kryer (shembuj: do [të] vij, do [të] vija; do [të] kem ardhë, do [të] kisha ardhë). Këtë lloj risie mund ta hetojmë si njësi gjuhësore më vete. Meqë njësia shfaq tipare me e

mbajtë ose bjerrë pjesëzën, ta shënojmë atë si një ndryshore me dy variante: [do+lidhore me pjesëz/do+lidhore pa pjesëz]: Moda për bjerrje të pjesëzës po e prek njësinë në gjithë strukturën e mësipërme gramatikore. Kjo nënkupton se nëse dikur në planifikimin gjuhësor synojmë ta paraqesim variantin pa pjesëz si risi normative, do ta bënim këtë në krejt strukturën e prekur.

Kur kemi të drejtë me ia sugjeru risinë normës standarde? A janë vendimet vërtet shkencore realisht të mundshme? Përgjigjet varen fillimisht nga hetimi i përhapjes së risisë. Pra nga matjet. Çka masim? Nëse masim ç'raport përhapjeje ka varianti [do+lidhore pa pjesëz] në raport me [do+pjesore me pjesëz], a masim vetëm përdorime të caktuara? Fjala vjen, veç përdorime që dalin nëpër botime e publikime institucionale, zyrtare, në gjuhë standarde? Apo masim madje edhe përdorime nëpër komente portalesh e rrjetesh sociale? Varet se sa *demokratik* e duam standardin, në kuptimin e gjithëpërfshirjes nëpër gjeografinë dhe hierarkinë e kulturës që me standardin e shqipes shërbehen. Do pasë parasysh edhe fakti se, nëse vartësve standardin ua ngarkojmë dhe kërkojmë nëpër shkolla dhe institucione zyrtare e publike, atëherë niveli i përdorimit të standardit prej tyre na intereson. Na interesojnë shpërputhjet që shfaqen mes përdorimit të gjuhës së shkruar prej tyre dhe standardit vetë. Në rastin e konkretizimit të këtushëm, na intereson që ndryshorja në fjalë [do+lidhore me/pa pjesëz] të jetë e përfaqësuar edhe në gjuhën standarde me variantin mbizotërues në përdorim përbrenda gjithë kësaj kulture. Kështu sigurohemi që të mos imponojmë variant të ndryshores që shkon ndesh me prirjet mbizotëruese të vetë përdorimit.

Raporti mes planifikuesit e përdoruesit nuk mund të jetë ai i njëanshmi i imponimit të vullnetit të njërit mbi tjetrin. Një standard që synon ta shtojë shkallën e përdorimit dhe numrin e përdoruesve, do t'i marrë parasysh prandaj veç *përdorimet*, cilatdo qofshin e nga kushdo qoftë, e jo *përdoruesit vetë*. Kështu sigurohemi që me matje të mos i paragjykojmë përdoruesit për trajtat që gjenerojnë.

Në shembullin konkret, nëse masim përpjesën e shfaqjes në përdorim ndërmjet: [do+lidhore me pjesëz] dhe [do+lidhore pa pjesëz]

regjistrojmë çdo paraqitje të pjesëzës brenda kësaj sintakse në krahun e majtë dhe çdo mungesë të saj në të djathtë. Madje kështu pavarësisht prej “higjienës drejtshkrimore” të vetë mostrave që i hetojmë. Prandaj, “do të bëjm”, “do të bojm” “do bejm” “do bajmë” janë të gjitha mostra të vlefshme, sepse secila na e jep krejt qartë informatën që po ia hetojmë përdorimit: prirjen e ndryshores me e bjerrë ose jo pjesëzën të.

Ta zëmë se mblodhëm disa miliona mostra nga ligje, gazeta, romane, botime, portale, shkresa zyrtare, tekste këngësh, e çfarëdo lloj botimesh e publikimesh që

mund t'i mendojmë e masim, në një kërkim shterues që e kap mirë botën shqipfolëse në koordinatat horizontale e vertikale, pra në gjeografi shtrirjeje dhe hierarki përhapjeje. Kjo detyrimisht se na e ndriçon dhe informon pastaj vendimin. Nuk është asnjëherë e mundshme të kufizohemi vetëm në mostra që mbledhim nga tekste në shqipen standarde. Kjo sepse ndonjëherë nuk është e lehtë të përcaktohet mirëfilli sa standarde është shqipja nëpër ato tekste. Sa me e pru ndonjë ilustrim, romanet e Ben Blushit a të Rudina Xhungës e japin herë njërin e herë tjetrin variant të ndryshores në fjalë. Kuptohet, këta kurrsesi nuk janë të vetmit. Kuptohet po ashtu se nuk krijojmë kurrsesi gjykimi për Blushin a Xhungën, e madje as për secilin përdorim jostandard të ndryshores në fjalë në tekstet e tyre (*do vij*). Ajo që po bëjmë është se po e masim përpjesën mes dy varianteve të ndryshores dhe asgjë tjetër; paragjykime të çfarëdo natyre nuk na duhen. Sepse, rikujtojmë, me këtë matje synojmë të kuptojmë nëse përdorimi më gjithëpërfshirës dhe standardi aktual në këtë pikë konkrete (pra tek kjo ndryshore gjuhësore) janë në sinkron ose jo. Me fjalë të tjera, më fort priret me u bjerrë apo me u mbajtë pjesëza të përdorim?

Ç'dëftojnë matjet?

Le të supozojmë se përpjesa mes dy varianteve të ndryshores që po hetojmë është 70% variante me pjesëz dhe 30 % pa. Ç'na thotë kjo përpjesë? Së pari, na njofton se tri nga dhjetë takimet që syri ynë lexues kolektiv ka me këtë njësi janë variante të ekonomizuara (*do vij*). Është nga njëra anë e hershme që risimin e shkurtuar (ndryshoren pa pjesëz) t'ia sugjerojmë shqipes standarde, sepse edhe përdorimi, i matur krejt krudo, përligj variantin standard (*do të vij*).

Çka nëse gjetjet e matjeve japin përpjesë 70%: 30% në të mirë të variantit të shkurtë (*do vij*)? Kjo d.m.th. se prirja ekonomizuese e ka pushtu përdorimin. Madje edhe në mos qoftë i pranuar zyrtarisht si variant standard, varianti i shkurtë ka çu tutje në përdorim, dhe kjo përqindje e lartë evidentimi të tij dëfton se ai depërtu ndjeshëm në gjuhën e shkruar, e madje pandehet për variant standard nga një numër i madh përdoruesish. Ndryshe, varianti nuk do ta dëshmonte një përqindje kaq të naltë në matje. Pra nëse nga çdo dhjetë matje të ndryshores, shtatë dalin me variante të shkurta (*do vij*), pasi kemi hetu në gjithë atë mori tekstesh, kjo është pikërisht sepse këto tekste janë të ngopura me të tilla variante të shkurta; ligjet, botimet, tekstet shkollore, shkresat zyrtare, portalet e çkado tjetër që masim.

Nëse zyrtarisht ende nuk kemi shpallë variantin e shkurtë si normativ, kjo për përdorimin vetë as nuk ka rëndësi fare. Përqindja kaq e lartë e shfaqjes së variantit të shkurtë dëfton se pakkush heton diçka jonormative tek ky variant. E në gjuhë, si në

jetë, 'gabimi' i bërë prej shumicës shndërrohet në rregull. Kjo sepse njësia gjuhësore, kësisoj e ndryshuar, kryen për bukuri brenda bashkësisë folëse detyrën që i ngarkohet: komunikon si shenjues. Me thënë a shkrujtë "do vij nesër", informatat morfologjike, sintaksore e kuptimore që fraza ngërthen, përçohen të plota nga dhënësi te marrësi, pa ia pasë hiç nevojën pjesëzës *të*.

Kur përlijgemi shkencërisht që variantin e shkurtuar (*do vij*) t'ia paraqesim standardit? Atëherë kur përpjesa nga matjet na del 50% me 50%. Dhe qe pse: këtu argumentet për njërin ose tjetrin variant të ndryshores janë krejt të barasvlefshme. Kjo përpjesë dëfton se as përpjekja e gjuhësisë normative për ta shkurajua variantin e shkurtë jostandard të ndryshores (*do vij*) nuk ka dhënë rezultat e pritura që ta mbajë këtë të nënrenditur në përdorim. As përqindja që mbush korpusin me "do të vij" e as ajo që e mbush me "do vij" nuk kanë ndonjë epërsi mbi tjetrën. Prandaj argumenti për ta mbajtur variantin e gjatë është po aq i vlefshëm sa ai për ta pranuar të shkurtin. Kësisoj, në rast të kësaj përpjese kështu të baraspeshuar, s'mbetet tjetër veçse me i përlijgë të dyja variantet në standard. Fundja, kemi tashmë informacionin se përdorimi është siguruar që syri ynë kolektiv në çdo dhjetë paraqitje të ndryshores, t'i lexojë nga pesë të gjata e pesë të shkurta. Po ashtu, vendimin e mbështetur mbi rezultate do mund t'ia paraqisnim çdo lloj kritike.

Që nga përpjesa 51% e tutje në të mirë të variantit të shkurtë, përlijgjet normimi vetëm i tij. Kjo për disa arsye: 1. varianti i shkurtë është më ekonomik; 2. Në raport me të gjatën kundrohet si më i kohës (e reja kundrejt të vjetrës); 3. më kosto-efektive për paren publike është me e mbajtur si variant normativ sesa me e luftu si jonormativ. Zgjedhja e dytë kish me shpenzu mund, kohë dhe mjete (publike detyrimisht) për ta ngjitur variantin më pak ekonomik dhe me prani 49% në përdorim përmbi variantin më ekonomik me 51% prani.

Si masim?

Matjet, sa më të sofistikuara, aq më të sakta. Sot për sot matje të mirëfillta në shqip nuk kemi. Na ofrohen, asgjëmangut, disa mënyra matjeje që deri diku na e informojnë vetëdijesimin për prirjet. Një gjenerim matjesh bën web-corpora.net. Mundësitë për matje këtu janë vërtet më të mirat që aktualisht ka interneti, porse vetë korpusi hë për hë mbetet fort i vobektë.

Të marrim një ndryshore sa për matjet. Hetojmë sot edhe rrugëve të Prishtinës afishe pronash që pronarët i japin me 'qera'. Huazimi turk 'qira' del i shkruar me 'e' gjithnjë e më shpesh. Realiteti shoqënor i Kosovës nuk e njihnte këtë shkrojtësi të fjalës veç para disa vjetësh. Dimë se prirja ka nisë në Shqipëri dhe shohim se po

përhapet edhe në Kosovë. Meqë në webfaqen “Korpusi i gjuhës shqipe” gjetjet për “qera” na japin edhe raste varianti shkrimor të fjalës “tjera”, matjet mund t’i saktësojmë e t’i ngushtojmë vetëm për frazën “me qera”. Kjo sepse kërkimi nëpër korpus mundësohet edhe me dy fjalë njëkohësisht (madje të njëpasnjëshme ose jo). Mund të saktësojmë edhe nëse fjalët që po i kërkojmë, të parën e/o të dytën, duam ta gjejmë nëpër korpus si fjalëformë ose si lemë. Gjetjet mbasandaj i kontrastojmë me ato të frazës “me qira”.

Matje kreative llojesh të ndryshme nga web-corpora.net janë vërtet të mundshme. Megjithatë, nga datat që shfaqen përposh çdo gjetjeje, bie në sy se korpusi do të jetë mbushë deri në vitin 2013, mbasi asnjë gjetje nuk del nga ndonjë e dhënë më e freskët se kaq. Kjo dikton edhe varfërinë e korpusit dhe pamundësinë e hetimit të prirjeve më të freskëta. Megjithatë, me aq sa mat, korpusi i këtushëm na jep 231 gjetje nga 160 dokumente të variantit “me qira” dhe 27 gjetje nga 19 dokumente të “me qera” (matjet më 26 gusht 2015).

Një tjetër mundësi matjesh, më rudimentare dhe larg më të përgjithësuar, na jep Google.com. Google nuk është motor kërkimi për matjet e korpusit të shqipes dhe prandaj një kërkim për një vargim germash si “qira” ose “qera” s’do mend se do të vjelë shumë gjetje që nuk janë të shqipes fare. Google-in mund ta “nënshtrojmë” herë-herë që të kërkojë dhe të gjejë vetëm në shqip. Në ndryshoren që po hetojmë na intereson realisht vetëm zanorja e theksuar, priret më fort drejt ‘e’ apo ‘i’?

Fjala ‘qira’ nuk prek shumë në strukturën e mëtejshme gjuhësore, duke mos qenë më shumë sesa një njësi leksikore. Por edhe si e tillë, formon fjalë më të përbëra. Fjalori i fundit (2006) i shqipes na jep këtë pasqyrë: *qira, qiraxhi-e, qiraxheshë, qiradhënie, qiradhënës-e, qiramarrje, qiramarrës-e*. Një kërkim në Google mund ta bëjmë pikërisht me këto fjalë të përbëra që do të na garantojnë vetëm gjetje prej shqipes (si *qiradhënës* p.sh.), bile pa u kufizuar veç në fjalëformën e vetë lemës. Qe një tabelë me disa matje të tilla nga Google. Ndryshojmë vetëm zanoren që hetojmë, gjithçka tjetër mbetet e njëjtë:

me I	gjetje	me E	gjetje
qiramarrje	55,700	qeramarrje	10,300
qiramarrësve	446	qeramarrësve	59
qiraxhinjte	366	qeraxhinjte	125
qiradhenesin	101	qeradhenesin	42
qiradhenien	340	qeradhenien	55

Matjet me Google konfirmojnë të dhënat nga web-corpora.net e që na informojnë se ndonëse prirja me ‘e’ po përhapet, duket ende e nënrenditur në përdorim. Të paktën aq sa është për t’u besu korpuseve dhe dy llojeve të matjes që bëmë këtu.

Gjuha – përherë në ndryshim

U përpoqëm me e ndriçu shkurtimisht mënyrën se si mund të përditësohet standardi në rastet e kur varianti i ri sfidon variantin tashmë standard të një ndryshoreje gjuhësore. Kuptohet, nuk është se risimet futen vetëm në trajtë variantesh të ndryshoreve, por është e qartë se sistemi gjuhësor, e madje edhe ai standard, ndryshojnë vazhdimisht. Shkaqet e ndryshimit gjuhësor nuk është se njihen krejt e mirëfilli. E dëshmojmë megjithatë prirjen për ekonomizim nëpër gjuhë e periudha të ndryshme si prirje universale. Kërkohet, nga ana tjetër, duke qenë gjuha një organizëm përherë në ndryshim, mirëmbajtja e vazhdueshme e saj. Me sofistikimin e mjeteve të matjes së gjuhës sofistikohet edhe vetë mirëmbajtja.

Mbetet prandaj në interesin e drejtpërdrejtë të botës shqiptare dhe detyrë e ngutshme në planifikimin e mëtejme gjuhësor me i sofistiku mjetet e metodat e matjeve. Kuptohet, mekanizmat matës nuk mund të jenë të ndryrë brenda institucioneve shtetërore, por duhet të jenë të disponueshëm *online* dhe prandaj të qasshëm e të përdorshëm prej gjithkujt që ka interes me u marrë me matjet. Veç kështu sigurojmë transparencë, besueshmëri dhe gjithëpërfshirje. Sigurohemi kështu që prirjet më të përgjithshme t’i sistemojmë në gjuhën standarde dhe zvogëlojmë hendekun mes përdorimit dhe standardit.

Khavit BEQIRI

LATENCA E PANATYRSHME E SHQIPES

Duke qenë në pozitën e gjuhës marrëse (inferiore), në raport me gjuhë të tjera *më të mëdha*, me të cilat është në kontakt mjaft dinamik, qoftë të drejtpërdrejtë, qoftë të tërthortë, gjuha shqipe tashmë po tregon hapur shenjat/pasojat e kësaj pozite *inferiore*.

Gjuha *publike* shqipe po manifeston njëfarë *vendi latent* (R. Jakobson) për “elemente të huaja” dhe kjo deri-diku paraqet edhe tendencën e zhvillimit të saj (të mëtutjeshëm).

Por, a ka vajtur puna deri aty, sa shqipja të mos mund “të mbahet” vetë, pa pasur nevojë të pranojë elemente gjuhësore nga gjuhët dhënëse? Kësaj pyetjeje (më shumë retorike) do të përpiqemi t’i përgjigjemi duke shtruar disa argumente gjuhësore, sipas të cilave realiteti i sotëm i shqipes, sidomos në domenin e jetës publike, del goxha i panatyrshëm.

Nëpërmjet këtij teksti, ne synojmë të dëshmojmë se gjuha shqipe sot, edhe në ligjërimin publik, i ka të gjitha mundësitë për të qenë më e mbrojtur nga ndikimet e jashtme, që disi artificialisht po rriten nga vetë shoqëria shqiptare.

I. Pamjaftueshmëria e gjuhës

Antropologu e gjuhëtari më i njohur amerikan i kohës së tij, Eduard Sapir, kishte vënë në pah se gjuhët, ashtu si kulturat, rallë i mjaftojnë vetvetes, ndërsa “nevoja për marrëdhënie i sjell folësit e një gjuhe në kontakt të drejtpërdrejtë apo të tërthortë me ata të gjuhës fqinje ose me gjuhën e folësve që kanë kulturë mbizotëruese”¹.

Sintagma *kulturë mbizotëruese*, në gjuhësi, nënkupton edhe *gjuhë superiore* (dhënëse). Si rrjedhojë, edhe *gjuhë inferiore* (marrëse). Logjikshëm, në rolin e gjuhës marrëse paraqiten gjuhët që kanë njëfarë statusi/gjendjeje inferiore ndaj gjuhës dhënëse a superiore. Arsytet e këtij “inferioriteti” shpesh janë jashtëgjuhësore dhe nuk kanë të bëjnë pothuajse aspak me pasurinë a varfërinë e një gjuhe. Gjatë historisë, gjuhët e popujve të fuqishëm kanë ndikuar përherë mbi gjuhët e popujve të

¹ Eduard Sapir, *Gjuha – Hyrja në studimin e ligjërimin*, “Rilindja”, Prishtinë, 1980, fq. 219.

nënshtruar. Perandoritë e mëdha, përveç pushtetit, popujve të nënshtruar ua impononin edhe rendin e ri, edhe kodin e ri të gjuhës. Të nënshtruarit duhej t'i përshtateshin jo vetëm mënyrës së re të jetesës, kulturës së re, sipas ligjit të sunduesit, por edhe "ligjërimin të ri", madje gjuhës së re, që sillte ndryshimi i rendit shoqëror e politik.

"Në çdo ideologji, në çdo regjim, ka një mënyrë të veçantë të perceptimit të shkrimit, të kuptimit dhe vlerës së fjalëve. Secila kohë e ka ligjërimin e vet (formë gjuhësore/mendim), kurse puna e parë, së cilës i rreket një pushtet i ri është "përmbysja" e rendit ekzistues të ligjërimin dhe funksionit të tij. Kuptohet, për ta vënë në fuqi një "ligjërim të ri", sipas interesave të veta"², patëm shkruar më parë.

Mirëpo, përveç ndikimit prej *zoris*, kulturat e popujve "inferiore" shfaqin njëfarë prirjeje të imitimit a të kopjimit të "kulturave të mëdha". Në botën e sotme shumë të gjallë, shumë dinamike, në të cilën mundësitë e (ndër)komunikimit janë të jashtëzakonshme, format e reja të veprimtarive kulturore (në film, në muzikë, në sport...), që lindin në "botën superiore", shtrihen me shpjetësi të pabesueshme edhe në të pjesën tjetër të shoqërisë njerëzore. Kështu, bashkë me modelet (gjedhet) e tjera të konsumit të përditshëm, popujt e vegjël i marrin të gatshme edhe modelet gjuhësore, të cilave, e shumta, vetëm ua shtojnë ndonjë formant "zbutës", ndonjë ndajshesë, sa për t'ia përshtatur natyrës së gjuhës së vet "inferiore".

Sic e kemi theksuar edhe në ndonjë rast tjetër, edhe gjuha shqipe është bërë tashmë pjesë e kësaj "loje moderne", ndërsa zelli ynë i madh për t'u dukur sa më modernë, shpeshherë na bënë bartës të stërkeqjes së gjuhës sonë, madje jo vetëm në fushë të fonetikës, të morfologjisë e të leksikut, por edhe në sintaksë. Kur e themi këtë, kemi parasysh faktin e pamohueshëm se, pos barbarizmave të përditshme, pos njërive gjuhësore që nuk kanë shtrirje të gjerë, në gjuhën tonë, si në ligjërimin e folur, ashtu edhe në atë të shkruar, ndeshim përplot ndërtime fjalish që bien tërësisht ndesh me natyrën e gjuhës shqipe dhe me topikën e saj.

Porse, kjo dukuri, në gjuhën e shqipe, nuk është aspak e re. Shqetësimet e para për bardjen e gjuhës sonë i kanë shfaqur qysh autorët e saj të parë, Pjetër Budi, Frangu i Bardhë e Pjetër Bogdani. Shqetësime të njëjta paraqiste shekuj më vonë edhe gjuhëtari Aleksandër Xhuvani, sipas të cilit pastrimi i gjuhës nga "fjalët dhe konstruktet e hueja ishte një nga çashtjet që rrihen e bisedohen shumë herë në gjuhësi".

"Letrarët e shkrimtarët e çdo gjuhe të botës janë interesue dhe përpjekë që gjuha e tyre të shkruhet e të flitet, sa âsht e mundun, e pastër dhe e qërueme nga elemente të hueja. Ky interesim për ta pastrue gjuhën nga fjalë e konstrukte jo shqipe

² Xhavit Beqiri, *Gjuha dhe Letrat*, AIKD, Prishtinë, 2005, fq. 15.

ka ndodhë edhe në gjuhën tonë. Nuk duhet të kujtojmë se kjo orvatje e jona për gjuhën është një gjâ e re në jetët tonë si popull. Kjo i ka të vjetra rranjat: për këte pastrim të gjuhës janë kujdesë shkrimtarët tonë të hershëm qysh prej Budit e tehu, d.m.th. qysh prej shekullit 16”³, shkruante Xhuvani më 1956.

Duke e çmuar edhe përpjekjen e shkrimtarëve të *Rilindjes* për pastërtinë e gjuhës sonë, Xhuvani pohonte me të drejtë: “Si dihet, në gjuhët tonë, prej marrëdhanievet që ka pasë populli ynë me popuj të tjerë, kanë hymë gjatë shekujvet fjalë të hueja mjaft, si latinishte, slavishte, turqishte e greqishte, të cilat gjuha i ka mbrujtë dhe u ka dhanë trajtë shqipe. Por Rilindasit kishin përpara syvet zgjedhën otomane që randoi për pesë shekuj mbi popullin tonë, dhe bashkë me dëshirën e me përpjekjet e tyre për ta flakë këte zgjedhë e për ta çlirue popullin soje kishin edhe kujdesin e madh për ta dliurë gjuhën edhe nga fjalët që kishin hymë në te prej kësaj zgjedhe, tue mos e vra fort mendjen mâ tej për fjalët e tjera të hueja”⁴.

Dëshira për ta pastruar shqipen nga fjalët e turqishtes, sikur i la nën hije përpjekjet e rilindasve për pastrimin e saj edhe nga fjalët e gjuhëve të tjera të huaja. Sidoqoftë, Xhuvani nuk lë pa përmendur se rilindasit, sidomos Naimi e Samiu, e shkruajnë shqipen “me një kthjellti e pastërti për t’u çuditë”. Po ashtu, ai veçon punën e madhe të Kristoforidhit, i cili “u reshtet fjalëvet të hueja, sidomos fjalëvet turqishte, si djalli nga thimiami”⁵. Në të vërtetë, Xhuvani duket se e çmon sidomos faktin se Konstandin Kristoforidhi, në Fjalorin e tij prej njëmbëdhjetë mijë e më tepër fjalësh, “nuk ka shtimë asnjë fjalë turqishte”.

Me gjithë kujdesin e rilindasve tanë, gjuha shqipe nuk u shpëtoi dot fjalëve të huaja.

“Por, sikundër që ka ndodhë në gjuhët e tjera të botës, që-shtu ndodhi edhe ndër ne; nga padia e nga pakujdesia e atyneve që e përdorshin gjuhën në të trajtuem gjithfarë çashtjesh, hynë edhe në gjuhët tonë mâ fort qysh prej shpalljes së pavarësisë më 1912 e tehu, shumë fjalë të hueja pa nevojë, kurse, në mos të gjitha, por shumë syresh mund zavendësoheshin me fjalë shqipe”⁶, vijon A. Xhuvani.

II. *Huazimet e sotme – një pamje e shkurtër*

Dukuria e përdorimit të fjalëve të huaja, edhe kur ato i kanë fjalët sinonime në gjuhën tonë, është e pranishme edhe sot, madje me shtrirje dhe intensitet shumë të

³ Aleksandër Xhuvani, *Për pastërtinë e gjuhës shqipe*, “Rilindja”, Prishtinë, 1968, fq. 7.

⁴ A. Xhuvani, vep., e cit., fq. 8.

⁵ Po aty.

⁶ A. Xhuvani, vep., e cit., fq. 9.

lartë në të gjitha fushat e jetës. Shfletimi pak më i kujdesshëm i revistave dhe të përditshmeve tona - pa i shqyrtuar fare *portalet elektronike*, ligjërimi i të cilave pa fije dyshimi mund të renditet te thjeshtëligjërimi - dëshmon praninë e madhe të fjalëve të huaja në shqipen e sotme publike. Për ta pasqyruar me shembuj konkretë këtë dukuri, kemi mbikëqyruar vetëm një javë, nga data 2 deri më 9 qershor 2015, dy gazeta të Kosovës, “Koha ditore” dhe “Zëri”⁷, në të cilat kemi gjetur plot fjalë të huaja, të cilat fare lehtë mund të zëvendësoheshin me fjalët përkatëse të shqipes. I kemi mbikëqyruar rubrikat që mbulojnë përditshmërinë/aktualitetin, kulturën dhe sportin. Si rezultat, kemi vërejtur se shumë fjalë të huaja, që janë tepër të pranishme në faqet e këtyre gazetave, mund të shmangeshin lehtë, po të tregohej vetëm pak kujdes qoftë nga gazetarët, qoftë nga redaktorët gjuhësorë/lektorët.

Kështu, në artikullin e “Kohës ditore”, *Loja direkte i sjellë Barçës “triple tën” e dytë* (fq. 36), gjejmë këto fjalë të huaja: direkt – drejtpërdrejt; demonstruar – paraqitur; fenomenale – e jashtëzakonshme; iniciativë – nismë; ofenzive – sulmuese; posedim – zotërim; spektakolare – madhështore; stabilitetin – qëndrueshmërinë; tretmanin – trajtimin; unike – e veçantë.

Po në këtë gazetë, në tekstin me titull *Juventusit mban kokën lart me gjithë humbjen në finale* (fq. 36, dt. 8. VI. 2015), po ashtu, lehtësisht mund të mos përdroreshin këto fjalë të huaja: ekstazë – përhanie; karshi - përballë; limiteve – kufizimeve; performancën – paraqitjen; objektivi – qëllimi; triumfit – fitores/ngadhënimit etj.

Në njoftimin e zgjeruar për hapjen e një ekspozite, “*Expo Diaspora*”, me 40 punime në Bocholt, kjo gazetë, më 7 qershor, në faqet e *Kulturës*, përman gjithashtu mjaft fjalë të huaja: audiencës – masës; fragment – pjesë; eveniment – ngjarje; identifikohet – njihet; iniciuar – nisur; mesazhin – porosinë; neglizhencë – moskujdes, lënie pas dore; nivelin – shkallën; prezantuar – shfaqur; zhanreve – llojeve.

Edhe në gazetën “Zëri” është shumë e pranishme dukuria e përdorimit pa vend të fjalëve të huaja. Kështu, në tekstin *Familjen në ISIS, tash në “luftë” me pushtetin*, fq. 4-5, të datës 8. VI. 2015, hasim këto fjalë: abuzim – keqpërdorim, ambientale – mjedisore; diskriminim – kufizim i të drejtave; fenomen – dukuri; eliminim – zhdukje, çrënjësje; mazhorancë – shumicë; monitoron – vëzhgon, mbikëqyr; lokacion – vend; pretekstin – shkasin; pretendimet – synimet; sugjeroj – këshilloj; specifike – e veçantë.

Në faqen 29, në tekstin *Turqi, kurdët shumë pranë pragut elektoral*, të po këtij numri, “Zëri” po ashtu na mbyty me fjalë të huaja: avancim – përparim; ambicie – dëshirë, synim; avantazh – epërsi; dominim – zotërim, sundim; elektoral – zgjedhor; influencë

⁷ Kjo mbikëqyrje është realizuar në kuadër të kursit *Kulturë gjube* me studentët e Fakultetit të Edukimit të Universitetit të Prishtinës.

– ndikim; president – kryetar; minoritet – pakicë; miting – takim, mbledhje; prioritet – përparësi; sondazheve – vëzhgimeve, mbikëqyrjeve.

Po ashtu, edhe në faqen e *Ekonomisë*, po të datës 8. VI. 2015, bie në sy përdorimi i fjalëve të huaja, si: aprovim – miratim; auditim – kontrollim; evidencën – thekson, vë në pah; evidente – e qartë, e dukshme; i atribuohet – i kushtohet, i ndajvitet; iniciativa – nisma; kontratë valide – marrëveshje e vlefshme, konsolidim – forcim, rregullim; posedon – ka, përmban; lider – udhëheqës, prijës; mazhorancë – shumicë; neglizhim – shkuqdesje, lënie pas dore; parcelë – ngastër, pjesë e tokës; reputacion – nam, famë.

Numri i përdorimit të panevojshëm të fjalëve të huaja në këto gazeta, të cilat, megjithatë, çmohen si ndër më cilësoret në vendin tonë, është vërtet shqetësues. Dhe, kur gjendja na paraqitet e tillë në to, atëherë njeriu as që guxon ta marrë me mend shkallën e shpërfytyrimit të gjuhës sonë në mjetet e tjera të informimit, qofshin ato gazeta, qofshin portale elektronike.

Por, më e rëndë se prania e theksuar e fjalëve të huaja është dukuria e huazimit strukturor nga gjuhët e huaja, e cila bën që fjalitë në gjuhën shqipe të jenë të paqarta, sa për shkak të rendit të panatyrshëm të fjalëve (gjymtyrëve në fjali), po aq edhe për shkak të mosrespektimit të rregullave të drejtshkrimit dhe të drejtshqiptimit.

Shmangiet në fushë të fonetikës janë të shumëllojshme. Siç e kemi vënë në dukje edhe më parë⁸, në radiotelevizione, folësit/spikerët nuk kanë aspak kujdes për tempin, ritmin, pauzën, intonacionin, shprehshmërinë, intensitetin e zërit. Veçanërisht në Kosovë, është shumë e pranishme dukuria e shqiptimit të keq të tingujve. Pothuajse është bërë i rëndomtë shqiptimi i qiellzoreve mesgjuhore *q* dhe *gj* në vend të qiellzoreve alvelare *ç* dhe *xh*, ndërsa është, gjithashtu, mjaft i shpeshtë përdorimi jo i drejtë i zanoreve *i, y* dhe *u*, si dhe monoftongimi i grupeve të zanoreve *ie, ye* dhe *ue* në *i, y* dhe *u*.

Në morfologji vijon të jetë shumë e pranishme dukuria e përdorimit të gabuar të trajtave të shkurtra të përemrit vetor, sidomos të rasës dhanore. Sa për ilustrim, po veçojmë këta dy shembuj të marrë nga faqja 30 e gazetës “Zëri” (3 qershor 2015), më konkretisht nga artikulli *Mosmarrëveshje për pasuritë e Robin Williams*:

1. *Gruas dhe fëmijëve të Robin Williams i janë dhënë dy muaj më shumë për të zgjidhur një marrëveshje mbi ndarjen e pasurive të komikut.*
2. *Gjykatësi i dha dy palëve kohë deri në fund të korrikut për të zgjidhur problemet.*

⁸ Shih Xhavit Beqiri, *Identiteti gjuhësor dhe globalizmi (Vënerime sociolinguistike)*, “Drita”, Prizren, 2012, fq. 30.

Në të dyja rastet e sipërcekura, trajta e shkurtër e përemrit vetor është e gabuar, sepse në vend të formës së dhanores shumë *u* përdoret forma e dhanores njëjës *i*.

Në përgjithësi, në gjuhën shqipe rendi i fjalëve në fjali është i lirë, edhe pse ekziston një rend i zakonshëm: *kryefjalë + kallëzues + gjymtyrë e dytë*. Ky rend quhet edhe *rend i drejtë gramatikor* ose *neutral*, ndryshe nga rendi i anasjelltë, në të cilin gjymtyra e dytë (përcaktor, kundrinor, rrethanor etj.) vihet para gjymtyrëve a gjymtyrës kryesore. Megjithatë, duhet të ceket se, rendi i fjalive asindetike dhe i fjalive të bashkërenditura zakonisht është i ngulitur.

Përveçse nuk përkojnë me natyrën e topikës së shqipes, fjalitë që ndërtohen sipas modeleve (gjedheve) të huazuara dalin edhe të palogjikshme. Për fat të keq, ndërtimet e tilla janë aq të shpeshta, sa që lexuesi/dëgjuesi mund ta ketë përshtypjen se *gjithçka është shqip*. Disa nga shembujt vijues madje janë bërë të zakonshëm për shqipen publike, pavarësisht se janë huazime strukturore nga serbishtja:

- Në qoftë se nuk gabohe (ako se ne grešim/varam) – për *në qoftë se nuk gabo*;
- Do të jem i shkurtër (biću kratak) – në vend se *do të flas shkurt* ose *nuk do ta zgjas*;
- Ndaj mendimin me N. N (delim mišljenje) – për *pajtohem me mendimin e N. N*;
- Mirupafshim deri nesër (do sutra dovidjenja) – për *mirupafshim nesër!*

Në shembullin e parë, folja e paraprirë nga pjesëza mohuese *nuk*, është përdorur në diatezën joveprore (*nuk + gabohem*). Në këtë rast, nevojitet qartas trajta përkatëse e foljes në diatezën veprorë (*nuk + gabo*). Te shembulli i dytë, po ashtu, mjafton një analizë e sipërfaqshme semantike për të parë se shkruesi/folësi ia ka huqur krejt, sepse s’është në dorën e atij (që flet a shkruan) as të jetë, as të bëhet më i shkurtër apo më i gjatë sesa është. Në shembullin e tretë, mendimi nuk ka si të ndahet, kurse në të katërtin folësi/spikeri s’është i vetëdijshëm se për ta përshëndetur dikë, me të cilin ndahesh, mjafton t’i thuash *mirupafshim*. Kështu si është fjalia (Mirupafshim deri nesër!), i bie që ai të mos ndahet fare, *deri nesër*, me atë (apo me ata) që përshëndet.

III. Tjetër qasje për gjuhën

Duke i parë “prurjet” kaq të shpeshta në shqipen e sotme, ndoshta mund të shtrohet dilema se a do të jetë mjaft e zonja gjuha jonë, tani dhe në të ardhmen, që t’i mbrujë e t’u japë trajtë shqipe të gjitha fjalëve e ndërtimeve që po e vërshojnë kaq me hov gjuhën tonë?!

“Letërsia sot zhvillon disa ushtrime për gjuhën si pronë kolektive. Gjuha, siç dihet, shkon nga t’i teket, nuk njih asnjë dekret nga lart, as nga politika, as nga akademitë, ajo mund ta ndalë hapin, por edhe mund të devijojë në gjendje të tjera, të cilat i konsideron optimale”⁹, thotë Umberto Eco.

Sado që ky mendim i Ekos për gjuhën disi na ngushëllon prapëseprapë nuk kemi si të mos e shfaqim një dozë frike se, po nuk ndodhi ndonjë ndryshim rrënjësor në qëndrimin tonë ndaj gjuhës, shqipja pas disa motesh mund të ketë një pamje krejt tjetër, një sistem të trashëguar e të normëzuar, të mbizotëruar gati tërësisht me leksik/fjalës të huaj!

Çështja e pastërtisë së gjuhës sonë dhe e shmangies së përdorimit të fjalëve e të konstrukteve të huaja duhet të shihet më shumë si problem sociolinguistik. Kjo çështje mund të trajtohet qoftë si një temë mjaft interesante sociolinguistike, nëse në qendër të venerimit vihet gjuha shqipe në raport me shoqërinë shqiptare (në tërësi), qoftë si një temë e sociologjisë së gjuhës, nëse dëshirohet të hetohet qëndrimi i shoqërisë shqiptare ndaj gjuhës shqipe. Madje, studimi i themeltë i kësaj teme do të ishte me shumë interes për të parë më me saktësi pse shqiptarët po e *braktisin* gjuhën e tyre, për t’i parë jo vetëm shkaqet, po edhe pasojat (e pritshme).

Megjithatë, ritheksojmë se shqipen nga vërshimi i fjalëve të huaj nuk e shpëton dot as *purizmi*. Ndërndikimet kulturore e gjuhësore sot janë aq të fuqishme, sa të thuash jam purist, është si të thuash jam Don Kishot! Prandaj, nevojitet tjetër strategji, tjetër qasje.

Ashtu siç bënë të parët, duhet të bëjnë edhe pasardhësit. Shpëtimi i gjuhës duhet të kërkohet te pasuria e madhe e leksikut/fjalësit shqip, te ai det i madh fjalësh konotimesh nga më të begatshmet, të cilat kanë mbetur jashtë fjalorëve të cinguar të shqipes së sotme normative. Le të hedhim një sy në thesarin e pashtershëm të epikës gojore shqipe, le ta kthejmë vëmendjen kah vepra e paanë e Fishtës, e Koliqit, e Camajt dhe e të gjithë krijuesve të tjerë që ishin të ndaluar, që të shohim se shqipja i ka të gjitha mundësitë për të qenë sërish *þorsi i ambli flladi i ërës* (Fishta), *e pastër dhe e dëlirë* (Naimi).

Me vendime të njëanshme, me dekrete plenumesh, gjuha as shpëtohet, as pasurohet! Thesari i brendshëm i vet gjuhës, i ruajtur dhe i mbujtur në letërsi (në të gjitha format e saj), është pika drejt së cilës duhet të drejtohemi!

Së fundi, për t’u rikthyer te titulli i këtij teksti, rikujtojmë se Roman Jakobsoni pohonte: “Gjuha pranon elemente të huaja vetëm atëherë kur ato përkojnë me

⁹ Umberto Eco, *Si shkruaj*, ShB “AIKD”, Prishtinë, 2003, fq.109.

tendencat e zhvillimit të saj”¹⁰. Pra, kjo do të thotë se në gjuhën marrëse duhet të ekzistojë vend latent për ato elemente, duhet të jetë krijuar që më parë njëfarë paradispozicioni strukturor në gjuhën marrëse për të pranuar elemente të gjuhës dhënëse.

Siç besojmë se e kemi dëshmuar edhe me shembujt e dhënë në këtë tekst, shqipja e sotme as nuk ka krijuar *vend latent*, as paradispozicion për të huazuar fjalë e konstrukte të huaja. Ndaj, edhe po themi *latencë e panatyrshme*, sepse huazimet po bëhen jo aq nga nevojat e shqipes si gjuhë, sa nga prirja jonë e çuditshme për të marrë me çdo kusht fjalë të huaja, madje edhe atëherë kur nuk na duhen fare (meqë i kemi tonat).

E meta, dhe këtë duhet ta themi troç, nuk qëndon te gjuha, te gjuha shqipe në rastin tonë, por te folësit/shkruesit e saj, të cilët ose nuk kanë formim të duhur gjuhësor (kompetencë gjuhësore), ose vuajnë që e kanë shqipen gjuhë amtare dhe, pa zgjedhur si e qysh, duan të tregojnë se kanë fjalës të pasur joshqip!

¹⁰ Roman Jakobson, *Sur la théorie des affinités phonologique entre les langues*, Appendix IV në N. S. Trubekoy: *Principes de phonologie*, Paris, 1949, fq. 359.

Fehmi ISMAJLI

FJALORTHI I TERMAVE PËR MËSIMDHËNËS I KURRIKULËS BËRTHAMË PËR KLASËN PARAFILLORE DHE ARSIMIN FILLOR TË KOSOVËS

Mileniumi i ri e ka gjetur Kosovën me probleme të mëdha dhe të ndryshme, si pasojë e rrethanave të veçanta të cilat iu imponuan më heret (lufta e fundit dhe pasojat e saj), por edhe si pasojë e ndërrimit të sistemit shoqëror-politik që domosdoshmërisht kushtëzoi ndryshime të tjera në sistemin arsimor të saj. Kështu, nga viti 2002, Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë (MASHT), krahas procesit të (ri)ndërtimit dhe aftësimit të infrastrukturës shkollore, ka filluar procesin e reformimit të tërësishëm të sistemit arsimor të Republikës së Kosovës, ku janë bërë një mori hapash të rëndësishëm¹. Pas hartimit dhe miratimit të *Kornizës së Kurrikulës së Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës*² (2011), njëra ndër të arriturat e rëndësishme të këtyre reformave, padyshim, është hartimi dhe miratimi i *Kurrikulës Bërthamë për klasën parafillore dhe arsimin fillor të Kosovës*³ (2012).

Ky akt nënligjor, i dalë nga *Korniza e Kurrikulës*, përkufizon ligjërisht fushat e *Kurrikulës Bërthamë* dhe rezultatet e të nxëniet sipas tyre; strukturën e fushave kurrikulare; përkufizon Planet dhe Programet mësimore, kriteret për hartimin dhe zbatimin e tyre në praktikë; përkufizon autonominë e shkollës dhe përcakton kurrikulën zgjedhore për nivelin e parë arsimor⁴; përcakton metodologjinë e përgjithshme të punës dhe jep udhëzime lidhur me procesin e mësimdhënies dhe udhëzime të përgjithshme për vlerësimin.

Para vitit 2000 termi *kurrikulë* nuk ishte në përdorim, por pasi Kosova duhej të përfaqësojë terminologjinë arsimore të saj me atë të vendeve euro-perëndimore, ajo u

¹ Po veçojmë disa prej tyre: dizajnimin e sistemit të ri arsimor në Kosovë; hartimin dhe miratimin e ligjeve dhe të akteve nënligjore; hartimin dhe miratimin e Planit të ri mësimor; hartimin e Programeve të reja lëndore; trajnimet e ndryshme të mësimdhënësve dhe të udhëheqësve të institucioneve edukativo-arsimore; hartimin e teksteve të reja shkollore, etj.

² Në vazhdim të këtij studimi do të përdorim emërtimin e shkurtuar - *Kornizë e Kurrikulës* (ose KK)

³ Kurrikula Bërthamë është hartuar nga një komision i gjerë ekspertësh të arsimit, i ndarë sipas fushave kurrikulare është miratuar me Vendimin e ministrit të MASHT-it, nr. 291/01B. KB

⁴ Klasën parafillore dhe klasat: I, II, III, IV dhe V të shkollës fillore

fut në përdorim në vend të termit *plan-program*, madje një kohë edhe pa u kuptuar mirë kuptimi dhe aq më pak dimensionin e plotë kuptimor të tij. Termi *kurrikulë* nuk ka të njëjtin kuptim as dimensionin kuptimor me atë të termit *plan-program*. I pari ka kuptim shumë më të gjërë se i dyti, prandaj, përmbajtësisht, *në themel të saj qëndron një plan*⁵. *Kurrikula si fushë studimi është karakterizuar si e pakapshme, e copëzuar dhe e ngatërruar*⁶. *Metoda e kurrikulës pasqyron një qëndrim gjithpërfshirës dhe gjithë-orientues*⁷. Kështu, termi *kurrikulë* filloi të kuptohet më qartë dhe ngadalë të zërë vendin e fjalës së deriatëhershme - *plan-program* e cila ka kuptim më të ngushtë se ajo, prandaj ai nuk është veçse një pjesë përbërëse e saj.

1.0. PËRZGJEDHJA E KONCEPTVE / TERMAVE TË FJALORTHIT

Kurrikula Bërthamë, përveç përmbajtjeve të sipërshënuara, ka përfshirë edhe një fjalor arsimor-pedagogjik të kësaj fushe, për këtë nivel arsimor, me emrin – *Fjalorth i termave për mësimdhënës*, i paraqitur në një tabelë prej afër 100 *konceptesh*⁸ të ndryshme të cilat janë emërtuar me *termat* e relevantë. Në të nuk ka të dhëna për kriteret e përzgjedhjes së termave. Këta terma⁹ të ndryshëm, sipas fushave kurrikulare¹⁰, janë paraqitur në fund të Kurrikulës Bërthamë¹¹. Fjalorthi paraqitet në formën e një liste *termash*, të renditur pa ndonjë kriter relevant¹², me një shënim¹³ që lë të kuptohet se përdorimi i tij nuk kufizohet vetëm në nivelin arsimor të cilit i kushtohet (niveli arsimor 1).

Por, si janë përzgjedhur termat e këtij Fjalorthi? Përgjegjjen në këtë pyetje nuk e kemi gjetur në Kurrikulën Bërthamë sepse në të nuk ka shënim për kriterin ose kriteret e përzgjedhjes së tyre, prandaj vetëm mund të bëhen supozime. Natyrisht, supozimet mund të jenë të ndryshme, por supozimi më logjik dhe më i mundshëm çon në përfundimin se kjo përzgjedhje e termave të Fjalorthit është bazuar në Kornizën e Kurrikulës (KK), pasi ky dokument është miratuar para Kurrikulës

⁵ Allan C. Ornstein, Francis P. Hunkins, *KURRIKULA, Bazë, parime dhe probleme*, botimi III, Tiranë, 2003, fq. 3

⁶ Ibid. fq. 1

⁷ Ibid, fq. 2

⁸ *Fjalorthi i termave për mësimdhënës i Kurrikulës Bërthamë* është i ngjashëm me *Fjalorthin e Kornizës së Kurrikulës*, sidomos nga vëllimi i tyre, por duke u dalluar prej tij me fleksibilitetin e përdorimit të tij

⁹ Në këtë studim do të ruajmë termin *koncept*, në kuptimin e njësisë leksikografike

¹⁰ Për fushën kurrikulare *Gjuhët dhe komunikimi* ka punuar një komision 14 anëtarësh

¹¹ Fq: 113-125

¹² Fjalët nuk janë renditur as sipas rendit alfabetik as sipas kriterëve gjuhësorë të shqipes

¹³ Në shënim shkruan: *Termt që nuk janë relevantë për mësimdhënësit mund të hiqen*

Bërthamë (KB) dhe pasi ajo mbulon tërë arsimin parauniversitar në të cilin bën pjesë edhe i Kurrikula Bërthamë dhe Fjalorthi i saj.

Nëse i bëjmë një vështrim analitik këtij Fjalorthi mund të vërejmë që pjesa më e madhe e fjalëve të tij i përket një fjalorthi gjuhësor specifik, arsimor-pedagogjik i cili në Kosovë është përdorur edhe më parë dhe i cili është i njohur për të gjithë ata që kanë një përvojë pune në institucione edukativo-arsimore (për mësimdhënës, udhëheqës dhe administratorë të tyre), pasi ata e kanë përdorur atë në praktikë, në të dy format e komunikimit zyrtar. Mirëpo, si rezultat i fenomenit të globalizimit, në të gjenden edhe një numër termash të huazuar nga gjuha e huaj¹⁴, në numër jo aq të vogël, që për një kohë mund të konsiderohen si terma të panjohur.

Tani duhet shikuar këtë Fjalorth nga prizmi i makrostrukturës dhe mikrostrukturës së tij. Fjalorthi ka një numër shumë të kufizuar termash, fjalë ose togfjalësha¹⁵, që dallon nga një fjalorth i zakonshëm gjuhësor jo vetëm nga vëllimi (numri i termave që ka), nga mënyra e trajtimit të tyre e tyre, por edhe nga qëllimi i hartimit të tij. Ky Fjalorth ka për qëllim përzgjedhjen e një numri të kufizuar termash profesionalë të fushës së arsimit dhe të nivelit të caktuar arsimor, me qëllim të përkufizimit kuptimor, përvetësimit dhe përdorimit të tij praktik dhe zyrtar, brendainstitucional dhe ndërinstitucional, nga të gjithë ata që punojnë në këtë fushë dhe nivel arsimor. Pra, shikuar nga ky aspekt, ky Fjalorth nuk i ngjan shumë një fjalorthi gjuhësor, edhe pse në disa aspekte tjera kanë ngjashmëri.

Pokështu, Fjalorthi dallon nga fjalorë të tjerë gjuhësorë edhe përnga mikrostruktura e tij pasi është më specifik nga të tjerët. Kjo ndodhë pasi përzgjedhja e termave të tij nuk i është nënshtruar strukturës gramatikore të tyre sepse ai nuk ka për qëllim përzgjedhjen e një fjalori të përgjithshëm për komunikim ndërpersonal dhe për çështje personale, por për një përdorim dhe zbatim të tij në praktikë, në institucioneve edukativo-arsimore të këtij niveli. Shikuar nga ky prizëm, mikrostruktura e Fjalorthit të Kurrikulës Bërthamë është e varfër: fjalët e tij, në masën më të madhe, i takojnë kategorisë së emrave (te fjalët) dhe atyre të emrave e mbiemrave (te togfjalëshat). Kategoritë tjera gramatikore në këtë Fjalorth janë në numër shumë të vogël¹⁶.

Në këtu nuk do të përpilojmë ndonjë listë të ngurtë të termave të këtij niveli arsimor pasi, së pari, ky nuk është qëllim i këtij studimi dhe, së dyti, pasi në fund të këtij studimi do të paraqesim listën e termave të këtij Fjalorthi, në formë tabelare, me shënime që lidhen me aspekte të ndryshme të tyre. Shikuar në tërësi, Fjalorthi i

¹⁴ Ata i takojnë gjuhës angleze

¹⁵ Numri i fjalëve të një togfjalëshi arrin deri në 7

¹⁶ Në Fjalorth ka edhe fjalë të kategorive gramatikore të tjera (si: lidhëza, parafjalë, etj.)

Kurrikulës Bërthamë përfshin një numër të mjaftueshëm termash, madje më të madh se ai i Kornizës së Kurrikulës e cila përfshin tërë arsimin parauniversitar në Kosovë¹⁷.

Por, cila është përbërja e këtij Fjalorthi? Natyrisht, këtu duhet nënvizuar se shumica absolute e termave të tij përbëjnë një fjalorth arsimor-pegagogjik i cili është përdorur në Kosovë për një kohë të gjatë dhe si i tillë është bërë i njohur për personelin arsimor. Megjithkëtë, një pjesë më e vogël e tyre janë terma të huazuar, kryesisht të panjohur për një kohë të caktuar. Këto huazime, edhe pse në numër të vogël karshi fjalëve të mëparme, duke u përsëritur dendur, herë si fjalë¹⁸, herë si togfjalësha¹⁹, përbëjnë një numër jo të vogël termash të Fjalorthit të cilët, në aspektin kuptimor, bëhen terma pjesërisht të njohur e pjesërisht jo²⁰. Termat e rinjë, të paraqitur në Fjalorth si fjalë të thjeshta, janë më të lehtë për njohje dhe përdorim të tyre, ndërsa të përfshira në togfjalësha, duke marrë kuptime të përgjithshme, ato mund të kërkojnë më shumë kohë për përvetësim dhe për përdorim të drejtë të tyre në praktikën arsimore. Edhe në rastet kur ndonjëra nga fjalët e togfjalëshit është e njohur, kuptimet e përgjithshme të tyre nuk mund të “nxirren” nga kuptimet e fjalëve përbërëse të tyre. Kjo ndodhë sidomos nëse fjala kryesore (një emër ose mbiemër) është huazuar dhe, rrjedhimisht, edhe si e tillë është e panjohur.

Prandaj, sidomos në një kohë fillestare, është shumë e nevojshme që kuptimet e tyre të qartësohen mirë, në mënyrë përshtatëse (duke përdorur me këtë rast një fjalor të njohur për personelin arsimor), ose me përdorim të termave relevantë, ashtu siç është vepruar në këtë rast. Në të kundërtën, përdoruesit e tyre do të kenë vështirësi në të kuptuarit e qartë të tyre dhe, rrjedhimisht, edhe ngatërime në përdorimin e tyre në praktikë, në institucionet edukativo-arsimore në të cilat punojnë.

Mirëpo, vërejtjet tona nuk kanë të bëjnë shumë me vet përzgjedhjen e këtyre termave, edhe pse këtu vërehen mangësi të caktuara²¹, por edhe prani të termave jo

¹⁷ Fjalorthi i *Kurrikulës Bërthamë* ka 99 terma, kurse ai i *Kornizës së Kurrikulës* përfshin 89 terma të ndryshëm

¹⁸ Janë gjithsej 5 fjalë të këtilla (*kurrikulë, kurrikulare, ekstrakurrikulare, formativ, holistik*), të futura zyrtarisht në përdorim praktik nga viti 1999, por të zyrtarizuara me këtë dokument të rëndësishëm

¹⁹ Fjala është për togfjalësh të ndryshëm në të cilët ato janë përdorur si kategori gramatikore të ndryshme (kryesisht si emra dhe mbiemra)

²⁰ Ja përdorimet e këtyre termave të huazuar të Fjalorthit, si togfjalësha: aktivitetet *ekstrakurrikulare*, çështje të ndërlikuara *ndërkurrikulare*, fushë *kurrikulare*, integrimi i *Kurrikulës*, korniza e *Kurrikulës*, *Kurrikula* bërthamë, *Kurrikula* efektive, *Kurrikula* e fshehur, *Kurrikula* formale, *Kurrikula* me bazë shkolle (në institucion), *Kurrikula* spirale, *Kurrikula* zgjedhore, mësimi *holistik* dhe i gjithanshëm, mjedisi për mësim *holistik*, politikat e *Kurrikulës*, sistemi i *Kurrikulës*, struktura e *Kurrikulës*, shkalla kryesore e *Kurrikulës*, vlerësimi *formativ* dhe zhvillimi *holistik*

²¹ *Klasë parafillore, edukator*, e donjë term tjetër që lidhet me këtë klasë

shumë të nevojshëm për këtë nivel arsimor²². Në këtë aspekt, ne do të jepnim një vlerësim pozitiv pasi, marrë më përgjithësi, përzgjedhja e termave është bazuar në një fjalor specifik, tashmë të njohur, të kësaj fushe dhe pasi që, si rezultat i reformimit të përgjithshëm të sistemit arsimor në Republikën e Kosovës, ai është zgjeruar dhe pasuruar me fjalë të huazuara. Natyrisht, ky huazim ishte i nevojshëm pasi që *gjuhët ndryshojnë për shkak se ndryshojnë edhe njerëzit që i flasin ato dhe rrethanat në të cilat jetojnë* (Murati, 2011)²³. Ky fenomen, i shndërruar në *globalizim*, është shumë i përhapur pasi *sot ndeshen, nga një anë, prirja e globalizimit dhe, nga ana tjetër, prirja e asbtuqajtur e "indigjenizimit" të kulturave* (Memisha, 2011)²⁴, pra edhe e gjuhëve të ndryshme.

Dukuria e huazimeve është e njohur qëmoti dhe ndodh jo vetëm në gjuhën shqipe. Pra, asnjë gjuhë nuk mund të izolohet nga të tjerat, prandaj huazimi nuk mund të vlerësohet si gjendje e varfërisë leksikore të një gjuhe të caktuar. Por, kjo prirje do të duhej kufizuar vetëm në *fjalët e nevojshme*, por jo edhe në *të panevojshmet* (Murati, 2011, siç është vepruar në rastin tonë. Përveç kësaj, fjalët e huazuara do të duheshin trajtuar sipas disa *qëndrimeve* (Rrokaj, 2014)²⁵ të përcaktuara paraprakisht e që lidhen me *akomodimin* e tyre në leksikon e gjuhës shqipe, sipas rregullave dhe specifikave të saj.

Huazimet e fjalëve të panevojshme në rastin tonë, në numër të kufizuar, sipas mendimit tonë, kanë mundur të mënjanohen, pa asnjë mëdyshje, duke përdorur në vend të tyre fjalë burimore të leksikut të shqipes, të përdorura edhe më parë në këtë fushë të dijes të cilat, në aspektin kuptimor, do të zëvendësonin plotësisht fjalët e huazuara²⁶. Në këto raste, ne shohim një "huazim" të panevojshëm kur pa pasur nevojë futet në përdorim një term i huaj, për një kohë i panjohur (ose jo plotësisht i njohur) dhe pa pasur nevojë nxjerr nga përdorimi një term i cili ka pasur një përdorim të gjatë dhe të efektshëm.

2.0. PARAQITJA E TERMAVE TË FJALORTHIT

Fjalorthi i *Kurrikulës Bërthamë* ka përfshirë, saktësisht 99 terma²⁷, të përzgjedhur dhe të paraqitur në fund të saj²⁸, në një Tabelë të ndarë në tri shtylla të ndryshme, për

²² Termat për nivelet tjera të arsimit parauniversitar si: *shkollë e mesme e ulët, shkollë e mesme e lartë, arsim joformal, arsim informal*, etj.

²³ Qemal Murati, *Të asbtuqajturat fjalë të huaja dhe purizmi*, "Gjuha shqipe", Prishtinë, 2011, fq. 6 (citat i huazuar nga Bugarski 2001)

²⁴ Valter Memisha, *Studime për fjalën shqipe*, Botart, Tiranë, 2011, fq. 163

²⁵ Shezai Rrokaj, *Përse e përdorim fjalën e huaj në vend të fjalës shqipe?! Revista Albanologjia*, 1-2, 2014, fq. 107

²⁶ Për shembull: aftësi (për *kompetencë*), përparim (për *progresion*), zgjedhor (për *selektiv*), etj.

²⁷ Për arsye praktike, *termi* do të përfshijë fjalët ose togfjalëshat të cilat, më vonë, mund të specifikohen

qëllime të ndryshme dhe me tekste të caktuara. Për arsye të natyrave të ndryshme, ne do t'i trajtojmë veç e veç.

Shtylla e parë përfshin termat e këtij Fjalorthi, të renditur në mënyrë të lirë, jo sipas rendit alfabetik siç veprohet me një fjalorth ose gjuhësor të zakonshëm. Si i këfillë, ai paraqet një objekt me interes për studim pasi ai do të jetë një minifjalor gjuhësor specifik, i fushës arsimore dhe pasi ai do të bëhet një fjalorth i detyrueshëm për përdorim të përditshëm në jetën profesionale të atyre që punojnë në këtë fushë të dijës. Ky Fjalorth, hartuar për herë të parë në këtë formë, i kushtohet një numri të konsiderueshëm punëtorësh të këtij niveli arsimor (dhe jo vetëm atij), prandaj ai meriton një trajtim të këfillë. Rëndësia e studimit të tij është e shumanshme, prandaj ai do të trajtohet si për përzgjedhjen dhe kriteret e përzgjedhjes së termave të tij; për paraqitjen dhe kriteret e paraqitjes në Fjalorth, ashtu edhe për përkufizimin kuptimor dhe përdorimin e drejtë të tyre në praktikën arsimore.

Në aspektin leksikologjik ky Fjalorth përfshinë fjalë dhe togfjalësha të ndryshëm. Të parat janë në numër të kufizuar²⁹, të dytat janë në numër shumë më të madh³⁰, duke paraqitur kështu, në këtë aspekt, përdorim të më shumë se një fjale të klasave të ndryshme gramatikore që shprehin një koncept të caktuar të këtij Fjalorthi. Togëfjalëshat shprehin një kuptim të përgjithshëm i cili do të duhej saktësuar në mënyrë përkthuese, me përdorimin e termave të nevojshme për këtë qëllim.

Por, si është bërë paraqitja e termave të këtij Fjalorthi? Ata nuk janë paraqitur mbi bazën e kriterëve të caktuara leksikografike as gjuhësore. Këto kritere është dashur të përfillen pasi janë të nevojshme për cilindo Fjalorth, prandaj edhe për këtë tonin. Renditja e termave sipas rendit alfabetik, një kriter bazë për hartimin dhe konsultimin e një fjalori / fjalorthi, në rastin tonë nuk është përfillur fare. Pothuaj njësoj ka ndodhur edhe me kriterin gjuhësor: emrat e shqipes (në njejës dhe në shumës), duhet të paraqiten në trajtën e pashquar, por kjo, në masën më të madhe, nuk ka ndodhur³¹, etj.

Pra, siç u pa më sipër, paraqitja e termave në këtë Fjalorth është përcjellë me lëshime leksikografike, gjuhësore dhe teknike³², në numër të konsiderueshëm, të cilat,

²⁸ Fjalorthi i *Kurrikulës Bërthamë* është paraqitur në 13 faqe të saj

²⁹ Janë gjithsej 17 fjalë të tilla: *llogaridbënia, vlerësimi, qëndrimi, kodi, komunikimi, kompetenca, kurrikulë, gjuha, mësimdhënia, vetëvlerësimi, shenja, simboli, shkathhtësia, standard, lënda, mësimdhënia dhe vlerat* – të përdorura herë në trajtën e pashquar e herë në të shquarën

³⁰ Në këtë Fjalorth janë gjithsej 82 togfjalësha, me nga 2 - 8 fjalë të ndryshme

³¹ Në këtë trajtë është dashur të paraqiten të gjithë termat, por kështu ka ndodhur vetëm në 7 sish: *lëndë bartëse, mjedis miqësor për fëmijët, vlerësim me bazë klase (vlerësim nga mësimdhënësi), Kurrikulë, klasë ndërvepruese dhe fushë kurrikulare*. termat tjerë (92 sish) janë paraqitur në trajtën e shquar

³² Si fjalët: *bashkësitë e interes publikë, kompetanca, aktivitetet ekstrakurrikulare, të njohurit, shenja, simboli*

me shpërputhje të rëndësishme brenda tyre, e bëjnë të nevojshme një paraqitje më të specifikuar:

- a) Termat në Fjalorth nuk janë renditur sipas rendit alfabetik, në kundërshtim me praktikën që ndiqen për hartimin e fjalorëve ose fjalorthëve të zakonshëm gjuhësorë;
- b) Termat mbulojnë klasën parafillore dhe shkollën fillore³³, por termi *klasë parafillore* nuk figuron fare në të dhe, padyshim, ky është njëri nga lëshimet e rëndësishme në procesin e përzgjedhjes së tyre;
- c) Përveç termit *arsim fillor* dhe ndoshta atij *arsim i përgjithshëm*, termat tjerë që emërtojnë nivele ose forma tjera arsimore, nuk kanë qenë të nevojshme për këtë Fjalorth pasi ato kanë zënë vend më heret në Fjalorthin e Kornizës së Kurrikulës³⁴, e cila përfshin edhe këtë nivel arsimor;
- d) Në Fjalorth termi *Kurrikula zgjedhor(e)* është paraqitur dy herë, në dy trajta të ndryshme³⁵, si rrjedhojë e ndonjë gabimi teknik;
- e) Gjatë paraqitjes së termave, në masën më të madhe, nuk është përfillur një kriter tjetër, kriteri gjuhësor i gjuhës shqipe – trajta e pashquar³⁶ e emrave e cila është përdorur shumë më pak sesa trajta e shquar.

Natyrisht, termat e përzgjedhur të këtij Fjalorthi, të shënuar në kolonën e parë, teknikisht janë dalluar nga termat tjerë, të shënuar me ngjyrë të theksuar, duke ndjekur një kriter jo të parëndësishëm me rastin e paraqitjes së tyre në të.

Këto terma (si fjalë a si togfjalësha), të paraqitur në këtë Fjalorth, nuk janë që të gjithë dhe plotësisht të njohur nga përdoruesit e tyre në praktikë, prandaj si të tillë, pas paraqitjes në të, sipas nevojës, është dashur edhe të qartësohen në aspektin kuptimor në atë shkallë që, pas konsultimit të tij, për përdoruesit e tyre të mos mbeten paqartësi të kësaj natyre dhe, rrjedhimisht, të mos krijohen ngatërime gjatë përdorimit të tyre në praktikën edukativo-arsimore. Natyrisht, nuk e kemi këtu fjalën për ata terma tasme të njohur që kanë qenë edhe më parë në përdorim dhe për të cilat nuk ka (pasur) nevojë për ndonjë shpjegim a qartësim kuptimor shtesë të tyre, por për ata terma të hauzuar, të futur në këtë Fjalorth, që realisht, të paktën për një kohë, mund të paraqesin vështirësi të kësaj natyre dhe të cilët realisht kanë nevojë për një përkufizim kuptimor më të qartë dhe më të plotë.

³³ Fjalorthi i tij përfshinë shkallët e Kurrikulës 1 dhe 2 të nivelit arsimor 1

³⁴ Fjalën e kemi për termat: *arsimi formal*, *arsimi gjithëpërfshirës*, *arsimi informal*, *arsimi i mesëm i ulët*, *arsimi joformal*, *arsimi i mesëm*, *arsimi dhe aftësimi profesional*

³⁵ *Kurrikula zgjedhore* (nr. 32) dhe *Kurrikula zgjedhor* (nr. 73 të Tabelës)

³⁶ Nga 99 termat e Fjalorthit, të paraqitur në të dy trajtat, vetëm 7 prej tyre janë paraqitur në trajtën e pashquar

3.0. SHPJEGIMI I KUPTIMIT TË FJALËVE

Për personelin e këtij niveli arsimor shumica e termave të Fjalorthit të Kurrikulës Bërthamë për klasën parafillore dhe arsimin fillor janë fjalë burimore të shqipes ose të huazuara më heret nga gjuhë të tjera dhe që kanë qenë në përdorim edhe para viteve 2000. Mirëpo, në mesin e tyre ka edhe terma të rinjë – të panjohur (në rastet e fjalëve) ose pjesërisht të njohur (në rastet e togfjalëshave). Për këtë arsye, hartuesit e këtij Fjalorthi, me të drejtë, e kanë parë të arsyeshme dhe të nevojshme që në tabelën e Fjalorthit të fusin një shtyllë të veçantë³⁷ në të cilën, duke përdorur një fjalor të njohur për personelin arsimor, në mënyrë përshkruese, kanë ofruar shpjegime shtesë (për termat e njohur) ose shpjegime bazë (për termat e panjohur), me qëllim të qartësimit të plotë të kuptimit të tyre. Kështu, kuptimet e ndryshme të këtyre termave janë *shpjeguar*, me fjalë burimore shqipe ose të huazuara qëmoti dhe që mundësojnë shpjegim të pjesërishtëm ose plotë të të kuptimit të tyre.

Mirëpo, si është bërë ky shpjegim dhe në ç'masë realizuar ai? Termat e këtij Fjalorthi janë trajtuar në të njëjtën mënyrë³⁸, duke u *shpjeguar*, që të gjithë, në mënyrë përshkruese, sikur të ishte fjala për terma të rinjë dhe të panjohur nga aspekti kuptimor. Kështu, për termat e përzgjedhur, terma të shqipes (si terma të njohur), apo terma të huazuar (si terma të panjohur), është përdorur shtyllë e veçantë për përkufizimin kuptimor të tyre, duke përdorur fjalor të njohur, pa bërë ndonjë trajtim të ndryshëm mes tyre. Dallimet në këtë aspekt mund të shihen vetëm në vëllimin e tekstit shpjegues (në numrin e fjalëve të përdorura) për termat e ndryshëm. Dallimet sasiore janë shumë të theksuara: kështu, për disa koncepte ka mjaftuar një fjali e shkurtër, për disa të tjera është bërë një *shpjegim* shumë më i gjatë³⁹.

Natyrisht, termat e këtij Fjalorthi, në këtë aspekt, është dashur të trajtohen në mënyra të ndryshme, varësisht se a është fjala për terma të huazuar ose jo, varësisht se a është fjala për fjalë të thjeshta ose të përbëra dhe jo në të njëjtën mënyrë që të gjithë. Sipas mendimit tonë, termat është dashur të ndahen në tri grupe: a) në terma (fjalë apo togfjalësha) kuptimisht të njohur; b) në terma pjesërisht të panjohur (togfjalësha në përbërjen e të cilëve ka edhe fjalë të reja)⁴⁰ dhe c) në terma të panjohur (fjalë të thjeshta), të huazuar dhe të futur në Fjalorth me një përdorim të dendur⁴¹.

³⁷ Tabela e Fjalorthit të KB që fillon në faqen 113, ka shtyllën e dytë me titull *Shpjegimi*

³⁸ Natyrisht, është jashtë çdo diskutimi se të gjithë këta terma (99 sish) janë të panjohur

³⁹ Shpjegimi më i shkurtër i i kuptimit të një termi të përzgjedhur ka vetëm 10 fjalë, më i gjati - 118 fjalë

⁴⁰ Ka gjithsej 22 terma të tillë në Fjalorthin e Kurrikulës Bërthamë (shih Shtojcën)

⁴¹ Në këtë Fjalorth kemi vetëm një fjalë të këtillë – *kurrikula* e cila përdoret shumë shpesh në togfjalësha të ndryshëm

Natyrish, për termat e njohur nuk ka pasur ndonjë nevojë reale për shpjegim të kuptimit të tyre; për të dytat mund të ketë pasur nevojë për shpjegim të pjesërishtë ose për shpjegim shtesë të kuptimit të tyre, kurse për të tretat, gjithsesi është ndër nevoja e *shpjegimit* dhe saktësisht kuptimor të tyre, duke përdorur terma të tjerë, të njohur, për t'i përkufizuar ato sa më qartë para përdorimit të tyre në praktikën arsimore.

Megjithkëtë, termat e Fjalorthit, edhe pse të trajtuara njësoj në këtë aspekt, janë shpjeguar dhe qartësuar në një masë të konsiderueshme, por cilësia e këtij shpjegimi, e shikuar sipas termave të përzgjedhur, duket hetogjene. Mirëpo, e vështruar në tërësi, ky shpjegim, sidomos ai i termave të huazuar, duket jo shumë i qartë për hapësirën që i është dhënë atij në këtë Fjalorth.

- I. Pas një vështrimi më të detajuar të këtij shpjegimi, paraqesim këto vërejtje:
- a) Për shpjegimin e termit *vlerësim i jashtëm*, në fjalinë e fundit të tekstit shpjegues, në vend të fjalës *subjektivizëm*, është përdorur gabimisht fjala *subjektivitet* e cila, edhe pse në formë duket e përafërt me të parën, në aspektin kuptimor nuk ka asgjë të përbashkët me të. Pokështu, në të njëjtën fjalë, përdorimi i termit *në maksimum*, nga një pakujdesi sintaksore, i jep asaj kuptim të kundërt me kuptimin e synuar⁴² të saj, duke krijuar një paqartësi të plotë. Fjalët do të duheshin përdorur në këto trajta: *maksimalisht* ose *në minimum*;
 - b) Gjatë shpjegimit të termave, në disa raste⁴³, janë formuluar fjali të mangëta të cilat nuk arrijnë tërësisht qëllimin e këtij shpjegimi;
 - c) Për shpjegimin e termit *Inteligjencat e shumëfishta* është përdorur togfjalëshi - zhvillim *i tërë personit*. Ky është një formulim gjuhësor jo i drejtë që nuk përkon me logjikën dhe natyrën e gjuhës shqipe⁴⁴, prandaj si të tillë nuk duhet pranuar pasi ne kemi (pasur) togfjalëshin zhvillim *i personalitetit të gjithanshëm* të nxënësit. Këtu kemi të bëjmë me ngatërrimin e dy emrave (*person* dhe *personalitet*) që, natyrish, nuk kanë të njëjtin kuptim dhe për dy mbiemra (*i tërë* dhe *i gjithanshëm*) që, poashtu, në gjuhën shqipe nuk kanë të njëjtin kuptim;

⁴² ... *Vlerësimi duhet të bazohet në standardet (kombëtare) të vlerësimit që subjektiviteti në vlerësim të zvogëlohet në maksimum* (i njëjti formulim shpjegues është përdorur edhe në rastin e shpjegimit të këtij termi në Fjalorthin e Kornizës së Kurrikulës)

⁴³ Kjo vlen për shpjegimin e termit *mësimdhënia e zgjeruar dhe koha për të mësuar*, apo të ndonjë termi tjetër

⁴⁴ Ky togfjalësh, në këtë formë, është përdorur edhe në Kornizën e Kurrikulës, si rezultat i përkthimit joadekuat

- d) Gjatë shpjegimit të termave të rinjë, jorralë, janë përdorur terma të tjerë të huaj të cilët nuk duket se kanë arritur në masë të madhe qëllimin e caktuar;
- e) Në tekstin shpjegues, shpeshherë tepër të zgjatur, ka edhe fjali jo të formuluar në frymën e sintaksës së gjuhës shqipe⁴⁵ të cilat nuk janë shumë të qarta;
- f) Ky tekst nuk ka arritur t'u shmanget plotësisht as gabimeve drejtshkrimore të ndonjë fjale e as gabimeve teknike të cilat dijnë të përvidhen shpesh.

Shikuar në tërësi, termat e këtij Fjalorthi, në masë të konsiderueshme kanë marrë shpjegimin e nevojshëm të kuptimit të tyre në kontekstin e caktuar, por sipas mendimit tonë jo edhe në masën e plotë, kryesisht për shkak të trajtimit të njëjtë të kategorive të ndryshme të tyre në aspektin kuptimor.

4.0. QARTËSIMI I TERMAVE ME TERMA TË BARASVLERSHËM

Fjalorthi i termave i Kurrikulës Bërthamë, përveç shtyllës së shpjegimit të termave të përzgjedhur, ka edhe një shtyllë plotësuese, të quajtur *Termt e barasvlershëm (anglisht, shqip dhe serbisht)*⁴⁶. Me termat e barasvlershëm është synuar një shpjegim plotësues ose një qartësim shtesë i termave të përzgjedhur. Siç është paralajmëruar në vet titullin e kësaj shtylle, për këtë qartësim të termave është dashur të jepen terma semantikisht të barasvlershëm që ata të mund të qartësonin (më shumë) ndonjë term të paqartë ose jo shumë të qartë të Fjalorthit. Nga gjithsej 99 terma të Fjalorthit, është bërë qartësimi i kuptimit të 28 syresh⁴⁷. Qartësimi është bërë në mënyra të ndryshme dhe jo vetëm me përdorimin e *termave të barasvlershëm*. Me këtë rast, janë përdorur mënyra të ndryshme të qartësimit të termave të përzgjedhur të Fjalorthit, duke përdorur tekst shpjegues, ngajshëm me shtyllën e shpjegimit të tyre. Pra, në këtë shtyllë kemi një qasje disonante në krahasim me qasjen e paralajmëruar në fillim.

Varësisht nga mënyra e qartësimit të këtyre termave në këtë shtyllë, ne i ndajmë ato në katër grupe, më pak ose më shumë të ndryshme mes vete:

⁴⁵ Sipas të gjitha gjasave, formulime të këtilla janë rezultat i përkthimit jo të mirë nga gjuha e huaj dhe e mospërshtatjes së tyre në gjuhën shqipe

⁴⁶ Natyrisht, në këtë dokument është vetëm përdorimi i termave shqip, prandaj përdorimi i këtyre termave në gjuhët tjera vetëm është paralajmëruar

⁴⁷ Ky është vlerësim i përgjithshëm pasi qartësimi i kuptimit të këtyre koncepteve është i larmishëm

- a) Në terma që janë trajtuar duke përdorur terma relativisht të barasvlershëm si: *çështjet e ndërlidhura ndërkurrikulare, kompetencat kryesore, kurrikula efektive, kurrikula formale, mësimdhënia e integruar dhe të mësuarit, rezultatet e të nxënës, vlerësimi i nxënës, vlerësimi për të nxënë, zhvillimi holistik;*
- b) Në terma që kuptimisht janë qartësuar në mënyrë përshtkuese, në disa raste me tekste relativisht të gjata, duke përdorur terma⁴⁸ të tjerë si: *arsimi themelor, bashkësitë e interesit praktik, gjuha, kodi, kompetenca, komunikimi, mësimi i bazuar në shërbim, mjedisi miqësor për fëmijët, programi mësimor, shenja, të shprehurit;*
- c) Në terma që janë qartësuar duke dhënë një shembull relevant ose një referencë për qartësim shtesë të kuptimit të caktuar të tyre, si: *gjuha artificiale, simboli dhe*
- d) Në disa raste, në përpjekje për të qartësuar më shumë kuptimin e disa termave, janë përdorur terma pothaj të njëjtë me ato të termave të përzgjedhur, si: *fushë kurrikulare – curriculum area; kurrikulë – kurrikulat; kurrikula spirale – rritja spirale e kurrikulës / mësimit; mësimi holistik dhe i gjithanshëm – mësimi i integruar; përmbajtja mësimore – përmbajtja. Ndërkaq, termi qendrimi, i shpjeguar kuptimisht në masën e nevojshme me terma të tjerë në shtyllën e dytë, me përdorimin e pavend të termit dispozitat, vetëm sa është ngatërruar në këtë aspekt.*

Siç mund të shihet, shtylla e tretë e tabelës së Fjalorthit ka bërë pak nga ajo që është synuar – qartësimin shtesë të kuptimit të termave të shpjeguar në shtyllën paraprake, duke ndjekur një qasje tjetër nga qasja e paralajmëruar – përdorimin e termave të barasvlershëm – të cilët janë përdorur në pak raste dhe një qasje të larmishme nga një term në termin tjetër. Përveç kësaj, ky lloj qartësimi kuptimor është tentuar [të realizohet vetëm në një numër të vogël të termave të Fjalorthit që është objekt i këtij studimi.

PËRFUNDIM

Që në fillim do të konstatojmë se me hartimin dhe miratimin e Kurrikulës Bërthamë për klasën parafillore dhe arsimin fillor është shënuar një sukses i rëndësishëm në procesin e reformimit dhe të përkufizimit ligjor të këtij niveli arsimor. Pokështu, Fjalorthi i termave i Kurrikulës Bërthamë është njëra nga pjesët e

⁴⁸ Fjala është për disa nga termat e përzgjedhur të Fjalorthit, të paraqitur në shtyllën e parë të tabelës shpjeguese

rëndësishme të saj pasi ajo përcakton një fjalorth themelor, specifik dhe praktik, duke e përkufizuar gjuhësisht dhe sanksionuar ligjërisht dhe duke e bërë atë një fjalorth të njësuar dhe të detyrueshëm për njohje dhe përdorim zyrtar për të gjithë ata që, në mënyrë të drejtpërdrejtë, janë të lidhur me institucionet edukativo-arsimore të nivelit arsimor 1.

Në këtë studim kushtuar Fjalorthit të termave të Kurrikulës Bërthamë të nivelit arsimor 1 kemi shqyrtuar aspekte të ndryshme të tij: a) cilësinë dhe të përshtatshmërinë e këtij fjalorthi (përzgjedhjen dhe kriteret e përzgjedhjes së termave); b) kriteret e ndjekura për paraqitjen e tyre në Fjalorth (paraqitjen e termave) dhe c) aspektin kuptimor të këtij fjalorthi (shpjegimin dhe qartësimin kuptimor të termave të tij).

Për mendimin tonë, përzgjedhja e termave të Fjalorthit është kryesisht e qëlluar, por megjitatë asaj mund t'i bëhen vërejtje që lidhen me mungesën e ndonjë termi kyç për këtë nivel arsimor, por edhe me përsëritjen e shumicës së termave që janë përfshirë më parë në Kornizën e Kurrikulës.

Paraqitja e termave në Fjalorth lëngon nga lëshime leksikografike (mosrenditja e fjalëve sipas rendit alfabetik) dhe nga gabime gjuhësore, lëshime drejtshkrimore e teknike, në numër të konsiderueshëm.

Ndërkaq, shpjegimi dhe qartësimi i kuptimit të termave, e sidomos i termave të rinjë, sipas vlerësimit tonë, nuk është realizuar në masën e plotë, në rend të parë për shkak të përzgjedhjes së panevojshme të një pjese të tyre; për shkak të shpjegimeve kuptimore të pjesërisht pamjaftueshme ose të paqarta dhe për shkak të shpjegimit dhe qartësimin shpeshherë të panevojshëm të një numri termash të njohur.

Në fund konstatojmë se, megjithë mangësitë, gabimet a lëshimet e natyrave të ndryshme, pakujdesitë dhe ngatërrimet e konstatuara në këtë studim, për mendimin tonë, Fjalorthi i Kurrikulës Bërthamë paraqet një mjet të nevojshëm dhe praktik për punën e përditshme të personelit arsimor të nivelit arsimor 1, kurse termat e tij, një minifjalor gjuhësor specifik për këtë fushë dhe këtë nivel arsimor. Konstatimet e mësipërme të këtij studimi, megjithatë, nuk zbehin rëndësinë, aktualitetin dhe praktikitetin e këtij Fjalorthi.

Literatura

1. Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Fjalor i Gjuhës së sotme shqipe, A-M, N-Zh*, "Rilindja", Prishtinë, 1981,
2. Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Gramatika e gjuhës shqipe, 1, 2*, Botim i Akademisë së Shkencave, Tiranë 2002,

3. Çeliku, Mehmet, *Gjuha e sotme letrare shqipe dhe shkolla*, "Gjuha jonë", 1/1985,
4. Çeliku, Mehmet, *Çështje të shqipes standarde*, Shtëpia Botuese e Librit Universitar, Tiranë, 2001,
5. Çeliku, Mehmet, *Veptra "Për pastërtinë e gjuhës shqipe dhe fjalët e huaja në përdorim"*, "Gjuha shqipe", nr. 03, Prishtinë, 2006,
6. Lloshi, Xhevat, *Dytësorët e përfutur nga purizmi*, "Gjuha shqipe", Prishtinë, 2001,
7. Memisha, Valter, *Studime për fjalën shqipe*, "Botart", Tiranë, 2011,
8. Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë, *Korniza e Kurrikulës e Arsimit parauniversitar të Republikës së Kosovës*, Prishtinë, 2011,
9. Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë, *Kurrikula Bërthamë për klasën parafillore dhe arsimin fillor*, Prishtinë, 2012,
10. Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë, *Kurrikula Bërthamë për arsimin e mesëm të ulët*, Prishtinë, 2012,
11. Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë, *Kurrikula Bërthamë për arsimin e mesëm të lartë*, Prishtinë, 2012,
12. Murati, dr. Qemal, *Gramatika e gabimeve, Kulla babilonike dhe përzierja e shqipes*, Shtypshkronja "ÇABEJ", Shkup, 2000,
13. Murati, Qemal, *Të ashtuquajturat fjalë të huaja dhe purizmi*, "Gjuha shqipe", Prishtinë, 2001,
14. Ornstein, Allan C. - Hunkins, Francis P., *KURRIKULA, Bazë, parime dhe probleme*, Botimi III, Tiranë, 2003,
15. Rrokaj, Shezai, *Përse e përdorim fjalën e huaj në vend të fjalës shqipe?!*, "Albanologjia", nr. 1-2, Revistë Ndërkombëtare e Albanologjisë, UShT, Tetovë, 2014,
16. Universiteti Shtetëror i Tiranës & Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe, I, II*, Tiranë, 1972.

Shtojcë: tabela e koncepteve të Fjalorthit të KB

N r	Koncepti	S	Q
1	Llogaridhënia*	+	-
2	Gjuha* artificiale	+	+
3	Vlerësimi*	+	-
4	Vlerësimi* për të nxënë	+	+
5	Vlerësimi* i nxënies	+	+
6	Metodologjia* e vlerësimit	+	-

	Koncepti	S	Q
51	Mësimdhënia* dhe mësimnxë. bashkëveprue.	+	-
52	Kompetencat* kryesore	+	+
53	Shkalla* kryesore e Kurrikulës	+	-
54	Të njohurit	+	-
55	Ekonomi dhe shoqëri e dijes	+	-
56	Fushë kurrikulare	+	+

7	Qëndrimi*	+	+
8	Arsimi* themelor	+	+
9	Mësimdhënia* në bllok	+	-
10	Lëndë bartëse	+	-
11	Mjedis miqësor për fëmijët	+	+
12	Vlerësim me bazë klase / nga mësimdhënësit	+	-
13	Kodi*	+	+
14	Komunikimi*	+	+
15	Bashkësitë* e interes praktik	+	+
16	Kompetanca*	+	+
17	Arsimi* i detyrueshëm	+	-
18	Periudha* kontaktuese	+	-
19	Qasjet* konstruktiviste	+	-
20	Kurrikula* Bërthamë	+	-
21	Çështjet* e ndërlydhura ndërkurrikulare	+	+
22	Kurrikulë	+	+
23	Korniza* e Kurrikulës	+	-
24	Integrimi* i Kurrikulës	+	-
25	Politikat e Kurrikulës	+	-
26	Struktura* e Kurrikulës	+	-
27	Sistemi* i Kurrikulës	+	-
28	Vlerësimi* diagnostik	+	-
29	Mësimdhënia* e diferencuar	+	-
30	Kurrikula* efektive	+	+
31	Mësimi* elektronik	+	-
32	Kurrikula* zgjedhore (+ 73)	+	-
33	Edukimi* për ndërmarrësi	+	-
34	Mësimdhënia* e zgjeruar dhe koha për të mësuar	+	-
35	Të shprehurit	+	+
36	Vlerësimi* i jashtëm	+	-

57	Gjuha*	+	+
58	Perspektiva* me nxënësin në qendër të vëmendjes	+	-
59	Mësimnxënia*	+	-
60	Përmbajtja* mësimore	+	+
61	Përvoja* mësimore	+	-
62	Mundësitë* mësimore	+	-
63	Rezultatet* e të nxënit	+	+
64	Burimi* i të mësuarit	+	-
65	Mësimi* tërëjetësor	+	-
66	Aftësitë* për jetë	+	-
67	Arsimi* i mesëm i ulët	+	-
68	Mësimi* domethënës	+	-
69	Koncepti* shumështrësor i identitetit	+	-
70	Inteligjencat* e shumëfishta	+	-
71	Gjuha* natyrore	+	-
72	Arsimi* joformal	+	-
73	(Kurrikula* zgjedhore*)	+	-
74	Vlerësimi* shoku-shokun	+	-
75	Edukimi* shoku-shokun	+	-
76	Mësimdhënia* shoku-shokun	+	-
77	Vlerësimi* parashikues	+	-
78	Arsimi* fillor	+	-
79	Aktivitetet* përmirësuese	+	-
80	Autonomia* e shkollës	+	-
81	Kurrikula* me bazë shkolle (në institucion)	+	-
82	Arsimi* i mesëm	+	-
83	Vlerësimi* selektiv	+	-
84	Vetëvlerësimi*	+	-
85	Mësimi* i bazuar në shërbim	+	+
86	Shenja*	+	+

FJALORTHI I TERMAVE PËR MËSIMDHËNËS I KURRIKULËS...

37	Aktivitetet* ekstrakurrikulare	+	-
38	Kurrikula* formale	+	+
39	Arsimi* formal	+	-
40	Vlerësimi* formativ	+	-
41	Arsimi* i përgjithshëm (shkollat)	+	-
42	Kurrikula* e fshehur	+	-
43	Mësimi* holistik dhe i gjithanshëm	+	+
44	Zhvillimi* holistik	+	+
45	Mjedisi* për mësim holistik	+	-
46	Arsimi* gjithëpërfshirës	+	-
47	Arsimi* informal	+	-
48	Teknolo. e infor. dhe të komunikimit (TIK)	+	-
49	Mësidhënia* e integruar dhe të mësuarit	+	+
50	Klasë bashkëvepruese	+	-

87	Simboli*	+	+
88	Shkathhtësia*	+	-
89	Kurrikula* spirale	+	+
90	Standard	+	-
91	Lënda*	+	-
92	Vlerësimi* përfundimtar	+	-
93	Mësimi* i qëndrueshëm	+	-
94	Progresioni* i mësimit të qëndrueshëm	+	-
95	Program mësimor	+	+
96	Mësimdhënia*	+	-
97	Fondi* i orëve	+	-
98	Vlerat*	+	-
99	Arsimi* dhe aftësimi* profesional	+	-
=			

Shpjegim: *Koncepti* – termi i përzgjedhur i Fjalorthit, ashtu siç është paraqitur në të

S (+) – shpjegimi i termave të përzgjedhur të me fjalë të tjera

Q (+) – prania e *koncepteve ekuivalente* për qartësimin e termave

Q (-) – mungesa e *koncepteve ekuivalente* për qartësimin e termave

Q (?) – *koncepte ekuivalente*, të përdorura pa ndonjë rezultat të dukshëm

(*) – terma me gabime gjuhësore, drejtshkrimore ose teknike

()** – togfjalësha me fjalë shqipe dhe të *huazuara*

(*)** – fjalë e re, e huazuar - (në *italik*)

Mustafa IBRAHIMI

FJALËFORMIME NË BOTËN E REKLAMAVE DHE DISKURSION POLITIK

Krijime të pazakonta verbale janë edhe fjalëformimet që i gjejmë në botën e reklamave, më shpesh me theks të veçantë të përdorimit të grafikëve dhe të shenjave të ndryshme, ndërsa nga aspekti gramatikor zakonisht përdorimi i mënyrës urdhërore. P.sh. një numër i madh fjalëformimesh krijohen me shenjën e euros €, kemi këto emërtime: Ekon:ference, Eurosig, EuroSpa, Ekolonializimi, Emisioni i autonomies; me shenjën @ e takojmë më shumë nëpër reklama: freem@il, @net, @cafe, blet@net, M@qedonia etj. Për krijimin e fjalëve të përzjera mjaft popullarizues janë edhe fjalëformimet në diskursion politik. Këto shpesh janë krijime të shënuara me “masbtrime” të segmenteve të caktuara (mund të jenë fjalë ose shkurtesa, më shpesh akronime). Përdoren kryesisht shkronja të mëdha, duke dhënë një efekt të veçantë vizual. P.sh., EncikloPADI, Meqë kjo lidhet me Akademinë e Shkencave të Maqedonisë (MANU), lindën edhe këto krijime: MANUpedia, MANU-SANU, MANITU, MANU-fakt(ura), AkANEMIKët. Raste të tjera kemi edhe te fjalët: DEPUTETTTT?! (Kush do të bëhet DEPUTETTTT?!, fUNd, YUNMIK dhe UNMIK-olonializëm etj.

Fjalët çelës: fjalëformime, diskursi politik, diskursi i marketingut, huazime, blende

Hyrje

Duke ditur se industria e reklamave është një degë e rëndësishme ekonomike, ajo vazhdimisht zhvillohet dhe jo rastësisht gjuha e reklamave është objekt i shpeshtë studimi të gjuhëtarëve (p.sh. Humar 2000, Logar 2004a, 2004b, Krieg 2005, Udier 2008, Fellner 2009 etj.). Lufta e vazhdueshme për të tërhequr konsumues ka bërë që industria e reklamave vazhdimisht të gjejë efekte të reja vizuale dhe auditive. Andaj për reklamat mund të flasim si një lloj mjaft të zgjeruar tekstual, në të cilat shpesh përdoren frazemat, figurat stilistike, por edhe thyerja me vetëdije të normave drejtshkrimore në çdo aspekt gjuhësor. Me reklamat dhe gjuhën merren disiplina të ndryshme shkencore, andaj ekzistojnë edhe pikëpamje të ndryshme dhe përdoren metodologji të ndryshme. Pikat kryesore të interesit tonë në këtë punim janë proceset fjalëformuese në gjuhën e reklamave, para së gjithash në **sloganet reklamuese**,

emërtimin e prodhimeve dhe emërtimin e objekteve. Duke i mbledhur dhe studiuar këto pikë, qëllimi ynë është t'i paraqesim format dhe mënyrat e krijimit të fjalëve të reja ose ndryshimit të fjalëve ekzistuese dhe vlerësimi i tyre në aspektin leksikologjik dhe fjalëformues të cilat janë krijuar me ndihmën e veprimeve të ndryshme grafike. Ky proces është i njohur edhe si **grafikizim** (Popova 2007:291-295), kurse prej kësaj krijohen **grafoderivate**, të cilat janë krijuar me anë të kombinimeve të gjuhëve të ndryshme ose kodeve që quhen edhe **hibride** ose **kentaure**. Autorja dallon disa lloje të **grafikizimit: monografikizimi** (formimi i fjalëve me mjete grafike brenda një gjuhe); **poligrafikizimi** ose **grafohibridizimi** (krahasimi i alfabeteve të ndryshme); **kodografikizimi** (kombinimi i mjeteve të ndryshme grafike: numra, fotografi, shenja kompjuterike); **tipografikizimi** (kyçja e mjeteve paragrafemike, siç është kombinimi i fonteve normale dhe të shtrira, ngjyrave), ndërsa nëse fjala është për kombinimin e mjeteve të numëruara, bëhet fjalë për grafoderivatet e kombinuara. (Popova 2007,2008a,2008b).

Grafoderivatet definohej si fjalë të formuara me ndihmën e veprimeve të ndryshme ortografike dhe grafike, gjegjësisht me anë të kombinimeve të grafemave të ndryshme, shenjave dhe elementeve figurative. (Lewis-Golub 2014:135). Analiza e korpusit tregoi se grafoderivatet dhe përzierja e fjalëve u përdorën në mënyrë që të krijojnë një ndjenjë e çudi të marrësit e mesazhit të reklamave. sipas vendit të tyre në leksik, fjalë të krijuara për këtë qëllim janë quajtur edhe **okazionalizma** (fjalë për raste të veçanta). Në gjuhësi ekzistojnë definime të ndryshme rreth këtij emërtimi dhe kriterëve të ndryshme për dallimin nga neologjizmat ose fjalitë potenciale. Okazionalizmat janë elemente të paleksikalizuara, kurse neologjizmat janë elemente të leksikalizuara.

I. PROCESE TË GRAFODERIVATEVE

Këto procese të ndryshme grafike, sipas V. Bondžolova (2007) quhen **okazionalizma grafike**, kurse sipas Popova dhe Stramljič Breznic quhen **grafoderivate**. Si shembuj të procesit të **grafoderivateve** ose **okazionalizmave** do të jenë fjalët në të cilët vjen deri te përfshirja e **simboleve, numrave, kllapave, shkronjave të mëdha, përsëritjes ose të dyfishimit të shkronjave** etj. Korpusi në të cilën ne kemi hulumtuar arrijnë në rreth 100 reklamash, të mbledhura gjatë periudhës 2006-2015 nga revistat, katalogët, ueb-faqet, shpalljet dhe spotet televizive dhe të radios. Reklammat i kemi shqyrtuar duke i analizuar në disa procese gjuhësore, si:

1) Përfshirja e simboleve në një fjalë:

Krijime të pazakonta verbale janë edhe blendet që i gjejmë në botën e reklamave, më shpesh me theks të veçantë në përdorimin e shenjave grafike dhe të shenjave të ndryshme, ndërsa nga aspekti gramatikor zakonisht përdoren në mënyrën urdhërore. Ndër simbolet më të shpeshta janë shenjat e euros **Ⓛ** dhe shenja **@** dhe **x** (**iks**).

Me shenjen e euros **Ⓛ**, kemi shënuar këto emërtime: *Ekon:ference* (Konference e organizuar nga revista Ekonomist 2005 në 3 ngjyra). Po me këtë shenjë në gazetën tiranase “*Koha jonë*” e datës 21 korrik 2008 takojmë reklamën: *Eurosig* dhe *EuroSpa*, *Ekolonializimi* (*Vetëvendosja* 2006/66), *Emisioni* i autonomisë (*Vetëvendosja* 2007/118).

Shenjen **@** e takojmë më shumë nëpër reklama, si në shembujt: *freem@il*, *@net* (ardhmëria NET.com), *@cafe*, *blet@net*, *M@qedonia*.

Në një reklamë mbi shkollën shqiptare të Athinës “*Gazeta e Athinës 18-24. 07. 2008*” vërejtëm formën: *xpert* “ekspert”, ku motoja është: Qendër ekskluzive trajnimi dhe testimi i certifikatës evropiane për kompjuter *xpert* për Greqinë.

2) Kombinimi i numrave dhe shkronjave në një fjalë:

Shumë fjalë kanë lindur edhe me anë të kombinimit të numrave dhe shkronjave, si p.sh.: *12-KS-44* (*Vetëvendosja* 2005/1), *Virusi U1N2M4I4K* (*Vetëvendosja* 2006/67), *Virusi E1U2L4E4X* (*Lajm* 2009); *12:44 Time's up UNMIK go Home* (*Vetëvendosja* 2006/67), *Eulexilium 1244 mg* (*Vetëvendosja* 2009/209); *2 day*

(Parllaku 2010:498); *Alb4ever*; *Piceri “4ever”*, *B4*, *Go4 slim*; *komuni8*, *publici8*; TË-PA-PËR-7-SHME (MAPO nr.1594, 25-26.07.2015, fq.30. Tiranë); Kafelibraria “*E për7shme*” në Tiranë (Ali Pajaziti, Urbanofilozofia në Çarshi). Portalb - 29.01.2015; Sytë 4, veshët 100.4 (reklamë për valet e radios – Tiranë 2010); “Ça ka 3”? Emision televiziv që me vite të tëra transmetohet për me programeve të KTV-së, në vend se të titullohej me shprehje fjalësh: “Çka ka të re”?; “*5fletësh*” (për hashashin) dhe “*7fletësh*” (për marihuanën), etj.

3) Përfshirja e shkronjave të mëdha në një fjalë:

Janë krijime të shënuara me “mashtime” të segmenteve të caktuara (mund të jenë fjalë ose shkurtesa, më shpesh akronime). Përdoren kryesisht shkronja të mëdha, duke dhënë një efekt të veçantë vizual. Në vijim do të japim disa shembuj.

Lidhur me botimin e enciklopedisë maqedonase, në mediet e shkruara u paraqitën shumë tituj me krijime të reja leksikore, si p.sh.: *EncikloPADI* (Vetëvendosja nr.211/ shtator 2009). Meqë kjo lidhet me Akademinë e Shkencave të Maqedonisë (MANU), lindën edhe këto krijime: *MANUpedia*, *MANU-SANU*, *MANITU*, *MANU-fakt(ura)*, *AkANEMIKët*.

Raste të tjera të këtij lloji kemi edhe në fjalët që lidhen me problemet politike në Kosovë, si p.sh.. siç është rasti me një shkrim në gazetën Lajm, lidhur me planin 6 pikësh të OKB-së për Kosovën, propozuar nga sekretari i përgjithshëm i OKB-së Ban Ki Mun, kemi titullin: “*Maqedonia pa qëndrim për planin ‘S’Ban, S’Ki, S’Mun’*” (në “*LAJM*”), *fUNd* (Vetëvendosja 2005/10), *YUNMIK* dhe *UNMIKolonializëm* (Vetëvendosja 2005/3); *UNfair!* (UN+fair) (VV, nr.346, 30 korrik 2012); UNMIK: YUNMIK, *UNMIKolonializëm* (UNMIK + Kolonializëm); *UNMIK + KEK = KATASTROFË* (Vetëvendosja nr.47/2006);

Një numër të konsiderueshëm të derivateve ku përfshihen shkronjat e mëdha, janë edhe shembujt që lidhen me ndeshjen e njohur futbollistike midis Serbisë dhe Shqipërisë. Procesi të tilla krijuese ishin të drejtuara në adresë të UEFAsë, si p.sh.: *UEFAtalitët* (Edmond Tupja, www.tetovanews.info); *UEFAviç* (Mavraj, tetor 2014, FB); *PlatinOVIÇ* (pankarta nga protestat tetor 2014 FB).

Mjaft interesant janë edhe proceset ku shkronjat e mëdha u dedikohen partive politike, si p.sh.: *DUIsllavia* (DUI + sllavia); DUI (BDI): *DUIsllavia* (DUI + sllavia): *deDUIzim*; PDK + LDK = LDK² (Vetëvendosja nr.110/2007); VMROland, joVMROistë, VMROizim (Ali Pajaziti, *Lamtumirë sovjetizëm, tungjatjeta putinizëm*. Portalb 13.01.2015); Nuk janë lënë anash edhe figura të njohura politike, si: *aDEMaçi* (www.fjalëkryqi.com), *AbmetOV* (Abmeti+ov).

Ja edhe disa fjalë ku janë përfshirë shkronja të mëdha, për ndonjë efekt të caktuar: OpEd (“Opinione dhe Editoriale”) (MAPO, nr.1598, 30.07.2015, fq.12. Tiranë); *SoCLAlizëm* (Zbiti 2009:309); *KameLEOpard* (kameleon + leopard); *FotoGRAFIa*(fotograf + grafia); *AlbANgle*(alban – angle); *ApartMANia* (apartman + mania); *IDEAle*, *referenDUM*, *BallKANkan* (Ballkan + kan), *DisKURSI*, *ANAListave* e *inteleKUAJVE* (Arsim Zekolli, Opozita po hesht për aferën telekom, si në kohën e Stalinit (Në “inaonline” - 08/09/2015).

4) Dyfishimi ose përsëritja e shkronjave në një fjalë;

Shpesh efekte speciale arrihet edhe me anë të zëvendësimit të thjeshtë të shkronjave ose të përsëritjes së ndonjë shkronje, p.sh.: *Kusb do të bëhet DEPUTETTTT?!* (në “Fakti ditor” 12.03.2011); *Mmmmmmmf...* (titulli i artikullit në

lidhje me MMF, në “Vreme” 15.09.2005); Pako bombastike 3 den./javë: Booom..., Boom...! ME KREEEEJT! (Albafone).

- 5) **Kyçja e kllapave:** (AR) *kitektura*, (AR) *gëtimi*, (AR) *atija*, dhe (RA) *hatija* (Jeta Iljazi, Portalb 7.1.2015); *Zgjedh(j)a (Vetëvendosja)* të ditës 25 shkurt 2008); *Projekta(r)t* (revistë për artin vizuel); *Sela(k)izimi në politikë* (Nazim RASHIDI, “KOHA”, Shkup. 4.5.2014); *Da(m)utogllu, Euro(pa)mania* (Koha 3.12.2009); **EU(lex) – EU(mik).**
- 6) **Kombinimi i llojeve të ndryshme ose sistemeve grafike:** *SHOOSTER* (emërtimi i një shitoreje për këpucë, aluzion për **shuster**); *CHEFLJA* (emër restoranti, aluzion për *sheflja*). *”BON, BON”* (emision televiziv i cili do të duhej që të shkruhej “Bën, bën “, e jo ashtu, nga se gjatë shqiptimit të këtij titulli nga ana e moderatorëve të tij, të gjithë fëmijët do të mendonin se këtu është fjala për bombona -sheqerka të fëmijëve?!); *Eulexilium 1244 mg* (kontingenti paqeruatës EULEX, aluzion në leksilium)
- 7) **Nënvizimi i një pjese të fjalisë:** *FENOMENALNO* (reklamë për çorape burrash).
- 8) **Përfshirja e logos së kompanisë:** *Dëjà VW*;



9) Kombinimi i ngjyrave ose madhësisë së shkronjave:

~~EU MIK
LEX~~

H I V
A R C E
K O Z
S H I
N G E
R
I N
Z E
R

UNMIK jashtë
EUMIK jashtë
të gjithë
...MIK jashtë



II. PROCESI I ETIMOLOGJIZIMIT NAIV TË FJALËVE

Ashtu si Popova edhe studiuesja Stramljić krijimet e reja i konsiderojnë si të barabarta me ata që janë krijuar në mënyrë “tradicionale”, pra me anë të fjalëformimit siç janë kompozitat ose derivatet (Stramljić Breznik 2010b;156). Autorja Stramljić përdor edhe termin **etimologjizimi naiv** e cila e përdor për të kërkuar fjalë të caktuara në pjesët tjera të fjalës që kanë renditje të njëjtë grafemash, në atë mënyrë që nëpërmjet veprimeve grafike (për shembull me përdorimin e shkronjave të mëdha) nxjerr në pah një pjesë të veçantë të fjalës, p.sh.:

- a) Në një shkrim ku flitet për investimet në Universitetin Shtetëror të Tetovës (USHT), midis tjerash në fund të tekstit thuhet: *PërkUSHTojnë së ardhmes.*
- b) Një krijim të tillë ka përdorur edhe televizioni **IN** nga Mali i Zi: *AdmINistracija, TrenINg, IstINa, DomINe, SINoptika* etj.; Një tjetër rast i ngjashëm është edhe ai i një pronar i petullave me sheqer të mbushur me marmelatë ose pekmez (ser. *pallaçinka*) i cili, duke parë çfarë është në trend harxhuesve të vet u ofron 16 lloje të petullave varësisht me çfarë janë të mbushura.
- c) Shembulli tjetër lidhet me një ngjarje që ka ndodhur në një ndërmarrje, ku kur vjen një përgjegjës i ri i brigadës, i cili pasi i pyet për mbiemrat dhe ata i thonë mbiemrat e tyre dhe sapo njihen, del një përkim i rastit: *Çelsula*,

Çelmeta, Çelaga. Përgjegjësi atëherë tha: *U pa puna, edhe unë nga Adhami do ta bëj Çeladhami!* (Lloshi 2001:124);

- d) Te “Çipi i palaçove”(1922), Faik Konica luan me tri trajta të emrit të kontinentit *Avrupa, Evropi, Evropa* për ata që shtiren se janë evropianizuar. (Lloshi 2001:56);
- e) Përsëritja e shkronjave të caktuara në fjalë, e hasim edhe në një shkrim të shtypit ditor lidhur me planin 6 pikësh i OKB-së për Kosovën, propozuar nga sekretari i përgjithshëm i OKB-së Ban Ki Mun, gazetari harton titullin: *Maqedonia pa qëndrim për planin “S’Ban, S’Ki, S’Mun” (në “LAJM”- E premte 28 nëntor 2008, f.4); Përsëritje kemi edhe në shemullin: (AR) këtektura, (AR)gëtimi, (AR)atija, dhe (RA)hatija* (Jeta Iljazi, Portallb 7.1.2015);

Neologjizmat


Numri i fjalëve të reja që kanë hyrë në gjuhën shqipe, që nga viti 1989 është shumë i madh edhe atë në terminologjinë e të gjitha fushave publike, por më së shumti janë të lidhura me fushën kompjuterike. Fjalë të reja, shpesh krijohen edhe me anë të ligjeve të fjalëformimit. duke përdorur sistemin ekzistues të fjalëformimit (parashtesat, prapashtesat etj.). Shumë rrallë, në formimin e fjalëve të reja, gjatë periudhës moderne të zhvillimit të një gjuhe kanë depërtuar edhe formante të reja. Zakonisht më prodhimtare janë formantet ekzistuese, që adaptohen me sfidat e reja. P.sh. *de-, anti-, mega-, mikro-, mini-, multi-, post-, super-, top-, ultra-, hiper- etj.* Kohëve të fundit janë aktivizuar edhe parashtesa të reja, si p.sh.: **euro-** (*eurodeputet, eurointegrim, euroskeptivizëm, eurofonde, eurobanknota, aurokup, euroligë, europolitikë*); **narko-** (*narkoafera, narkobiznes, narkodiler, narkokanal, narkodollarë*); **porno-** (*pornobiznes, pornoindustri, pornoaktor/e, pornokompani, pornodiskë*); **seks-** (*seksbiznes, seksmaniak, seksbombë, seksklub, seksindustri, sekspunëtore, sekskandal*); **tekno-** (*teknogrupë, teknoklub, teknoparti*). Krijohen edhe një sërë fjalësh me me një fjalë të dytë, si p.sh. **biznes-** (*aviobeznes, autobiznes, narkobiznes, seksbiznes, radiobiznes*), **-bos** (*narkobos, radiobos, telebos*)

Edhe zhargonet e të rinjve janë një nga burimet kryesore për pasurimin e gjuhëve me blende Adoleshentët, nga imagjinata dhe aftësia e tyre e lojës me fjalë, na çojnë të njihemi me karakteristikat psikologjike e morale të njerëzve dhe me profesionet e tyre, me ambientin shkollor, vendtakimet më të preferuara, preokupimet e të rinjve, sendet e prodhimet e ndryshme etj. Këtu mund të veçojmë: *profaraon* (profesor), *horongop* (idiot), *toçkuklle* (idiot), *franglish a franglais* (frëngjisht + anglisht), *denglish a germish* (gjermanisht + anglisht), *spanglish, chinglish* e të tjera në Evropë e në Azi, mund të themi që po i shtohet edhe “*albglish*” apo “*shqipglish*”, *albangle* si *frangle*. Po ashtu për

llojet e automobilave: *shkodilak* (shkoda), *varborxhini* (Vartburg), *figuar* (Fiat 750); slogane politike: *Jungatjeta* (përshëndetje si parullë e PDSH-së në zgjedhjet e fundit parlamentare në Maqedoni), *sperminator* (burrë mjaft potent), *shahobus* (autobus me shahistë) (Ibrahimi 2009).

Përfundim

Sipas analizave të bëra, mund të vijmë në përfundim se okazionalizmat e korpusit tonë në bazë të mjeteve grafike që kemi përdor dhe proceseve fjalëformuese mund t'i klasifikojmë në këtë mënyrë:



Pas analizave dhe interpretimeve kaq të detajuara, përfundimi mund të jetë i shkurtër. Ne u morëm me një metodë të re gjuhësore që përdoret në ligjërimit bisedor dhe të shkujdesur për t'i vërejtur para së gjithash ngjashmëritë midis sendeve dhe gjërave dhe duke u dhënë kuptime tjera. Edhe pse ky material në shikim të parë duket si i njohur dhe i ngushtë, që për dikë edhe nuk paraqet diç të re dhe interesante për hulumtim, megjithatë e dimë se njerëzit zbavitën nëpërmjet lojës së gjuhës, por dikush do të parashtronte një pyetje e tipit, po pse e bëjnë këtë ata?

Nga shembujt u përpoqëm sadopak të japim përgjigje, duke besuar se arritëm t'ju tregojmë se edhe këtu ka vend për studime të thelluara gjuhësore. Sipas kësaj metode, ne arritëm të shqyrtojmë material gjuhësor, në një mënyrë të re të studimit që

deri tani ka qenë e lënë pas dore, e ajo është mënyra e re krijimit të fjalëve në botën e reklamave.

Meqë, siç vërejtëm në shembujt e lartpërmendura, gjuha është prodhim i lojës dhe zbavitjes intelektuale, ajo megjithatë në mënyrë të qartë na tregon edhe për kapacitete tjera të njeriut. Këtu para së gjithash e kemi fjalën për ndryshimin e fjalëve ekzistuese dhe vlerësimin e tyre në aspektin leksikologjik dhe fjalëformues të cilat janë krijuar me ndihmën e veprimeve të ndryshme grafike. Për shembull, viteve të fundit përveç lojërave me shkronja, ata shpeshherë kombinohen edhe me shkronja të mëdha, numra, shenjat e pikësimit e deri me fotografi, si p.sh: *blet@net*, *Eurosig*, *Xpert*, *Omega*, *E1U2LAE4X*, *12-KS-44*, *fUNd*, *EncikloPADI*, *DEPUTETTTT?!*. Këtu hynë edhe shumë fjalë që janë pjellë e imagjinatës si krijim autentik i njeriut.

Literatura

- ANNELIES, Harald Burger, ur. *Phraseology in Motion II. Theorie und Anwendung. Akten der Internationalen Tagung zur Phraseologie*. Hohengehren: Schneider Verlag, 61-74.
- BONDŽOLOVA, Valentina. (2007). *(Ne)sāštstvuvašti dumi: okazionalno slovtvorčestvo*. UI Sv. sv. Kiril i Metodij. Veliko Tārnovo.
- BUGARSKI, Ranko. (2002). Dve reči u jednoj: leksičke skrivalice. *Nova lica jezika*. Biblioteka 20. Vek. Beograd. 219–227.
- FELLNER, Robert. (2009). *Okkasionalismen in Werbeslogans zwischen 2003 und 2008 unter besonderer Berücksichtigung der Branchen Kosmetik, Ernährung, Getränke und Pharmazie*. Diplomski rad. Philologisch-Kulturwissenschaftliche Fakultät. Wien. 99 str.
- GURGA, Gëzim (1996). *Emri – shenjë e identitetit qytetar dhe kombëtar*. Rilindja, Prishtinë. 13 qershor 1996. f.9.
- HALIDOVIĆ, Alma. (2011). *Frazemi u reklamnim tekstovima*. *Philologia*, 2011, 9, 21-28, Beograd. (E KAM)
- HUMAR, Marjeta. (2000). Besedilne in jezikovne značilnosti reklamnih besedil. *Kultura, identiteta in jezik v procesih evropske integracije*. Ur. Štrukelj, inka. društvo za uporabno jezikoslovje slovenije. ljubljana. 315–336.
- IBRAHIMI, Mustafa (2012^a). *Krijimi i neologjizmave në gjuhën shqipe gjatë tranzicionit demokratik*. Në “AKTET” –Revistë e institutit Alb-Shkenca. *Journal of Institute Alb-Shkenca*. Tiranë/Prishtinë/Shkup, 2012. *Vëll.V, nr.4, fq 708-713*.ISSN 2073-2244.
- IBRAHIMI, Mustafa (2014). *Modele krijuese të zhargoneve në gjuhën shqipe*. Në “STUDIME SOCIOLINGUISTIKE II”: *Përmbledhje e kumtesave nga Konferenca "Gjendja dhe perspektiva e Sociolinguistikës sot"*, mbajtur më 1 nëntor 2013 në UEJL. □ Tetovë, 2014, fq.35-46. ISBN 978□ 608□ 4503□ 92□ 7

- IBRAHIMI, Mustafa. (2009). *Fjalor i zhargoneve dhe eufemizmeve shqiptare*. Shkup: Interlingua.
- IBRAHIMI, Mustafa. (2012b). *Tema sociolinguistike dhe etnolinguistike*. Interlingua, Shkup.
- KËRBIZI, Marisa (2014). Funkcionet e neologjizmave në disa romane bashkëkohore shqiptare. ANAS nr.7-8/2014. Instituti Alb-Shkenca, Shkup. (fq. 85-96).
- KRIEG, Ulrike. (2005). *Wortbildungsstrategien in der Werbung. Zur Funktion und Struktur von Wortneubildungen in Printanzeigenen*. Buske. Hamburg. udier, sanda lucija. 2008. O jeziku reklame. *Jezik i mediji – jedan jezik: više svjetova*. ur. Granić, jagoda. Hrvatsko društvo za primijenjenu lingvistiku. Zagreb – split. 711–721.
- LEWIS, Kristian Barbara Štebih Golub. (2014.). *Tvorba riječi i reklamni diskurs* rasprave 40/1, str. 133–147
- LOGAR, Nataša. (2004a). Nove tehnologije in nekateri nesistemske besedotvorni postopki. *Aktualizacija jezikovnozvrstne teorije na Slovenskem: členitev jezikovne resničnosti*. ur. Kržišnik, Erika. Center za slovenščino kot drugi/tuji jezik pri oddelku za slovenistiko Filozofske fakultete. ljubljana. 121–132.
- LOGAR, Nataša. (2004b). Nove tvorjenke v publicistiki. *Poti slovenskega novinarstva – danes in jutri: Znanstveni zbornik ob 40. obletnici študija novinarstva na Slovenskem*. ur. kalin Golob, Monika; Poler kovačič, Melita. Fakulteta za družbene vede. ljubljana. 175–199.
- POPOVA, Tat'jana Vital'evna. (2007). Grafičeskie okkazionalizmy russkogo jazyka konca XX – načala XXI vv. *Russkoe slovo, vyskazyvanie, tekst*. Moskovskij gosudarstvennyj oblastnoj universitet. moskva. 291–295.
- POPOVA, Tat'jana Vital'evna. (2008a). Vidy grafoderivacii v sovremennom russkom jazyke. *Russkij jazyk: čelovek, kul'tura, komunikacija*. Ural'skij gosudarstvennyj tehničeskij universitet. ekaterinburg. 182–191.
- POPOVA, Tat'jana Vital'evna. (2008b). Grafoderivat: slovo ili tekst? *Russkij jazyk: čelovek, kul'tura, komunikacija*. ural'skij gosudarstvennyj tehničeskij universitet. ekaterinburg. 191–198.
- STRAMLJIČ BREZNIK, Irena. (2010b). Besedotvorne lastnosti slovenskih okazionalizmov. novye javlenija v slavjanskom slovoobrazovanii: sistema i funkcionirovanie. *Trudy i materialy „Slavjanske jezyki i kul'tury v sovremennom mire”*. ur. Petruhina, elena Vasil'evna. moskovskij gosudarstvennyj universitet imeni m. V. lomonosova, Filologičeskij fakultet. moskva. 352–363.

www.vetevendosje.org

www.ardhmëriaNET.com

www.inaonline.com

Aida KURANI

RRETH FORMAVE TË SHPREHJES SË RAPORTEVE RRJEDHIMORE NË GJUHËN STANDARDE SHQIPE

Hyrje

Raportet rrjedhimore janë pjesë e raporteve sintaksore që vendosen mes njërive të ndryshme sintaksore ashtu si ato vendore, kohore, lejore etj. Tradicionalisht në sintaksën shqiptare ato janë trajtuar në kuadrin e sintaksës së periudhës dhe, në veçanti të periudhave me fjali të nënrenditura rrethanore.

Por, periudha me fjali të nënrenditur nuk është e vetmja mënyrë e shprehjes së raporteve rrjedhimore. Përveç periudhave me fjali të nënrenditura rrjedhimore, ato mund të shprehen edhe me *fjali të thjeshta*, *periudha me fjali të bashkërenditura*, *periudha me fjali asindetike*, si edhe përtej periudhës, *në nivel teksti*. Ngjyrimet rrjedhimore ngërthejnë edhe një numër periudhash të tjera me fjali të nënrenditura.

Në këtë punim jemi ndalur në shprehjen e raporteve *sbkak-pasojë*, duke mos u kufizuar vetëm në periudhën me fjali të nënrenditur rrjedhimore, por duke vështruar edhe ndërtime të tjera që shprehin marrëdhënie të këtij lloji. Kjo mënyrë e së vështruarit na jep mundësinë që këto raporte të shihen më gjerë, dhe të vihen në dukje jo vetëm ndërtimet tipike që shprehin këto lloje marrëdhëniesh, por edhe ndërtime të tjera ndër to edhe ndërtime me gërshetime raportesh ose me nuanca të veçanta kuptimore.

1. Shprehja e raporteve rrjedhimore në periudhën me fjali të nënrenditur rrjedhimore

Trajtimi i formave të shprehjes së raporteve rrjedhimore ka qenë në vëmendje të studimeve të gjuhëtarëve tanë ku përmendim, A. Xhuvani (Xhuvani 1922, 1938, 1942: 41), A. J. Rrota (Rrota, 1943: 88-89), K. Cipo (Cipo, 1952: 97), M. Domi (Domi, 1955: 192, 1971: 109), S. Floqi, (Floqi, 1965: 55), S. Prifti (Prifti, 1971: 417), *Gramatika e gjuhës shqipe II, Sintaksa (Gramatika, 1997: 493)*, M. Totoni (Totoni, 2012: 199-215) etj. Këta studiues, në punimet e tyre, kanë bërë objekt diku më shkurt a më gjerë, çështje që kanë të bëjnë me aspekte të ndryshme të shprehjes së raporteve rrjedhimore.

Ajo ç'ka vërejmë në studimet e tyre është se raportet rrjedhimore janë trajtuar në kuadrin e periudhës dhe, në veçanti, të periudhës me fjali të nënrenditur rrjedhimore.

A. Xhuvani¹ (i cili mendohet se është i pari ndër studiuesit shqiptarë që i ka vendosur emrin këtyre fjalive të nënrenditura) në tekstin e tij jep këtë përkufizim për fjalinë rrjedhimore: “*Fjalitë rrjedhore kallëzohen një përfundim, një rrjedhje të punës që tregohet në fjalinë e parë*”. Ai vë në dukje përdorimin e lidhëzave që lidhin fjalinë kryesore me fjalinë e nënrenditur e konkretisht lidhëzën *saqë*, e cila vjen pas ndajfoljeve *kaq*, *aqë* dhe nëse në fjalinë kryesore mungon ndajfolja *kaq*, në fjalinë rrjedhore përdoret vetëm lidhëza *sa*. Këtu ai jep shembullin: Fiton **sa me jetue**.

Duke e vështruar në rend kronologjik trajtimin e kësaj njësie sintaksore në gramatikat dhe studimet për gjuhën shqipe² vërejmë se përkufizimi, tiparet e periudhës me fjali të nënrenditur rrjedhimore jepen pak a shumë njësoj, pa shumë ndryshime. Në vija të trasha, periudha me fjali të nënrenditur rrjedhimore shpreh marrëdhënien ndërmjet një shkakut dhe pasojës a rrjedhimit të tij. Studimi i saj në gjuhën shqipe ka ecur duke hyrë më thellë në kuptimin e marrëdhënieve rrjedhimore dhe të mjeteve shprehëse të tyre.

Nga ana tjetër, mund të themi se ndonjëherë janë lënë jashtë përfshirjes në periudhat me fjali të nënrenditura rrjedhimore edhe disa tipa periudhash ku, për mendimin tonë, marrëdhënia rrjedhimore është kryesorja. E kemi fjalën, para së gjithash, për periudhat me fjali që bashkohen me lidhëzat **sa**, **derisa** etj. Në disa gramatika të shqipes, si për shembull tek ajo e Martin Camajt (1984), këto fjali klasifikohen si rrjedhimore, por në të tjera, si për shembull te *Gramatika II (Sintaksa)* e

¹ A. Xhuvani, *Njohurit e para të sintaksës shqipe, pjesë e parë për klasët e nalta të filllores*, Vlorë, 1922; *Njohurit e para të sintaksës shqipe për klasët e nalta të Filllores e për t'ullat e Shkollave të Mesme*, Tiranë, 1938; *Libri i gjuhës shqipe, pj. II për klasat e nalta të filllores dhe të parat e Qytetes*, Tiranë, 1942.

² A. Xhuvani, *Njohurit e para të sintaksës shqipe, pjesë e parë për klasët e nalta të filllores*, Vlorë, 1922; *Njohurit e para të sintaksës shqipe për klasët e nalta të Filllores e për t'ullat e Shkollave të Mesme*, Tiranë, 1938; *Libri i gjuhës shqipe, pj. II për klasat e nalta të filllores dhe të parat e Qytetes*, Tiranë, 1942.

J. Rrota, *Sintaksa e gjuhës shqipe*, botimi i dytë, Shkodër, 1943; *Gjuha e shkrueme ase vërejtje gramatikore*, Botimi I, Botime Françeskane, Shkodër, 2006.

K. Cipo, *Sintaksa*. Botim i Institutit të Shkencave, Tiranë, 1952.

M. Domi, *Gramatika e gjuhës shqipe, pjesa II, Sintaksa, tekst për shkollën 7-vjeçare*, Tiranë, 1955; M. Domi, *Gramatika e gjuhës shqipe, pjesa II, Sintaksa*, Tiranë, 1964; *Sintaksa e gjuhës shqipe II*, dispensë, Tiranë, 1969; M. Domi, “*Gramatika e gjuhës shqipe*”, *Sintaksa për shkollat e mesme*, Prishtinë, 1969 dhe 1971.

S. Floqi, *Periudha me fjali të nënrenditur rrjedhimore në shqipen e sotme*, Studime filologjike, 1965/2.

S. Prifti, *Sintaksa e gjuhës shqipe*, Prishtinë, 1971.

Akademia e Shkencave, *Gramatika e gjuhës shqipe II, Sintaksa*, Tiranë, 1997, 2002.

M. Totoni, *Frazja me nënrenditje*, Tiranë, 2000.

Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, cilësohen si periudha me fjali të nënrenditur *kohore* me ngjyrimë rrjedhimore.

Mendojmë se për interpretimin e tyre duhet mbajtur parasysh deri diku vërejtja që bëhet po në *Gramatikën II*³ sipas së cilës, nëse në këto fjali mbizotëron kuptimi kohor apo ai rrjedhimor, kjo varet nga konteksti a situata.

Kështu, periudha “Qeshi **sa i dolën lot nga sytë**” duhet të merret si rrjedhimore (mund ta perifranojmë me një periudhë me fjali të nënrenditur rrjedhimore si: *Qeshi aq shumë, sa i dolën lot nga sytë*, por jo me një kohore që tregon kohëzgjatje si: **Qeshi për aq kohë sa i dolën lot*), por tek *E skuqim qepën sa të marrë ngjyrë të verdhë* është e vështirë të thuash nëse kryesor është kuptimi kohor apo kuptimi rrjedhimor (si parafraza *E skuqim qepën për aq kohë sa të marrë ngjyrë të verdhë*, ashtu edhe *E skuqim qepën aq sa të marrë ngjyrë të verdhë* janë njësoj të përshtatshme).

Sidoqoftë, mund të thuhet me siguri se këtij tipi periudhe mund t’i bëhet gjithherë një interpretim *rrjedhimor*, gjë që s’mund të thuhet edhe për atë *kohor*, ndaj kjo përligj, sipas gjykimit tonë, klasifikimin e tyre përkrah fjalive të tjera rrjedhimore. Kështu, për ne janë rrjedhimore edhe periudhat me fjali të nënrenditur si: *Ishte aq i fuqishëm, sa të tërë ia kishin frikën*, ashtu edhe të bashkërenditura e jolidhëzoret *Ishte i fuqishëm dhe (si rrjedhim) të tërë ia kishin frikën*; *Ishte i fuqishëm, ndaj të tërë ia kishin frikën*; *Ishte i fuqishëm, (si rrjedhim) të tërë ia kishin frikën*.

Pavarësisht nga struktura e tyre sintaksore, për sa i përket kuptimit, këto periudha janë sinonime me njëra-tjetrën.

Po, përveç periudhave me fjali të nënrenditura rrjedhimore, ndërtimet rrjedhimore mund të shprehen edhe me *fjali të thjeshta*, *periudha me fjali të bashkërenditura*, *periudha me fjali asidentike*, si edhe përtej periudhës, *në nivel teksti*. Ngjyrimë rrjedhimore ngërthejnë edhe një numër periudhash të tjera me fjali të nënrenditura.

2. Shprehja e raporteve rrjedhimore në fjali të thjeshtë

Tradicionalisht në sintaksën shqiptare nuk ka qenë i përhapur emërtimi “*fjali (e thjeshtë) rrjedhimore*”.

Kjo me gjasë ka ndodhur jo vetëm ngaqë nuk është bërë ndonjë klasifikim sistemor i fjalive të thjeshta sipas raporteve funksionale-kuptimore (ose qoftë edhe formale) ndërmjet gjymtyrëve të tyre, por edhe sepse është menduar, siç vërehet në *Gramatikën e Gjuhës Shqipe II (Sintaksa)* të Akademisë së Shkencave (f. 493), se në këto fjali nuk ka raporte rrjedhimi, gjë që, sipas autorëve të kësaj vepre, dëshmohet nga

³ Akademia e Shkencave, *Gramatika e Gjuhës Shqipe II*, Sintaksa, Malaka, Tiranë, 2002, f. 574.

mungesa e plotësve (rrethantorëve) të rrjedhimit, përkundër qenies së fjalive të nënrenditura rrjedhimore.

Por ne jemi të mendimit se edhe në shqip ka njësi sintaksore që mund të thuhet se kryejnë funksionin e rrethantorëve të rrjedhimit. E tillë, sipas gjykimit tonë, është për shembull fraza *për vdekje* në “rrah (godas, qëlloj) **për vdekje** (*dikë*)”, frazë e cila është sinonime me fjalinë e varur rrjedhimore (*aq*) *sa e vdes*.⁴

Sidoqoftë, për mendimin tonë marrëdhëniet rrjedhimore ekzistojnë edhe në ndërtimet ku ato nuk janë të shprehura posaçërisht nga ana leksikore, domethënë ku ka fraza - kryesisht në rolin e rrethantorëve - që mendohet se shprehin në fjali raporte të tjera, sipas të cilave edhe emërtohen. Kështu, për shembull, kuptim rrjedhimor mund të themi se kemi edhe në ato fjali ku si gjymtyrë e dytë del një rrethantor shkak, ndonëse në to sigurisht raportet rrjedhimore ndërthuren me raportet shkakore. Në këtë mënyrë, ndërtimet me rrethantorë të shprehur me emër me parafjalë, me emër në rrjedhore a me folje në përcjellore si: *U mek nga të qeshurit (së qeshuri; duke qeshur)* mund të perifrazohen qoftë me një periudhë me fjali të nënrenditur shkakore konstatuese (*U mek ngaqë qeshi*), qoftë edhe - duke tingëlluar mbase më natyrshëm - me një periudhë me fjali të nënrenditur rrjedhimore (*Qeshi sa u mek*).

Po kështu, edhe ndajfolja *copash* e lokucioni i barasvlershëm me të *copa-copa* në *E thyej xhamin copash (copa-copa)*, që tradicionalisht do të interpretoheshin si rrethantorë mënyre, mund të themi se janë rrethantorë rrjedhimi dhe këtë sërish e provon perifrazimi me periudha rrjedhimore: *E thyej xhamin aq shumë (aq keq), sa e bëj copash (copa-copa)* ose *E thyej xhamin sa e bëj copash (copa-copa)*. Perifrazimi mund të shërbejë shumë mirë si një letër lakmushi për të përcaktuar së ç’lloj raportesh shprehen në fjali ose të paktën llojin e rrethantorit që përmban ajo.

Kështu, ndonëse fjalia *E bëj xhamin copash (copë-copë)* është sinonime me *E thyej xhamin copash (copë-copë)*, ajo nuk mund të perifrazohet me periudha rrjedhimore: s’mund të themi, për shembull, **E bëj xhamin aq shumë (aq keq), sa e thyej copash (copa-copa)* ose **E bëj xhamin sa e thyej copash (copa-copa)*.

Ndaj mund të arrijmë në përfundimin se *copash (copë-copë)* tek *E bëj xhamin copash (copë-copë)* tregon shkallën e ndryshimit të gjendjes së realies që shënon emri në funksionin e kundrinës (*xhamin*), prandaj mund të cilësohet si rrethantor mënyre.

⁴ Por nuk mund të thuhet e njëjta gjë edhe për ndërtimet e tipit “mërzis (bezdis) (*dikë*) për vdekje”, ku *për vdekje* përdoret në kuptim jo të drejtpërdrejtë dhe luan rolin e një rrethantori sasie a mënyre.

3. Shprehja e raporteve rrjedhimore në periudha me bashkërenditje

Një formë e veçantë e shprehjes së raporteve rrjedhimore janë disa ndërtime me fjali të bashkërenditura. Nga pikëpamja pragmatiste, kodifikimi i rrjedhojës me anë të nënrenditjes ndryshon nga bashkërendimi prej llojit të veprimit gjuhësor që përmbushet prej folësit.

Periudha me nënrenditje rrjedhimore shpreh një marrëdhënie rrjedhimore mes dy fakteve të një pohimi të vetëm. Në të kundërt, duke përdorur dy fjali që nuk janë të renditura në mënyrë hierarkike, folësi realizon dy pohime, i dyti prej të cilëve vendoset si përfundim kundrejt të parit.

Periudhat me fjali të bashkërenditur që shprehin *marrëdhënie rrjedhimore* janë zakonisht ato përmbyllëset. Te këto periudha me fjali të bashkërenditura me strukturë detyrimisht dykryegjymtyrëshe, fjalia e dytë shpreh diçka që del si rrjedhim, përmbyllje e fjalisë së parë dhe lidhet me fjalinë e parë me anë të lidhëzave të specializuara: *andaj, ndaj, pra, pa*.

Tha se ishte i sëmurë, prandaj atë ditë nuk mund të shkonte në shkollë.

Ka bërë shumë ftohtë, ndaj rruga është e ngrirë.

Lidhja rrjedhimore mes këtyre dy fjalive mund të jetë e vlefshme edhe në mungesë të lidhëzave të posaçme rrjedhimore: *Ishte i fuqishëm dhe të tërë ia kishin frikën*

4. Shprehja e raporteve rrjedhimore në periudha me fjali asindetike

Lidhja rrjedhimore mes dy fjalive mund të jetë e vlefshme edhe në mungesë të mjeteve të specializuara lidhëse (fjalitë asindetike): *Ishte i fuqishëm, (si rrjedhim) të tërë ia kishin frikën.*

Kësisoj në fjalinë “*Ka bërë shumë ftohtë, rruga ka ngrirë*” interpretimi rrjedhimor bëhet nëpërmjet faktorëve enciklopedikë.

Dihet se për nga ana e raporteve kuptimore midis fjalive në bashkimet asindetike mund të shprehen si *raportet e barazisë*, pra të bashkërenditjes, ashtu edhe *raportet e varësisë*, pra të nënrenditjes. Në periudhat me fjali asindetike me marrëdhënie rrjedhimore fjalia e parë përmban *shkakun*, ndërsa e dyta rrjedhimin a pasojën e këtij shkak.

Siç vërehet në Gramatikën e Akademisë,⁵ ka periudha asindetike që për nga kuptimi dhe për nga intonacioni mund të vihen në lidhje edhe me periudha me fjali të

⁵ Akademia e Shkencave, *Gramatika e Gjuhës Shqipe II, Sintaksa*, Malaka, Tiranë, 2002, f. 624.

bashkërenditura lidhëzore, edhe me periudha me fjali të nënrenditura lidhëzore, si p.sh. disa raste periudhash me marrëdhënie rrjedhimore ose përmbyllëse: *U shtriva që u shtriva, po bëj një sy gjumë.*

5. Ngjyrimet rrjedhimore në periudha me fjali të tjera të nënrenditura

Ngjyrim rrjedhimor ngërthejnë edhe fjali të tjera të nënrenditura, si periudha me fjali të nënrenditur përcaktore, kohore e qëllimore. Kështu, siç vërehet në *Gramatikën e gjuhës shqipe II (Sintaksa)* të Akademisë së Shkencave (f. 534), bashkëlidhja e brendive reale konkrete të fjalive të periudhës mund t'i japë fjalisë së nënrenditur përcaktore ngjyrim rrjedhimor. Për këtë ka edhe disa tregues formalë gramatikorë në fjalinë kryesore.

Paraprijës është një togfjalësh emëror, i përbërë prej një emri të përgjithshëm të shoqëruar nga përemra dëftorë të cilësisë, si kësi, ai, i (a) tillë. Prania e përemrit dëftor shkakton një lidhje shumë të ngushtë midis fjalive; fjalia e nënrenditur është pjesë e domosdoshme e fjalisë kryesore nga pikëpamja gramatikore dhe kuptimore.

Përemrat dëftorë i japin emrit një cilësim në mënyrë më të përgjithshme, por gjithmonë pa e emërtuar atë cilësi. Kjo cilësi e pashprehur zbulohet vetëm nëpërmjet asaj që thuhet në fjalinë e nënrenditur, d.m.th. zbulohet nëpërmjet *rrjedhimit, pasojës: Fytyra i mori një pamje të tillë që e gëzoi vajzën.*

Paraprijës mund të jetë një emër i vetëm, i pashoqëruar nga ndonjë përemër dëftor, por semantika dhe trajta e këtyre kërkojnë doemos një karakteristikë, të cilën në të vërtetë e jep fjalia e nënrenditur nëpërmjet diçkaje që është rrjedhim i saj. Paraprijësi emër është rëndom një emër i vetëm në trajtë të pashquar, i shoqëruar nga fjalët një a disa (ca): *Kishte ca piktura që ta prishnin mendjen.*

Marrëdhëniet rrjedhimore mund t'u mbishtohen fjalive qëllimore me lidhëzat që dhe lokucionin lidhëzor në mënyrë që, sidomos kur fjalia drejtuese pas foljes kallëzues ka ndonjë gjymtyrë të shprehur me ndajfolje mënyre, ndajfolje sasive ose me mbiemër: *Shuplakat më të rënda do ti japim atyre, gjersa të gjithë të largohen nga ky vend.*

6. Raportet rrjedhimore në nivel teksti

Në gjuhësinë bashkëkohore flitet edhe për një njësi gjuhësore që qëndron mbi fjalinë. Kjo njësi është teksti. Kur vendoset përtej kufijve të fjalisë a periudhës, marrëdhëniet e rrjedhjes siguron një lëvizje teksti që lejon të organizohet ligjërimi në bazë të nevojave të veçanta arsyetuese:

Dadaizmi nuk mëtonte t'i jepte pikënisje një rryme artistike me rregulla të kodifikuara, sikurse në fakt ishte, për shembull, rasti i fotodonamizmit futuristë të Balës e të Boçionit. Dadaizmi që provokim i pastër: Kështu, futurizmi dhe dadaizmi mund të kenë pika lidhjeje.

Përfundime

Si përfundim mund të themi se, interesi i treguar për ndërtimet rrjedhimore nuk ka munguar nëpër gramatika apo studimet sintaksore të gjuhëtarëve tanë, por trajtimi i temës në fjalë ka qenë i paplotë. Ndërtimet rrjedhimore nuk ishin parë në tërësinë e tyre, por ishin kufizuar në trajtimin e periudhës me fjali të nënrenditur rrjedhimore. Po, siç u trajtua edhe më sipër, përveç periudhave me fjali të nënrenditura rrjedhimore, ato mund të shprehen edhe me *fjali të thjeshta*, si edhe përtej periudhës, në nivel teksti.

Bibliografia

- Akademia e Shkencave, *Gramatika e gjuhës shqipe I*, Tiranë, 2002.
- Cipo, K., *Gramatika e gjuhës shqipe për klasat e V-ta, VI-ta, VII-ta të shkollave 7-vjeçare*, Tiranë, 1949.
- Cipo, K., *Sintaksë* (Tekst për Institutin Pedagogjik), Tiranë, 1951.
- Cipo, K., *Sintaksa shqipe*, Tiranë, 1952.
- Domí, M., *Gramatika e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1968.
- Domí, M., *Gramatika e gjuhës shqipe*, Sintaksa për shkollat e mesme, Prishtinë, 1969 dhe 1971.
- Floqi, S., *Periudha me fjali të nënrenditur rrjedhimore në shqipen e sotme*, Studime filologjike, 1965/2.
- Mansaku, S., *Prirje të strukturës sintaksore të shqipes së sotme standarde*, Seminari XX ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe kulturën Shqiptare 20/1, Prishtinë 2002.
- Mikeli, G., *Gramatika e gjuhës shqipe*, Shtypshkronja “Nikaj”, Shkodër, 1916.
- Prifti, S., *Sintaksa e shqipes*, Tiranë, 1962, ribotuar në Prishtinë, 1971.
- Rrota, J., *Syntaxa e gjuhës shqipe (ose Sintaksi i shqipes, 1942) për klasën II, III, IV të shkollave të mesme*, Shkodër, shtypshkronja At Gj. Fishta, Shkodër, 1943
- Rrota, J., *Gjuba e shkrueme ase vërejtje gramatikore*, ASHSh IGjL Botimi I, Botime Françeskane, Shkodër, 2006.
- Xhuvani, A., *Libri i gjuhës shqipe*, pjesë e dytë për klasat e nalta të fillores dhe të parat e Qytetses, Tiranë, 1942

Xhuvani, A., *Njohunit` e para të sintaksës shqipe, pjes` e parë për klasët e nalta të fillores*, Vlorë, 1922.

Xhuvani, A., *Njohunit e para të sintaksës shqipe për klasët e nalta të Fillores*, Tiranë, 1938.

Idriz METANI

PËRDORIMI I FIGURSHËM I FJALËVE PROFESIONALE NË LIGJËRIMIN E SOTËM PUBLICISTIK

Për ligjërimin e sotëm¹ publicistik, vështruar si fushë veprimtarie gjuhësore në gji të stilit politiko-shoqëror të shqipëse standarde, ka një varg studimesh², artikujsh³ e sprovash të ndryshme në të cilat analizohet gjuha e këtij ligjërimi në vetëjakësinë e saj. Pjesa më e madhe e këtyre punimeve kanë bërë objekt vëzhgimi herë dukuritë leksikore të pranishme në ligjërimin e sotëm publicistik për të vënë në dukje vecoritë leksiko-semantike të këtij ligjërimi dhe herë sintaksën e tij për të spikatur risitë e ligjërimin të sotëm publicistik në këtë aspekt.

Artikuli ynë mëton të analizojë përdorimin e figurshëm të disa fjalëve, kryesisht të atyre profesionale⁴, në ligjërimin e sotëm publicistik, për të vënë në dukje **së pari**, fushat tematike prej të cilave vijnë këto fjalë dhe, **së dyti**, për të hetuar përbërësit kuptimorë që bëjnë të mundur lidhjen e tyre në një strukturë të figurshme brenda këtij ligjërimi.

¹ Siç dihet, pas vitit 1990, në Shqipëri u vendos, me pëmbysjen e diktaturës, një sistem i ri ekonomik-shoqëror që krijoi kushte për lindjen e zhvillimin edhe të një gazetarie të re, gazetarisë së fjalës së lirë, në të cilën u shpreh pluralizmi politik dhe u pasqyruan alternativa mendimesh sipas programeve të shoqatave e partive politike. Natyrisht që pluralizmi i mendimeve nuk u shpreh vetëm tek organet e shtypit (gazeta e revista), por edhe tek mjetet e informimit e të propogandës (radioja e televizioni, si dhe në format e tjera të ngjashme (konferencat e shtypit, mitingjet, parlamenti etj). Të gjitha këto mjete, të shtuara e të gjallëruara, sidomos këto vitet e fundit, shpërthyen guaskën njëngjyrëshe të medias së mëparshme, zgjeruan hapësirën shoqërore të gjuhës, me dukuri të reja në mjetet e shprehjes gjuhësore duke i dhënë ligjërimin publicistik të shqipëse një fytyrë të re në aspektin gjuhësor.

² Shih, ndër të tjera dhe Lloshi Xh., Gjuha, stili dhe redaktimi në shtyp, 1977; Murati Q., Gjuha e medie-Fjalor i gabimeve gjuhësore, Prishtinë, 2008; Fjalor i gabimeve gjuhësore-Këshilla për tu shprehur saktë dhe bukur, Shkup, 2013

³ Shih, përvec të tjerave, edhe Thomai J., Dukuri leksikore në shtypin e sotëm, Gjuha jonë, 1-4, 1993, f. 29-34; Tipare të gjuhës së shtypit në kohën tonë, Teksti dhe gjuha, f. 181-192; Dhrimo A., Për një gjuhë sa më të pastër e të njësuar në publicistikën tonë, Norma letrare dhe kultura e gjuhës, I, 1973, f. 306-312

⁴ Lënda gjuhësore e vënë në analizë është vjelë nga shtypi i ditës, nga librat e politikanëve e qeveritarëve tanë, si dhe nga bisdatat e intervistat e tyre në media.

1 Fjalët profesionale ose, sic quhen ndryshe, profesionalizmat, formojnë në gjuhën shqipe, si në cdo gjuhë tjetër, një shtresë leksikore që njihet dhe përdoret vetëm prej grupesh të vecanta njerëzish, prej punonjësish e specialistësh që merrën me një punë të caktuar sipas mjeshtërisë që ata ushtrojnë. Kështu janë specifike për mjekët fjalët **insuficiencë kardiake, kancer, ngërc...**, për pilotin **bombardues, pikiadë, skuadrilje...**, për studentin **auditor, leksion, vlerësim** etj. Një pjesë e mirë e këtyre fjalëve përdoren edhe jashtë kufijve të profesionit, madje edhe në ligjërimin publicistik, duke u rikuptimësuar për të zgjeruar kësisoj strukturën e tyre kuptimore. Po japim më poshtë disa shembuj të përdorur në emisionin “Top Story” të 25 qërshorit 2015, ku i ftuar ishte Erjon Veliaj pas zgjedhjes së tij si kryebashkiak i Tiranës përballë gazetarëve Sokol Balla, Skënder Minxhozi, Mustafa Nano dhe Arjan Vasjari: *aksesorë politikë, barrë fiskale, blloku i politikës, cedimi i politikës, cibanë sociale (për banesat sociale), ferr financiar, grupë financiare, gjëagjëzë politike, hendek ligjor, hendek social, ë politike, kolateral politik, katapultë politike, korrektim financiar, korrektim i buxhetit, kryefjala e protestave, mandat i blinduar, ndjellje turistike, nervi i politikës, nuatje politike, performancë e politikës, pikiadë partiake, qytet konfuz, rutinë politike, sita e politikës, suport politik, shpellat e politikës, shurrtore e politikës, sharmi i politikës, turizëm politik, turizëm i koventave, turizëm ideologjik, truke turistike, tender i politikës, temperatura e fushatës, trafik votash, trafik i politikës, uria e izolimit, verbëri politike, zelli i politikës* e ndonjë tjetër. Fushat tematike prej të cilave ato vijnë, sic del nga vëzhgimet që kemi bërë, janë disa:

a) mjeksia me fjalët **arterie, dhëmbë, mushkri, vesh, operacion, palcë, tumor** etj. psh. *arteriet rrugëve, dhëmbët e babëzisë, mushkëria e qytetit, qeveri pa veshë, operacioni i sistemit, palca e shtetit, tumor politik a partiak* etj. Devijimet që u hapën rrugë ndërtimeve për të cilat interesohet **barku** i oborrit të kryeministrit. (Kurban, f. 281). Kur ngjyrat nisën të shëronin **lëkurën** e rjepur të godinave të vjetra (Kurban, f. 50). Terapi e suksesshme për të ndërhyrë dhe **për të operuar** gjithë sistemin duke bërë të mundur që ai të ngrihet në këmbë e të jetë në gjendje tu shërbejë gjithë qytetarëve (Panorama, 18.05.2012)

b) bujqësia me fjalët **cipë, pyllëzim, teharre, zgërbonjë** etj. psh. *cipa e mediokrëtitit, pyllëzim me beton, tehar procesin vendimmarrës, ekonomi zgërbonjë* etj. **Pyllëzimi** me beton i brezit të parë të Dajtit (Kurban, f. 107). Dhe një arsim shqiptar të zhytur në **mocalin** e interesave private qoftë në qeveri, qoftë në sferën jopublike të arsimit (Kurban, 216). Për të mbajtur në këmbë hijen e forcës që ë zhysin shoqërinë në **mocalin** e frikës e të indiferencës konsesuale (Kurban, 243)

c) blegtoia me fjalët **bari, guaskë, koshere, krimb, vathë, zhabë** etj. psh. *bariu i qeverisë, guaska e pushtetit, koshere socialiste, krimbi i korrupsionit, vathë partiake, zhaba e mllëfit* etj. Përpjekja për kompromis u shua me hirin e zjarrit që ndezi aty për aty me

drurët e malit të akuzave të tij **bariu** i qeverisë. (Kurban, f. 171). Ideja e mbarë e Bamir Topit ishte të nxiste një debat pak më të gjerë e më largpamës se sa debati **shterpë** i lejdhënies për ndërtime në Tiranë (Kurban, f.296). U desh dashamirësia dhe këmbëngulja e Gramoz Rucit, sekretar i përgjithshëm socialist aso kohe, gjithmonë në rolin e një burri të urtë, parimor e tolerant dhe asnjëherë palë në sherret e **kosheres** socialiste (Kurban, f. 210). E detyruan Fatosin ta gëlltiste **zhabën** e mllëfit dhe të priste një ditë më të mirë për të më prerë kokën (Kurban, f. 142). Rama, peshku i madh i krimit (55, 7.09.2015)

d) gjeografia me fjalët **furtunë, granit, ë, lumë** etj. psh. *furtuna e pushtetit, granit qeveritar, ë mosbesimi, lumi i debateve* etj. Emri i është kthyer si pak kujt ndër jopolitikanët në tabelë qitjeje për armatën e baltës e valët e sulmeve (Kurban, f. 228). Mbytur në **furtunat** e përditshmërisë shurdhuese të politikës dhe braktisur kaherë në fund të detit të shpirtit me gjithë gjërat e shfaqura aty për shkak të detyrës (Kurban, f. 12). Sa herë duhet hedhur një gur coroditës kur **lumi** i debateve futet në rrjedhë (Kurban, f. 157). Një përballje e egër mes **prurjeve** të eksituara demografike në kërkim të lumturisë tokësore (Kurban, f. 100). Vittyti katandiset në një rrobë të grisur predikuesish nga **shkretëtira** e shurdhët e shoqërisë (Kurban. F. 25). Duke besuar se mund të mbillet besimi në një **ë** mosbesimi (Panorama, 13.05.2012)

dh) ushtria me fjalët *armatë, llogore, viktimë* etj. psh. armata e baltës, llogorja e qeverisë, viktimë financiare etj. Emri i është kthyer si pakkujt ndër jopolitikanët në tabelë qitjeje për **armatën** e baltës (Kurban, f. 228). Ai premtoi se Partia Demokratike do ta cojë deri në fund **betejën** e dekriminalizimit të parlamentit e të administratës publike, duke u bërë thirrje të largohen nga detyra të gjithë ata që kanë rekorde kriminale (Panorama, 11.09.2015). Me kushtin që LSI-ja të mos jetë rreshtuar në **llogoren** e qeverisë (Panorama, 19.05. 2012). Ai është përgjegjësi numër një për futjen në Kuvendin e Shqipërisë dhe emërimin në poste publike të individëve me rekorde të tmerrshme kriminale për të bërë detyrën e shëmtuar të **skuadronëve** të dhunës kundër kundërshtarit politik, kundër opozitës, kundër fjalës së lirë, kundër vetë pluralizmit (RD, 11.09.2015)

e) arti me fjalët *ngjyrë, shfaqje, teatër, tatuazh* etj. psh. ngjyra e pushtetit, shfaqje politike, teatër i politikës, tatuazhet e akuzave etj. As për Ferrarin apo bentlyn që për Tanin ishin **skulptura** vrapuese (Kurban, f. 237). Deputetët e opozitës po shfrytëzonin komisionin për të bërë **shfaqje** politike (Panorama, 12.09.2012) Me **tatuazhet** e akuzave dhe të shpifjeve mbi lëkurën time (Kurban, f. 30). Ka dhe fusha të tjera si **arkitektura, ekonomia, jeta sociale, jurispodenca, sporti, teologjia, turizmi, psikologjia, ndërtimtaria** e ndonjë tjetër. Po japim disa shembuj: Duhet ta dijë se është në shënjestër si **arkitekt** i kriminalizimit (Panorama, 11.09.2015). Pri, prit,

hetimi ndërkombëtar është i domosdoshëm, sepse kemi të bëjmë me depozita kolosale parash në **parajsa** fiskale të diskutuara nga angjencitë shqiptare (Panorama, 11.09.2015) Këtë bëtë ju dhe kjo është e vërtetuar, bëtë marrëveshjen e **vetëgjyqjesisë** financiare, tha Gjijnuri (Panorama, 11.09.2015). Këto ditë kam ndjekur me keqardhje se, jo vetëm ministri i brendshëm, por edhe e gjithë **tifozëria** rilindase rrotull tij gëzoheshin si fëmijë, nga që avioni i fundit që u kap me drogë shqiptare në Itali, nuk paska mbrritur direkt nga Shqipëria në Piemonte, por paska bërë një ndalesë në Lece për furnizim (Panorama, 11.09.2015). Partnerët tanë janë të skandalizuar me **rekordet** e zeza të krimit të qeverisë (Panorama, 11.09.2015). Gusmari nuk është republikë e Shqipërisë është republikë e kanabisit dhe kjo është arsye dhe po ja u pranoj (Panorama, 11.09.2015). Sot në sytë e shqiptarëve del pra lakuriq përpara tyre morali dhe fytyra e kryebosit të krimit...(55, 7.09.2015). Kjo ditë dhe cdo ditë është një thirrje për cdo shqiptar, pavarësisht nga bindjet e tij të ngrihemi dhe me një revolucion demokratik të thërrmojmë muri e krimit e të korrupsionit të Edi Ramës...(55, 7.09.2015)

2 Me mjaft interes na duket edhe çështja e hetimit të semave a përbërësve kuptimorë që bëjnë të mundur qëndrimin pranë njëra tjetrës në një lidhje të figurshme te një fjale profesionale me një fjalë tjetër, zakonisht të leksikut politiko-shoqëror⁵. Kjo çështje meriton një studim më të përimtuar, por që në këtë kumtese do të trajtohet fare shkurt.

Nga shqyrtimi i kujdeshëm dhe tërësor i lëndës gjuhësore që kemi në dorë del se përbërësit kuptimorë që mundësojnë zgjerimin semantik të një fjale profesionale në ligjërimin e sotëm publicistik duke e lidhur atë në mënyrë të figurshme me fjalë të tjera, zakonisht të fushës politiko-shoqërore, shprehin gjuhësisht tregues të ndryshëm të realies që shenjohet prej këtyrë fjalëve. Si të tillë mund të përmendim:

a) Përbërës që shprehin gjuhësisht **tregues të cilësisë** së realies, si *afërsia, shterpësia, verbëria, vogëlsia, pastërtia fizike e shpirtërore, lartësia, shurdhëria, rrezikshmëria, madhësia, bollësia, thellësia, forca, gjatësia* etj. psh barku i oborrit, debat shterpë, verbëria e dhunës, glasa betoni, higjiena shpirtërore, lëkura e godinave, cipa e mediokritetit, mur shurdh, qeveri pa vesh, tumor politik, lumi i debateve, armata e baltës, oktapod korrupsioni, ekonomi zgërbonjë, guaska e krimit, granit qeveritar, zhaba e mllefrit, planet i artit, tërkuza e akuzave etj.

⁵ Në monografinë me titull “Rreth leksikut politiko-shoqëror në gjuhën shqipe”, Tiranë, 2008, studiuesi Mico Samara bën një analizë të gjerë strukturore e semantike të këtij leksiku nga këndvështrimi sociolingistik bashkëkohor duke marrë parasysh ndikimin e faktorëve gjuhësorë në bashkëlidhje të ngushtë me faktorët jashtëgjuhësorë, të cilët, kohë pas kohe, kanë bërë të mundur zhvillimin e këtij leksiku.

b) Përbërës që shprehin gjuhësisht **tregues të përdorimit a të funksionit** të realies psh. *arteriet e rrugëve, dhëmbët e babëzisë, thikat e verbërisë, mushkëria e bulevardit, palca e shtetit, perja e qeverisë etj.*

c) Përbërës që shprehin gjuhësisht **tregues të mjedisit** të realies psh. shfaqje politike, teatër politik etj.

Si përfundim mund të themi se, përveç dukurisë së rikuptimësimit të figurshëm me zgjerim semantik të disa fjalëve që vijnë nga profesione të ndryshme, të cilën u rrekëm ta analizojmë shkurt në kumtesën tonë, tek ligjërimi i sotëm publicistik duke e kundruar atë në rrafshin gjuhësor, janë të pranishme të paktën edhe dy dukuri të tjera leksikore, që presin të studiohen më gjerë në të ardhmen. Si të tilla mund të përmendim: a) neologjinë leksikore ose fjalëkrijimin. Nga vëzhgimet tona paraprake del se është shtuar ndjeshëm në këtë ligjërim numri i fjalëve të krijuara prej autorësh të ndryshëm, si u anashkalojnë (problemeve), bashkëvuajtës, dyshtetësi, eksodistët, epitetoj, etj), b) shtimin në përdorim të fjalëve me burim dialektor e krahinor që mbartin vlera të ndryshme shenjuese e karakterizuese, si, bindshëm, bollshëm, guximshëm, hershëm, kërcënueshëm, mëtim, mjeran, prishaqejf, ushlat “fluskat e duarve” etj.

Bibliografi

Dhrimo, A. Për një gjuhë sa më të pastër e të një suar në publicistikë n tonë, Norma letrare e kultura e gjuhës, 1973

Lloshi, Xh. Gjuha, stili dhe redaktimi në shtyp, 1977

Mazruiu, A.A. The political sociology of english language, 1975

Murati, Q. Gjuha e medievet-Fjalor i gabimeve gjuhësore, 2008

Samara, M. Rreth leksikut politiko-shoqëror në gjuhën shqipe, 2008

Thomai, J. Teksti dhe gjuha, 1992

Teuta DHIMA

KOMUNIKIMI VERBAL DHE JOVERBAL ME PËRDORUESIN NË BIBLIOTEKAT PUBLIKE

Qëllimi i këtij studimi është:

- Të sjellë aspekte të komunikimit verbal dhe joverbal në Bibliotekat Publike dhe më konkretisht në Bibliotekën Publike të Durrësit. Larmishmërinë e llojeve të folurit dhe gjuhën që përdoret nga përdorues të ndryshëm gjatë procesit të huazimit të materialeve në bibliotekë.
- Të argumentojë që, një komunikim i mirë qoftë ai verbal ose jo, jep frytet e tij si për huazuesin e informacionit, ashtu edhe për marrësin.

Metodat: kam përdorur metodat cilësore - sasiore për realizimin e qëllimit studimor. Më konkretisht, metodat e përdorura janë:

- Intervista- si një metodë cilësore, e realizuar me përdorues të kategorive dhe status shoqëror të ndryshëm. Ato kanë qenë individuale ose në grup.
- Vëzhgimi natyror - në ambientet e bibliotekës, aty ku përdoruesi vjen për të kërkuar informacion. Vëzhgimin natyror duke qenë se nuk ofron njohuri të sigurta për motivet, dëshirat, parapëlqimet dhe pretendimet,¹ e kam kombinuar me metodën sasiore të **anketimit**.
- Metoda e anketimit: anketimet e bëra me përdoruesit në Bibliotekën Publike kanë qenë individuale ose në grup, me pyetje të hapura dhe të mbyllura.

Arritjet: *Së parë:* përmirësimi i komunikimit verbal dhe atij joverbal në bibliotekë. Ky përmirësim sjell rezultate pozitive si për shfrytëzuesin e informacionit ashtu edhe për institucionin dhe specialistin që e bën të mundur përdorimin e këtij informacioni. Të jesh i dobishëm, të sjellësh tek përdoruesi *atë* çfarë ai kërkon, *atë* çfarë ai pëlqen dhe në kohën kur ai e ka të nevojshme, është një nga arritjet më të mëdha për një specialist të bibliotekës dhe institucionit që ai i përket.

¹ L. Sokoli, *Metodat e kërkimit në shkencat sociale*, IS, 2009, f. 149

Së dytë: njohja e vetvetes dhe e tjetrit. Komunikimi verbal ose joverbal ndryshon nga një përdorues në tjetrin. Ai asnjëherë nuk do t'i ngjasojë krahëve të barazuar të një peshoreje, për të vetmen arsye se kompetenca komunikative e pjesëmarrësve në komunikim (përdoruesi dhe specialisti) nuk është asnjëherë e njëjtë. Në çastin kur çdonjëri prej nesh fillon e flet, gjuha që përdor im na bën të marrim një pozicion të veçantë dhe individual.

Fjalët çelës: bibliotekë, informacion, komunikim, gjuhë, përdorues.

E drejta për t'u informuar është një prej të drejtave themelore të njeriut. Një ndër institucionet në të cilat përdoruesi mund ta marrë informacionin që i nevojitet, është edhe biblioteka. Bashkë me nevojën për informacion, lind edhe nevoja e komunikimit specialist – përdorues. “Komunikimi” nuk përkon me “informacionin”: mund të komunikohet edhe pa u informuar medoemos (psh, kur kërkon informacion, apo urdhëron dikë), ndërsa është e pamundur e kundërta: nuk mund të ketë informacion pa komunikim.²

Komunikimi specialist – përdorues mund të jetë joverbal, para-verbal dhe verbal.

1. Forma joverbale e komunikimit

Komunikimi joverbal me institucionin nis me orarin. Përdoruesi nëpërmjet gjuhës së shkruar, informohet për orarin e shërbimeve bibliotekare. Më pas, po në sajë të gjuhës së shkruar, emërtimeve dhe etiketimeve, ai do të zgjedhë sallën përkatëse duke u nisur nga nevoja për informacion që ka: libra(në shqip apo gjuhë të huaj), periodikë etj. Vëllimi i informacionit në bibliotekë është shumë i madh dhe tenton të shkojë drejt rritjes. Përdoruesit i intereson të përdorë dhe të gjejë një informacion që i duhet atij. Në këtë pikë na vjen në ndihmë klasifikimi materialeve. **Klasifikimi përkuqfizohet si renditje sistematike në raft sipas subjektit të librave dhe materialeve, si edhe regjistrimeve në katalog në mënyrë të përshtatëshme për ata që kërkojnë një material të caktuar.** Çdo skemë klasifikimi përdor sisteme simbolesh- kode që simbolizojnë subjektet e një klase në renditje. Në bibliotekën tonë përdoret Klasifikimi Dhjetor Universal (KDU), i cili është një sistem ndërkombëtar dhe nuk është në varësi të gjuhës. *Me anë të simboleve, shkruan Tomas Karlitë në librin me titull Sartor Rezartus, njeriu udhëbëiqet dhe komandohet, lumturohet dhe mjerohet. Ai e gjen veten të rrethuar ngado me simbole, të njohura dhe të panjohura si të tilla. Simbolet janë më shumë se figura.*³ Me anë të renditjes së njëpasnjëshme të simboleve

² E. Buharaja, *Semiotika*, Acustica, 2012, Leksione, f. 62

³ T. Marrs, *Kodet magjike*, Bota shqiptare, 2009, f. 20

në rastin tonë, paraqiten lidhjet midis objekteve dhe ndarja nga objekte të tjerë. Këto simbole janë numrat, shkronjat e alfabetit ose përzierje. Për sistemimin nëpër rafte të materialeve, përdoren ndarje jo shumë të detajuara, ndërsa për katalogun sistematik klasifikimet arrijnë në detajimin maksimal. Në ndarjet nëpër rafte, detyra e specialistit, është të japë në etiketime barasvlerën e këtyre shifrave me fjalë. Psh. 821.111- 31, për bibliotekarin, është letërsi angleze (romane), ndërsa për përdoruesin, nëse nuk interpretohen me fjalë, janë vetëm një grumbull shifrash. Çdo pjesë e klasifikimit identifikohet me lehtësi nëpërmjet simboleve dhe kjo bën që njësitë të dallohen nga: forma fizike, subjekti etj. Disa shenja që përdoren në klasifikim janë:

- + (plusi), lidh dy ose më shumë numra të KDU-së për të shprehur subjekte të përbërë për të cilët nuk ka një numër të veçantë klasifikimi.
- / fraksioni lidh numrin e parë deri tek i fundit në serinë e numrave të KDU-së, për të shprehur një subjekt të gjerë.
- (:) raporti, kur subjektet janë në raport me njëri tjetrin, janë të varur njëri nga tjetri.
- [] kllapat katrore përdoren kur një subjekt i shprehur me dy ose më shumë numra kryesorë, të lidhur me shenjën e plusit, fraksionit ose raportit, lidhen me një numër tjetër. Shenja të tjera janë: = barazimi, * yllthi, ‘ apostrofi, “ “ thonjëzat etj. Nëpërmjet katalogut publik në rrjet mund të bëhen kërkime sipas subjektit dhe të bëhen zgjedhje të ndryshme. Treguesi alfabetik i tabelës së KDU-së shërben si një fjalor ku përdoruesi gjen orientim për subjektin në renditje sistematike. Duhet pasur kujdes të bëjmë dallimin midis mjeteve ndihmëse të specialistit klasifikator, siç janë treguesit e botuar të KDU-së dhe fjalorit të termave të njehsuar (për simbolet e klasifikimit në një sistem të automatizuar). Treguesi i KDU-së dhe vetë tabela janë mjetë pune për bibliotekarët profesionistë dhe jo për përdoruesit, pasi nuk shërbejnë si udhëzues të koleksioneve konkrete.

Përdorimet e KDU-së në rrjet. Kërkimi sipas subjektit në sistemet e kërkimit në rrjet kryhet duke përdorur: sistem të kontrolluar të emërtimeve lëndore dhe fjalë nga teksti i titullit ose abstraktit.

Katalogimi. Përfshin krijimin e përshkrimeve për dokumentet bibliotekare dhe ka si synim ndërtimin e mjeteve të kërkimit të informacionit të cilat janë: Katalogët, baza e të dhënave, bibliografitë etj. Antonio Panizzi, i cili hartoi *Rregullat e hartimit të katalogut*, në vitin 1841, shprehet: *Lexuesi mund ta njohë veprën që ai kërkon; nuk mund të*

*mendohet që ai të dijë të gjitha hollësitë e botimeve të ndryshme të kësaj vepre; këtë informacion ai ka të drejtë ta marrë nga katalogët.⁴ **Çfarë duhet të realizojë një katalog?***

-Të mundësojë përdoruesit gjetjen e një libri për të cilin ai di: autorin, titullin, subjektin.

- Të tregojë çfarë ka biblioteka nga një autor i caktuar, për një subjekt të caktuar.
- Të ndihmojë në gjetjen e një libri. *Për t' i realizuar këto dubet:*
 1. autori element hyrës me referimet e nevojshme
 2. titulli element hyrës ose referim për titullin
 3. subjekti dhe numrat e klasifikimit elementë hyrës
 4. dhënia në përshkrim e botimit dhe e shtypit me shënime kur është e nevojshme
 5. shënime⁵

Çdo dokument paraqitet nëpërmjet përshkrimit bibliografik ose regjistrimit, me veçoritë kryesore dhe vendin që ai zë në bibliotekë. Në katalogët tradicionalë, (skedar) përshkrimet bibliografike janë komplete skedash, kurse në katalogët e kompjuterizuar në rrjet, regjistrimet bibliografike janë informacione të koduara në formate të lexueshëm nga kompjuteri. Në bibliotekën tonë, përdoruesit i ofrohen të dyja mundësitë e kërkimit.

Etiketat e librave. Në to jepen të dhëna për përkatësinë institucionale, gjininë, autorësinë dhe numrin e kopjes, gjithmonë shprehur kjo me shifra. Përsëri përdoruesi gjendet përpara *barrierës së shifrave*, pasi etiketa për përdoruesin sjell një mesazh që nuk mund ta interpretojë, ndërsa specialisti i bibliotekës po. Në përgjithësi, përdoruesi i thjeshtë nuk meret me leximin dhe interpretimin e etiketës së librit.

Raste të tjera të përdorimit të simboleve në komunikimin joverbal. Simbolet, kaq domethënëse në vetvete... *Me anë të simboleve*, shkruan Tomas Karlitë në librin me titull *Sartor Rezartus, njeriu udhëbëiqet dhe komandohet, lumturobet dhe mjerohet. Ai e gjen veten të rrethuar ngado me simbole, të njohura dhe të panjohura si të tilla. Simbolet janë më shumë se figura.*⁶

⁴ Rregullat e katalogimit dhe kërkesat funksionale për regjistrimet bibliografike, Leksione, f. 1

⁵ Po aty.

⁶ T. Marrs, *Kodet magjike*, Bota shqiptare, 2009, f. 20



Logoja: Në çdo dokument, botim apo ftesë veprimtarish që i përkasin bibliotekës, logoja është prezent për të na treguar përkatësinë. Logoja paraqitet e ndarë në dy gjysma: e shkuara dhe e ardhmja. Në bazën e saj, viti i krijimit të institucionit. Në qendër të saj, mbi tre kolona të fuqishme, qëndron libri, si simboli i këtij tempulli të dijes. Kolonat mbi të cilat qëndron simbolizojnë: qëndrueshmëri, fuqi dhe stabilitet në çdo kohë. Pjesa e sipërme e logos ka rreze të arta drite të cilat dalin prej librit të hapur për të përforcuar edhe më shumë idenë se: një libër i hapur sjell vetëm dritë në rrugën e njerëzimit.

Vula. Gjatë gjithë historisë njerëzore, vulat kanë përcjellë ide, koncepte. Kemi dy lloje vulash:

- vulën e i institucionit, që përdoret nga drejtuesi dhe bën të qartë përkatësinë e tij.
- vula që përdor klasifikatori i bibliotekës gjatë përpunimit fizik të librit. Ajo vendoset në faqen e titullit dhe atë 17. Në rastin tonë, materialet bibliotekare kanë vulën Biblioteka Publike Durrës. Mesazhi që merr përdoruesi me një libër të vulosur kështu është: ky libër i përket Bibliotekës Publike Durrës.

Lloje të tjera të Komunikimit Joverbal:

Njoftimet e ndryshme që i bëhen përdoruesit. - Në *ligjërimin e shkruar*, - thotë Gjovalin Shkurtaç, - *ligjëruesi nuk ka mundësi të mbështetet në situatën a mjedisin konkret, as të shfrytëzojë intonacionin e vet apo, gjestet.*⁷ Për këtë, gjuha me të cilën janë të shkruara këto lajmërimet duhet të jetë e saktë. Përmbajtja duhet të jetë konçize dhe domethënëse, me të vetmin qëllim që të qartësojë dhe të mos sjellë konfuzion. Zakonisht në këto lajmërimet, përdoruesit informohen për të drejtat e tyre, mirëmbajtjen e materialeve të huazura, kthimin e tyre në kohë, si dhe respektimin e qetësisë në sallat e studimit.

Lajmërimet për vonestarët e materialeve: Përdoruesi kërkon materialet që i nevojiten, por shpesh herë nuk është korrekt në respektimin afateve për kthimin e materialeve të bibliotekës. Në këtë rast i takon specialistit që të bëjë lajmërimet e rastit për secilin prej përdoruesve problematikë. Specialisti komunikon me përdoruesin nëpërmjet kontakteve të ndryshme të cilat mund të jenë numra telefoni, e-mail, etj.

⁷ Gj. Shkurtaç, *Si të shkruajmë shqip*, Toena, 2008, f. 179

Një formë tjetër janë edhe lajmërimet postare në adresat e banimit.⁸ Komunikimi verbal- joverbal që kemi në këtë rast, ka për qëllim të vetëm rritjen e ndjeshmërisë së përdoruesit ndaj zbatimit të rregullores institucionale.

Komunikimi joverbal dhe gjuha e trupit: Gjashtë të fshehtat për të tërhequr me gjuhën e trupit janë: fytyra, gjestet, lëvizjet e kokës, kontakti optik, qëndrimi i trupit, hapësira intime, pasqyrimi. Komunikimi joverbal mund të shërbejë për të komunikuar qëndrimet apo ndjenjat tona të cilat n pavarësisht përpjekjeve, nuk arrijmë dot t'i fshehim plotësisht. Sipas Allan& Barbara Pease, *të nxënit e gjuhës së trupit na bën të kuptojmë më mirë se me çfarë mënyre njerëzit përpiqen t'u imponohen të tjerëve, por njëkohësisht na ndihmon të kuptojmë se edhe ne bëjmë të njëjtën gjë. Më e rëndësishmja, është se na mëson se si të jemi më tepër të ndjeshëm me ndjenjat dhe emocionet e të tjerëve*⁹. Nuk është çudi që mjafton një gjest, një lëvizje koke apo një buzëqeshje për ta ndryshuar rrjedhën e komunikimit përdorues- specialist. Kush e njeh gjuhën e trupit jo vetëm di ta përdorë mirë atë, por edhe bën interpretimet e rastit.

Gjestet: *Përdorimi i duarve tërheq vëmendjen, rrit fuqinë e komunikimit dhe ndihmon njeriun të mbaj mend më shumë informacion.*¹⁰ Në komunikimin joverbal specialist-përdorues, përdoren gjeste të ndryshme psh:

- Vendosja e gishtit tregues para buzëve kur kërkojmë të respektohet qetësia në bibliotekë.
- Ngritja lart e gishtit tregues, për t'i bërë të qartë përdoruesit se duhet të presë pak.
- Ngritja e dorës lart nga përdoruesi në sallën e leximit, kur i ka mbaruar materialet dhe kërkon të tjera.
- Lëvizja e kokës në pozicionet lart - poshtë dhe majtas djathtas, për shenjat e mohimit dhe pohimit etj.

Këto gjeste dhe shenja, në vende dhe kultura të ndryshme kanë interpretime të ndryshme, ndaj duhet të jemi të kujdesshëm në përdorimin e tyre. Gjestet e mësipërme, mund t'i përdorim në komunikimin joverbal, por duhet pasur parasysh që: *njerëzit bashkëkohës, nuk arrijnë aq lehtë sa parardhësit e tyre të lexojnë valët që rrezaton gjuha e trupit, sepse vëmendjen e tyre e komandon gjuha e folur.*¹¹

⁸ Të gjitha këto të dhëna personale si: nr. tel, e-mail, adresë postare janë në kartelën personale të përdoruesit me të cilën ai pajiset kur bëhet anëtar i bibliotekës.

⁹ A.& B. Pease, *Gjuha e trupit*, Liloprinting, 2014, f. 55

¹⁰ Po aty, f. 174

¹¹ Po aty, f. 54

2. Komunikimi para-verbal. *Kjo formë komunikimi vibet në pah përmes tonit të zërit, intensitetit, kohës (që përfshin shpejtësinë e të folurit, kohëzgjatjen, pushimet, etj. Përveç këtyre mund të futen këtu edhe fenomene të ndryshëm me karakteristika të tjera tingëllore ose vokale si e qeshura, hapja e gojës, mërmëritja, e qara, shfryrja, psherëtima, frymëmarrja e thellë, etj.¹²*

Në saj të komunikimit para-verbal, arrijmë të kuptojmë nëse përdoruesi është apo jo i kënaqur nga shërbimi i materialeve të kërkuara. Një shembull konkret: përdoruesi vjen në bibliotekë dhe përqëndrohet para vitrinës së librave të rinj. Reagimet e tij mund të jenë të ndryshme: mund të psherëtijë pasi titujt e rinj janë të paktë, nuk janë ato që ai ka pritur të jenë, ose mungon pjesa e një triologjie. Por, ai mund të marrë frymë thellë, ose mund të mërmërijë i kënaqur kur ka materialin që i nevojitet. Komunikimi para-verbal luan një rol të rëndësishëm pasi është një hap paraprak në komunikimin verbal ose joverbal që do të vendoset më pas midis specialistit dhe përdoruesit.

Empati ose me fjalë të tjera, aftësi për t'u futur në botën e tjetrit dhe për të ndier çfarë ndien ai. Nga një vëzhgim i bërë personalisht, një ndër fjalët e para me të cilën nis komunikimi, është përemri vector *unë*. unë kërkoj, unë kam nevojë, unë do të dëshiroja. Pra përdoruesi e ka bërë një hap drejt komunikimit dhe jep sinjale për një lidhje empatike. Nga një vëzhgues i mirë fjalët e tij do të interpretoheshin:- më kupto! Kërko me mua për atë që unë kam nevojë. Lidhja empatike me përdoruesin shprehet me gjuhën verbale dhe joverbale. Shprehjet si: ju kuptoj, e di se çfarë kërkon, e vlerësoj rëndësinë e studimit tuaj, do ta bënin përdoruesin të ndihej mirë. Apo, një buzëqeshje... Një buzëqeshje vlen sa njëmijë fjalë.

Prosemika dhe komunikimi: *Termi është ideuar dhe përdorur në 1963 nga antropologu amerikan Edwart T. Hall për të treguar studimin e marrëdhënieve të afërsisë hapësinore në komunikim. Është një tjetër kanal komunikimit jo-verbal që merret me studimin e sjelljeve hapësinore duke u nisur nga idea që njeriu, sikurse dhe kafsha, ka dhe mbron territorin e tij. Sipas tij njeriu ka një "zgjerim" personal që shtrihet në hapësirën rrethuese, përmasat e të cilës varen nga dendësia e popullsisë, nga kultura ose tradita e vendit, por edhe nga gjinia¹³. Psh. nga përvoja personale në marrëdhëniet me publikun, ne shqiptarët e respektojmë fare pak idenë e sipërpërmendur, pasi jo pak herë na mungon distanca në komunikim duke depërtuar në të ashtëquajturin territor i bashkëbiseduesit.*

¹² E. Buharaja, *Semiotika, Acustica*, 2012, Leksione, f. 99

¹³ E. Buharaja, *Semiotika, Acustica*, 2012, f. 92

2. Forma verbale e komunikimit në bibliotekë

Pritja dhe orientimi i publikut, pika e informacionit refererues dhe huazimi i materialit në institucionin tonë bëhen nga një specialist i cili është edhe kontakti i parë që ka përdoruesi me bibliotekën, ose çelësi hapës i gjithë informacioneve dhe materialeve që përmban biblioteka. Komunikimi përdorues- specialist nis si një komunikim verbal, për të ndryshuar më pas në përshtatje me situatat dhe llojet e përdoruesve. Përdoruesit në bibliotekë: i huazohen materiale, konsultohet me burimet referuese, tradicionale dhe elektronike, fotokopjim dhe printim si edhe veprimtari kulturore.

Komunikimi verbal specialist-përdorues ka në bazë të tij dialogun: nga njëra anë është përdoruesi, nga ana tjetër është specialisti që duhet të interpretojë mesazhin. *Atributet sociologjike më të rëndësishme të pjesëmarrësve në ligjërime që kushtëzojnë të drejtat, detyrat dhe privilegjet janë: seksi, mosha, profesioni, gjësbastur edhe karakteristikat shoqërore si familjariteti, respekti etj.*¹⁴ Përdorueset në bibliotekë mund të jenë gra ose burra. Nga statistikat, numri i përdoruesve gra është më i lartë. Ato kanë librat e tyre të parapëlqyer prej të cilave përmendim historitë romantike të dashurisë dhe biografite apo autobiografite e personaliteteve të shquar etj. Ato jo vetëm që dominojnë ndaj përdoruesve burra, por gjuha e tyre ka edhe karakteristika që e dallojnë prej tyre.

Le t'i shohim konkretisht këto dallime:

Dallimet në gjuhë dhe të folur	Përdorueset gra	Përdoruesit burra
Sasia e të folurit	Flasin më shumë dhe sjellin copëza nga jeta familjare.	Flasin më pak dhe shpeshherë, janë të heshtur.
Detajat në të folur	Janë më detaiste. Ato shpesh herë komentojnë atë çfarë kanë lexuar dhe kanë një gjuhë plot ngjyra.	Komentojnë rrallë për atë çfarë lexojnë.
Përshtatja me normën	Përshtaten më mirë me normën letrare dhe përpiqen të përqafojnë risitë e momentit	Paraqiten më të ngurtë dhe rrallë herë <i>ndryshojnë</i> pozitat e tyre natyrore të gjuhës.

¹⁴ Gj. Shkurtaj, *Sociolinguistika*, Toena, 2005, f.129

Fjalët “e ndaluara”	Ka shumë fjalë të cilat gratë nuk mund t’i përdorin në publik: si fjalë që përdoren rëndom në zhargone apo sharje të ndryshme.	Burrat shfaqin një tendencë për t’i përdorur duke shfaqur edhe raste ekstreme apo problematike
Fjalë karakteristike	Përdorin shpesh herë fjalë si: <i>e dashur, motër, moj xhan</i> , apo prapashtesa zvogëlimi që japin më shumë afrimitet.	Nga ky rast, burrat pothuajse janë të përjashtuar.

Sigurisht që edhe brenda ndasive të mëdha gra/ burra, ka edhe ndarje të tjera që krijohen në përshtatje me moshën dhe profesionin. Psh. gjuha që përdor një nxënëse vajzë, nuk është e njëjtë me gjuhën që përdor një studente. Ose gjuha që përdor një grua intelektuale me një pozicion të caktuar shoqëror dhe profesional, me atë të një gruaje shtëpiake.

Përdoruesit e vegjël dhe fëmijët e moshës 6-14 vjeç, për të cilët, Bibliotekat Publike kanë një sektor të veçantë. Fëmijët e sotëm, do të jenë të rriturit e së ardhmes ndaj specialisti në këtë sektor të bibliotekës duhet të ketë aftësi të veçanta komunikimi duke përzgjedhur një gjuhë të përshtatshme për këtë moshë përdoruesi. Fëmijët më shumë se kushdo tjetër, janë përdorues që reagojnë me shprehi dhe gjeste duke bërë të qartë se si është kuptuar mesazhi. Ka një ndryshim rrënjësor midis përdoruesit të rritur dhe atij fëmijë. Përdoruesi i rritur, është i bindur në vërtetësinë e pohimit: të lexosh, është e rëndësishme. Një bindje kjo e bazuar në eksperiencën personale, ndaj edhe e frekuentojnë bibliotekën, ndërsa përdoruesi fëmijë duhet të *niset* vetë drejt kësaj të vërtete. Osho thotë: - *Nuk i dubet mësuar fëmijës e vërteta, por i dubet mësuar që ai ta kërkojë vetë atë. Dubet mësuar të kërkojë, dubet mësuar synimi i bulumtimit.*¹⁵

Gjuha e përdoruesve fëmijë. Jo të gjithë fëmijët iu drejtohen bibliotekës sapo mbarojnë abetaren, por ata që e kanë me pasion leximin, fillojnë e kërkojnë librat e parë. Ky lloj përdoruesi është ende *pre* e ambientit gjuhësor në të cilin është rritur. Këto ambiente janë të ndryshme: ai mund të jetë rritur nga gjyshi dhe gjyshja, nga prindër të shkolluar që punojnë, apo nga një nënë shtëpiake që u ka thënë lamtumirë librave me mbylljen e ciklit shkollor etj. Fëmijët në këtë rast, janë një pasqyrë e gjallë e mjedisit gjuhësor nga i cili ata vijnë. Specialisti i bibliotekës, sigurisht që nuk mund të bëjë punën e prindërve në edukimin gjuhësor të fëmijëve, por në ato momente komunikimi që ai ka me ta, duhet të japë shembullin personal duke përdorur një gjuhë letrare dhe forma korrekte.

¹⁵ Osho, *Osho mbi fëmijët*, “Fan Noli”, Tiranë 2013, f. 63

Përdoruesi mund të jetë i kategorive të ndryshme: nxënës, student, intelektual apo ndryshëm. Ndarjet e mësipërme kanë efektet e tyre në komunikimin verbal, për të thjeshtin fakt që secili prej tyre komunikon duke përdorur një gjuhë të tijën. Përshtatja në komunikim, lidhet drejtpërdrejt me zgjedhjen e regjistrit përkatës. Tipat e përdoruesve janë të ndryshëm ndaj specialistit i takon detyra e vështirë e të qenit përdorues i zoti i regjistave të thjeshtë, atyre të zakonshëm dhe regjistrave librorë në situata dhe rrethana të veçanta.

Përdoruesit nxënës: Përdoruesit e fashës moshore 15-18 vjeç jo pak herë mes tyre, por edhe me të tjerët përdorin fraza, fjalë apo shkurtime fjalësh që konsiderohen nga vetë ata si trende të momentit. Përshtatja e plotë e specialistit me përdoruesin në këtë rast nuk mund të arrihet, por ajo e pjesshme, mund të pretendohet. Mospërshtatja, do ta hermetizonte këtë tip përdoruesi dhe do ta largonte atë nga biblioteka ku ai është ofruar për të gjetur informacion, ndërsa përpjekja për të gjetur një lloj gjuhe sadopak të përafërt, do ta tërhiqte më shumë atë. Karakteristikë për këtë tip përdoruesi janë përshtatjet e huazuara nga anglishtja dhe italishtja ku më popullorët janë hi!, ciao!, terma në anglisht nga fusha e elektronikës si folder, save, insert etj. Gjithashtu kërkimi i titujve të librave në versionin origjinal dhe jo në atë tëshqipërimet. Janë të parët që kërkojnë letërsi që ende nuk është shqipëruar, pasi duke patur fatin e njohjes së gjuhëve të huaja i lexojnë ato në gjuhën origjinale. **Gjuha** e përdorur nga bibliotekari në këtë rast duhet të jetë e thjeshtë, jo bombastike dhe e ngarkuar me terma të fushës, të cilat ky lloj përdoruesi nuk është i detyruar t'i njohë.

Përdoruesit studentë: Përdoruesi student, paraqitet më i formuar dhe ka një kompetencë komunikative më të lartë se ai nxënës. Ai është i prirur drejt hulumtimit për gjetjen e informacionit që kërkon dhe është tashmë i familjarizuar me mjetet e kërkimit të tij. Studentët janë edhe ndër përdoruesit më frekuent të bibliotekës, pasi ata jo vetëm kërkojnë informacion, por përdorin edhe sallën e leximit për studime apo konsultime të fondit të referencave (fjalorët, enciklopeditë etj.) *Studentët që studiojnë jashtë Shqipërisë:* Mendoj se përbëjnë një nëndarje më vete brenda ndarjes së madhe të kategorisë studentë. Studentët që studiojnë në universitetet jashtë territorit shqiptar kanë karakteristika të veçanta në komunikimin e tyre psh: përdorin dhe njohin skedarin manual dhe elektronik, janë më kërkues dhe eksplorues të zotë. Karakteristikë e gjuhës së tyre janë edhe mjaft shprehje të cilat i përkasin gjuhëve që ato flasin e studiojnë si anglisht, italisht etj. Përmend këtu shprehjet: mund të kem akses në internet, apo, më jep një dorë për të gjetur një informacion (it.dami una mano), e shumë të tjera.

Përdoruesi i kualifikuar (intelektualët): jo vetëm ka të qartë informacionin që i nevojitet, por di ta kërkojë atë me të gjitha mënyrat (skedarin manual dhe atë

elektronik). Ky lloj përdoruesi aq sa komod është në komunikim, aq edhe kërkues, pasi kërkon informacione specifike të cilat i përdor për qëllime studimore. Ai ka një kompetencë komunikative shumë të lartë, shprehi të shumta e të larmishme gjuhësore dhe është në gjendje të komunikojë me natyrshmëri. Di gjuhë të huaja dhe më shumë se një varietet të gjuhës kombëtare.¹⁶ Ky lloj përdoruesi në ligjërimin e tij sjell me vete edhe shumë fjalë që i huazon nga gjuhët që ai përdor psh: anglofon= anglishtfolës; frankofon= frëngjishtfolës; literaturë= letërsi; aktivitet=veprimtari; eksperiencë= përvojë; ekspresiv= shprehës; firmos= nënshkruaj; kurioz= kureshtar¹⁷ etj. Do të ishte mirë që këto fjalë të huazuara të shkonin drejt zëvendësimit me fjalët e gjuhës shqipe.

Përdoruesi i thjeshtë, që shfleton periodikun apo materiale të ndryshme si romane, tregime të cilat i huazohen në shtëpi. Jo pak herë ky tip përdoruesi kërkon ndihmë dhe sugjerime prej specialistit për ta drejtuar drejt një libri të bukur apo të shumëpëlqyer kohët e fundit. Komunikimi në këtë rast, ndikohet shumë nga familjariteti që mund të ketë me përdoruesin. Theksimi i intimitetit midis bashkëbiseduesve shfaqet edhe në shmangien nga kultura letrare dhe përdorimin e shprehjeve të thëna me përkëdheli.¹⁸psh: *Sa e fortë je! Je e madhe! Ç’je një ti!* **Gjuha** është më e shpenguar, më e thjeshtë dhe jo pak herë specialisti “gëlltit” edhe përdorimin e fjalëve të zhargonit të cilat, ky lloj përdoruesi i sjell me vete duke pasqyruar qartë klasën shoqërore të cilës i përket.

Karakteristikë në gjuhën që përdor ky lloj përdoruesi vihen re forma foljore të gabuara psh. thotë:

<i>Forma e gabuar në të folurin e zakonshëm</i>	<i>Forma e rregullt në ligjërimin zyrtar</i>
Ky artikull <i>qe</i> në gazetën e djeshme	Ky artikull <i>ishte</i> në gazetën e djeshme
Duam emrat e atyre që i kapi amnistia	Duam listën emërore të personave që përfituan nga amnistia
<i>Punoka</i> biblioteka të shtunën?(forma e gabuar e habitores)	<i>Punuaka</i> biblioteka të shtunën?
Si i bëhet me marr libra?	Si mund të anëtarësohem në bibliotekë?
Kanë dalë notat e provimeve të maturës?	Janë publikuar rezultatet e provimeve të maturës?

¹⁶ Shkurtaç, Gjovalin, *Sociolinguistika*, 2005, f. 127.

¹⁷ Shkurtaç, Gjovalin, *Si të shkruajmë shqip* (tregues i fjalëve të huaja që mund të zëvendësohen plotësisht ose pjesërisht), Toena, Tiranë, 2008, f. 253

¹⁸ Lloshi, Xhevat, *Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika*, SHBLU, Tiranë, 2001, f. 174

Komunikiminë bibliotekë dhe dukuria e migrimit. Migrimi ka bërë që të ardhurit nga zona të ndryshme, të sjellin me vete edhe të folurat krahinore të prejardhjes së tyre. Komunikimi përdorues- specialist në këtë rast ka vështirësitë e veta. *Bershtajni, duke u mbështetur në një metër të caktuar, vlerësues, normativ, i interpreton karakteristikat që e dallojnë sjelljen gjuhësore të shtresës së ulët nga ajo e shtresës së mesme e të lartë, si dukuri të mungesës, ose deficitit.*¹⁹ Specialisti që presupozohet të jetë një njohës i mirë jo vetëm i gjuhës standarte por edhe i dialekteve, në këtë rast merr rolin drejtues në komunikim. Ai i drejtohet përdoruesit duke përdorur gjuhën standarte, duke qenë i gatshëm të përballojë **deficitin gjuhësor** që mund të shfaqet tek bashkëbiseduesi. **Gjuha** që kjo lloj shtrese përdor, shpesh herë bëhet shkak për një komunikim jo shumë të suksesshëm. Specialisti duhet të jetë i kujdesshëm në këto raste, pasi pavarësisht shtresës që përfaqëson, apo gjuhës që përdor, ai ka të drejtën për t'u informuar dhe për të përdorur materialet bibliotekare. Regjistrat e thjeshtë në këto raste, janë më të përshtatshmit.

Një tip i veçantë përdoruesi është ai me të meta fizike si: të paralizuarit që lëvizin me karroca, të verbrit (për të cilët duhet të ketë edhe salla braille të veçanta dhe informacione si libra me alfabet brail, kasete- libër), përdoruesi i shurdhër i cili përdor gjuhën e shenjave. Chomsky thekson: *Duhet pasur kujdes me problemin e njerëzve të shurdhër. Nëse njerëzit e shurdhër kanë zhvilluar gjuhën e shenjave, atëherë ata nuk kanë aspak të meta intelektuale.*²⁰ Në këtë pikë të diskutimit mund të lind legjitime pyetja: - a mos vallë po kërkohet shumë prej specialistëve që shërbejnë informacionin? Mendoj që duhet bërë e pamundura për t'i ofruar komunitetit atë që i nevojitet, pse jo edhe t'i përgjigjemi gjuhës së shenjave. Të jesh i nevojshëm për një përdorues që ka shumë për të thënë, por nuk mundet, është së pari një detyrë, së dyti një kënaqësi.

Toni i zërit në komunikimin verbal: Një kujdes të veçantë në komunikimin specialist- përdorues i duhet kushtuar edhe tonit të zërit. Ai duhet të jetë i qetë dhe bisedat me zë të lartë duhen shmangur. Specialisti duhet të jetë kërkues ndaj vetes, por edhe ndaj përdoruesit. Duhet të kemi parasysh faktin që përdoruesi vjen nga një ambient i hapur, jashtë institucionit dhe mund të ketë edhe një gjendje emocionale disi euforike. I takon specialistit që të bëjë hapin e parë duke përshëndetur me një ton të moderuar, i cili do ta ftojë përdoruesin t'i përshtatet pa vështirësi.

Mos harro asnjëherë të dëgjosh! Shpesh herë nën ndikimin e situatave të ndryshme mund të jemi euforikë, të trishtuar apo paksa të nxituar në dhënien e përgjigjeve në bashkëbisedim me përdoruesin. Nëse jemi të kujdesshëm dhe lejojmë përdoruesin të shprehet pa e ndërprerë, i krijojmë mundësi që ai të shprehet lirshëm

¹⁹ Po aty, f.16

²⁰ N. Chomsky, *Gjuha dhe problemet e njohjes*, Toena, 2007, f. 196

dhe qartë. *Të dëgjuarit dhe të folurit janë shumë të rëndësishëm sepse, në përgjithësi komunikimi i dobët është një nga arsyet kryesore të prishjes së kësaj marrëdhënieje.*²¹ Specialisti i bibliotekës, si rezultat i përvojës së dëgjimit dhe të folurit me shumë njerëz, është tashmë i stërvitur dhe sintonohet lehtësisht me gjëndjen shoqërore dhe shpirtërore të përdoruesit që ka përballë tij.

Heshtja është një lloj komunikimi. Efektet pozitive janë tek të dy palët: përdoruesi shpreh qartë mesazhin dhe marrësi (specialisti) e merr dhe interpreton saktë atë. Hapësirat kohore në bashkëbisedim duhet të jenë të moderuara, pasi nëse heshtim më shumë seç duhet, mundet që këto hapësira kohore të kthehen në “**humnera**” të pakapërcyeshme të cilat e humbasin efikasitetin e komunikimit. Bashkëbiseduesi demoralizohet duke iu larguar gjithmonë e më shumë informacionit që kërkon.

Veprimtaritë kulturore janë një aspekt tjetër i komunikimit verbal. Qëllimi i organizimit të këtyre veprimtarive është përcjellja e vlerave tek përdoruesi. Këto veprimtari janë nga më të ndryshmet: përrurime librash, pasdite letrare-artistike, takime me shkrimtarë etj. Në këtë lloj komunikimi, specialistët moderatorë janë protagonistë, por në situata të caktuara edhe vetë përdoruesit bëhen protagonistë me diskutimet, kritikën dhe pyetjet drejtuar autorëve. Gjuha e përdorur në këto raste është e tejmbushur me terminologji ndaj jo pak herë komunikimi verbal nuk ka efikasitetin e duhur. Përzgjedhja e kujdesshme e publikut në këto raste do të ishte zgjidhja e vetme.

Si përfundim: jemi të ndryshëm nga njëri- tjetri, kemi gjuhën dhe mënyrën individuale të folurit, por nuk shkojmë asgjëkund nëse nuk komunikojmë sepse *komunikimi është fenomen bazik i qenësisë, madje pa të nuk do të kishte qenësi, e kjo sepse të gjithë janë të ndërruar nga të gjithë, ndërrarje kjo që ka të bëjë me mbijetesën e çdo qenieje, pra me vetë ekzistencën. Kështu që mund të themi që gjithshka është pashmangshmërisht e dënuar të komunikojë nëse do të ekzistojë*²².

Burimet:

- A.& B. Pease, *Gjuha e trupit*, Liloprinting, 2014, f. 55
E. Buharaja, *Semiotika*, Acustica, 2012, f. 92
E. Buharaja, *Semiotika*, Acustica, 2012, Leksione, f. 62
E. Buharaja, *Semiotika*, Acustica, 2012, Leksione, f. 86
E. Buharaja, *Semiotika*, Acustica, 2012, Leksione, f. 99
Gj. Shkurtaj, *Si të shkruesim shqip*, Toena, 2008, f. 179
Gj. Shkurtaj, *Sociolinguistika*, Toena, 2005, f.129

²¹ Th. Theobald, C. Cooper, *Hesht dhe dëgjol*, Max, 2004, f. 171

²² E. Buharaja, *Semiotika*, Acustica, 2012, Leksione, f. 86

- L. Sokoli, *Metodat e kërkimit në shkencat sociale*, IS, 2009, f. 149
- Lloshi, Xhevat, *Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika*, SHBLU, Tiranë, 2001, f. 174
- N. Chomsky, *Gjuba dhe problemet e njohjes*, Toena, 2007, f. 196
- Osho, *Osbo mbi fëmijët*, “Fan Noli”, Tiranë 2013, f. 63
- Rregullat e katalogimit dhe kërkesat funksionale për regjistrimet bibliografike*, Leksione, f. 1
- Shkurtaç, Gjovalin, *Si të shkruajmë shqip* (tregues i fjalëve të huaja që mund të zëvendësohen plotësisht ose pjesërisht), Toena, Tiranë, 2008, f. 253
- Shkurtaç, Gjovalin, *Sociolinguistika*, 2005, f. 127
- T. Marrs, *Kodet magjike*, Bota shqiptare, 2009, f. 20
- Th. Theobald, C. Cooper, *Hesht dhe dëgjol*, Max, 2004, f. 171

Haxhi SHABANI

DOMENET PUBLIKE TË SHQIPES NË MALIN E ZI

Përdorimet publike të shqipes në këtë kumtesë vështrohen përmes analizës së dygjuhësisë në të cilën ajo përshtat rolin e saj në varësi të faktorëve të ndryshëm.

Ka dy situata kryesore të përdorimit të gjuhëve ndër shqiptarët në Malin e Zi: situata e komunikimit privat përmes gjuhëve dhe ajo e komunikimit publik, të cilët karakterizohen me përdorime të ndryshme të gjuhëve, që nga përdorimi i gjuhës bazë, i njërës më pak e tjetrës më shumë, i të dyjave së bashku, i ndryshimit të gjuhës bazë dhe i humbjes së gjuhës së parë. Të gjitha këto përdorime kanë nuancat e veta të cilat manifestohen përmes folësve të kushtëzuar nga faktorë të ndryshëm siç janë: vendi, koha, lloji i mesazhit, fusha e komunikimit etj.

Përdorimi i i gjuhës (ve) si rezultat i ndikimit publik

Përdorimi në ambientet joformale jashtë shtëpisë, në krahasim me përdorimet brenda familjes është më shumë heterogjen dhe nëse edhe në këto ambiente joformale si në rrugë, në treg, në shitore, në mjedise të tjera gjysmëformale shqipja ruan epërsinë e saj, por gjuha malazeze qysh në këtë nivel fillon të jetë konkurente serioze, duke njohur shumicën e fazave që nga niveli i huazimeve, togfjalëshave, deri te sintagma e më gjerë, te ndryshimi i kodit.


Si në rastin e parë: në ambientet e shtëpisë dhe në ambientet joformale nuk ka ndonjë ndryshim për të vërjetur nëpër trevat përkatëse të shqipfolësve në Malin e Zi.

Për ta konkretizuar sasinë, vendin dhe kohën e përdorimit të shqipes në Malin e Zi përfshirë këtu edhe domenet publike të saj janë zhvilluar anketime në terren. Në një nga anketatat gjithsej janë anketuar 337 shqipfolës nga të cilët në qytetin e Ulqinit: 101 ose 29.97%, në Malësi: 93 ose 27.59%, në Anë të Malit 56 ose 16.61%, në Krajë 30 ose 8.90%, në Plavë e Guci 16 ose 4.74%, në Rozhajë 17 ose 5.04% dhe në Tivar 6 ose 1,78%.


Shqiptarët e anketuar në Malin e Zi në familjen e tyre përdorin gjuhën shqipe në masën 91%, malazesishten 2%, të dyja gjuhët 5% dhe rreth 2% tjetër. Këto janë rezultatet e përgjigjes në pyetjen se cila gjuhë flitet në familjen tënde. Kjo tregon se shqipja është shumë dominuese në mjediset familjare, por edhe faktin se të dyja

gjuhët: shqipja e malazezishtja janë prezente brenda familjes, pasi që edhe ata që janë përgjigjur me tjetër të lënë të kuptosh se e kanë fjalën për përdorimin e gjuhës malazeze, por për shkaqe të ndryshme nuk dëshirojnë ta pohojnë një gjë të këtillë. Thënë me gjuhën e shifrave 9% të të anketuarve edhe brenda komunikimit gjuhësor në familje përdorin gjuhën malazeze të vetme apo së bashku me shqipen.

Cilën gjuhë e flet më tepër:



Përqindja e përdorimit të gjuhës shqipes zvogëlohet jashtë shtëpisë nga 91% brenda saj, në 73% jashtë saj. Ky është rezultati kryesor i përgjigjes në pyetjen se cila gjuhë flitet më shumë jashtë shtëpisë. Duke parë edhe rezultatet e tjera të kësaj përgjigje: 8% përdorin gjuhën MSBK, 16 % të dyja, 2% - tjetër dhe pa përgjigje -1%, arrihet përfundimi se folësit që gjuhën bazë kanë shqipen, në rreth 30% të rasteve në mjediset jashtë shtëpisë, do të thotë në ato publike, përdorin gjuhën malazeze apo këtë gjuhë dhe atë shqipe.




Edhe përgjigjet në pyetjen tjetër se nëse i flet të dyja jashtë shtëpisë cilën gjuhë e flet më tepër, dëshmojnë logjikën në përgjigjet e pyetjes paraprake: 87%- shqipen, 11%-malazezishten dhe pa përgjigje-2%.

Përdorimi dytësor i shqipes me shkrim dhe përdorimi publik në variantin e folur

Përdorimi fragmentar i dygjuhësisë është situata më e dukshme kur kemi të bëjmë me përdorimin e dygjuhësisë, pasi vetëm në raste të pakta kemi përdorimin e dygjuhësisë të barabartë në aspektin kohor, në të cilën do t'i kushtohet kohë dhe vend i barabartë njërës dhe tjetrës gjuhë. P.sh. në një dokument të zakonshëm me shkrim të komunës së Ulqinit në shumicën e rasteve gjuha shqipe gjendet krahas gjuhës malazeze, (kjo e dyta ka pozitën e parë) vetëm në pjesën që ka të bëjë me të dhënat e përgjithshme sipas këtij modeli: *Opstina Ulcinj, Komuna e Ulqinit, Sekretarijat za Ekonomiju, Sekretariati për Ekonomi*, por pjesa tjetër që ka të bëjë me një vendim apo rregullore, ta zëmë, është vetëm në gjuhën malazeze. Të këtilla modele mund të gjenden në komunën urbane të Tuzit, në ndonjë rast edhe të Plavës, por edhe në komunën e Tivarit apo Rozhajës. Në shumicën e tubimeve publike, në të cilat publiku është shqiptar dhe që flitet në shqip, por kur folësi i referohet thënies së një folësi malazez, apo kur i parafrazon fjalët e tij, sikurse edhe në rastet kur citon një ligj, rregullore apo diçka tjetër që ka të bëjë me institucionet shtetërore, mendimet e këtilla i thotë në gjuhën malazeze, pa i parafrazuar në shqip sepse konsiderohet se receptuesit i kuptojnë pa asnjë problem. Në rastin tjetër, kur vetëm nëse një nga të pranishmit është folës i gjuhës MSBK, me përjashtime të rralla, komunikimi bëhet në gjuhën në gjuhën e përmendur.

Në pyetjen për përdorimin e gjuhës në vendin e punës, 83% e të anketuarve përdorin gjuhën shqipe, 9% gjuhën malazeze, 5% janë përgjigjur kësaj pyetje tjetër dhe 3% pa përgjigje. Sipas këtyre rezultateve del se gjuha shqipe është gjuhë pune, por kjo ka të bëjë më shumë me gjuhën e folur, kurse kur është fjala për gjuhën e shkruar atëherë raportet ndryshojnë dukshëm sipas vëzhgimit të drejtpërdrejtë në favor të gjuhës malazeze dhe në dëm të gjuhës shqipe.



Sipas sasisë së përdorimit të gjuhës në punë sipas trevave që është domen publik, del se në Ulqin, shqipen gjatë punës, por që ka të bëjë më së shumti me përdorimin me gojë, në bazë të rezultatit të anketës kryesore, e përdorin 94% të folësve, kurse në Tuz - 87%, në Krajë - 83%, ndërsa në Anë të Malit - 80%. Këto rezultate janë tregues se gjuha shqipe në këto dy mjedise realizohet si gjuhën pune. Vijnë sipas përqindjes së përdorimit të shqipes në vendin ku punon (mëson) Tivari me 67%, Rozhaja - 41% dhe Plava me 38%. Në anën tjetër, gjuhën malazeze më së shumti në punë e përdorin subjektet që janë nga Plava - 46%, Tivari - 33%, Rozhaja - 24%, Kraja - 17%, Ana e Malit - 10% etj. Duhet përmendur se subjektet e anketuar në Rozhajë janë përgjigjur me tjetër - 24% dhe ato nga Plava - 15%. Pa përgjigje janë 12% nga Rozhaja që parashikohet se përdorin gjuhën boshnjake.

Renditja e gjuhëve në përdorimet publike me shkrim

Përdorimi: e para gjuha shqipe, e dyta gjuha malazeze ose angleze. Këto gjuhë sipas kësaj renditjeje janë të përdorura në një reklamë, shqipja e para, malazezishtja e dyta. P.sh. një pano e vendosur në rrugën kryesore të qytetit të Ulqinit ka këtë përmbajtje: në shqip: *Banesa për shitje*, në malazezisht: *Prodaja stanova*. Edhe pse gjuha

shqipe është e renditur si e para, ndikimi i malazezishtes është vendimtar, pasi edhe sintagma e përdorur në shqip është ndërtuar sipas modelit të gjuhës së dytë. Në shqip thuhet më natyrshëm: *Shiten banesa*. Ose shembulli tjetër që përfshin po ashtu të njëjtën veprimtari, me një tekst tjetër. Renditja është e njëjtë, sikurse edhe ndikimi i gjuhës malaazeze, po ashtu i dukshëm: shqip: *Banesa luksoze në shitje*. Kurse në anglisht: *Lux apartments for sale*. Në shqip njoftimi i këtillë në mënyrë më të natyrshme është: *Shiten banesa luksoze*.

Ndikimi i gjuhës malazeze në shqipen duket i qartë edhe në portalin Ul - Info që është në dy gjuhë në shqip dhe në gjuhën malazeze, sikurse edhe në mediet e tjera si TV Teuta i cili po ashtu është dygjuhësor. Modeli i përdorimeve gjuhësore këtu zhvillohet sipas kësaj amze: fillimisht teksti shkruhet në gjuhën malazeze në portalin Ul - Info, pasi përdoruesi është më i aftë ta bëjë në këtë gjuhë, pastaj përkthehet në shqip, por në të shumtën e rasteve bëhet ruajtja e modelit të gjuhës bazë, të paktën në kuptimet leksikore të fjalëve të gjuhës së përmendur, deri në përdorimet e sintagmave. Kurse në TV Teuta edhe pse shumica e programit është në gjuhën shqipe dhe autorët e emisioneve në këtë medie shkruajnë në shqip, ndikimi i gjuhës malazeze është i dukshëm. P.sh. një nga gazetare i shtron pyetjen e këtillë një bashkëbiseduesi: *Çka është në pyetje?* në vend të: *Për çka është fjala?*

Në shumicën e rasteve, kjo thujse është praktikë, në dokumentet me shkrim të institucioneve në nivel të komunës së Ulqinit dhe të komunës urbane të Tuzit e ndonjëherë në komunën e Plavës, por jo në atë të Tivarit dhe Rozhajës, respektohet dygjuhësia vetëm në të dhënat e përgjithshme në fillim të dokumenteve. Modeli është i këtillë: në fillim gjuha malazeze dhe pastaj gjuha shqipe.

Crna Gora/Mali i Zi

OPSTINA ULCINJ-KOMUNA E ULQINIT

Sekretarijat za privrednu i ekonomski razvoj

Sekretariati për ekonomi

Up. I. Broj-Nr: 08-412/14

Ulcinj-Ulqin, 11.07. 2014. godine, vit

Dhe teksti në vazhdim i dokumentit është vetëm në gjuhën malazeze, përjashto dygjuhësinë e cila respektohet te vendi i nënshkrimit të sekretarit përkatës: *V. D. / U. D. SEKRETAR* dhe nënshkrimi i kuadrit përkatës. Por, ka edhe modele të tjera, i tërë teksti është në dy gjuhë fillimisht në gjuhën malazeze e pastaj në gjuhën shqipe, përkatësisht një rend në gjuhën malazeze dhe rendi tjetër nën të, në gjuhën shqipe si p.sh.:

Sekretariatat za finansije i budzet Opstine Ulcinj postupajuci po zahtjevu Sekretariati per financa dhe buxhet i Komunes se Ulqinit me kerkes¹ te iz Ulcinja na osnovu cl. 165 ZUP-a ("Sl. list RCG" br. 60/03) izdaje: nga Ulqini në bazë të nenit 165 LPA-së ("Gaz. Zyr. E RMZ" nr.60/03 lëshon

UVJERENJE - ÇERTIFIKATË

....

Për të parë këtë dukuri është zhvilluar anketa: **në cilën gjuhë shqipfolësit flasin e shkruajnë më lehtë?**

Në pyetjen e parë të kësaj ankete: në cilën gjuhë e ke më lehtë të flasësh, janë përgjigjur se e kanë më lehtë në shqip - 13 të anketuar, kurse varësisht nga rasti - 2. Ky rezultat dëshmon se shqipja është mbizotëruese në varinatin e folur. Në pyetjen tjetër: në cilën gjuhën e ke më lehtë të shkruash, mbizotërimi i gjuhës shqipe edhe këtu është i dukshëm. Janë përgjigjur se në gjuhën shqipe e kanë më lehtë të shkruajnë - 12 të anketuar, njësoj - 2 dhe malazezisht - 1. Kurse në pyetjen se sa vjeç e ke mësuar gjuhën malazeze, përgjigjet janë heterogjene nga 7 - 20 vjeç, por ka edhe të atillë që përgjigjen: qysh jam bërë i vetëdijshëm (në orgjinal thonë: *qysh se di për vedit*), që është një ndërtim i gjuhën malazeze: *od kad znam za sebe*. Pyetjes së katërt se në cilën gjuhë e ke (je) duke e kryer shkollën janë përgjigjur: në shqip - 14, kurse në malazezisht - 1. Në pyetjen nëse e ke kryer në gjuhën malazeze shkollën, po t'ja fillosh edhe njëherë a do ta kryeje në të njëjtën gjuhë, i anketuari që është përgjigjur se e ka kryer shkollën në malazezisht ka pohur se përsëri do ta kryente në këtë gjuhë sepse është më lehtë të gjesh punë. Dhe në pyetjen e fundit të kësaj ankete, në cilën gjuhë dëgjon më shumë muzikë kemi këto përgjigje: shqip - 10 persona, malazezisht - 2, anglisht - 3 (njëri nga këta të fundit, pohon arsyen, sipas tij, sepse këngët në këtë gjuhë janë më të bukura).

Përdorimi: lingua franca - malazezishtja e anglishtja

Gjatë përdorimit të gjuhëve me shkrim shqipfolësit në shumicën e rasteve kur dëshirojnë t'u shmangen përdorimit të shqipes dhe malazezishtes, sidomos kur përdorimi i gjuhës është minimal si në rastin e reklamave, mbishkrimeve, emrave të ndërmarrjeve apo shitoreve private, zakonisht zgjedhin gjuhën angleze, apo ndonjë gjuhë tjetër: italishten, frëngjishten, të cilat konsiderohen se janë të pranueshme për të gjithë, apo thënë në aspektin e shikimit negativ të gjërave, shqipja është më pak e

¹ Modelet janë marrë në orgjinal ashtu siç i kanë shkruar zyrtarisht nëpunësit në Sekretariatin përkatës, prandaj janë të këtyllë, me gabime gjuhësore.

papëlqyeshme se gjuhët e tjera nga palët e ndryshme. Kështu p. sh. emërtimet e lokaleve afariste zgjedhen emërtimet si: **Piano, Venus, Avanti**, apo të shoqatave: **Art Club, New Horizon, Green Home** etj. Kjo ndodh jo vetëm në këtë plan, por të rinjtë shqiptarë gjatë komunikimit të tyre nëpër mes të mediave sociale kur është puna për t'ju shmangur përdorimit të gjuhës amtare, ato zgjedhin gjuhën angleze, kurse ndonjëherë edhe gjuhën malazeze. Por, ndodh që kur është fjala për të zgjedhur një gjuhë, atëherë shqipfolësit në komunikimin institucional me shkrim, të zgjedhin gjuhën malazeze. P. sh. në një shkresë të datës 8 korrik 2014, Sekretariati i administratës dhe veprimtarvie shoqërore u drejtohet të gjitha sekretariateve dhe shërbimeve të komunës së Ulqinit në gjuhën malazeze.

Ja një pjesë e cituar e saj: “Na osnovu clana 87. Zakona o drzavnin sluzbenicima i namjesticima (“Sl. list CG”, br. 39/11, 50/11 i 66/12) i clana 6. Pravilnika o kriterijumima i nacinu sacinjavanja lista clanova Disciplinske komisije za 2014. godinu i to... Në vazhdim jepen emrat përkatës, kurse sekretari është shqiptar.

Në anën tjetër kur është fjala për folësit e gjuhës MSBK, ata zakonisht komunikojnë në këtë gjuhë, edhe në mjediset ku shqiptarët janë shumicë në Malin e Zi. Të gjitha përdorimet me shkrim, përjashtojnë ndonjë dokument të Ministrisë së Pakicave dhe Qendrës për ruajtjen e kulturës së pakicave, janë në gjuhën e përmendur. Si rrjedhim, lingua franca e tyre në mjediset me shumicë shqiptare është malazezishtja, edhe pse në ndonjë rast këtë rol e luan gjuha angleze.

Shqipja në shuarje e sipër

Gjuha shqipe në nivel të shqiptarëve në Malin e Zi, apo më mirë të themi të ish-shqiptarëve funksionon edhe si gjuhë e cila është në fazën e gjuhës në vdekje e sipër. Shqipja realizohet në shkallën e gjuhës moribonde (në shuarje e sipër) te boshnjakët dhe myslimanët në zonat e qytetit të Plavës, Tivarit, Gucisë dhe Rozhajës, të cilët janë me origjinë shqiptare. Kjo popullatë gjatë disa dhjetëvjetshave, më së shumti gjatë njëqind vjetëve të fundit, në kohën e përpjekjeve për t'u përshtatur rrethanave të reja, në kuadër të juridiksionit të Malit të Zi, përkatësisht ish-Jugosllavisë ka arritur një drejtpeshim: ka humbur gjuhën e parë (shqipen), por ka ruajtur fenë (islame), duke pranuar gjuhën e shumicës, gjuhën MSBK, për të hequr dorë nga gjuha e parë. Brenda kësaj kategorie të folësve, të cilët gjenden në pjesët urbane të qyteteve Tivar, Guci, Plavë e Rozhajë, aty-këtu mund të gjenden folës të funtmë të shqipes, kurse pjesa dërmuese shqipen e kanë më shumë si kujtesë të cilën dikur e kanë folur të parët e tyre, apo të shumtën marrin vesh diçka nga kjo gjuhë.

Disa subjekte të intervistuar (shumica nëpunës të Qendrës së Kulturës në

Plavë) pranojnë me krenari se disa nga personalitetet e artit dhe letërsisë, përfshirë këtu edhe poetin e Esad Mekuli apo kompozitorin Rexho Mulliqi, i kanë pasur farefis, mirëpo kur është fjala për përdorimin e gjuhës shqipe, ata pohojnë se nuk mund ta flasin, por thonë se diçka kuptojnë. Këto subjekte, flasin boshnjakisht, por nuk hezitojnë që të përdorin ndonjë fjalë në formë përrshendetjeje në shqip si: *Mirëdita! Ditën e mirë!*

Shkalla e gjuhës shqipe në procesin e shuarjes², manifestohet edhe te një pjesë e subjekteve me origjinë shqiptare që i përkasin fesë katolike të cilët jetojnë në qytetin e Tivarit, e më pak në Ulqin. Kjo shtresë e popullatës së përmendur është me origjinë kombëtare shqiptare, kurse sa i përket orgjinës territoriale janë nga katundet: Brisk, Ljarje e Shestan apo Muriq e nga ndonjë katund tjetër i Krajës. Këto subjekte rregullisht komunikojnë në gjuhën MSBK, kurse në raste të veçanta mund të thonë ndonjë fjalë në shqip. Të kuptuarit e shqipes është në nivel diçka më të madh, në krahasim me boshnjakët e myslimanët e përmendur me origjinë shqiptare nga Plava, Gucia e Rozhaja. Por, gjatë disa vjetëve të fundit, sidomos popullata e cila është me origjinë nga katundet: Shestan, Brisk, Ljarje e Shestan që jetojnë në komunën e Ulqinit, në katundet në afërsi të Ulqinit si në Braticë e Krythë, kanë një prirje për rikthim drejt indentitetit gjuhësor e kombëtar. Ata me formimin e shoqatës *Gjon Buzuku*, revistës *Buzuku* dhe një grupi valleje bëjnë përpjekje për rilidhjen me rrënjët e tyre, ndonëse nuk hasin në përkrahjen e të gjithë kësaj bashkësie, përkundrazi një pjesë e tyre kundërshton këtë vetëdijësim. Këtu kemi të bëjmë sikurse edhe në rastin e arvanitishtes “me bashkëkzistencën e dy tipeve themelore të ideologjisë gjuhësore të folësve të arvanitishtes. Këto tipe janë diskursi kongurent (i pajtueshmërisë) dhe diskursi kontradiktor (kundërthënës)”³.

Si pasojë e këtij kompormisi boshnjakët, myslimanët dhe shtresa e përmendur e popullatës në Tivar e më pak në Ulqin, të përkatësisë fetare katolike, kanë arritur të integrohen më shumë në jetën ekonomike, sociale e politike, në krahasim me shqiptarët që kanë ruajtur indentitetin gjuhësor dhe fetar, por kanë humbur një pjesë të indentitetit (gjuhësor e kombëtar), duke ndikuar në zvogëlimin e drejtpërdrejtë të numrit të shqiptarëve në Malin e Zi.

Për një origjinë më të largët shqiptaro-malazeze, me humbjen e elementit të parë, flasin herëpashere edhe folës të caktuar malazezë që thonë se janë nga fisi i

² Në këtë situatë është edhe arvanitishtja në Greqi. “Avanitishtja është gjuhë në vdekje e sipër, që prej bartësve të saj një kohë të gjatë është përçmuar, por e cila edhe sot vazhdon të përçmohet”, Hans Jürgen Sasse, Arvanitika, Die albanischen Sprachreste in Griechenland, Wiesbaden, 1991, f. VII.

³ Lukas D. Tsitsipis, A Linguistic anthropology of praxis and language shift, Arvanitica (Albanian) and Greek in contact, Oxford, 1998, f. 119.

Piperëve (Piperović), nga ai i Kuçit (Kuč) etj. P. sh. një folës i këtillë, duke pritur për t'u takuar me kryetarin e komunës së Ulqinit, pohonte se rrjedh nga fisi i Kuçit dhe pranonte origjinën shqiptare, por këta folës retrospektivisht kanë humbur gjuhën shqipe, para disa brezave.

Literatura e përdorur:

1. Hamers Josiane and Blanc Michel, *Bilinguality and Bilingualism*, Cambridge University Press, 2000.
2. Ismajli Rexhep, *Gjuhë dhe etni*, Prishtinë, 1991.
3. Ismajli Rexhep, *Etni e modernitet*, Pejë, 1994.
4. Kodrić Snježana, *Jezik i nacionalizam*, Zagreb, 2010.
5. Nuhju Vesel, *Ndikimet ndër-gjuhësore*, Prishtinë, 1990.
6. Pozita e gjuhës shqipe në Malin e Zi në krahasim me atë në përgjithësi, Ulqin, 2010.
7. Sasse Hans Jürgen, *Arvanitika, Die albanischen Sprachreste in Griechenland*, Wiesbaden, 1991.
8. Suzanne Romaine, *Language in society*, New York, 2000.
9. Shabani Haxhi, *Rrezikimi i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2007.
10. Tsitsipis Lukas, *A Linguistic anthropology of praxis and language shift, Arvanitica (Albanian) and Greek in contact*, Oxford, 1998.

Abstrakt

Në këtë kumtesë trajtohen përdorimet kryesore publike të shqipes nëpër trevat kryesore të shqipfolësve në Malin e Zi. Paraqiten variantet e përdorimeve publike por edhe të tjera, të cilat si rrjedhim kanë lidhje të drejtpërdrejta me njëra-tjetrën. Gjithashtu vihen në dukje edhe situatat dygjuhësore, përkatësisht rastet kur gjuha shqipe në përdorimin publik është gjuhë e barabartë me gjuhën malazeze si dhe kur kjo e fundit zëvendëson shqipën.

Përdorimet e varianteve të ndryshme të shqipes, me theks në të veçantë në domenet publike të saj janë më stabile dhe më të përhapura në komunën e Ulqinit dhe deri në një shkallë edhe në qytezën e Tuzit. Në komunat: Tivar, Plavë, Guci e Rozhajë përdorimet publike të shqipes janë tepër të kufizuara, herë-herë kemi një dygjuhësi të kufizuar, kurse më shumë shqipja zëvendësohet me gjuhën malazeze nga vetë shqipfolësit, përjashto zonat rurale në të cilat ajo ka kryesisht përdorim të folur.

Kumtesa është e bazuar në hulumtimet në terren, përkatësisht në rezultatet e anketave, intervistave dhe vëzhgimit të drejtpërdrejtë të përdorimeve të ndryshme të shqipes dhe rivalës së saj gjuhës malazeze nga shqiptarët në Malin e Zi.

Xhemaludin IDRIZI

GJUHA SHQIPE NË SHKRIMIN E MBISHKRIMIN E FIRMAVE TË OBJELTEVE TË NDRYSHME NË KOMUNËN E ÇAIRIT ME THEKS TË VEÇANTË NË ÇARSHINË E VJETËR TË SHKUPIT

Sipas regjistrimit të fundit të vitit 2002, komuna e Çairit është e banuar me mbi 50% me popullsi shqiptare dhe sipas akteve normative të Republikës së Maqedonisë i gëzon të drejtat nacionale si përdorimin e gjuhës amtare, përdorimin e flamurit, arsimim në gjuhën amtare në të gjitha nivelet etj. Në lidhje me përdorimin e gjuhës shqipe në shkrimin e firmave në këtë hapësirë vërehen shkrime në përputhje me kërkesat normative të gjuhës shqipe, por gjithashtu vërehen edhe shmangie nga normat gjuhësore, gabime drejtshkrimore, përkthime nga gjuha maqedonishte, shkrime vetëm në gjuhën maqedonishte, anglishte e kështu me radhë. Pronarët shqiptarë në përgjithësi edhe përkundër mangësive të natyrave të ndryshme firmat i shkruajnë bile disa vetëm në gjuhën shqipe, ndërsa një pjesë në të dyja gjuhët, ndërsa pronarët e nacionaliteteve të tjera vetëm në gjuhën maqedonishte. Shpesh ndodh që të bëhen gabime të rënda gjuhësore gjatë shkrimit të firmave, që flet se të njëjtat shkruhen pa konsultuar njohës të gjuhës shqipe, e që lënë një përshtypje të keqe për mosnjohjen e gjuhës, apo moskushtimit vëmendje të duhur gjuhës amtare, afirmimit të saj në këtë fushë.

Fjalët kyçe: gjuhë, shqip, huazim, drejtshkrim, gabime, normë, firmë, përkthim.

Hyrje

Çështja e studimit të shkrimit të mbishkrimeve të firmave të ndryshme, përfaqëson një problematikë të gjerë, shumë komplekse dhe interesante. Një vështrim sado i përciptë i dukurive të kësaj problematike dëfton se këto, para se gjithash janë elemente të jetës reale dhe së dyti paraqesin dhe përmbajnë elemente kombëtare. Prandaj kjo dukuri nuk është aq e thjeshtë sa në dukje, po shumë e rëndësishme për gjuhën, përkatësisht identitetin e një populli.

Një problematikë aq komplekse është vështirë të shtrohet brenda një kumtese si kjo. Në të do të trajtojmë problematikën në fjalë pa u udhëhequr nga ndonjë kriter i veçantë, do të prekim disa dukuri që lidhen me aspekte normative dhe gjuhësore, të

cilat shfaqen shumë dukshëm dhe fare qartë dëshmojnë mbi ndikimin e shumë faktorëve gjatë periudhave të ndryshme kohore qofshin në Ish Jugosllavinë apo në Republikën e Maqedonisë së pasviteve të 90-ta. Dukuritë e shkrimit të mbishkrimeve të dyqaneve, institucioneve e objekteve të ndryshme në gjuhën shqipe si shprehje e normës ligjore dhe respektimit dhe përdorimit të gjuhës shqipe është një obligim edhe ligjor po edhe respekt ndaj një popullate numerikisht të parë në komunën e Çairit, përkatësisht numerikisht të dytë në Republikën e Maqedonisë. Kë problematikë këtu do ta trajtojmë në tri aspekte, aspektin normativ, praktik dhe devijimin gjuhësor.

1. Aspekti normativ

Me rëndësi të veçantë është të them disa fjalë se cilat janë aspektet ligjore që e rregullojnë këtë problematikë në Republikën e Maqedonisë. Kjo çështje është e rregulluar me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë, ku në nenin 7 lidhur me përdorimin e gjuhës shqipe krahas gjuhës maqedonase thuhet:

“Në tërë territorin e Republikës së Maqedonisë dhe në marrëdhëniet e saj ndërkombëtare gjuhë zyrtare është gjuha maqedonase dhe shkrimi i saj cirilik. Gjuhë tjetër të cilën e flasin së paku 20% e shtetasve, gjithashtu, është gjuhë zyrtare dhe shkrimi i saj, siç është përcaktuar me këtë nen. Dokumentet personale të shtetasve të cilët flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase, lëshohen në gjuhën maqedonase dhe shkrimin e saj, si dhe në atë gjuhë dhe shkrimin e saj në pajtim me ligjin. Cilido shtetas i cili jeton në njësinë e vetadministrimit lokal në të cilën së paku 20% e shtetasve flasin gjuhë zyrtare tjetër nga gjuha maqedonase, në komunikim me njësitë rajonale të ministrive, mund të përdorë cilëndo nga gjuhët zyrtare dhe shkrimin e saj. Njësitë rajonale kompetente për ato njësi të vetadministrimit lokal përgjigjen në gjuhën maqedonase dhe shkrimin e saj cirilik, si dhe në gjuhën zyrtare dhe shkrimin të cilin e përdor shtetasi. Çdo shtetas në komunikim me ministrinë mund të përdorë një nga gjuhët zyrtare dhe shkrimin e saj, ndërsa ministrinë përgjigjen në gjuhën maqedonase dhe shkrimin e saj cirilik, si dhe në gjuhën zyrtare dhe shkrimin të cilin e përdor shtetasi.

Amandamentet më të shumta u nxoren pas konfliktit të vitit 2001 si rezultat i nënshkrimit të Marreveshjes Kornizë të Ohrit dhe obligimeve që dalin nga ajo. Amandamenti kryesor i cili rregullon përdorimin e gjuhëve është amandamenti V i cili terësisht i kushtohet përdorimit të gjuhëve, ku thuhet:

“1. Në tërë territorin e Republikës së Maqedonisë dhe në marrëdhëniet e saja ndërkombëtare gjuhë zyrtare është gjuha maqedonase dhe alfabeti i saj cirilik. Gjuhë tjetër që e flasin më së paku 20% e qytetarëve gjithashtu është gjuhë zyrtare dhe

alfabeti i saj siç është përcaktuar me këtë nen". Këtu duket qartë se përveç theksimit të qartë për përdorimin e gjuhës maqedonase dhe alfabetit të saj cirilik si gjuhë zyrtare, me alinenë vijuese, për herë të parë në Kushtetutat e Republikës së Maqedonisë krijohet mundësi për përdorimin e një gjuhe dhe alfabeti tjetër gjithashtu të jenë zyrtare. Mirëpo për të qenë një gjuhë tjetër zyrtare duhet të plotësojë një kusht – ajo gjuhë të flitet nga më së paku 20% nga qytetarët në Republikën e Maqedonisë. Në këtë moment gjuhë e vetme që e plotëson këtë kusht është gjuha e bashkësisë shqiptare në Republikën e Maqedonisë. Teoretikisht edhe gjuhë tjetër në Republikën e Maqedonisë mund të bëhet gjuhë zyrtare nëse pjesëmarrja e bashkësisë që e flet atë gjuhë arrin në 20% nga popullata e përgjithshme e Republikës së Maqedonisë.

Për implementimin e këtij amandamenti të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë është nxjerrë Ligji për Përdorimin e Gjuhës që e flasim më së paku 20% nga qytetarët në Republikën e Maqedonisë dhe në Njësitë e Pushtetit Lokal.

Me këtë nënkuptohet edhe përdorimi i gjuhës shqipe në shkrimin e mbishkrimeve të dyqaneve, objekteve afariste, institucioneve dhe ndërmarrjeve publike dhe të tjera.

2. Aspekti praktik

Shumica e emrave të mbishkrimeve të dyqaneve, institucioneve, ndërmarrjeve publike, bankave, shkollave, ndërmarrjeve tregtare, marketeve, e tjerë mbajnë mbishkrime me qëllim për të treguar sendin e llojet e shërbimit. Mbishkrimet e këtyre objekteve në gjuhësi merren si fjali emërore të quajtura emërtuese e që emërtojnë emra gjeografikë, emra institucionesh, dyqanesh etj. Këto nëpërmjet emërimit tregojnë ekzistencën, qenien e një sendi. Shprehen me emra ose me togje emërore si Mobileri, Kafe, Konfeksione të gatshme, Bonboneri, Teatri Shqiptar, Universiteti Shtetëror i Tetovës, Shkolla e Mesme Shtetërore e Qytetit të Shkupit etj.

Për shkrimin e mbishkrimeve të dyqaneve, institucioneve e objekteve të tjera në komunën e Çairit lirisht mund të themi se një numër i caktuar i respektojnë normat ligjore, me ç'rast mbishkrimet e veta i shkruajnë në dy gjuhë, në gjuhën maqedonase dhe shqipe. Këtë element e gjejmë te institucionet shtetërore, mandej te firmat, dyqanet, shërbimet që janë pronarë të nacionalitetit shqiptar (një numër modest), ndërsa në këtë komunë pronarët e dyqaneve, firmave të ndryshme të nacionalitetit qoftë maqedonas apo tjetër joshqiptar nuk gjen përdorim gjuha shqipe me përjashtime shumë të vogla. Institucionet publike në shkrimin e mbishkrimeve të tyre e respektojnë normën ligjore, mbishkrimin e kanë të shkruar në gjuhën maqedonase dhe në gjuhën shqipe, si p.sh. Makedonska Poshta (me alfabet cirilik) dhe Posta e

Maqedonisë (me alfabet shqip), Shkolla e mesme e Qytetit të Shkupit (Sredno drzhavno ucilishte na grad Skopje), Shkolla Fillore Jashar Beu, Shkup (osnovno ucilishte Jashar Beu, Skopje, (shkruar më parë me alfabetin cirilik dhe mandej me alfabetin shqip). Kështu ndodh me të gjitha institucionet dhe ndërmarrjet publike. Ndërmarrjet private disa prej tyre e respektojnë normën ligjore, ndërsa shumica jo, kështu do të hasim mbishkrim si psh. Skopski Pazar (shkruar me alfabet cirilik) dhe jo edhe me alfabetin e gjuhës shqipe, por vërehet mbishkrimi i shkruar në gjuhën shqipe – Pazari i grave, maqedonisht Zhenski Pazar dhe turqisht Kadinlar pazari. Vërehet një mosrespektim i gjuhës shqipe në shkrimin e mbishkrimeve të të gjitha filialeve të bankave që veprojnë në komunën e Çairit. Derisa Stopanska banka, Ohridska banka dhe Komercijalna banka mbishkrimet i kanë të shkruara me alfabet cirilik (Stopanska banka edhe me alfabet latin), tri bankat tjera, Tutunska banka, Shparkasse bank dhe Halkbank me alfabet latin, në të gjitha këto nuk vërehet asnjë shërbim të shkruar në gjuhën shqipe. Objektet e mbetura nga koha e Osmanëve si Kapan Han, Çifte Hamam, Suli Han janë të shkruara me alfabet cirilik dhe latin (disa), ndërsa këtu vërehet eliminimi i shkronjës –h dhe del të shkruhen Kapan an, Çifte amam, Suli an etj. Në Çarshinë e Vjetër gjendet busti i heroit kombëtar, Skenderbeut. Në vetë bustin qëndron mbishkrimi Gjergj Kastrioti Skenderbeu, i shkruar drejtë, ndërsa në tabelën e vënë më vonë atë pranë, disa metra më larg nga qyteti i Shkupit emri i heroit kombëtar është shkruar me alfabet cirilik dhe i shtrembëruar – Gerg e jo Gjergj dhe gabimi i dytë qëndron në Skenderbeg e jo Skenderbeu, ashtu siç duket në tabelën e mëposhtme.. Kujtoj që gabimi është i qëllimshëm, kur i njohim maqedonasit si vjedhës të historive e kulturave të popujve fqinj, andaj edhe ky fakt nuk na habit fare.



Në Çarshinë e Vjetër të Shkupit vërehen mbishkrime të objekteve tregtare dhe objekteve të tjera të shkruara në më shumë raste vetëm në një gjuhë dhe atë në gjuhën

maqedonase (përzier, me alfabet cirilik dhe më tepër me atë latin), po edhe nga pronarë shqiptarë. Shembull te veçantë paraqesin mbishkrimet e dyqaneve që merren me përpunimin dhe shitjen e arit. Gati se të gjithë pronarët e këtij artizanati janë të kombësisë shqiptare, mbishkrimet në dyqanet e tyre janë të shkruara në gjuhën maqedonase si Zlatar (ai që merret me shitjen e arit) ose Zlatara (veprimtari artizanati), që në gjuhën shqipe do të duhej shkruar bizhuteri, e që kjo fjalë nuk haset në rastin konkret në asnjë shitore të këtij artizanati të Çarshisë së Vjetër të Shkupit. Gjithashtu gjuha shqipe nuk është prezente as në shumë kafeteri, qebaptoçe, dyqane që tregtojnë mallra të ndryshme, qofshin teknikë të bardhë, mobilje etj., ëmbëltore që zakonisht mbishkrimi qëndron në gjuhën maqedonase si Slatkarnica shkruar me alfabet cirilik (Zanaetçiska slatkarnica Ohrid, pronari nuk është i përkatësisë shqiptare), Qebapçilnica Destan (pronari nuk është i përkatësisë shqiptare), Serdarot, skara na zhar (shkruar vetëm me alfabet cirilik) etj.. Vërehen edhe disa firma që janë privatizuar dhe gjenden në Çarshinë e Vjetër të mbajnë mbishkrime me alfabetin shqip, por duke e huazuar fjalën e huaj nëpërmjet sllavishtes si mobilje (që në gjuhën shqipe do të duhej të qëndronte mobileri, si një fjali e pagjymtyrëzueshme – fjali emërore të quajtur emëruese, mbishkrimi Libraria e Çarshisë, e hapur shumë vonë, e cila si qëllim ka shpërndarjen dhe kultivimin e librit lexuesve. Fjalën avokat e gjejmë të shkruar gati se tërësisht në formën maqedonase me alfabet cirilik si advokat po edhe te disa nga ata të përkatësisë shqiptare, advokat N.R. (shkruar me alfabet cirilik). Në bulevardin Këste Misirkov regjistrova disa nga mbishkrimet si Lëvizja Besa, që emërton parti politike, të shkruar vetëm në alfabetin e gjuhës shqipe, TV Alsat M shkruar me alfabet cirilik në gjuhën maqedonase Nacionalna televizija dhe me alfabet të gjuhës shqipe Televizioni Kombëtar, mbishkrimin Zaman (turq. zaman, shq. koha) shkruar me alfabet latin dhe emërton një gazetë që botohet në tri gjuhë, shqip, maqedonisht dhe turqisht në Shkup me qëllime të njohura gjithandej, fotokopir shkruar vetëm me alfabet cirilik, Ameli studio shkruar me alfabet latin e që kemi një konstrukt sllav, Mekici Tabako dhe Mekici Sara shkruar me alfabet cirilik. Karakteristikë është të shkruarit e firmave te dyqaneve që merren me shitjen e pjesëve të makinave. Gati se kudo gjen mbishkrimet avtodelovi shkruar me alfabet cirilik, ose autodelovi dhe auto pjesë shkruar me alfabet latin, auto parts, oto trejd, që kujtoj se vjen nga fjala auto në turqishte oto dhe trejd, ngaqë pronari i takon kombësisë turke, pastaj të gjitha reklamat e këtij dyqani janë të shkruara në gjuhën maqedonase me alfabet cirilik. Kemi edhe raste si Inter mobil-Fabrika za mebel me alfabet cirilik dhe Fabrika e mobiljeve, e që kjo fjali emërore emërtuese do të duhej të ishte Mobileri, ngaqë këtu kemi të bëjmë me dyqan e jo me fabrikë. Interesante është të theksohet se në vend të fjalë bukëpjekës përdoret fjala e huaj furna (pronari shqiptar) shkruar me alfabet latin dhe pranë tij furna shkruar me

alfabet cirilik (pronari maqedonas), mandej burekdzilnica shkruar me alfabet latin dhe burektore në gjuhën shqipe (pronari shqiptar) etj. Në mbishkrimet e shumë dyqaneve qëndrojnë mbishkrime të firmave të ndryshme të vendeve të jashtme si p.sh. Hedef Fashion (tekstil) shkruar me alfabet latin, Marmaris, Karamanmarash, Hisar Turizam (që i shtohet një –a dhe shndërrohet në formë sllave) – dhe vërehet reklama çdo ditë-sekoj den za Istanbul, që emri i qytetit të Stambollit shkruhet ashtu siç e shqiptojnë turqit dhe maqedonasit e jo edhe shqiptarët etj.

Në komunën e Çairit i gjejmë disa alfabete me të cilët janë shkruar firmat e objekteve të ndryshme afariste, shoqërore, tregtare etj.

- Kështu kemi mbishkrime të shkruara vetëm në gjuhën maqedonase me alfabet cirilik, si p.sh. *ТЕДИКО СУПЕРМАРКЕТ*, *Кебанчилиница – РИО*, *Бутик –НЕКО*, *Сервис –БАГАТ*, *Златара – АРТА*, *Златара –РУБИИ*- etj.,

- mbishkrime të shkruara vetëm në gjuhën shqipe me alfabet latin (janë të pakta dhe me gabime drejtshkrimore) si *Gjellëtorja*; *Mishtorja “ISAK”*; *LION mobilje*; *SHARR TURIST*; *Shitore – Libraria “Restoran “BLACA”*; *Artaria “BADI”*; *Artaria “LAMI”*; *Restoran “ISAK” etj.*

- mbishkrime që forma e fjalëve është e gjuhës maqedonase ndërsa të shkruara me alfabet latin si p.sh. *Дијагностички Центар*, *Менувачница*; *Фризерски салон “Стил ВЕЧА”*; *Млечен ресторан “ТЛАМА- Н”*; *Перална - Вулканизер*; *Златар “РАМА”*; etj.,

- mbishkrime të shkruara në tri gjuhë (në gjuhën maqedonase me alfabet cirilik, në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaj me alfabet latin) si p.sh. *Општина Чаур - Комуна Çair*; *Аптека – pharmacie - barnatore*; *Гинеколошка ординација – Ambulanta gjinekologjike “NËNA”*; *Мебел – mobilje LION-M*; *Кројач - Robaqeps “PARIS”*; *Месарница – Mishtorja “МЕКА”*; *Месарница – Mishtore “AMIIC”*; *Менувашица – Këmbimore “ZAMAN”*; *Слаткарница “МЛАДОСТ” – Ёmbëlltorja “RINIA”*; *Македонска пошта – Posta e Maqedonisë*; *Судски преводи – Përkthime gjyqësore*; *Млечен ресторант – restoran qumështi etj.*

- mbishkrime **hibride, me alfabete cirilike dhe latine, si në** Çarshinë e Vjetër të Shkupit, vërehen shkrime ku një pjesë është shënuar me shkronja latine ndërsa pjesa tjetër me cirilike dhe e kundërta, p.sh. *Hotel “ SANTOS”*; *Servis за миење коли “GABER”*; *Свеќарница “GIFT SHOP”*; *Опрема за водовод “FORTUNA”*; *Bela teknika “BOSCH”*; *Proto~ni bojleri “SIEMENS”*; *Boutique “DEVET”*; *Kineski Bazar by Bambus Oaza*; *Gostilnica “BLACA”*; *Botique “FATIMA”*; *Fonko - klimatizeri*

- mbishkrime të shkruara në gjuhë të huaja me alfabet latin, emra që u përkasin gjuhëve të ndryshme ballkanike, evropiane dhe botërore, pra jepen në gjuhën nga janë marrë, p.sh.

- a) nga gjuha angleze: *Discount TINEX, Discount ALDI TREJD; China Shopping; MEGA Computers; AQUADENT – Dental clinic; Hotel “STONE BRIDGE”; King Shoes; Mondo & Bazar; Shopping Center “Most”; Copy Center; Magic Eye & Europe; Photo BENNY; Caffè “EUROPA”; Caffè “GRAFFITI”; Caffè “KING”; SIGMA TRADE;*
- b) nga gjuha italiane: *Pizzeria PANINI; Caffè & pizza TOSKANA; Restaurant PIZZERIA “KALABRIA”; Caffè Bar “VERSACE”; Caffè “KANCONA”; Caffè & Pizzeria “FLORANNA”*
- c) nga gjuha frengje: *Boutique “SARA”; Boutique “NEKO”; Restaurant “BRATSTVO”;*
- d) nga turqishtja: *ARÇELIK; DÖNER “FERA”; Bazar Shainler;*

Në shumë dyqane e restorante, te dera shkruhet anglisht **"push"** dhe jo shqip **"shtyje"**, "open" dhe jo shqip **"hapur"**, "cloused" dhe jo shqip **"mbyllur"** etj., ose maqedonisht otvoreno apo atvoreno, hapur apo mbyllur.

3. Gabime drejtshkrimore

Në mbishkrimet që u mblodhën dhe analizuan vërehen edhe gabime të rralla drejtshkrimore. Më poshtë kemi treguesit e objekteve kulturore të Shkupit ku vërehen gabime materiale si në treguesin Sheshi Skenderbeg në gjuhën shqipe (drejtë duhet te jete Sheshi Skenderbeu), mandej Urra e Gurit – fjala ura e shkruar me shkronjën – rr, që paraqet devijim drejtshkrimor sepse kjo fjalë shkruhet me shkronjwn –r.



Bashkësia Islame në Republikën e Maqedonisë (qëndron si mbishkrim në këtë institucion fetar të R.së Maqedonisë), që mendoj se duhet të shkruhet Bashkësia Islame e Republikës së Maqedonisë, në vend të parafjalës në kallëzore të përdoret gjinorja, që me siguri gabimi qëndron në përkthimin nga gjuha maqedonase Islamska zaednica vo Republika Makedonija (ky mbishkrim është i shkruar në katër gjuhë, pra edhe në gjuhën turqishte dhe angleze). Gjithashtu kur jemi këtu duhet theksuar edhe faktin se mbishkrimi për këtë institucion fetar qëndron edhe në objektin e Kapan Hanit shkruar në katër gjuhë, në gjuhën shqipe i shkruar drejt se edhe në gjuhën maqedonase është shkruar drejt (Bashkësia Islame e Republikës së Maqedonisë – Islamska Zaednica na Republika Maqedonija, turq. T.C.Islam Birliqi).



Emri i Xhamisë së Murad Pashës është i shkruar me gabime gjuhësore - Xhamija e Murad Pashës – 15 shekuj (në maqedonisht Murad Pashina Xhamija 15 vek dhe në turqisht Murad Pasha Xhamisi – 15 hasır). Këtu hasen dy gabime, njëri në fjalën xhamija – e që –j bie ndërmjet -i dhe –a (rregull drejtshkrimore) dhe 15 shekuj, që vjen nga përkthimi nga maqedonishtja -15 vek, që në gjuhën shqipe duhet të qëndrojë para fjala e përcaktuar dhe të pasohet nga fjala përcaktuese, pra fjala e përcaktuar është shekulli, ndërsa fjala përcaktuese i pesëmbëdhjetë (15). Gjithashtu duhet theksuar edhe ndikimin e gjuhës maqedonase si në rastet sallon dasmash, sallon mobiljesh etj., fjala sallon duhet të zëvendësohet me sallë, pra sallë dasmash, mobileri, berberski sallon me rojtores ose floktari, që e hasim në disa raste të rralla në këtë komunë. Mbishkrimi Komuna Çair është shkruar nga ndikimi i gjuhës maqedonase Opshtina Çair. Kjo duhet të shkruhet Komuna e Çairit, ashtu siç është edhe për formnat tjera si Komuna e Gostivarit, Komuna e Tetovës, Komuna e Strugës etj. Pra fjala përcaktuese që e përcakton fjalën e përcaktuar të përdoret në trajtës së shquar të rasës gjinore. e assesi në emërore të pashquar.

Në tabelën e mëposhtme vërehet plaka me mbishkrimin që tregon drejtimin për në spitalin shtetëror Nëna Terezë shkruar gabim Nëna Terëze që flet se me shkrimin e mbishkrimeve nuk konsultohen profesionistë.



Përfundim

Çështja e shkrimit të mbishkrimeve në rajonin në fjalë paraqet një problematikë shumë e gjerë, komplekse dhe shumë interesante dhe serioze, në veçanti në përdorimin e gjuhës shqipe ashtu siç e kërkojnë normat ligjore dhe gjuhësore. Gjuha shqipe duhet mbrojtur, meqë përfaqëson tiparin kryesor të identitetit, përfaqëson monumentin më të madh që ne si shqiptarë e kemi trashëguar nga të parët tanë. Për implementimin e drejtë të mbishkrimeve në objekte të ndryshme qofshin publike apo private në këtë komunë duhet angazhuar organet kompetente duke aplikuar normat ligjore, ndërsa gjithashtu për aspektin e standardit gjuhësor të konsultojnë profesionistë të fushës së gjuhës shqipe. Është koha e fundit që të kemi një ligj për mbrojtjen institucionale të gjuhës shqipe, përkatësisht standardit gjuhësor në Republikën e Maqedonisë.

Matilda PARLLAKU

KËMBIM REGJISTRASH NË KOMUNIKIMIN GJUHËSOR TË D. AGOLLIT - DEPUTET DHE SHKRIMTAR

1. Hyrje

Me poezinë e tij *“Në rrugë doli”*, *“Udhëtoi i menduar”* duke ndier herë të matur e herë të shkujdesur *“Hapat e tij në asfalt”* për të vazhduar udhëtimin e tij herë si *“Lypës i keohës”* e herë si *“Pelegrin i vonuar”* në *“Mesditë”* nëpër *“Shtigje malesh dhe trotuare”*, me bindjen se vërtet *“Fjala gdhend gurin”*, siç ka gdhendur fjala e tij poemat *“Për babanë dhe për veten”* dhe për *“Nënë Shqipëri”* dhe me synimin që me *“Çudirat dhe marrëzitet”* e *“Pleshtucit”*, *“Edukatës së Mackave”*, *“Përrallën e kecërve”* do të argëtonte, më shumë se vetëm fëmijët apo të apasionuarit pas kafshëve e fabulave të thurura për to.

Agolli është nga ata shkrimtarë, prej të cilit lexuesi nuk do të lodhet asnjëherë kur të lexojë për trimëritë e *“Komisarit Memo”* dhe për egon e guximin e *“Njeriut me top”* nuk do të lodhet as nga dilemat e personazhit të *“Trëndafilët në gotë”* të vendosur mes disa *“zjarresb”*, as duke lexuar për rrugën e mundimshme të Sherif Abecesë për të zbuluar *“Arkën e Djallit”* e për të shpëtuar *“Shakanë e ndaluar”* të Bamkë Dynjasë, e aq më pak duke lexuar shkrimet e Demkës për *“shokun Zylo në të gjitha fazat e shkëlqimit dhe rënies së tij”*, që pavarësisht të gjithave nuk e la veten të ishte *“Dështaku”*.

Ashtu sikurse bindemi përmes tregimeve e dramave të tij që *“Njeriu i mirë”* nuk mund ta jetojë i qetë *“Moshën e bardhë”*, pa u trazuar nga *“Zburma e erërave të dikurshme”* dhe pa u përballur me *“Fytyrën e dytë”* jo vetëm të një njeriu të vetëm, por të gjithë njerëzimit.

Udhëtimi përmes titujve të vjershave brenda vëllimeve të tij me poezi na përball me të *habishtmen, të larmishmen, të bukurën, hyjnoren, personalen, të paanshmen, me dëshirën, realen, dashurinë (për njeriun dhe për tokën, vendin), me heshtjen, trishtimin, moshën, pritjen, përndjekjen, mallin, ndarjen, largësinë, besimin, dhimbjen, peizazhin* etj. Të gjitha këto janë veçse pak grimca nga titujt e veprës letrare aq të pasur të Agollit, për të cilin është shkruar dhe s`është shkruar mjaftueshëm.

Komunikimi i tij me publikun nëpërmjet artit të prozës a të poezisë që krijon me penën e vet artistike, bart në vetvete kohë, frymëzim, ndjenjë, ushqim për shpirtin e atyre që i lexojnë, spontancitet, mendim, kritikë, dashuri etj. Ky komunikim i takon

një sferë tjetër, një regjistri joformal, të lirshëm dhe pa korniza, pa kufizime për grupin të cilit i drejtohet. Edhe pse paraqitet në formë të shkruar, nëpërmjet veprave në prozë a poezi, apo gazetës ky komunikim bëhet më i drejtpërdrejtë, e afron më shumë me publikun, e sidomos me kategorinë e dashamirësve të artit, atyre që e ndiejnë përkëdheljen e ndjenjave të tyre nëpërmjet penës së tij dhe vargjet e mësuara përmendësh i citojnë mes miqsh apo edhe i dëgjojnë si vargje këngësh.

2. Ana e panjohur e Agollit si deputet

Vij në parlament ku bëbet zburmë/Dhe qëndroj i heshtur si gubak;/ Gjëra që s'më duhen gjej aq shumë,/ Gjëra që më duhen marr kaq pak! (Në parlament/Poetët e shint)

Jetojmë në shëkuillin e mendjes dhe progresit/Demokracinë e tregut botëror/dhe zemër na jep frymë e parlamentit për pasuri e kapital madhor./Më bëj një nder, se ta jap vetë djathin/Ia fut në vesh Kuvendit Popullor/Posaçërisht të ma përkerabë djalin/të bëbet në Holandë ambasador.¹

Agolli në një artikull ka theksuar: “*Poezija si çdo art tjetër, dubet t'u flasë zemrave dhe të bëbet e nevojshme si ajri, uji dhe buka.*”

Për vlerat e tij si shkrimtar i papërsëritshëm, jo vetëm për poezitë e ndiera dhe prekëse, që përcjellin edhe sot kur i lexon, dashurinë për gjithçka që e ka nxitur t'i shkruajë dhe dëshirën për t'i rilexuar e për t'i mbajtur mend a cituar në një kontekst të caktuar, por edhe për majën shpuese të penës së tij nëpërmjet satirës e humorit të përcjellë nëpërmjet romanit “Shkëlqimi dhe rënia e Shokut Zylo” aq të vlerësuar nga shumë autorë të huaj e revista a të përditshme prestigjioze, ka shkrime e variante të biografisë së tij lehtësisht të konsultueshme në libra a faqe interneti, artikuj vlerësues në konferenca të mbajtura në përvjetorët e tij.

Por ka një anë të këtij personaliteti që nuk e njohim mirë, atë të pjesëmarrësit aktiv në Parlament. Nëpërmjet biografisë së tij mësojmë që ai ka qenë deputet për 30 vjet (përfshirë këtu periudhën e parlamentarizmit kur diskutimet në seanca, jo vetëm nuk transmetoheshin nëpërmjet medias për publikun e gjerë, por as nuk botoheshin nëpër përmbledhje, çka na ka penguar t'i bëjmë pjesë të korpusit tonë për studim) Gjatë kësaj periudhe parlamentare “*veprimtaria e Kuvendit si organ përfaqësues ka qenë tërësisht e zhvendosur nga roli i tij legjislativ nga Presidiumi. Për këto arsye mund të thuhet se sistemi shtetëror i vendosur në Shqipëri pas Luftës së Dytë Botërore ka qenë një sistem në të cilin përimisht u mohua dhe praktikisht u zhduk parlamentarizmi.*”² Për këtë arsye në korpusin tonë është përfshirë aktiviteti parlamentar i Agollit pas viteve '90, në periudhën që ai ka qenë deputet.

¹ Korbi dhe dhelpra 1993 në *Çudira dhe marrëzi*, fabula dhe epigram, Sh.B. Toena, 1995, f. 10-11

² Y. Bufi, *Tempulli i demokracisë*, Ombra GVG, Tiranë 2010, f. 168

Diskutimet e D. Agollit, sikurse dhe debatet që kemi konsultuar janë vetëm ato që janë regjistruar gjatë seancave plenare, në sesione parlamentare, jo në komisione parlamentare, u përkasin viteve 1991 (vitet e ndryshimeve rrënjësore në sistemin politik në Shqipëri, për të cilat Agolli ka folur mjaft në Parlament). Punimet e Kuvendit në këtë periudhë kanë filluar me legjislaturën e 12-të, janë të përmbledhura në 6 numra dhe Agolli ka qenë mjaft aktiv me diskutime gjatë kësaj legjislature. Të njëjtin aktivizim e vërejmë edhe në legjislaturën e 13-të që është mbajtur në vitin 1992 dhe punimet e së cilës janë të përmbledhura në 7 numra veprash. Legjislatura e 13-të ka vijuar edhe përgjatë viteve 1993, 1994 dhe 1995, me punime të pasqyruara në 4 vëllime për secilin vit, në seancat e të cilave Agolli ka marrë pjesë me diskutime e debate, me përjashtim të një periudhe të shkurtër kohe të pasqyruar në vëllimin nr. 3 të vitit 1993, ku nuk ka fjalime a diskutime. Fjalime nuk ka as në vitin 1996 dhe në vëllimin e parë të vitit 1997 (legjislatura e 14-të).

Në vitin 1997 kur zhvilloheshin punimet e Parlamentit në legjislaturën e 15-të, vëllimi 2, në sesionin e parë, ditën e mërkurë, 23.07.1997 Agolli drejton seancën e pasdites, të cilën e nis me: *“Më në fund, pas një prijjeje të mundimshme, i çelëm portat e Legjislaturës së re të Kuvendit Popullor, i çelëm me një nënqeshje të lodhur në buzet tona, por aspak të ngrirë. Dhe është nder për mua, si një ndër 10 deputetët më të moshuar, t’i hap punimet e sesionit të parë të Legjislaturës së re,”*

Ka fjalime në vitin 1998 në vëllimet 1, 2 (nuk ka tek numri 3), 4, 5; në vitin 1999 ka fjalime vetëm në numrin 1, por jo tek dy numrat e tjerë (2,3). Në vitin 2000 ka vetëm në numrat 1 dhe 3 (jo në ata 2 dhe 4).

Nga tekstet e fjalimeve dhe debateve të konsultuara kemi konstatuar që Agolli ka qenë mjaft aktiv në seanca, jo vetëm me fjalime të përgatitura për çështje përkatëse të rendit të ditës, por edhe me improvizime të atypëratyshme, në të cilat kalimi i tij në regjistrin joformal bëhet duke futur në tekst ndërtime që i përkasin gjuhës së popullit ose figura të stilit të letërsisë artistike.

Tribuna politike janë partitë, sheshet, auditoret, gazetat, librat dhe të gjitha mjetet e tjera të informacionit. Prandaj, i bëjnë hesapet pa hanxhinë ata që thonë se miratimi i këtij ligji do të sigurojë pastërtinë e jetës demokratike.³

Por, kur digjesh nga qulli, i fryn kosit, i thonë një fjale.⁴

Po ngopet populli nga mitingjet dhe nga përrenjtë e fjalëve premtuese, nga çrrënjosjet, rrënjosjet dhe prashitjet.⁵

Por do të bëhet ndonjë bata dhe do të çuditemi të gjithë pastaj.⁶

³ Punime të Kuvendit, Legjislatura e 13-të, viti 1995, nr.4, f. 1251

⁴ Punime të Kuvendit Legjislatura e 13-të viti 1992, nr. 1-2 f. 51

⁵ Punime të Kuvendit, Legjislatura e 13-të, viti 1992, nr. 2, f. 697

3. Koncepti për regjistrin dhe këmbimi i regjistrave në komunikimin gjuhësor të D. Agollit

Komunikimin e Agollit me publikun do ta shohim në aspektin e regjistrave gjuhësorë (niveleve) të zgjedhur prej tij, për ta realizuar atë. Nocioni i Regjistrit i trajtuar nga Halliday dhe bashkëpunëtorët e tij McIntosh dhe Strevens⁷ mbështetet në faktin që “çdo folës zotëron disa varietete gjuhësore, të cilët i përdor në mënyrë alternative: *“The variety according to use is REGISTER”*⁸ Regjistrat dallojnë nga njëri-tjetri në aspektin formal d.m.th. nga tipare leksikore e sintaksore.

Të njëjtin konceptim për regjistrin jep dhe Hudson, i cili, shprehet se *“Termi regjistër është shumë i përhapur në sociolinguistikë dhe u referohet “varieteteve në raport me përdorimin” duke cituar në këtë mënyrë emrat e autorëve tek të cilët e ka gjetur këtë koncept (Cheshire 1992; Downes 1994; Biber 1988).⁹ Në vijim të shpjegimeve për dallimin ndërmjet dialekteve dhe regjistrave, Hudson i referohet pikërisht Michael Halliday-t (1978, f. 33), kur na sjell në vëmendje që tri dimensionet në të cilat mund të vendoset një akt komunikimi janë: “fushë” (“qëllimi”, “tema e komunikimit” – “përse” dhe “për çfarë”), “mënyrë” (mjetet me të cilat realizohet komunikimi “si”) dhe “toni” (varet nga marrëdhëniet mes pjesëmarrësve “kujt”).¹⁰*

Në të njëjtën frymë trajtohet koncepti i regjistrit edhe nga Gj. Shkurtaj në “Sociolinguistika”, në të cilin ai vë në dukje edhe njësimin e stilit të shqiptimit me regjistrin e të folurit, duke cituar Xh. Lloshin¹¹ për konceptin e stilit dhe duke veçuar fushat që preken (leksikun dhe sintaksën) nga përdorimi i varieteteve të ndryshme të gjuhës: *“Variacionet e stilit të shqiptimit quben edhe regjistra të të folurit.”¹²*

T. Topalli flet për dy lloje regjistrash të ulët dhe të lartë, që përcaktohen nga situata formale dhe joformale. Duke u bazuar tek *bashkëfolësit* ai vëren ekzistencën e dy llojeve të regjistrave: *konfidencial* (gjuhë e ulët) dhe *i respektuar* (gjuhë e lartë). Në bazë të *nivelet të përkujdesjes gjuhësore dallon* regjistrat: *informal* (pak e përkujdesur) dhe *formal* (e

⁶ Punime të Kuvendit Legjislativ të 12-të, viti 1991, nr. 3, f. 932

⁷ Halliday, M.A.K., McIntosh, A. & P. Strevens *Readings in the Sociology of Language*, edited by J. Fishman, La Haye, Mouton, 1972

⁸ Halliday, M.A.K., McIntosh, A. & P. Strevens 1972, po aty, f. 141

⁹ Hudson, A. R., *Sociolinguistika*, Sh. B. Dituria, përktheu M. Ymeri, botimi i dytë, Tiranë 2004, f. 57

¹⁰ Po ai, po aty, f.58

¹¹ Xh. Lloshi, *Gjuha, stili dhe redaktimi në shtyp*, Tiranë 1977

¹² Gj. Shkurtaj, *Sociolinguistika*, Botimet Toena, SHBLU, Tiranë, 1999, f. 101

përkujdesur), kurse në bazë të *paraqitjes* dallon regjistrat: *objektiv* (i depersonalizuar) dhe *subjektiv* (shpreh qëndrim, emocion, gjykim të atij që flet) ¹³

E veçanta e ligjërimit politik të Agollit është pikërisht që emetuesi i komunikimit politik është, në fakt, një artist, i mësuar me fjalën dhe me lirinë e përdorimit të saj si në kuptimin e drejtpërdrejtë, ashtu edhe në kuptimin e saj të figurshëm. Ajo që ka rëndësi në komunikimin parlamentar është formulimi i mesazhit dhe publiku të cilit i drejtohet, me qëllim që ai t' u përgjigjet rregullave të komunikimit. Në përkapjen e këtij mesazhi nga dëgjuesi, (publiku i synuar), rol të rëndësishëm luajnë shumë faktorë, që nga gjatësia dhe mënyra e formulimit të fjalive, shpejtësia a intonacioni me të cilin shqiptohen kur ligjërohen në parlament, fjalori i pasuruar me fjalë të reja me ngjyrim politik apo të figurshëm etj.

Në mënyrë të përgjithshme debati parlamentar është një shkëmbim ndërmjet së paku dy folësish për një publik pak a shumë pasiv. Ai i përket sferës publike dhe u nënshtrohet rregullave të marrjes së fjalës, të kohës për ndërhyrje etj., të përcaktuara që më parë, me një drejtues seance të ngarkuar për të respektuar procedurat dhe rregulloren. Dhe për më tepër ai ka karakter jo të drejtpërdrejtë, me qëllim final mbërritjen te publiku, i cili në fakt, nuk ndërhyr dot në të.

Duke qenë një lloj ligjërimit i përcaktuar nga retorika klasike, funksioni i tij është të jetë bindës, të tërheqë vëmendjen, duke u mbajtur në një asamble publike. Duke qenë vendi në të cilin merren vendime të rëndësishme për vendin dhe për shoqërinë, vihen në dukje të gjitha vlerat e të nevojshmes dhe të së dëmshmes dhe janë të lidhura drejtpërdrejt me konceptin e demokracisë:

Ne në vend që të mendojmë se si ta drejtojmë Shqipërinë dhe t'i japim alternativë se kush duhet të jetë në Qeveri, se si të mbledhim njerëzit e mençur për të qeverisur vendin, themi dhe mendojmë se duhet të rrëzohet kjo apo ajo qeveri! ¹⁴

Ky ligjërimit është a) *verbal*, i transmetueshëm tek auditori nëpërmjet medias herë në formën e monologut, kur është fjalim, herë në formën e dialogjeve ndërmjet dy a më shumë folësish, pjesëmarrës në debate, b) *ndërveprues* (pavarësisht diskutimit të përgatitur për çështjen përkatëse, diskutanti, debatuesi i radhës i referohet paraardhësit të tij për t' i dhënë përgjigje apo për të replikuar me të) dhe është gjithashtu 3) *dinamik*, gjithçka ndodh brenda një kohe të përcaktuar dhe diskutimet e debatet ndjekin njëri-tjetrin, sipas një rendi dite të miratuar dhe njoftuar që më parë dhe sipas një liste diskutantësh gjithashtu të miratuar.

¹³ T. Topalli, *Gjuhësi teksti*, Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi", Instituti i Studimeve Albanologjike, Shkodër 2011, f. 62-63

¹⁴ Punime të Kuvendit, Legjislatura e 13-të, Viti 1994, nr.3 – 4, f. 905

Për nga karakteristikat gjuhësore dhe përmbajtja e mesazhit që transmeton komunikimi nëpërmjet regjistrit joformal renditet në *stilin e veprimtarisë shoqërore e politike*, në nënstilin e formave gojore publike (*oratoria, gojëtaria*), duke i plotësuar më së miri, falë karakterit të tij, jo vetëm ato karakteristika që R. Qosja te “*Gojëtaria ose muza e barruar*”¹⁵ i numëron si kërkesa që duhet të plotësojë gojëtari që të thuhet se flet bukur, siç janë *zotërimi i një kulture të përgjithshme dhe i njohurive nga fusha të ndryshme, njohja e mirë e temës për të cilën do të flasë, përgatitja për të folur për çështjen përkatëse, të komunikojë me auditorin duke e nderuar atë, të njohë rolin e gojëtarisë dhe efektin që kërkon të arrijë, si edhe të zotërojë mirë gjuhën shqipe, pasuritë e saj dhe mjeshtërinë stilistike*.

Të gjitha këto aftësi Agolli i ka dhe i shfaq pa asnjë mundim në ligjërimet e veta në parlament, gjatë të cilave e ka gjithashtu të pamundur t’i shmanget asaj që ka ditur gjithë jetën ta bëjë edhe më mirë se gjithçka, të ndërhyjë në këtë komunikim me mjete të figurshme, duke zbutur me spontaneitet atë zymtësi që krijon komunikimi nëpërmjet stilit formal, që shpesh ndez edhe debatet.

“*Kuvendi nuk është vetëm për të bërë ligje, por vetë fjala "kuvend" do të thotë që të kuvendosh për shumë gjëra të kohës që kanë ardhur edhe papritur, edhe të përgatitura.*¹⁶ *Domethënë këta kanë mendjen më të qartë, janë më të pastër dhe nuk mbajnë mbi supë leshterikë ideologjish dhe pikëpamjesh të shtrembra antidemokratike.*¹⁷;

“*... por ç’është e vërteta kur dëgjova oshëtimën e ortekut të sulmeve u butova dhe e tërhoqa diskutimin, pasi nuk desha të isha pjesë dëborëze e këtij orteku.*”¹⁸;

“*E bëj këtë shtesë, sepse deputeti bëhet leckë nëpër dogana. Ca picirukë të vegjël, ca vajza të vogla t’i fusin duart nëpër xhepa, domethënë të vjen turp të jesh deputet.*”¹⁹

Nëpërmjet regjistrit formal zyrtar Agolli i drejtohet një grupi të caktuar shoqëror e nëpërmjet medias, mbarë kombit, me ndihmën e fjalimeve të përgatitura që më parë (apo edhe të improvizuara në çast) dhe me tema qartësisht të përcaktuara, kryesisht me përmbajtje politike, shoqërore, ekonomike a shkencore, të lidhura ngushtë me çështje themelore të jetës së popullit dhe, ky është një komunikim jo i drejtpërdrejtë me publikun dhe auditorin, duke u mbështetur te logjika, arsyetimi, argumentet në favor apo kundër çështjes që diskutohet.

Duke u ndalur te përcuesi i mesazhit, duhet të theksojmë faktin që Agolli, si shkrimtar (poet, prozator, fabulist, satirist etj.) vjen në këtë komunikim me publikun nëpërmjet diskutimit a debatit parlamentar i shoqëruar në mënyrë të pandarë nga bagazhi jetësor i pasqyruar në secilin prej zhanreve të shkrimeve të tij dhe këtë

¹⁵ “*Gojëtaria ose muza e barruar*”, në librin *Anatomia e kulturës*, Rilindja, Prishtinë, 1976

¹⁶ Punime të Kuvendit Legjislativa e 15-të viti 1998, nr.2, f. 1716

¹⁷ Punime të Kuvendit Legjislativa e 13-të, viti 1992, f. 1456-1457

¹⁸ Punime të Kuvendit Legjislativa e 15-të, viti 1998, nr. 2, f. 802

¹⁹ Punime të Kuvendit Legjislativa e 12-të, viti 1991, nr. 1, f. 176

regjistër gjuhësor tashmë të gatshëm, me të cilin hyn në sallat e seancave plenare, e ka të pamundur të mos e shfrytëzojë qoftë edhe pjesërisht për të realizuar komunikimin nëpërmjet regjistrit tjetër krejt formal me fjali të gjata, një leksik krejt të ndryshëm dhe plotësisht të ndikuar nga politika dhe sfera të tjera të jetës shoqërore.

“Zotërinj, të flasësh sot në këtë Parlament është shumë vështirë, njerëzit duhet të mësohen të flasin mes vështirësish dhe jo mes duartrokitjesh ... se tani nuk ka qetësi në Parlament e nuk ka fjalime të gatshme, të parapërgatitura nga një tjetër. Në xhunglën e këtij politizimi, është vështirë të flasësh. Urdhri i komandës së sotme të lartë politike për ndryshimin e datës tradicionale të Çlirimit të Shqipërisë në një mbledhje të një Parlamenti që pretendon se paska në gjirin e tij aq burra mendjendritur sa bëkan cudira të padëgjuna edhe në zhvendosjen e rrjedhës së kaluar të historisë, nuk mund të mos na ngjallë një keqardhje të trishtuar, të përzier me një buzëqeshje të hidhur. Kjo keqardhje dhe kjo buzëqeshje vjen kur kerabason kokën e madhbërshme të historisë me këto 140 kokat tona që hapin gojët e tyre për ta kafshuar këtë histori. Me këtë kafshim të historisë këta parlamentarë shprehin një megalomani mjaft të trashë, duke rrahur gjokset.”²⁰

Në ligjërimin poetik “sintaksa e vargjeve u nënshtrohet kërkesave, që nisin nga rima e theksi dhe vijnë deri te llojet e strofave. ... Sintaksa është faktori veprues kryesor në vargjet, sepse bashkërendon elementet e tjera, ndërton grupet e kerabasueshme ose paralele, krijon rrethanat ligjërimore që diçka të bjerë në sy ose të shqubet.”²¹

Ndërkohë që në ligjërimin politik, parlamentar shpalosen sidomos përftesat sintaksore (me paralelizma, antifraza, përsëritje, pyetje retorike, reticensa) dhe asociacionet historike, kulturore, letrare e folklorike të shoqëruara me përftesat e intonacionit gjatë shqiptimit.²²

Siç u risoll në vëmendje më sipër koncepti për regjistrin dhe nga analiza e deritanishme, e dimensioneve në të cilat shtrihet ky komunikim sipas të gjithë autorëve të sipërcituar, ne kemi studiuar në diskutimet e Agollit në seanca plenare edhe rolin që luajnë përemrat vetorë të vetës së parë të numrit njëjës dhe shumës, përkatësisht “unë” dhe “ne” duke i parë ata edhe në raport me foljet që vendosen pas tyre. Funkcioni i tyre si kryefjalë në fjali, përcakton në të njëjtën kohë edhe rendin e fjalëve në fjalinë ku ndodhen. Ky rend, sipas studimit që kemi bërë, krahas statistikave për frekuencën respektive të përdorimit të tyre, rezulton në pjesën më të madhe të rasteve të jetë rend i drejtë, por, kemi konstatuar edhe raste të atij të anasjellë

“... por ne të drejtë morale në gjendjen e psikologjisë së sotme të popullit nuk kemi që të marrim shpërblim. Ne, kur duruam kaq muaj që po punojmë këtu, le të durojmë edhe 4-5 muaj.”²³

²⁰ Punime të Kuvendit, Legjislatura e 13-të, viti 1993, f. 2038

²¹ Xh, Lloshi, Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika, SHBLU, botim i dytë Tiranë, 2001, f. 272-273

²² Po ai, f. 218

²³ Punime të Kuvendit, Legjislatura e 12-të, viti 1991, nr.3, f. 1419

Megjithëse gjuha shqipe nuk e ka të domosdoshme kryefjalën në fjali, madje edhe në përdorimin e përemrave vetorë të vetës së parë dhe të dytë si kryefjalë ka kufizime sinatksore (vetëm kur ka kundërvënie dhe theksim), në diskutimet e Agollit kemi konstatuar se përemrat vetorë “*unë*” dhe “*ne*” janë përdorur prej tij përkatësisht 199 dhe 208 herë në raport me 30.806 fjalë që rezultoi të ketë përdorur Agolli gjatë fjalimeve të konsultuara prej nesh në “Punimet e Kvendit” gjatë periudhës 1991-2000.

Siç është e njohur tashmë, përemri “*ne*” shërben për të krijuar një entitet kolektiv, duke qenë në këtë mënyrë më tepër politik se përemri “*unë*”. Qëllimi i *përemrit të vetës së parë të numrit shumë* është të transmetojë tek dëgjuesit një mendim të grupit që përfaqëson, duke u shfaqur si përfaqësues i këtij grupi, ndërkohë që *ai i vetës së parë të numrit njëjës* është më tepër jopolitik, sepse transmeton tek dëgjuesi mendimin apo përvojën individuale të folësit. Ky dallim bëhet edhe më i dukshëm, kur konstatojmë foljet kallëzues me të cilat vendosin lidhje këta përemra në funksionin e kryefjalës. Me përemrin “*unë*” në fjalimet e Agollit gjetëm të përdorura më tepër foljet e *opinionit*, sesa ato të *veprimit*, çka tregon që ai synon që opinionin e tij i bazuar mbi përvojën e gjatë jetësore dhe mbi argumentet, t’u transmetohet si më i besueshëm dhe t’u vijë në ndihmë të gjithë përfaqësuesve të zgjedhur nga populli për të përfaqësuar interesat e tij.

Me përemrin “*unë*” në funksionin e kryefjalës si veprues apo si përvojëdhënës, në këto diskutime apo edhe debate kemi konstatuar foljet: *mendoj* (numri më i madh i rasteve, 103), *them* (48), *dua* (18), *votoj* (14), *flas* (7), *njoh* (3), *habitem*, *çuditem*, *iki*, *jam* (dakord), *mbështes*, *di*, *mbroj*, *quaj*, *kuptoj* (marr vesh), *dal*, *miratoj*, *ftoj*. Këto folje janë përdorur prej tij në kohën e tashme, me ndonjë përjashtim për ndonjë folje veprimi (*iki*) që e kemi gjetur të përdorur në kohën e kryer të thjeshtë apo ndonjë tjetër në të ardhmen me kuptimin e së tashmes (*do të flas këtu*).

Ndërkohë që me përemrin “*ne*” ka një larmi foljesh që janë zgjedhur të përdoren nga Agolli në fjalimet e tij: *propozojmë shohim*, *mbajmë* (premtimet, përgjegjësi), *lejojmë*, *rritim*, *diskutojmë*, *synojmë*, *detyrojmë*, *bëjmë*, *arsyetojmë* (këto 3 të fundit janë përdorur shpesh edhe si pjesë e dytë e kallëzuesit të përbërë, me foljen gjysmëndihmëse që tregon domosdoshmërinë e kryerjes së veprimit *dubet* apo në ndonjë rast edhe me foljen gjysmëndihmëse të mundësisë së kryerjes së veprimit *mund*), *lëmë*, *shkojmë*, *mësojmë*, *respektojmë* (ndonjëherë edhe në kohën e tashme të mënyrës kushtore), *quaj*, *kompromentohemi*, *bëbemi*, *durojmë*, *jemi* (fajtorë), *betohemi*, *kërkojmë*, *marrim*, *arrijmë*, *zhdokim* (nuk mund ta), *biem* (në kundërshtim, ndesh me), *lehtësojmë*, *sakrifikojmë*, *bartëm*, *duruam*, *kërkojmë*, *premtuam etj.*

Larmia e foljeve të përdorura me përemrin “*ne*” e përforcon faktin që, pavarësisht synimit që me diskutimet e tij të sjellë në Parlament përvojën e tij

individuale (duke përdorur përemrin “*unë*” me foljet e cituara më sipër), në fakt ai ka një mision edhe më të lartë për të kryer, së bashku me të gjithë kolegët e tij në sallën ku i përçon mesazhet e tij, atë të përfaqësimit, mbrojtjes së të drejtave dhe vendimmarrjes së duhur për sigurimin e një jete më të mirë të popullit të vet.

Në poezi vetori i vetës së parë njëjës është përdorur për kundërvënien me përemra të së njëjtës klasë, ose edhe për krijimin e rimës, duke mos synuar ndryshimin e përmbajtjes apo të kuptimit të mesazhit.

Edhe në fjalimet apo debatet parlamentare, Agolli bën art, natyrshëm, pa u ndier, ndërfit figura të stilit poetik. Përzgjedhja e regjistrit kërkon llojin e ligjërimit që i përshtatet përdorimit të tij.

Im atë tokën shumë e donte

Siç donte nënë e grua

Për tokën lodhej dhe rënkonte

Dhe djersën derdhte krrua

Dhe tokës shpirt me shpirt i jepte

Nga shpirti i çuditsëm

(Poemë për babanë dhe për veten)

Unë tokën si njerë kurrë s'e kam parë

po e kam parë si nënë

dhe po të mundja hënën do kisha marrë

dhe në gjoks si gjerdan do t'ia kisha vënë...

(Përsëri për tokën)

“Lotët e tokës”

Me tokën shpuçë e lemeri

Atje pa ballet e pa dertet

jeton e liga çmenduri. “Psalm i ri për tokën”

Fushë – Kosovë

Ah, të çlirohej vetëm me vjersha Kosova,

Unë e çliroja i pari, mua lavdia më ndriste të parit.

Me shpatën e vargut si pjeptra do prisja gjokse dhe koka

Dhe flamurin lart do ta ngrija në malet e

Sharrit!

Unë tokën e dua mbase më shumë se të gjithë shenjtorët që janë këtu në këtë tempull, me ndonjë përjashtim, dhe duke e dashur, nuk mund të rri pa folur, pasi edhe fjala vjen nga toka. Që ta duash tokën, duhet ta kesh. Po nuk e pate tokën, nuk flet dot. Pa një grusht tokë nuk do as të shenjtin atdhe. Prandaj unë do të flas jashtë çdo partie parlamentare, do të flas si njeri që, si ta them, në këtë karrige kam marrë me vete disa thërrime toke. Toka nuk është as tapet dhome dhe as karrige zyre, që vjetërsoben apo ndryshojnë.²⁴

Ka 85 vjet që një Shqipëri tjetër jeton nën thundrën serbe. Durimi ka një kufi. Populli shqiptar në Kosovë i përdori të gjitha mjetet e durimit dhe të kërkesave paqësore, Edhe vetë demokracia jonë do të jetë gjysmake, do të jetë një demokraci e çalë, demokraci e plagosur, demokraci fare e vockël, sa një vezë arabecke, në qoftë se nuk zgjidhet çështja kombëtare. Lufta në

²⁴ Punime të Kuvendit, Legjislatura e 13-të Viti 1993 f. 929

Ti qeshte Kosovës vetëm nga njershat liria dhe fati,

Unë do bëja me vargje kërdinë dhe batanë:

Në Fushë-Kosovë s'do vritej vetëm sulltan

Murati,

Do vriteshin katërmbëdhjetë sulltanë,

Unë di shumë për Kosovën

Nuk besoj të këndojë si unë asnjeri për Kosovën në vargje

Dhe s'mendoj të lotojë askush si unë tani për tani.

Unë e njoh Kosovën nga pluburi i zverdhur në pragje,

unë e gjej Kosovën në pikën e vesës atje në hardhi.

Unë e di si djall dhe lugat çdo gjë në Kosovë, i di lugët e bujkut, i di stinët kur mbjell e kur korr,

E njoh sërbin dinak me gjarpër në kokë.

Gjarpër që rritën stërgjyshët e sërbit në oborr

Unë e di se ç'mendon malësori i Drenicës,

Minatori i Trepçës e di se ç'mendon,

Unë e di dhe në Vlorë atë lumin ters të

Shushicës

se çbën për Kosovën dhe ç'këngë nga Vlorë këndon

Unë i di të gjitha dhe s'ka kush më thotë

Se gjoja Kosovën nga larg si poet dashuroj,

Mes Kosovës jam brenda me kokën e ftohtë,

Ndaj Kosovën, si bukën, nga mitet, vërtet

çmitizoj...

Kosovë është ajo shkëndijë e madhe, ajo flakë që edhe demokracinë tonë do ta bëjë të plotë dhe të mirë. Prandaj ne me çdo kusht duhet ta ndihmojmë luftën në Kosovë me të gjitha mjetet, me të gjitha mënyrat, në përputhje edhe me koniunkturat ndërkombëtare, por jo edhe me servilizëm të plotë ndaj këtyre koniunkturave. Falemnderit!²⁵

Gjendja në Kosovë na vë përgjegjësi të mëdha, sepse jemi gjysma e një kombi, një pjesë është andej dhe një pjesë është këtej, janë dy Shqipëri, një këtej Drinit dhe një andej Drinit, kur një gisht i dhemb një tjetri nga ajo anë, neve na dhemb gjithë trupi dhe anasjelltas. f. 1664

Unë e përsbëndes fjalën e Kryeministrit. Kosova është lënë në mes të lukunisë së ujqve. Këta ujq ndonjëberë kërcënohen nga fuqitë e mëdha të Europës, ndonjëberë i këshillojnë dhe u thonë të largoben, por ujqit vazhdojnë të shqyejnë. Kjo të kujton atë përrallëzën e maçokut me emrin Vaskë, i cili rrëmbente mish nga kuzhina. Kuzhinieri e këshillonte: Mos merr mish, o Vaskë, se është turp! Por Vaska dëgjonte dhe hante. Edhe Milosheviçi dëgjon kuzhinierin e Europës dhe ha.²⁶

Siç mund të shihet edhe nga shembujt e dhënë nga të dy regjistrat, të përbashkëtat dhe dallimet janë herë të dukshme, herë jo të mjaftueshëm, falë këmbimit të natyrshëm dhe përdorimit të gjuhës së figurshme edhe në diskutimet

²⁵ Punime të Kuvendit, Legjislatura e 15-të, Viti 1998, nr.4 – 5, f. 1593

²⁶ Punime të Kuvendit, Legjislatura e 15-të, Viti 1998, nr.5, f. 2190

parlamentare, për të larguar monotoninë dhe zymtësinë, në të cilën bien shpesh diskutimet e debatet, për shkak të natyrës së përcaktuar nga çështjet e miratuara.

Çështje si ato të: a) ndërrimit të sistemeve *Ne e boqëm një diktaturë, diktaturën e Enver Hoxhës, por atë e zëvendësuam me diktaturën e rrugës, me diktaturën e vjedhësve, të kriminelëve dhe të spekulatorëve. Tani ne filluam të bëhemi qytetarë, pa diktaturë. Por gjëma e diktaturës së rrugës po na e ul kokën.²⁷ Demokracia nuk i merr gjërat bardhë e zj dhe nuk i merr në mënyrë vertikale, meqë unë kam qenë poshtë, tani do të ngrihem lart dhe ata që janë lart, të bien poshtë. Ja, më thoni edhe një poet nga ana e tyre një vjershë për komunizmin e ka bërë apo jo? Unë kam bërë më shumë se ata (Të qeshura në sallë) Po, doemos kam bërë. Ne bartëm të gjithë disa leshterikë të këtij deti që na ra mbi kurriç.²⁸; b) hapjes së dosjeve: “Autoriteti u njihet relativisht njerëzve, kurse ndershmëria nuk u njihet plotësisht po nuk u hapën dosjet. Pra, dosjet të hapen në një kohë për të gjithë. T’i zgjedhim, pastaj lumi ta marrë kush është ngatërruar.”²⁹ c) rolit të studentëve dhe i rinisë: studentët kanë qenë generatori më i fuqishëm në procesin e demokracisë në vendin tonë dhe kjo është një nga karakteristikat e këtyre proceseve, që ndryshon nga ajo e vendeve të lindjes. Ata e meritojnë ndihmën. Të mos e detyrojmë ajkën e vendit të emigrojë, se është truri i vendit.³⁰ Mua më duket se ne të gjithë kemi një paragjykim të gabuar për rininë. Po të mos ishte rinia, kurrë nuk do të bëhej demokracia.³¹ Agolli i trajton sa më me seriozitet, aq edhe më me lirshmëri, pikërisht në saje të gjuhës së rrjedhshme dhe të stilit të nuancuar.*

Në të dyja rastet në regjistrat e këtij shkrimtari-orator, në ndeshëm karakteristikat e regjistratit formal që përdoret gjatë ligjërimit politik në parlament, pra një fjalor specifik, periudha të gjata të ndërlikuara, por edhe stil lakonik, të prerë, figura të të dy stileve, pyetje retorike (edhe pse janë tipike për retorikën), anasjelljen e subjektit/kryefjalës pas disa ndajfoljeve lidhore.

Ndërkohë që në veprat letrare autori synon drejt një kohe përgjithësisht të pacaktuar që ajo të mbetet aktuale në çdo kohë, fjalimet parlamentare shkruhen dhe mbahen, po aq sa edhe i përkasin një kohe, epoke të caktuar, duke bartur me vete ngjarjet më të rëndësishme të ndodhura gjatë saj. Tek ky poet-orator ky këmbim regjistrash ndodh natyrshëm, pa krijuar një “bendek” të dukshëm ndërmjet tyre, edhe pse të dy kanë tipare të formales, në komunikimin e tij letrar zotëron lakonikja, e bukura, dashuria për njeriun dhe gjithçka lidhet gëlimin e jetës, ndërsa në komunikimin parlamentar epërsi merr serioziteti, fjalitë e gjata, argumenti, referimi ndaj parafolësit apo ndaj ngjarjeve të kaluara, respekti ndaj publikut dhe ligjeve që krijohen, diskutohen dhe votohen në favor të interesave të përbashkëta.

²⁷ Punime të Kuvendit, Legjislatura e 12-të, viti 1991, f. 2070-2071

²⁸ Punime të Kuvendit, Legjislatura e 13-të, viti 1992, f. 2413

²⁹ Punime të Kuvendit, Legjislatura e 13-të, viti 1992, nr. 1-2, f. 316

³⁰ Punime të Kuvendit, Legjislatura e 12-të, viti 1991, nr.5 – 6, f. 1998

³¹ Punime të Kuvendit, Legjislatura e 13-të, viti 1992, nr. 2, f. 705

Po japim këtu më poshtë disa shembuj të figurave letrare që Agolli ka përdorur në fjalimet parlamentare duke i krahasuar me ato që përdor në poezi.

Nëpërmjet ndërthurjes së talljes së hollë e të fshehur pas intonacionit lavdërues që nënkupton të kundërtën (**ironisë**, *figurë stilistike kejo e fjalëve dhe e shprehjeve*) me **pyetjen retorike** (*figurë stilistike e shqiptimit poetik*) që i jep më tepër forcë frazës dhe e bën intonacionin më shprehës, Agolli tërheq vëmendjen mbi një çështje në mbrojtje të së cilës del, jo vetëm me fakte (në diskutimin në vijim), por edhe me gjuhën e figurshme.

Pyetje retorike

Ç'të keqe do të kishte fshatari nga vajtja ime, fjala njen, pranë tij? Ç'do ta pengonte një shtëpi e vogël që do të ngrija unë? Ç'do ta mërzieste një arë dhe një kopsht që do të punoja, apo një dhi që do të rrisja, apo një pjergull që do të mbillja, meqë mua më ka dalë nami edhe për rakinë, apo jo? ³² Do të më vërsulen plot zhurmë dhe do të më thonë: "Ç'ke zotrote që flet?" "Kejo parti është imja, ç'të ha merakun ty?"³³; E ç'punë prish po të jenë dy festa: e Pavarësisë dhe e Çlirimit? ³⁴

Ironia

"Në xhunglën e këtij politizimi, është vështirë të flasësh. Urdhri i komandës së sotme të lartë politike për ndryshimin e datës tradicionale të Çlirimit të Shqipërisë në një mbledhje të një Parlamenti që pretendon se paska në gjirin e tij aq burra mendjendritur sa bëkan çudira të padëgjura edhe në zhvendosjen e rrjedhës së kaluar të historisë, nuk mund të mos na ngjallë një keqardhje të trishtuar, të përzier me një buzëqeshje të hidhur. Kjo keqardhje dhe kejo buzëqeshje njen kur krahason kokën e madhërisme të historisë me këto 140 kokat tona që hapin gojët e tyre për ta kafshuar këtë histori. Me këtë kafshim të historisë këta parlamentarë shprehin një megalomani mjaft të trashë, duke rrahur gjokset: "Ne ia ndryshojmë kur të duam festat historike popullit tonë, e kthejmë 29 Nëntorin në 28 Nëntor ose në 17 Nëntor, se ne jemi më mendjendriturit e mëmëdheut." (Të qeshura.) Po cilët qenkemi ne?!³⁵

Ndërtim enumeracioni duke krijuar çifte epitetesh nëpërmjet strukturave

Epiteti dhe enumeracioni:

Vrasje të kësaj natyre janë të liga dhe tinzare,

³² Punime të Kuvendit, Legjislatura e 13-të, viti 1993, f. 929

³³ Punime të Kuvendit, Legjislatura e 13-të, viti 1992, f. 1666

³⁴ Punime të Kuvendit Legjislatura e 15-të, viti 1997, nr.3, f. 1236

³⁵ Punime të Kuvendit, Legjislatura e 13-të, viti 1993, nr.4, f. 2038

sintaksore paralele të përbëra nga një mbiemër i nyjshëm i ndjekur nga një i panyjshëm apo edhe enumeracione me emra:

*Në procesin e gjatë dhe të vështirë demokratik, ku të lodhshëm e ku ngazëllyes, ku të gëzuar e ku tragjik, kanë humbur jetën ose janë plagosur njerëz, qytetarë, demonstrues, kufitarë, simpatizantë të njërës ose tjetrës partie. Një njeri është vrarë këtu, një atje, një në një manifestim, një në një grumbullim turme.*³⁶

*finoke dhe të ulëta, pasi fshehin djallëzi, mbulohen me mjegull para opinionit kombëtar e ndërkombëtar dhe vrasësi apo shkakitari, urdhëruesi i hapjes së zjarrit apo ngritjes së dorës bumb gjurmët lehtë dhe forcat e drejtësisë bien në qetësi.*³⁷

Retë shtynin shamitë mbi pemë. ("Çerdhet e zogjve në dimër"); Mbi varrin tim do të rrijë i beshtur/ Një qiparis si murg i ngratë. (Kur të jesh mërziur shumë)

Lulet u ngritën nga shtrati i tokës/ Dhe i veshën fustanet më të bukura/ Për të shkuar në ballon e madhe të pranverës/ Ku luan orkestra e bilbilave / E mjeshtërve të violinës. ("Vizatime në pranverë") Pranvera shkruan miliona libra gjelbërimi. ("Fund dimri");

Zogjtë me majën e sqepit firmosin e larg fluturojnë. ("Vdekja e fshatarit"); Në vendin tim e në vendin tënd/ Hënë si petull e pjekin në shkëmb. (Në vendin tim e në vendin tënd)

Ju aq baltë po hidhni mbi mua./ Sa në baltën permbi trup, / mund të mbijë një dardbë a një ftua, / një korije e madhe me dushkë. (hiperbolë) (Kundërshtarëve të mi)

Të gjithë këta shembuj, si edhe përdorimi i:

Frazave të përbëra të ndërtuara nga paralelizma sintaksorë;

Pra, ngritja e temperaturës së atmosferës politike në këto raste të pengon të gjykojë me gjakftohtësi, të pengon të mbrosh dikë dhe t'i japësh të drejtë atij apo këtij, pasi çdo gjë mbushet me emocione politike, që zëvendësojnë logjikën dhe arsyetimin. Ai Parlament që do të bëjë një hap për ta bequr këtë festë, do të dalë në sytë e popullit si një grup liliptësh përpara Guliverit. F. 2493

Kundrinorëve të brendshëm:

nëse ata ende kanë oborr dhe ende oborrtojnë.

Si edhe i paralelimave figurativë dhe metaforave në diskutimet parlamentare:

Dhe ne mblidhemi sot në Kuvend, në agim të fushatës së zgjedhjeve, për ta sjellë këtë bir mbreti të fushatojë në këtë fushatë.

³⁶ Punime të Kuvendit, Legjislatura e 12-të, viti 1991, f. 338

³⁷ Punime të Kuvendit, Legjislatura e 12-të, viti 1991, f. 338

Megjithatë, çdo rregull ka edhe përjashtim, një lloj mbretërisë unë i dua më shumë se ç'i duan borgjezët, dhe këta janë mbretërit e përrallave. Në përralla mbretërit janë të urtë, janë shakatorë, qejflinj dhe pakëz tubafë, që bëjnë çudira. Këta mbretër rrallë urrejné, rrallë mbajnë armë, dhe aq më rrallë vrasin. Edhe të bijtë e mbretërve të përrallave janë të mirë dhe fisnikë dhe martohen me vajza të bukura të përbufura nga njerëkat, vajza si Hirushja.³⁸

janë dëshmi bindëse dhe përmbledhje e gjithë sa u tha më sipër në lidhje me aftësinë e Agollit për përdorimin në vend të njëri-tjetrit dhe të këmbimit të regjistrave gjuhësorë në komunikimin e tij me publikun. Nëpërmjet kësaj kumtese u përpoqëm të hedhim pak dritë mbi një anë pak të njohur të D. Agollit duke e studiuar ndihmesën e tij të çmuar në aspektin gjuhësor. Në korpusin e këtyre fjalimeve, ne konstatuam edhe elemente të tjera gramatikore e leksik të pasur, ndërtime sintaksore mjaft të veçanta etj. nëpërmjet përdorimit të të cilave kemi mundësi ta studiojmë ndikimin e tij tek publiku me të cilin komunikon.

Raste të tilla si: roli i përdorimit të mjetit lidhës *që* (540 raste) si lidhës apo si përemër lidhor; i lidhëzave bashkërenditëse *dhe* (730 raste); *por* (140 raste); i lidhëzave të tjera nënrenditëse: *sepse* (86 raste), *meqë, në qoftë se*, apo edhe roli i pjesëzës mohuese *nuk* (i ndeshur në 484 raste), sikurse edhe i ndonjë aspekti tjetër gramatikor, do të jenë objekt i një studimi tjetër.

Ne urojmë dhe shpresojmë që Agolli të vazhdojë **të na Dritë-ro-jë** me veprat e tij edhe për shumë vite të tjera! *Edhe pse jeta është i vetmi libër fletët e të cilët nuk mund t'i kthesh prapa*, ndryshe nga shumë të tjerë, Agolli na ka krijuar mundësinë që, fletët e jetës së tij, të shkruara në trashëgiminë letrare dhe atë oratorike të mund t'i shfletojmë e t'i vlerësojmë siç e meritojnë, sa herë që të kemi dëshirë, madje edhe për të kuptuar prej tyre vlerën e thënies: *Leximi i librave të mirë na zbulon mendimet e fshehura në shpirtin tonë.*

Bibliografi

- Halliday, M.A.K., "The Users and Uses of Language" Readings in the Sociology of
McIntosh, A., & Language edited by J. Fishman, La Haye, Mouton, 1972, f. 139-
170
- Stevens, P., Hudson, A. R., *Sociolinguistika*, Sh. B. Dituria, përktheu M. Ymeri, botimi i
dytë, Tiranë 2004
- Lloshi, Xh., *Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika*, SHBLU, botim i dytë Tiranë, 2001
- Punime të Kuvendit Botim i Kuvendit, Tiranë, 2011, Përgatiti për botim Drejtoria e
Shërbimit

³⁸ Punime të Kuvendit, Legjislatura e 15-të, Viti 2000, f. 979

Seancat plenare të Botimeve Parlamentare, shtypshkronja e Kuvendit, Vitet 1991-2013

Shkurtaj, Gj., *Socilinguistika*, Botimet Toena, SHBLU, Tiranë, 1999

Topalli, T., *Gjuhësi teksti*, Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, Instituti i Studimeve Albanologjike, Shkodër 2011

Bade BAJRAMI

FRAZEOLOGJIA E FUSHËS SË MJEKËSISË NË PORTALET SHËNDETËSORE NË GJUHËN SHQIPE

Rezyme

Të gjithë kemi tendencë të lexojmë artikuj shkencorë për t'u informuar për një patologji që na intereson dhe veçanërisht nëse ka të bëjë me ne. Prej nga pra dëshira që të merremi me këtë domen dhe të vjelim informata në media të ndryshme. Qëllimi i punimit është të vëhet në pah veçoria e gjuhës së përdorur në fushën e mjekësisë duke dalluar frazeologjizmat që i referohen kësaj fushe nga ata që nuk i referohen. Për këtë jemi mbështetur në një korpus artikujsh nxjerrë nga portalet shëndetësore në gjuhën shqipe. Analiza e artikujve na ka mundësuar të nxjerrim paraqitjen vijuese: shkaku-përshkrimi – tretmani, e cila na ka mundësuar të bëjmë një klasifikim tematik të frazeologjizmave dhe të tregojmë se cilët përdoren më së shpeshti.

Hyrje

Mjeku buzëqesh kur pacienti flet për mjekësi sepse ky i fundit nuk i përdor fjalët e duhura në momentin e duhur, madje i deformon ose i ndërfton në fjali padyshim të sakta gramatikalisht por të pasakta në të folurit e mjekut. Studimi i frazeologjisë i një domeni të specializuar është një analizë e kodeve që e bëjnë një diskurs të specializuar. Është me rëndësi të përcaktohen orientimet e mëdha të një analize frazeologjike të teksteve përfaqësues të një fushe të specializuar. Një fushë e specializuar karakterizohet nga një gjuhë e mirëfilltë e specializuar që ka të bëjë me vet gjuhën por edhe me organizimin e tekstit. Punimet e gjuhëtarëve të ndryshëm tregojnë faktin se informata e specializuar bartet nga frazemat (frazeologjizma) ose njësi polileksikore diku më shumë diku më pak të ngurosur dhe diku më shumë diku më pak të figurshme. Leximi i artikujve gjuhësorë kushtuar këtyre njësive polileksikore vë në dukje variante të shumta në emërtime të mundshme.

Që nga Mel'cuk (1994), terma frazemë fillon të përhapet. Ajo përfshin, gjithë duke mundësuar dallimin e tyre, njësi po aq të ndryshme siç janë, idiomat, kolokacionet dhe lokucionet me folje bartëse. Kriteret kryesorë të dallueshmërisë të

këtyre kategorive të ndryshme frazemash janë çdoherë polileksikaliteti, ngurosja dhe figurshmëria. Polileksikaliteti është bashkimi i së paku dy leksemave, ngurosja është karakteri i pandryshueshmërisë i këtij bashkimi. Figurshmëria është suspendimi i kuptimit të mirëfilltë në dobi të një kuptimi global të frazemes.

1. Specificiteti i fushës mjekësore dhe pasojat mbi gjuhën e specializuar

Fjala që do të mund të karakterizonte fushën mjekësore është heterogjeneiteti. Mjekësia ka të bëjë me të gjithë, në çdo kohë dhe në çdo vend dhe përmban nën fusha shumë të ndryshme njëra nga tjetra. Themi të gjithë, sepse nuk ka të bëjë vetëm me mjekë, por me çdo qenje njerzore, pacient ose pacient potencial. Në çdo moment dhe në çdo vend sepse diskursi mjekësor nuk del vetëm në spital, në ordinancë apo në një artikull të shtypit të specializuar por gjithashtu në familje, në treg, në një emision televizioni me audience të gjërë. Më në fund ka nën fusha shumë të ndryshme që kanë të bëjnë, secila me pjesë shumë komplekse të “makines-njeri”. Ky heterogjeneitet ka për pasojë një numër të madh situatash komunikative të mundshme. Çdo situatë komunikative ka diskursin e saj mjekësor, gjuhën e saj të specializuar mjekësore.

Që të kufizojmë punën, kemi zgjedhur nën-fushën mjekësore “kancer” sepse është problem botëror i shëndetit public, sëmundje shumë e përhapur e cila mund të prek secilin prej nesh dhe që lidhet drejtpërdrejt me frekuencën e saj të vdekshmërisë. Koncepti mjekësor «kancer» është një koncept fillestar që hap udhë për disa nën nocione. Relacionet në mes të nocioneve të ndryshme mund të jenë të llojllojshme. Brenda konceptit KANCER, kemi nxjerrë relacionet që shprehin shkakun, karakteristikën dhe pasojat. Mund të paraqesim këtë nivel të parë të fjalës KANCER në mënyrën vijuese:

Shkaktohet nga SHKAQET /

...gjenet që bëjnë mutacion, hormonet, viruse dhe bakterie të caktuara, karakteristikat ekologjike dhe biologjike ose mënyra negative e të jetuarit

Karakterizohet nga PERSHKRIMI /

...rritje të pakontrolluar të qelizave anormale, të cilat mund t'i sulmojnë indet dhe organet tjera

Ka për pasojë TRETMANIN /

Kirurgjia luan rol të rëndësishëmnë trajtimin e kancerit. / Onkologjia radiologjike nënkupton shfrytëzimin e rrezeve jonizuese në trajtimin e pacientit me kancer....

Vendi dhe rolet përkatëse të gjuhës së zakonshme (ose natyrore) në diskursin e fushës mjekësore janë përshkruar nga gjuhëtarë të ndryshëm (Gréciano, Müller, Ghazi

ose Kühtz). Nëse të gjithë pajtohem me ndërvarësinë gjuhë e zakonshme/gjuhë e specializuar, atëherë duhet precizuar natyrën e kësaj ndërvarësie në diskursin mjekësor. Fillimisht vërejmë bashkezistencën e frazemave të gjuhës së përditshme dhe të gjuhës së specializuar që bëjnë një ndarje të “roleve”. Frazemat e gjuhës së zakonshme mundësojnë që të lidhen pjesët e ndryshme të saj, të vëhet në pah informata, të jepet një vlerësim, kurse frazemat e gjuhës së specializuar shërbejnë për emërtimin dhe predikimin.

Klasifikimi i propozuar nga Greciano (1998, 2004) i cili punon mbi gjuhën e mjekësisë është përdor edhe në fusha të ndryshme si ekonomia, politika, apo sporti (Doillon 1997). Dallohen kater grupe frazeologjizma: frazeotermat, frazemat e specializuar, frazemat e diskursit dhe frazeotekstet.

2. Njësitë frazeologjike

a. Frazotermat

Nga pikepamja formale paraqiten disa lloje frazeotermash:

- togfjalëshat emërorë të llojit emër +mbiemër (ose disa mbiemra):
Kancer, tumor (primar)/ kancer, tumor (metastatik) / (sëmundje) malinje, gjenetike/ tumor (malinj, benignj)/ (sistemi) imunitar, limfatik/ nija, gjëndrra (limfatike), mutacion gjenetik / (onkologji)molekulare, radiologjike, mjekësore / kujdes paliativ / (fazë) e parë, e hershme, e avansuar / (rrezet) ultraviolete, ionizuese / faktorët ekologjik, biologjik;/ infektimi virusal/ palca kockore/ masat parandaluese,/ (mjelomë) multiple, e shumfishhtë / (terapi) hormonale, biologjike, kirurg specialist, etj leukemi akute limfoblastike, leukemia limfocitike acute / leukemia mieloide akute, etj
- togfjalëshat emër + emër në gjinore:
(kancer) i gjakut, i gjirit, i mushkërisë / karcinom i lukthit, / diagnostifikimi i kancerit, mënyra e jetesës, mënyra e të ushqyerit,/ trajtimi, monitorimi (i sëmundjes) / (trajtimi) i kancerit, i tumorit, i pacientit / mjekimi i pacientit, koha e trajtimit, koha e diagnostifikimit/ qelizat e kancerit / faktorët e rrezilut/ Fazë e sëmundjes / çrregullim i hormoneve / përcjellja e pacientëve, etj.
- emër + togfjalësh parafrjalor:
qendra për onkologji dhe radioterapi, mbikëqyrja mbi efektivitetin e mjekimit dhe diagnoza e hershme, trajtim me kimioterapi/ diagnoza për mutacionin e K-Ras/ Mutacioni EGFR

Siç duket këto frazeoterma janë kryesisht frazema emërorë të mirëfilltë për komunikimin e brendshëm të specializuar. Ata emërtojnë fenomene mjekësore ashtu

si dhe etapat e mjetet e ndryshme të terapisë dhe kodifikojnë njohjen teorike të specializuar. Duket këtu se termat bazë emërtojnë patologjinë, evolucionin e saj, gjendjen e të sëmurit, veprimin e mjekut. Kurse termi tjetër që varet prej atij bazë, është më tepër teknik dhe mund të japë indikacione lokale, farmakologjike, kohore, anatomike, shkakore, etj.

b. Frazemat e specializuar

Ata janë kolokacione që mund të zëvendësojnë ose parafrazojnë frazeotermat, të ripërdorin kolokacionet e gjuhës së zakonshme në gjuhën e specializuar. Ata mundësojnë të bartet njohuria, të sqarojnë: janë prezentë në komunikimin e specializuar të brendshëm dhe të jashtëm. Jemi kufizuar në frazemat e specializuar foljorë që paraqesin kryesoren e frazemave të specializuar: me anë të foljes, frazema e specializuar vë konceptet në «dëvizje», ajo i lidh në mes tyre ose me konceptin fillestar (këtu kanceri):

Jap diagnozën, marr masat parandaluese, mjekoj karcinomën, zbuloj në kohë/ shpëtoj jetën/ zvogëloj rrezikun/ mbroj nga kanceri/ marr terapi/ marr vendime / bëj ndërhyrje / jap siguri / ofroj mbështetje, etj.

c. Frazemat e diskursit

Këto janë frazema të përbashkëta për të gjitha shkrimet shkencore dhe shpesh janë lokucione me folje bartese. Ato janë qenësore për difuzionin e informatës të cilën e mbështesin duke treguar fazat e analizës, e sintezës, të komentimit. Meqenëse i destinohen lexuesit ata janë të formuluar me një ton mjaft familjar me qëllim që faktet shkencore të jenë më të kapshëm për lexuesin.

Me qëllim që të kuptohet / Një nga çështjet më të rëndësishme / Prandaj është e rëndësishme të ... / në mënyrë shkencore është dëshmuar/ duhet vërejtur/ është objekt i shumë ...kjo pikë sugjeron se... / etj.

d. Frazeotekstet

Frazeotekstet janë tekste të shkurtëra, të hartuara sipas një modeli fiks: rigjejmë karakteristikat (polileksikaliteti dhe fiksiteti) në shkallën e një teksti. Hasim për shembull frazeotekste në definicionet e termave shkencorë, në titujt e artikujve shkencorë:

Kanceri është emër i përgjithshëm për grupin e 100 sëmundjeve. E përbashkët për këto sëmundje është se fillojnë me rritje të pakontrolluar të qelizave anormale.

Tumor markesët janë molekula të cilat në përqendrimë më të mëdha në gjak, urinë ose ind tregojnë se pacienti ka tumor. / HPV është bashkësi e ndërlikuar virusale

Kuptohet se këto dy grupet e fundit nuk janë shumë prezentë në korpusin tonë, sepse këto tekste nuk i drejtohen nje komuniteti shkencor, por lexuesit të rëndomtë.

3. Njësitë frazeologjike metaforike

Leximi madje sipërfaqësor i portaleve mjekësore që përbëjnë korpusin tonë, tregon qartë prani të shprehjeve të fakteve mjekësore të dala nga fusha të tjera. Vërejmë gjithashtu se është një rritje e plotë e koncepteve të një fushe të dhënë që mund të rindërtohet kur kemi në dispozicion një numër të mjaftueshëm artikujsh. Sipas disa gjuhëtarëve (Lakoff), zbatimi i këtyre koncepteve të njohur të fushave të zakonshme në fusha abstrakte keq të përvetësuara, është ajo që mundëson transferin e njohjes, dhe ky projektion i një fushe A kah një fushe B e lind metaforën konceptuale.

Shihet pra mundësia të nxirren modele metaforike të mirëfillta për një sëmundje të dhënë në një korpus të teksteve të llojit të njëjtë. Por gjithashtu nuk duhet të ekzagjerohet rëndësia e këtyre metaforave: fushat burimore përzihen dhe koherenca tekstuale nuk pengohet. I tërë të kuptuarit nuk mbështetet vetëm në këto njësi frazeologjike. Kemi identifikuar disa fusha burimore kryesore në korpusin tonë: LEVIZJA, GJEOGRAFIA, dhe LUFTA që mundësojnë ndërtimin e një numri të larmishëm të modeleve metaforike. Përshkruajmë së pari LEVIZJEN. Fushat e arritjes janë «hulumtimi mjekësor», «zhvillimi i sëmundjes», «qarkullimi i substancave në trup». Modelet metaforike që kemi identifikuar janë:

- HULUMTIMI SHKENCOR LËVIZ
- TRUPI I NJERIUT ËSHTË NJË TERITOR I PAISUR ME NJË RRJETË UDHËSH TË QARKULLIMIT
- KANCERI LËVIZ

Modeli 1: HULUMTIMI SHKENCOR LËVIZ

Mendimi shkencor shkon në një drejtim dhe merr kahje të caktuar për të arritur qëllimin e tij: njohjen. Drejtimi i marrë nga hulumtimi është një metaforë që gjejmë shqip me fjalët zbuloj, zbulim, gjej.

Ky zbulim vie pas një zbulimi tjetër të rëndësishëm në fushën e shëndetësisë ku u zbulua se si virusi i herpesit mund të jetë çelësi në trajtimin e kancerit të lëkurës. / Mirëpo fatmirësisht shkencëtarët e Universitetit të Shefildit në Britani të Madhe kanë gjetur një tretman i cili mund të

ndalojë përhapjen e kancerit të gjirit drejt eshtrave. / Në bashkëpunim me Institutin e Hulumtimeve mbi kancerin në Londër dhe Universitetin e Kopenbagës, shkencëtarët kanë zbuluar rrugëtimin e kancerit i cili më pas prek edhe eshtrat, gjë që ndodh në 30 përqind të rasteve.

Modeli 2: TRUPI I NJERIUT ËSHTË NJË TERITOR I PAISUR ME NJË RRJETË UDHËSH TË QARKULLIMIT

Qelizat e kancerit mund të përhapen në pjesët tjera të trupit përmes kokës dhe sistemit limfatik./ Zakonisht, qelizat kancerogjene të cilat përhapen jashtë tumorit primar kalojnë në gjak. Në këtë mënyrë mund të arrijnë në çdo pjesë të trupit. / Shfaqet atëherë kur qelizat e gjakut infiltrohen në gjak dhe në sistemin limfatik, duke arritur në këtë mënyrë tek indet e tjera tek të cilat shfaqen metastazat.

Gjaku dhe sistemi limfatik duke qenë udhët e trupit, metafora e fushës burimore gjeografi e cila del shpesh, është ajo e rrugës, emërtuar me termat kaloj dhe rrugë.

Modeli 3: KANCERI LËVIZ (PËRHAPET)

Qelizat e këtyre tumoreve shumohen aq shpejt dhe mund të përhapen dhe t'i kaplojnë indet dhe organet që janë në afërsi. / Ky lloj kanceri përhapet edhe në eshtra duke ndikuar kështu edhe në intensitetin e dhimbjeve te pacienti i prekur. / Shkencëtarët kanë zbuluar rrugëtimin e kancerit i cili më pas prek edhe eshtrat, gjë që ndodh në 30 përqind të rasteve.

Fusha tjetër burimore është LUFTA / SFIDA. Kemi dalluar një model metaforik: Organizmi pëson sulm. Shembujt tregojnë një gjendje lufte të organizmit kundër qelizave anormale që sulmojnë dhe sikur spiunët, infiltrohen në sistemin limfatik dhe depërtojnë tek indet ku rriten në heshtje. Reagimi i pacientit shihet si një kundër sulm, si një akt agresiv dhe sfidues. Por nuk duhet humbur shpresë, ekzistojnë masa parandaluese siç është ushqimi. Kjo luftë paraqitet me foljet: sulmoj, sfidoj, mbroj, zbrapset.

E përbashkët për këto sëmundje është se fillojnë me rritje të pakontrolluar të qelizave anormale, të cilat mund t'i sulmojnë indet dhe... / Ato mund të bëjnë problem nëse fillojnë të rriten dhe me madhësinë e tyre të bëjnë presion mbi organet dhe indet e shëndosha... / Milionë pacientë në botë e sfidojnë kancerin. Kanceri mund të sfidohet, por është e rëndësishme që të zbulohet në kohë. / ...në mënyrë shkencore është dëshmuar se hudhra e vret bakterin heliobakter pilori, që e shkakton të thatin në luth dhe e mbron nga shumë lloje të kancerit. / Konsumimi i sojës në ushqimin tuaj disa herë në javë e zvogëlon rrezikun nga paraqitja e këtyre llojeve të kancerit.

Mbani mend se veprimi mbrojtës i vitaminave dhe të mineraleve kundër sëmundjeve paraqitet bashkë me molekulat antioxidante, fitokemikalet, fijet bimore dhe elementet ushqyese, të cilat gjenden në ushqim tjetër..

Kjo është arsyeja më e rëndësishme për të qenë agresiv dhe proaktiv gjatë kryerjes së vetëkontrollit të gjirit, për të bërë kontroll profesional çdo vit dhe për të bërë mamografi sipas udhëzimeve më lart. / albeu.com/L... shkaktojnë që enzimat ta zmbrojnë proliferacionin e qelizave tumorale, e zvogëlojnë nivelin e kolesterolit në serum dhe e lehtësojnë rregullimin e presionit të gjakut

Sipas kësaj, duket se te metaforat e mirëfillta të diskursit mjekësor, i tërë problemi është të kapet dhe të interpretohet lidhja në mes të fushës burimore (fusha nga është nxjerrë imazhi) dhe fusha e arritjes (fusha të cilës i zbatohet imazhi) ashtu si dhe natyra, roli dhe prurja e tyre në diskurs.

Përfundim

Jemi përpjekur të tregojmë se në çfarë frazeologizma mbështetet dhe organizohet teksti i portaleve mjekësore. Sipas rezultateve është e qartë se këto shkrime mjekësore mbështeten para së gjithash në frazeotermat dhe pastaj në frazemat e specializuara të cilët janë shtyllat e diskursit mjekësor dhe janë bartës të pjesës më të madhe të informatës. Ndërsa frazeotekstet, frazemat e diskursit dhe frazemat metaforik zënë një vend të margjinalizuar.

Bibliografi

- DUCROT, O. / SCHAEFFER, J.-M. (1995): Nouveau dictionnaire encyclopédique des sciences du langage. Seuil (Points Essais).
- GRECIANO G. (1997b) La phraséogénèse du discours. In Martins-Baltar M. (ed.) *La locution: Entre langue et usages*. Fontenay Saint-Cloud: ENS Editions, 179-200.
- GRECIANO, G. (1998): Phraseologie und medizinisches Wissen. In Wirrer, J. (Ed.): *Phraseologismen in Text und Kontext. Phrasemata I*. Aisthesis Verlag, Bielefeld, p. 197-208.
- GRECIANO, G. (2004): Fachtextphraseologie aus europäischer Perspektive. In Steyer, C (Ed.): *IDS 2003 Wortverbindungen – mehr oder weniger fest*. Walter de Gruyter, Berlin, New York, p. 394-414.
- LERAT, P. (1995): *Les langues spécialisées*. PUF, Paris.
- MEL'ČUK, I., 2006, "Parties du discours et locutions". *Bulletin de la Société de linguistique de Paris*, 101: 1, 29-65.
- REY, M.G., «Le rôle de la métaphore dans la formation des expressions idiomatiques» *Centro de Investigaciones Lingüísticas e Literarias "Ramón Piñero"*, Santiago de Compostela

<http://www.albeu.com/shendetesi/kanceri-i-gjirit-mjeket-shpjegojne-semundjen/129498/> (konsultuar më 02.08.2015)

<http://www.doktoriim.com/kanceri-i-kockave-zbuloni-llojet-simptomat-shkaqet-dhe-mjekimet/> (konsultuar më 02.08.2015)

<http://cancertreatment.mk/index.php/sq/jeta-me-kancer> (konsultuar më 02.08.2015)

<http://cancertreatment.mk/index.php/sq/cfare-eshte-kanceri>
(konsultuar më 02.08.2015)

<http://cancertreatment.mk/index.php/sq/kujdesi-palativ> (konsultuar më 02.08.2015)

<http://cancertreatment.mk/index.php/sq/kontrollimi-i-dhimbjes>
(konsultuar më 03.08.2015)

<http://cancertreatment.mk/index.php/sq/kanceri-dhe-te-ushqyerit>
(konsultuar më 03.08.2015)

<http://fr.slideshare.net/danielashehi1/kanceri-nje-forme-e-rebelimit-qelizor-1>
(konsultuar më 03.08.2015)

<http://sherohu.com/category/semundjet/kanceri/> (konsultuar më 02.08.2015)

medicusalb.wordpress.com/2013/05/page/2 (konsultuar më 02.08.2015)

Julie KOLGJINI

NJË HETIM LINGUISTIK RRETH TURBULLIMEVE ESTETIKE TË IDEOLOGJISË SË GJUHËS STANDARDE: RASTI I SHQIPES NË HAPËSIRAT (JO)PUBLIKE

1.0 HYRJE

Gjatë disa dekadave të fundit, në lidhje me ideologjitë e standardizimit gjuhësor dhe zgjedhjes së gjuhës, në veçanti duke u përqendruar në mënyrat e komunikimit në të folur dhe të shkruar, janë hulumtuar gjerësisht gjuhë të shumta (p.sh. anglishtja britanike dhe ajo amerikane). Pak kërkime bashkëkohore, megjithatë, e kanë shqyrtuar përfshirjen e burimeve alternative të pellgjeve gjuhësore dhe repertorëve që gjenden në disa prej (nën)varieteteve të shqipes, zakonisht të stigmatizuara, duke përfshirë veprat letrare të neglizhuara të shqiptaro-amerikanit Miftar Spahija, si një përbërës i legjitimuar brenda shqipes. Paralelisht me zbatimin hegjemonist të ideologjisë së gjuhës letrare të njësuar shqipe (GjLNj-së) zyrtarisht, Spahija (1990, 1998) duke refuzuar të pajtohet me burimet e saj fikse gjuhësore, ndjek një trajektore që eksploron gjithashtu kontinuitete dinamike tejprtej dhe brenda varianteve gjuhësore. Duke vepruar kështu, ai ndjek një kurs të ngjashëm me atë të disa prej paraardhësve dhe bashkëkohësve të tij, si p.sh. Ernest Koliqi dhe Martin Camaj, ndër të tjerë. Spahija estetikiisht ndërthur elemente hibride gjuhësore, policentriste, kod-përzierje, ndër-gjuhëzime, shprehje e fjalëformime të reja, komponente të lojës me fjalë, si dhe burime dinamike gjuhësore (shih Pennycook dhe Otsuji 2014, 2015), ndër të tjera, brenda një sistemi fluid, siç manifestohet shpesh në periudhën e vonshme dhe post-moderne në praktikatat e përdorimit gjuhësor. Ai nuk i kufizon burimet e tij gjuhësore në një kullë të ngurtë, përkundrazi, ai i hap kufijtë e sistemeve të shumta dhe, duke bërë kështu, kap thelbin e agjencisë gjuhësore - të folësit, kallëzimitarit dhe autorit. Shkrimet e Spahisë përqendrohen në *multispeachedness*-in e personazheve në romanet (batriilat) e tij, duke refuzuar limitimin e tyre në kufijtë e linjës strikte të kulturës së standardit gjuhësor (të GjLNj-së). Ai nuk u fshihet praktikave gjuhësore katun(d)are të ashtuquajtura gjoja disfluenci (p.sh. *xhit*, krh. *çka*, *çfarë*; *tamël*, krh. *qumësht*; *kinxh*, krh. *kingj*, *qingj*, *qengj*; *dhami*, krh. *dhambi*, *dhëmbi*; *prájshin*, krh. *pushojshin*, *pusbonin*; *lakmojshin*, krh. *lakmonin*); përkundrazi, ai përpiqet për të kapë estetikën në heterogjenitetin e

përdorimit të tyre të përditshëm. Me lenten e analizës kritike të diskursit, në vend të kompozimit të një traktati të gjatë përshkruar të pamjaftueshmërisë së standardit (aktual), ai i ofron lexuesit shembuj të panumërt të alternativave që bashkëjetojnë në veprat e tij si (ri)invenzione formash gjuhësore (p.sh. *msojbanë*, krh. *msojtore*, *shkollë*; *dritore*, krh. *dritare*, *penxhere*). Duke pranuar dhe integruar kombinimin midis hapësirave sociale dhe praktikave gjuhësore (shih Pennycook dhe Otsuji 2014, 2015), vërehen prirje të dallueshme të Miftar Spahisë që janë bazuar në praktikat e gjuhës *in situ*, ku lexuesit janë të ftuar të luajnë në *sandbox*-in e tij gjuhësor dinamik, hapësirë në të cilën, gjithashtu, edhe ata vetë mund të jenë pjesëmarrës aktivë në praktikat autentike të përdorimit të gjuhës, duke përfaqësuar kështu, horizonte të shumta ku repertorët e tyre gjuhësore janë të pranueshëm e të ligjshëm. Shkrimet e Spahisë përqendrohen në diskursin e vendit, në peizazhe gjuhësore gjeo-semiotike, që zhvillohen befás në situata kontekstesh të caktuara, ku ndërthurjet gjuhësore të stilizuara jo-hegjemoniste, ndërrimi i stileve dhe manifestimi i transidiomaticitetit janë evidente.

2.0 KUNDER-HEGJEMONIA, HETEROGLOSLIA DHE NDERGJUHEZIMI

Diskutimet në lidhje me ideologjinë e standardizimeve gjuhësore shpesh përfshijnë kritika në të cilat janë përmendur lëvizjet e ndryshme kundër-hegjemonike. Siç është vënë në dukje nga studiues të shumtë (p.sh. Woolard dhe Schieffelin 1994; Cameron 1995; Pennycook 1998; Ricento 2000, Milroy 2001; Shohamy 2006; Watts 2010; Otsuji dhe Pennycook 2010; Milroy dhe Milroy 2012, Armstrong dhe Mackenzie 2013), ideologjia e gjuhës standarde shpesh përfshin nocionet e respektimit rigoroz të rregullave ortolinguistike, preskriptivizmit të ngurtë, purizmit gjuhësor, imperializmit gjuhësor dhe kështu me radhë (Pietikäinen dhe Dufva 2014:66). Gjatë dekadave të fundit janë bërë përpjekje eksplicite për të nxjerrë në pah dhe për ta problematizuar qëndrimin e tillë ideologjik të së kaluarës, duke përfshirë rolin e folësit (Pietikäinen dhe Dufva 2014:64, 66). Përpjekjet e tilla kanë përfshirë “kontestimet e konceptualizimit tradicional...të gjuhës, gjuhëve dhe përdoruesve të gjuhës,” ku promovimi kritik i vetëdijes gjuhësore dhe agjencia e folësit marrin rëndësinë themelore, duke përfshirë edhe njohjen e një game të gjerë të formulimeve të reja në gjuhë, të tilla si heteroglosia *Bakhtin-esque* dhe ndërgjuhëzimi (Garcia 2009; Pietikäinen dhe Dufva 2014:64), të cilat janë konsideruar, ndër të tjera, shpesh si kundër-hegjemonike; pra, këto trajektore gjuhësore alternative (në mënyrë implicite dhe eksplicite) janë përpjekje për të sfiduar në mënyrë kritike shumë qëndrime (në rrjedhën dominuese) në lidhje me gjuhën.

Heteroglosia është me rëndësi të konsiderueshme në diskutimet në lidhje me sfidimin dhe/ose kontestimin e politikave dhe praktikave hegjemoniste gjuhësore. Lin (2014) shpjegon se, heteroglosia lejon “mundësinë e lirisë së ndërjegjies, dhe mundësinë e çlirimit nga hegjemonia ideologjike e gjuhëve dhe diskurseve dominuese” duke përfshirë “diskursin absolut” të politikave “të gjuhës unitare” që miraton praktikën gjuhësore monoglosike (të centralizuara) (122), veçanërisht në fushat ku “mbyllja ideologjike dhe gjuhësore (si eksplicite dhe implicite) është një realitet i përditshëm” (Lin 2014:123). Heteroglosia shpesh përfshin “thyerjen e ideologjisë homogjenizuese të identiteteve gjuhësore dhe kulturore” (Lin 2014:123). Kështu, këto praktika gjuhësore alternative nuk iu përmbahen udhëzimeve tradicionale ortolinguistike të përdorimit të gjuhës, duke përfshirë pretendimet se ku mbaron njëra gjuhë ose variant dhe ku fillon tjetra/tjetri. Heteroglosia, shpesh shpjegohet si *multispeachedness*, pra, përfshirje e zërave të shumtë (në mesin e përbërësve të tjerë), dhe që tenton të përfshijë praktika gjuhësore që aktivizojnë diversitetin të gjuhëve dhe/ose (nën)varianteve brenda së njëjtës gjuhë dhe/ose në të shkruar dhe/ose të folur, shprehje dhe sekuenca gjuhësore. Lin (2014) komenton: “Për Bakhtin-in, një frazë është heteroglosike kur dy pika të ndryshme (potencialisht kontradiktore) të pikëpamjeve të dy botëve përbri njëra-tjetrës ballafaqohen brenda kufijve të së njëjtës frazë ose të së njëjtës fjalë” (133). *Multispeachedness*-i Bakhtian-ian lejon optikë të shumëfishtë (duke përfshirë format dhe historitë gjuhësore, p.sh. nga (nën)variante të ndryshme, regjistra, stile, dhe kështu me radhë) që të jenë të pranishëm dhe ndërveprues në lojë kundër njëri-tjetrit, duke i lejuar përdoruesit e gjuhës që të eksplorojnë individualitetin e vetvetes nëpërmes dinamikës dhe shumanësisë në kërkim të të shprehurit autentik, duke përfshirë aspektin stilistik (shih Dentith 1994).

Një komponent qendror i heteroglosisë është prania e forcave konkurruese (shpesh) në konflikt. “Bakhtin-i ishte i shqetësuar me gjuhët e grupeve të shtypura në shoqëri duke argumentuar se çdo frazë përfaqëson një tension të madh në mes të forcave të standardizimit/unifikimit dhe ‘heterogjenitetit popullor’” (Nougueron-Liu dhe Warrier 2014:182). Me fjalë të tjera, tensionet që përfshijnë zgjedhjet gjuhësore në lidhje me përdorimin e varianteve standarde ose jo-standarde të gjuhës janë në provë në heteroglosi, ku “‘çdo shprehje konkrete është një mikrokozmos i kësaj lufte midis ‘forcave centripetale’ dhe ‘centrifugale’ që në të njëjtën kohë njësojnë dhe stratifikojnë gjuhën në të gjitha fazat e ekzistencës së saj historike’ (fq. 112)” (Nougueron-Liu dhe Warrier 2014:182). Hayward-i (2001) shpjegon se “centripetalja orienton drejt një ‘qendre’ që nënkupton nocionin e një gjuhe ‘zyrtare’ apo ‘nacionale’” dhe në anën tjetër, centrifugalja sheh “nga kjo ‘qendër’ në drejtim të dialektit rajonal, si dhe ‘gjuhët’ e përdorura nga klasa, gjenerata, dhe profesione të ndryshme që përbëjnë komunitetin

e folësve...Vepra e Bakhtin-it tenton të theksojë centrifugalen” ku “shtytja dhe tërheqja e forcave mes varianteve kombëtare (ose ‘standarde’) gjuhësore dhe varianteve lokale (ose ‘jostandarde’)” bashkekzistojnë (Nougueron-Liu dhe Warriier 2014:182). Me fjalë të tjera, në lidhje me praktikimet dhe përzgjedhjet e gjuhës prej folësve të përditshëm, ekzistojnë tensionet përkatësisht me selektimin për të aplikuar standarde homogjene dhe forma të ndryshme jo-standarde. Stratifikimi i përdoruesve të gjuhës del në dritë bazuar në zgjedhjen e formave gjuhësore. Siç shkruan Bakhtin-i: “Dhe kur ky stratifikim dhe heteroglosia janë realizuar, nuk është vetëm një invariant statik i jetës gjuhësore, por gjithashtu, diçka që siguron dinamikën e saj: stratifikimi dhe heteroglosia zgjerojnë dhe thellojnë gjuhën sa kohë që ajo është e gjallë dhe në zhvillim. (Bakhtin 1981: fq. 272)” (cit. në Nougueron-Liu dhe Warriier 2014:182). Shikuar nga optika e heteroglosisë Bakhtin-ianë, tensione të tilla janë pjesë e zhvillimit dinamik të gjuhës së gjallë.

Variacioni gjuhësor, fluiditeti në gjuhë(t) dhe identiteti i folësit janë gjithashtu pjesë e këtij konflikti. Pietikäinen dhe Dufva (2014) komentojnë: “Heteroglosia... thekson ndryshueshmërinë thelbësore në të gjithë veprimtarinë gjuhësore njerëzore” (64); ajo kërkon “jo vetëm një ripërcaktim të ‘gjuhës’ në vetvete, por edhe nocione të tilla si ‘folësi’... ‘folësi amtar’ dhe të ngjashme” (64). Me fjalë të tjera, variacioni gjuhësor (përfshi elasticiteti gjuhësor) dhe identiteti i përdoruesit, janë pjesë e realitetit heteroglosik që nevojësojnë rikonceptualizimin se si shoqëria e percepton gjuhën, folësit vetveten dhe praktikatat gjuhësore.

Koncepti i ndërgjuhëzimit (Gracia 2005; Creese dhe Blackledge 2010) është gjithashtu relevant për trajektorët e tilla alternative gjuhësore. Lin (2014) shkruan: “Ndërgjuhëzimi, ashtu si heteroglosia, fokusohet në depërtimin dhe thyerjen e ideologjisë së gjuhës diskrete unitare, dhe duke goditur... mbylljen e imponuar përmes...purizmit gjuhësor dominues në literaturën e edukimit gjuhësor si dhe politikave qeveritare të edukimit gjuhësor (Lin 1996, 2006)” (123). Ngjashëm me heteroglosinë Bakhtian-iane, ndërgjuhëzimi sfidon shumë nga supozimet e ideologjive të gjuhës standarde, duke përfshirë edhe insistimin se një gjuhë nuk duhet të “rrjedhë” në apo “ndotë” një tjetër. Lemke shkruan: “Kjo nuk është aspak e qartë se, në qoftë se ato nuk do të pengoheshin politikisht duke vepruar kështu, ‘gjuhët’ nuk do të përziheshin dhe të shpërndaheshin nëpër njëra-tjetrën, por ne nuk kuptojmë pothuajse asgjë nga procese të tilla...thjeshtë sepse ne përkulemi para politikës dominuese dhe presioneve ideologjike për t’i mbajtur ‘gjuhët e pastra dhe të veçuara...’ (Lemke 2002, fq. 85, në Creese dhe Blackledge 2010, fq. 106)” (cit. në Lin 2014:123). Me fjalë të tjera, fluiditeti gjuhësor është një pjesë integrale e ndërgjuhëzimit. García dhe Leiva (2014) shkruajnë se ndërveprimet e tilla janë “transformuese, që përpiqen të fshijnë

hierarkinë e praktikave të gjuhës që konsiderojnë disa [gjuhë dhe (nën)variante] më të vlefshme se të tjerat. Kështu, ndërgjuhëzimi mund të jetë një mekanizëm për drejtësi sociale” (200), në këtë mënyrë “[duke] synuar të shkolonizojë njohuritë dominuese intelektuale, duke përfshirë gjuhën” (204). Ndërgjuhëzimi inkurajon përdoruesit që të ballafaqohen me padrejtësitë gjuhësore të epokave të shkuara, si dhe të tashmet. Mundësive alternative gjuhësore u hapet rruga për të dhënë frutat e veta; këto marrëdhënie dinamike gjuhësore shoqërohen shpesh me pranimin e formave të tilla të larmishme. Garcia dhe Leiva (2014) komentojnë: “Kjo hapësirë e tolerancës nuk është një hapësirë statike, por një hapësirë e re në zhvillim dinamik ku transformimet sociokulturore janë të mundshme...; por gjithashtu e bën të mundur supozimin e një pozitë të ndërmjetme që i bën rezistencë asimetrisë së praktikave të standardit gjuhësor të vendosur nga pushteti... ku identitetet fluide zhvillohen së bashku me të tjerët në një proces vazhdimësie të të bërit” (211). Me pak fjalë, toleranca gjuhësore është një pjesë integrale e kësaj lëvizjeje, ku mundësitë e reja gjuhësore janë të inkurajuara. Garcia dhe Leiva (2014) shpjegojnë se “[n]dërgjuhëzimi rikthen zërin që ishte përjashtuar nga ideologjitë e standardeve monoglot-e” (211). Këtu, folësit e privuar nga e drejta bëhen të dukshëm, ku përfshirja e alternativës së tyre (p.sh. jo-standarde) gjuhësore e (nën)varianteve të manifestohet. “Ndërgjuhëzimi ka të bëjë me nxjerrjen në pah të shkëmbimeve shpesh të fshehura në mesin e njerëzve dhe çlirimin e historive të shtypura... ku përfaqësime socio-historike, ashtu si edhe praktikat gjuhësore të pranëvendosen... në mënyrë që kufizimet e të menduarit dhe të përfaqësimeve alternative të gjenerohen” (Garcia dhe Leiva 2014:211). Pra, elementet gjuhësore të refuzuara me herët, vendosen në qendër të vëmendjes, bëhen të mirëpritura, dhe përbëjnë kapitalin gjuhësor të denjë për të qenë të përdorura në sferat e shumta publike. Garcia dhe Leiva (2014) shpjegojnë: “Duke ekspozuar historitë, përfaqësimet dhe njohuritë alternative, ndërgjuhëzimi ka potencial për të shpërthyer fluskën ‘e gjuhës standarde’...që vazhdon t’i përjashtojë” (215) shumë përdorues (të jo-standardit). Nëpërmjet ndërgjuhëzimit, hapen mundësitë e shfaqjes dhe shprehjes së bollëkut të historive gjuhësore që kanë qenë (dhe akoma janë) në heshtje.

3.0 TURBULLIMET ESTETIKE TË IDEOLOGJISË SË GJUHËS STANDARDE: MIFTAR SPAHIJA – STILIZIMET, ENREGJISTERMENT-I DHE NDIKIMET

Shkeljet e ideologjisë së gjuhës standarde - duke përfshirë (mes tjerash) tendencat heteroglosike dhe ndërgjuhëzuese - vërehen rregullisht në veprat e Miftar Spahisë, sidomos në lidhje me nocionet e forcave centrifugale dhe centripetale.

Shkeljet e tilla gjuhësore mendohen shpesh si kundërshtim me politikat dhe praktikat e ndryshme centripetale dhe ortolinguistike të imponuara. Heteroglosia dhe ndërgjuhëzimi përfshijnë mbivendosje të konsiderueshme, si p.sh. mjegullimin e kufijve (të imagjinuar) gjuhësorë, p.sh. për një gjuhë të përcaktuar dhe (nën)variante të ndryshme; ato përfshijnë ndërthurjen e kodeve të shumta, në mesin e elementeve të tjera (shih Madsen 2014:42). Pajisur me këto praktika gjuhësore alternative, përdoruesi nuk limitohet në kufijtë striktë (shpesh artificialë) të një entiteti të veçantë gjuhësor, p.sh. (nën)varianti, ose të një periudhe veçanërisht të kufizuar kohore. Alternativa të tilla transgresive, megjithatë, mund të përfshijnë edhe elemente të uniformitetit. Ashtu siç shpjegojnë Pietikäinen dhe Dufva (2014): “Në pikëtakimin [e gjuhëve] zyrtare dhe vernakulare, të reja dhe të vjetra, modalitete dhe mënyra të ndryshme, gjuhëzimi vazhdon të variojë, por nën trysinë [drejt] modeleve të reja të përputhjes” (67). Me fjalë të tjera, këto opsione alternative gjuhësore lejojnë rregullshmërinë e ndërkonstrukteve; ato nuk ndalojnë elemente të uniformitetit. Në të njëjtën kohë, megjithatë, stili dhe shprehja e unit nuk vihen në rrezik. Forcat centrifugale, duke përfshirë “format emergjente, të ricikluara dhe të përvetësuara” (Pietikäinen dhe Dufva 2014:66-7) përfshi indeksimin e autenticitetit (kulturor dhe gjuhësor) në përdorimin e formave lokale (p.sh. nëndialektore) (shih Pietikäinen dhe Dufva 2014:69), ndër të tjera, janë ende manifestuese në praktikat kundër-hegjemonike. Gjithashtu, mund të argumentohet se neologjizmat e shumta të Spahisë përfaqësojnë forcat opozitare neutralizuese ndaj këtyre tensioneve, p.sh. disa nga neologjizmat e tij si: *flebë* AC 202-3 (krh. *femën, femër*); *vresë* AC 79 (krh. *nusë*), *krëb* H 11 (krh. *mashkull*), *bagal* AC 9 (krh. *bisedë*) dhe *msojbanë* AC 21 (krh. *msojtore, shkollë*), në mesin e shumë e shumë të tjerave.

Gjithashtu, praktikat gjuhësore në veprat letrare të Spahisë reflektojnë fonologjinë, morfo-sintaksën dhe leksikun lokal. Në shembujt e mëposhtëm Spahija vizaton mbi një repertor lingistik të bazuar në praktikat e gjuhës lokale të rajoneve ku ngjarjet ndodhin, posaçërisht në Shqipërinë verilindore.

Për shembull, në lidhje me zgjedhjet fonologjike, ai integron elemente si: a.) zanoret hundore (p.sh. *me bâ* H 32 (krh. *me ba, për të bërë, të bësh*), *smûja* H 49 (krh. *sëmundja*)); b.) monoftongizimin e disa togzanoreve (p.sh. *ie ~ i; diell ~ dillë* AC 10, 34, 44, 95 (shih gjithashtu H 14, 97, 107), *miell ~ millë* AC 297)); c.) reduktime të herë-pas-hershme të grup-bashkëtingëlloreve (p.sh. *nd ~ n* (p.sh. *nigjue* H 9 (krh. *ndigjue, dëgjuar*), *katun* H 27 shih gjithashtu AC 10 (krh. *katund, fshat*), *noshta* AC 10 (krh. *ndoshta, ndofta*), *kunra* AC 10 (krh. *kundra, kepuçë*)); *mb ~ m* (p.sh. *mrena* H 12 (krh. *mbrenda, brenda*), (*më mathë* (krh. *mbathë*), *dhami* (krh. *dhambi, dhëmbi*)) si dhe d.) variante të tjera fonologjike, p.sh. *k ~ q* (*kinxh* AC 834 (krh. *qingj, qengj, kingj*)).

Në lidhje me zgjedhjet morfo-sintaksore, praktikat gjuhësore të Spahisë përfshijnë formën e shkurtë (gege) të paskajores (p.sh. *me hypë* AC 207 (krh. *të hipësh, për të hipur*), *me prâjtë* H 21 (krh. *të prâje, me pushue, për të pushuar, të pushosh*)) dhe konstruktet të kohës së ardhme, shpesh kur shprehet domosdoshmëri (p.sh. *ka me ardhë* AC 342 (krh. *do të vijë*)). Zgjedhje të tjera të lokalizuara morfo-sintaksore të gjuhës përfshi shënimin e shqesit fundor në format lokale p.sh. ku *i-ja* përdoret në vend të *u-së* (p.sh. *gjak-i* AC 210 (krh. *gjak- u*), *bark-i* H 32 (krh. *bark-u*), *plak-i* AC 700 (krh. *plak-u*)). Një tjetër strukturë lokale prevalente në veprën letrare të Spahisë është ndërveprimi i përemrit-në-folje (shih Joseph 2006; Kolgjini 2010), p.sh. *trazobna* AC 427 (krh. *trazobemî*), *dabna* AC 428 (krh. (*n*)*dabemî*), *të bâhna* H 68 (krh. *të babemî, të bëbemî*), *tutna* H 68 (krh. *tutemî*), *nxebna* H 621 (krh. *nxebemî, nxebemî*), *flobna* H 621 (krh. *flobemî*) dhe *çobna* AC 101 (krh. *çobemî*). Fokusimi i Spahisë në aplikimin e strukturave të ndryshme të prapashitesave foljore të kohës së pakryer, me përjashtim të vetës së tretë njëjës, gjithashtu pasqyron praktikat gjuhësore lokale (p.sh. koha e pakryer:

-(j)shem (1nj, arkaike), *-(j)she* (2nj), *-(j)shim* (1sh), *-(j)shni* (2sh), *-(j)shin* (3sh); krh. – *ja, -je, -nim, -nit, -nin*); vini re se Spahija për të pakryerën e vetës së tretë njëjës përdor mbaresën *-nte* që u atribuohet shpesh regjistrave formale, të GjLNj-së/toskërishtes (formë e elaboruar edhe në gegnishten veriperëndimore: *shkote, shkonte*) ndërsa mbaresat e të pakryerës në vetat e tjera të (lokalizuara) përmendura më sipër janë të lidhura më shumë me praktikat e gjuhës krahinore (p.sh. *thojshin* H 12 (krh. *thoshin, thonin*), *prâjshin* H 6 (krh. *pusbojshin, pushonin*) dhe *lakmojshin* H 6 (krh. *lakmonin*) (krh. *-nte* (3nj), p.sh. *menonte* H 12, krh. *mendonte*; forma krahinore për të pakryerën e vetës 3nj është *-(j)ke*, p.sh. *menojke*). Gjithashtu Spahija në tekstet letrare të tij përzgjedh forma të ndryshme arkaike të foljeve si në të pakryerën e vetës së parë njëjës (p.sh. *ishem* AC 30 (krh. *isha*), *dijshem* AC 30 (krh. *dijsha, dija*) dhe *dojshem* AC 31 (krh. *dojsha, doja*)).

Në lidhje me përzgjedhjet e elementeve leksikore në gjuhën e Spahisë në tekstet e tij letrare, në shumë raste përshfaqen format e larmishme lokale (me zgjerime harmonike në drejtime të ndryshme brendageografike), p.sh. *bathë* AC 192 (krh. *fasule, groshë*), *cucë* AC 78 (krh. *vajzë, vashë, çikë, goçë, çupë*), *xbit* AC 399, H 24 (krh. *çka, çfarë*), *tamël* H 14, 15 shih gjithashtu AC 9 (krh. *qumësht*), *tlynë* H 15 shih gjithashtu AC 126 (krh. *gjalpë*), *ilbera* H 40 (shih gjithashtu AC 208, krh. *ylbera*), *dhallë* AC 12 (krh. *dhallë*), etj., etj..

Këta shembuj nuk janë aspak shterues, por vetëm ilustrues se si Spahija përpiqet për të krijuar një ndjenjë të origjinalitetit gjuhësor dhe kulturor me indeksimin e formave lokale (nëndialektore) duke aplikuar komponentet gjuhësore, që përdoren lehtësisht nga përdoruesit në të dy sferat si ajo publike, doemos dhe ajo private në

rajonin gjeo-linguistik ku zhvillohen historitë dhe ngjarjet (shih Pietikäinen dhe Dufva 2014:69), sidomos në hapësirat e Shqipërisë verilindore (por edhe te pellgut te përgjithshëm te nëndialektit të gegnishtes verilindore qe përfshin edhe Kosovën juglindore, Maqedoninë veriperëndimore dhe Serbinë jugperëndimore; shih gjithashtu Friedman 2003:266). Nëse autori në fjalë do të kishte përdorur variantin e GjLNj-së ose toskë, në çdo aspekt, duke përfshirë labirintet e sofistikuar të mendimit, dialogjet, monologjet, pasazhet dhe kështu me radhë, kurrë nuk do të kishte përcjellë thellësinë e mendimeve dhe ndjenjave të personazheve në batrilat që pasqyrojnë me saktësi lidhjen me praktikat gjuhësore në kontekstin e komunikimit të përditshëm të folësve të rajoneve specifike nga vijnë ngjarjet dhe subjektet. Nëse standardi (dhe toskërishtja) do të aplikohet më shpesh se ç' është bërë në këto tekste letrare, një numër i konsiderueshëm i audiencës (duke përfshirë edhe lexues të gegnishtes) mund të prirë për ta akuzuar autorin si “jo-autentik” nisë prej (nën)variantit të (gegnishtes verilindore) të shqipes (që është harmonizuar në mënyrën më të elaboruar ndonjëherë nga ndonjë shkrimtar deri më tash) për një numër të konsiderueshëm të përdoruesve në verilindje të Shqipërisë (shih Byron 1976).

Gjuha e stilizuar e përdorur e Spahisë, ilustruar në shkrimet e tij letrare, është një pjesë integrale e heteroglossisë. Stilizimi përfshin një “veprim komunikues reflektues në të cilën folësit prodhojnë reprezentime posaçërisht të shënuara dhe shpesh të ekzagjeruara të gjuhëve, dialekteve, dhe stileve që gjenden jashtë repertorit të tyre të përhershëm’ (Rampton 2009, fq. 149)” (Link et al. 2014:257-8). Përdorimi Bakhtin-ian i gjuhës së stilizuar përfshin aplikimin e zërit të repertorit gjuhësor të “tjetrit,” që nuk “i takon” folësit përdorues në atë moment të caktuar kohor. “Ky koncept... ilustron se si, kur folësit prodhojnë ‘një imazh artistik të gjuhës së tjetrit’ (Bakhtin 1981, f. 362), ata janë duke reflektuar në mënyrë kritike dhe vlerësuese mbi atë gjuhë si dhe duke e pozicionuar veten e tyre në lidhje me folësit e saj (Rampton 2006)” (cit. Link et al. 2014:258). Me fjalë të tjera, përdorimi aktual i elementeve të veçanta (p.sh. i disa karakteristikave gjuhësore) që priren të mos “i përkasin” një repertori të zakonshëm - në vend të shmangies së tyre - mund të shërbejë si një kritikë e këtyre strukturave. Stilizimi i tillë përfshin “përdorimin e një gjuhe apo varianti që ndihet...‘tjetër’ për pjesëmarrësit në aktivitet, që përfshijnë lëvizjet e mprehta rreth kufijve sensitivë socialë ose/apo etnikë, në mënyrë që mund të venë në pikëpyetje legjitimitetin’ (Rampton dhe Çaralambus 2010, fq. 2; shih gjithashtu Rampton 1995)” (Link et al. 2014:258). Në vend të shkrimit të një traktati të gjatë mbi mangësitë e një sistemi të caktuar, autori ofron elementet e këtyre strukturave të paraqitura në veprat e veta që të demonstrojnë tensionin dhe të lejojnë audiencën apo bashkëbiseduesit për të dëshmuar dhe marrë pjesë në përplasjet estetike. Madsen-i (2014) shkruan se

stilizimet shpesh “ndodhin... ku shkeljet e normës dhe/ose marrëdhëniet me autoritetet në një farë mënyre vihen në diskutim” (55), mund të ilustrohen me veprën e Spahisë në rastin e shqipës. Stilizimi shpesh rezulton në “një regjistër emergjent diskursiv në të cilën shenjat linguistike dhe paralinguistike na sjellin në lidhjen dhe në njohjen prej grupeve të caktuara të folësve (Agha 2004, 2005, 2007)” (Link et al. 2014:258). Gjithashtu mund të venrohet se në përgjithësi, regjistri i zhvilluar nga Spahija është lëvizja e tij kritike si largim nga GjLNj-ja, ku anashkalohet vetëdijshëm në raste të gjithfarshme (e përbashkëta me GjLNj-në është vetëm ajo çka i bën natyrshëm këto dy variante në të së njëjtës gjuhë, përfshi këtu edhe variantet e tjera). Këto turbullime estetike të ideologjisë së gjuhës standarde, pra të GjLNj-së, ofrojnë forca qendër-ikëse (centrifugale, p.sh. alternativat e (nën)varianteve të shqipës) në qendër të vëmendjes, por njëkohësisht ballafaqohen me komponentin qendër-synues (centripetal) që nuk mund të shmanget plotësisht.

Në mjaft raste në të gjithë shkrimet letrare të Spahisë, teksti është spërkatur me elemente tradicionalisht të lidhura me standarde të ndryshme, me atë të mëparshmin (bazuar në gegnishten jugore, përkatësisht elbasanishten) si dhe me GjLNj-në (bazuar në variantet toske) pra dialektin toskë (shih Byron 1976). Të dyja pra, si GjLNj-ja dhe toskërishtja përfaqësojnë zërin e “tjetrit” duke pasë parasysh se dialekti “amtar” i autorit është varianti gegë (specifikisht nënvarianti verilindor i Shqipërisë, ku përfshin rajonin e Kukësit), i cili në vitin 1972 ashtu si edhe variantet e tjera geqe, u përjashtua zyrtarisht me statusin e jo-standardit, ku u përfshinë vetëm shumë pak elemente plotësuese aty-këtu në standard (shih Byron 1976; shih gjithashtu Friedman 2003:266). Spërkatje të tilla mund të shihen në shumë shembuj në veprën e Spahisë, veçanërisht në fonologji/fonetikë, morfo-sintaktike, si dhe në nivelet leksikore, ku veçanërisht fjalëformimet e tij zënë vend të veçantë.

Një shembull fonologjik/fonetik që përputhet me GjLNj-në përfshin mungesën e monoftongizimit të tog-zanores *ie*, p.sh. *diell* AC 90 (krh. *dillë*).

Disa shembuj morfo-sintaksor në tekstet e Spahisë nga ajo që është konsideruar shpesh “tjetra” (p.sh. GjLNj-ja, toskërishtja, dhe jo aq e përdorur në gegnishten lokale) përfshijnë a.) shënuesin e kohës së ardhme **do të** (krh. formen e kohës së tashme **kam + me** + formën pjesore të foljes), p.sh. **do të bajsh** AC 333 (krh. **ke me ba**); b.) shënuesin e pjesëzës së mënyrës lidhore **të** (krh. Me paskajoren e shkurtë (geqe), p.sh. *të báj* AC 399 (krh. *me ba*), *të bahet* AC 21 (krh. *të bëhet, me u ba*), të pràje H 30 (krh. *me pràjtë, me pushue*) (shih gjithashtu 21), ndër të tjera të shumta; dhe c.) prapashtesa e të pakryerës së vetës së tretë njëjës *-nte*, p.sh. *fillonte* H 21 (krh. *-jke, fillojke*), në mesin e shumë të tjerave. Edhe pse këto tri struktura morfo-sintaksore janë gjithashtu të mundshme në gegnishte, ato nuk janë shpesh të përdorura në praktikat

gjuhësore të lokalizuara në mesin e shumë përdoruesve në verilindje të Shqipërisë, prej nga burojnë veprat letrare të Spahisë.

Disa ndërthurje-kodesh në nivelin leksikor nga (nën)variantet e tjera, p.sh. GjLNj-ja/toskërishtja, përfshijnë p.sh. *çikë* AC 98 (krh. *pakë*) për sasi të vogël, *fsbatarët* H 86 (krh. *katunarët, katundarët*), *një* AC 21 (krh. *nji*), *kokë* AC 385 (krh. *krye*), mes të tjerash. Spahija e pasuron leksikun e tij, gjithashtu me përfshirjen leksikore jo-lokale me karakteristika të repertorëve gjuhësorë që lidhen me nënvariantet e tjera të gegnishtes (p.sh. asaj veriperëndimore që ka historinë më të gjatë të shqipes së shkruar, por dhe qendrore e jugore), p.sh. *vashë* H 611 (krh. *vajzë, cucë, çikë, gocë, çupë*) dhe *groshtë* AC 11 (krh. *bathë, fasule, pasul*), ndër të tjera.

Enregisterment-i është një element tjetër (i stilizimit) në përdorimin e gjuhës, i cili reflektohet në praktikat gjuhësore të Spahisë. Madsen-i (2014) shkruan: “Teoria e enregisterment-it përlllogarit proceset nëpër të cilat stilet gjuhësore...janë konstruktuar dhe merr në konsideratë aktivitetet metapragmatike në nivele të ndryshme” (43). Enregisterment-i, si produkt i stilizimit, është një proces që mund të rezultojë nga zhvillimi dhe transformimi i stilizimit ku “format e veçanta të të folurit të njihen shoqërisht (dhe asociojnë) si tregues të attributeve gjuhësore të folësve nga popullsia përdoruese e gjuhës’ (Agha 2005, fq. 38)” (Link et al. 2014:258). Struktura të ndryshme gjuhësore lidhen me karakteristika që iu atribuohen shpesh folësve, të cilët i aplikojnë format e tilla gjuhësore (përfshi ata që paragjykohen si aplikues të tyre). Madsen-i (2014) shkruan: “[S]tilizimet... përdorin burimet gjuhësore që asociojnë në shkallë të ndryshme. Disa përfshijnë stile shumë të gjera asociuese (Agha 2005, 2007) të njohura nga një popullsi relativisht e madhe; të tjerat janë të kufizuara në nivele lokale dhe që përfshijnë tiparet gjuhësore të indeksalitetit më të paqartë” (48). Elementet gjuhësore që përdoren në raste të tilla mund të vijnë nga një spektër i gjerë burimesh, disa nga një bazë më e përgjithshme përdoruesish (p.sh. nga një variant më i përgjithësuar) dhe të tjerët më lokale (p.sh. prej një nënvarianti të një mjedisi të drejtpërdrejtë). Madsen-i (2014) shton: “Nga pikëpamja e enregisterment-it, përdorimi interaktiv i formave të ndryshme gjuhësore nga folësit (ri)krijon vlerat stereotipike indeksale të formave që përdoren. Atributi i vlerave të formave gjuhësore mund të jetë pak a shumë eksplicit” (44). Dmth, karakterizimet stereotipizuese të folësve, praktika gjuhësore e të cilëve paraqet elemente të veçanta (implicite dhe eksplicite), shpesh ndodh që shumë prej këtyre stereotipizimeve të tilla priren të hedhin hije negative mbi folësit e jo-standardit.

Në lidhje me përzgjedhjet e gjuhës së Spahisë, në disa raste, kur ai përdor një formë të GjLNj-së apo toskërishtes, mund të duket sikur ai estetisist po kërkon tensione potenciale në lidhje me bilancin e pabarabartë të pushtetit në lidhje me

mënyrën se si GjLNj-ja u përzgjedh dhe se sa shumë folës “jo-amtar” të saj ishin të papërfillur thjesht se vinin nga areal jo-toskë. Në raste të tjera, kur ai përdor format më lokale, mund të konceptohet se ai po përcjell një ndjenjë të solidaritetit me ata folës të marginalizuar duke elaboruar gjuhën e tyre amtare. Ai e kupton dhe e përfaqëson pozitën e pafavorshme të tyre duke pasë parasysh padrejtësitë në të kaluarën (dhe të tashmen) bazuar në diskriminimin gjuhësor. Ai u jep zë shqetësimeve të tyre përmes zgjedhjeve të veçanta të qëllimshme gjuhësore. Ai e bën këtë, gjithsesi, duke refuzuar t’u dorëzohet kërkesave të kujdestarëve të GjLNj-së. Në vend që të ndjekë verbërisht traditat ortolinguistike nga gardianët e GjLNj-së, i grah kursit të vet, një kurs që, në këtë kontekst, përfaqëson konceptin heteroglosik dhe ndërgjuhëzimin (si p.sh. nëpërmjet ndërthurjes së shumë (nën)varianteve), në mesin e strategjive të tjera gjuhësore.

Pavarësisht përhapjes dhe përdorimit relativisht të gjerë të praktikimit të gjuhës jo-standarde në gjuhën shqipe (duke përfshirë format e gegnishtes, pa përfshirë shumë nga ato forma që paraqiten në veprat letrare të Spahisë hulumtuar këtu) në disa segmente të shoqërisë në qarqe të shumta metropolitane, indeksimi i formave të tilla shpesh i shigjeton këto përdorues si objekt talljeje, kur ata përdorin forma të stigmatizuara dhe të marginalizuara të ndryshme jo-standarde që më parë (para-1972, ishin pjesë përbërëse e standardit) gëzonin prestigj të dukshëm (shih Byron 1976); përdorimi i formave të tilla (ende) rezulton mbi përdoruesit me etiketime nënçmuese stereotipike, si p.sh. *katundar* dhe *malok*, duke ilustruar dinamikën sociale të gjuhës në veprim. Më tej, praktikatat transgresive të gjuhës së Spahisë kërkojnë reflektimin e audiencës mbi politikat gjuhësore aktualë dhe ftojnë për ndryshimin e praktikave të tyre dhe orientimin drejt analizave autokritike.

Më tej, praktikatat poliglosike dhe policentrike të gjuhës së Miftar Spahisë ku ai përthith nga burime të shumta gjuhësore, si p.sh. GjLNj-ja, toskërishtja, gegnishtja (jo lokale), përbëjnë raste të ndërgjuhëzimit ku repertori i tij dinamik gjuhësor e lëviz atë nga një (nën)variant tek tjetri, shpesh brenda fjalisë së njëjtë, p.sh. *nuk do të kishem shkue* AC 25 (krh. *nuk do të kisha shkuar*; *nuk kisha me shkue*). Shkrimet e tij letrare shfaqin ndërthurje (nën)dialektesh të ndryshme së bashku, duke ndërlidhur regjistrat formalë (të lartë) dhe jo-formalë (të ulët); fokusi i tij nuk është në dallimet racore ose etnike; në vend të kësaj, shkrimet e tij tërheqin vëmendjen për kategoritë e shumta socio-ideologjike dhe kategoritë stereotipike duke i (ri)indeksuar nëpërmjet ndërlojës estetike të formave të ndryshme (dhe shpesh të kundërta) gjuhësore.

Më tej zgjedhjet gjuhësore të Miftar Spahisë janë pjesërisht të ndikuara nga disa shkrimtarë të tjerë shqiptarë (përveç atyre të vjetër), p.sh. nga Ernest Koliqi, dhe gjithashtu, janë të ngjashme me trajektorët e disa prej bashkëkohësve, veçojmë këtu

Martin Camajn. Ernest Koliqi, herët, shërbeu si një shembull për Spahinë dhe e ka ndikuar trajektoren e tij letrare, e cila është veçanërisht e dukshme kur lexohen të dy autorët. Për shembull, disa zgjedhje leksikore të Spahisë të kujtojnë Koliqin (të tilla si a.) e pakryera e vetës 3nj, p.sh. *hynte* dhe *derdhte*, 2001:16; dhe b.) zgjedhjet leksikore si *dritore*, krh. *dritare*, *penxhere* 2001:16). Gjithashtu, elementet e ngjashme me ato të Camajt janë prezent me shumicë, në eksplorimin e teksteve të Spahisë, duke ushqyer audiencën me perspektiva estetike të formave të stigmatizuara shpesh (si përfshirjen e paskajores së shkurtë si një shënues gegë, p.sh. *me u ba poet* 1994:11 (krh. *të babesh*, *të bëbesh*, *për t'u bëre*), si dhe shënuesve të ngjashëm të foljeve në të pakryerën, p.sh. *-sha*, *-she*, *-(n)te*, *-shim*, *-sbni*, *-shin*, p.sh. *tingulloshin* 1994:10 (krh. *tingullojshin*, *tingullonin*). Miftar Spahija nuk qëndron i vetëm në arritjet e tij letrare, por është në shoqërinë e gjigantëve të tjerë të respektuar të letërsisë shqiptare moderne.

4.0 IMPLIKIMET DHE KONKLuzionET

Shkrimet letrare të autorit Miftar Spahija përfshijnë implikime të shumta, veçanërisht në lidhje me lëvizjen e nocionit të gjuhës përpara, duke hedhur poshtë mitet e ndryshme gjuhësore të kaluara, por që vazhdojnë dhe në të tashmen. Praktikrat gjuhësore të vërejtura në veprat e Spahisë sfidojnë ideologjinë e gjuhës standarde dhe “statusin mitik të gjuhës” (Makoni 2014:79), duke lejuar përdoruesit e gjuhës për të vendosur se deri ku mbërrijnë kufijtë e një gjuhe dhe/ose (nën)varianti të caktuar. Gjithashtu zgjedhjet gjuhësore të Spahisë nuk janë një fotografim i kufizuar sinkronik i caktuar njëherë e përgjithmonë, por një dinamikë që i ofron audiencës perspektiva të ndryshme historike nëpërmes kombinimit të konstrakteve arkaike dhe inovative gjuhësore, që lejojnë përdoruesit të udhëtojnë nëpër kohë (shih Makoni 2014:85). Shkrimet e tij paraqesin një formë të metatrajtesës në lidhje me repertorë estetikë komunikues rreth shqipes (shih Rymes 2014:301-4, 314-6), duke funksionuar si ndihmues të rivlerësimit kulturor dhe gjuhësor si dhe riharmonizimit (shih Jordan 2015:370) nëpërmes një turbullimi estetik mbi politikrat gjuhësore hegjemoniste, ku ideologjia e gjuhës standarde vihet nën lupën e ekzaminimit dhe rishqyrtimit (shih Rymes 2014:296-7) ku *status quo*-ja e saj bëhet objekt transformimi (Rampton 2014:280) nëpërmjet ri-enregisterment-it (Rymes 2014:301) - dhe ku agjencia gjuhësore i kthehet informimit të përdoruesve me vetëdije kritike gjuhësore. Trajektorja e alternatives së Spahisë për zhvillimin gjuhësor hap rrugë për rikontekstualizim, riciklim, rimodifikim, rilokalizim, dhe *crossing over* kufijve të normës së vjetruar e të dalë mode (shih Pietikäinen dhe Dufva 2014:66).

5.0 REFERENCAT

- ARMSTRONG, NIGEL, and IAN E MACKENZIE. 2013. *Standardization, ideology, and linguistics*. Basinstoke: Palgrave Macmillan.
- BLACKLEDGE, ADRIAN, and ANGELA CREESE. 2010. *Multilingualism: A critical perspective*. London: Continuum.
- BLACKLEDGE, ADRIAN, and ANGELA CREESE (eds.). 2014. *Heteroglossia as practice and pedagogy*. Dordecht: Springer.
- BYRON, JANET LEOTHA. 1976. *Selection among alternatives in language standardization: The case of Albanian*. The Hague: Mouton.
- CAMAJ, MARTIN. 1994. *Djella*. Prishtinë: Gjon Buzuku.
- CAMAJ, MARTIN. 1996. *Vepra letrare 1*. Tiranë: Apollonia.
- CAMAJ, MARTIN. 2001. *Rrathë*. Shkodër: Camaj-Pipa.
- CAMERON, DEBORAH. 1995. *Verbal hygiene*. New York: Routledge.
- CREESE, ANGELA, and ADRIAN BLACKLEDGE. 2010. Translanguaging in the bilingual classroom: A pedagogy for learning and teaching. *The Modern Language Journal* 94.103–15.
- CREESE, ANGELA, and ADRIAN BLACKLEDGE. 2015. Translanguaging and identity in educational settings. *Annual Review of Applied Linguistics* 35.20–35.
- DENTITH, SIMON. 1994. *Bakhtinian thought: An introductory reader*. Florence, Ky: Routledge.
- FRIEDMAN, VICTOR. 2003. Language in Macedonia as an identity construction site. *When Languages Collide: Perspectives on Language Conflict, Language Competition, and Language Coexistence*, ed. by Brian Joseph, J. Destafano, N. Jacobs, and I. Lehiste. 257-295. Columbus: The Ohio State University Press.
- GARCÍA, OFELIA. 2009. *Bilingual education in the 21st century: A global perspective*. Oxford: Wiley-Blackwell.
- GARCÍA, OFELIA and CAMILA LEIVA. 2014. Theorizing and enacting translanguaging for social justice. *Heteroglossia as practice and pedagogy*, ed. by A. Blackledge and A. Creese, 199–216. Dordecht: Springer.
- HAYWARD, STEVEN. 2001. Heteroglossia. *Encyclopedia of postmodernism*, ed. by C. E. Winquist and V. E. Taylor. Retrieved from <http://search.credoreference.com.ezproxy.rit.edu/content/entry/routpostm/heteroglossia/0>
- JORDAN, JAY. 2015. Material translingual education. *College English* 77.4.364–382.

- JOSEPH, BRIAN. 2006. On connections between personal pronouns and verbal endings in the Balkans. In: *Studia Caroliensia. Papers in Linguistics and Folklore in Honor of Charles E. Gribble*, ed. by R. Rothstein, E. Scatton, & C. Townsend. Bloomington: Slavica Publishers. 177-88.
- KOLGJINI, JULIE. 2010. Alternative verbs paradigms in Albanian: The case of the Geg imperfect. 17th Balkan and South Slavic Linguistics, Literature and Folklore Conference, The Ohio State University in Columbus (15-18 April).
- KOLIQUI, ERNEST. 2000. *Tregtar flamujsh*. Shkodër: Camaj-Pipa.
- KOLIQUI, ERNEST. 2001. *Pasqyrat e narçizit: Tregjme*. Shkodër: Camaj-Pipa.
- KOLIQUI, ERNEST. 2004. *Hija a maleve*. Shkodër: Camaj-Pipa.
- LEMKE, JAY. 2002. Language development and identity: Multiple timescales in the social ecology of learning. *Language acquisition and language socialization*, ed. by C. Kramsch, 68–87. London: Continuum.
- LIN, ANGEL. 2014. Hip-hop heteroglossia as practice, pleasure, and public pedagogy: Translanguaging in the lyrical poetics of '24 Herbs' in Hong Kong. *Heteroglossia as practice and pedagogy*, ed. by A. Blackledge and A. Creese, 119–136. Dordecht: Springer.
- LINK, HOLLY, SARAH GALLO, AND STANTON WORTHAM. 2014. 'Gusame ka' latal: Faux Spanish in the new Latino diaspora. *Heteroglossia as practice and pedagogy*, ed. by A. Blackledge and A. Creese, 255–273. Dordecht: Springer.
- LOW, BRONWEN and MELA SARKAR. 2014. Translanguaging in the multilingual Montreal hip-hop community: Everyday poetics as counter to the myths of the monolingual classroom. *Heteroglossia as practice and pedagogy*, ed. by A. Blackledge and A. Creese, 99–118. Dordecht: Springer.
- MAKONI, SINFREE. 2014. 'The Lord is my shock absorber': A sociohistorical integrationist approach to mid-twentieth century literacy practices in Ghana. *Heteroglossia as practice and pedagogy*, ed. by A. Blackledge and A. Creese, 75–97. Dordecht: Springer.
- MADSEN, LIAN MALAI. 2014. Heteroglossia, voicing and social categorisation. *Heteroglossia as practice and pedagogy*, ed. by A. Blackledge and A. Creese, 41–58. Dordecht: Springer.
- MILROY, JAMES. 2001. Language ideologies and the consequences of standardization. *Journal of Sociolinguistics* 5.4.530–55.
- MILROY, JAMES, and LESLEY MILROY. 2012. *Authority in language: Investigating Standard English* (4th ed.). Florence, Ky: Routledge.

- NOUGUERÓN-LIU, SILVIA and DORIS S. WARRIER. 2014. Heteroglossic practices in the online publishing process: Complexities in digital and geographical borderlands. *Heteroglossia as practice and pedagogy*, ed. by A. Blackledge and A. Creese, 179–197. Dordrecht: Springer.
- OTSUJI, EMI, and ALASTAIR PENNYCOOK. 2010. Metrolingualism: Fixity, fluidity and language in flux. *International Journal of Multilingualism* 7.3.240–54.
- OTSUJI, EMI, and ALASTAIR PENNYCOOK. 2014. Unremarkable hybridities and metrolingual practices. *The global-local interface and hybridity: Exploring language and identity*, ed. by S. Rubdy and L. Alsagoff, 83–99. Bristol, UK: Multilingual Matters.
- PENNYCOOK, ALASTAIR. 1998. The right to language: Towards a situated ethics of language possibilities *Language Sciences* 20.1.73–87.
- PENNYCOOK, ALASTAIR. 2010. *Language as a local practice*. London: Routledge.
- PENNYCOOK, ALASTAIR and EMI OTSUJI. 2014. Metrolingual multitasking and spatial repertoires: ‘Pizza mo two minutes coming?’. *Journal of Sociolinguistics* 18.2.161–184.
- PENNYCOOK, ALASTAIR and EMI OTSUJI. 2015. Metrolingualism: Language in the city. Florence, KY, USA: Taylor and Francis. Retrieved from <http://www.ebrary.com> ProQuest ebrary. Web. 8 June 2015.
- PIETIKÄINEN, SARI and HANNELE DUFVA. 2014. Heteroglossia in action: Sámi children, textbooks and rap. *Heteroglossia as practice and pedagogy*, ed. by A. Blackledge and A. Creese, 59–74. Dordrecht: Springer.
- RAMPTON, BEN. 2014. Dissecting heteroglossia: Interaction ritual or performance in crossing and stylisation? *Heteroglossia as practice and pedagogy*, ed. by A. Blackledge and A. Creese, 275–300. Dordrecht: Springer.
- RICENTO, THOMAS. 2000. Historical and theoretical perspectives in language policy and planning. *Journal of Sociolinguistics* 4.2.196–213.
- RYMES, BETSY. 2014. Marking communicative repertoire through metacommentary. *Heteroglossia as practice and pedagogy*, ed. by A. Blackledge and A. Creese, 301–316. Dordrecht: Springer.
- SHOHAMY, ELANA. 2006. *Language policy: Hidden agendas and new approaches*. New York, NY: Routledge.
- SPAHIJA (IHAÇI), MIFTAR ZENEL. 1990. *Hasimja*. Canada: Pristine Publishing. (H)
- SPAHIJA (IHAÇI), MIFTAR. 1998. *Arbanet e Curranet*. Tirana: Koha. (AC)
- TJUPA, VALERIJ. 2009. Heteroglossia. *Narratologia Contributions to narrative theory: Handbook of narratology*, ed. by P. P. Huhn and J. S. Wolf, 124–131. Berlin, Germany: Walter de Gruyter.

- WATTS, RICHARD J. 2010. The ideology of dialect in Switzerland. *Language, power and social process: Language ideological debate*, ed. by J. Blommaert, 67–103. Munchen, Germany: Walter de Gruyter.
- WOOLARD, KATHRYN A., and BAMBI B. SCHIEFFELIN. 1994. Language ideology. *Annual Review of Anthropology* 23.55–82.

Imri BADALLAJ

PASKAJORJA GEGE E TIPIT *me + pjesore*

Dominon mendimi se paskajorja si formë perifrastike është krijuar brendapërbrenda shqipes gjatë zhvillimit historik të saj, atëherë kur edhe u krijuan edhe format e tjera foljore. Si e tillë kjo formë foljore gjallon në të dy kryedialektet e shqipes, por me dallime në mënyrën e ndërtimit të saj dhe në dendurinë dhe masën e përdorimit apo të shtrirjes.

Në shqipen standarde, sidomos pas Kongresit të Drejtshkrimit të vitit 1972, tipi i paskajores *me punue*, që është tipar qenësor i gegërishtes dhunshëm u përjashtua nga përdorimi, duke u zëvendësuar nga forma foljore e pashtjelluar e përbërë nga pjesëza parafoljore dhe emri foljor asnjansë i pashquar: *për të punuar*, formë kjo, që në shqipen standarde u bë zotëruese, ngase e gjithë toskërishtja në sistemin e saj foljor e posedon një formim kësisoj. Përndryshe, në sferën dialektore paskajorja e mirëfilltë (*me ba, me la, me punue*) ka një shtrirje fort të dendur, jo vetëm në gegërishten e Shqipërisë Veriore, në atë të Shqipërisë së Mesme, por në gjithë Kosovën, në Maqedoni, në Mal të Zi dhe në trevat shqiptare në Jug të Serbisë.

Pra, tipi i paskajores *me punue* është kryekëput dominues në shtrirjen më të madhe të shqipes, duke kryer funksione të shumta gramatikore.

Është për t'u përmendur edhe tipi i paskajores *për me punue*, që haset në gegërishten jugore, që padyshim është rezultat i kontaminimit të paskajores *me punue*, por një formë e këtillë nuk i kaloi caqet e të folmeve që i përmendëm. Sipas Jorgji Gjinarit në gegërishten veriore shpesh haset një formë e kohës së shkuar të paskajores, e cila ka gjetur vend në një funksion sintaksor të caktuar dhe përdoret si folje kallëzues e një fjalie kushtore: *Mos me pa dit, kishte nejt.*¹⁾

Mendimi i gjuhëtarëve rreth kësaj forme foljore në segmentin diakronik është shumë i diskutueshëm, sepse edhe vetë udha e formimit të saj në gjuhën shqipe ka qenë me ndryshime të mëdha. Prandaj, mendimet e gjuhëtarëve, që shpeshherë janë kontradiktore, na bëjnë të gyojmë, se çështja e infinitivit në gjuhësinë shqiptare është e një rëndësie të veçantë. Ata të cilët mendojnë se paskajorja është një kategori foljore, e cila është zhvilluar në familjen e gjuhëve indoevropiane nuk janë të pakët. Mirëpo, mënyra e formimit të saj në këtë familje të madhe gjuhësh ka pasur një zhvillim me

drejtime të ndryshme, çfarë edhe përcaktimi i tipareve dalluese ose edhe i tipareve të përbashkëta ndërmjet tyre është mjaft i vështirë për t'u shpjeguar.

Tentime për shpjegimin e kësaj forme foljore, sidomos në rrafshin e gjuhëve ballkanike kanë bërë: Jozef Brajan, Helmut Shaller, Kristian Sanfeld, Selman Riza, Eqrem Çabej, Besim Bokshi, Holger Pedersen, Olberg Herman, Shaban Demiraj, Mahir Domi, Vaclav Cimohovski, Idriz Ajeti, Mehmet Çeliku, Koleç Topalli, Jup Kastrati, Bahri Beci. Rexhep Ismajli, Tomor Osmani, L. Mario Savoja, Imri Badallaj, Seit Mansaku, Françesko Altimari, Nuhi Veselaj e ndonjë tjetër.

H. Pedersen²⁾ është i mendjes se ka ekzistuar një paskajore, që një një fazë të zhvillimit të saj është bërë unifikimi i formës së pjesores me format e paskajores. Format e pjesores: *pa pasur* dhe *do me thanë* i trajton si paskajore të mbarë shqipes. I këtij mendimi është edhe N. Jokl, K. Sanfeld e ndonjë tjetër.

I përmenda këta dy gjuhëtarë, sepse ata kishin bërë shpjegime të argumentuara, se shqipja ka pasur një paskajore me kuptim indoevropian, tezë kjo që disa gjuhëtarë, ndoshta më pak të thelluar në këtë problematikë e mohojnë një qëndrim të tillë.

Gjuhëtarë ynë i madh- Selman Riza, çështjes së paskajores i ka bërë një trajtim më të gjerë se të gjithë të tjerët, që ky origjinalisht e sheh infinitivale edhe pjesoren brenda formës së përcjellores: *tue punue* dhe *nxjerr*, se trajta *punue*, të cilën e njohim sot si pjesore, do të ketë qenë në shqipen e lashtë vetëm paskajore³⁾. Ndërsa Mahir Domi shprehet: *Trajta primare e paskajores së shqipes ka qenë gjitha gjasash e thjeshtë si ajo e gjithë gjuhëve motra indoevropiane*⁴⁾. Ky më tutje shton, *se trajtën e paskajores së thjeshtë të lashtë duhet ta kërkojmë ndër trajtat e sotme të pjesores, që me kohë i kanë përzier funksionet e pjesores me ato të paskajores dhe kështu u formua paskajorja analitike, që padyshim trajtat e thjeshta mbeten si trajta pjesoreje*.

Pra, Domi shpreh mendimin e tij se paskajorja me *me* ka qenë e tërë shqipes, sepse mbeturinat e këtij mjeti gramatikor nuk mungojnë edhe në toskërishten.

Edhe Dhimitër Kamarda në shqipen ka parë një paskajore sintetike me formantin *–me* (*me shkrueme*). Ndërsa Gustav Vajgandi emrat prejfoljorë të tipit *ndihmë* dhe emrat përpjesorë të tipit: *e shkumja*, *e dridhmja* etj., i trajton si infinitiva të substantivuar.

Gabinski prapashtesën *–me* të Kamardës e vë në dyshim, që kjo prapashtesë të ketë pasur lidhje me sufiksën participor *–m* të gjuhëve të tjera indoevropiane⁵⁾.

E. Çabej ka besuar në praninë e një infinitivi sintetik në shqipen, por duke mos e përzier këtë me format e pjesores të çfarëdo faze qofshin ato⁶⁾.

Shaban Demiraj në tipin e e formave *me ba* sheh ekzistimin e paskajores, që me kohë këto forma janë zhvilluar si zëvendësime të formave të një paskajoreje më të vjetër, e cila mundur të jetë zhdukur. Mirëpo, Besim Bokshi në studimin e tij

monografik: *Paskajorja e shqipes - vështrim diakronik* na duket se më shumë se gjithë të tjerët është thelluar edhe rreth çështjes së paskajores në shqipen, për të cilën shton: Argument kryesor në të cilin bazohet mendimi, se shqipja e fazës së dokumentuar ka krijuar dëshmi të pranishëm së dukshme të paskajores sintetike, e cila del me formën e pjesores së sotme me burim nga participi pasiv i perfektit, merret në radhë të parë bashkëvjajtja e kësaj forme foljore modale *dubet* dhe *do: dubet thënë – do thënë, dubet larë – do larë*, duke pasur parasysh se në gjuhët neolatine perëndimore këto folje ndiqen nga infinitivi. Nga kjo, shton më tutje Bokshi, u konkludua pastaj edhe për format: *me la – pa la*, apo *pa larë*, si të përbëra burimisht nga paskajorja me parafjalë e u nxor në vijim i njëjti përfundim për përcjelloren: *tue la – duke larë*⁷⁾

Gjergj Pekmezi mendon se trajta e shkurtër e pjesores brenda kohëve të përbëra është e besueshme të jetë formë e shkurtuar e infinitivit të lashtë⁸⁾. Edhe Xhuvani është kategorik në bindjen e tij, se shqipja e lashtë ka pasur një paskajore sintetike të tipit indoevropian.

Ndërsa Gabinski në një studim të tij shton: *Analiza kritike e argumenteve për dhe kundër infinitivit të lashtë të shqipes (apo protoshqipes) të çfarëdo infinitivi më të vjetër, përveç atij të përdorshmit nuk ka*⁹⁾

Për këtë infinitiv, që Gabinski e quan të përdorshëm, për Çabejn skema e paskajores *me+pjesore* nuk ka qenë e mbarë shqipes dhe të jetë zhdukur pastaj në toskërishten¹⁰⁾

Disa gjuhëtarë pa një analizë dhe shpjegim të thukët për këtë mjet të rëndësishëm gramatikor e mohojnë ekzistencën e mëhershme. Të tillët janë: Bariqi, Ajeti, Majeri e Hahni. Përkundër këtyre gjuhëtarëve që po sa i zëmë ngoje, F. Altimari është i bindur thellë për ekzistencën “...e një arketipi të përbashkët **me + pjesore**, dikur pjesë e shqipes së përbashkët e me gjasë, zëvendësues i një forme më të vjetër sintetike të realizuar me anë të pjesores sipas modelit indoevropian, *dubet* të jenë gjeneruar paralelisht në shqipen e përbashkët dy struktura perifrastike të paskajores: *për+me+pjesore* dhe *për+të+pjesore*, dikur të shtrira në të dy dialektet edhe në arbërisht, dëshmi kejo e një faze më të njësuar të shqipes, të paktën që në shekujt e parë të dokumentimit të saj. më vonë këto trajta të paskajores pësuan ngushtim të funksioneve¹¹⁾. Ja edhe disa shembuj të paskajores të shtruar nga ky gjuhëtar arbëresh, të cilat forma infinitivale janë vjelë nga autorët arbëreshë dhe arbërishtfolës të sotëm me strukturën: **me+pjesore**.

Nga Nikollë Filja në veprën *Kodi i Qeftit (Il Codice Chientino): E sa tona t'mira t'jenë gjithë të tijët e s'jan me thënë*, fq. 143). *Andaj ka mo ardburë, mo gjukuar të gjalltë e të vdekurit, po aty*, fq. 47). *Ka mo ardburë Krishti papa në jetë*, po aty, f.47. *Sbërbiset e mia q s'janë për me o thënë*, fq. 50.

Nga Nikollë Keta në veprën *Urtisa e Kërshtë e Ndëlgisa e Barisisë të gjith Rruzullimit:*

Vjen me rarë, fq. 64. *Desb me mbësuarë të marrëvet jevre, po aty*, fq.58. *Për mbi malet kanë me mbetur ujërat*, fq. 88. *Këtu mbarë kam me porositurë*, fq. 66; Në të folmen e Firmës F. Altimari regjistroi personalisht forma të paskajores të tipit: **për me ngrënë, për me pîr**. Edhe në të folmen e Lungrës i ka gjetur shembuj me të njëjtat forma si në Fermë: **pri me ngrënë, pri me pir**. Edhe në Shën Vasil janë të përhapura ndërtimet analoge si: **prima ngrôn** (□ për me ngrënë) e **prima pîr** (□ **për me pir**)¹²⁾ etj.

Nga të gjitha mendimet dhe gjykimet e gjuhëtarëve të zënë ngoje më sipër për paskajoren, mendojmë se shpjegimi i Selman Rizës më bindshëm qëndron, i cili thotë: *Nuk ka dyshim trajta punue, të cilën na sot e njohim, vetëm si particip, do të ketë qenë në shqipen e lashtë vetëm infinitiv¹³⁾*.

Në anën tjetër edhe vetë funksionet sintaksore të cilat shprehen dhe ndërtohen me paskajore, bindshëm përforcojnë mendimin e gjuhëtarëve: N. Joklit, K. Sanfeldit, S. Rizës, B. Bokshit e ndonjë tjetrit, që kësaj radhe këtu më poshtë po i shtrojmë disa shembuj, ku shihen qartë funksionet sintaksore të paskajores gege.

Ndërtime qëllimore: *Kambët janë me ecë*.

Ndërtime krahasore: *Nuk ashtë aq i keq sa mos me i zanë besë*.

Ndërtime përcaktore: *Nuk e ka fort shprehi me u tallën me njerëz*.

Ndërtime pyetëse: *Ma mirë me mësue apo me u sjellë udhëve?*

Ndërtime kryefjalore: *Nuk i kujtobet se me cilin kishte me këndue*.

Rrethanor kohe të paraprirë me **para se**: *Matu mirë para se me folë*.

Ndërtime kushtore: **Me e pa**, *kisbit me u çmendë*.

Ndërtime lejore: *Sado vonë me ra, ai ngribet gjithmonë herët*.

Ndërtime rrjedhore: *Derdhi sa mujti një rreth vetes, aq sa m'u ba një liqe*.

Ndërtime të së ardhmes: *Duhet me ia ba një dhuratë për martesën e djalit*.

Në shembullin: *Ma mirë me krye punë apo me pushue?* Toskërishtja këtë funksion sintaksor e shpreh me vetën e dytë të lidhores: *Më mirë të kryesh punë apo të pushosh?* Çfarë shihet qartë, se kjo vetë e dytë e lidhores toske (të *pushosh*) i ka humbur lidhjet kuptimore me vetën e dytë të lidhores së mirëfilltë, që pa dyshim në këtë rast është funksionalisht e barasvlershme me paskajoren gege të tipit *me punue*.

Pra, shikuar në përgjithësi përhapja apo përdorimi i paskajores gege na del me shumë funksione sintaksore, që si e tillë tregon se është, sa e lashtë, aq edhe e përhapur dendur në tri të katërtat e folësve të shqipes. Atëherë, pse kundërshtohet inkuadrimi i paskajores në shqipen e sotme standarde, kur argumentet flasin në favor të saj.

Referencat:

1. J. Gjinari, Dialektologjia shqiptare, Tiranë, 1988, fq. 98.
2. H. Pedersen, IF – ANZEIGER, 91-93.
3. S. Riza, Sistemi foljor i letrarishtes shqiptare bashkëkohore, Tiranë, 1994, fq. 94.
4. M. Domi, Morfologjia historike (Konspekt leksionesh), Tiranë, fq. 67.
5. M. Gabinski, Pojavljenje i utrata pervičnogo albanskogo infinitiva, Leningrad, 1990, Fq. 9.
6. E. Çabej, Studime filologjike, 3, 1975, fq. 55.
7. B. Bokshi, Pjesorja e shqipes – vështrim diakronik, Prishtinë, 1998, fq. 11.
8. Gj. Pekmezi, Grammatik der albanesischen Sprache, Wien, 1908, s. 130
9. M. Gabinski, Po aty, fq. 35.
10. E. Çabej, Po aty, fq. 56.
11. F. Altimari, Vëzhgime gjuhësore dhe letrare arbëreshe, Prishtinë, 2002, fq. 114.
12. F. Altimari, Po aty, fq. 104, 105, 111.
13. S. Riza, Tri monografina albanologjike, Tiranë, 1944, fq.125.

Haki HYSENAJ

SHKARJE ORTOEPIKE NË SHQIPEN E FOLUR DHE STATUSI I TYRE

Abstrakt

Në gjuhën e folur standarde tradicionalisht “gabime” konsiderohen shkarjet ortoepike nga norma. Më këtë punim provojmë të vëmë në pah këto “gabime”, natyrën e tyre, shtrirjen, si dhe përcaktimin nëse janë të rastësishme ose të shkaktuara nga rregulla e faktorë gjuhësorë e jogjuhësorë.

Shkarjet ortoepike burimin e kanë kryesisht te shqiptimi dialektor i folësve të gjuhës standarde, prandaj në këtë punim ato trajtohen nga aspekti i studimit të gjuhëve në kontakt.

Hulumtimi tregon se këto “gabime” janë natyrash të ndryshme dhe se realizohen edhe në situata formale. Disa variante dalin në raporte barazie midis vete, prandaj edhe i kundërvihen njëra-tjetrës për të zënë pozitë prestigji.

Me këtë punim provojmë për të saktësuar statusin e këtyre shkarjeve, nëse vërtet janë “gabime ortoepike”, apo të njëjtat rrinë në raporte konkurrence me trajtat e normuara.

Qëllimi i hulumtimit ka përcaktuar si fushë hulumtimi shqipen e folur standarde në masmediat shqiptare.

Fjalë kyçe: gjuha standarde, gabime ortoepike, shkarje nga norma, varietete dialektore, kontakte gjuhësore, shqiptim prestigjioz, shqiptim dialektor.

1. Hyrje

Shqipja standarde, në variantin e folur të saj, edhe përkundër insistimit se ka një normë të caktuar ortoepike (Dodi, 2004:209-233), më shumë se 40 vjet pas kodifikimit vazhdon të realizohet në formë varietetesh shqiptimore. Këto varietete kryesisht identifikohen me gjuhën e folur standarde në dy vernakularët kryesorë të saj, në atë të Tiranës dhe të Prishtinës. Këto dy varietete në strukturën e tyre përmbajnë elemente gjuhësore jostandarde, në radhë të parë të natyrës fonetike. Këtu dalin në pah variacione shqiptimore tingujsh të ndryshëm dhe dukuri të caktuara fonetike të

karakterit dialektor, të cilat burimin e kanë në kontaktet gjuhë standarde-gjuhë dialektore, por edhe në burime të tjera të karakterit shoqëror.

Trajtave jonormative, që dalin në dy varietetet e përmendura, duhet shtuar edhe trajtat dialektore që tashmë kanë fituar prestigj nga influenca ideologjike e elitës politike, e ushtruar gjatë dhe pas procesit të standardizimit të shqipës. Në anën tjetër, burimin e një pjese të këtyre trajtave duhet kërkuar edhe të fakti se shqipja standarde, në një pjesë të hapësirës shqipfolëse, asnjëherë nuk ka arritur të përvetësohet në shkallë të kënaqshme.

Grupi i parë i gabimeve është karakteristik për të folurën e Tiranës, ndërsa grupi i dytë karakterizon të folurën e Prishtinës. Në këtë mes ka mbetur i pahulumtuar një grup i veçantë trajtash jonormative. Këto trajta shquajnë gjuhën e folur dhe të shkruar të një grupi të caktuar njerëzish të cilët tashmë njihen si “refuzues” të kodit standard. Në fakt, ky grup që provon të rikthejë gegërishten letrare në përdorimin publik, bazuar në vëzhgime josistematike, shpesh realizon shkarje të dyfishta për të njëjtën njësi, sepse gjuha standarde ka ndikuar në rrafshimin e dallimeve dialektore në mbarë shqipën.

Nisur nga këto realitete gjuhësore korpusi i këtij punimi është hartuar mbi bazën e gjuhës së folur në masmediat e Tiranës e të Prishtinës. Duke bërë matje në emisione të ndryshme kemi përshkruar “mozaikun” e shkarjeve nga norma e shqipës së folur standarde në situata formale dhe më pas kemi provuar të përcaktojmë statusin e tyre.

Çështja e përcaktimit të statusit të shkarjeve ortoepike paraqet vështirësi interpretimi (Dulay,1982), njëjtë siç del e vështirë edhe çështja e përcaktimit nëse një njësi e caktuar gjuhësore e karakterit dialektor, me dominim përdorimi ndaj trajtës së normuar, do të duhej trajtuar si “gabim ortoepik”, apo si trajtë që kërkon vend në sistem, pra si trajtë që ka fituar prestigj në përdorim ndaj trajtës së normuar, por jo edhe status të definuar me rregulla gjuhësore.

Ndërkaq, sa i përket qëndrimit të folësit ndaj shkarjeve ortoepike gjatë procesit të të folurit, Dulay shprehet se folësi realizon trajta jonormative të shumtën pa menduar për performancën dhe normën shqiptimore dhe pa menduar as për shkakun e përdorimit të tyre (Dulay, 1988: 139). Gjuha e folur reflekton mendimin, jo tekstin e shkruar.

Zhvillimet e sotme gjuhësore, pavarësisht kodifikimeve të gjuhëve, në këtë mes edhe në shqipë, dalin me një seri specifikash, gjuhësisht interesante nga pikëpamja e kontakteve gjuhë standarde-gjuhë dialektore, si dhe nga aspekti socio e psikolinguistik.

Krahas zhvillimeve të reja sociolinguistike edhe në hapësirat shqiptare, varietetet e përmendura, ai i Tiranës dhe ai i Prishtinës, mendohet se kanë fuqizuar

përdorimin e variacionit dialektor, i cili edhe më parë funksiononte si nënsistem jostandard, por me prirje prestigji. Për më shumë, tashmë janë evidentuar edhe tendenca të reja vetëstrukturuese në kuadër të standardit ekzistues (Mimoza Karagjozi-Kore, 2011: 205-2015 & Linda Shamku-Shkreli, 2007). Në Kosovë variacioni gjuhësor është më i thellë (Munishi, 2009: 95) dhe më heterogjen, prandaj shkarjet nga norma ortoepike e shqipes standarde këtu numerikisht janë më të shumta dhe në shumicën e rasteve reflektojnë identitete të caktuara.

2. Subjektet folëse dhe korpusi

Duke pasur parasysh se qëllimi i këtij punimi është hulumtimi i përdorimit të shqipes standarde në domenin publik ne kemi përzgjedhur disa subjekte folëse, gjuhën e të cilave e kemi analizuar nga prizmi i hetimit dhe i përsëkrimit të shkarjeve ortoepike nga norma e shqipes standarde. Për të folurën e Tiranës kemi përzgjedhur gjuhën e folur të 7 figurave politike e kulturore, si dhe ligjërimin e folur të 2 moderatorëve televizivë¹, ndërsa për të folurën e Prishtinës kemi përzgjedhur gjuhën e 2 moderatorëve televizivë dhe gjuhën e 17 pjesëmarrësve në 4 debate televizive, të zhvilluara në dy televizione kombëtare, 2 në Koha Televizion (KTV) dhe 2 në Radio Televizionin 21 (RTV 21)². Këto subjekte dallojnë midis tyre për profesionin dhe shkallën e ngritjes intelektuale. Kohëzgjatja e emisioneve sillet nga 40 deri në 50 minuta, që do të thotë se të gjitha emisionet së bashku kanë zgjatur më shumë se 3.5 orë.

Emisionet e përzgjedhura për të folurën e Prishtinës janë “Rubikon” i KTV-së dhe “Click” i RTV 21. Që të dyja janë të karakterit interaktiv. Përzgjedhje e tyre është bërë për faktin se në këto emisione ndodh zhvendosja e stilit të të folurit në boshtin formal, d.m.th. pjesëmarrësit në studio, varësisht nga situata dhe natyra e debatit rrëshqasin nga përdorimi i gjuhës standarde në gjuhën e vernakularit, apo në të folurit të zakonshëm të individit (Munishi, 2009: 99). Pikërisht kjo situatë vë në pah numrin edhe frekuencën e përdorimit të ndryshoreve dialektore dhe variacionin shqiptimor, të cilat janë trajtuar dhe vazhdojnë të trajtohen si shkarje ortoepike nga norma e gjuhës standarde. Ndërsa emisionet televizive për të folurën e Tiranës janë të natyrës së debatit, monologëve dhe të intervistave (Hysenaj, 2015: 433).

Situatat e ngjashme, por ndonjëherë në emisione të ndryshme nga këto të masmediave të Prishtinës, janë shpërfaqur edhe në masmediat e Tiranës. Por, në këtë

¹ Shih: Hysenaj, Haki; Ndikimi i ideologjisë në varietetet e shqiptuara të shqipes, në Seminari XXXIII Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, Prishtinë, 2015, f. 433.

² Shih linqet në fund të punimit.

varietet shqiptimor ndryshoret dialektore dhe variacioni shqiptimor i tyre, siç do të shihet në vijim, në radhë të parë janë pasojë e ndikimit të gjuhës së elitës politike gjatë dhe pas procesit të standardizimit dhe e kontaktit gjuhë standarde-gjuhë dialektore. Këto tipare jonormative kanë fituar prestigj kundruall trajtave të normuara (Hysenaj, 2015: 429-437). Në Kosovë, siç u tha edhe një herë tjetër, variacioni gjuhësor është më i madh dhe më heterogjen, pavarësisht se varieteti i folur i shqipes standarde për bazë ka varietetin e shkruar. Shqipja standarde në Kosovë është mësuar në rrethana të tjera nga ato të Shqipërisë.

3. Sfondi

Në komunikimin gojor në gjuhën standarde disa nga njësitë fonetiko-fonologjike realizohen në formë variacionesh ortoepike, prandaj hulumtimi ynë për bazë ka pasur gjuhën standarde të realizuar në kufijtë gjuhësorë: të shkruar-të folur. Ortoepia e shqipes bazohet në normën ortografike.

Shkrimi jo vetëm në rastin e shqipes, por edhe në rastet e gjuhëve të tjera të standardizuara, nuk ka përmbushur gjithnjë nevojat e ligjërimit të folur (Subačius, 2011). Këtu duhet kërkuar njërin prej shkaqeve të shfaqjes së shkarjeve ortoepike në gjuhët e standardizuara.

Nëse njërive fonetiko-fonologjike të karakterit jonormativ, që dalin në dy varietetet kryesore të gjuhës së folur standarde shqipe, ua shtojmë edhe gabimet e natyrës latente (Jakobsoni), të cilat qëndrojnë të fshehura në ndërdijen e folësve, e që kanë prestigj të mbuluar, pyetja e parë që shtrohet është nëse ato janë shmangie të qëllimshme nga norma, janë të rastësishme dhe pa ndonjë rregullsi shfaqjeje, janë pasojë e njohjes së dobët të gjuhës standarde, apo në paraqitjen e tyre ndikojnë “ligje” të caktuara.

Për të gjetur përgjigjet e kërkuara në këtë hulumtim na ka ndihmuar analiza e raporteve gjuhë standarde-idiomë jostandarde, në njërin anë dhe analiza e shkallës së ndikimit të gjuhës së folur i elitës politike gjatë dhe pas procesit të standardizimit të shqipes. Dy kategoritë e para bashkekzistojnë dhe përdorimi i tyre u nënshtrohet kërkesave të caktuara shoqërore, prandaj interferojnë midis tyre. Ky interferim, në variantin e folur të gjuhës standarde, posaçërisht në masmediat audiovizuale, prodhon variacione të ndryshme gjuhësore, në radhë të parë të karakterit fonetik.

Analiza e parë mundëson përshkrimin e shkarjeve ortoepike në gjuhën e folur standarde të vernakularit të Prishtinës, ndërsa e dyta mundëson përshkrimin e gjuhës së folur standarde të vernakularit të Tiranës. Këndvështrimi i parë nuk përjashtohet as në studimet e ngjashme për shqipen e folur standarde edhe në Shqipëri, sepse këto

kontakte, në rrethanat e reja shoqërore, kanë krijuar kushte të volitshme për shpeshitim të përdorimit të variacionit dialektor.

Kontakti midis dy ose më shumë idiomave, në rastin kur ndonjëra është e standardizuar, kontakti ka veti ndërmjetësimi së paku në dy çështje: në kristalizimin e prestigjit të idiomës përkatëse dhe në faktin se gjuhë dhënëse është gjuha standarde. Përgjithësisht, kontakti gjuhësor i dy idiomave dialektore me gjuhën standarde shqipe mundëson prodhimin e variacioneve shqiptimore. Këto variacione janë rezultat i trysnisë së idiomës dialektore mbi kodin standard dhe bazuar në përdorimin e tyre ato mund të krijojnë njësi konkurruese, që kërkojnë prestigj ndaj trajtave të normuara dhe njësi të karakterit alternues, të cilat nuk kanë ndonjë prestigj dhe as formë të njëjtë.

Në rastin e Tiranës variacioni dialektor është i karakterit konkurrues, ndërsa në rastin e Prishtinës ka karakter alternues. Të parat kanë fituar prestigj kundruall trajtave normative (Hysenaj, 2015), ndërsa të dytat alternojnë me trajtat e normuara sa herë që folësi kujdeset për përdorimin e gjuhës standarde.

Midis variacioneve konkurrenente edhe atyre me karakter alternativ ka dallime thelbësore. Variacionet konkurrenente, që janë karakteristike për variantin e folur të vernakularit të Tiranës, si trajta me /ë/ në vend të /e/-së, trajtat me /ll/ në vend të /l/-së, neutralizimi i zëshmërisë së bashkëtingëlloreve në fund të fjalës (Hysenaj, 2015: 435) tashmë janë trajta me prestigj kundrejt trajtave preskriptive, prandaj përdoren rregullisht në vend të trajtave të normuara. Hulumtimi ynë tregon se këto variacione burimin e kanë te ndikimi i gjuhës së elitës politike gjatë dhe pas procesit të standardizimit të gjuhës, si dhe te kontaktet e natyrshme të gjuhës standarde me dialektin e toskërishtes. Kësaj duhet shtuar edhe përzgjedhjen e bazës dialektore për kodin standard (Byron, 2012).

Në anën tjetër, variacionet alternuese, siç është thënë edhe një herë, janë karakteristike për gjuhën standarde shqipe të folur në Kosovë, veçanërisht në Prishtinë. Këto variacione shqiptimore nuk janë të njëtrajtshme dhe nuk kanë fituar prestigj në komunikimin gojor në situatat formale të ligjërimit në gjuhën standarde. Ato realizohen në trajta të ndryshme edhe përbrenda grupit që i takojnë, duke reflektuar kështu, në radhë të parë, përkatësinë dialektore e krahinore të folësve, mosnjohjen e duhur të gjuhës standarde dhe në raste të rralla edhe refuzimin e vetëdijshëm të kodit standard.

4. Rasti i Tiranës

Analiza e gjuhës së folur e subjekteve të përzgjedhura për varietetin e folur të Tiranës ka vërtetuar hipotezën se gjuha e elitës politike në Shqipëri ka ndikuar në zhvillimin e shqipes së normuar, gjatë dhe pas procesit të standardizimit.

Variacioni shqiptimor është hetuar me rastin e identifikimit dhe të përshkrimit të alternantëve fonetikë: /e/-/ë/; /y/-/i/; /l/-/ll/, /r/-/rr/ dhe të neutralizimit të bashkëtingëlloreve të zëshme në fund të fjalës.

Rregullat e drejtshkrimit të gjuhës shqipe, mbi bazë të të cilave pretendohet se është ngritur norma ortoepike e shqipes standarde (Dodi, 2004: 209) përcakton qartë shqiptimin e elementeve të para të këtyre fonemave, të cilat në gjuhën e folur standarde në masmediat e Tiranës dalin në raporte konkurruese në kuadër të vargut fonematik. Nga ana tjetër, rrafshimi i kundërvënies **r/rr** dhe shurdhimi i bashkëtingëlloreve të zëshme në fund të fjalës janë elemente po ashtu të karakterit dialektor, të ngritura në trajta me prestigj nga faktorë të njëjtë.

Se këto trajta përdoren gjithnjë në ligjërimet publike në Shqipëri dëshmojnë matjet e bëra për punimin “Ndikimi i ideologjisë në varietetet e shqiptuara të shqipes” (Hysenaj, 2015: 429–439).

Prestigji i këtyre variacioneve përballë trajtave të normuara shtron pyetjen nëse ende këto variacione duhen konsideruar shkarje nga norma, “gabime ortoepike”, apo duhet menduar për fatin e tyre në sistemin fonetiko-fonologjik të shqipes standarde.

5. Rasti i Prishtinës

Në varietetin e gjuhës së folur standarde në Kosovë dalin variacione të tjera, të cilat për dallim nga variacionet e gjuhës së folur në vernakularin e Tiranës janë të karakterit alternues, Gjatë procesit të prodhimit gjuhësor (Paçarizi, 2011) të shumtën e rasteve ato reflektojnë përkatësinë dialektore e krahinore të folësve, ndonjëherë edhe mosnjohjen e duhur të gjuhës standarde. Në raste të rralla përdorimi i këtyre variacioneve dialektore reflekton edhe refuzimin e vetëdijshëm të kodit standard nga një grup i caktuar shoqëror.

Këto pohime rrjedhin nga analiza e gjuhës së folur të dy moderatorëve televizivë dhe të 17 subjekteve të tjera folëse, pjesëmarrës në debatet e përmendura. Pritshmëria ka qenë që subjektet folëse kanë njohuri të kënaqshme të gjuhës standarde shqipe. Vetëm një prej pjesëmarrësve në njërin prej debateve të përzgjedhura për korpus të këtij punimi ka folur gjithnjë gjuhën dialektore, prandaj sekuencat e angazhimit të tij kanë mbetur jashtë interesimit tonë.

Moderatorët e përzgjedhur³ shquhen për fillimin e emisioneve në gjuhën standarde. Në këtë etapë variacioni shqiptimor i tyre i afrohet shumë varietetit model të Prishtinës, ndërkohë që gjatë emisionit ndërrojnë stilin e të folurit, duke kaluar nga shqiptimi standard në shqiptim dialektor, jo për ndonjë solidarizim gjuhësor me bashkëbiseduesit, por më shumë për shkak të “*latencës*” së përmendur dhe të identitetit të tyre dialektor. Ndërrimin e stilit shpesh e kushtëzon edhe situata dhe dinamika e bisedës.

Në rastin e Prishtinës hulumtimi ynë është përqendruar në përshkrimin e variacioneve nyjetimore të zanoreve, në mënyrë të veçantë të tingujve /a/ dhe /e/, të gjatësisë e të hundorësisë, si dukuri fonetike të gegërishtes, pastaj në nyjetimin e bashkëtingëlloreve qiellzore /q – gj/, të afrikateve /ç – xh/ dhe të dridhëseve /r – rr/.

Analiza e gjuhës së subjekteve tona ka treguar disa realitete gjuhësore tipike për gjuhën e folur standarde shqipe në Kosovë.

Këto realitete mund të përshkruhen me këto të dhëna: shqipja e folur në masmediat e Prishtinës shquhet për nyjetime nga më të ndryshmet të tingujve zanorë, në radhë të parë të zanores **a** dhe **e**, të cilat dalin në variacione të ndryshme, varësisht nga përkatësia dialektore, pastaj për ruajtjen e gjatësisë funksionale të zanoreve, tipar ky i gegërishtes. Shumica e pjesëmarrësve në debate, madje edhe moderatorët, gjatë procesit të komunikimit gojor kanë realizuar zanore të gjata për të dalluar kuptimet e fjalëve me përbërje të njëjtë fonematike. Kjo ndodh për faktin se gjatë të folurit dominon mendimi, ndërsa gjatë të lexuarit shkrimi. Pjesëmarrësit në debate në asnjë rast nuk kanë lexuar.

Subjektet folëse kanë realizuar edhe fonema zanore me timbër hundor. Intensiteti i hundorësisë ka dalluar nga subjekti në subjekt dhe realizimi i saj shpesh është varur nga pozicioni fonetik i zanoreve. Në asnjë rast nuk kemi gjetur që kjo dukuri fonetike të kryejë funksione fonologjike, gjë që vërteton tezën se ky tipar tashmë edhe në gegërishten verilindore ka marrë prirjen gjithnjë e më të shpejtuar të bjerrjes së tërësishme nga sistemi. Ndërkaq, timbri i kushtëzuar nga pozicioni fonetik dhe nga përkatësia regjionale e pjesëmarrësve në debate nuk ka paraqitur ndonjë variacion shqiptimor që do të mund t'i përshkruhej së folmes për të cilën po flasim, Prandaj, këtu përlligjet mendimi se timbret krahinore në shqiptim nuk konsiderohen thyerje të normës letrare (Shkurtaç, 2003: 233-234).

Matjet e bëra për përdorimin e shqipes standarde në Kosovë kanë treguar se dy moderatorët e përzgjedhur si subjekte folëse dhe 17 pjesëmarrësit në debatet e përmendura, në të gjitha rastet e përdorimit, kanë rrafshuar opozicionin midis

³ Shih listën e moderatorëve dhe të subjekteve folëse në fund të punimit.

qiellzoreve /q – gj/ dhe afrikateve /ç – xh/, duke bërë kështu sistemin fonetiko-fonologjik të shqipës së folur standarde më të varfër për këtë kundërvënie fonologjike. E njëjta situatë është shënuar edhe për kundërvënien **r/R**, ndonëse këto dy fonema dalin të realizuara në disa variante, si në Prishtinë ashtu edhe në Tiranë.

Në të dy vernakularët dominon prirje e ngjashme për “prodhimin” e një tingulli të ri, i cili duket se “synon” të zërë vendin e këtyre dy fonemave. Në të dy rastet variacioni i përmendur është më shumë i karakterit alternues e jo konkurrues. Madje, si në Shqipëri ashtu edhe në Kosovë, në gjuhën e folur standarde, në radhë të parë në mediet audiovizuale, hetohet nyjëtimi i një foneme të vetme dridhëse /ɾ/, të cilin ne e identifikojmë si variant “i ndërmjetëm”, nyjëtimi i së cilës qëndron midis nyjëtimeve të këtyre dy fonemave. Varietetet shqiptimore të saj janë të ndryshme dhe varen nga shumë faktorë.

Rrafshimi i kësaj kundërvënieje, është pasojë e ekzistimit të një numri të vogël çiftesh minimale, por edhe e prirjes së folësve për identitet të caktuar social.

Megjithatë, analiza e materialeve të shfrytëzuara për këtë punim ka treguar se shqipja standarde, e përdorur në domenin publik (në masmediat audiovizuale në Tiranë dhe në Prishtinë), shquhet për trajta ortoepike jonormative, por me dominim përdorimi, të cilat kryekëput lidhen me formën e jo me përmbajtjen e njëjësive gjuhësore.

Përfundime:

Mbi bazën e këtyre matjeve kemi arritur në këto përfundime:

1. Variacionet ortoepike në planin fonetiko-fonologjik në shqipen standarde, duke qenë se burimin e kanë te kontaktet gjuhë standarde-gjuhë dialektore, duhen konsideruar si shkarje jo të qëllimshme dhe pa ndonjë rend të caktuar.
2. Variacionet ortoepike janë dyfarëshe. Në të folurën e vernakularit të Tiranës ato janë të karakterit konkurrues, çka do të thotë se trajtat jopreskriptive kanë fituar prestigj ndaj trajtave preskriptive, ndërsa në të folurën e vernakularit të Prishtinës këto variacione janë të karakterit alternues, që do të thotë se përdorimi i njërit a tjetrit variacion është i lirë dhe jo i stabilizuar.
3. Krahasuar me variacionet konkurrenente variacionet alternuese numerikisht janë më të shumta dhe për nga trajta edhe më heterogjene.
4. Trajtat konkurruese, që tipizojnë varietetin e gjuhës së folur standarde në Tiranë, burimin e kanë në ndikimin e gjuhës së elitës në procesin e

standardizimit të shqipes, si dhe në kontaktet midis gjuhës së normuar dhe idiomës dialektore, toskërishtes.

5. Trajtat alternuese, që janë karakteristike e shqipes së folur në Prishtinë, burimin e kanë në kontaktet gjuhësore: gjuhë standarde-dialekt dhe në mosnxënien e kënaqshme të standardit të folur, si dhe te përdorimi i gjuhës në mënyrë origjinale (Lawrence, 2004) nga pjesëmarrësit në debate.

Vështruar nga aspekti i moscenimit të standarditetit të normës (aspekti preskriptiv-Rugova, 2015: 502) këto variacione fonetiko-fonologjike do të duhej vazhduar të cilësoheshin si “gabime ortoepike”, mirëpo epërsia në përdorim dhe prestigji i trajtave të përmendura në varietetin e folur të shqipes standarde, në Shqipëri dhe në Kosovë, shtrojnë kërkesën e rivlerësimit të statusit të tyre. Përdorimi i këtyre variacioneve ortoepike në ligjërimin e folur në asnjë rast nuk ka vështirësuar marrëveshjen midis shqipfolësve.

Në fund të fundit edhe nëse vazhdohet të cilësohen si shkarje ose “gabime ortoepike”, situata e tanishme dhe evoluimi i gjuhës standarde na bën të besojmë se ato nuk do të eliminohen nga përdorimi. Në mos për asgjë tjetër, në rrethanat e reja të krijuara në hapësirat shqipfolëse, bartësit e këtyre varieteteve sigurisht se me vetëdije do t’i bëjnë rezistencë fshirjes së tërësishme të identitetit të tyre gjuhësor.

Referencat:

1. Dodi, A., (2004). *Fonetika dhe fonologjia e gjuhës shqipe*, ASHSH, Tiranë.
2. Dulay, W., (1982). In *Fargian*.
3. Kore, K., M. (2011). *Për një përmirësim të normës morfologjike në standard*, në Shqipja në etapën e sotme, Botimet Albanologjike, Tiranë.
4. Shkreli, L., Sh., (2007). *Standard dhe neostandard*, Çabej, Tiranë.
5. Munishi, Sh., (2009). *Media*, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë.
6. Hysenaj, H., (2015). *Ndikimi i ideologjisë në varietetet e shqiptuara të shqipes*, në Seminari XXXIII Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, Universiteti Prishtinës, Prishtinë.
7. Subaçius, D., (2001). *Written and spoken Standard*, Baltu Filologjia, Riga.
8. Byron, J., (2012). *Përzgjedhje midis alternativash në standardizimin e gjuhës dhe shkrime të tjera*, Dituria, Tiranë.
9. Paçarizi. Rr., (2011). *Shqipja standarde në parametrat psikolinguistikë*, K., Pen C., Prishtinë.
10. Shkurtaç, Gj., (2003). *Kabe dhe dukuri të kulturës së Gjuhës Shqipe*, Tiranë.

11. Lawrence, M., (2004). *Investigating the relation between idiolect and sociolect*, Netherlands.
12. Rugova, B. (2015). *Ideologjia e preskriptivizmit në gjuhën shqipe*, në Seminari XXXIII Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, Universiteti Prishtinës, Prishtinë.

Shtojcë:

Subjektet folëse për varietetin e Shqipërisë: E. Hoxha, R. Alia, F. Nano, G. Pollo, I. Kadare, B. Fevziu dhe Adi Krasta (Shih punimin: *Ndikimi i ideologjisë në varietetet e shqiptuara të shqipes*, në Seminari XXXIII Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, Universiteti Prishtinës, Prishtinë, 2015).

Subjektet folëse për varietetin e Prishtinës: Adriatik Kelemendi KTV, Leart Hoxha RTV 21

Rubikon 1: Rubikon 2:

Faredin Shehu Arsim Bajrami

Nora Hasani Llapashtica Blerim Rexha

Balsor Hoxha Isuf Thaçi

Ag Apolloni Dukagjin Popovci

Ilire Zajmi

Click 1: Click 2:

Riza Smaka Pal Lekaj

Fisnik Korenica Muharrem Nitaj

Muharrem Nitaj Arben Demhasaj

Driton Selmanaj Besnik Krasniqi

Linqet:

RUBIKON 1

Emisioni: Reformat e arsimit të lartë 20-05-2015

<https://www.youtube.com/watch?v=UONSvXN61qM>

RUBIKON 2

Emisioni: A KEMI BREZ TE RINJ SHKRIMTARESH? 04.06.2015

<https://www.youtube.com/watch?v=IIHwO6UW6cg>

CLICK 1

Emisioni: CFARE PRESIDENTI I DUHET KOSOVES 20.05.2015

<https://www.youtube.com/watch?v=mAV1PmMiEOw>

CLICK 2

Emisioni: Si matet pasuria e politikeve?! 03.06.2015

<https://www.youtube.com/watch?v=-L-6LkJxMeo>

Vjosa HAMITI, Blertë ISMAJLI

“Ju” DHE “ti”: FORMAT FORMALE DHE JOFORMALE TË ADRESIMIT NË DISKURSIN PUBLIK NË KOSOVË

0. Hyrje

Në këtë kumtesë do të analizohen format e adresimit me “ti” dhe “ju” në gjuhën shqipe, në diskursin publik. Format e adresimit në një gjuhë konsiderohen si veprim kyç i komunikimit të parë me bashkëbiseduesin. Përmes adresimit me “ti” apo “ju” krijohet afërsi por edhe distancë me bashkëbiseduesin. Përdorimi i formës formale është e ndërlidhur ngushtë edhe me politesën. Në fillim të këtij punimi do të paraqiten shkurt teoritë mbi politesën. Pastaj do të bëhet paraqitja e adresimit me përemrat vetor. Shumë gjuhë evropiane, si gjermanishtja “Du/Sie”, apo edhe frengjishtja “tu /vous”, dallojnë midis dy formave ashtu si në gjuhën shqipe. Mirëpo ka edhe gjuhë si p.sh. anglishtja, e cila tash e disa shekuj ka vetëm “you” për të dyja format.

Qëllimi i këtij punim është që të hulumtohet përdorimi i këtyre formave në diskursin publik në Kosovë. Për këtë arsye është përpiluar një korpus nga diskursi në media të Kosovës që shpërfaq përdorimin e këtyre formave të adresimit. Rezultatet e para tregojnë për një përdorim jo të kënaqshëm të këtyre formave. Gjatë intervistave në televizionet dhe radiot nacionale të Kosovës, gazetarët bëjnë gabime të mëdha sidomos në përdorimin e formës formale. Në shumicën e rasteve pyetja fillon me përemrin "ju" që kërkon foljen në vetën e dytë shumës, mirëpo folja pason në vetën e dytë njëjës, “ti”, që krijon tonin e një bisede joformale. Pjesë e analizës për këtë kumtesë bëhen edhe intervistat e transmetuara, që pastaj janë botuar edhe në mediet e shkruara, me ndërhyrje për të ndrequr shkarjet në përdorimin e gjuhës në të folur.

1. Pjesa teorike

1.1. Politesa

Politesa manifestohet në të gjitha format në një shoqëri dhe ka për detyrë rregullimin e bashkëjetesës së pjesëmarrësve të saj, përmes normave të caktuara nga shoqëria. Fenomeni i politesës është në njërin anë fenomen universal, sepse të gjitha

shoqëritë kanë si bazë mirësjelljen, e cila rregullon bashkëjetesën e një komuniteti. Mirëpo në anën tjetër nuk është universal sepse shoqëritë në botë dallojnë nga njëra tjetra jo vetëm përmes gjuhës, por sigurisht edhe kulturës dhe gjithsesi normave të përcaktuara të saj. Teoritë mbi politesën të hulumtuesve anglo-amerikan Brown/Levinson (1978), Lakoff (1979) dhe Leech (1983), të cilët konsiderohen si etërit themeltar të studimit modern të politesës, janë kryesoret në këtë fushë. Sado që e përkufizuar në forma të ndryshme, politesa përkufizohet si një tentativë për ta “ruajtur fytyrën” nga aktet e ndryshme që paraqesin kërcënim për të (krhs. Mills 2003: 6). Në këtë kontekst mund të përmendim shprehjet e shqipes “marr fytyrën”, “i pafytyrë”, “ruaj fytyrën” si shprehje pikërisht të mbrojtjes së një imazhi që folësi dëshiron ta ketë para të tjerëve ose të dëmtimit të imazhit të tjetrit. Pra, politesa mund të kuptohet si mbrojtje ose dëmtim imazhi. Brown/Levinson (1978) në teorinë e politesës, e cila ka influencë edhe sot, përdorin termin “face” (fytyrë) pozitive dhe negativet të politesës¹ si dy aspektet themelore të ndërveprimit social:

1. ‘positive face politeness’ (PF)²: duke theksuar ngjashmëritë e folësit me bashkëbiseduesin, si p.sh. duke përdorur emra përkëdhelës apo dialektin e bashkëbiseduesit etj.³

2. ‘negative face politeness’(NF)⁴: duke përdorur strategji shmangieje të cilat nuk përcaktojnë të adresuarin, p.sh. aty hyjnë të gjitha format ilokutive të përmbajtjes, modalizimet, nënvlerësimet etj.⁵

Kjo do të thotë deri sa PF kërkon njohje dhe konfirmim shoqëror, intonacioni i NF është që të ruaj lirinë dhe mos të kufizohet nga të tjerët. Mirëpo interesi i përbashkët i bashkëbiseduesve është që ta ruajnë “face” e njëri-tjetrit. Fenomeni i politesës studiohet nga shumë disiplina, si linguistika, antropologjia, pragmatika, psikologjia dhe sigurisht edhe nga sociologjia. Sipas Eelen (2001) efekti i politesës mund të arrihet përmes formave të ndryshme:

¹ Në këtë artikull do të përdoret termi “face” për t’iu referuar terminologjisë së përdorur nga Brown/Levinson si dhe për t’i ikur keqkuptimit që do të mund të shkaktonte përdorimi i fjalës “fytyrë”.

² Në vazhim do të përdoret kjo shkurtesë për “positive face”.

³ Brown/Levinson (1987: 61): “the positive consistent self-image or ‘personality’ (crucially including the desire that this selfimage be appreciated and approved of) claimed by interactants”.

⁴ Në vazhim do të përdoret kjo shkurtesë për “negative face”.

⁵ Brown/Levinson (1987: 61): “the basic claim to territories, personal preserves, rights to non-distraction- ie. to freedom of action and freedom from imposition”.

“The commonsense definition of politeness in terms of „proper behavior“ points out that politeness is not confined to language, but can also include non-verbal, non-linguistic behavior. [...] Politeness may manifest itself in any form of behavior, and even in the absence of behavior.” (Eelen 2001: iv)

Sipas Brown/Levinson (1978: 99) politesa shprehet në mënyrë verbale: përmes mjeteve të caktuara gramatikore apo edhe nga elemente leksikore si për p.sh. fjalitë ellipse, konstrukte në diatezën pësore, konstrukte nominale etj. dhe jo-verbale: përmes elementeve fonetike dhe sigurisht duke mënjanuar sjellje apo veprime të caktuara etj.

Tabela në vijim paraqet të përmbledhura strategjitë negative dhe pozitive të politesës që bazohet në Brown/Levinson (1987:101-211):

Negative:	Pozitive:
- Të jeshë i/e tërthortë	- Vë re/përcjell dëgjuesin
- Vë në dyshim/kufizoj	- Ekzagjeroj
- Jam pesimist/e	- Intensifikoj interesimin
- Minimizoj imponimin (me fjalë)	- Përdor shenjues brendagruporë
- Shfaq respekt/përulem	- Kërkoj dakordim
- Kërkoj ndjesë/pranoj imponimin/dëftoj mosdashje (ngurrim)/jap arsyet fort bindëse /lyp kërkimfalje	- Evitoj mosmarrëveshjen
- Impersonalizoj folësin dhe dëgjuesin (me përemra/diatezë pësore/nyje të pashquara/terma të referencës /distancim nëpërmjet pikëshikimit)	- Parasupozoj/shtroj/pohoj gjuhë të përbashkët
- Dëftoj akte kërcënimi të “face” fytyrës (angl. FTA, face-threatening acts) si rregull e përgjithshme	- Bëj shaka
- Nominalizoj	- Pohoj/parasupozoj njohje të/brengë për nevojat e dëgjuesit
- Shfaq borxhin publikisht	- Ofroj/premtoj
	- Jam optimist
	- Përfshij si folësin ashtu edhe dëgjuesin
	- Shpalos (apo kërkoj) arsyet
	- Pretendoj/pohoj reciprocitet
	- Jap dhurata (artikuj/bashkëndjenjë/mirëkuptim/bashkëpunim)

Brown/Levinson (1978) janë të mendimit se “face can be lost, maintained, enhanced and must be constantly attended to in interaction” (1987: 60). Kjo do të

thotë se Brown/Levinson nisen në teorinë e tyre, ku shumica e akteve të ligjërit shihen në mënyrë të natyrshme si kërcënim i “face-it” dhe pikërisht politesa shërben për zvogëlimin e këtij kërcënim. Ky aspekt përbën edhe pjesën qendrore të teorisë së tyre, sepse janë të mendimit që çdo bashkëbisedim (bashkëveprim) social i nënshtrohet një konflikti potencial, dhe për këtë arsye përdorin termin “face threatening act” (FTA)⁶ (Brown/Levinson 1978: 70). Tabela sjellë në mënyrë të përmbledhur teorinë e tyre për FTA të paraqitur përmes shembujve të akteve të kërcënimit për “face-in” (fytyrën) (Brown/ Levinson, 1987:65-68):

	FTA-të negative (Aktet negative të kërcënimit të “face-it”)	FTA-të pozitive (Aktet pozitive të kërcënimit të “face-it”)
Që prekin dëgjuesin	<ul style="list-style-type: none"> - Urdhra/kërkesa - Sugjerime/këshilla - Përkujtues -Kërcënime/ paralajmërimet/ sfidime - Oferta - Premtime - Komplimente/ xhelozit/ adhurim - Emocione të forta negative 	<ul style="list-style-type: none"> - Mospajtim/ kritikë/ përbuzje/ përqeshje/ ankesa/ qortime/ akuza/ fyerje - Kontradita/mospajtime/sfida - Emocione të dhunshme - Mosrespektim (mosbesim)/ tabu - Lajm i keq/ krekosje - Temë emocionale/ përçarëse - Mosbashkëpunim - Terma joadekuate të adresimit
Që prekin folësin	<ul style="list-style-type: none"> - Bëj falënderime - Marr falënderime/ kërkimfalje - Shfajësime - Pranim i ofertave - Reagime ndaj shkarjeve të dëgjuesit - Premtime/ oferta/ pa dëshirë/ bërë pa qejf 	<ul style="list-style-type: none"> - Ndjesë - Pranim i komplimentit - Rënie e kontrollit fizik - Vetëpërrulje/ denigrim - Rrëfime/ pranime të fajit - Rrjedhje emocionale/ mosnkontrollim i të qeshurës/ lotëve

1.2. Adresimi me politesë përmes përemrave

Format e adresimit pasqyrojnë marrëdhënie ndër personale, që tregon se kjo formë nuk studiohet vetëm në aspektin morfosintaksor por edhe atë pragmatik dhe sigurisht sociolinguistik. Këto forma përdoren në shumë gjuhë evropiane duke

⁶ Në vazhim do të përdoret kjo shkurtesë për “face threatening act”.

përfshirë edhe gjuhën shqipe. Duke pasur parasysh këto rregulla të politiesës, në këtë punim do të bëhet paraqitja e adresimit me politiesë përmes përemrave të shqipes, duke i krahasuar me gjuhën gjermane.

Për përdorimin e përemrave për adresimin e bashkëbiseduesit, si bazë do të shërbejë punimi i studiuesve amerikan Brown/Gilman “The Pronouns of Power and Solidarity” i vitit 1960, i cili konsiderohet si fillimi i studimit dhe hulumtimit të formave të adresimit përmes përemrave. Ky punim shërben deri në ditët e sotme si bazë për hulumtime e kësaj dukurie.

Sipas studiuesve amerikan Brown/Gilman zgjedhja e formave të adresimit përcaktohet nga ‘pushteti’ dhe ‘solidariteti’. Brown/Gilman përdorin simbolet **T** dhe **V** për diferencimin e formave të adresimit duke u nisur nga zhvillimi i dy përemrave të veçantë në gjuhët e Evropës bazuar në latinishten. T, shkurtësë e përemrit latin *tu*, shërben si simbol i përemrit për adresimin ndaj të njohurit (të afërmit) ndërsa V, shkurtësë e përemrit latin *vos*, si simbol i përemrit për adresimin me politiesë. Edhe në këtë punim do të përdoren këto simbole për gjuhën shqipe T për përemrin *ti* dhe V për përemrin *ju*. Sipas Brown/Gilman zanafilla e përdorimit të shumësit për adresimin e një personi në njëjës daton që nga kohërat e Perandorisë Romake, kur veta e dytë e shumësit ishte përdorur për t’iu adresuar perandorëve, pra “pushtetit”. Trajta e shumësit nuk i referohet shumësisë, por shumësia përdoret si metaforë e pushtetit:

„The usage need not have been mediated by a prosaic association with actual plurality, for plurality is a very old and ubiquitous metaphor for power.“ (Brown / Gilman 1971: 255)

Adresimi përemëror mund të jetë reciprok apo jo-reciprok. Në adresimin reciprok bashkëbiseduesit i drejtohen njëri-tjetrit me “ti” apo me “ju” që do të thotë përdoret vetëm njëra formë gjatë bisedës. Te adresimi jo-reciprok njëri nga bashkëbiseduesit i drejtohet tjetrit me “ju” kurse tjetri i drejtohet me “ti”. Skema në vazhdim e Brown/Gilman zbardhë këto raporte:




Figure 1 The two-dimensional semantic (a) in equilibrium and (b) under tension

Skema e marrë nga Brown/Gilman (1971: 259)

Sipas Brown/Gilman (1971: 255–257) më herët adresimi jo-reciprok shprehte raportin e “pushtetit”,⁷ që do të thotë njëri nga bashkëbiseduesit kishte status më të lartë në shoqëri apo edhe në familje dhe duhej të adresohej me formën-V kurse tjetri me status më të ulët me formën-T. Për të paraqitur mënyra e adresimit në Evropë në rrafshin diakronik, i cili pjesërisht është bartur deri në ditën e sotme, Brown/Gilman paraqesin këtë skemë:




Figure 2 Social dyads involving (a) semantic conflict and (b) their resolution

Skema e marrë nga Brown/Gilman (1971: 256)

⁷ Brown / Gilman (1971: 255) sjellin këtë shpjegim për “pushtetin”: „[...] a relationship between at least two persons, and it is nonreciprocal in the sense that both cannot have power in the same area of behavior.“

Më vonë këto forma të adresimit nuk reflektonin më raportet “pushtet”-“solidaritet”, por u zhvilluan si forma për të shfaqur raportet e intimitetit (I) dhe formalitetit (V) (Brown/Gilman 1971: 257).

Forma e shumësit për adresimin ndaj një personi përdoret për të shprehur politesë, formalitet, respekt dhe sigurisht edhe distancë sociale. Në anën tjetër, solidariteti nënkupton intimitet (afri) dhe për këtë arsye është edhe reciprok. Sipas Brown/Gilman (1971: 254) “një formë ekskluzivisht në shumës është vënë në përdorim historikisht për t’u përdorur po ashtu edhe si njëjës i politesës siç quhet në mënyrë të lirshme.” Kjo formë përdoret edhe në ditët e sotme në shumë gjuhë evropiane.

2. Format e adresimit të politesës në gjuhën shqipe

Gjatë analizës që ju është bërë librave shkollor të Republikës së Kosovës të lëndëve Edukata Qytetare dhe Gjuhë Shqipe, u vu re se format e adresimit nuk përmenden fare. Madje edhe për politesën thuajse nuk gjendet diçka që do tu shërbente brezave të ardhshëm në këtë drejtim. Në gramatikat e gjuhës shqipe forma formale e adresimit përmendet tek përemrat vetor dhe atë vetëm me një shënim shumë të shkurtër duke mos dhënë shumë shpjegime:

“2. Në vend të vetës së dytë njëjës përdoret shpesh forma e shumësit për të shënuar një person të vetëm, **për nderim e mirësjellje**.

p.sh.: -*Ju jeni drejtori i punimeve?* -*Ju bile u nisët i pari – vazhdoi Kujtimi, duke sjellë ndër mend të kaluarën. -Kam dëgjuar për ju, po s’ju kam parë.*” (Agalliu et. al 2002: 221)

Edhe gramatikat tjera të gjuhës shqipe nuk japin përshkrim më të detajuar. Siç u potencua më lartë nga studimi i Brown/Gilman përemri V përdoret ndaj superiorit, të pushtetshmit. Në shkrimet e para të shqipes (Meshari) forma formale V nuk është përdorur fare. Veta e dytë e shumësit shërbente për adresimin e më shumë vetave. Forma V për adresim të një personi filloi të përdoret gjatë kohës së mbretit Zog (1928-1939), ku futen dy format të reja të adresimit në gjuhën shqipe **Naltmadbnia juaj** dhe **Shkëlqesia Juaj** (krhs. Kadzadej 2003). Këto forma të adresimit përdoren edhe në ditët e sotme.

- *Naltmadbnia juaj shkon në rrugën e Skanderbeut e ne mas rrugës Suej Naltmadbni.* (Gazeta „Besa“, 13 shtator 1931, f. 1)

Sipas studimit diakronik të Kadzadej (2003) për format e adresimit të gjuhës shqipe, në gjuhën e shkruar forma e adresimit formal fillon të gjejë përdorim më të

gjerë pas vitit 1944, kryesisht për adresimin e intelektualëve si p.sh: mësues, mjek, avokatët etj. Shembulli në vazhdim tregon këtë tendencë:

Unë çuditërisht sonte me ju. - Seriozisht e keni? Unë nuk ju kuptoj sonte. (Ismail Kadare „Gjeneral i ushtrisë së vdekur“ 1965)

Siç mund të shohim nga ky përshkrim i shkurtër, në gjuhën shqipe forma V e adresimit ka përdorim më të vonshëm sesa në gjuhët tjera evropiane.

3. Analiza

Për të hulumtuar përdorimin e adresimit formal apo me politesë në diskursin publik në Kosovë janë marrë 30 intervista në televizionet nacionale të Kosovës si dhe janë analizuar mbi 15 transkripte të seancave plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Në shumicën e shembujve të analizuar vërehet se forma V në përdorimin e saj në diskursin publik lë për të dëshiruar. Gazetarët dhe politikanët në përgjithësi bëjnë shumë gabime gjatë përdorimit të këtyre formave. Duhet të përmendet që gazetarët e televizionit Klan Kosova, intervistat e të cilëve janë analizuar, prijnë me shkarjet. Mbetet e paqartë se a e bëjnë këtë zgjedhje të gabueshme për shkak të mosdijes apo për shkak se nuk duan t'i drejtohen bashkëfolësit me adresim formal. Në vijim do të paraqesim tre shembuj reprezenues të tentimit për të përdorur formën formale dhe gabimet që hasen gjatë përdorimit të saj.

Shembulli i parë është intervista e gazetarit B. H. me kryetarin e sapo zgjedhur të Prishtinës Sh. A.. Në fillim të kësaj interviste gazetari dhe i ftuari i tij tematizojnë vetë formën e adresimit, që sipas gazetarit do të duhej të ndryshonte për shkak se bashkëfolësi tani bart një post publik. Kurse i ftuari adresimin me “Kryetar” dhe “Ju” nuk e sheh si adresim me politesë apo formal, por e interpreton si formë që përdoret ndaj pushtetit dhe kërkon që të hiqen barrierat në komunikim, pra tenton të shfaqë solidaritet. Bie në sy se në vazhdim të intervistës gazetari bën edhe gabime të një natyre tjetër gjatë përdorimit të formave të adresimit: i drejtohet bashkëfolësit me “zoti kryetar” ose “ju” por folja qëndron në vetën e dytë njëjës:

a. Intervista BH. me SH.A.:⁸

B.H: Kjo është biseda e parë në Klan Kosova me kryetarin e ri të Prishtinës Shpend Ahmeti. **Shpend mirë se erdhe.**

SH.A.: **Mirë se ju gjej!**

⁸ https://www.youtube.com/watch?v=Cc7rLZ_bljQ (1:23-2:14). (shkarkuar më 24.08.2015). Shembujt në vijim janë transkripte të intervistave përkatësisht fjalëve të mbajtura në KK. Teksti jepet pa ndërhyrje.

B.H.: Prej sot edhe do e ndërrojmë komunikimin – kështu – përse po themi kryetar dhe për hir të komunikimit po themi edhe për qytetarin: **kryetar mirë se edhe** në Zonën B.

SH.A.: Faleminderit **Baton** edhe pse kisha preferu me vazhdu me më qytet Shpend, kjo ka qenë edhe pjesë e fushatës, që mos të krijojmë tash barriera me tituj më shumë.

B.H.: Deri sa ishim në atë debatën e madh me ekspert dhe analistët e bëmë një marrëveshje që të quajmë Shpend po tash e tutje nga qytetarët nuk kam të drejt që... Atëherë **kryetar cili është** vendimi i parë i **jujë që do ta merrni** për Prishtinën.

Shembulli i dytë paraqet intervistën e gazetarin Xh. R. me deputetin e Kuvendit të Kosovës Z. B. Ky është shembulli i raportit jo-reciprok të adresimit: gjatë kësaj Interviste gazetari i drejtohet me formë formale deputetit, mirëpo ky ia kthen me formën jo formale:

b. Intervista XH.R. me Z.B.:⁹

XH.R.: **Ju përmendët** shumë Facebook-un, **jeni** tmerrësisht keq me gjuhën shqipe zoti Berisha.

Z.B.: Jo në fakt e di që ma kanë keqpërdorë nga plazhi i Sarandës një shkrim, por nuk nënkupton që jam profesor i gjuhës shqipe

XH.R.: Jo, por gabime **bëni** goxha shumë.

Z.B.: **A mush** me ma dokumentu!

XH.R.: Po po përpara e kam, “provinciale” nuk shkruhet me J shumë të tjera, “seriozisht” nuk shkruhet me Ë ne fund.

Z.B.: Po thashë nuk jam profesor i gjuhës shqipe. S’e di a ka rëndësi kjo në politikë.

XH.R.: Jo, jo shumë, por pritët prej një deputeti një nivel më i lartë.

Z.B.: Si do që të jetë. A i ke pa komentet e kolegeve **TU**. A përdorin Ë ndonjëherë në rrjetet sociale. Megjithatë unë kam botu edhe shkrime në gazeta dmth. ditore. Por jo në këtë nivel. Fund fundi ajo është diçka shumë personale dhe me një situatë ku e përdori për shembull prej një kafiterie apo restoranti, çfarë rëndësi a â një shkronjë a jo. Me rëndësi është mesazhi që kam thanë.

Në këtë rast dëgjuesit i krijohet përshtypja se adresimi në vetën e dytë njëjës nga ana e deputetit përkundër insistimit për komunikim formal nga ana e gazetarit bëhet me qëllim të nënçmimit të bashkëfolësit (A i ke pa komentet e kolegeve **TU**), përkatësisht me tendencën për të shpërfaqur pushtetin.

⁹ <https://www.youtube.com/watch?v=Ow9rDIXGBSs>. (shkarkuar me 24.08.2015).

Situata nuk del më e mirë edhe në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Folësit janë jokonsekuent gjatë përdorimit të formave të adresimit: fillojnë adresimin me Ti, kalojnë në formalitet, kthehen përsëri në vetën e dytë njëjës. Kjo shkakton konfuzion te dëgjuesi, i cili nuk e ka të qartë qëllimin e folësit: nënçmim, barazim social, solidaritet apo ndoshta edhe shpërfaqje e pushtetit? Nëse marrim parasysh skemën e adresimit reciprok dhe jo-reciprok të Brown/Gilman komunikimi në kuvend është kryesisht jo-reciprok. Shembulli në vazhdim tregon se kapërcimi nga forma formale te jo-formale bëhet në mënyrë arbitrare. Në shembullin e përzgjedhur zëvendëskryeministri i drejtohet një deputeteje me emër, fillon komunikimin me formën T, në vetën e dytë njëjës, por më vonë vazhdon t'i drejtohet me formën V, vetën e dytë shumës:

c. Senaca plenare e Kuvendit të Republikës së Kosovës

[.....]

ZËVENDËSKRYEMINISTRI H. TH.: **Donikë**, unë kisha ftuar, se moti kështu s'jemi ballafaquar, të mos e keqpërdorësh mikrofonin dhe rastin e Ramushit, se nuk **të ka hije**, e para. Sa i përket ballafaqimit, **merrini krejt mëhallët e juaja** politike, nuk e kam problem. **Ti e di** këtë. Sa i përket interpelancës, unë zyrtarisht, në mënyrën më të rregullt të mundshme, i jam drejtua Kryesisë së Kuvendit për mundësinë që ta kemi një ballafaqim të argumenteve sa i përket asaj çështjeje që **ju e keni kërkuar**. Por, **po ta jap përgjigjen edhe ty**, edhe sqarimin për gjithë opinionin publik dhe për ju, deputetë të nderuar. [...]¹⁰

Mbetet e paqartë se a i bëhet adresimi vetëm një personi apo edhe më shumë, pra veta e dytë shumë përdoret si formë V apo bëhet fjalë thjesht për shumësin. Në këtë pikë duhet të përmendet fakti se gjatë analizës u vu re se traskriptet, që gjenden në Web-faqen e Kuvendit, i nënshtrohen një lekturë gjuhësore. Shembulli i lartpërmendur ka edhe incizimin, që gjendet në youtube.¹¹ Këtu shihen intervenimet që i janë bërë këtij pasusi.

¹⁰ Traskripti i mledhjesë plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, e mbajtur me 18 dhe 25 qershor 2015. f. 3.

http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/proc/trans_s_2015_06_18_10_6008_al.pdf (shkarkuar 24.08.2015)

¹¹ <https://www.youtube.com/watch?v=dZ6gxAvyknQ>. (0:11-1:00).

4. Përfundim

Në këtë punim u paraqiten teoritë e politesës, për tu ndërlidhur me format e adresimit me përemrat “ti” dhe “Ju”. Në gjuhën e folur bëhen shumë gabime sidomos gjatë përdorimit të formave të adresimit me politesë. Mbetet e paqartë se a dëshiron folësi të tregojë afërsi duke përdorur vetën e 2. njëjës, apo nuk ka njohuri të bollshme gjuhësore për ta përdorur formën formale gjatë gjithë komunikimit. Ky konkludim erdhi pas analizës së diskursit publik në Kosovë (Mediat dhe Kuvendi).

Në gjuhën e shkruar vërehet se ka kujdes më të shtuar në përdorimin e adresimit formal. Duhet të përmendet se intervistat që ishin transmetuar ne radiot apo televizionet nacionale me rastin e botimit të tyre ishin përmirësuar. Kjo tendencë e përmirësimit të gjuhës së folur u vërtetua edhe nga transkriptet e seancave plenare të Kuvendit të Kosovës. Duhet të theksohet së gjatë analizës së fjalimeve të politikanëve në Kosovë forma formale përdoret çdo herë në mënyrë korrekte, pra në rastet kur lexohen tekste të përgatitura paraprakisht.

Sipas analizës del që format e adresimit me politesë përdoren në shumicën e rasteve në mënyrë arbitrare dhe ka përzierje të formave gjuhësore me shumësin. Si në shumicën e gjuhëve evropiane, edhe shqipja dallon midis formës T dhe asaj V. Fatbardhësisht në Kosovë nuk ekziston një ligj i ngjashëm me ligjin gjerman i cili parasheh ndëshkim për të gjithë ata që nuk i adresohen zyrtarit publik me formën V¹²sepse sipas hulumtimit të bërë, do të bankrotonin shumë gazetarë por edhe shumica e politikanëve në Kosovë.

Literatura:

1. **Agalliu, Fatmir/ Angoni, Engjell/ Demiraj, Shaban/ Dhrimo, Ali/ Hysa, Enver/ Emil, Lafe/ Likaj, Ethem (2002)** Gramatika e gjuhës shqipe Vëllimi I, Morfologjia, Tiranë: Maluka.
2. **Brown, Roger/ Gilman, Albert (1960)** “The pronouns of power and solidarity.” Në: T. A. Sebeok (ed), *Style in Language*. Cambridge: MA: MIT Press Cambridge, 253–276.

¹² Gazeta gjermane *tagesspiegel.de* e vitit 2011 sjellë një koment të gazetarit Johnaes Radke ku tregon se ishin shqiptuar 3 gjoba për mospërdorimin e formës formale ndaj policisë rrugore për vetëm atë vit. Gjobat variojnë nga 100 Euro deri në 3200 Euro.
<http://www.tagesspiegel.de/berlin/beamtenbeleidigung-3200-euro-strafe-fuer-einen-witzbold/3938602.html#kommentare> (shkarkuar më 23.08.2015)

3. **Brown, Penelope/ Levinson, Stephen (1978)** Universals in Language usage: Politeness phenomena. In: Goody, N. Esther (eds.) Questions and politeness: Strategies in social interaction. London/N.Y [u.a]: Cambridge University Press
4. **Brown, Penelope/ Levinson, Stephen (1987)** Politeness. Some universals in language usage. Cambridge, N.Y [u.a]: Cambridge University Press.
5. **Clyne Michael/ Heinz L. Kretzbacher/ Catrin Norrby/ Jane Warren (2003)** Address in some Western European languages. Proceedings of the 2003 Conference of the Australian Linguistics Society.
<http://www.als.asn.au/proceedings/als2003/clyne.pdf> (20.08.2015).
6. **Eelen, Gino (2001)** A Critique of Politeness Theories. Manchester: St. Jerome Publishing.
7. **Kadazdej, Brikena (2003)** Anrede- und Grußformen im Deutschen und Albanischen (kontrastive Vergleich). Justus-Liebig-Universität Gießen.
8. **Lakoff, Robin (1973)** What You Can Do with Words: Politeness, Pragmatics and Performatives. University of California: Berkeley.
9. **Lakoff, Robin (1990)** Talking power: The politics of language in our lives. Glasgow: Harper Collins.
10. **Leech, Geoffrey N. (1983)** Principles of pragmatics. London/New York: Longman.
11. **Mills, Sara (2003)** Gender and Politeness. Cambridge: Cambridge University Press.
12. **Niebisch, Daniela/ Penning-Hiemstra, Sylvette (2013)** Schritte International 1 /Kursbusch+Arbeitsbuch. Hueber Verlag: Ismaning.

Berton SULEJMANI

SHQIPJA STANDARDE NË SHKOLLAT E MESME TË QYTETIT TË SHKUPIT

Punimi ynë do të nxjerrë në sipërfaqe nivelin e zotërimit të shqipes standarde nga nxënësit e shkollave të mesme të qytetit të Shkupit. Hulumtimi ynë përfshin të gjitha shkollat e mesme të qytetit të Shkupit (gjimnazet dhe shkollat e mesme profesionale). Hartimet e nxënësve ose ushtrimet me shkrim, kryesisht këto, do t'i kemi si dëshmi tonën për ta parë (mos)zotërimin e shqipes standarde. Lënda Gjuhë shqipe dhe letërsi në gjimnazet tona mësohet katër orë gjatë një jave, ndërsa në ato profesionale tri orë. Nga ky fond i përgjithshëm i orëve, rreth 40% i kushtohen fushës së gjuhësisë. Por, praktika na shpie diku tjetër. Shumica e mësimit mësohet më shumë orë i kushtojnë letërsisë sesa orëve në fjalë. Duke e pasur parasysh se leximi dhe letërsia nuk janë të dëmshme për ta, por lënia “anash” a “mosmbajtja” e orëve të parapara për gjuhë rezultojnë në një nivel jo të kënaqshëm të zotërimit të standardit të shqipes nga nxënësit. Veç nxënësve, do t'i vëmë në pah dhe gabimet eventuale drejtshkrimore të mësimit mësohet. Duke menduar e duke u arsyetuar disa nga mësimit mësohet e lëndëve tjera (për fat të mirë këtë e dëgjojmë nga një numër i vogël) se kujdesi ndaj gjuhës duhet të jetë vetëm i gjuhëtarëve, rezultojnë në gabime/ thyerje të normës drejtshkrimore edhe nga ta. Dubet ta themi se ka mësimit mësohet të lëndëve të ndryshme, por kujdesin ndaj gjuhës e kanë vënë para vetës si detyrë kombëtare. Këtë lëndë, thyerje a zbatim të normës gjuhësore nga mësimit mësohet do ta shohim në ditarët e paraleleve. Aty ku i shkruajnë orët e mësimit.

Qëllimi i kësaj kumtese është që të paraqitim gjendjen apo nivelin e zotërimit të shqipes standarde nga nxënësit e shkollave të mesme të qytetit të Shkupit. Po ashtu në këtë punim, fare shkurtimisht do të themi diçka edhe për statusin e gjuhës shqipe në Maqedoni.

Pas Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe (1972) nëpër të gjitha nivelet e arsimit nga çerdhet deri te shkollat e mesme përdoret shqipja standarde. Shqipja standarde filloi të përdoret edhe në mjetet e informimit, të shkruarat dhe elektronike në gjuhën shqipe. Shqiptarët tanimë në të gjitha nivelet e arsimit e mësojnë dhe e studiojnë shqipen. Hapja e Katedrës së Gjuhës dhe Letërsisë Shqiptare në kuadër të Universitetit të Shkupit, themelimi i Universitetit të Tetovës (1994) brenda së cilës funksionon edhe Katedra e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe, themelimi i Institutit të Trashëgimisë Kulturore e Shpirtërore të Shqiptarëve “Pjetër Bogdani” (2007) janë ngjarje shumë të rëndësishme që lidhen me shqipen në Maqedoni.

Shumë shkurt për statusin e gjuhës shqipe në Maqedoni. Me ndryshimet e fundit pas Marrëveshjes së Ohrit, që u bënë në Kushtetutën e Maqedonisë, statusin e gjuhës shqipe do ta kërkojmë duke deshifruar përqindjet në formulimin e nenit 7 të kësaj kushtetute: *Në tërë territorin e R. së Maqedonisë dhe në marrëdhëniet e saj ndërkombëtare gjuhë zyrtare është gjuha maqedonase dhe shkrimi i saj cirilik. Gjuhë tjetër të cilën e flasin së paku 20% e shtetasve, gjithashtu është gjuhë zyrtare dhe shkrimi i saj, siç është përcaktuar me këtë nen. Emërtimi gjuhë tjetër të cilën e flasin së paku 20% e shtetasve... dhe shkrimi i saj në fakt i referohen gjuhës shqipe dhe shkrimit latin. Cilat janë shkaqet që gjuha shqipe të emërtohet në mënyrë kaq implicite, mbetet një enigmë. Gjuha shqipe në formë zyrtare, krahas asaj maqedonase, përdoret në kuadër të pushtetit vendor, ku shqiptarët përbëjnë shumicën e popullsisë, përdoret nëpër institucionet shtetërore, kur drejtohen nga shqiptarë (në ato ministri që drejtohen nga joshqiptarë, përdorimi i shqipes çdoherë pengohet për shkaqe të paqarta), në foltoren e Kuvendit dhe së fundi me ndryshimet më të reja edhe në fjalimet e funksionarëve të zgjedhur nga Kuvendi.*

Për maqedonishten, në vitin 1998 është miratuar një ligj i posaçëm (*Ligj për përdorimin e gjuhës maqedonase*) i cili në vitet 2008 dhe 2010 ka pësuar ndryshime dhe plotësime. Ligji në fjalë rregullon mënyrën e përdorimit të maqedonishtes, siguron mbrojtjen e saj me ligj, parasheh formimin e një Këshilli për Mbrojtjen e Gjuhës Maqedonase, rregullon statusin e lektorit zyrtar të maqedonishtes si dhe parasheh sanksionimin edhe me gjobë për përdorimin e gabuar të gjuhës maqedonase, për botimin e teksteve të paredaktuara¹. Në rrethanat tona, gjuha shqipe, si gjuhë e standardizuar, që ka rregulla të përcaktuara të përdorimit, është lënë në ndërgjegjes së folësve se sa këto rregulla do të respektohen. Sikur gjuha shqipe të ishte e mbrojtur me ligj dhe moszbatimi do të sanksionohej, sot me siguri gjuha shqipe në Maqedoni do të ishte në gjendje më të mirë sa i takon respektimit të normës. Në këtë mënyrë, mediat do të detyroheshin të punësonin lektorë shqiptarë, të cilët nuk do të lejonin aq shumë shmangie nga norma. Ndodh që televizionet në gjuhën shqipe, bie fjala, televizioni Alsat-M është i detyruar të punësojë lektorë të gjuhës maqedonase sepse ligji ia kërkon (në maqedonisht i jep vetëm lajmet dhe ndonjë emision tjetër), ndërsa lektor të shqipes jo (kur 90% e programit është në gjuhën shqipe).

Gjuha standarde shqipe dhe shkollat e mesme të Shkupit. Në vazhdim të punimit, do t'i paraqesim edhe thyerjet më të shpeshta të normës drejtshkrimore dhe drejtshqiptimore të gjuhës shqipe në shkollat e mesme të Shkupit. Hallka kryesore që qëndron në ballë të përpjekjeve për zotërimin e standardit të shqipes është pa dyshim

¹ Valbona Toska (Nesimi), *Gjuha shqipe në Republikën e Maqedonisë*, Akademia jubilarë me rastin e 40-vjetorit të Kongresit të Drejtshkrimit, Universiteti "Fan S. Noli" Fakulteti i Edukimit dhe i Filologjisë, f. 62, Korçë, 2012.

shkolla me karakterin e saj të theksuar masiv. Në asnjë mënyrë pas shkollës nuk duhet mohuar këtu rolin e madh të *librit, të shtypit, të radiotelevizionit, të kinematografisë, të teatrit, të veprimtarisë ekonomike, shoqërore, kulturore e shkencore* etj. Për këtë arsye, duke iu drejtuar popullit shqiptar për të përdorur standardin e shqipes, Kongresi i Drejtshkrimit i drejtohet, në radhë të parë, “shkollës shqipe, si vatra themelore e formimit gjuhësor të brezave të rinj...” që ajo “ta vlerësojë përvetësimin e normave të njësuar të gjuhës letrare e të drejtshkrimit të miratuar nga Kongresi si detyrë themelore dhe të zbatojë plotësisht rregullat e reja të drejtshkrimit, duke filluar nga viti 1973 – 1974”².

Lëndën Gjuhë shqipe dhe letërsi, nxënësit e shkollave të mesme në Maqedoni, gjegjësisht ata të vitit I, II dhe III brenda një viti shkollor e realizojnë me 144 orë (d.m.th. 4 orë në javë³), ndërsa viti IV me 132 orë brenda një viti shkollor, sepse maturanët mbarojnë një muaj më herët. Të gjitha këto orë të parapara janë të ndara për letërsi, gjuhë, lektyra, përsëritje, hartime me shkrim etj., megjithatë numri më i madh i orëve i takojnë letërsisë dhe gjuhës. Megjithatë, lirisht mund të themi se gjuhën ose njësitë mësimore që lidhen me gjuhën, në mënyrë më aktive, nxënësit i mësojnë në shkollat fillore, për këtë gjë jemi edhe vet dëshmitarë se në shkollat e mesme më shumë mësohet ose i jepet përparësi letërsisë sesa gjuhës. Andaj, nxënësit, të detyruar i përkushtohen më shumë letërsisë (e cila gjithsesi se është e dobishme për ta) sesa gjuhës (mësimi të normave të shqipes standarde).

Thyerje të normës gjuhësore, nga nxënësit, i hasim në të gjitha fusha e gjuhësisë, si në atë të fonetikës e fonologjisë ku më të shpeshta janë: 1) **përdorimi i r-së në vend të rr-së**, *ara* (< *arra*); *bigor* (< *bigorr*); *koridor* (< *korridor*); *kurjë* (< *kurrgjë*) etj. Mospërdorimi drejt i këtyre bashkëtingëlloreve vërehet edhe në të shkruar edhe në të folur (më shumë në të folur); 2) **Përdorimi i gabueshëm i zanores [i] në vend të zanores [y] (zhbuzorëzimi i [y] në [i])** si në të folur ashtu edhe në të shkruar, vërehet te nxënësit e shkollave të mesme të qytetit të Shkupit (sidomos tek ata që vijnë nga rrethi i Karshiakës, Dervenit, Kumanovës dhe disa fshatrave përreth). Ata zanoren [y] në të shumtën e rasteve e zhbuzorizojnë në [i], p.sh. *atë* (< *aty*), (*atë* në vend që të përdor *aty*); *atire* (< *atyre*), *bashkëqitetar* (< *bashkëqytetare*), *bestitni* (< *bestytni*), *bërril* (< *bërryl*), *frîj* (< *frÿj*), *frimë* (< *frÿmë*); 3) **shndërrime të [y] në [u]**. Ka edhe kësisoj raste kur në vend të zanores [y] të mbarë shqipes, në ligjërimin e shkruar, por edhe në ligjërimin e folur, nxënësit në pak raste përdorin zanoren [u], si p.sh. në vend të fjalës *byrek* përdorin *burek* (*burektore* për *byrektore*); *huxhum* në vend të *hÿxhÿm*; *musafir* (< *mysafir*), *mushteri* (< *myshteri*), *musliman* (< *mysliman*), *mufti* (< *myfti*), *gÿunab* (< *gÿynab*) *duqan* (< *dÿqan*), *qumur* (< *qÿmyr*), *trusni* (< *trÿsni*), e ndonjë fjalë tjetër; 4)

² Rezolutë e Kongresit të Drejtshkrimit, në “*Drejtshkrimi i gjuhës shqipe*”, Tiranë 1973, f.25-26.

³ Shkollat e mesme profesionale, gjuhën shqipe dhe letërsinë e mësojnë 3 orë në javë.

qiellzorizimi i [ë]-së në [i] kemi vërejtur, se zanoren gjysmë të hapur të radhës së mesme [ë] në rrokje të patheksuar në shumë pak raste e gjejmë të qiellzorizuar në [i], si në fjalët: *lishon*, *lishuar* (< *lëshon*, *lëshuar*; cit. *Afrimi e ka lishuar mësimin*⁴ në vend që të thotë *Afrimi e ka lëshuar mësimin*), *nji* (< *një*), *xhimon* (< *gjëmon*; cit. *Plaka Nicë xhimoj dhe i tha gjeneralit...*⁵ në vend që të thotë *Plaka Nicë gjëmoj dhe i tha gjeneralit...*), *likura* (< *lëkura*) etj.

Në hartimet me shkrim, ushtrimet me shkrim, fletoret e lektyrave, por edhe në ligjërimin e folur (në shqiptim), te nxënësit e shkollave të mesme të qytetit të Shkupit nuk mungojnë rastet e këmbimit të glotales shtegore të shurdhët [b] në buzore-dhëmboren [f], si: *ftoft* (< *ftobt:ë*), *ftojfe* (< *ftojbe*), *ftoftësi* (< *ftobtësi*), *fsbef*, *msbef* (< *fsbeb*), *fsbeftas*, *msbeftas* (< *fsbehtas*), *njef* (< *njeh*), *njefem* (< *njebem*), *njof* (< *njoh*), *i njojsbëm* (< *i njojsbëm*), *shijem* (< *shibem*), *shijet* (< *shibet*) etj. Aty gjejmë edhe **shndërrime të [th] > [f]** në disa fjalë (posaçërisht në ligjërimin e folur), pra **[th]-në** ta këmbëjnë me buzore-dhëmboren [f], si në fjalët: *i (e) fellë* (< *i (e) thellë*) cit. *Kjo gotë qenka shumë e fellë* (< *Kjo gotë qenka shumë e thellë*), *ufull* (< *uthull*). Në punimet me shkrim, por edhe gjatë ushtrimeve gojore të nxënësve vërehet **afrikatizimi i [q, gj] në [ç, xh]**. Nga studimet e shumta dihet që pjesa më e madhe e të folmeve të gegërishtes priren që mesgjuhoret t'i njëtojnë si më të përparme, aq sa disa edhe plotësisht i afrikatizojnë⁷. Ky shqiptim më i përparmë ka humbur opozicionin fonologjik /q/ ~ /ç/ dhe /gj/ ~ /xh/, pra është bërë defonologjizimi i tyre në të folmet e Kosovës⁸, të Shkupit⁹, të Tetovës¹⁰, të Kërçovës¹¹, të Dibrës¹² etj. Në bazë të gjendjes faktike, te nxënësit, vërejmë dy çifte bashkëtingëlloresh: qiellzore ~ afrikate, por shpeshherë dallimi i tyre nuk del i qartë, d.m.th. nxënësit bëjnë përzjerjen e tyre si në ushtrimet me shkrim, po ashtu edhe në ushtrimet gojore. Ja disa fjalë (shembuj) kur në vend të bashkëtingëllores qiellzore është shkruar afrikatja gjegjëse, si p.sh. *xhak* (< *gjak*), *xhakmarrje* (< *gjakmarrje*), *xharpër* (< *gjarpër*), *xhashtë* (< *gjashtë*), *xhashtë* (< *gjashtë*) *orë kemi sot.*, *i xhatë* (< *i gjatë*), *e xhete* (< *e*

⁴ Fjalët e një nxënësi të vitit të III, i cili thotë **lishon** në vend që të thotë **lëshon**.

⁵ Fjalët e një nxënësi tjetër (vitit të katërt) i cili bën përshkrimin e Plakës Nicë.

⁶ Fjalët e një nxënësi të vitit të III-të, gjatë kohës kur ishim në ekskurzion në Ohër, ishim në kafene.

⁷ Asllan Hamiti, Paralelja shqipe në dy fjalorët shumëgjuhësh të Gjorgji Puleskit, Vatra, 2005, Shkup, fq. 90.

⁸ Idriz Ajeti, *Rreth disa veçorive të të folmeve të shqiptarëve të rrethit të Preshevës dhe të Bujanovcit*, Kërkime gjuhësore, Prishtinë, 1978, fq. 192.

⁹ Haki Ymeri, *E folmja shqipe e Karshiakës*, Shkup, 1997.

¹⁰ Remzi Nesimi, *E folmja e Dërvenit*, (punim doktorate në dorëshkrim), Prishtinë, 1988.

¹¹ Qemal Murati, *E folmja shqipe e rrethit të Tubinit të Kërçovës*, Studime gjuhësore II (Dialektologji), Prishtinë, 1989, fq. 18.

¹² Naim Basha, *E folmja e qytetit të Dibrës*, Studime gjuhësore II (Dialektologji), Prishtinë, 1989, fq. 163.

gjete), *xhindet*, *xhendet* (< *gjendet*), *mënxhes* (< *mëngjes*), *xbeneral* (< *gjenral*), *xberman* (< *gjerman*), *xbermanisht* (< *gjermanisht*), *xbimnaz* (< *gjimnaz*), *xbevrek* (< *gjevrek*), *liturxhi* (< *liturgji*), *loxhikë* (< *logjikë*), *loxhikisht* (< *logjikisht*), *hexhemonist* (< *hegemonist*) etj.

Nga **fusha e morfologjisë** gjejmë thyerje të shumta, por në këtë punim do t'i paraqitim vetëm disa. Në fletoret e ushtrimoreve, fletoret të cilat u shërbejnë nxënësve për të mbajtur shënime të ndryshme, kemi vërejtur se, në kopertinat e fletoreve më saktësisht në vendin e posaçëm për të shkruar emrin dhe mbiemrin, një numër i madh i nxënësve **në fillim e shkruajnë mbiemrin e pastaj emrin** personal, si p.sh.: *Shabani Sedat*, *Bislimi Hirjete*, *Veseli Behare* etj., në vend që të shkruaj më parë emrin e pastaj mbiemrin, *Sedat Shabani*, *Hirjete Bislimi*, *Behare Veseli*. Kjo si duket është ndikim i gjuhës maqedonase, sepse tek ata në fillim shkruhet mbiemri e pastaj emri, si p.sh.: Тодоровски Никола (Todorovski Nikolla). Aty kenë vërejtur: **1. Gabime në përdorimin e emrave mashkullorë që ndërrojnë gjininë në shumës.** *Forumet* (< *forumet*) letrare nuk po bashkëpunojnë me nxënësit e shkollave të mesme. *Festivala* (< *festivale*), *lokala* (< *lokale*), *materiala* (< *materiale*), *dyqana* (< *dyqane*) etj.; **2) Gabime në përdorimin e emrave mashkullorë që e bëjnë shumësin me prapashtesën –ra** Në hartimet me shkrim është vërejtur që nxënësit në vend të prapashtesës **–ra**, përdorim prapashtesën **–na**, si, p.sh.: *Fshatmat* (< *fshatrat*) malorë nuk kanë kushte të mira për shkollim. *Qendra tregtare “Ramstor” ka mallna* (< *mallra*) të shtrenjta. *Ujna* (< *ujra*) të zezë; *vajna* (< *vajra*), *plebna* (< *plebra*); **3) Gabime në përdorimin e emrave të përveçëm (sidomos emrave të huaj) - Jozefi u zgjua nga gjumi.** për: *Jozefi u zgjua nga gjumi*¹³. *Mbi peshkë hidhet Santiago.* për: *Mbi peshkë hidhet Santijagoja*¹⁴. **4) Shkrimi i emrave të përveçëm të huaj të shkruar me grafinë e huaj si:** Washington për: Uashington; New-York për: Nju-Jork; Istanbul për: Stamboll etj. **5) Gabime gjatë përdorimit të shumësit të disa emrave,** si: **shumë molla për shumë mollë; pak nxënës (nxansa) për pak nxënës; Në këtë periudhë kemi dy kallëzues (kallxues)* për: *Në këtë periudhë kemi dy kallëzues* etj. **6) Gabime gjatë përdorimit të trajtave të shkurtra.** Shpeshherë në vend të trajtave të shkurtra të shumësit përdorin trajtat e shkurtra të njëjësit. Ja disa shembuj: *Le t'i kthebemi temave të sotme.* Për: *Le t'u kthebemi temave të sotme.* *Le t'i kthebemi mungesave tona.* Për: *Le t'u kthebemi mungesave tona.* **7) Përdorimi i formave të kallëzores për gjinoren, dhanoren apo rrjedhoren****Klasës tonë* për: *klasës sonë*; **Klasës tuaj* për: *klasës suaj*; **Klasës tënde* për: *klasës sate*.

Luhatje nga norma morfologjike kemi vërejtur edhe gjatë shumësit të **disa emrave me prapashtesa.** emrat mashkullorë me fundoret **–an, –ar, –ec, –er, –ir,** dhe **–on,** të cilët shumësin e bëjnë me prapashtesën **–e,** nga nxënësit në shumë raste e

¹³ Personazh i romanit “Procesi” të F.Kafkës.

¹⁴ Personazh i romanit “Plaku dhe deti” - E. Heminguej.

gabojnë shumësin e tyre. Ja disa shembuj (do ta shënojmë edhe formën e drejtë të shumësit): **dyqana* - dyqane; **tavana* - tavane; **honorara* - honorarë; **mindera (minera)* - mindere; **panaira* - panairë; **sallona* - sallone; **ballkona* - ballkone etj. Emrat mashkullorë, kryesisht të huaj, me fundoret **-ion** dhe **-(i)um**, të cilët gjithashtu shumësin e formojnë me prapashtesën **-e**, gabohen nga nxënësit. Ja disa shembuj (do ta shënojmë edhe formën e drejtë të shumësit): **bataliona* - batalione; **kampiona* - kampione; **simpozioma* - simpoziume; **akuariuma* - akuariume; **albuma* - albume etj. Njëjtë ndodh edhe me fjalët e huaja që kanë si pjesë të dytë fundoren **-gram**, si p.sh.: **telegram* - telegrame; **diagram* - diagrame etj. Emrat mashkullorë me temë me fundoret **-ek**, **-en**, **-ik**, **ist**, **-er**, **-or**, **-osh**, **-an**, **-ir**, **-on**, **-un** etj, që shumësin e bëjnë me prapashtesën **-ë**, nga ana e nxënësve në të shumtën e rasteve¹⁵ gabohet. Ja disa shembuj: **fishbeka* - fishekë; **byreka (bureka)* - byrekë; **kapitena* - kapitenë; **ibrika* - ibrikë; **turista* - turistë; **alkoolista* - alkoolistë; **futbollista* - futbollistë; **oficera* - oficerë; **berbera* - berberë; **menaxhera* - menaxherë; **ambasadora* - ambasadorë; **doktora* - doktorë; **profesora* - profesorë; **mjekrosha* - mjekroshë; **kazana* - kazanë; **shandana* - shandanë; **zinxhira* - zinxhirë; **vagona* - vagonë; **kamiona* - kamionë; **timona* - timonë; **majmuna* - majmunë; **bastuna* - bastunë; **piruna* - pirunë etj.

Edhe emrat që dalin me fundoret **-el**, **-at**, **-et**, **-ant**, **az** etj. e formojnë shumësin me **-e** (kur shënojmë jofrymorë) (në shumë raste gabohet shumësi i tyre nga nxënësit), p.sh.: **hotela* - hotele; **tunela (tunella)* - tunele; **atentata* - atentate; **aparata* - aparate; **fakulteta* - fakultete; **restoranta* - restorante; **deodoranta*¹⁶ - deodorant; **variant* - variante; **kafaza* - kafaze; **gjimnaza* - gjimnaze etj.

Folja është pjesa e ligjëratës më problemorja në gjuhën standarde shqipe. Ajo, si me kategoritë gramatikore (më të shumtat ndër të gjitha pjesët e tjera të ndryshueshme të ligjëratës), ashtu edhe me këmbimet e shumta tingullore që janë zhvilluar në gjuhën shqipe gjatë historisë, si dhe për shkak të dallimeve të shumta dialektore, paraqet vështirësitë më të mëdha në përdorimin normativ në ligjërim në gjuhën e sotme standarde shqipe¹⁷. Në të shkruar dhe në të folur, te nxënësit kjo kategori gramatikore na del tepër problematike, meqë nuk e njohin mirë sistemin foljor të shqipës, andaj do të përpiqem t'i paraqes gabimet (luhatjet) e bëra në vetë, numër, kohë, diatezë, zgjedhim etj. **Vetëm për foljet** ndihmëse *jam* dhe *kam* për të tashmen e

¹⁵ Më tepër gabohet në të folur, sesa në të shkruar.

¹⁶ Përdorin edhe formën **dezodoransa** (nga gj.maq. ДЕЗОДОРАНСА).

¹⁷ Zijadin Munishi, Zgjedhimi i foljeve, sh.b. Libri shkollor, Prishtinë, fq. 3.

mënyrës dëftore, nxënësit i përdorin edhe këto forma të gabuara. P.sh.: *Ne **jena** e ardhmja e këtij vendi. për: Ne **jemi** e ardhmja e këtij vendi. *A **imi** krejt në klasë?¹⁸ për: A **jemi** krejt (të gjithë) në klasë. *Ne **ina** klasa ma e mirë. për: Ne **jemi** klasa më e mirë. *Ti **ije** profesori ma i mirë. për: Ti **je** profesori më i mirë. *Personazh kryesor **është** Afërdita. për: Personazh kryesor **është** Afërdita. *Ti **kije(ki)** shumë ndikim. për: Ti **ke** shumë ndikim. *Ne vitin e parë **kena** shumë lëndë për: Në vitin e parë **kemi** shumë lëndë. *Në klasën tonë **kina** shumë nxënës të sjellsbëm. për: Në klasën tonë **kemi** shumë nxënës të sjellsbëm. *Ju **kini** shqip orën e parë? për: Ju **kemi** shqip orën e parë? *Ata **k:an** kimi. për: Ata **kanë** kimi. *E **qartë osht**. për: E **qartë është**.

Rreziqet më të mëdha sintaksës, shpirtit të gjuhës sonë, në Maqedoni i vijnë nga ndikimi i gjuhës maqedonase. Situatat e larmishme politike, kulturore e shoqërore sjellin edhe ndërlikime të ndryshme gjuhësore. Këto ndërlikime bien në sy veçanërisht te shqiptarët, të cilët jetojnë nëpër treva ku ndikimi i gjuhës së huaj, në këtë rast i maqedonishtes, është i drejtpërdrejtë. Ky ndikim ka lënë gjurmë të pashlyeshme, sidomos te shtresa e popullit të pashkolluar (dikur e sot), te njerëzit e moshës më të shtyrë, kryesisht në të folur, por në një masë të caktuar edhe në të shkruar. Sot, të rinjtë, me diploma të fakulteteve që punojnë në mjetet e informimit, në redaksitë e botimeve të librave shkollorë, administratë shtetërore etj., bëjnë përkthime joadekuate, dhe në këtë mënyrë sintaksa e shqipes është e detyruar që të çalojë. Ky ndikim i sintaksës së maqedonishtes mbi atë të shqipes vërehet në tekstet shkollorë të lëndëve të ndryshme (përjashto këtu librin e gjuhës shqipe) që autorë kryesisht kanë maqedonas (shumë rrallë me ndonjë koautor shqiptar). Të njëjtat tekste, pra të këtyre autorëve (kupto: maqedonas) përkthehen dhe shërbejnë edhe për nxënësit shqiptarë. Ndodh që nxënësi në ndonjë lëndë të caktuar, bie fjala, në lëndën e fizikës, kimisë, biologjisë etj. shumë vështirë e ka ta mësojë një përkufizim të caktuar (qoftë edhe dy rreshta i shkurtër). Kjo ndodh pasi që tekstet në fjalë nuk kanë sintaksë të shqipes. Kalket e tipit: ***u përgjigj në pyetjen** (ОДГОВОРИ НА ПРАШЕЊЕТО) në vend të **iu përgjigj pyetjes**; ***e ndajmë mendimin** (ДЕЛИМ МИСЛЕЊЕ) për **e kemi të njëjtin mendim** ose **mendojmë njëjtë**; ***e bleva çantën shkollore** (ГО КУПИВ ШКОЛСКАТА ТАШИНА) për **e bleva çantën e shkollës**; ***jam (ndjehem) më tepër se i lumtur** (се осеќам повеќе од радосен) për **jam (ndjehem) më shumë se i lumtur** etj. Që ndikimet nga kjo gjuhë t'i tejkalojmë dhe t'i ndalim (aq sa është e mundur) është mirë që sa më shpejtë t'i unifikojmë tekstet shkollorë. Me një fjalë, të kemi një libër të fizikës për të gjitha shqiptarët. Sikurse me abetaren e gjuhës shqipe, edhe pse të njëjtën nuk po arrijnë që zyrtarisht ta përdorin edhe nxënësit e trevave lindore shqiptare. Përdorimi i disa ndërtimeve të huaja (sidomos kalke sllave), për të cilat është shkruar

¹⁸ Kujdestarët e javës shpesh kështu thonë.

edhe më parë, në vend të ndërtimeve shqipe, si: *mbeta pa tekst* në vend të ndërtimit *mbeta gojëhapur* (*mbeta i ngrirë, mbetëm të ngrirë*), ose: *këmbishë krabëshkurtër / krabëgjatë* në vend të: *këmbishë mëngëshkurtër / mëngëgjatë* etj., sikur kanë lëshuar rrënjë, për fat të keq.

Thyerjet e normës gjuhësore nga mësimdhënësit. Edhe nga ana e profesorëve të lëndëve të ndryshme ndodh që të bëjnë gabime gjuhësore gjatë plotësimit të ditarëve, regjistrimit të nxënësve në regjistër, plotësimin e orëve mësimore etj. Këto thyerje të normës gjuhësore më së shumti i vërejmë te profesorët që studimet i kanë mbaruar në gjuhën maqedonase. Po e ilustruam vetëm me një shembull: gjatë kontrollit të një ditari (regjistri të nxënësve) të gimnazit “Zef Lush Marku” të Shkupit vërejmë këto thyerje të normës së gjuhës shqipe, si: SH.M.Q.SH. “Zef Lush Marku”, Shkup¹⁹ (në vend që shkurtesën Shkolla e Mesme e Qytetit të Shkupit ta shkruan pa pika në mes, pra: SHMQSH “ZLM”, Shkup). Në të njëjtin regjistër i gjejmë edhe këto gabime, si: java e IV, java e III (në vend të java IV, java III) për kohën kur është mbajtur hartimi me shkrim²⁰. Vërejtëm edhe disa orë mësimore të shkruara me shkronja të shtypit²¹, disa si, p.sh.: **Logjika dhe shkencat e tjera* në vend të Logjika dhe shkencat tjera etj.

Njëra nga cilësitë themelore të çdo gjuhe është pastërtia e saj dhe originaliteti, që domethënë përdorimi i mjeteve vetjake për të shprehur qartë dhe me përpikëri, në mënyrë të shkathët dhe pa vështirësi, ngjyrimet më të ndryshme kuptimore²². Përkundër kësaj, te disa sikur është krijuar paragjykim i fjalës sikur nuk tingëllon, sikur nuk e thotë atë që kërkohet, prandaj nxitojnë që ta zëvendësojnë atë me fjalën e huaj, me bindjen e tyre të plotë se fjalës e huaj ka diçka të veçantë, plotësuese, se na qenka më e ëmbël. P.sh.: nuk preferohet për: nuk pëlqehet; opcionet për: zgjedhjet; rrezik permanen për: rrezik i përhershëm; unitet për: bashkim, lidhje. Në leksikon e tyre hasim edhe fjalë të tilla si: okej për: mirë; shumë najs (nice) për: shumë bukur; kejo punë është dejnshër për: kejo punë është e rrezikshme etj. Në fund të kësaj kumtese do të paraqes një dukuri jo edhe e panjohur për ne. Fjala është për përdorimin e përsëritjeve të huaja në vend të përsëritjeve shqipe nga nxënësit e Shkupit, madje edhe nga më të moshuarit. Kjo dukuri vërehet edhe në qytetet tjera shqiptare të Maqedonisë. Përdorimi i fjalëve aksham, sabah në vend të fjalëve shqipe mbrëmje (muzg), mëngjes, paraqet një dukuri fare të panevojshme për ne, veçanërisht për shkollarët. Të rinjtë në vend që t’u thonë mjaft këtyre fjalëve dhe përsëritjeve të huaja (kryesisht turke dhe arabe) për të cilat shqipja ka fjalë gjegjëse,

¹⁹ Ditari (regjistri) i paralelës IV-5, v.sh. 2013-2014, f. 1, 3.

²⁰ Po aty, f. 13.

²¹ Po aty, f. 40.

²² Qemal Murati, *Drejpërdorimi i shqipes dhe kultura gjubësore*, Shkup, 1996, f. 129

ata (tani për tani një numër jo shumë i madh) sikur nuk duan ndryshime, por po u shkojnë për shtati të moshuarve²³ (kryesisht të pashkolluar – fjala është për pleqtë). Përdorimi i përsëritjeve arabe, turke, si: meraba, geçmish olsun, selam etj., në vend të përsëritjeve shqipe tungjatjeta, të shkuara, qoftë e kaluar, mirëmëngjesi, mirëdita mirëmbrëma etj., duhet që të largohen menjëherë. Rinia është ajo që bën ndryshime në një shoqëri. Pse mos të bëjë edhe për këtë diçka?!

Përfundim dhe propozim

Formimi i një Qendre të kulturës gjuhësore (sepse një ligj për gjuhën shqipe në Maqedoni, tani për tani, as që diskutohet në qarqet politike, prandaj themi se vështirë mund të sillet) do të ndihmonte shumë në këtë drejtim. Aty do të punësoheshin gjuhëtarë të cilët seriozisht merren me çështje të gjuhës, të drejtshkrimit, të drejtshqiptimit. Kësaj qendre do të mund t'i drejtoheshin me pyetje të punësuarit e institucioneve të ndryshme (shkolla, fakultete, radiotelevizione, ministri etj). Kësaj qendre do të mund t'i drejtoheshin edhe shkollarët (nxënësit) nëpërmjet telefonit ose postës elektronike. Formimi i një qendre të tillë është punë e vështirë, por mund të realizohet me një bashkëpunim ndërmjet Republikës së Shqipërisë, Republikës së Kosovës dhe shqiptarëve në Maqedoni dhe kjo qendër të jetë e përbashkët për të gjithë shqiptarët.

Literatura e shfrytëzuar:

- Agalliu, Fatmir**, *Emrat që përdoren vetëm në shumës në gjuhën shqipe*, “SF”, 1972/2.
- Blaku, Murat**, *Shkrime gjuhësore*, IAP, Prishtinë, 2015.
- Çeliku, Mehmet**, *Çështje të gjuhës standarde*, Tiranë, 2001
- Hamiti, Asllan**, *Fonetika dhe fonologjia e gjuhës standarde shqipe*, Shkup, 2005.
- Memushaj, Rami**, *Shqipja standarde, (Si ta flasim dhe ta shkruajmë)*, BOTIMET TOENA, Tiranë, 2005.
- Memushaj, Rami**, *Vendi i drejtshkrimit dhe drejtshqiptimit në normat e gjuhës letrare*, Gjuha jonë, 1984, 1.
- Миљчин, Илџа**, *Јазикот на медиумите* (трета книга), независни изданија, ЃУРЃА Скопје, 2002.
- Munishi, Zijadin**, *Zgjedhimi i foljeve*, SHB, LIBRI SHKOLLOR, Prishtinë, 1998.
- Munishi, Shkumbin**, *Shqipja në epokën e globalizimit*, ZEROPRINT, Prishtinë, 2015.

²³ Të mos i gjeneralizojmë të gjithë të moshuarit. Fjala është për ato familje të cilat pleqtë si në rini ashtu edhe në pleqëri përdorin fjalë e përsëritje të huaja.

Murati, Qemal, *Drejtëpërdorimi i shqipes dhe kultura gjuhësore*, Shkup, 1996.

Rugova, Bardh, *Gjuba e gazetave*, KOHA, Prishtinë, 2009.

Sulejmani, Berton, *Gjuba standarde shqipe dhe shkolla (zbatimi i saj nga nxënësit e shkollave të mesme të Shkupit)*, LOGOS-A, Shkup, 2011.

Toska (Nesimi), Valbona, *Gjuba shqipe në Republikën e Maqedonisë*, Akademia jubilarë me rastin e 40-vjetorit të Kongresit të Drejtshkimit, Universiteti “Fan S. Noli” Fakulteti i Edukimit dhe i Filologjisë, f. 60 - 63, Korçë, 2012.

Natasha KAZMAJ (KALEMI)

GJUHA SI KOMPETENCË DHE MËSIMDHËNIA E SHQIPES

Të mësuarit me kompetenca është sfidë e shekullit të 21^{te} jo vetëm në ventdet e BE, por është shtrirë në tërë sistemet arsimore në botë, ku synohet të pregatitet brezi i ri me njohuri që i shërbejnë gjatë gjithë jetës.

“Konceptimet bashkëkohore për procesin e të nxënës, theksojnë rolin aktiv të nxënësve në zhvillimin e njohurive të reja dhe të kompetencave. Nxënësit duhet të jenë veprimtarë aktivë në procesin e ndërtimit, zbatimit dhe vlerësimit të tyre. Vetëm kështu, njohuritë, shkathhtësitë, vlerat dhe qëndrimet do të organizohen në struktura që mundësojnë përdorimin e tyre.” Thuhet në kornizën e re kurrikulare 2014, në lidhje me mënyrën e re të konceptimit të të nxënës.

(Korniza kurrikulare e arsimit parauniversitar të republikës së Shqipërisë. Tiranë, 2014 http://www.izha.edu.al/index.php?option=com_content&view=article&id=55&Itemid=74)

Por çfarë është të mësuarit me kompetenca?

Ky është një term që po merr përdorim të gjerë në kurrikulën tonë shkollore në vazhdim, por jo I panjohur më parë për kurrikulat shkollore të vendeve të tjera të Europës. Duke iu referuar Komisionit Europian në “Për krahuja e zhvillimit të kompetencave në mësimdhënie”, termi kompetencë, *“përshkruhet si kombinimi më kompleks i njohurive, atësive, të kuptuarit, vlerave dhe qëndrimeve që çojnë në një veprim njerëzor më efektiv, në një fushë të veçantë”*

(Komisioni europian, Edukim dhe trainim. Mbështetja e mësuesve për zhvillimin e kompetencës dhe rezultate më të mira të të mësuarit. Qershor 2013.) http://ec.europa.eu/education/policy/school/doc/teachercomp_en.pdf

Ndonëse koncepti i të mësuarit me kompetenca, ka hyrë vonë në sistemin tonë arsimor, është një koncept që vjen me një eksperiencë dhe shembuj të shumtë nga BE, duke e bërë atë më të asimilueshëm dhe më të lehtë për t’u përshtatur e praktikuar me më të mirat e veta në sistemin tonë arsimor. Kështu në sisteme të ndryshme arsimore të mësuarit me kompetenca tashmë nuk shihet vetëm si një atribut i shkollimit public virtual por edhe i shkollimit online, ndonëse herë pas here me këto terma “të mësuarit me kompetenca” ose “arsim i bazuar në kompetenca” në distancë jo rrallë sillen për t’ë promovuar programe me vlerë të dyshimtë në arsim, thuhet në

(Fjalor i reformës së edukimit. Kompetencat bazë të të mësuarit, 5 Maj 2014 <http://edglossary.org/competency-based-learning/>), ndaj shkollimi me kompetenca kryesisht mbetet atribut i shkollës.

Por cilat janë kompetencat me të cilat duhet të pajiset nxënësi në sistemin parauniversitar?

Ato janë diku gjashtë e diku shtatë dhe unike ndonëse aplikimi i tyre nuk është koherent për të të gjitha vendet në të gjitha vendet.

Kompetencat që nxënësit duhet të zotërojnë për një të mësuar gjatë gjithë jetës janë;

1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit;
2. Kompetenca e të menduarit;
3. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë;
4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin;
5. Kompetenca personale;
6. Kompetenca qytetare.

7. Kompetenca digjitale që në disa vende, edhe Kosova bën pjesë këtu, e gjejmë të shpërndarë në këto fusha studimi:

- a. Gjuhët dhe komunikimi
- b. Matematikë
- c. Shkencat e natyrës
- d. Shoqëria dhe mjedisi
- e. Arte
- f. Edukim fizik, sporte dhe shëndet
- g. Teknologji dhe TIK

(Korniza kurrikulare e arsimit parauniversitar të republikës së Shqipërisë. Tiranë, 2014 http://www.izha.edu.al/index.php?option=com_content&view=article&id=55&Itemid=74)

Le të shohim se ku janë përqendruar strategjitë kombëtare për mbështetjen e zhvillimit të këtyre kompetencave, sipas fushave të studimit në sistemet arsimore të vendeve të ndryshme të BE.

Po t'i referohemi një grafiku me të dhëna për strategjitë kombëtare të zhvillimit të këtyre kompetencave, që nënkuptojnë fushat e studimit, vërejmë se prioritet I është dhënë pothuajse në të gjitha vendet e BE, me përjashtim të Maltës, Anglisë dhe Irlandës së Veriut, kompetencës digjitale dhe në vazhdim kompetencës së gjuhëve, të matematikës e shkencës.

(Kompetencat kryesore në shkollat e Europës, zhvillimi, sfidat dhe mundësitë për politika. Nëntor 2012, fig 1.1) http://eacea.ec.europa.eu/education/eurydice/documents/thematic_reports/145EN.pdf

Por kompetenca që në shumë vende konsiderohet më e rëndësishmja dhe primare, duke i kushtuar vëmendjen më të madhe të strategjive kombëtare, është kompetenca e gjuhës dhe komunikimit dhe kuptohet që pregatitja me këtë kompetencë bëhet kryesisht duke rritur shkathhtësitë e lexim-shkrimit.

Është shumë e rëndësishme të përqendrohen strategjitë kombëtare në zhvillimin e kësaj kompetence sepse siç shihet tashmë komunikimi po shkon drejt globalizmit dhe kjo nuk mund të bëhet vetëm përmes gjuhës amtare ose gjuhëve të tjera, por po shtrihet dhe në fusha të tjera. Kështu veç gjuhës verbale ka dhe mënyra të tjera por që lidhen ngushtësisht me të folurit e tyre, si; grafikët, hartat, diagramet, tabelat statistikore etj.

(Divizioni i politikave gjuhësore, Gjuha në lëndët e tjera, Referues i grupit të punës Helmut VOLLMER, 2009 https://www.google.al/?gëz_rd=cr&ei=OzzUVZG4AYKjsAHN7bqYCA#q=Language+in+Other+Subjects+Language+Policy+Di+vision)

Në këtë material gjithashtu thuhet se matematika është abstrakte, por përkthimi i saj bëhet nëpërmjet gjuhës, në shkencat e tjera natyrore gjuha shërben për të dhënë hipoteza e bërë shpjegime, ndërsa historia e të tjera shkenca shoqërore nuk mund të kuptohen pa gjuhën.

Po ku jemi ne me përdorimin e gjuhës në këto fusha?

Për këtë le t'i referohemi fillimisht testimit të PISA, që është një matës i njohurive për shumë vende dhe prej disa kohësh vepron dhe në Shqipëri, sidomos për matjen e aftësive të shkrim-leximit. PISA punon me tre lloje të alfabetizimeve:

1. *të leximit*, e përcaktuar si kapacitet për të kuptuar, përdorur dhe për të reflektuar në tekste të shkruara, për të arritur qëllimet, zhvilluar njohuritë dhe potencialin, që të marrë pjesë në shoqëri;

2. *shkrim-leximit matematikor* përkufizohet si kapaciteti për të identifikuar dhe për të kuptuar rolin që matematika luan në botë, për të bërë gjykime të bazuara, për të përdorur matematikën si në mënyrë që plotëson nevojat e jetës së dikujt si qytetar konstruktiv.

3. *shkencor*, shkrim e këndim që përkufizohet si kapaciteti për të përdorur njohuritë shkencore, që të identifikojnë çështjet shkencore për të tërhequr konkluzione të bazuara në dëshmi, në mënyrë që të kuptojnë dhe të ndihmojnë të marrë vendime në lidhje me botën natyrore dhe ndryshimet e bëra në të me anë të veprimtarisë njerëzore. (Afësitë dhe kompetencat e shekullit XXI, Katerina

Ananiadou, Magdalan Claro: EDU/ËKP, 18 dhjetor 2009, f. 7 [http://www.oecd.org/officialdocuments/publicdisplaydocumentpdf/?cote=EDU/WKP\(2009\)20&doclanguange=en](http://www.oecd.org/officialdocuments/publicdisplaydocumentpdf/?cote=EDU/WKP(2009)20&doclanguange=en))

Po si është paraqitur Shqipëria në këtë testim dhe çfarë konkluzionesh vijnë për të.

«Nxënësit shqiptarë kanë përmirësuar performancën e tyre në PVNN1 në lexim, matematikë dhe shkencë ndërmjet vitit 2002 dhe vitit 2012, një periudhë kohore gjatë së cilës aksesit në arsimin e mesëm u rrit shumë.

Pavarësisht tendencës në rritje, performanca e përgjithshme e Shqipërisë mbetet e ulët. Rezultatet PVNN 2012 të Shqipërisë janë më të ulëtat në gjithë Europën dhe Azinë Qendrore»

(Cilësia e Arsimit dhe Mundësitë për Zhvillimin e Aftësive në Shqipëri Analizë e rezultateve të PVNN-së 2000-2012 Qershor 2014) <http://www.worldbank.org/content/dam/worldbank/document/eca/Albania/al-pisa-report-al.pdf>

«Nxënësit shqiptarë e kuptojnë tekstin e vazhdueshëm (tekste në trajtë paragrafesh) shumë më mirë sesa tekstin jo të vazhdueshëm (grafikë, diagrama, katalogë etj.) dhe është e nevojshme që të përmirësohen aftësitë e tyre për të reflektuar dhe për të vlerësuar.

(Cilësia e Arsimit dhe Mundësitë për Zhvillimin e Aftësive në Shqipëri Analizë e rezultateve të PVNN-së 2000-2012 Qershor 2014) <http://www.worldbank.org/content/dam/Worldbank/document/eca/Albania/al-pisa-report-al.pdf>

Për të parë se si dhe se ku qëndron problemi janë zhvilluar këto lloj testimesh me bazë tekste jo të vazhdueshme. me 128 nxënës të klasave të IX,

Testimi1

ARSIMI BAZË: NUMRI I SHKOLLAVE

Një informacion të plotë mbi numrin e shkollave për sistemin publik dhe privat për serinë kohore është paraqitur në tabelë. Në sistemin arsimor funksionojnë shkolla jovartëse dhe vartëse. Çdo shkollë vartëse është në varësi të një shkolle jovartëse, që nënkupton se ato përfaqësojnë një institucion shkollor. (VJETARI STATISTIKOR PËR ARSIMIN 2012 - 2013 dhe seri kohore <http://www.arsimi.gov.al/files/userfiles/statistik>)

GJUHA SI KOMPETENCË DHE MËSIMDHËNIA E SHQIPES

Viti shkollor	PUBLIKE			PRIVATE		
	NUMRI I SHKOLLAVE			NUMRI I SHKOLLAVE		
	Me 1-9 klasa (jovartëse)	Me 1-9 klasa (vartëse)	Me 1-5 klasa (vartëse)	Me 1-9 klasa (jovartëse)	Me 1-9 klasa (vartëse)	Me 1-5 klasa (vartëse)
2004-2005	1438	234	1092	78	2	10
2005-2006	1487	238	1063	91	2	11
2006-2007	1487	247	1005	105	2	6
2007-2008	1484	242	968	120	2	4
2008-2009	1477	249	923	128	0	7
2009-2010	1459	279	894	141	0	5
2010-2011	1356	341	840	140	0	1
2011-2012	1341	351	817	132	0	1

- Sa klasa jovartëse janë në shkollat private 1-9 për vitin 2005-2006? _____
- Në ç'vit është numri më i madh i klasave vartëse 1-9 në shkollat publike? _____
- Si ka ardhur numri i klasave jovartëse 1-9 nga viti në vit në shkollat publike, në rritje apo në zbritje? _____
- Ku është numri më i madh i klasave vartëse në shkollën publike 1-9 apo 1-5? _____
- Sa është diferenca e klasave vartëse 1-9 në shkollat publike për vitet 2005-2008 dhe 2010-2011? _____
- Në vitin 2005-2006 sa është diferenca mes klasave jovartëse 1-9 nga shkolla publike në atë private? _____
- Po në vitin 2010-2011 si është kjo diferencë? _____

Në këtë testim nxënësit kanë arritur të përgjigjen;

- 67% plotësisht
- 26% pjesërisht
- 7% nuk janë përgjigjur fare

Testimi 2

Ndërkohë u kërkua të ndërtonin një tabelë të dhënash dhe grafikë bazuar në të për numrin e nxënësve në klasë ndarë në vajza e dejm, duke i nklasifikuar ata dhe

sipas nivelit ë shkollë sipas tri kategorive; (Kjo detyrë u zhvillua në çift). Të dhënat u dhanë me fjalë dhe në bazë të tyre duhej të ndërtonin grafikë.


1. Shmë të mirë me mesatare mbi 9
2. të mirë me mesatare 7-9
3. të dobat me mestare nën 7

Nga 64 çifte nxënësish vetëm 5 prej tyre, pra vetëm 7.8%, arritën ta çonin deri në fund. Ndërkohë vetëm 22 çifte, pra 34%, arritën ta zhvillonin pjesërisht duke dhënë vetëm tabelën e të dhënave djem e vajza dhe klasifikim sipas nr të përgjithshëm jo sipas gjinisë për nivelin e tyre në shkollë.

Ndërsa 37 prej çifteve, pra 57.8%, nuk arritën ta zhvillonin detyrën.

Pra vërehet se e kanë shumë të vështirë të lexojnë të dhëna që duhen dhënë në mënyrë statistikore, në interpretimin e një teksti të vazhdueshëm nëpërmjet një teksti jot të vazhdueshëm.

Testimi 3. (Zhvillimi i turizmit në Shqipëri, <http://open.data.al/sq/lajme/lajm/id/344/titull/Zhvillimi-i-Turizmit-ne-Shqiperi>)



- Në cilin vit kanë hyrë më shumë vizitorë në Shqipëri? _____
- Në cilin vit kanë hyrë më pak vizitorë në Shqipëri? _____
- Në cilët vite është diferenca më e madhe e futjes së të huajve në Shqipëri? _____
- Në cilët vite kanë hyrë më shumë se 1.500.000 të huaj në Shqipëri? _____
- Në cilët vite kanë hyrë më pak se 1.000.000 të huaj në Shqipëri? _____

- Në cilin vit kanë hyrë mbi 2.500.000 të huaj në Shqipëri?_____
- Në cilin vit kanë hyrë më shumë të huaj në Shqipëri, në 2009 apo 2011?__


Gjatë këtij testimi ashtu si dhe për tabelat rezultatet qenë të kënaqshme sepse:

- 82% e nxënësve e realizuan plotësisht detyrën,
- 14 % pjesërisht dhe
- 4% nuk e realizuan fare.

Kjo dëshmon se arrijnë të lexojnë tabela me të dhëna statistikore dhe grafikw duke iu referuar pyetjeve të bëra rreth tyre por nuk mund të referojnë informacionin nëse nuk ka pyetje referuese.

Testimi 4 Harta e marrë për testim është marrë nga (Gjeografia 9, Albas 2013.)
Nxënësve iu drejtuan këto pyetje në lidhje me hartën.

- Cila zonë e Shqipërisë ka densitetin më të madh të popullsisë?_____
- Cila zonë e Shqipërisë ka densitetin më të vogël të popullsisë?_____
- Cila është struktura moshore në Tiranë?_____
- Cila është struktura moshore në përgjithësi në Shqipëri?_____
- A është më e mazdhe struktura moshore 0-14 vjeç apo 15-64 vjeç në Shqipëri?_____
- Krahaso densitetin e popullsisë në rrethet Dibër e Fier._____
- Krahaso strukturën moishore të rrethit Elbasan me atë të rrethit Kavajë._____
- Si është densiteti i popullsië nga zona malore në krahasim me atë bregdetare?




U vu re se dhe në interpretimin e kësaj harte nxënësit patën rezultate të mira por jo të njëjtën performancë me tabelat dhe grafikët. Kështu vetëm;

- 52% u përgjijën saktë
- 26% pjesërisht saktë
- 22% nuk e realizuan pothuajse fare atë.

Por duhet tërhequr vëmendja se për këto detyra, pra për hartën e gjeografisë, tabelat dhe grafikët, fillimisht nuk u dhanë pyetje referuese dhe nxënësit e shihnin pothuajse të pamundur të komentonin me fjalë, të dhënat e grafikëve, në një relacion përmblendhës dhe krahasues. Detyra u bë e realizueshme vetëm pasi ata kishin pranë grafikëve, hartës e tabelës, listën e pyetjeve orientuese se çfarë kërkohesh nga të dhënat që ato përmbanin.

Testimi 5

Interpretoni me fjalë hartën e dhënë për veprimet e ushtrisë osmane dhe kundërveprimet e ushtrisë së lidhjes, në luftimet shqiptaro-osmane të vitit 1881 (Historia 9, Albas 2013)



Në lidhje me këtë detyrë për të parë rezultatin e saj korigjimi u bë në bashkëpunim me mësueset e historisë, duke kërkuar që nxënësit të respektonin plotësisht të dhënat e hartës dhe jo thjesht njohuritë që kanë për ngjarjen në interpretimin e saj.

U vu re se nxënësit

- saktë e zhvilluan detyrën në masën 11% të tyre.
- Ndërsa rreth 58 % e tyre e zhvilluan pjesërisht
- 31% nuk e zhvilluan fare atë.

Për këtë hartë nuk u pa e arsyeshme të jepeshin pyetje ndihmëse sepse ngjarja ishte e njohur në aspektin historik nga vetë teksti prej nxënësve.

Çfarë u vu re në këtë detyrë; së pari vetëm 11% ishin përgjigjur duke respektuar plotësisht të dhënat e hartës bazuar në njohuritë që kanë për ngjarjen ndërsa pjesa që I janë përgjigjur pjesërisht asaj I kanë respektuar fare pak të dhënat me shigjeta të hartës duke e interpretuar atë më tepër në bazë të njohurive që kanë për ngjarjen se në bazë të të dhënave.

Në lidhje me këtë hartë përveç korigjimit, iu kërkuar mësuesvet të historisë të jepnin një mendim dhe rreth terminologjisë së përdorur nga nxënësit në interpretim. Një nga mësuesit nuk vuri në dukje problematika të mëdha në lidhje me terminologjinë, ndërsa mësuesi tjetër theksoi se gjuha e përdorur nga nxënësit, I rri larg terminologjisë së shkencës së historisë duke e dhënë si një ngjarje të treguar normalisht.

Ky problem do ta vihet re më poshtë dhe në testimin dhe për lëndën e matematikës.

Testimi 6

Ky testim u hartua në bashkëpunim me mësuesit e matematikës në shkollë duke parashtruar si kërkesë që primar në këtë testim nuk është saktësia shkencore matematikore në veprime, por përdorimi I gjuhës në mënyrë shkencore, të saktë dhe të kuptueshme nga ana e nxënësve dhe të kuptuarit e gjuhës matematikore nga nxënësit për të relizuar zgjidhjen e testit.

- Përkthe me fjalë në gjuhën e zakonshme
 $(a+b) \cdot 5$
 $5+a \cdot b$
 10: $(a-b)$
 $3 \cdot a-b$

Në lidhje me këtë pyetje në pamjen e parë duket se u përgjigjën

- 63% e nxënësve por që në fakt
- me terminologjinë e duhur matematikore vetëm 10% e tyre,
- ndërkohë që 27% nuk e kishin zhvilluar fare atë.

Gjatë kontrollit që u bë në bashkëpunim me mësuesit e matematikës (me 5 mësues) se cila duhej të ishte përgjigjia më e saktë vetëm dy prej tyre e quajtën problem që nxënësit nuk kishin përdorur terminologjinë e duhur në përgjigje.

Psh për pikën e parë përgjigjia e saktë duhej të ishte;

“shuma e dy numrave a dhe b e shumëzuar me pesë”.

Pjesa më e madhe e nxënësve kishin dhënë përgjigje si më poshtë;

“ a e mbledhim me b dhe e shumëzojmë me pesë”.

- Shkruani në gjuhën matematikore këto fjali;
 Dyfishi i a i zmadhuar me 7 $2 \cdot a+7$
 Trefishi i ndryshesës së numrave a e bështë dyzet e pesë. $3 \cdot (a+b)=45$
 Ndryshesa e pesëfishit të një numri me 1 $5X-1$

Në këtë detyrë janë përgjigjur;

- 27% e nxënësve - plotësisht
- 13% e tyre - pjesërisht

- 60% e tyre nuk kanë arritur ta zhvillojnë, duke treguar se kanë mangësi të shumta në të kuptuarit e gjuhës shkencore, ose kanë problemin e përkthimit të fjalëve në simbole matematikore.

- Pyetja 3 Problemë
Në një klasë numri i djemve është 4 herë më i vogël se i vajzave. Shkruaj me simbole matematike;
Numrin e djemve të klasës $X/4$
Numrin e nxënësve në klasë $X/4 + X$
Numri i nxënësve në klasë është $28 X/4 + X = 28$
Kjo problemë u arrit të interpretohej vetëm nga 21% e nxënësve plotësisht 37% pjesërisht dhe 42% nuk u interpretua fare.

- Ndonëse nuk janë përfshirë në testim një problem më vete përbëjnë sipas mësuesve të matematikës funksionet. Më tepër se zgjidhja e tyre, shpjegimi me fjalë ose ndërtimi I tyre nisur nga fjala është tepër I vështirë për nxënësit.
Por ky problem i njohjes së terminologjisë sipas fushave nuk i përket vetëm shkencave natyrore por dhe atyre shoqërore, sidomos në ato raste që kërkohet jo thjesht njohje e gjuhës por përdorim i saj në nivel të analizës e argumentit.

Testi 7 Lënda: Edukatë shoqërore.

U zhvillua një minitest me nxënësit e klasës së IX me këto pyetje;

- Ç'është demokracia,
- Mbi ç'parime mbështetet ajo?
- Cilët janë elementet e demokracisë?
- Argumento përse elementet e demokracisë janë si hallkat e një zinxhiri ku njëri prej tyre të mos funksionojë dhe demokracia nuk funksionon si duhet.

Për tri pyetjet e para diku plotësisht e diku me disa mangësi u përgjigjën 83% e nxënësve. Ndërsa për pyetjen e fundit u përgjigjën në masën 9% ndonëse pyetja ishte e lidhur ngushtësisht me tri përgjigjet e para dhe kërkonte përdorimin e gjuhës në mënyrë logjike në një nivel më të lartë dhe më kerativ, në nivel argumenti.

Duket se problemi duhet kërkuar në kurikulat shkollore. Duke parë programet egzistuese të gjuhës shqipe vërehet se vetëm në klasën e IX nxënësi duhet të shpjegojë harta e grafikë, ndërkohë që puna me gjuhën në shpjegimin e grafikëve, tabelave e

hartave fillon shumë më parë. (Programi i lëndës së gjuhës shqipe për klasën e nëntë, Shkurt 2010, <http://izha.edu.al/View/Biblioteka,/gjuha9.pdf>)

Por sipas vëzhgimit që i është bërë teksteve të gjuhës për klasën e nëntë, është vërejtur se vetëm një tekst “Gjuha shqipe 9”, shtëpia botuese “Shkronjë pas shkronjë”, Tiranë 2010, f. 72, i ka lënë një hapësirë krejt të vogël ndërtimit dhe shpjegimit të grafikëve përmes gjuhës. Ndërkohë dihet që veç programit një rol të rëndësishëm në hartimin e planeve shkollore, zënë tekstet dhe në to realisht mungojnë përdorime të tilla të gjuhës.

Por përvetësimi i gjuhës nuk është problematike veç në këtë drejtim që ne e pamë si më të prekurin ndaj dhe e trajtuam në veçanti. Nxënësit paraqesin problem me gjuhën amtare në shumë fusha të jetës dhe që më të dukshme janë në lexim-shkrim.

Nga eksperiencia e vendeve të Europës, që të mësuarit me kompetenca e kanë aplikuar më herët, gjuha amtare, pavarësisht prioriteteve që i jepet TIK-ut dhe shkencave, ka rolin më të rëndësishëm në aftësimin e nxënësve për jetën. Lidhur me këtë vende të ndryshme aplikojnë politika kombëtare nga më të ndryshmet që nuk ndërmerren vetëm në shkollë por në mbarë jetën shoqërore të vendit duke kombinuar të mësuarit e gjuhës përmes shkollës, medias, familjes etj.

Kështu në shumë vende planet e veprimit për lexim shpesh përqëndrohen në nxitjen e leximit si pjesë e të mësuarit gjatë gjithë jetës. Për shembull në Portugali, strategjia kombëtare e leximit promovon një sërë iniciativash si; leximi në familje; reklama televizive në lidhje me leximin dhe me veprimtari në institucione të ndryshme të tilla si bibliotekat publike, shoqatat kulturore, etj.

Në raste të tjera, po zbatohen strategji të veçanta arsimore të shkrim-leximit që të përqëndrohen në përvetësimin e aftësive në shkrim e lexim në gjuhën amtare, kryesisht në kontekstin e shkollës dhe pjesa më e madhe e shteteve po zbatojnë strategji kundër analfabetizmit të kombinuara këto me strategji të numrave.

(Developing Key Competences at School in Europe: f 18 http://eacea.ec.europa.eu/EDUCATION/EURYDICE/documents/thematic_reports/145EN.pdf)

Në rekomandime sugjerohet që të ketë mësues të veçantë dhe të specializuar të leximit të cilët duhet të jenë të pranishëm qoftë dhe si mësues ndihmës, gjë që vetëm pak vende e aplikojnë. Kështu vetëm në Britaninë e Madhe dhe vendet Skandinave ka mësues specialist për të lexuarit, pak vende kanë mësues ndihmës për të mësuarit ndërkohë që pjesa më e madhe e vendeve të Europës ku bën pjesë dhe Shqipëria nuk kanë mësues të specializuar për të lexuarit.

(Developing Key Competences at School in Europe: f40 http://eacea.ec.europa.eu/EDUCATION/EURYDICE/documents/thematic_reports/145EN.pdf)

Konkluzione

- Përvetësimi i gjuhës në moshat shkollore si një kompetencë që i aftëson për jetën është në një nivel shumë të dobët.
- Problemet janë kryesisht në lexim-shkrimin e teksteve jo të vazhdueshme.
- Kryesisht paraqesin vështirësi në interpretimin gjuhësor të hartave, grafikëve, tabelave e diagramave që nuk kanë udhëzues.
- Nuk zbërthejnë dot saktë me fjalë, simbole matematikore dhe nuk përkthejnë saktë gjuhën nëpërmjet simboleve.
- Nuk njohin terminologjinë shkencore të fushave të ndryshme dhe kanë vështirësi të lexim-shkrimit në fusha të ndryshme.
- Kanë përdorim të gjuhës në nivel nohjeje e zbatimi duke hasur shumë vështirësi në nivel argumenti, sintetizimi e analize krahasuese.

Rekomandime

- Të përmirësohet kurrikula shkollore ku lexim-shkrimi i teksteve jot ë vazhdueshme të ecë paralel me tekstet e vazhdueshme.
- Të aplikohen metoda të reja mësimdhënieje që sigurojnë përvetësimin e gjuhës jo thjesht në nivel njohjeje e zbatimi por dhe të përdorimit të saj në nivel argumenti, analize sintetizimi etj.
- Të synohet për një të lexuar logjik, jo thjesht linear por dhe kreativ.
- Të orientohet të mësuarit e gjuhës më shumë si aftësi për jetën se sa si një dodmosdoshmëri shkollore.
- Të aftësohen mësuesit e të gjitha fushave duke i konsideruar veçse mësimdhënës të fushës së tyre dhe mësues gjuhe.
- Të aplikohen strategji kombëtare përmes medias, bibliotekave, shoqatave e familjes në luftë kundër analfabetizmit dhe ndihmë të lexim-shkrimit.

Litertatura

1. Korniza kurrikulare e arsimit parauniversitar të republikës së Shqipërisë. Tiranë, 2014
http://www.izha.edu.al/index.php?option=com_content&view=article&id=55&Itemid=74
2. Komisioni europian, Edukim dhe trainim. Mbështetja e mësuesve për zhvillimin e kompetencës dhe rezultate më të mira të të mësuarit. Qershor 2013.

- http://ec.europa.eu/education/policy/school/doc/teachercomp_en.pdf
3. Fjalor i reformës së edukimit. Kompetencat bazë të të mësuarit, 5 Maj 2014
<http://edglossary.org/competency-based-learning/>
4. Kompetencat kryesore në shkollat e Europës, Zhvillimi, sfidat dhe, mundësitë për politika. nëntor 2012, fig 1.1)
http://eacea.ec.europa.eu/education/eurydice/documents/thematic_reports/145EN.pdf
5. Divizioni i politikave gjuhësore, Gjuha në lëndët e tjera, Referues I grupit të punës Helmut VOLLMER, 2009
https://www.google.al/?gësd_rd=cr&ei=OzzUVZG4AYKjsAHN7bqYCA#q=Languag+in+Other+Subjects+Language+Policy+Division
6. Afësitë dhe kompetencat e shekullit XXI, Katerina Ananiadou, Magdalean Claro: EDU/WKP, 18 dhjetor 2009, f 7
[http://www.oecd.org/officialdocuments/publicdisplaydocumentpdf/?cote=EDU/ËKP\(2009\)20&doclanguage=en](http://www.oecd.org/officialdocuments/publicdisplaydocumentpdf/?cote=EDU/ËKP(2009)20&doclanguage=en)
7. Cilësia e Arsimit dhe Mundësitë për Zhvillimin e Aftësive në Shqipëri Analizë e rezultateve të PVNN-së 2000-2012 Qershor 2014,
<http://www.worldbank.org/content/dam/Worldbank/document/eca/Albania/al-pisa-report-al.pdf>
8. Developing Key Competences at School in Europe: f 18
http://eacea.ec.europa.eu/EDUCATION/EURYDICE/documents/thematic_reports/145EN.pdf
9. Programi i lëndës së gjuhës shqipe për klasën e nëntë, Shkurt 2010,
<http://izha.edu.al/View/Biblioteka./gjuha9.pdf>
10. VJETARI STATISTIKOR PËR ARSIMIN 2012 - 2013 dhe seri kohore
<http://www.arsimi.gov.al/files/userfiles/statistik>
11. Zhvillimi i turizmit në Shqipëri,
<http://open.data.al/sq/lajme/lajm/id/344/titull/Zhvillimi-i-Turizmit-ne-Shqipëri>
12. Gjeografia 9, Albas, Tiranë 2013
13. Historia 9, Albas, Tiranë 2013
14. Gjuha shqipe 9, Shkronjë pas shkronje, Tiranë 2010

Carrie Ann MORGAN

(RI)REGJISTRIMI I DIALEKTEVE TË SHQIPES DHE TË VEÇORIVE TË TYRE NË KONTEKSTIN E TIRANËS SË SOTME

Hyrje

Vala e tretë e sociolinguistikës dhe antropologjia gjuhësore dallohen për theksin që i vënë kuptimit socio-indeksues. Kjo do të thotë që ndryshe nga shumica e gjuhëtarëve që kanë si objekti kryesor të studimit kuptimin denotativ, studimet e kësaj qasjeje hulumtojnë mënyrën në të cilën gjuha merr strukturën e saj në bazë të funksioneve shoqërore që kryen dhe nga ana tjetër si shërben gjuha si mjet për të krijuar rendin shoqëror (Eckert, 2012). Kjo qasje i konsideron folësit të vullnetshëm, po jo doemos të ndërgjegjshëm, të shfrytëzojë rrjedhshmërinë e kategorive shoqërore për të arritur rezultate të ndryshme ndërveprimore nëpërmjet gjuhës, dialekteve, ose veçorive gjuhësore të ndryshme.

Këto kuptime socio-indeksuese varen nga njohuritë kulturore dhe për këtë arsye tri koncepte janë tejet të rëndësishëm në studime të tilla: ideologjitë gjuhësore, regjistimi [*enregisterment*], dhe sfera indeksuese [*indexical field*]. Ideologjitë gjuhësore mund të përshkruhen thjeshtë si “komplete të besimeve për gjuhën të artikuluar nga folësit si shpjegim ose justifikim për strukturën dhe përdorimin e përceptuar të gjuhës” (Silverstein, 1979: 193). Për shembull, është ideologjike të themi që paskajorja geqe tregon origjinën veriore të një folësi sepse gama e efekteve që mund të sjell ndonjë veçori gjuhësore, duke përfshirë dhe paskajorjen geqe, në momentin e ndërveprimit është shumë më e madhe se sa kaq (Agha, 2007: 159). Regjistrimi është procesi që krijon këto lidhje ideologjike duke bërë gjuhën objekt kulturor (Agha, 2007; Campbell-Kibler, 2012) dhe sfera indeksuese është “togu i kuptimeve socio-indeksuese të lidhura ideologjikisht me gjuhën, dialektin, ose veçorinë” (Eckert, 2008). Prova e këtyre dukurive gjejmë në komente metalinguistike dhe në përdorimin e përditshëm të gjuhës.

Në kontekstin shqiptar shumëkush ka folur për ideologjitë e standardit dhe ndryshimet në to në periudhën passocialiste. Për shembull, Vehbiu (1997) ka shkruar për “rilindjen geqe” dhe për humbjen e “prestigjit” që ka pësuar standardi. Megjithatë ka mbetur akoma për të studiuar në mënyrën sistematike se si funksionojnë ideologjitë

gjuhësore në jetën e përditshme të folësve. Kjo është veçanërisht e rëndësishme sepse shpërdarja e ideologjive gjuhësore në shoqëri nuk është homogjene. Në vende të ndryshme dhe mes grupeve të ndryshme të Shqipërisë (si dhe të Kosovës që nuk është fokusi i këtij studimi) ka ideologji të ndryshme.

Ideologjitë gjuhësore kanë një rëndësi të veçantë në qendrat e kontaktit mes varieteteve të shqipes, siç është Tirana. Në këtë qytet shumëzërësh, studentët janë shumë të ekspozuar ndaj varieteteve të ndryshme meqë bota e tyre shoqërore që nga konviktet deri në festat është e populluar nga varietetet e ndryshme të shqipes. Pra, pyetja kryesore e këtij studimi është: çfarë ideologjish gjuhësore përftohen në kontekstin e kontaktit mes studentëve në Tiranë dhe cilat janë pasojat për regjistrimin dhe sferën indeksuese të dialekteve dhe të veçorive të tyre? Argumenti që do të sjell është që dialekti i Shqipërisë së mesme po merr statusin e një dialekti më vete në rendin ideologjik dhe që disa veçori që historikisht gjuhëtarët i kanë cilësuar si “gege” po marrin një tjetër kuptim socio-indeksues. Kjo mund të quhet ri-regjistrimi dhe zgjerimi i sferës indeksuese.

Metodologjia

Vendimi im për të marrë qasjen e ideologjive gjuhësore është bazuar në respektin për njohuritë vendore kulturore dhe në mohimin e përparësisë së patundur të mendimit të analistit që, si ato të folësve, nuk mund të përfaqësojë “pikëpamje nga kurrkundi” (Gal & Irvine, 2000: 36; Bucholtz, 2003: 404). Me fjalë të tjera, në këtë qasje analistja nuk mohon subjektivitetin e saj të pashamgshëm. Të dhënat kryesore në këtë studim janë mbledhur në Tiranë përmes intervistave metalinguistike me 14 të rinj (nga mosha 18-28, të pamartuar, pa fëmijë). Metoda e përzgjedhjes së mostrave ishte e qëllimshme (Oliver, 2006: 245-6), bazuar në rrjetin tim shoqëror në Tiranë. Shumica e pjesëmarrësve janë studentë, por disa janë vetëm pjesë e një rrjeti shoqëror me studentët. Veç të dhënave nga intervistat, do të shfaq edhe disa të dhëna nga një sondazh me 21 studentë në Tiranë. Këto të dhëna ishin thjeshtë për një “studim - pilot”, por në këtë rast shërbejnë njëkohësisht për të mbështetur argumentin. Së fundmi, kam marrë të dhëna edhe nga një bisedë në blogun “*Peshku pa ujë*”.

Geg, Tosk dhe krijimi i dialektit të Shqipërisë së Mesme

Raportet mes konceptimit “geg” dhe “tosk” si varietete të idealizuara gjuhësore dhe i konceptimit “geg” dhe “tosk” si etiketime të gjeografisë dhe të tipeve të njeriut është kryesore për ideologjitë gjuhësore sepse këto të fundit funksionojnë me anë të

analogjive mes këtyre konceptimeve. Nga njera anë, ideologjia esencjaliste që mëton lidhje primare dhe kategorike mes gjuhës dhe identitetit është shprehur nga shumë rilindas, si për shembull Faik Konica që ka thënë se ndryshimet në karakterin e gegëve dhe të toskëve shprehen nëpërmjet ndryshimeve në dialektet e tyre (Byron, 1967: 52-58). Kjo ideologji bashkë me atë të standardit në kohën e socializmit ka lejuar që cilësimi kulturor i përfutur në kohën e osmanëve që gegët janë “malokë të trashë” dhe toskët “elitë institucionale” (Blumi, 2011: 21) të shërbejë si kornizë për të cilësuar vetë varietetet gjuhësore. Si rezultat, varietetet gjuhësore janë bërë ikona e cilësive si “trashësi”, “edukatë”, “modernitet”, ose “njësi”.

Edhe pse ky rend ideologjik është akoma në fuqi, ndryshimet shoqërore në periudhën passocialiste e kanë lëkundur disi. Rilindja gege dhe lidhja ideologjike mes standardit dhe socializmit kanë zgjeruar sferën indeksuese të dialektit geg dhe dialektit standard. Ndikimi ndaj dialektit tosk, edhe pse më pak i qartë, duhet të jetë lidhur me atë të standardit. Dialekti geg ka marrë prestigjin e një kodi që kundërshton hegjemoninë e totalitarizimit dhe të standardit ndërkohë që standardi ka marrë deri diku vlerat e kundërta nga ato që kishte më përpara: ndarje dhe prapambetje socialiste. Në këtë mënyrë, sferat indeksuese të këtyre varieteteve janë zgjeruar. Figura 1 tregon sferën indeksuese të këtyre varieteteve sipas ideologjive të ndryshme.

<i>malokë</i> <i>trashësi</i> GEGËRISHT <i>demokraci</i> <i>pluralizëm</i>	<i>njësi</i> <i>modernitet</i> STANDARDI <i>socializëm</i> <i>ndarje</i>	<i>standard</i> <i>edukatë</i> TOSKËRISHT ???
--	---	---

Figura 1

Megjithatë, ka një pjesë tjetër të njohurisë kulturore për të cilën flitet më pak nga gjuhëtarët, po që është me peshë të madhe në këtë sistem: Shqipëria e mesme. Dikur rilindësit kanë bërë analogji mes këtij varieteti dhe gjeografisë së tij, duke thënë që meqë ishte gjeografikisht “në mes” të veriut dhe të jugut mund të shërbente si varietet i mesëm gjuhësisht (Byron, 1976: 58). Edhe pse historikisht gjuhëtarët thonë se i përket dialektit geg si nëndialekt jugor (p.sh. Gjinari, 2003; Shkurtaç, 2012), duket që të paktën disa folës e klasifikojnë ndryshe.

peshku pa ujë

A është dialekt më vete e folura e Shqipërisë së Mesme?


1 Prill 2012 - 06:14

Kudo që lexon dicka për Shqipërinë thuhet që egzistojnë dy grupe të medha gjuhësore: gegerisht - toskerisht. Mos të flasim për debatet e koheve të fundit mbi gjuhën letrare.

Po Shqipëria e mesme a nuk ka dialekt më vete?

Figura 2: Titulli i bisedës në blogun “Peshku pa ujë”


Në blogun *Peshku pa ujë*, pseudonim *alke* bën pyetjen, “A është dialekt më vete e folura e Shqipërisë së Mesme?” Përgjigjet janë të ndryshme, por mund të klasifikohen gjësisht në tre kategori: (1) Dialekti i Shqipërisë së mesme është geg (*Figura 3*), (2) Dialekti i Shqipërisë së mesme është përzierje e gegërishtes dhe toskerishtes (*Figura 4*) dhe (3) Dialekti i Shqipërisë së mesme është dialekt më vete (*Figura 5*). Ka dhe komente që ky dialekt është më standard. Komentet në figurat më poshtë janë shembuj të këtyre diskutimeve.

 romaku - 1 Prill 2012 - 17:26

Keta kane nje variant katunar te gegerishtes. I ke degjuar elbasanasit sa shemtut flasin?

13 PËRGJIGJE

Figura 3

 Dora_Noli - 1 Prill 2012 - 17:58

Jo s'ka. Eshte nje shartim i gegerisht me toskerisht. Pastaj mund te kete nen-grupime vendore.

11 PËRGJIGJE

Figura 4

 Tironc Pa Hesap2012 - 3 Prill 2012 - 18:00

Po ajo oshte nje djalekt me vete

Figura 5

Nga vetë pyetja si dhe përgjigjet kuptohet që statusi i Shqipërisë së mesme nuk është i qartë. Ky është konkluzioni që unë kam nxjerrë edhe nga sondazhi dhe intervistat me të rinjtë në Tiranë. Figura 6 tregon përgjigjet e 21 studentëve ndaj pyetjes, “Cilat janë dialektet e gjuhës shqipe?” Siç e shohim, 9 (.43) studentët janë

përgjigjur që dialektet janë tre – veriu/geg, Shqipëria e mesme, dhe jugu/tosk – dërsa 12 (.57) janë përgjigjur që dialektet janë dy – veriu/geg dhe jugu/tosk.




Figura 6

Por si shpjegohet dukuria e Shqipërisë së mesme? Disa komente nga intervistat dhe një koment në blogun na tregojnë që kjo është çështje e një ideologjie që e interpreton Shqipërinë nëpërmjet një modeli qendër-përfëri e jo veri-jug. Më poshtë, Lule tregon një histori që paraqet një ideologji pak ndryshe nga ajo që pamë në sferat indeksuese të gegërishtës, toskërishtës dhe standardit. Këtu Shqipëria e mesme dallohet nga veriu dhe jugu sepse këto dy të fundit janë “shumë të fortë edhe në karakter”. Domethënë kemi të bëjmë me konceptimin e “geg” dhe “tosk”, ose “veri” dhe “jug”, si tip njeriu që është larg nga norma e qendrave urbane të Shqipërisë së mesme.

L: Prapë për mu ekstremet janë të dyja të forta, ekstremet edhe jugu edhe veriu të dyja, domethënë, janë të forta. Mbjaj mend një histori që na ka tregu, me atë Xhenin e Vlorës.

C: Për gjitonën?

L: Jo jo jo për gjitonën @@. Këta ishin, ishte Xheni në klasë edhe takoi një gocë e duke u prezantuar kështu si shoqet në klasë <Që nga je ti? unë nga Vlora Q> i thotë kjo, <Q po ti nga je? Q> <Q nga Tropoja, ej mirë se komshija qenkemi. Q> e kupton @@? se qenkemi aq afër @@. e kupton? praktikisht e njëjta gjë, janë të dy ekstremet, janë shumë të forta si me karakter.

Pastaj, Ardita tregon që veriu dhe jugu kanë më shumë “krahinorizma” ndërkohë që Shqipëria e mesme është më letrare ose standarde.

A: Jo jo, {Shqipëria e mesme} dallohet edhe nga gjuha se, domethënë, në qoftë se, ecën më në veri [për shembull, janë më- janë më shumë rreth] drejt gegërishtës, kurse Shqipëria e mesme pakashumë ka gjuhën standarde.

C: ëh hëh

A: përdorin gjuhën standard[.janë drejt letrares. kurse:::]...në të dyja anët e::, domethënë s'ka- në dy pjesët e tjera të Shqipërisë, domethënë kur e marrim..veriore edhe jugore, kanë më shumë, domethënë këto krahinorizmat ose janë më të- janë si më të thelluar në një pjesë domethënë, nuk është se janë drejt standartes.

Prapë kemi të bëjmë me analogjinë ku përceptimi i dallimit shoqëror bazuar në koncepte kulturore ndikon në përceptimin e gjuhës si reflektim i identitetit shoqëror. Një koment nga *alke* në blogun, përmbledh këtë ide:




Figura 8

Me fjalë të tjera, Shqipëria e mesme është zona më urbane në Shqipëri. Ideologjikisht urbaniteti lidhet me modernitetin. Këto cilësi kulturore duhen reflektuar dhe në gjuhën që lidhet me këtë rajon. Gegërisht nuk shkon sepse veriu kuptohet si rural dhe tradicional ndërkohë që dialekti standard është më i përshtatshëm si simbol i modernitetit në një ideologji. Për të rregulluar këtë “mospërputhje”, e quajmë dialektin e Shqipërisë së mesme dialekt standard. Mund t’i shtojmë Shqipërinë e mesme skemës së sferave indeksuese të varieteteve të gjuhës shqipe.

<i>rural</i>		<i>njësi</i>	<i>standard</i>	<i>rural</i>	<i>urban</i>
malok		<i>modernitet</i>			<i>modern</i>
<i>trashësi</i>		STANDARDI	TOSKËRISHT		SHQIPËRIA
GEGËRISHT		<i>socializëm</i>			E MESME
<i>demokraci</i>		<i>ndarje</i>	<i>edukatë</i>		TirOns
<i>pluralizëm</i>					

Figura 9

Veçoritë ideologjike

Cilat janë pasojët e këtij modeli qendër-periferi që e cilëson Shqipërinë e mesme si dialekt me vete dhe më standard? Kuptimet socio-indeksuese mund të lidhen, siç e pamë, me varietete të tëra, por gjithashtu mund të lidhen me veçoritë e këtyre varieteteve. Si rezultat, kjo ideologji qendër-periferi ndikon në menyrën që cilësojmë veçoritë gjuhësore të lidhura, qoftë nga gjuhëtarët qoftë nga folësit e tjerë, me geg, tosk dhe Shqipërinë e mesme. Në këtë rast do të përmend disa veçori që folësit nga intervista i lidhin bashkë me etiketimin “shkurtime”.

Në fund të intervistave kishte pyetje edhe mbi disa veçori specifike të prezantuar në shkrim. Ndër këto veçori ishin pjesorja dhe togjet e zanoreve *ue/ua* dhe *ye*. Sipas Atlasit Dialektologjik variantet e këtyre “të shkurtuara” kanë shpërndarje pak a shumë në veri të Shkumbinit. Shkurtaç (2012: 56, 101-102) i cilëson këto si gege. Ndërkohë Gjinari (2003: 194) shkruan për togjet zanore, “Gjenden këto togje si të tilla (të paredukuara) dhe të pandryshuara në të gjitha të folmet e toskërishtes,” dhe për pjesoren, “Me përjashtim të rasteve të pakta...sot në të folmet e Jugut pjesoren e gjejmë të paredukuar.” Kështu që dialektologjia shqiptare i klasifikon variantet e shkurtuara si gege dhe ato të pashkurtuara si toske.

Megjithatë, folësit që kanë marrë pjesë në intervista kanë patur një tjetër shpjegim. Këto variante të shkurtuara, ndonjëherë bashkë me togjet e bashkëtingulloreve, përbëjnë një kategori “shkurtime”. Ndryshe nga paskajorja ose përcjellorja gege që ishin të regjistruara fort si gege për folësit, pjesorja e shkurtër dhe togjet e reduktuara shihen jo si gege, po si pjesë të një regjistri joformal që flitet sidomos në Tiranë. Për ata nga jugu, ndërkohë që përdorimi i paskajores ose përcjellores gege duket i papranueshëm, ata mund të përvetësojnë pjesoren e shkurtër dhe togjet e reduktuara pa problem ideologjik. Para se t'i prezantoja shembujt në shkrim, Tatjana, një studente nga Kuçova, më shpjegoi që kishte ndryshuar të folurën e saj qëkur ka ardhur në Tiranë:

Tatjana [24, nga Kuçova]

shkurtimi i fjalëve... 'çfarë **du**.' nuk them 'çfarë **dua**' për shembull. E shof si më tërëhatshme. Pastaj pjesa tjetër nuk e ndryshoj dot.

Të intervistuarit e tjerë kanë cilësuar “shkurtime” në mënyrë të ngjashme, duke thënë që janë pjesë e një ‘dialekti të lehtë’ ose ‘përtesë’. Kështu që ndryshe nga variantet e paskajores dhe përcjellores që gjuhëtarët i cilësojnë si gege, këto “shkurtime” që cilësohen si gege në dialektologjinë shqiptare, nuk janë të regjistruara

si gege në njohurinë kulturore të këtyre studentëve. Madje, kur unë kam cilësuar këto “shkurtime” si gege në një intervistë, Lule, një studente nga një qytezë afër Elbasanit, më ka shpjeguar që dialekti i Tiranës, që nuk është geg, i ka “huazuar” nga gegërishtja.

Një provë tjetër për statusin e këtyre “shkurtimeve” është përdorimi i pjesores në intervista. Në nëntë intervista ku kishte vetëm një folës, kam koduar 15 minutat e para të intervistave për paskajoren, përcjelloren dhe pjesoren. Ndërkohë që kishte vetëm një përdorim të paskajores gege dhe nuk kishte asnjë të përcjellores gege, nga 173 përdorime të pjesores, 26 (15%) ishin të shkurtra dhe 147 ishin të gjata (85 %). Tabela 1 dhe Figura 10 tregojnë përqindjen e përdorimeve nga secili folës. Në Figurën 10, shkronjat në kllapa tregojnë vendin ku ka lindur dhe mbaruar gjimnazin folësi përkatës.

Darina	Lule	Kujtm	Arjan	Besa	Illir	Jurgen	Tatjana	Vilma	
5 (.33)	7(.35)	1(.04)	1(.2)	0(.0)	8(.31)	0(.0)	4(.16)	0(.0)	26(.15)
10(.33)	13(.65)	25(.96)	4(.8)	20(1.0)	18(.69)	17(1.0)	21(.84)	19(1.0)	147(.85)
15	20	26	5	20	26	17	25	19	173(1.0)

Tabela 1: përdorimi i pjesores; gri i errët = e shkurtrë, gri i çelët = e gjatë




Figura 10

Edhe pse mbetet për të studiuar variabla parashikuese e variacionit të pjesores, të rëndësishme këtu janë dy gjëra. E para, komentet metalinguistike të folësve tregojnë që “regjistrimi” i pjesores është ndryshe në krahasim me atë të paskajores dhe

përcjellores dhe kjo është në përputhje me përdorimet aktuale në intervista. E dyta, përdorimi i pjesores nuk është kategorik brenda folësit, as brenda grupeve sipas vendlindjes apo vendit të gjimnazit. Kjo e fundit do të thotë që duhet trajtuar si një variabël sociolinguistike e jo vetëm dialektologjike.

Interpretime dhe Përfundime

Me këto të dhëna jam përpjekur të përdor koncepte teorike nga traditat e sociolinguistikës dhe antropologjisë gjuhësore për të zërthyer kontekstin e kontaktit mes folësve të varianteve të ndryshme të gjuhës shqipe në Tiranën e sotme. Të dhënat që kam prezantuar tregojnë që ideologjitë esencialiste krijojnë lidhje analogjike mes aspekte kulturore dhe gjuhësore të koncepteve “geg”, “tosk”, dhe “standard”. Si rezultat, regjistrimi dhe sferat indeksuese të tyre duken që janë në ndryshim e sipër. Kjo është veçanërisht e theksuar në rastin e Shqipërisë së mesme dhe të “shkurtimeve”. Zhvillimi urban i Shqipërisë së mesme si zonë gjeografike me “4 nga qytetet më të mëdha” në Shqipëri ka krijuar imazh kulturor që nuk i përshtatet atij geg. Për të justifikuar këtë mospërputhje, Shqipëria e mesme po merr statusin e një dialekti më vete, që ndryshon nga dialekti geg. Në këtë kontekst, modeli i dallimit veri-jug po kthehet në model qendër-periferi, ku Shqipëria e mesme shërben si qendra “normative” po aq në gjuhë sa edhe në kulturë. Në mënyrë të ngjashme, “shkurtimet”, sidomos pjesorja e shkurtër, po humbin lidhjen e tyre me dialektin geg.

Lidhja e dukurisë së Shqipërisë së mesme me atë të “shkurtimeve” mbetet akoma për t’u zërthuar, por fakti që të dyja dukuritë kanë të bëjnë me “zbardhjen” e lidhjes me dialektin geg është interesante. Për më tepër, komentet e studentëve nga jugu që “shkurtimet” janë veçori që mund t’i “huajzojnë” kur vijnë në Tiranë, gjithashtu dëshmojnë që janë të lidhura. Lidhja e Shqipërisë së mesme me standardin, komentet e studentëve që “shkurtimet” janë “dialekt i lehtë”, dhe përdorimi i pjesores së shkurtër në kontekstin pak a shumë formal të intervistës janë edhe më interesante kur marrim parasysh rezultatet e studimit të Moosmüller-it (2006) mbi zanoret e dialektit standard. Ajo shkruan: “It rather looks as if the North influences the South and the South influences the North, so that ultimately, a counter-balanced Standard variety might emerge.” Duke patur këtë ndërmend, studimet e ardhshme mund të hulumtojnë nëse këto të dhëna mbi Shqipërinë e mesme dhe “shkurtime” janë gjithashtu pjesë e këtij “ri-regjistrimi” të variantit standard.

Referenca

- Agha, Asif. 2007. *Language and Social Relations*. Cambridge: Cambridge University Press.
- Blumi, Isa. 2011. *Reinstating the Ottomans: Alternative Balkan modernities*. New York: Pelgrave MacMillian.
- Bucholtz, Mary. 2003. Sociolinguistic nostalgia and the authentication of identity. *Journal of Sociolinguistics*, 7:3, 398-416.
- Byron, J. 1976. *Selection among Alternates in Language Standardization: The Case of Albanian*. The Hague: Mouton & Co.
- Campbell-Kibler, Kathryn. 2012. Contestation and Enregisterment in Ohio's Imagined Dialects. *Journal of English Linguistics*, 40(3): 281-305.
- Eckert, Penelope. 2008. Variation and the Indexical Field. *Journal of Sociolinguistics*, 12:4, 453-476.
- 2012. Three Waves of Variation Study: The Emergence of Meaning in the Study of Sociolinguistic Variation. *Annual Review of Anthropology*, 41: 87-110.
- Gjinari, Jorgji; Shkurtaj, Gjovalin. 2003. Dialektologjia. Tiranë: Shtëpia Botuese e Librit Universitar.
- Ginjari, Jorgji, Bahri Beci, Gjovalin Shkurtaj, Xheladin Gosturani, eds. 2007-2008. *Atlasi dialektologjik i gjuhës shqipe*, 2 vols. Napoli: Univ. degli Studi di Napoli l'Orientale.
- Irvine, J. T., and Gal, S. 2000. Language Ideology and Linguistic Differentiation. In P. V. Kroskrity (ed.) *Regimes of Language* (pp. 35–84). Sante Fe, NM: School of American Research Press.
- Moosmüller, Sylvia; Granser, Theodor. 2006. The Spread of Standard Albanian: An illustration based on the analysis of vowels. *Language Variation and Change*, 18.
- Oliver, Paul. 2006. Purposive Sampling. In Victor Jupp (ed.) *The SAGE dictionary of social and cultural research methods*. Retrieved from:
<http://srmo.sagepub.com.proxy.lib.ohio-state.edu/view/the-sage-dictionary-of-social-research-methods/n162.xml>
- Shkurtaj, Gjovalin. 2012. *Dialektet e shqipes*. Tiranë: Botimet Morava.
- Silverstein, Michael. 1979. Language Structure and Linguistic Ideology. In P.R. Clyne, W.F. Hanks, C.L. Hofbauer (eds.) *The Elements: A Parasession on Linguistic Units and Levels* (pp. 193-247). Chicago: Chicago Linguistic Society.
- Vehbiu, Ardian. 1997. Standard Albanian and the Geg Renaissance: A Sociolinguistic Perspective. *The International Journal of Albanian Studies*, 1:1, 5-20.

Bardh RUGOVA

GJUHA E SHKENCËS: SHEMBULLI I ALBANISTIKËS

Synimi i këtij studimi është t'i hulumtojë dhe t'i përshkruajë mjetet gjuhësore të shqipes, me të cilat realizohet një punim shkencor. Duke u nisur nga supozimi se studimi do këndvështrim neutral, doracakët e ndryshëm të shkrimit akademik parashkruajnë modele të hartimit të një studimi objektiv, ndërsa autorë të ndryshëm (Lloshi 1999, Kukharenko 2000) tek i përshkruajnë stilet funksionale në gjuhë, e propozojnë stilin shkencor, si një stil i veçantë, përmes të cilit realizohet një tekst shkencor. Një studim përshkrues për gjuhën e shkencës kemi ofruar (Rugova 2012) më parë, por kjo për ta dalluar shkallën e akribisë shkencore në tekstet që diskutojnë çështje të standardit të shqipes, mbështetur në hipotezën, se një pjesë e madhe e diskutimeve për këtë temë është e mbështetur në paragjykim, ndërsa studiuesit nuk arrijnë ndonjëherë të ndajnë ideologjinë e tyre nga faktet.

Ndërkohë, ky studim i tanishëm nuk lidhet me studimet e standardit, por të shqipes përgjithësisht dhe nisat nga botëkuptimi se tekstet shkencore, sikur edhe tekstet e tjera, në strukturën e tyre përfshijnë ndërthurje të tipave të ndryshme të tekstit, secili me veçori gjuhësore të vetat. Kjo e krijon nevojën për hulumtimin e strukturave të një teksti shkencor, të llojeve të fjalive, të mjeteve të këndvështrimit folës, të zgjedhjeve leksikore dhe përcaktimet e stileve dhe të regjistrave. Zbulimi i këtyre gjedheve gjuhësore përbën edhe objektin e studimit në këtë punim, duke u mbështetur në fushën e gramatikës së tekstit. Pra, nisemi nga hipoteza se nuk ekziston një stil i veçantë shkencor i gjuhës si prodhim, por se një artikull shkencor përfshin prerje të ndryshme stili dhe kategorish tekstore.

Për hulumtimin e këtyre gjedheve gjuhësore kemi zgjedhur një mostër prej katër artikujsh, të katër albanologëve.

1. Francesco Altimari, Mbi huazimet nga italishtja dhe nga dialektet italo-romane në sistemin foljor të arbërishtes, në *Studia Linguistica Italo-Albanica – arbërishtja në kontekstin gjuhësor ballkanik dhe italian*, ASHAK, Prishtinë, 2014
2. Victor A. Friedman, Urdhërorja treguese në gjuhët ballkanike, Shqipja dhe gjuhët e Ballkanit, ASHAK, Prishtinë, 2012

3. Besim Bokshi, Emrat e ditëve të javës – dëshmi e një gjendjeje të lashtë të fleksionit emëror të shqipes, Varia, ASHAK, Prishtinë, 2014
4. Rexhep Ismajli, Edhe diçka rreth rotacizmit në gjuhën shqipe, Artikuj mbi gjuhën shqipe, Rilindja, Prishtinë, 1987

Përzgjedhja e autorëve është subjektive, e mbështetur në relevancën e autorëve në fushën e albanistikës, ndërsa përzgjedhja e artikujve është e rastit, por njëloj subjektive: janë përzgjedhur artikujt e parë që na kanë rënë në dorë nga zgjedhjet e librave nga rafti.

Me këtë rast është mëtuar të gjenden elementet strukturore të të katër artikujve, të vështrohen kategoritë tekstore të sekuencave e të njëjësive brenda artikujve, të trajtohen llojet e fjalive, të kundrohet dhe të përshkruhet këndvështrimi i autorëve, pa u ndalur te zgjedhjet leksikore, me të cilat janë realizuar studimet.

Veçoritë individuale të autorëve mund të merren parasys, por nuk janë thelbi i hulumtimit.

Kufijtë e shkencës

Para se të diskutojmë prodhimin gjuhësor, le ta diskutojmë përmbledhtazi një pjesë të procesit: konceptimin e nocionit shkencë.

Fjalori enciklopedik i anglishtes i Websterit, te zëri science (*shkencë*) (1996:1716) jep këtë sqarim si shpjegim të parë: “Fushë e dijes ose e studimit që merret me një tërësi faktesh ose të vërtetash të aranzhuara në mënyrë sistematike dhe që tregon veprimin e ligjeve të përgjithshme”.

Duke nxjerrë këtë përkufizim po ecim pak më tutje nga konceptet e Platonit të shekullit IV para erës sonë. Ai duke konsideruar se mosdija është thelbi i çdo të keqeje, do të përpiqej ta përkufizonte dijen si “besim i mirëfilltë i arsyetuar”. Ai këtë e arsyetonte me tri kërkesa. Që të themi se dimë diçka, koncepti duhet të jetë i vërtetë, duhet ta besojmë dhe duhet të arsyetojmë. Njëzet e katër shekuj më pas, konceptet i vërtetë dhe besim dhe arsyetim duan një sqarim më të thellë. Mirëpo, po të mos hyjmë thellë në përkufizimet semantike, do të vërejmë se në thelb, Platoni dijen e koncepton si një hipotezë (besim) që duhet të argumentohet (arsyetim) në mënyrë që të sjellë një mendim të vërtetuar (i vërtetë).

Një ndër themeluesit e teorisë së metodës shkencore, Karl Popperi do ta quajë historinë e njerëzimit si një histori të paragjykimëve dhe të dogmës, shpesh të kapluar edhe nga mungesa e tolerancës (Popper 1997:83). Mbështetur në këtë pikë, Popperi do ta përcaktojë vijën e demarkacionit mes shkencës dhe joshkencës. Sipas tij, një teori

nuk mjafton të quhet shkencore vetëm në bazë të verifikueshmërisë së saj, por doemos edhe në bazë të falsifiabilitetit. Pra, nuk mjafton metoda induktive, por që një teori të quhet e dëshmuar ose e arsyetuar ajo duhet të trajtohet dhe të dëshmohet me metodën deduktive (1997:88, 2005:18).

Sipas Popperit, një shkencëtar, qoftë ai teorist apo empirist, vë deklarime në sisteme të deklarimeve dhe i teston ato hap pas hapi. Në fushë të studimeve empirike ndërton hipoteza ose sisteme teorike dhe i provon ato kundër përvojës përmes vëzhgimit ose eksperimentit (Popper, 2005:3).

Autorë bashkëkohorë si Masimo Pigliucci do ta kontestojnë rigorozitetin e vijës demarkuese të Popperit, duke thënë se ekzistojnë disa mënyra të ndryshme se si bëhet shkencë dhe kjo përcaktohet nga dy kritere: kompleksiteti i objektit të studimit dhe shkalla, në të cilën luan rol historia e studimit të atij sistemi që trajtohet. Sa më jokompleks problemi, aq më i saktë dhe i qartë rezultati. Po ashtu, sa më historik problemi, aq më të lehta do të jenë parashikimet e bëra, të nxjerra si rezultat i studimit (Pigliucci 2010:303).

Së këndejmi, gjuha e një artikulli shkencor është gjuhë që shërben për formulim të hipotezave, paraqitje të të dhënave dhe provë të hipotezave.

Autorë postmodernë si Fayeraband (1975) i kundërshtojnë prestigjin dhe autoritetin e shkencës, duke e konsideruar si ideologji më vete. Fayerabend konsideron se konceptet objektiv – subjektiv vlejnë edhe jashtë kërkimit shkencor dhe mbron qëndrimin, me fjalë të tjera, se shkenca është një këndvështrim i shikimit të botës dhe të së vërtetës.

Duke e pasur parasysh spektrin e gjerë të këndvështrimeve mbi botën dhe të vërtetën, ky hulumtim trajton këndvështrimin shkencor sipas nocioneve të Pigliuccit.

Në rrafshin e kërkimit gjuhësor, hulumtimin e mbështesim mbi disa nga konceptet e studiuesit Michael Halliday (2004:49), i cili e përkufizon gjuhën e shkencës si një tërësi formash të ndryshme të ligjërit, në të cilat përshkruhen dhe zbatohen aktualitetet shkencore parë si burim sistematik për krijim të kuptimit e jo si përmbledhje instancash të tekstit. Mirëpo, Halliday, duke e konsideruar gjuhën shkencore si regjistër më vete (2004:170) vlerëson se gjuha e shkencës i përfshin format e ndryshme të diskutit, në të cilin kryhen aktivitetet e të bërit shkencë (2004:49).

Mekanizmat kryesorë hulumtues të një korpusi gjuhësor (teksti) janë analiza kualitative dhe analiza kuantitative.

Karakteristikë themelore e të dhënave kuantitative është se mund ta bëjnë informacionin të numërueshëm, të matshëm. Pra, të dhënat mund t'i shndërrojmë në numra, shifra e grafe dhe t'i procesojmë me procedura statistikore ose të tjera

matematikore, sipas fushës dhe objektit të studimit. Pyetja themelore e hulumtimit të tillë është: *sa?* (Rasinger 2013:10)

Trajtohet për të gjetur nëse një formë gjuhësore del më shumë në këtë rrethanë komunikimi apo në një tjetër. Po e zëmë, nëse e kundrojmë çështjen e kohëve të foljes, në kundërvënien *kohë e kryer* dhe *kohë e kryer të thjeshtë* në tipa të ndryshëm të tekstit, atëherë ky hulumtim bëhet me matje kuantitative. Shikohet sa herë ka dalë në tekstin A dhe sa herë në tekstin B ndryshorja e parë dhe sa e dyta. Po ashtu, shikohet edhe sa është përdorur në ligjëratë të drejtë dhe sa në ligjëratë të zhdrejtë. Mbështetur në të dhënat që procesohen si numër ose si përqindje mund të nxirren përfundime të caktuara që e mbështesin hipotezën e caktuar ose jo. Të dhënat e një korpusi shërbejnë kryesisht si orientime dhe prirje dhe si të tilla duan edhe interpretim.

Thua se çdo çështje gjuhësore mund t'i nënshtrohet hulumtimit kuantitativ (sasior), të cilin e konsiderojmë si metodë të pranueshme shkencore. Rasinger (2013) hulumtimin kuantitativ e konsideron deduktiv, ndërsa hulumtimin kualitativ induktiv. Nga induksioni, pra, metoda induktive mund të vërejmë një prirje, ose mund të ngremë një hipotezë.

Hulumtimi kualitativ (cilësor) e kërkon përgjigjen e pyetjes *si?*

Vërtetimi i një dukurie shkencore nis me hipotezën (ose hipotezat) në formë të pyetjeve. Zhvillohet një metodë, me të cilën do të provohet hipoteza, ndërsa janë gjeneruar të dhënat që procesohen në formë numrash e shifrash. Vendosja e këtyre numrave në procedurat përkatëse matematikore e sjell rezultatin, ndërsa deduktimi pastaj tregon nëse hipoteza është vërtetuar ose jo. Në hulumtimin kualitativ, ndërkaq, analiza e të dhënave e nxit vërejtjen e dukurive dhe ngritjen e hipotezave.

Gramatika e tekstit shkencor

Studimi i gjuhës së shkencës është objekt i studimit të gramatikës së tekstit dhe, së këndejmi, i gjuhësisë. Darian (2003:2) thekson se si i tillë ky studim nuk bën ndryshim nga studimet e tjera gjuhësore, meqë është “subjekt i të njëjtave fakte dhe fantazive të gjuhës së zakonshme dhe mënyrat e të menduarit shkencor, në një masë të madhe, janë pjesë përvërese e gjuhës në përgjithësi”.

Në kuadër të kategorizimit tekstor, një artikull shkencor bën pjesë në kuadër të argumentimit shkencor (Werlich 1983:106) me përfaqësim objektiv të tekstit, me fjali që kanë plotësi në struktura inherente (Rugova & Sejdiu-Rugova 2015:127). Si mostër globale e dijes të argumentimi shkencor është plani, ndryshe nga skema që është karakteristike të rrëfimi, osed korniza të përshkrimi (De Beaugrande, Dressler 1981:184).

Në rrafshin e strukturës tematike, Reeves (2005:50-51) dallon kategori konvencionale si abstrakti, hyrja, përshkrimi i metodës, gjetjet dhe diskutimet.

Mirëpo, ndonëse argumentim shkencor në tërësi, një artikull shkencor përbëhet nga sequenca që mund të jenë përshkruese, rrëfyese e shpjeguese, varësisht nga lloji i artikullit dhe i hulumtimit. Kjo mbështetet në mendimin (Pigliucci 2010:303) se shkencë nuk është një aktivitet monolitik, pasi që ka shumë mënyra se si mund të bëhet shkencë dhe kjo përcaktohet nga kompleksiteti i objektit të studimit dhe nga historia e problemit.

Xhevat Lloshi (1999:188-194) si veçori dalluese të ligjërimit shkencor shquan objektivitetin e kumtimit, formulimin e ngjeshur, karakterin e përgjithësuar abstrakt, strukturimin sipas organizimit logjik, ndërsa shton se në bërthamën e leksikut shkencor dominojnë termat.

Autorë si Kinneavy (1971 te Schleppegrell 2004) gjuhën e shkencën e konsiderojnë të shquar si abstrakte, objektive dhe të orientuar nga informimi, duke vërejtur shmangie të vetës së parë në tendencë të përdorimit të diatezës joveprore dhe shmangies së lidhore (Schleppegrell 2004:117)

Lirimi nga konotacionet (Reeves 2005:10) dhe sistem deskriptimi i thjeshtë del si veçori më vete.

Autorë të ndryshëm (Schleppegrell 2004:145, Reeves 2005, Darian 2003:2) vërejnë se gjuha e shkencës, ndonëse si gjuhë që nuk i nënshtrohet inuendos, nuk është e liruar nga metaforat dhe figurat.

Duke mos e parë çështjen e stileve funksionale të prerë sipas fushave të caktuara, stilet i përcaktojmë (Werlich 1983, Rugova 2009, Rugova & Sejdiu-Rugova 2015) sipas orientimeve të tyre në ligjërimit. Argumentimet shkencore u përkasin stileve formale të orientuara nga informimi: stili teknik dhe ilustrues-krahasues.

Mirëpo, le të shohim se çfarë thonë rezultatet e kërkimit tonë.

Rezultatet – struktura e tekstit

Një artikull shkencor është tekst argumentues dhe ka strukturë të planit. De Beaugrande dhe Dressler (1981) thonë plani është një lloj skeme që ka një qëllim, ndërsa skema më vete është një varg kornizash që ka një rend serik.

Siç u paraqit më lart, argumentimi shkencor realizohet përmes një plani që ka njësi të veta strukturore.

Korpusi i këtij studimi, i përbërë nga katër artikuj shkencor, vërteton njësitë e përcaktuara nga Reeves më lart: abstrakt, hyrje, metodë, gjetje dhe diskutim.

Abstrakti përfshin titullin tok me përkufizimin e objektit të studimit. Në disa raste paraqitet si i ndarë, i sinjalizuar nga titulli dhe i ndjekur nga fjalë kyçe. Një nga katër artikujt e korpusit e ka të veçuar abstraktin, ndërsa tre të tjerët të inkorporuar brenda tekstit.

Te artikulli i Bokshit dhe te ai i Ismajlit abstrakti gjendet në titullin dhe paragrafin e parë, te artikulli i Altimarit abstrakti është te titulli dhe pjesa përmblylëse e hyrjes.

Abstraktet janë rëndom tekste ekspozitore. Tipi ekspozitor i tekstit (Rugova & Sejdiu-Rugova 2015:58) quhet edhe tekst shpjegues, ndërsa shpjegon natyrën, rrethimin, përdorimin, origjinën, qëllimin, gjendjen, procesin e asaj për të cilën shkruhet dhe lidhet fort me domenin e faktit.

Hyrja, sipas korpusit tonë, mund të jetë sfond teorik dhe historik i problemit.

Te artikulli i Altimarit në korpus janë të përfshira të dyja.

Pjesa e historikut është realizuar me tip rrëfyes teksti, si tip referencial me zhvillim kohor (Dykro dhe Todorov 1984:413).

“Variatetet arbëreshe që prej më se pesë shekujsh jetojnë në kontakt të ngushtë gjubëor me ato italo-romane... e gjatë shekullit të fundit...” (nga artikulli i Altimarit fq. 169)

Kjo vlen edhe në rastet, kur diskutohet thjesht si sfond teorik i problemit.

“Zanorja fillimisht e hundorëzuar... ka pësuar ndryshime... me kobë kaloi në zanoren e mesme”. (nga artikulli i Ismajlit, fq. 185).

Te të dy shembujt mund të vërejmë njësi gjuhësore që i referohen kohës: *që prej pesë shekujsh, gjatë shekullit të fundit, si dhe fillimisht..., me kobë kaloi.*

Pjesa e sfondit teorik, ku zhvillohet lexim kritik i literaturës dhe i rezultateve paraprake, zhvillohet me ndërtim të tekstit argumentues të mbështetur në krahasim dhe kundërshti.

“Një përgjigje na e jep N. Mjeda... Këto shënime të Mjedës kanë nevojë të plotësohen...” (nga artikulli i Bokshit fq. 12).

Pjesa e metodës është e paraqitur në dy nga katër artikujt. Metoda është e dosmosdohme në çdo hulumtim kuantitativ, por është zgjedhjesor në hulumtimet kualitative.

Si kategori teksti sekuenca e metodës në të dy punimet është shfaqur përshkruese.

“Në veçanti kemi marrë në shqyrtim modalitetet e përshtatjes morfologjike të huazimeve... kemi shqyrtuar, gjithashtu, edhe zhvillimet historike”... (nga artikulli i Altimarit, fq 170).

Njësia e gjetjeve përfshin pjesën, në të cilën në një hulumtim kuantitativ janë gjeneruar të dhënat që i nënshtrohen analizës. Në një hulumtim kualitativ hipoteza drejtpërdrejt i gjeneron të dhënat, analiza e të cilave ofron struktura dhe gjedhe, të cilat ofrojnë hipoteza të reja.

Kjo nënkupton se ekziston një ndërlidhje e gjetjeve dhe e diskutimeve, por me një diskutim të përgjithshëm si njësi më vete, rëndom në fund të artikullit.

Të katër artikujt që i janë nënshtruar hulumtimit për nevoja të këtij studimi kanë një ndërlidhje mes gjetjeve dhe diskutimeve, pa qenë të ndara në njësi strukturore të veçanta - por si njësi më del një diskutim përmbledhës.

Duke qenë argumentime shkencore, edhe struktura tekstore e gjetjeve është ndërtuar në formën e krahasimit dhe të kundërshtisë.

Sa i përket diskutimit, në të katër artikujt, realizohet në formë të përmbylljes – njëri nga të cilët edhe me krahasim.

Si ndërtim i fjalisë, në pjesën e diskutimeve idiomë e rëndomtë tekstore argumentuese del fjalia e përbërë nga fjali që i atribuohen cilësisë përmes foljes jam apo ndonjë foljeje tjetër të gjendjes në të tashmen, shoqëruar edhe nga negacioni dhe të plotësuara me mbiemër.

“Ky interpretim nuk është i mundshëm për sllavishten jugore...”, (nga artikulli i Friedmanit, fq. 121)

Në sekuencat ekspozitore të artikujve ndeshen dy lloje kryesore të fjalive, sipas termave të Werlichut (1983:28): fjali që shprehin sintetizim dhe që identifikojnë dukuri përmes foljes jam apo foljeve të gjendjes në të tashmen, të shoqëruara me plotës emërorë.

Në pjesën përmblylëse të artikullit të Bokshit përdoren fjali (6 sosh) që identifikojnë veprim, që identifikojnë dukuri (2 sosh) dhe që identifikojnë gjendje (2 sosh), si fjali të karakterizuara përgjithësisht (Werlich 1983) si fjali objektive.

Rezultatet - këndvështrimi folës

Këndvështrimi i tekstit e përbën këndin nga i cili bëhen zgjedhjet gjuhësore brënda tekstit (Rugova dhe Sejdiu-Rugova 2015:155). Një nga kategoritë e këndvështrimi folës është përfaqësimi folës, i cili mund të jetë subjektiv dhe ai

objektiv. Një mjet themelor i përfaqësimit objektiv është kategoria e vetës. Në këtë studim, po ashtu, do t'i trajtojmë edhe mbiemrat dhe kohët e foljeve.

Artikujt e korpusit, janë të dominuar nga veta e tretë, pra të orientuar nga objekti, por përfshijnë edhe folje ose përemra të vetës së parë, qoftë njëjës, qoftë shumës.

Artikulli i Bokshit përbëhet nga 6 raste të përdorimit të vetës së parë shumës që ka përdorim objektiv në kontekste të caktuara. Artikulli i Friedmanit ka shtatë raste të përdorimit të vetës së parë, dy nga të cilat në njëjës (*do të sjell argumente për këtë pikëpamje; më kanë thënë se...*) në pjesën e argumentimit. Artikulli i Altimarit ka 14 raste të përdorimit të vetës së parë, që të gjitha në shumësin objektiv, ndërsa artikulli i Ismajlit ka tri raste të përdorimit të vetës së parë shumës.

Në rrafshin e zgjedhjes së kohëve të foljeve, dominojnë kohët e komentit, kundruall kohëve të rrëfimit.

Nga njëzet foljet e para të artikullit të Ismajlit, pesë janë të mënyrës lidhore, ndërsa të tjerat janë të dëftores dhe kjo 4 në kohën e kryer dhe 11 në kohën e tashme. Të gjitha këto janë kohë të komentit.

Rezultate të ngjashme ka edhe artikulli i Altimarit: nga 19 foljet e para, tri janë të mënyrës lidhore. Nga foljet e dëftores 12 janë në të tashmen dhe 4 në të kryerën.

Friedman nga 15 foljet e para, 14 i ka në të tashmen.

Bokshi ndërkaq, ka 8 folje në të kryerën, 5 në të tashmen, një në më se të kryerën (si kohë komenti), por edhe katër folje në të kryerën e thjeshtë, dy nga të cilat në citime të autorëve të tjerë. Ka disa folje të tjera në të ardhmen dhe në lidhore.

Gjetjet tregojnë rregullsi të kohëve të komentit.

Sa i përket përdorimit të mbiemrave, duke e pasur parasysh se artikujt shkencor përmbahen nga cilësimet, është e pritshme që të mos ketë shumë mbiemra që shprehin qëndrim, ndonëse përfshirja e mbiemrave nuk mungon.

Nga 19 mbiemrat e parë në artikullin e Bokshit, 17 janë mbiemra që nuk shprehin qëndrim dhe vetëm dy (*të pasqaruar, i mundur*) janë mbiemra që shprehin qëndrim (epitete). Në artikullin e Friedmanit, 3 nga 13 mbiemrat e parë janë epitete, ndërsa te artikulli i Ismajlit në mesin e 13 mbiemrave të parë nuk ka asnjë epitet. Në zgjedhjet gjuhësore të Altimarit, ndërkaq, mbiemrat janë më të shpejtë përgjithësisht, por nuk mungojnë mbiemrat që shprehin qëndrim. Në mesin e 46 mbiemrave të parë, 33 janë mbiemra që nuk shprehin qëndrim dhe 13 janë epitete.

Përfundime

Korpusi i hulumtuar tregon përfshirje të njëjësive konvencionale brenda një artikulli shkencor, por mekanizma të ndryshëm gjuhësorë, me të cilët realizohen ato njësi konvencionale. Kjo mbështet qëndrimin e Pigliuccit (2010:303) se shkenca nuk është një aktivitet monolitik, meqë ka shumë mënyra si të bëhet shkencë varësisht nga kompleksiteti i objektit të studimit dhe nga historia e problemit.

Organizimi strukturor i njëjësive varet nga njësitë: struktura logjike është karakteristike për sekuencat shpjeguese, ndërsa kundërshti-krahasime të sekuencat argumentuese.

Dominojnë fjalitë që identifikojnë dukuri, gjendje dhe veprim.

Në rrafshin e këndvështrimit folës dominon përdorimi i përfaqësimit objektiv të tekstit, përmes vetës së tretë, kohëve të foljeve të komentit dhe përdorimit të mbiemrave konventë - që nuk shprehin qëndrim. Mirëpo, edhe koncepti i përfaqësimit varet nga lloji i artikullit dhe i problemit që trajton.

Mbështetur në gjetjet e korpusit, mund të konstatohet se derisa është e vërtetë se gjuha e artikujve shkencorë u përket teksteve me përfaqësim objektiv, kjo gjuhë, nuk është njësi e njëtrajtshme, por si çdo fushë tjetër, përbëhet nga sekuenca kategorish të ndryshme tekstore, secila me veçori të vetat, të cilat varen tutje nga objekti i studimit.

Bibliografi

- Darian S. 2003. *Understanding the Language of Science*. University of Texas Press, Austin
- De Beaugrande R, Dressler H. 1981. *Introduction to Text Linguistics*. Longman, London
- Dykro O., Todorov C. 1984. *Fjalor enciklopedik i shkencave të ligjërimit*. Rilindja, Prishtinë
- Fayerband P. (1993) 1975. *Against the Method: Outline of an Anarchist Theory on Language*. Verso, London
- Halliday M. 2004. *The Language of Science*, Continuum, New York
- Johnstone B. 2008. *Discourse Analysis*, Blackwell, Oxford
- Kuharenko V. A. 2000. *Praktikum s stilistiki anglisekoi movi:Pidrucnik*. Nova Kniga, Vinnicia
- Lloshi Xh. 1999. *Stilistika dhe pragmatika*, Toena, Tiranë

- Pigliucci M. 2010. *Nonsense on Stilts, How to tell Science from Bulk*, University of Chicago Press, Chicago
- Plato, *Theaetetus* (përkth. në anglishten Benjamin Jowett) në www.gutenberg.org/files/1726/1726-h.html#2H-4-0002
- Popper K. 1997. Science: Problems, Aims, Responsibilities, te *The Myth of the framework: in defence of science and rationality*, Routledge, New York
- Popper K. 2005 (1935). *The Logic of Scientific Discovery*, Routledge, London & New York
- Rasinger S. 2013. *The Quantitative Research in Linguistics: An Introduction*. The Bloomsbury Academics, London & New York
- Reeves C. 2005. *The Language of Science*. Routledge, London & New York
- Rugova B. 2009. *Gjuha e gazetave*, KOHA, Prishtinë
- Rugova B. 2012. Gjuha e kumtesave për shqipen standarde. Te Ismajli R. (red.) *Studime 19*. ASHAK, Prishtinë
- Rugova B, Sejdiu-Rugova L. 2015. *Hyrje në gramatikën e tekstit të gjuhës shqipe*. Trembelat, Prishtinë
- Schleppegrell M. J. 2004. *The Language of Schooling – A Functional Linguistic Perspective*. Lawrence Erlbaum Associates. London
- Van Dijk T. 1988. *News as Discourse*, Lawrence Erlbaum Associates, Hillsdale
- Weiyun He A. 2003. Discourse Analysis, te Aronoff M. & Rees-Miller J. (red.) *The Handbook of Linguistics*, Bleckwell, Oxford
- Werlich E. 1983. *A Text Grammar of English*, Quelle & Meyer, Heidelberg

Anton PANCHEV

SHQIPJA NË DOMENIN PUBLIK BULLGAR NË FUND TË SHEK. XIX DHE NË FILLIM TË SHEK. XX

Hyrje

Interesimi i bullgarëve ndaj fqinjëve të tyre shqiptarë u shtua dukshëm në pjesën e dytë të shek. XIX, sidomos pas Çlirimit të Bullgarisë në vitin 1878. Edhe para kësaj date në Bullgari kanë jetuar shumë shqiptarë¹, por shteti i ri i lirë u ka dhënë shumë mundësi shqiptarëve për zhvillim ekonomik dhe kulturor. Në Sofje shpejt u formua koloni e madhe shqiptare e cila ka pasur kontribut të madh në zhvillimet dhe luftërat kulturore dhe politike të Rilindjes shqiptare. Këto zhvillime kanë qenë të lidhura ngushtë edhe me gjuhën shqipe. Gjatë viteve 80-ta dhe 90-ta të shek. XIX u botuan edhe veprat e para në gjuhën shqipe në Bullgari. Nga ana tjetër, interesimi i shkencëtarëve bullgarë për gjuhën shqipe ka filluar akoma në fund të shekullit të XIX. Si shembull mund të tregohen përrallat e Kuzman Shapkarevit, një shkrimtar dhe intelektual bullgar nga Maqedonia². Ai ka shkruar gjashtë përralla dhe një këngë shqiptare me shkronja bullgare bashkë me përkthimin e tyre në bullgarisht³. Në këtë mënyrë, me punën e veprimtarëve bullgarë dhe shqiptarë, u krijuan kushtet për praninë e gjuhës shqipe në fusha të ndryshme të domenit publik bullgar.

Burime të çmueshme për këto zhvillime janë gazetata shqiptare në Sofje, librat dhe veprat e botuara, kujtimet e veprimtarëve të kulturës dhe të politikës shqiptare. Patjetër duhet ta përmendim studimin më të plotë të veprimtarisë së kolonisë shqiptare në Sofje – „Албански възрожденски печат в България” (“Shtypja shqiptare e Rilindjes në Bullgari”) nga Bojka Sokolova. Ka edhe studime të tjera të

¹ Shih: Гюзелев, Боян. Албанци в Източните Балкани. С., 2003; Pançev, Anton. Diaspora shqiptare në Bullgari. Në: Poeta nascitur, historicus fit – Ad honorem Zef Mirdita. Albert Ramaj (ed.), St. Gallen – Zagreb, 2013, f. 1015-1027.

² Кузман Шапкарев (1892, 1894; 1973) Български приказки и верования съ прибавление на неколку Македоновлашки и Албански Простонародна българска философия или Български народни приказки, в□рования, пословици, гатанки, игри и пр. Събралъ и издава К. А. Шапкаревъ.

³ Ato janë botuar edhe në Shqipëri, në serinë “Mbledhës të hershëm të folklorit shqiptar” (vëll. III, Tiranë 1962, f. 435-446).

cilat na japin fakte të rëndësishme për këtë periudhë të zhvillimit të kulturës shqiptare në Bullgari përmes të cilave mund ta ndriçojmë aspekte të ndryshme nga Rilindja shqiptare.

Kolonia shqiptare

Organizimi i kolonisë

Për praninë e gjuhës shqipe në domenin publik bullgar rol të madh ka pasur veprimtaria e kolonisë shqiptare në Sofje. Sipas disa të dhënave, në fund të shekullit XIX në Sofje kanë jetuar më shumë se 500 familje shqiptare⁴. Shumica prej tyre ishin punëtorë, por ka pasut mjaft njerëz të cilët merreshin me zejtari, me tregti dhe me veprimtarinë ekonomike krijuan një mjedis të begatshëm dhe të përshtatshëm për aktivitete kulturore. Këta njerëz kanë përcjellë me interes të madh zhvillimet shoqërore, politike dhe kulturore në Atdheun e tyre të robëruar dhe kanë kontaktuar vazhdimisht me qendrat kryesore të Rilindjes shqiptare si në Shqipëri, ashtu edhe në Stamboll, në Bukuresht etj. Me këtë mënyrë, shqiptarët në Bullgari mblodhën përvojë organizative dhe kulturore dhe ndërmorën hapa më të mëdhenj drejt veprimtarisë së tyre atdhedashëde. Shqiptarët në Bullgari filluan të merreshin me lexim dhe shkrim në gjuhën amtare. Ndoshta Dhimitër Molle i ka sjellë në Sofje librat e parë shqip në vitin 1886 dhe kështu filloi aktiviteti kulturor në koloninë shqiptare në Sofje⁵. Organizata kryesore e shqiptarëve të Bullgarisë ka qenë shoqata “Dëshira” e cila u themelua më 1 janar 1893⁶. Qëllimi kryesor i shoqatës ka qenë të shpërndante diturinë dhe mësimin e gjuhës shqipe dhe të hapte shkolla shqiptare në Shqipëri, ndërsa statuti i “Dëshirës” kërkonte nga anëtarët e saj të punonin “për lulëzimin e gjuhës shqipe”⁷. Shoqata e ka përdorur si alfabetin e vetëm dhe zyrtar alfabeti i Shoqatës së Stambollit nga viti 1879 dhe mes veprimtarëve të kolonisë më me edukatë kanë qenë Shahin Kolonja dhe Midhat Frashëri (Lumo Skendo)⁸.

Shtypshkronja

Shtimi i aktiviteteve kulturore tregoi nevojën për një shtypshkronje të veçantë e cila të merrej me botime shqiptare. Kështu në fund të shek. XIX u krijua

⁴ Бобев, Боби и Тома Кацори. Близката и непознатата Албания. София, 1998, f. 206.

⁵ По ату, f. 207.

⁶ Соколова, Бойка. Албански възрожденски печат в България. С., 1979, f. 45; Бобев, Боби и Тома Кацори. Вера е situar, f. 208.

⁷ Соколова, Бойка. Вера е situar, f. 46.

⁸ По ату, f. 45-46.

shtypshkronja “Mbrothësia” nga Kristo Luarasi. Ajo ka pasur shumë merita për shpërndarjen e librave dhe veprave shqipe. Veprimtaria botuese e kolonisë në përgjithësi dhe e shtypshkronjës në veçanti ka qenë shumë e madhe për këto kohëra. Atje u botuan mbi 50 libra shqip⁹ si edhe shumë abetare dhe libra mësimorë për shkollat shqipe. Kjo shtypshkronje u vendos në Tiranë pas Luftës së parë botërore dhe e ka vazhduar punën e saj në fushën e botimeve.

Librat dhe gazetat

Gjuha shqipe e ka pasur praninë më të madhe në domenin publik bullgar në sferën e gazetarisë. Akoma në fund të viteve 70-ta dhe në vitet 80-ta kanë vepruar gazetarë shqiptarë në Sofje të cilët kanë botuar gazeta por në gjuhën turke. Në vitin 1897 në Sofje filloi të dilte kalendari atdhetar - “Ditërfenjësi i shqip”, i cili e ndryshoi emrin në “Kalendari kombiar” nga viti 1901. Në të publikoheshin kryesisht poezi, tregime, folklor. Në fund të kalendarëve jepej alfabeti shqip i Shoqatës së Stambollit¹⁰. Me ndikim kanë qenë edhe revistata “Vetëtimja” (Thoma Avrami) dhe “Shqipëria” (Nikola Ljako).

Gazeta “Drita” (1901 – 1908) ka qenë ndër gazetat më të rëndësishme në shtypin shqiptar në Sofje. Botues i 18 numrave të parë ka qenë Thoma Avrami dhe pas tij Shahin Kolonja. Me rëndësi të madhe ka qenë edhe gazeta e Josif Bagerit “Shqypeja e Shqypenise”, e cila botohej në shqip por edhe një pjesë në bullgarisht¹¹. Një gazetë e tjerë ka qenë “Liri e Shqipërisë” (1911-1915), e cila u përfshi në mënyrë aktive në betejat politike para Çlirimit të Shqipërisë. Gazetat shqiptare në Sofje kanë marrë pjesë në të gjitha diskutimet rreth çështjeve të rëndësishme të Rilindjes shqiptare, qoftë politike, qoftë kulturore dhe arsimore. Një vend të rëndësishëm kanë zënë diskutimet për gjuhën shqipe dhe për alfabetin. Kështu, opinioni bullgar njihej me problemet dhe me arritjet e çështjes shqiptare. Intelektuellët shqiptarë në Bullgari e kanë përdorur dhe e kanë përkrahur Alfabetin e Stambollit të Sami Frashërit. Botimi i shpesht dhe i vazhdueshëm i gazetave shqiptare në dialektin tosk në Bullgari, bashkë me veprimtarinë në fushën e gjuhës si edhe shumë faktorë të tjerë, kontribuan për krijimin e një baze të gjerë të dialektit tosk me përfshirjen e elementeve të gegnishtes¹². Veprimtaria e gazetarëve shqiptarë në Bullgari çoi deri zgjerimin e funksioneve

⁹ Po aty, f. 175.

¹⁰ Po aty, f. 53.

¹¹ Po aty, f. 74-75.

¹² Po aty, f. 173.

shoqërore të shqipes në domenin publik bullgar dhe gjuha shqipe zuri një vend të vogël por të qëndrueshëm në jetën e gazetave të Bullgarisë.

Gjuha shqipe e ka zënë vendin e saj edhe në fusha të tjera si p.sh. në dramaturgji. Në vitin 1911 në Sofje për herë të parë në gjuhën shqipe doli drama e S. Frashërit “Besa”, pasi në vitin 1902 u përkthye në bullgarisht nga turqishtja. Në vitin 1906 gjithashtu në Sofje u botua drama e Mihail Gramenos “Vdekja e Piros” – një tragjedi me katër akte në vjersha me një fabulë historike. Gjuha shqipe e ka praninë e vet dhe në fushën e letërsisë artistike sepse u shkruan, u përkthyen dhe u botuan shumë romane, tregime, vjersha.

Gjuha shqipe ka qenë e pranishme edhe në fushën e shkencës në Bullgari. Një shembull i mirë për këtë pohim ka qenë punimi i Lllazar Siljanit “Afërimi i bullgarishtesë së sotme me gjuhën shqip”¹³, ndërsa gazeta “Drita” e ka dhënë fillimin e karikaturës shqiptare.

Por gjuha shqipe ka pasur vendin e saj jo vetëm në kryeqytetin bullgar por edhe në qytete të tjera. P.sh. në verën e vitit 1908 në Varna u hap “një klub për lexim me libra të huaj dhe shqiptar”, në të cilin punohej për arritjen e qëllimeve kombëtare¹⁴.

Shkollat

Gjuha shqipe ka pasur prani të madhe edhe në fushën e arsimit. Që në vitet 1898-1899 në dhomat e shoqatës “Dëshira” u hapën shkolla për të rritur dhe për fëmijë. Në mbrëmje kanë studiuar të rriturit dhe të dielën fëmijët. Mësuesja për fëmijët ka qenë Polikseni Luarasi. Bëheshin edhe përpjekje për hapjen e një shkolle të rregullt. Qëllimi kryesor, përveç edukimit, ka qenë ndalimi i praktikës fëmijët shqiptarë të shkonin në shkollën greke¹⁵.

Kisha

Gjuha shqipe ka pasur praninë e saj edhe në domenin publik fetar. Kisha “Shën Spas” është përdorur nga priftërinjtë shqiptarë të cilët kanë shërbyer mesha në gjuhën shqipe. P.sh. edhe Fan Noli në vitin 1911 ka zhvilluar shërbesa kishtarë në këtë kishë e cila iu dha kolonisë shqiptare nga bashkësia fetare bullgare¹⁶. Librat në fushën e fesë të

¹³ Po aty, f. 181-182.

¹⁴ Po aty, f. 41.

¹⁵ Po aty, f. 51.

¹⁶ Po aty, f. 65.

Kristo Negovanit “I drunjti kryq ndarë në dy pjesë”, Sofja, 1906 etj., gjithashtu i ndihmuan funksionet shoqërore të gjuhës shqipe në domenin publik bullgar.

Studimi nga princat

Gjuha shqipe ka hyrë edhe në fushën e politikës bullgare. Jo pak diplomatë bullgarë kanë mësuar dhe kanë përdorur gjuhën shqipe në punën e tij. Ata e kanë mësuar gjuhën nga fqinjët e tyre shqiptarë në Maqedoni. Më me interes është fakti se edhe princat bullgarë, bijtë e mbretit Ferdinand Saks-Koburg-Gota, Borisi dhe Kirili, kanë studiuar gjuhën shqipe për shkak të ambicieve politike të babait. Akoma në vitin 1907 diplomati bullgar Nedjalko Kollushev ka dërguar në pallatin e Ferdinandit 6 libra shqip, një gramatikë dhe një fjalor. Mësuesi i princave ka qenë Perikli Çile nga Krusheva¹⁷. Kjo ide e mbretit Ferdinand ka dhënë disa rezultate në vitet e mëvonshme.

Në prill, maj dhe qershor të vitit 1913, kryetari i Qeverisë së përkohshme shqiptare Isamil Qemali Bej takohej me kryetarin e delegacionit bullgar na Londër dr. Stojan Danev, me atasheun ushtarak në Romë major Gançev, me ministrin e akredituar në Vjenë Ivan Salabashev dhe me të dërguarin e posaçëm nga Sofja N. Kolushev. Në takimet është diskutuar kandidaturën e princit bullgar Kiril Preslavski për mbret shqiptar dhe pjesëmarrja e Shqipërisë në luftën e afërt. Marrëveshje konkrete nuk është e arritur por vet Ismail Qemali ka pranuar që Kirili e ka ditur shqipen në nivel shumë të lartë dhe kjo ka qenë një përparësi të madhe¹⁸.

Përfundim

Pa dyshim gjuha shqipe e ka zënë vendin e saj në domenin publik bullgar në fund të shek. XIX dhe në fillim të shek. XX. Natyrisht, ky vend ka qenë i kufizuar për shkak të numrit të vogël të shqiptarëve në Bullgari. Por, megjithëse me kufizime, shqipja e kishte ndikimin e saj në pothuajse çdo fushë të domenit publik bullgar. Krijimi i shtetit shqiptar çoi deri ikjen e intelektualëve shqiptarë të cilët kishin dëshirë

¹⁷ Shih: Илиева, Илиана. Албанският въпрос (1908-1912). През погледа на българските дипломати. С., 2013.

¹⁸ ЦДА, ф. 176К, оп. 2, а.е. 1366, л. 111–112; а.е. 1367, л. 187; а.е. 368, л. 68, 104, а.е. 1369, л. 140, 275, 294; а.е. 1370, л. 263, 294; а.е. 1372, л. 357–359; ДВИА, ф. 40, оп. 2, а.е. 231, л. 175–179; НБКМ–БИА, ф. 15, а.е. 3001, л. 697–698; *Салабашев, Пв.* Спомени. С., 1943, 154, 461–474, 476–485; *Марков, Г.* България в Балканския съюз..., 405–406. Shih edhe: Fan Noli. *Vepra*, 2. Tiranë, 1988, f. 442-443.

të punonin për zhvillimin e Atdheut të tyre. Por veprimtaria e tyre e vuri bazën për hulumtimin e mëtejshëm të gjuhës shqipe nga shkencëtarët bullgarë.

Abstrakt

Interesimi i bullgarëve ndaj fqinjëve të tyre shqiptarë është shtuar dukshëm në pjesën e dytë të shek. XIX. Ky interes është lidhur ngushtë edhe me gjuhën e tyre. Në këtë periudhë janë publikuar shkrimet e para bullgare mbi gjuhën shqipe. Kolonia shqiptare në Sofje ka dhënë kontribut të rëndësishëm jo vetëm për zhvillimin e shqipes por edhe për pranimin e saj në domenin publik bullgar. Theks i veçantë në këtë punim do të vihet mbi përdorimin e shqipes në domenin publik të Bullgarisë në fund të shek. XIX dhe në fillim të shek. XX. Në kryeqytetin bullgar janë botuar shumë libra si edhe disa gazeta dhe revista në shqip. Trajtohet edhe tema për studimin e shqipes në Bullgari në këtë periudhë, si dhe hulumtimet shkencore për gjuhën shqipe.

Fjalë kyçe: shqipja, librat, gazetatat, studimi, Bullgaria

Bibliografi:

- Бобев, Боби и Тома Кацори. Близката и непознатата Албания. София, 1998.
- Божилова, Румяна. България и албанският въпрос в началото на XX век. Нѐ: Исторически преглед, 1982, 4.
- Гюзелев, Боян. Албанци в Източните Балкани. С., 2004.
- Димитров, Страшимир. България и албанското Възраждане. В: Из взаимоотношенията на балканските народи. Балкани. 1. София, 1966, с. 83-93.
- Илиева, Илиана. Албанският въпрос (1908-1912). През погледа на българските дипломати. С., 2013.
- Соколова, Бойка. Албански възрожденски печат в България. С., 1979.

Linditë SEJDIU-RUGOVA, Lindita TAHIRI

KATEGORIA E VETËS NË LIGJËRIMIN PUBLIK

Qëllim themelor i këtij punimi është që nëpërmjet kategorisë gramatikore të vetës të nxjerrë në pah shkallët e vlerësimit subjektiv dhe neutralitetit folës, apo fokalizimin, që sipas Genette-it (1972) e dallon pozicionin rrëfyes nga zëri rrëfyes, dhe më pas këtë term e përpunon Rimmon-Kenan (1983) për ta shënuar orientimin emotiv dhe njohës brenda diskursit. Përmes korpusit të përbërë nga diskursi publik këndej dhe andej kufirit, punimi synon nxjerrjen në pah të perspektivës autoritare dhe dominuese të folësve të shqipes në një ligjërim të caktuar publik të cilët transmetojnë vlerësime ideologjike të grupeve të caktuara shoqërore duke e nxitur formimin dhe riprodhimin e po këtyre vlerësimeve tek audiencia. Regjistrimet e emisioneve politike dhe argëtuese në Kosovë dhe Shqipëri e përbëjnë korpusin e këtij studimi. Bisedat dhe dialogjet e regjistruara do të analizohen në rrafsh të subjektivitetit dhe të objektivitetit folës, duke u mbështetur gjithnjë në mjetet gjuhësorë të përfaqësimit të tillë folës. Një analizë e tillë do të mundësonte edhe krahasimin gjuhësor të ligjërimin të folur në variantet e folura të shqipes. Analiza e kategorisë së vetës, e ndërlidhur me kategoritë e tjera gramatikore që shprehin subjektivitet gjuhësor, do të nxjerrë rezultate të rëndësishme sa i përket pyetjes sonë të hulumtimit: Sa subjektiv dhe, rrjedhimisht, sa ideologjik është folësi shqiptar në një debat a diskutim publik? Përfaqësimi individual folës mund të realizohet sipas përfshirjes së vetvetes në ligjërim dhe përfshirjes së ligjërimin të mëparshëm, të bëra nga vetë folësi apo nga të tjerët. Sipas këtyre parametrave mund të dallojmë edhe përfaqësimin sipas kundërvënies subjektiv-objektiv dhe ligjëratë e drejtë – ligjëratë e zhdrejtë (Rugova & Sejdiu-Rugova, 2015: 157). Pra, nëpërmjet të vetës si kategori e këndvështrimit folës që shërben për dallimin ndërmjet referencave deiktike të njësisë të ligjërimin: folës– marrës – botë që komunikohet, synojmë, ta shpjegojmë shfaqjen e njësisë së vetës në tipa të ndryshëm të ligjërimin.

Veta në gramatikat e shqipes

Në traditën e gramatikave preskriptive të shqipes, veta si kategori gramatikore lidhet me nocionin e zgjedhimit të foljes dhe nuk shpjegohet në një rrafsh më të gjerë

kotekstual. Veta shpjegohet si kategori gramatikore e foljes, e ndryshme nga kategoria e vetës te përemrat vetorë dhe pronorë (Gramatika I: 260) meqë ka karakter sintaksor për shkak të kushtëzimit që i bën veta e kryefjalës, ndërkaq te përemrat shpjegohet si ndryshim në kuptimin leksikor të tyre: Kuptimi i vetës te përemrat vetorë përkon me kuptimin leksikor të tyre (Gramatika I:220).

Sipas Gramatikës së Akademisë së Shkencave (1995), kategoria gramatikore e vetës te folja shpreh lidhjen midis folësit dhe kryefjalës dhe varësisht nga kjo lidhje folja vihet në vetën e parë, të dytë apo të tretë. Gjithashtu, Gramatika e Akademisë e veçon edhe një numër të atyre foljeve që përdoren vetëm në vetën e tretë dhe që e kanë kryefjalën e nënkuptueshme ose të shprehur (fryn, hingëllin, etj.) si dhe foljet që nuk e kanë të shprehur këtë kryefjalë e as të nënkuptueshme (pavetoret e tipit bubullin, vetëtin, ekziston, etj).

Për këtë kategori foljesh studiuesja Ludmilla Buxheli jep një shpjegim të detajur të funksionit të tyre në monografinë e saj të vitit 2011: *Foljet njëvetore në gjubën shqipe*. Buxheli thekson se termi pavetore në të vërtetë rrjedh nga termi impersonal i gramatikave të gjuhëve latine dhe gjermanike (Buxheli, 2011: 83). Por, ndryshe nga këto gramatika ku termi pavetore i kundërvihet termit vetore (impersonal-personal), Buxheli vëren se në shqipen, nocioni pavetore u kundërvihet dy koncepteve: vetor dhe njëvetor. Buxheli thekson se duhet marrë parasysh kriterin morfologjik për ta bërë dallimin ndërmjet foljes *bubullin* dhe foljes *punon*, e ky është markuesi i vetës së tretë njëjës: mbaresa –n.

Meqë në shqipen gjinia si kategori e emrit është e gramatikalizuar atëherë ndryshe nga anglishtja, e cila e dallon vetën e tretë shumës të shprehur me frymorë ose jofrymorë (impersonal dhe personal *it*), shqipja e ka rrafshuar një dallim të tillë. Përemri *ajo* mund t'i referohet *tavolinës*, por edhe *Zanës*. Natyrisht, në shqipen që ka fleksion të dendur, përemrat vetorë dhe trajtat e shkurtëra të përemrave nuk janë të domosdoshëm për ta shprehur referencën sepse ajo mund të shprehet nëpërmjet vetës së foljes. Pra, veta e tretë njëjës dhe shumës mund t'u referohet personave dhe objekteve (vetë e tretë jopersonale) dhe u referohet drejtpërdrejt njësisive të botës së komunikuar. Meqë shqipja nuk ka mjete gjuhësore për të bërë një dallim të këtillë (person – objekt) te vetorët, një dallim i kësaj natyre bëhet te determinativët në sintagma emërore të tipit: *Cili libër...*, krahasuar me trajtën jogramatikore: *Kush libër...* Veta e tretë njëjës ka përdorim më të gjerë dhe shfaqet në të gjitha kategoritë tekstore. (Rugova & Sejdiu-Rugova, 2015: 165)

Veta - kategori tekstore

Në suaza të gramatikës së tekstit, koncepti i vetës shpjegohet brenda kategorisë tekstore të këndvështrimit dhe përkufizohet si konstituent (përbërës) që e tregon dhe e përcakton pozitën mentale dhe fizike nga e cila folësi flet ose shprehet në një situatë të caktuar të komunikimit (Werlich, 1983: 133). Kjo pozitë, sipas Werlich-ut, tregon zgjedhjen që e folësi e bën në vetë dhe numër, kryesisht nëpërmjet përsëritjes së kryefjalës ose kundrinave me ndihmën e përemrave – e ashtuquajtura referencë vetore anaforike e Halliday/Hasan-it (1976):

/Kemi ardhur në pjesën e dytë të emisionit dhe jemi duke folur për kompaninë Belle Air e cila sot është paraqitur në gjykatë dhe ka kërkuar ristrukturim të biznesit të saj/ (Subjekti D)

si dhe nëpërmjet pëfaqësimit të qëndrimit të tij folës duke e subjektivizuar apo objektivizuar një proces a dukuri.

/Unë po them që ato qa kemi base ka pase parregullsi dhe kam thënë nuk jemi të interesuar që t'bejme ndjekje të shtrigave apo t'merremi vetëm me të kaluaren/ (Subjekti A)

Një zgjerim tekstor i tillë i vetës e krijon koherencën funksionale brenda tekstit (një, ky, kjo, ai) karshi asaj tematike: *druri, i gjatë, i bardhë*, etj. (Werlich, 1983: 163) dhe ky studiuës i kategorizon në grupin e shënjesëve funksionalë të sekuencës e që Halliday në termat e tij i konsideron si referencë vetore brenda kohezionit si një nga standardet e tekstualitetit (Halliday/Hasan, 1976: 37).

Në të vërtetë, Halliday/Hasan (1976) në skemën e tyre të përbërësve funksionalë-semantikë të sistemit gjuhësor e vendosin kategorinë e vetës brenda grupit foljor në kuadër të përbërësit ndërpersonal e që ka të bëjë me funksionin shoqëror, ekspresiv dhe konativ të gjuhës. Ky përbërës e shpreh këndin nga i cili flet folësi, qëndrimin dhe gjykimet e tij, kodimin e folësit brenda marrëdhënieve funksionale në një situatë të komunikimit si dhe motivin e tij për të thënë diçka (Halliday/Hasan, 1976: 27). Pra, nëpërmjet kategorisë së vetës folësi ndërhyt në komunikim). Rugova-Sejdiu (2015:138) një dukuri të tillë e përkufizojnë si hyrje në ligjërim për herë të dytë të së njëjtës njësi.

Duke e bërë dallimin semantik ndërmjet “speech roles” (Veta I dhe II) dhe “other roles” (Veta III), Halliday/Hasan e shpjegojnë edhe dallimin ndërmjet vetave gjatë përdorimit të tyre në komunikim si dhe mundësinë e paraqitjeve të ndryshme të vetës në funksione shpesh atipike për të (shembulli i njëjësit përgjithësues ose i shumës të individualizuar). Këtu do të mund ta konsideronim edhe përdorimin e përmerit i/e *tij* si referencë anaforike në fjalitë ku kryefjala i përfshin të dy gjinitë natyrore:

Njeriu nuk mund ta lëdojë veten e tij. (është fjala për përshtatjen e gjinisë gramatikore *njeriu-tij*, por në të vërtetë situata e komunikimit i përfshin të dyja gjinitë natyrore).

Halliday/Hasan (1976) mendojnë se gjatë ndarjes së roleve brenda kategorisë së vetës, janë pikërisht veta e parë dhe e dytë (Speech roles) që i referohen zakonisht një situatë të komunikimit duke shprehur përfaqësim folës: *Nuk e pashë anijen e djegur! Ku ishte?* (Kjo fjali mund të interpretohet kështu: Isha e pranishme në një situatë të komunikimit por nuk e pashë objektin për të cilin po flasim! Distancohem nga objekti në njëfarë mënyre.), dhe është veta e tretë ajo që i referohet kryesisht tekstit dhe krijon kohezion të vërtetë gramatikor (Halliday / Hasan: 1976: 48): *Ku ishte?* = *ku ishte anija?* (*ku ishte ajo?*)! Natyrisht, këto role ndryshojnë me kalimin nga ligjëratat e drejtë në ligjëratën e zhdrejtë apo të raportuar:

Mami ma kishte lënë një shënim në frigorifer. Aty shkruante: - Nuk kthehem para orës shtatë të mbrëmjes!. Dhe unë u stepa. Në këtë shembull është interesant kalimi nga *Mami* – veta e tretë në (*unë*) *nuk kthehem* – veta e parë. Veta e parë në ligjëratën e drejtë është e ndryshme nga veta e parë në narracion dhe nuk shpreh përfaqësim folës, por është thjesht anaforë kohezive.

Sipas gramatikës së Rugova / Sejdiu-Rugova (2015: 165-166), veta e dytë mund të përdoret edhe në funksion fiktiv: *I dashur ditari, e dashura lexuese X.* Në raste të tilla, nuk është marrësja, ajo, së cilës po i drejtohet folësja, por është një personazhe fiktive, përmes raportit me të cilën marrëses i jepet mesazh i caktuar. Përdoret, po ashtu, për nevoja të nxitjes së veprimit të tjetrit. Veta e dytë shumë shërben edhe në funksion përgjithësues: *Ju mund të shkoni...*, me ç'rast e merr kuptimin: *mund të shkohet; njeriu mund të shkojë* e kështu me radhë. Me këtë rast, duke mos qenë e lidhur me marrësen, merr tipar neutral. Veta e dytë shumë shënjon respektin për tjetrin.

Një tipar shumë interesant që nuk përmendet në gramatikat tradicionale të shqipes, por theksohet shumë në studimet tekstore është edhe përdorimi i vetës së dytë në një monolog krahas një dialogu: në situatën e parë i adresuari përfshihet në përshkrim ose në qëndrim folës (*Kur të kalosh pranë shtëpisë sime, e sheh një lis të lartë me një kurore të bukur. Aty është vendi ku u takova me të.*), tipike për tekstet përshkruese, ndërsa te rasti i dytë nuk përfshihet si qëndrim folës, por vetëm si marrës i informacionit, i adresuar. (*Ti*) *shko në shkollë!* (tipike për tekstet instruktive).

Këndvështrimi dhe përfaqësimi folës shprehet më së miri nëpërmjet vetës së parë meqë veta e parë njëjës përdoret kryesisht në tekstet me përfaqësim subjektiv: rrëfime, komente e kështu me radhë, por është shumë interesant përdorimi i vetës së parë shumës, e cila e përfshin ose e përjashton folësin gjatë situatës së komunikimit:

- Dubet t'i bindim ata që të vijnë me ne. (unë bashkë me ju)

- *Duhet t'i shkojmë kësaj pune deri në fund!* (Nuk do të thotë patjetër që unë do t'i shkoj bashkë me ju, veta në solidarizim me modalitetin (duhet) e shprehin një nuancë të mundshme të obligimit, të këshillës a nevojës së fuqishme të folësit, në rastin e dytë jo detyrimisht si pjesë e grupit folës). Duhet theksuar se qëndrimi folës nuk shprehet vetëm me përdorim të vetës, por edhe me përdorim ose jo të ligjëratës së drejtë, si dhe nëpërmjet shpjegimit eksplisit ose implicit të një fenomeni të caktuar (subjektiv vs. objektiv) (Werlich, 1983:139).

Metodologjia

Sfondi teorik i analizës: veta si dëshmi e subjektivitetit folës

Funksioni shoqëror i ideologjive është diskutuar së tepërmi, meqë bëhet fjalë për një fenomen të dukshëm të legjitimitetit të pushtetit në shoqëri. Ideologjitë nënkuptojnë jo vetëm strukturat shoqërore por edhe besimet apo prezantimet mendore të individëve. Sipas studiuesit Van Dijk (1998), në qoftë se të dyja këto këndvështrime shihen së bashku, mundësohet një përfaqje socio-kognitive që studion prezantimet shoqërore të përbashkëta për një grup shoqëror, si dhe përvetësimin dhe përdorimin e këtyre prezantimeve. Një teori e këtillë e shmang thjeshtëzimin teorik të konceptit të ideologjive, meqë këto janë të ndërthyer në gjuhë si një fenomen kompleks shoqëror dhe janë pjesë e shprehive tona gjuhësore ashtu siç është gramatika.

Meqenëse punimi e analizon subjektivitetin e diskursit, duhet thënë se vështirë mund të ketë diskurs plotësisht objektiv, ndërkaq, subjektiviteti i aktit foljor është një fakt i vetëkuptueshëm. Një shënjtues i qartë i këtij subjektiviteti është përmirë vektor “unë”. Do të përdorim konceptin e Benveniste-s, i cili dallon dy subjekte në diskurs: subjektin e aktit foljor, pra shqiptuesin apo performuesin, dhe subjektin brenda aktit foljor, pra të rrëfyerin. Sipas Benvenistes (...), kuptimi i ‘vetës’ i takon vetëm vetës së parë dhe të dytë: aspekti pragmatik i përmirëve vektorë i dallon ata nga fjalët e tjera ‘unë’ dhe ‘ti’ janë prodhime kontekstuale të diskursit, dhe mund të identifikohe vetëm nga ligjërimi që i përmban ato, përderisa ai/ajo gjendet jashtë ligjërimin, është si një ‘jo-vetë’ për të cilën flitet. Ndërkaq veta e parë dhe e dytë janë instrumente që e shndërrojnë gjuhën në diskurs, dhe veta e parë jo vetëm që është shenjë e mundësisë për ta “ushtruar” gjuhën por edhe është filli i diskursit individual.

Sipas Benveniste-s kategoria e vetës e mundëson “subjektivitetin” në gjuhë dhe jashtë saj, dhe ligjërimi e nxit shfaqjen e këtij subjektiviteti.

Po kështu do të shfrytëzohet analiza e trefishtë të tipareve formale gjuhësore nga Fairclough (2001) në përputhje me dimensionin apo vlerën e tyre kuptimore:

analizën në rrafshin e përmbajtjes dhe njohurive gjuhësore, që e quan vlerë e përvojës, në rrafshin e raporteve mes folësve, që e quan vlerë relacionesh, dhe në rrafshin e shprehjes të identitetit, që e quan vlerë ekspresive të ligjërimit. Ky klasifikim e përkujton ndarjen e tri funksioneve gjuhësore që e bën Halliday (1973), atë ideacional, interpersonal dhe tekstual, të influencuar nga Bühler-i (1934) që flet për funksionin ekspresiv, konativ dhe referencial, e që Jakobsoni (1960) e pasuron me tre funksionet e tjera, atë fatik, metalinguistik dhe poetik.

Korpusi

Meqë qëllim i këtij punimi mbetet analiza e përdorimit të vetës si këndvështrim dhe përfaqësim folës në ligjërimit publik, do të analizohen shembujt e nxjerrë nga dy emisione televizive të produksioneve shqiptare në Prishtinë dhe në Tiranë. Përdorimi i referencës vetore, i trajtave foljore të caktuara, kalimi nga ligjërata e drejtë në të zhdrejtën dhe anasjelltas si dhe prezantimi skenik kundruall atij të përmbledhur (scenic vs summary) do të shtjellohen detajisht në dy fragmente të transkriptit të caktuar nga dy prezantime televizive formale dhe publike të televizioneve në gjuhën shqipe.

Emisionet nga të cilat janë nxjerrë transkriptet për analizë janë Rubikon në KTV dhe TOP Story në TOP Channel, që të dyja me karakter politik, si dhe Zona e Debatit në KLAN Kosova dhe TOP Show në TOP Channel, që të dyja me mysafirë që përfaqësojnë figura të njohura publike në të dyja vendet. Emrat e pjesëmarrësve në debat, të cilët paraqesin pjesëmarrësit direkt të korpusit të këtij punimi nuk do të shpalosen fare në mënyrë që punimi mos të marrë ngjyrim subjektive dhe politike. Personazheve mysafirë të emisionit do t'u referohemi si Subjekte, pra Subjekti A dhe C në Kosovë si dhe B e D në Shqipëri, dhe emisionet janë zgjedhur sipas mostrës së rastit, gjatë vitit akademik 2013/14, gjatë një hulumtimi të bërë rreth deiktivë të shqipes në shqipen e folur. Janë krahasuar përdorimi i vetës në diskursin e politikanit (A) dhe të fytyrës së njohur publike nga Kosova (C) dhe politikanit (B) e fytyrës së njohur publike nga Shqipëria (D).

Analiza e diskursit

Në një nga fragmentet e pjesës së transkriptit të zgjedhur për analizë nga emisioni Rubikon vërehet përdorim i shpeshtë dhe i shumëllojshëm i përmerave vetore si dhe i atyre dëftorë në pozitë referenciale ndaj personave dhe fenoemeneve të caktuara. Në sekuencën:

/po ne kemi prezantuar Adriatik në atë konferencë për shtyp raportin 100 ditësh.../

Subjekti A i drejtohet udhëheqësit të emisionit joformalisht, me emër personal, ndonëse pyetja i bëhet me **Ju** në përpjekje për të qenë sa më popullor dhe sa më i afërt me moderatorin, i cili në të vërtetë e përfaqëson publikun nëpërmjet pyetjeve të tij. Qysh në fjalinë e parë, Subjekti A automatikisht kalon në shumësin gjithëpërfshirës **ne** për ta identifikuar veten si pjesë të një grupi të caktuar. Kalimet e tilla të zakonshme bëhen (sipas gjuhëtarëve) për t'i ikur përgjegjësisë individuale dhe për të mos e personalizuar veprimin. Në të vërtetë, sipas Werlich-ut, përdorimi i vetës së parë shumës **ne**, e cila e përjashton marrësin apo deshifruetin e mesazhit janë tipike për disa variante të teksteve objektive, siç është raportimi dhe argumentimi shkencor. Këtu nuk kemi të bëjmë me një shumës akademik, siç quhet në botën e shkrimit akademik Pluralis Modestiae (*Në këtë punim kemi dashur ta themi këtë e këtë...* kur autori dëshiron ta përfshijë veten në traditën e rezultateve dhe zbulimeve paraprake), por me një shumës që tenton ta barazojë veprimtarinë e një individi me tërë grupin, duke iu shmangur subjektivitetit ose së paku duke u përpjekur për t'iu shmangur atij.

Në vazhdim të përgjigjes ndaj pyetjes së njëjtë të udhëheqësit, Subjekti A vazhdon raportimin me shumës gjithëpërfshirës por që e përjashton marrësin dhe pasojnë shumë raste të përdorimit të gabuar të përemrit të vetës së tretë njëjës **ajo** për t'iu referuar një dëftori të gjinisë femërore kjo, i cili paraprakisht i referohet një situatë a veprimi të shprehur me fjali të varur lidhore:

/ne kemi filluar punën, ato kanë orare, por ajo që kisha me thanë është ma me rënsi që e kemi vendosë një ton të ri apo një linjë të re të qeverisjes apo mendimit qeverisës e besoj se kjo vlen tash edhe për Republikën e Kosovës e ajo është që në fillim çdo vendim kem thanë që do ta bëjmë publik, ashtu e kemi bërë.../

Pra, ndodh një referencialitet i dyfishtë (në katror) i përemrit vetor **ajo**, gjë që gramatikisht nuk është aspak korrekte për shqipen dhe një sekuencë e tillë shndërrohet në një fjali tejet konfuze për dëgjuesin. Thjesht, deikticiteti i përemrit **ajo** në këtë rast e humb aftësinë për t'iu referuar elementit të presupozuar, humb magjia e të shënjuarit.

Në përputhje me modelin funksional e analizës së trefishtë të Fairclough, ky tekst do të dukej kështu:

Përmbajtja	Raportet	Identiteti
Unë flas	Nuk ka pasë parregullsi	Unë i mbaj zotimet

Më pas, në sekuencat tjera të nxjerra nga transkripti i po të njëjtit emision vërejmë edhe shumë raste të kalimit nga shumësi **ne** në njëjtesin e theksuar **unë**:

/jaaa, nuk tërhiqem unë i kam dhënë ato dymbëdhjetë zotime i mbaj njerzjt në kuleta kur ju kam thënë se pas mandatit katërnjëçar është e drejtë e secilit qytetar që t'ofrohet dhe t'thotë këtë e ke

përmbushë, këtë nuk e ke përmbushë. Nuk ka ndryshu asgjë nga koha para fushatës, të gjitha ato zotime kemi filluar t'i zbatojmë, disa më lehtë disa më me vështirësi, por në përgjithsi nuk ka befasi, nuk ka gja të cilën kena thanë nuk e kena dit se asht kështu apo kena menu që do t'jetë ma mirë, domethan për gjithcka kemi qenë gati...unë po them që ato ça kemi hasë ka pasë parregullsi dhe kam thënë nuk jemi të interesuar që t'bejmë ndjekje të shtrigave apo t'merremi vetëm me t' kaluarën/

Pra, subjekti A e krijon një marrëdhënie më të fortë me dukuritë për të cilat flet duke i portretizuar si pjesë të mendimeve dhe të veprimeve të tij. Një distribuim i tillë i vetës e bën tekstin në vazhdim subjektiv, raportimi kalon në një përshkrim impresionistik (i *mbaj njerëzit në kuleta*) e në fund të sekuencës bëhet edhe rrëfim duke e shndërruar përemrin vector **unë** në një shumës gjithëpërfshirës përsëri, për t'iu shmangur prezantimit subjektiv folës.

Në përgjithësi, me disa përjashtime të vogla, dominon përdorimi i shumësit **ne** ndaj njëjësit **unë**, por me përdorim tejet të gabuar të referencës vetore, të anaforave dhe të mospërshtatjes sintaksore të elementit të cilit i referohet Subjekti A nëpërmjet mjeteve referuese. Statistikisht, nga 23 sintagma foljore të fragmentit të zgjedhur nga biseda me subjektin A, 5 sosh u referohen pozitës së folësit (unë), në 10 sosh dominon shumësi gjithëpërfshirës, ndërkaq vetëm 4 sintagma foljore u referohen ngjarjeve tjera në vetën e tretë. Në dy nga rastet e përdorimit të vetës së dytë, bëhet kalimi nga ligjëratë e zhdrejtë në të drejtën, dhe njëherit ndryshimi i referencës vetore nga **unë** në **ti**, duke iu referuar vetvetes.

Në transkriptin e Subjektit B (TOP Story, 2014) zhvillohet një proces i ngjashëm i përdorimit të vetës së parë njëjës dhe shumës, por ndryshe nga politikanë kosovar, politikanë nga Shqipëria (Subjekti B) përdor konstrukcione sintaksore më të sakta gramatikisht dhe nuk bën gabime të rënda referenciale kur e përdor vetën në funksion referencial koheziv. Përdorimi i ligjëratës së zhdrejtë dhe identifikimi i subjektit “unë do të” brenda grupit “ne kemi” apo “ne do të” është më i natyrshëm te Subjekti B.

Ndryshe nga politikanët, në një transkript të nxjerrë nga biseda e zhvilluar në studio të Subjektit C (Zona e debatit, Klan Kosova, 2014) dhe Subjektit D (TOP Show, TOP Channel, 2014), pra të figurave publike me pozitë të rëndësishme shoqërore në tregun kosovar dhe shqiptar, ligjërimi i tyre dallon dukshëm nga ligjërimi i subjekteve A dhe B. Disa nga tiparet e ligjëritimit të Subjekteve C dhe D janë përdorimi i vazhdueshëm i të ashtuquajturës “Forma di Cortesia” (trajta e respektit) në shqipen (Ju), si dhe përdorimi i vetës së tretë neutrale dhe jopersonale, duke iu referuar më shumë dukurive e jo subjekteve si dhe duke mos e prezantuar ngjarjen e caktuar si rrëfim subjektiv të ndarë e të përshkruar në sekuenca, por si përmbledhje të përgjithshme të organizuar mirë, e përjashton pothuajse plotësisht folësin nga të qenit

“kryesori” në situatë të komunikimit, duke mos u dhënë shumë rëndësi faktorëve individualë kontekstualë. Këta folës e përmbledhin lirshëm ligjëratën e drejtë në të zhdrejtën, duke krijuar fjali të shumta hipotaktike brenda tekstit të caktuar dhe bëjnë zhvendosje të kategorisë së vetës nga njëra perspektivë në tjetrën në mënyrë të natyrshme, pa e ndryshuar fare idomën tekstore të tipit të caktuar tekstor.

Në vazhdim po japim një ekstrakt të nxjerrë nga transkripti i subjektit D, në të cilin vërehet largim nga të shprehurit e qëndrimit folës dhe automatikisht edhe subjektivitetit folës meqë nga 19 sintagma foljore, vetëm 3 sosh u referohen vetës së parë shumës, në një rast të vetëm folësi i drejtohet drejtuesit të emisionit me **Ju** dhe të gjitha sintagmat tjera paraqiten në vetën e tretë, duke iu shmangur maksimalisht shfaqjes së qëndrimit subjektiv folës:

/autoriteti i aviacionit civil është një strukturë piramidale, natyrisht që drejtohet nga drejtori i autoritetit, por personi numër një i autoritetit të aviacionit civil është ministri i transporteve/ ai bën kontrollin, ministri i transporteve është përfaqësues i qeverisë për lidhje me transportin ajror dhe kështu funksionon e gjithë piramida shtetërore/ kjo nuk ka funksionuar përpara për autoritetin e aviacionit civil/ nuk ka pasur dëshirë qoftë politike qoftë administrative, qoftë të gjithë operatorët ajrorë të operonin brenda kritereve ligjore, që edhe ju e thoni kanë ekzistuar/ natyrisht kanë ekzistuar, por po nuk u zbatuan ç’ vlerë kanë? kjo është ajo që ne garantojmë/ për sa kohë jemi në këto pozicione garantojmë zbatueshmërinë me përpikërinë më t’ lartë t’ ligjit, t’ ligjit dhe kritereve që janë në të gjithë shtetet e komunitetit europian / asnjë ndryshim nuk kanë standardet ligjore që ne kemi me ato t’ autoritetit europian/

Intepretimi i rezultateve

Theksimi i përemrit dëftor në njëjës ‘unë’ edhe në rastet kur nënkuptohet nga folja në vetën e parë, e shquan pozicionin autoritar të folësit, dhe njëkohësisht e personalizon tekstin. Folësi krijon një kontekst ku rëndësi parësore ka fakti se flet pikërisht ai, dhe për më shumë, në këtë kontekst dëgjuesi ka mundësi të marrë pjesë drejtpërsëdrejti në këndvështrimin e folësit të pozicionuar si autoritet superior. Distanca dhe autoriteti i pushtetit politik ndërthuren me ftesën personale që i bëhet dëgjuesit ta përjetojë drejtpërsëdrejti situatën ligjërimore.

Kontekstualizimi i vetë aktit të të folurit (mund të them, e theksoj), që shndërrohet në referencë të drejtpërdrejtë të realitetit, ku fjala e demonstroi superioritetin dhe pushtetin e folësit.

Strategjia e përdorimit të ligjërimin bisedor dhe stilit informal në media, përmes treguesve të tillë si adresimi në vetën e dytë njëjës në vend të shumës të politesës, nën dukjen e një filozofie egalitare që i favorizon njerëzit e rëndomtë kundruall elitës

politike, mund të shihet edhe si veprim efikas për ta përvetësuar audiencën dhe për ta manipuluar atë. Si do të thoshte Van Dijk, ideologjia e diskursit publik del si një ndërlidhje mes individit, shoqërisë, institucioneve dhe politikës, apo si një dimension shoqëror të konstrakteve personale mendore, të cilat vijnë në shprehje në të gjitha strukturat e shoqërisë.

Veta e parë që e shqipton ligjëratën e drejtë vepron me forcë ilokucionare tek dëgjuesi duke e eliminuar distancën me te dhe duke u shfaqur njëkohësisht edhe si subjekt i aktit folës dhe si subjekt brenda këtij akti (Benveniste: 1971) dhe kështu, njëkohësisht, veta e parë shfaqet si impersonale, si transmetuese e gjendjeve faktike, duke e ftuar audiencën që thëniet e shqiptuara të mos merren si vlerësime personale të folësit por të përjetohen si vlerësime edhe të audiencës dhe të pranohen deri në universalizim të pakushtëzuar nga rrethanat e caktuara referenciale. Rrjedhimisht, audienca ftohet që ta pranojnë përjasjen e konstruktuar për botën në diskursin e tij si faktike, konkrete, dhe përfundimtare.

Përfundim

Veta është kategori gramatikore e ndërlidhur me pozicionin folës dhe me perspektivën folëse dhe si e tillë ngërthen forcë ilokucionare të ligjëritimit të folësit ndaj pjesëmarrësve në situatë të komunikimit. Nuk mund të shpjegohet dhe të analizohet përdorimi i vetave pa një përfshirje kontekstuale të të gjithave funksioneve tekstore në situatë të komunikimit. Shkalla e subjektivitetit të folësit varet nga faktorët kontekstualë që ndikojnë në situatë të komunikimit (qëllimi i diskutimit, lloji i audiencës). Hulumtimi ynë dëshmon se politikanët kosovarë dhe shqiptarë janë subjektivë dhe ideologjikë krahasuar me figurat e tjera publike, duke e përdorur në mënyrë dominante aktin komisiv të të folurit (*do të bëjmë*) krahasuar me figurat tjera publike apolitike, të cilët e kanë përdorur llojin representativ të të folurit (*bëjmë*), në terma të Yule-it (1996) si dhe stilin joperonal (*bëbet*). Pra, përdorimi i caktuar i vetës me ngjyrim subjektiv dhe ideologjik si dhe përdorimi i ligjëratës së drejtë karshi të zhdrejtës për të shprehur qëndrime personale karshi atyre grupe dhe anasjelltas, në kontekstin aktual, e vërtetojnë hipotezën tonë që subjektiviteti folës paraqet një nuancë të ideologjisë dhe veta si kategori tekstore është një nga shumë kategori tjera gramatikore që e bëjnë të mundur realizimin e një nuancimi të tillë.

Referencat

- Benveniste, E. 1971. "The Nature of Pronouns" and "Subjectivity in Language". *PGL*, volume 1 & 2. University of Miami Press. (f.217-230)
- Bucholz O., Fiedler W. 1987. *Albanische Grammatik*, Leipzig: Verlag Enzyklopädie
- Buxheli L. 2011. *Foljet njëvetore në gjuhën e sotme shqipe*. Tiranë: QSA
- Dykro O., Todorov C. 1984. *Fjalor enciklopedik i shkencave të ligjërimin*, Prishtinë: Rilindja
- Fairclough N. 1985. Critical and Descriptive Goals in Discourse Analysis. *Journal of Pragmatics* 9. (739 – 763)
- Fairclough N. 1992. *Critical Language Awareness*. London: Routledge
- Fairclough N. 1995. *Media Discourse*. London: Edward Arnold
- Fairclough N. 2003. *Analysing Discourse*. London, New York: Routledge
- Halliday M. 1973. *Explorations in the Functions of Language*, London: Edward Arnold
- Halliday M, Hasan R. 1976. *Cohesion in English*. London: Longman
- Halliday M. 1994 [1985]. *An Introduction to Functional Grammar*. London: Edward Arnold
- Huddleston R. Pullum G. et al. 2002. *The Cambridge Grammar of the English Language*. Cambridge: CUP
- Ismajli R. 1980. *Shumësia e tekstit*, Prishtinë: Rilindja
- Jacobson R. 1966. *Lingvistika i poetika*. Beograd: Nolit
- Rugova –Sejdiu L. 2008. *Elemente kohëzive, tipike për anglishten dhe shqipen*. In: Badallaj I. (ed.) *Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare 27/1*. Prishtinë: Universiteti i Prishtinës (119-131)
- Shlomith Rimmon- Kenan. 1983. *Narrative Fiction*. Methuen & Co.Ltd.
- Tahiri L. 2009. *Rrëfimi impersonal i Kadaresë*, Shkup: Vatra
- van Dijk T. 1977. Sentence topic and discourse topic. *Papers in Slavic Philology* 1, (49-61)
- van Dijk T. 1979. New developments and problems in textlinguistics. In: J.S. Petöfi, (red.) *Text vs. Sentence. Basic questions of textlinguistics*. Hamburg: Buske Verlag, 2 vols., (509-523)
- van Dijk T. 1988. *News as Discourse*. Hove, London: Lawrence Erlbaum
- van Dijk. T. 2009. *Society and Discourse. How Social Contexts influence Texts and Talk*. New York: Cambridge University Press.
- Werlich E. 1983. *A Text Grammar of English*. Stuttgart: Quelle&Meyer
- Yule G. 2002. *Pragmatics*. Oxford, New York: Oxford University Press
- Zherar Zhenet. "Figura", Prishtinë, Rilindja, 1985

Haredin XHAFERI

PËRDORIMI I LOKUCIONEVE TË NDËRMJETME ME STRUKTURË JOTOGFJALËSHE NË GJUHËN E SOTME SHQIPE

Abstrakt

Lokucionet me vlerën e një fjale të ndërmjetme janë togje të qëndrueshme fjalësh shënuese dhe shërbyese, me lidhje të qëndrueshme, që nuk kryejnë funksione të caktuara sintaksore dhe nuk lidhen me fjalët e fjalisë sipas lidhjeve të njohura të fjalëve në togfjalësia. Këto struktura përdoren si njësi të gatshme, shprehin një nocion të vetëm dhe kanë një kuptim tërësor. Ato janë të ndryshme nga struktura dhe nga kuptimi. Shumica e tyre kanë strukturë jotogfjalëshe, në kuptimin gjubësor të termit. Më të pakta janë lokucionet me strukturë togfjalëshi. Te lokucionet e të dy grupeve është e domosdoshme prania të paktën e një fjale shënuese, e cila mbart edhe peshën kryesore semantike. Lokucionet e ndërmjetme me strukturë jotogfjalëshe janë të përbëra nga dy ose më shumë elemente. Këto elemente janë fjalë shënuese dhe fjalë shërbyese. Numër të madh përbëjnë lokucionet e formuara nga një fjalë shërbyese dhe një fjalë shënuese. Fjala shërbyese është parafjalë ose lidhëz. Nga vlera semantike, këto lokucione afrojnë me pjesët e ndryshueshme, por nuk kanë vlerën e asnjë pjese të tillë, sepse ato nuk kryejnë funksionin e asnjë gjymtyre të fjalisë.

Në gjuhën shqipe krahas fjalëve dhe togjeve të qëndrueshme të fjalëve që lidhen gramatikisht me njëra - tjetrën me lidhjet karakteristike për togfjalëshin apo fjalinë, përdoren edhe fjalë apo grupe të qëndrueshme fjalësh që nuk mund të lidhen me këto lloj lidhjesh me fjalët e tjera të fjalisë. Këto fjalë e grupe fjalësh janë quajtur fjalë e togje fjalësh të ndërmjetme dhe fjalë e togje fjalësh të ndërkalura.

Fjalët dhe togjet e fjalëve të ndërmjetme M. Çeliku i ka përkufizuar si: "...fjalët e togjet e fjalëve të palidhura sintaktikisht me fjalinë, që shprehin mendimin e folësit ndaj kumtimit të tij bazë (kryesor), vlerësimin e përgjithshëm të tij ose që tregojnë burimin e kumtimit a lidhjen midis gjymtyrëve të fjalisë ose midis fjalive."¹ Këto fjalë e togje fjalësh nuk kryejnë ndonjë funksion sintaksor të caktuar, nuk lidhen sintaksorisht me fjalët e tjera të fjalisë, nuk gjenden me anë të pyetjeve. Ato kanë intonacionin e tyre

¹ M. Çeliku, *Fjalët dhe togjet e fjalëve të ndërmjetme*, Gjuha shqipe dhe letërsia në shkollë, 3, 1975, f. 104

karakteristik, shqiptohen me një ton më të ulët dhe më të shpejtë nga ai i fjalisë, zakonisht ndahen me pauza nga fjalia dhe kanë theksim pak a shumë të dobët. Autori ka vënë në dukje se në shumicën e rasteve fjalët e togjet e ndërmjetme kanë trajtë të ngurosur. Shkallën e tyre të ngurosjes ai e ka shpjeguar me mungesën e lidhjes gramatikore me gjymtyrët e fjalisë si dhe me funksionin e veçantë që ato kryejnë. Ajo shprehet me përbërjen leksiko - gramatikore dhe me tiparet e tyre morfologjike të përcaktuara, me pamundësinë e zgjerimit me elemente të tjera etj. Togjet e ndërmjetme i kanë të ngulituara elementet përbërëse. Megjithatë, M. Çeliku ka nënvizuar se shumë prej këtyre fjalëve e togjeve të ndërmjetme i ruajnë të gjalla lidhjet me pjesët e ligjëratës dhe paralelisht dalin edhe në funksion të gjymtyrëve të fjalisë. Për dallimin e këtij grupi, përveç anës kuptimore e sintaksore, sipas tij, luan rol edhe pikësimi (treguesi i intonacionit).² A. Kostallari togjet e ndërmjetme i ka quajtur ndërtime frazeologjike modale, që nuk shërbejnë si gjymtyrë fjalie dhe lidhen me gjithë fjalinë, duke treguar raportin e saj me realitetin, vërtetësinë e mendimit që shprehet si dhe qëndrimin e folësit për atë që shpreh.³

Lokucionet e ndërmjetme bëhen për herë të parë objekt i një studimi të veçantë, i cili i shtohet monografisë për lokucionet.⁴ Ato kanë tiparet që kanë lokucionet me vlerën e një pjese të ligjëratës.⁵ Këto njësi janë të formuara nga dy ose më shumë fjalë shënuese dhe fjalë shërbyese. Elementet përbërëse e kanë humbur kuptimin dhe funksionin e tyre sintaksor. Ato përdoren si struktura të gatshme, nuk prodhohen në çastin e ligjëritimit, nuk shprehin marrëdhënie nocionesh, por një nocion të vetëm mbi bazën e një kuptimi të vetëm. Ato kanë vlerën e një fjale të vetme. Shkalla e humbjes së kuptimit të elementeve është e ndryshme. Kriteret e përcaktimit të këtyre lokucioneve janë ato që përcaktojnë edhe lokucionet e grupeve të tjera: *kriteri semantik* (kanë vlerën e një fjale); *kriteri morfologjik* (elementet funksionojnë si një njësi e vetme gramatikore) dhe *kriteri sintaksor* (karakterizohen nga rendi i ngulitur i elementeve përbërëse, të cilat nuk mund të lidhen me fjalë të tjera, nuk mund të kryejnë funksionet sintaksore që kryejnë kur përdoren jashtë lokucionit dhe ndërmjet tyre nuk mund të ndërfiten njësi të tjera leksikore).

² Po aty, f. 104 - 105

³ A. Kostallari, *Parimet themelore për bartimin e "Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe"*, Studime mbi leksikon dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe, II, 1972, f. 40

⁴ Ne kemi publikuar monografinë "*Locution in Albanian language*", Scholars'Press, Saarbrücken, Germany 2015, në të cilën kemi trajtuar grupet e lokucioneve me vlerën e pjesëve të ligjëratës. Me këtë artikull kjo monografi bëhet e plotë, duke u pasqyruar të gjitha grupet e lokucioneve që përdoren në gjuhën shqipe.

⁵ Për karakteristikat e përgjithshme të lokucioneve shih H. Xhaferi, *General Remarks on Locutions*, Academic Journal of Interdisciplinary Studies, Vol 4 No 1, Rome, Italy 2015, f. 319 - 322

Lokucionet e ndërmjetme janë të larmishme nga struktura dhe nga vlera e tyre semantike.

Ato kanë strukturë jotogfjalëshe ose togfjalëshe.⁶ Në këtë artikull do të trajtohen togjet e fjalëve të ndërmjetme me strukturë jotogfjalëshe⁷ në planin strukturor dhe semantik, përdorimi i tyre dhe pasqyrimi në fjalorët e gjuhës shqipe.

I. Analiza strukturore dhe semantike

Këto lokucione kanë në strukturë dy ose më shumë elemente. Elementet janë fjalë shënuese ose fjalë shërbyese.

1. **Lokucione të formuara nga një fjalë shërbyese dhe një fjalë shënuese.** Lokucionet që përfshihen në këtë grup, janë të shumta. Fjala shërbyese e këtyre strukturave është parafjalë, lidhëz ose pjesëz.

1.1. *Lokucionet e formuara nga parafjalë + fjalë shënuese* janë të larmishme dhe përbëjnë një numër relativisht të madh. Elementi i parë në strukturën e këtyre njësisve është parafjalë e një rase të caktuar. Elementi i dytë është emër ose përemër. Parafjala nuk përdoret për të shprehur lidhjet sintaksore të emrit me një gjymtyrë tjetër. Emri i ka humbur veçoritë kuptimore, kategoritë gramatikore dhe aftësinë për t'u lidhur me fjalë të tjera. Bashkë me parafjalën ai ka formuar një tërësi të vetme.

a. Nga parafjalët *e rasës emërore* në strukturën e këtyre lokucioneve përdoret parafjala *tek*. Kjo parafjalë ka formuar me një emër lokucionet *tek e fundit, tek e mbramja*. Ato përdoren për të realizuar lidhjen logjike të fakteve, të dhënave apo të pjesëve të kumtimit. P. sh. ***Tek e fundit, edhe vetë mbreti e pa që ai ishte më i përshtatshëm si sekretar.***

b. Parafjalët *e rasës kallëzore* që janë elemente të strukturës së lokucioneve, janë më të shumta. Më të përdorshme janë: *për, me, më, në, nën, nëpër, pa, mbi, përmbi*.

* Parafjala *për* del te një numër relativisht i madh lokucionesh. Ajo është lidhur me një emër konkret ose abstrakt dhe ka formuar lokucione me vlerë semantike të ndryshme.

• Lokucionet *për mrekulli, për bukuri, për fat, për bela, për habi, për çudi, për sherr, për dreq* etj. janë formuar nga parafjala *për* + një emër që emërton një ndjenjë a diçka tjetër me karakteristika të veçanta. Emri përbën temën semantike të lokucionit. Të dy elementet përdoren të ngurosur, duke humbur kuptimin dhe funksionin sintaksor. Me

⁶ Për këtë klasifikim i jemi përmbytur konceptit gramatikor për togfjalëshin, si “bashkimi gramatikor dhe kuptimor i dy ose më shumë fjalëve kuptimplota të bashkuara me lidhjen e nënrenditjes, që tregon marrëdhënie midis sendeve, dukurive, proceseve e tipareve” (*Gramatika e gjuhës shqipe* II, 1996, f. 81 - 82).

⁷ Ne kemi tw pwrfunduar studimin e plotë për lokucionet e ndërmjetme, por, për arsye vendi, ky artikull përmban vetëm trajtimin e lokucioneve me strukturë jotogfjalëshe.

anë të këtyre lokucioneve folësi një fakt a një dukuri, të cilën e kumton, e vlerëson mbi bazën e emocionit që i ka shkaktuar. P. sh. *Dbe, për çudi, ndodhte që të më zinte vërtet gjumi, i trullësuar dhe i dehur nga shungullima dhe lëvizja. Atë çast ushtoi pushka dhe plumbi, pasi përshkoi derën e kuzhinës, goditi supin e djaloshit, por, për fat, pa ndonjë dëm. Për dreq dhe për bela, në kohërat që nuk mbahen mend, dikush vrau dikë aty te lisi nën rrugë dhe njerëzit filluan të hidhnin gurë te vendi i vrasjes.*

- Lokucionet *për pasojë, për shembull, për rrjedhim* etj. janë formuar me parafjalën *për + emër* abstrakt. Ato shërbejnë për të bërë lidhjen logjike të pjesëve të kumtimit. P. sh. *Ky merak, për shembull, aq larg shkoi, sa për shekuj të tërë ajo familje nuk lidhte martesë me familjet e tjera të mëdha.*

- Lokucionet *për flamur, për nder, për besë, për ideal* etj. janë formuar me parafjalën *për + emër* abstrakt ose një emër konkret. Këto lokucione tregojnë shkallën e vërtetësisë së një fakti a të dhënës. P. sh. *Ai s'e kishte mendjen fare në punë. Unë ca më keq. Për nder, gjesb ramë thes e përdbe nga trarët e çatisë. - Për besë, paska më trima se ne, - tha dhe pa me pikëllim plakun që i kishte nxitur të linin bjeshtë. - Për flamur, po të mos qëndrojtë maliberi në këmbë në mes të thelave, do t'ua hedh maceve bakllavanë.*

- * Parafjala *me* bashkë me një emër abstrakt, zakonisht me orgjinë mbiemërore, ka formuar togje të qëndrueshme, si: *me të drejtë, me të vërtetë,⁸ me siguri, me gjasë* etj. Këto struktura e paraqesin atë që kumtohet, si të vërtetë, të sigurtë a të pasigurtë për të ndodhur. P. sh. *Etbet ishin një dukuri kaq misterioze dhe, me siguri, që të rriturit duhej të kuptonin më shumë nga kjo punë. Këto kërkesa nuk ishin bërë kurrë në malësi dhe njerëzit, me të drejtë, i kundërshtonin me forcë.*

- * Parafjala *më*, duke u lidhur me emra me orgjinë mbiemërore, ka formuar pak lokucione.

⁸ A. Xhuvani i ka pranuar këta emra si gjini asnjëse e mbiemrit që merret si emër abstrakt (*Orgjina dhe formimi i ndajfoljeve në shqipë, Çështje të gramatikës së shqipes së sotme*, II, 1975, f. 244). E. Hysa i ka quajtur mbiemra të substantivuar në formën e gjinisë asnjëse (*Formimi i ndajfoljeve, Çështje të fonetikës dhe të gramatikës së gjuhës shqipe*, 1972, f. 304). F. Agalliu i quan emërzime të trajtës së mbiemrit asnjëse, sepse në gjuhën e sotme mbiemri i emëruar nuk përdoret më. (*Gramatika e gjuhës shqipe*, I, 1995, f. 147). Pak a shumë të tillë i ka quajtur edhe Xh. Gosturani (*Vëzhgime për formimin e fjalëve në gegërishten verilindore*, Studime filologjike, 1 - 4, 1992, f. 126). Sh. Demiraj i ka quajtur emra prejmbiemërorë të gjinisë asnjëse (*Rreth ndajfoljësimit (adverbializimit) të disa formave gramatikore dhe të disa togjeve të tipit parafjalë + emër, Çështje të fonetikës dhe të gramatikës së gjuhës shqipe*, 1972, f. 76). Sipas tij, një klasë fjalësh duhet emërtuar sipas vlerës aktuale dhe jo sipas klasës nga e cila është formuar (Shih *Emrat prejfoljorë asnjëse dhe togjet me vlerë foljore të formuara me pjesëmarrjen e tyre*, Studime filologjike, 2, 1969, f. 48).

Lokucionet *më së shumti, më së paku* etj.⁹ përdoren për të treguar shkallën e rëndësisë së një fakti a të dhëne. P. sh. **Më së paku**, në këtë mënyrë mbulohet një pjesë e dëmit që kjo valë karkalecësh u kishte shkaktuar banorëve të kësaj zone. Lajmet ishin, **më së shumti**, të zymta, por kishte herë - herë edhe zbatimëse.

• Lokucionet *më së fundi, më së pari* tregojnë lidhjen logjike midis pjesëve të kumtimit. P. sh. **Më së fundi**, kur ne të gjithë ia bëmë të qartë se nuk ishte koha për mërira, ai u bind. Këtë e di populli liridashës, por këtë, **më së pari**, duhet ta dinë shkrimtarët që pretendojnë të jenë ndërgjeje e tij dhe ta kenë fjalën e amshueshme siç pretendonte me të drejtë Fishta.

Temën semantike të lokucionit e përbën emri. Ai përdoret edhe pa pjesëzën *më (së paku, së shumti, së fundi* etj.), duke u bërë bartës i gjithë përmbajtjes së lokucionit.¹⁰ Këto lokucione janë shumë të afërta me lokucionet ndajfoljore të tipit *më së miri, më së bukuri* etj.

* Parafjala *në* me një emër abstrakt ka formuar lokucione që kanë vlerë kuptimore të ndryshme.

• Lokucionet *në thelb, në esencë, në realitet, në fakt, në të vërtetë* etj. janë formuar nga parafjala *në* dhe një emër me përmbajtje reale. Emri është ngurosur, ka humbur aftësinë për t'u lidhur me fjalët e tjera dhe funksionon së bashku me parafjalën. Këto lokucione tregojnë sigurinë e kumtimit apo të asaj që shpreh folësi. P. sh. **Në thelb**, kjo ka të bëjë me thellimin e realizmit në letërsinë bashkëkohore. Duke ia kthyer popullit veprën e Fishtës ne, **në të vërtetë**, ia kthejmë vetes librin gjithmonë të hapur të historisë, në të cilin mund ta lexojmë fatin tonë të djeshtëm dhe të nxjerrim mësimë për fatin tonë të sotëm. **Në fakt**, në fund të veprës ai shpëton i gjallë, por kjo ka domethënie.

• Lokucionet *në përgjithësi, në tërësi* etj. janë formuar nga parafjala *në* dhe një emër me përmbajtje të përgjithshme të papërcaktuar. Emrat i kanë humbur veçoritë gramatikore dhe lidhjet me fjalët përcaktuese. Këto lokucione i shërbejnë folësit për të bërë vlerësimin e një fakti në raport me një fakt tjetër ose me fakte të tjera. P. sh. - *Mua nuk më intereson gjetja e tij, - tha generali. - Sonte, në përgjithësi, nuk më intereson asnjë gjetje.*

⁹ Për këta emra janë bërë vlerësime të ndryshme nga studiues të ndryshëm. A. Xhuvani i ka marrë si mbiemra të gjinisë asnjë në rasën rrjedhore (*Orgjina ...*, art. i cit., f. 240). Edhe E. Hysa i ka marrë si të tillë (*Formimi ...*, art. i cit., f. 305). Sh. Demiraj i ka quajtur "forma e ngurosur e rrjedhore së pashquar njëjës të mbiemrave ose të rreshtorëve të substantivuar." (*Rreth ndajfoljësimit ...*, art. i cit., f. 72)

¹⁰ Këtë dukuri e ka vënë re J. Thomai te frazeologjizmat foljorë. Sipas tij, kur peshën kuptimore e emocionale të frazeologjizmit e merr njëra gjymtyrë, gjymtyrët e tjera nuk janë më të domosdoshme, bien dhe frazeologjizmi prishet krejt, meqë nuk është më togfjalësh (në kuptimin klasik të këtij termi)" (*Frazeologjizmat foljorë në gjubën shqipe*, Studime filologjike, 1, 1976, f. 100). Një dukuri e tillë vihet re edhe te këto lokucione.

* Lokucionet e formuara nga parafjala *pa* dhe një emër abstrakt i parmë ose jo i parmë janë të pakta. Të tilla janë: *pa fjalë, pa frikë, pa mëdyshe, pa bezitim, pa ngurim, pa dyshim, pa rezervë* etj. P. sh. *Po të hiqeshin të ardhurat nga mbarështimi i dhenve, pa frikë, kerabina dhe njerëzit mund të qubeshin të varfër. Ngjarjet e vitit 1914 në Shqipëri do të kishin qenë, pa dyshim, një barrë e përballueshme me njerëz edhe më të aftë dhe më të fortë se princi e princesha.* Këto lokucione përdoren për të shprehur sigurinë e folësit për atë që thotë.

* Me parafjalën *ndër* dhe përemrin *të tjera* është formuar lokucioni *ndër të tjera*, i cili përdoret për të bërë lidhjen logjike midis fakteve, pjesëve të kumtimit etj. P. sh. *Një nga çështjet më të diskutueshme ishte, ndër të tjera, edhe prania e personelit femëror në pallat.*

* Parafjalët *mbi* dhe *përmbi* përdoren mjaft rrallë. Ato kanë formuar me një përemër të pacaktuar lokucionet: *mbi të gjitha, përmbi të gjitha, mbi të tjera, përmbi të tjera, mbi gjithçka, përmbi gjithçka* etj. Këto lokucione shprehin shkallën e rëndësisë së një fakti a të dhëne. P. sh. *Mbi gjithçka, është populli, publiku që u tregon njerëzve rrugën nga të ecin dhe si të ecin. Dhe, përmbi të gjitha, të jemi të bashkuar!*

c. Nga parafjalët e *rasës rrjedhore* më të përdorshme janë *sipas, para, kerabas, midis, përpos, veç, përveç.*

* Parafjala *sipas* me një emër ose me një përemër ka formuar lokucione që përdoren për të treguar burimin e kumtimit.

- Lokucionet *sipas zakonit, sipas traditës, sipas ligjit, sipas rregullores, sipas kanunit, sipas kuranit* etj. e kanë emrin të ngurosur në formën e numrit njëjës në trajtën e shquar. Megjithëse emri përdoret në të shquarën, ai ka një kuptim mjaft të përgjithshëm e të papërcaktuar. P. sh. *Sipas zakonit, më dha edhe i dhashë një cigar.*

- Lokucionet *sipas shenjave, sipas gjasave, (sipas gjasës), sipas të thënave, sipas të dëgjuarave, sipas njoftimeve, sipas informatave* etj. janë formuar nga parafjala *sipas* dhe një emër në numrin shumës, i cili emërton diçka konkrete apo abstrakte që shërben si burim informacioni. P. sh. *Sipas informatave, gjermanët do të internonin me dhjetra shokë.*

- Lokucionet *sipas meje, sipas teje, sipas tij, sipas atyre, sipas këtyre, sipas të tjerëve, sipas dikujt* etj. kanë në strukturë një përemër vetor a një përemër tjetër që tregon subjektin, i cili shërben si burim i kumtimit. P. sh. *Sipas meje, e vetmja dëshirë që i shtynte të vinit këtu këta njerëz nga fshati, ishte dëshira për të vallëzuar. Sipas nesh, e ngrëna jonë ishte shenjë e oreksit të mirë, mirëpo ai deshi të na shiste të tjera mendje.*

* Parafjala *para*, duke u lidhur me një emër me orgjinë përemërore, ka formuar lokucionin *para së gjithash*, i cili tregon shkallën e rëndësisë së një të dhëne. P. sh. *Këtu, para së gjithash, dua të nënvizoj se për këtë ekzistojnë gjykime të ndryshme, sepse në rrjedhë të shekujve kanë ndodhur ndryshime.*

* Parafjala me orgjinë ndajfoljore *kerabas* dhe një përemër kanë formuar lokucione, si: *kerabas kësaj, kerabas asaj, kerabas të tjerave* etj., të cilat tregojnë lidhjen logjike

të pjesëve të kumtimit, fakteve, të dhënave etj. P. sh. **Krabas kësj**, *mbaj mend që kullosja edhe një qengj dhe një dhi mallteze. Teatri i Operës dhe i Baletit do të shfaqë, krabas të tjerave*, koncertin me këngë partizane.

* Parafjala *midis* ka formuar lokucion me përemrin të tjera: *midis të tjerave* dhe *midis të tjerash*. Forma e dytë e përemrit del me mbaresën e rrjedhores - *sb*. P. sh. Një veçori e procesit letrar të sotëm është se, **midis të tjerave**, ai ka barrën për të plotësuar boshllëqet e letërsisë së mëparshme shqiptare, të kushtëzuara nga shkaqe letrare dhe jashtëletrare. Babai im ishte bujke i mirë dhe unë, **midis të tjerash**, fillova dalëngadalë të mësoja edhe profesionin e babait.

* Parafjala *përpos* ka formuar lokucione me përemra të ndryshëm, si: *përpos kësaj*, *përpos asaj*, *përpos të tjerave* etj., të cilat bëjnë lidhjen logjike të pjesëve të kumtimit. P. sh. Italia ... e ka penguar zbatimin mbi ne të genocidit që kishte përgatitur Serbia, **përpos të tjerash**, edhe përmes marrëveshjes turko - jugosllave mbi shpërnguljen e myslimanëve (shqiptarë).

Parafjalët *veç*, *përveç* me një përemër a emër kanë formuar lokucionet *veç kësaj*, *veç asaj*, *veç të tjerave*, *përveç kësaj*, *përveç saj*, *përveç të tjerave* etj., që tregojnë lidhjen logjike të fakteve a të pjesëve të kumtimit. P. sh. Në një vepër të gjatë, siç është romani, të tre këta komponentë, **veç të tjerave**, kanë rëndësinë e tyre të madhe, pse ndërthuren në kuadrin e kompozicionit për të plotësuar njëri - tjetrin. **Përveç kësaj**, princi francez nuk gëzonte pothuajse asnjë përkrahje nga Fuqitë Evropiane.

1.2. Lokucionet e formuara nga lidhëz + fjalë shënuese janë të rralla.

- Lokucionet *si pasojë*, *si rrjedhim*, *si përfundim* janë formuar nga lidhëza *si* dhe një emër abstrakt i prejardhur. Lidhëza dhe emri kanë humbur kuptimin dhe funksionin sintaksor. Lokucionet shërbejnë për të bërë lidhjen logjike të pjesëve të kumtimit. P. sh. **Si pasojë**, në çdo hap ndeshesha me një mori dukurish të tilla qesharake pa humor, sa më lëshonte zemra. **Si rrjedhim**, cikli i fjalëve do të niste nga e para. **Si përfundim**, ia plasëm gazit, të qeshurat vazhduan gjatë dhe atij i doli nga mendja që ishte i lodhur.

- Lokucionet *si zakonisht*, *si gjithnjë*, *si kurdoherë*, *si gjithmonë*, *si përherë*, *si kudo*, *si ngado*, *si gjithandej* etj. janë formuar nga lidhëza *si* dhe një ndajfolje kohe ose vendi. Këto lokucione tregojnë shkallën e rëndësisë së një fakti a të dhëne. P. sh. - *Dhe unë, si gjithnjë*, i ktheva të njëjtën përgjigje, - *tha Avniu*.

- Lokucioni *si rregull* është formuar me lidhëzën *si* dhe emrin *rregull*. Ky lokucion tregon vërtetësinë e asaj që kumtohet nga folësi. P. sh. *Copat e antologjisë, si rregull*, janë shoqëruar me një shënim të shkurtër biografik për çdo autor, pa pretendime vlerësimi e karakterizimi.

1.3. Lokucionet e formuara nga pjesëz + fjalë shënuese janë të rralla.

- Lokucionet *më qartë*, *më drejt*, *më saktë*, *më mirë* etj. janë formuar nga pjesëza *më* dhe një ndajfolje, e cila në këto struktura e ka humbur kuptimin e shkallës krahasore. Pjesëza nuk kryen funksionin e saj të zakonshëm. Këto lokucione përdoren për të

shprehur qëndrimin e folësit ndaj kumtimit. P. sh. *Vetëm në shtëpinë tonë s' pyetj kurrë për shtëpinë e re ose, më mirë, që të mos gënjejmë, s'fitej kurrë në sy të xhaxha Delit. Ditët kalonin dhe unë e Jonida i largobeshim njëra - tjetrës ose, më saktë, i largobesha unë asaj.*

- Lokucionet *dhe kështu, kështu pra, po kështu* kanë në strukturë një pjesëz dhe një ndajfolje. Pjesëza mund të jetë element i parë i lokucionit ose mund të qëndrojë pas ndajfoljes. Këto lokucione tregojnë lidhjen logjike të pjesëve të kumtimit, të fakteve etj. P. sh. *Kështu pra, puna e modës mori të tatëpjetën dhe njerëzja, duke kërkuar si t'i gjente një rrugë asaj pune, nisi të bënte disa luftra. Dhe kështu, që t'u vinin mbarë ato përpyekje, herë me sëpatë e herë me hunj, u ndërruan vendin edhe varreve.*

2. Lokucione të formuara nga dy fjalë shërbyese dhe një fjalë shënuese.

Nuk përbëjnë numër të madh. Fjala shënuese në këto struktura është zakonisht emër ose një ndajfolje. Kjo fjalë paraprihet nga dy fjalë shërbyese që i përkasin së njëjtës kategorie leksiko - gramatikore ose dy kategorive të ndryshme. Ato mund të jenë parafjalë ose lidhëza.

- Lokucioni *më në fund* i formuar nga parafjala *më* + parafjala *në* + emri *fund* i ka elementet me lidhje të ulët qëndrueshmërie. Ky lokucion ka vlerë ndajfoljeje dhe tregon lidhjen logjike midis pjesëve të kumtimit. P. sh. *Më në fund, duke përparuar kështu nga njëra mrekulli në tjetrën, e gjeta edhe rrugën e re për te baldakini.*

- Lokucioni *për më tepër* është formuar nga parafjala *për* + pjesëza *më* + ndajfolja *tepër*. Elementet përbërëse kanë fituar një farë qëndrueshmërie dhe kanë humbur funksionet sintaksore. Lokucioni tregon shkallën e rëndësisë së një fakti. P. sh. *Duart e tij merreshin si shpesh me veshët e mi dhe unë ia falja. Për më tepër, as unë nuk isha tipi ideal i fëmijës së mbarë.*

- Lokucionet *si për mrekulli, si për bela, si për çudi, si për inat* etj. kanë element të parë lidhëzn *si* dhe element të dytë parafjalën *për*, të ndjekur nga një emër me përmbajtje cilësie. Lidhja e parafjalës me emrin është më e qëndrueshme dhe formon një tog, që ka edhe përdorim të veçantë si lokucion. Këto lokucione shprehin qëndrimin e folësit për një fakt a diçka tjetër. P. sh. *Si për inat, shteti dhe njeriu turk, sado që pas Tanzimatit mundoheshin shumë të dukeshin demokratikë dhe të përparuar, e kishin ruajtur nderimin për aristokracinë.*

3. Lokucione të formuara nga dy fjalë shënuese dhe një fjalë shërbyese.

Përbëjnë një numër të vogël. Fjalët kuptimplota mund të jenë forma të së njëjtës fjale të përsëritur ose fjalë me veçori leksiko-gramatikore të ndryshme. Fjala jokuptimplotë është lidhëz ose parafjalë.

- Lokucioni *qind për qind* është formuar me dy forma të emrit *qind* në të pashquarën dhe parafjalën *për*. Ky lokucion tregon vërtetësinë e kumtimit, sigurinë e

folësit për atë që thotë. P. sh. - *Qind për qind, ky është fryt i fantazisë sate të sëmurë!* - i tha Ndrekoja.

• Lokucioni *pak a shumë* është formuar nga dy fjalë shënuese antonime të lidhura me lidhëz. Shërben për të treguar vërtetësinë e kumtimit. P. sh. *Telasbet e prijtes dhe të përkujdesjes për mysafirët ai, pak a shumë, ia kishte lënë vëllait më të madh.*

• Këtu do të përfshihet edhe lokucioni *pa një, pa dy*, i formuar nga parafjala *pa* e përsëritur dhe një numëror. Ky lokucion tregon siguri të plotë të kumtimit, domosdoshmëri, detyrim etj. P. sh. - *Sa herë bie shi i rrëmbyeshëm, këto toka përmythen nga lumi, pa një pa dy*, - tha xha Nezua.

II. Përdorimi dhe pasqyrimi në fjalorë

1. **Përdorimi** i lokucioneve të ndërmjetme është i lidhur me vlerat semantike që ato mbartin. Këto lokucione përdoren në gjuhën e folur dhe në atë të shkruar.

a. Në *gjuhën e folur* takohen shpesh lokucionet e ndërmjetme që përdoren për të bërë vlerësimin emocional, për të treguar burimin e kumtimit etj., si: *tek e fundit, për fat, për belë, për sherr, për dreq, për besë, në fakt, si për inat, për çudi, sipas meje, si gjithmonë, si përherë* etj.

b. Më të shpeshta këto lokucione janë në *gjuhën e shkruar*. Të shumta janë lokucionet e ndërmjetme që përdoren për të bërë lidhjen logjike të pjesëve të kumtimit, për të treguar sigurinë dhe vërtetësinë e tij, shkallën e rëndësisë etj., si: *për habi, për shembull, për rrjedhim, më së shumti, më së paku, më së pari, në thelb, në esencë, pa mëdyshje, pa bezitim, pa ngurim, pa rezervë, ndër të tjera, sipas njoftimeve, sipas informatave, para së gjithash, krabas të tjerave, midis të tjerave, midis të tjerash, si pasojë, si rrjedhim, dhe kështu, kështu pra, po kështu, për më tepër, si për mrekulli, si për çudi* etj.

2. **Pasqyrimi** i këtyre lokucioneve në fjalorët e gjuhës shqipe ka munguar, megjithë përdorimin e tyre të shpeshtë. Në fjalorë të ndryshëm ato nuk janë vlerësuar si njësi të veçanta gjuhësore me një vlerë semantike të caktuar, por janë pasqyruar në forma të ndryshme. Kështu, në Fjalorin e gjuhës shqipe të vitit 1954 janë pasqyruar një numër mjaft i kufizuar i këtyre lokucioneve, të tilla, si: *për mrekulli, për bukuri, për çudi, për dreq, për besë, në përgjithësi, në tërësi, pa fjalë, ndër të tjera, për rrjedhim* etj.

Në këtë vepër ato janë dhënë thjesht si shembuj ilustrues pas shpjegimit të fjalës titull dhe në ndonjë rast është dhënë edhe vlera e tyre semantike.

Në Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe të vitit 1980 këto njësi kanë gjetur një pasqyrim më të gjerë. Megjithatë, edhe në këtë vepër ato nuk janë vlerësuar si njësi të veçanta, por janë pasqyruar pak a shumë sipas praktikës së ndjekur në Fjalorin e vitit 1954.

Në Fjalorin e vitit 1980 ato janë pasqyruar në tri mënyra:

- Si shembuj ilustrues pas shpjegimit të fjalëve titull, si: *për ideal, me të drejtë, me gjasë, pa frikë, mbi gjithçka, sipas rregullores, sipas gjasës, sipas të thënave, sipas meje, si gjithnjë, si përherë* etj.

- Si një kuptim i veçantë i fjalës titull me shën. *ff. e ndërmjetme*, si: *kështu pra* etj.

- Si bashkim i qëndrueshëm në sythin e frazeologjisë. si: *tek e fundit, për fat, për bela, për dreq për pasojë, me të vërtetë, në fakt, në përgjithësi, në tërësi, pa rezerva, ndër të tjera, mbi të gjitha, para së gjithash, midis të tjerash, ndërmjet të tjerave, veç kësaj, si pasojë, për më tepër, më në fund, si për inat, qind për qind* etj.¹¹

Lokucionet e ndërmjetme kërkojnë trajtim më të plotë e të hollësishëm, që i kalon kufijtë e një kumtese. Këto lokucione janë të larmishme nga struktura dhe nga semantika. Nga vlera semantike, ato afrohen me pjesët e ligjëratës, por nuk kanë vlerën e asnjë pjese të tillë, sepse ato nuk kryejnë funksionin e asnjë gjymtyre të fjalisë. Në studimet e ardhshme ky grup lokucionesh do të trajtohet më në gjerësi, duke evidentuar më shumë veçori strukturore dhe kuptimore të tyre.

Literatura:

A. Kostallari, *Parimet themelore për bartimin e "Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe"*, Studime mbi leksikon dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe, II, 1972

A. Xhuvani, *Orgjina dhe formimi i ndajfoljeve në shqipe*, Çështje të gramatikës së shqipes së sotme, II, 1975

E. Hysa, *Formimi i ndajfoljeve*, Çështje të fonetikës dhe të gramatikës së gjuhës shqipe, 1972

Fjalor i gjuhës së sotme shqipe, 1980

Fjalor i gjuhës shqipe, 1954

Gramatika e gjuhës shqipe, I, 1995

Gramatika e gjuhës shqipe II, 1996

H. Xhaferi, *General Remarks on Locutions*, Academic Journal of Interdisciplinary Studies, Vol 4 No 1, Rome, Italy 2015

J. Thomai, *Frazeologjizmat foljorë në gjuhën shqipe*, Studime filologjike, 1, 1976

M. Çeliku, *Fjalët dhe togjet e fjalëve të ndërmjetme*, Gjuha shqipe dhe letërsia në shkollë, 3, 1975

¹¹ Në këtë fjalor disa lokucione janë pasqyruar si një fjalë e vetme me shën. *ndajfolje*. Njësisia *tek e fundit* është pasqyruar edhe si tog fjalësh (f. 516). Këto lokucione nuk kanë vlerë ndajfoljeje as si tog fjalësh, as si fjalë.

- Sh. Demiraj, *Emrat prejfoljorë asnjans dhe togjet me vlerë foljore të formuara me pjesëmarrjen e tyre*, Studime filologjike, 2, 1969
- Sh. Demiraj, *Rreth ndajfoljësimit (adverbializimit) të disa formave gramatikore dhe të disa togjeve të tipit para-fjalë + emër*, Çështje të fonetikës dhe të gramatikës së gjuhës shqipe, 1972
- Xh. Gosturani, *Vëzhgime për formimin e fjalëve në gegërishten verilindore*, Studime filologjike, 1 - 4, 1992

DOKTORANTËT

Shpëtim ELEZI

PËRDORIMI I SHQIPES STANDARDE NGA MËSIMDHËNËSIT E CIKLIT FILLOR

1. Sfondi teorik

Shkolla është domeni kryesor i përdorimit të gjuhës standarde, krahas administratës shtetërore dhe medias etj., në të cilat një gjuhë standarde përdoret para së gjithash në variantin e saj të shkruar, si dhe aspirohet të gjejë përdorim deri diku edhe varianti i folur i saj. Kjo situatë hetohet edhe në domenin e shkollës në Kosovë, në të cilin në radhë të parë parakuptohet përdorimi i atij varietetit të shqipes që në gjuhësinë shqiptare tashmë konvencionalisht po quhet shqipe standarde, si term më neutral dhe më i përshtatshëm në krahasim me të tjerët, i cili, sikur kemi vërejtur gjatë hulumtimit, tashmë gjerësisht është i njohur dhe i pranuar në mesin e respondentëve (mësimdhënës) që kanë qenë në fokus të hulumtimit. Ky varietet gëzon prestigj, qoftë si gjuhë e dokumentacionit pedagogjik dhe e teksteve shkollore, qoftë si gjuhë që shërben për komunikim në relacionin mësimdhënës – nxënës / student, në të gjitha hallkat e sistemit arsimor në Kosovë, në nivelin parashkollor e fillor, në atë të mesëm dhe në nivelin universitar. Së këndejmi, shqipja standarde kështu vjen dhe merr statusin e një gjuhe që përfaqëson shkollën dhe institucionet arsimore në përgjithësi. “Varieteti standard i një gjuhe është zakonisht ai varietet që përfaqëson kombin si tërësi dhe institucionet e tij më të larta drejtuese, arsimore dhe të kulturës në përgjithësi” (Fishman 1978: 45).

Përtej kësaj, shkolla është edhe institucioni kryesor ku zë fill nxënia e një gjuhe standarde dhe vetë imponimi dhe përhapja e tij nis pikërisht nga këtu. Edhe mësimi i varietetit standard të shqipes ose, më saktë, i sistemit gjuhësor të këtij varietetit është i lidhur ngushtë me procesin formal arsimor, sepse që këtu nis zyrtarisht mësimi, përhapja dhe zhvillimi i mëtejme i shqipes standarde. Studiuesit pajtohen se gjuha standarde mësohet e mësimi i saj në radhë të parë ndodh në shkollë, krahas institucioneve të tjera, si mediet, vendi i punës, jeta publike etj., që luajnë po ashtu rol në këtë drejtim. Lidhur me këtë, J. A. Fishmani (1978: 39) thotë se “pranimi formal i varietetit të kodifikuar (të standardizuar) përforcohet përmes ndërmjetësve dhe autoriteteve, siç janë qeveria, sistemi arsimor, mjetet masive të komunikimit,

institucioneve fetare dhe ‘establishmenti’ kulturor”. Këtë të dhënë për gjuhën standarde – i nxënë përmes shkollimit dhe praktikës pedagogjike gjuhësore – e gjejmë të përfshirë në të gjitha përkufizimet e gjuhëve standarde ndërkombëtare, si një varietet “që mësohet në shkollë” ose “që përhapet përmes shkollës” etj. Bie fjala, P. Trudgilli (2000: 5), kur e përshkruante anglishten standarde, e cilësoonte edhe si variant që mësohet në shkollë. Këtë element e gjejmë edhe në përkufizimin e R. Ismajlit për termin gjuhë standarde shqipe, që, sipas tij, shënon “varietetin e përbashkët gjuhësor për hapësira të gjera komunikimi të shkruar dhe gojor, në rrafsh mbidialektor, në jetën publike, me sistem të normuar dhe të kodifikuar, të mësuar përmes shkollimit dhe praktikës pedagogjike gjuhësore, me legjitimitet të krijuar përmes procesit kompleks historik në tubimet e marrëveshjes së përgjithshme dhe me zbatim institucional e tradicional përdorimor tashmë tri dekada” (Ismajli 2005a: 33). Sipas Xhevat Lloshit (2011: 229), “shkollë është vatra më e rëndësishme ku shoqëria ndërhyr drejtpërdrejt e në mënyrë të planifikuar për të ngulitur normën letrare.” Edhe sipas një hulumtimi të Munishit (2013: 72-73), realizuar përmes anketimit me qytetarë në Kosovë, del se shkollë është institucioni kryesor me 53% për mësimin e shqipes standarde dhe me 39% përsëri shkollë bashkë me mediet. Pra, një gjë e tillë pranohet përgjithësisht nga sociolinguistët. Sidoqoftë, me gjithë rolin e madh që ka shkollë në nxënien dhe përdorimin e një varieteti standard, problemet e funksionimit e të zotërimit të shqipes standarde në një shkollë jo gjithëqë të mirë nuk duhej lidhur vetëm e vetëm me mësimdhënien në shkollë. Problemi është shumë më kompleks se kaq, por nuk është rasti të diskutohet këtu. Sa i takon sistemit edukativo-arsimor në Kosovë, nxënia dhe zotërimi i shqipes standarde nis më intensivisht në moshën 6-vjeçare dhe vazhdon të mësohet në të gjitha nivelet e tjera të arsimit, e në njëfarë mase edhe në institucionet parashkollore më shumë si shkathtësi komunikimi në variantin e folur të saj.

Pra, lidhja ndërmjet gjuhës standarde dhe shkollës është e ngushtë dhe e dyfishtë: institucion ku mësohet dhe domen ku përdoret më së fortë ky varietet. Shkollë e imponon formën standarde të një gjuhe te nxënësit, të cilët, para se t’i nënshtroheshin këtij procesi, për nevoja komunikimi kanë mësuar spontanisht dhe kanë praktikuar natyrshëm një varietet natyror të tyre (gjuhë native), të nxënë përmes imitimit në mjedisin familjar e shoqëror ku kanë lindur e kanë jetuar deri në moshën parashkollore. Tashti, me të ardhur në shkollë, fëmijët ballafaqohen me një varietet gjuhësor të ndryshëm nga ai varieteti i tyre organik. Ky varietet i ri për ta është shqipja standarde që fëmijët nisin ta mësojnë falë aftësive të tyre natyrore për gjuhët dhe në saje të imitimit dhe kontaktit shoqëror. Një nga tiparet gjuhësore të këtij varieteti, siç thekson Ismajli, është karakteri artificial i tij (Ismajli 1991: 335). Ky tipar nuk ka të bëjë vetëm me faktin e formimit të gjuhës standarde në mënyrë arbitrare dhe me

përdorimin atëherë e aty ku nuk e ka vendin, por edhe pse nxënia e tij imponohet “dhunshëm”, pra jospontanisht, përmes mekanizmave të ndryshëm shoqërorë dhe, në radhë të parë, përmes shkollës. Prandaj, është e vetëkuptueshme se çfarëdo qoftë zhvillimi i përgjithshëm i nivelit të shkollimit, si i tillë ai manifestohet edhe në punë të ngritjes së nivelit të zotërimit të gjuhës standarde. Nga ana e tij, sistemi arsimor në Kosovë, në këto dekada të funksionimit të tij, ka përjetuar zhvillime herë të çrregullta e herë të çuditshme, duke u zhvilluar gjithmonë në rrethana të jashtëzakonshme, si pasojë e gjendjes dhe e zhvillimeve të jashtëzakonshme të përgjithshme shoqërore e politike nëpër të cilat ka kaluar shoqëria shqiptare në Kosovë deri më sot. Studiuesit, si Ismajli (2005a) dhe Munishi (2013), përshkruajnë në mënyrë më të plotë rrethanat politike e shoqërore që kanë pasur implikime direkt ose indirekt edhe në politikat për procesin e standardizimit të gjuhës shqipe dhe në nivelin e të zotërimit e të përhapjes të saj në Kosovë. Shkolla shqipe në të gjitha nivelet e saj nuk është zhvilluar në kushte normale në Kosovë, madje as në këto 15 vjetët e fundit të pasluftës, gjatë të cilave pareshtur është provuar e po provohet që të përshtaten e të hartohen plan-programe të ndryshme shkollore, më së shumti, deri në pikën e programeve pilot, por kurrë pa ia dalë të konsolidohen qëndrueshëm. Andaj, në këto rrethana, duhet parë edhe niveli jo gjithaq i kënaqshëm i shqipes standarde në komunikimin publik në Kosovë. Kjo situatë është pasojë e asaj çfarë ka qenë sistemi shkollor për këto vjet prejse është formuar shqipja standarde. Studiuesit, si Isa Bajçinca (2006), mendojnë që kjo gjendje e keqe e shqipes standarde në Kosovë është përveç të tjerash edhe pasojë e një sistemi edukativo-arsimor të zhvilluar në rrethana të pafavorshme dhe nën ndikimin e madh të serbishtes sidomos në vitet '50 e '60 të shek. XX. Po ashtu, edhe sipas Munishit (2013: 195), mospërhapja e shqipes standarde është pasojë e imponimit të pamjaftueshëm nga institucionet, shkollat dhe mediet. Mirëpo, përveç këtyre dhe faktorëve të tjerë sociolinguistikë, si ambienti gjuhësor, ku fëmija e nxë variantin e parë të gjuhës së folur, niveli i përgatitjes i mësimit në shkollat fillore, emisionet televizive, përkatësia një grupi të caktuar shoqëror, Paçarizi (2011: 163-164) si më të rëndësishmin e vlerëson mungesën e kontaktit me folësit burimorë të variantit mbi të cilin është mbështetur gjuha e shkruar standarde. Nga ana tjetër, ai përmend edhe faktorë psikolinguistikë që “janë të lidhur me proceset e prodhimit dhe të të kuptuarit të gjuhës, pastaj proceset psikomotorike të realizimit akustik të konceptit mendor, apo aftësia e shndërrimit të sinjaleve vizuale në sinjale akustike (Paçarizi 2011: 164). Megjithatë, parë thjesht brenda problemit të kësaj teme, mund të thuhet se çfarë është gjendja në shkollë, përgjithësisht, e tillë është edhe situata e përdorimit të shqipes standarde. Nëse në përgjithësi themi se çalon sistemi arsimor, një gjë e tillë do të mund të thuhet edhe sa i përket cilësisë së përdorimit të shqipes standarde. Me

siguri që shqipja standarde mësohet edhe përmes medieeve, vendit të punës, komunikimit dhe në rrethana të tjera, por s'do mend që shkolla mbetet domeni kryesor i mësimit dhe i përdorimit të saj. Kjo edhe për faktin se pikërisht në shkollë, si një nga domenet kryesore të komunikimit publik, ngjizet motivi, ngrihet ndërjegjja dhe selitet ideja të rinjtë për të mësuar dhe për të përdorur shqipen standarde, e cila kështu përfton karakterin e një varieteti prestigjioz në raport me varietetet e tjera gjuhësore me bazë dialektore e sociale, ndonjëherë edhe duke i mohuar e duke i stigmatizuar gabimisht këto varietete natyrore të fëmijëve, natyrisht me qëllimin e mirë pedagogjik që nxënia, zhvillimi dhe ngulitja e shqipes standarde, si një varietet i përbashkët gjuhësor, të bëhet sa më mirë e në mënyrë sa më të plotë në komunikimin e folur e të shkruar. Ndaj, për këtë rol që ka shkolla dhe sistemi arsimor si subjektet kryesore për mësimin e gjuhës standarde, Munishi (2013: 77) thotë se çdo lëndatë apo kritikë për cilësinë dhe nivelin e nxënies së gjuhës standarde nga individit duhet të adresohet te shkolla dhe sistemi arsimor. “Niveli i lartë i nxënies së gjuhës standarde sigurisht është meritë e arsimtarëve që ua kanë mësuar gjuhën standarde individëve dhe çdo defekt në gjuhën standarde, nëse nuk është defekt patologjik, ndonjë lloj afazie, duhet të konsiderohet si defekt në një hallkë të caktuar të sistemit arsimor që ka rezultuar me dështimin në mësimin e gjuhës standarde” (Po aty, f. 77). Në të vërtetë, “një sistem i mirë për t'i rritur fëmijët është t'i vendosësh ata në një mjedis stimulues, ku aftësia e tyre natyrore do të jetë në gjendje të lulëzojë” (Draçini 2013: 240). Por, sipas Çomskit, për arsye të vlefshme shoqërore, këto aftësi jo që nuk u mësohen fëmijëve, por shkollat të projektuara për t'u mësuar fëmijëve bindjen dhe konformizmin bëjnë saktësisht të kundërtën, “pengojnë që aftësitë e natyrshme të fëmijëve të zhvillohen” (Chomsky 2008: 172). Shikuar në këtë prizëm, roli i shkollës të fëmijët është sa i rëndësishëm po aq dhe delikat, por ky është problem tjetër dhe, prandaj, nuk do të diskutohet më tej këtu. Me këtë rast, në vijim do të mjaftohemi me disa mendime lidhur me procesin e mësimit të gjuhës shqipe në shkollë.

Studiuesit, si Rexhep Ismajli (2005b) dhe Bahri Beci (2007), sugjerojnë që në procesin e programimit të njohurive për gjuhën amtare dhe në procesin e hartimit të teksteve dhe në praktikën e punës mësimore në shkollë të merret parasysh që gjuha shqipe operon në variante, stile e regjistra, secili me një sistem më vete mjetesh gjuhësore dhe me vlerë të veçantë në varësi nga situatat e komunikimit, numri i bashkëbiseduesve dhe i natyrës së marrëdhënieve me ta, qëllimi i komunikimit etj. Megjithatë, ka studiues, si Isa Bajçinca (2006), Xhevat Lloshi (2011) etj., që shtrojnë të kundërtën e kësaj që u tha më lart. Bajçinca mendon se në shkollë duhet të mësohet vetëm sistemi gjuhësor i shqipes standarde, madje duke i parë idetë e mësipërme si tendencë për bastardimin a edhe për ndryshimin e shqipes standarde. Kurse Lloshi,

duke identifikuar nxënës në shkollë, por dhe mësues me të folur dialektor që vjen nga një krahinë e caktuar, që ka shprehinë e formimin e vet, thotë se “në klasat e shkollave tona tashmë nuk ka përsë të hyjnë mësues që nuk zotërojnë gjuhën letrare, ashtu si nuk ka përsë të marrin diplomën e fakulteteve të mësuesisë studentë që edhe pas 16 vjet shkollë,...nuk janë në gjendje të kapërcejnë nga dialekti në të folurit letrar” (230) dhe prandaj shton se “na mbetet mjaft punë për të bërë,...që brenda mureve të shkollës të tingëllojë shqipja letrare” (Po aty, f. 196). Mirëpo ky konceptim, me gjithë qëllimin e mirë që bart në vete, thënë kështu jo vetëm që nuk tingëllon mirë në aspektin pedagogjik dhe është tepër mohues në aspekt kulturor e shoqëror, por tashmë është i tejkaluar edhe në gjuhësi, pasi një varietet standard dhe varietetet e tjera jostandarde të një gjuhe jo që nuk krijojnë kundërvënie, por janë komplementare ndërmjet vete në repertorin gjuhësor të një bashkësie gjuhësore në situata e me funksione të ndryshme komunikimi. “Standardi dhe varietetet e tjera deri te dialekti “i pastër” e ushqejnë njëri-tjetrin në rrafshet dhe në nivele të ndryshme” (Ismajli 2005b). Sociolinguistët, siç është R. Hudson-i, japin vërejtjen që “mësuesi sigurisht nuk duhet të synojë të çrrënjosë plotësisht varietetin jostandard të fëmijëve. Nëse kjo është e qartë për të gjithë të interesuarit, fëmijët mund të mësojnë të kalojnë nga standardi në jostandard (dhe e kundërta) sipas rrethanave, siç ndodh në të gjitha bashkësitë diglosike” (Hudson 2002: 248). Kjo edhe për arsye se, siç theksojnë psikolinguistët, si Paçarizi (2011: 133), deri në moshën gjashtëvjeçare fëmijët tashmë e kanë perfeksionuar gjuhën e tyre native dhe çdo gjuhë tjetër që e mësojnë pas kësaj moshe llogaritet si gjuhë e dytë, të cilën kurrë nuk do të arrijnë ta përvetësojnë deri në masën sa ta përdorin si gjuhë të emocioneve, gjuhë të përrallave dhe gjuhë intime. Sipas tij, për fëmijët në Kosovë gjuha standarde nuk është gjuhë të cilën e kanë mësuar duke e dëgjuar në mënyrë permanente, prandaj edhe kur vijnë në shkollë ata e mësojnë jo standardin e folur, por standardin e shkruar, të cilin e përjetojnë si një gjuhë tjetër nga ajo që e kanë mësuar deri në atë moshë në shtëpi dhe kështu vetë shqipen standarde e identifikojnë vetëm me formën e shkruar. (Shih për më tej Paçarizi 2002: 109 – 136). Më tej, R. Ismajli (2005b) thotë se është e nevojshme të kërkohet dhe të nxitet selitja edhe e shprehjes dialektore dhe substandarde, jo vetëm pse përjetohet si shprehje e natyrshme, por edhe për arsye parimore pedagogjike: stimulohet nevoja për gjuhë të kujdesur, çka është thelbësore për standardin. “Prandaj del e nevojshme që në shkollë shqipja standarde të mësohet më tej duke mos mohuar varietetet e ndryshme që kanë sjellë me vete fëmijët, por si një “kod” i veçantë, i dalluar mirë: fëmijëve duhet t’u tregohet se burimet, funksioni dhe zbatimi i gjuhës standarde janë të ndryshme nga ato të varieteteve që tashmë njohin... Me këtë ne ndihmojmë zgjerimin e aftësive komunikative të fëmijëve për varietete të ndryshme të shqipes, pra dhe horizontin e

zotërimit të shqipes standarde” (Ismajli 2005b). Këtë pikëpamje e gjejmë të shprehur edhe në mbledhjen e Këshillit Ndërkademiç për Gjuhën Shqipe (2014). Në pikën e dytë të rendit të ditës, ku është diskutuar çështja: “Shqipja standarde dhe shkolla”, si propozim i 8-të jepet: “Në shkolla t’i kushtohet vëmendje diversitetit kulturor e begatisë dialektore të shqipes, në mënyrë që të mos krijohet hapësirë për stigmatizim të cilitdo varietetit të shqipes”. Po ashtu, Shkumbin Munishi, përveçse e sheh të nevojshme që me konsensus institucional mbarëkombëtar korpusi i shqipes standarde të rishikohet e të pasurohet me elemente nga varietetet e tjera të folura të shqipes, shton se “planifikimi i nxënies duhet të përqendrohet jo vetëm në nxënien e normës së shqipes standarde nga nxënësit dhe përdoruesit e tjerë të shqipes standarde, por edhe në mësimin e varieteteve të tjera të shqipes” (Munishi 2015: 172). Ai, më tej, për sa u përket raporteve të shqipes standarde me kodet e tjera, promovon një politikë relativisht liberale dhe egalitare në pajtim me diversitetin kulturor si vlerë shoqërore dhe në kundërshtim me qasjen e derivonshme monolingualiste, si dhe sugjeron që përdorimi i këtyre varieteteve të shqipes të bëhet në përputhje me adekuacitetin funksional. Munishi mendon se këto veprime në fushën e politikës e të planifikimit gjuhësor do të kontribuonin që të forcohej vitaliteti i gjuhës shqipe, të zgjerohej funksionaliteti i saj, të pranohej e të zbatohesh ajo nga gjithë shqiptarët dhe, në këtë mënyrë, t’u bëjë ballë sfidave globale e rajonale të këtij mijëvjeçari (Po aty, f. 172, 174). Sipas Rexhep Ismajlit (2005b), dy drejtimet të zhvilluara tradicionalisht në punë të mësimdhënies së gjuhës amtare: mësimdhënia e mbështetur në kodin gjuhësor ose gramatikor që e thekson shqipen e shkruar si manifestimin më të mirë të shqipes standarde dhe mësimdhënia e përqendruar te të folurit, te prodhimi i mesazheve, që i merr parasysh perspektivat dhe rezultatet e studimeve sociolinguistike, psikolinguistike e funksionale, që nuk mbyllet vetëm në rregullat gramatikore, por u jep hapësirë aftësive dhe potencialeve krijuese, aktivitetit verbal në klasë, spontanitetit – është e nevojshme të kombinohen përmes një baraspeshimi. Pikërisht në këtë frymë, si dije teorike e si praktikë përdorimi, gjuha shqipe mund t’u selitet e t’u mësohet fëmijëve në shkollë, sepse tek e fundit parësor është komunikimi në funksion të të cilit është gjuha. Të kihet gjithashtu parasysh se mësimdhënia e gjuhës shqipe në sistemin arsimor në Kosovë është konceptuar si bartëse e veprimtarive të tilla, si: të dëgjuarit dhe të folurit; të lexuarit dhe të shkruarit, shkathtësi që janë me rëndësi jo vetëm për mësimin e vetë lëndës së gjuhës shqipe, por përmes tyre edhe për mësimin e materieve të lëndëve të tjera në shkollë, si dhe për “alfabetizimin e popullatës dhe transmetimin e vlerave tradicionale, të letërsisë dhe të kulturës së trashëguar, të njohjeve, (pra, mësimdhënia e gjuhës amtare – shënim imi) synon të përgatisë individë për ta ushtruar funksionin e komunikimeve të institucionalizuara përbrenda bashkësisë kombëtare dhe jashtë saj.

Prandaj është e nevojshme të mos harrohen varietetet e gjuhës që lidhen me këto funksione. Në të gjitha variantet duhet një zotërim i shqipes së zgjedhur gojore. (Ismajli 2005b). Së këndejmi, sipas tij (po aty), në veprimtaritë me shkrim kërkohet shqipja standarde, korrekte, ndërsa me gojë mund të nxirren në shesh sa më shumë elementet dalluese dhe të flitet për to e të ushtrohen.

Në gjithë këtë sa u tha më lart, padyshim, rol qenësor luan mësuesi, si një nga komponentët qendrorë në procesin mësimor krahas plan-programeve dhe teksteve shkollore, duke formuar kështu trekëndëshin tekst shkollor – mësues – nxënës, që natyrshëm përfaqësojnë edhe tri varietete gjuhësore. Metodistët e mësimdhënies e quajnë shumë të rëndësishëm rolin e mësuesit në tërë këtë proces. Sipas Lloshit (2011: 197), mësuesi që shpjegon në klasë për t'iu dhënë njohuri nxënësve, medoemos u mëson atyre edhe gjuhën, me të cilën shprehen ato njohuri, si dhe kulturën e ligjërimit. Rezultatet e të nxënimit në përgjithësi dhe të nxënimit të gjuhës shqipe në veçanti varen edhe nga efektiviteti i metodave të përdorura nga mësimdhënësi në klasë. Mirëpo, po ashtu, këto metoda, që të japin efekte të dëshiruara te nxënësit, duhet t'i zbatojë një mësimdhënës kompetent në fushën e tij të specializimit. Së këndejmi, nuk ka dyshim që një mësues i tillë, që, para së gjithash, dëshmohet për kompetencë dhe për performancë gjuhësore cilësore dhe që zotëron edhe komponentin didaktik të mësimdhënies, ndikon në mënyrë të gjithanshme te nxënësit dhe është faktor themelor për nxënien cilësore të gjuhës (standarde) shqipe në formën e saj të shkruar dhe në atë të folur. Sipas Munishit (2013: 89-90), mësuesit, bashkë me spikerët konsiderohen si përcuesit dhe përhapësit më të mirë të normës së folur të gjuhës standarde. Natyrisht, nxënësit e shkollës fillore 5-vjeçare, krahas mësimin përmes metodave të ndryshme globale, shpesh mësojnë formën e shkruar të gjuhës në mënyrë fotografike duke e parë të prodhuar me shkrim dhe formën e folur duke imituar, në radhë të parë, mësuesit gjatë aktit të tyre të ligjërimit. Kjo sepse “veprimtaria ligjëruese formon një tërësi në të cilën gërshtohen në një të vetme gjuha dhe ligjërimit, se gjuha si sistem dhe aktet e ligjërimit konkret janë dy anë të një dukurie të vetme, se të njohësh gjuhën do të thotë të njohësh edhe sistemin edhe aktet e ligjërimit konkret” (Beci 2007). Pra, mësuesi është edhe modeli që duhet ndjekur nga nxënësit edhe në punë të praktikimit me shkrim e me gojë të gjuhës standarde. Por çfarë shembulli jep mësuesi i ciklit fillor në Kosovë? Cili është niveli i tij i njohjes dhe i përdorimit të shqipes standarde? Deri tash, përgjigjet për këto pyetje shpeshherë kanë dalë në formën e deklaratave të pabazuara në hulumtime konkrete në terren. Shefkije Islamaj (2004: 77) konstaton se “kultura gjuhësore e mësimdhënësve tanë, që punojnë në universitet, ashtu si edhe në arsimin e mesëm dhe në atë fillor, është jo e dëshirueshme, për të mos thënë e keqe në shtrirje të gjerë. Fjala është sidomos për

shprehjen gjuhësore, që e karakterizon procesin e mësimdhënies dhe paraqitjen publike të kësaj shtrese intelektuale.” Për këtë, ajo thotë se “shkaqet janë të shumta, objektive e subjektive, por shumë më shumë subjektive (Po aty, f. 77). Edhe Isa Bajçinca (2007), ndër të tjera, flet për një shkallë të ulët të përgatitjes, sidomos në fushë të kulturës së gjuhës, së mësuesve të shkollave, në përgjithësi e edhe të mësuesve të shqipes. Shkallë e pamjaftueshme e njohjes dhe e zbatimit të shqipes standarde konstatohet edhe në mbledhjen e Këshillit Ndërkademiç për Gjuhën Shqipe (2014), në diskutimet dhe propozimet për çështjen e dytë të rendit të ditës: “Shqipja standarde dhe shkolla”, për çka, ndër të tjera, propozohet që të bëhet “trajnimi i mësuesve të gjuhës në kurse periodike katërvjeçare.”

Por, megjithëse ky punim në fushë të sociolinguistikës merret me problemin e përdorimit të shqipes standarde nga mësuesit, sepse sistemi shkollor është një nga domenet kryesore të nxënies dhe të përhapjes së varieteteve standarde, Hudson-i (2002: 239-241) na tërheq vëmendjen se nuk duhet të ngatërrohet forma gjuhësore e përdorur në klasë me informacionet e tjera që mund të duken më të rëndësishme në procesin mësimor. Prandaj, bazuar në këtë pikëpamje të tij, as duhet paragjykuar forma gjuhësore deri në atë pikë sa të ndikojë që të krijohen përshtypje të gabuara për aftësinë e mësuesve, për shkathhtësitë e tjera dhe nivelin e përgjithshëm të tyre në mësimdhënie. Pra, këtu do të vështrohet niveli cilësor i përdorimit të shqipes standarde, por pa i paragjykuar aftësitë e tjera të tyre, si pedagogjike, komunikuese etj. Po ashtu, bazuar në matjen se sa standarde është gjuha e tyre, do të ishte e gabuar të nxirrej vlerësimi që të gjithë mësuesit kanë kompetencë të ulët gjuhësore, sepse, përtej kësaj, mund të kenë “kompetencë komunikuese”, term i krijuar nga Dell Hymes (1971) që koncepton dijen, njohurinë e nevojshme të folësit ose të dëgjuarit dhe që ka bazë më të gjerë sesa “kompetenca gjuhësore” e gjuhësisë çomskiane. Ndërkaq, Basil Bernstein dallon dy “kode” gjuhësore shumë të përgjithshme, të cilat ai i quan kodi “i kufizuar” dhe kodi “i përpunuar”. Sipas kësaj teorie, kodi i fundit, i përpunuar, është ai që është i nevojshëm në shkollë, ku është e rëndësishme të jesh i aftë të shprehesh shkoqur dhe qartë. Por, kompetenca që fëmijët kanë për të është e pabarabartë, sepse ata vijnë nga mjedise të ndryshme shoqërore. (Bernstein, cituar sipas Hudson 2002: 246). Pra, ky hulumtim nuk paragjykon rezultatet e nxënies në klasë, sepse ndodh që mësuesit, megjithëse performojnë dobët në shqipen standarde, të kenë zhdërvjelltësi ligjërimore të atillë që nxënësit i marrin, madje shumë mirë, informacionet rëndësore. Sipas Hudson-it (2002: 240), as mund të supozohet që mësuesit me nivel të ulët të standardit kanë sukses të ulët në procesin e të nxënies. Një përshtypje e tillë për mësuesit do të ishte njësoj e gabuar krahasuar me fëmijët që kanë një mënyrë të foluri që të jep fillimisht një përshtypje të pafavorshme. I rëndësishëm në fund është

informacioni. Po t'i ndërtojmë përshtypjet tona për mësuesit vetëm mbi bazën e zotërimit të shqipes standarde, do t'i linim anash faktorët e tjerë që ndikojnë në procesin e të nxënit. Kjo nuk mëtohet këtu. Pra, do të ishte e gabuar të mendoje që të gjithë mësuesit që flasin varietete ose që kanë shqiptim jostandard, të jenë mësues të dobët dhe të pasuksesshëm në mësimdhënie. Ata edhe mund të mos ua mësojnë mirë gjuhën standarde fëmijëve, më saktë sistemin gjuhësor të këtij varieteti, gjë që edhe e kanë për detyrë ta arrijnë këtë objektiv të rëndësishëm, por mund të jenë mësues të suksesshëm, sepse zotërojnë një varg komponentësh të tjerë që lidhen me personalitetin e tyre dhe me procesin e mësimdhënies përgjithësisht.

2. Sfondi metodologjik

Në këtë punim janë vështruar situata gjuhësore të përdorimit të shqipes standarde nga mësimdhënësit e ciklit fillor të klasave nga 1 – 5. Përmes matjeve empirike sociolinguistike, ky hulumtim josistematik dhe i rastit i kryer në terren në muajin maj 2015 ka hetuar situata dhe probleme konkrete të përdorimit të shqipes standarde dhe të varieteteve të tjera në shkollë. Hulumtimi është realizuar në formë anketimi dhe sprovimi në probleme konkrete të normës së shkruar të shqipes standarde me një numër prej 66 mësimdhënësish në marrëdhënie pune në disa shkolla fillore në Kosovë dhe në Kosovën Lindore. Është përfshirë ky numër personash me qëllim të interpretimit më të lehtë të rezultateve. Zgjedhja e shkollave dhe e kampioneve të hulumtimit ka qenë e rastit. Nga 66 të anketuar, në Prishtinë janë anketuar 24 respondentë të dy shkollave, njëra publike e tjetra jopublike, në Gjilan (5 respondentë), Kamenicë (6), Kaçanik (3), Klokot (2) dhe në Viti, Novobërdë, Shtërpçë dhe në Han të Elezit nga një, si dhe në Preshevë (12) dhe në Bujanovc (10). Nga këta, sa i përket nivelit të kualifikimit të tyre, 44 mësimdhënës janë me shkollë të lartë pedagogjike (ShLP), 12 me bachelor dhe vetëm 8 me master e 2 nuk janë deklaruar fare. Sa i përket përvojës së punës, shumica prej tyre dalin që kanë më shumë se 10 vjet përvojë pune në mësimdhënie. Ndërsa sa i përket gjinisë, 49 janë mësimdhënës dhe 17 mësimdhënës. Sa i takon prejardhjes, 27 vijnë nga zonat rurale dhe 35 nga qyteti, si dhe 4 nuk e kanë deklaruar fare. Për të pasur një shembull të hapësirës katërdimensionale, janë marrë me qëllim informata për faktorë sociolinguistikë, si përvoja e punës, prejardhja regjionale, kualifikimi dhe gjinia e respondentëve, si dimensione të rëndësishme për gjuhën. Hulumtimi është realizuar në kondida të respektimit të kritereve etike të punës në terren. Kështu, respondentët janë informuar që anketimi po bëhet për qëllime studimore të karakterit sociolinguistik dhe që informatat e marra prej tyre do të përdoren vetëm në kuadër të këtij studimi

dhe do të mbeten konfidenciale, ashtu siç kanë pasur mundësi që të mbeten anonimë pa e dhënë emrin e tyre, por vetëm të dhënat e tjera relevante.

Anketa, e përbërë nga 9 kërkesa, është konceptuar në tri pjesë, sipas tri qëllimeve të ndryshme: në pyetjet 1 – 7 të tipit të mbyllur është kërkuar të jepet opinioni dhe qëndrimi i mësimdhënësve lidhur situatat dhe funksionet e përdorimit të shqipes standarde dhe të varieteteve të tjera në shkollë; pyetja e 8-të ka qenë kërkesë për të zgjedhur midis alternativës së saktë e të pasaktë të 10 shembujve individualë të dhënë me trajta gramatikisht jokorrekte, nga ata që mund të cilësohen si më të lehtë e mesatarë dhe deri tek ata që janë të një natyre më të vështirë për t'u zgjidhur. Dhe pyetjen e 9-të e ka përbërë një tekst me 49 gabime gjuhësore (kryesisht të natyrës fonetike e morfologjike dhe më pak të karakterit sintaksor e leksikor), të cilin të anketuarit është dashur ta korrigjojnë e ta përshtatin sipas rregullave të shqipes standarde. Të anketuarit janë përgjigjur me shkrim brenda kohës së caktuar.

Ky hulumtim ka më tepër karakter përshkrues, pasi, në radhë të parë, bën përshkrimin e situatës gjuhësore sa i përket përdorimit të gjuhës standarde nga mësimdhënësit e disa shkollave në Kosovë. Qëllimi nuk ka qenë që të jepen vlerësime të natyrës preskriptive dhe as të mbahet qëndrim lidhur me rastet e hulumtuara, por që në mënyrë më të plotë përmes korpusit të krijuar nga anketimi të përpunohen të dhënat statistikisht dhe kështu të pasqyrohet një gjendje faktike e përdorimit të shqipes standarde në formën e shkruar të saj nga mësimdhënësit e ciklit fillor. Në hyrje është paraqitur edhe një sfond teorik i problemit, duke e parë në kuadër të mendimit gjuhësor shqiptar dhe më tej.

Përmes këtij hulumtimi, u është dhënë përgjigje këtyre pyetjeve:

- Cili varietet i shqipes përdoret nga mësimdhënësit në klasë / në shkollë në komunikim me nxënësit?
- Cili nga varietetet përdoret më shpesh dhe pse, kur ata komunikojnë me nxënësit?
- A përdoret shqipja standarde vetëm kur flitet për tema mësimore apo edhe për tema të tjera?
- A përdoret shqipja standarde vetëm në orët e gjuhës shqipe apo edhe në orët e lëndëve të tjera?

Përgjigjet e këtyre pyetjeve të parashtruara kanë shpënë te rezultatet e hulumtimit, përmes të cilave është konstatuar edhe shkalla e përdorimit të shqipes standarde dhe e varieteteve të tjera nga mësimdhënësit e ciklit fillor të klasave nga 1 – 5, si dhe niveli i kompetencës gjuhësore të vetë mësimdhënësve në shqipen standarde.

3. Rezultatet e hulumtimit

3.1. Interpretimi i rezultateve të pyetjeve 1 – 7

Përmes pyetjeve të para të anketës (pyetjet 1 – 7) kemi pasur për qëllim që të marrim opinionin e mësimitdhënësve lidhur me atë se sa shpesh, kur, ku dhe për çka e përdorin ata shqipen standarde në komunikim me nxënësit e tyre, cilat janë qëndrimet e tyre për shqipen standarde, si dhe a përdorin ata ndonjë varietet tjetër në komunikimin e tyre në shkollë.

Në pyetjen e parë: A e përdorni shqipen standarde kur komunikoni me nxënësit? – 83% (55 të anketuar) janë përgjigjur: *PO*, 15% (10) kanë zgjedhur alternativën: *JO* dhe 2% (1) nuk ka dhënë fare përgjigje.

Këtë përqindje të lartë e kanë konfirmuar edhe në kërkesën e dytë, kur janë pyetur se në ç'mjedis e përdorin më shumë shqipen standarde kur komunikojnë me nxënësit, për të cilën 86 % (57 të anketuar) kanë zgjedhur alternativën: *në çdo mjedis shkolle*, 12 % (8) janë përgjigjur: *vetëm në klasë*, asnjë nuk ka zgjedhur alternativën: *nuk e përdor në asnjë ambient shkolle* dhe 2% (1) nuk është përgjigjur fare.

Numër i madh i të anketuarve, 61 % prej tyre (40 të anketuar) kanë zgjedhur alternativën: *rregullisht*, kur janë pyetur për kohën e përdorimit të shqipes standarde në komunikim me nxënësit, 26 % (17) janë përgjigjur: *përgjithësisht*, 12 % (8) kanë zgjedhur alternativën: *mesatarisht* dhe 1% (1) nuk është përgjigjur fare; Për alternativat: *ndonjëherë* dhe *asnjëherë* nuk është përgjigjur asnjë prej tyre.

Kur janë pyetur se për ç'tema e përdorin më shumë shqipen standarde në bashkëbisedim me nxënësit, 77% (51) prej tyre kanë zgjedhur alternativën: *për tema mësimore dhe tema të lira*, ndërsa vetëm 9 % (6) kanë zgjedhur alternativën: *vetëm për tema mësimore*. Përqindje të vogël prej 9 % (6) përbën edhe numri i tyre që kanë deklaruar se: *gjithmonë flasim në dialekt me nxënësit*, ndërsa asnjë prej tyre nuk ka zgjedhur alternativën: *për tema të lira flasim në dialekt, si dhe pa përgjigje* janë 5% (3) e të anketuarve.

Po ashtu, përqindje të lartë prej 77% (51) kanë dhënë edhe për pyetjen nëse shqipen standarde e përdorin: *në të gjitha orët mësimore të çdo lënde*, ndërsa vetëm 17% (11) kanë thënë se e përdorin: *më shumë në orët e gjuhës shqipe dhe më pak në orët e lëndëve të tjera*, nga 1.5% (1) kanë zgjedhur alternativat: *vetëm në orët e gjuhës shqipe* dhe *në orët e lëndëve të tjera flas në dialekt*, si dhe 3% (2) të anketuar nuk janë përgjigjur fare.

Interesante janë përgjigjet e tyre në kërkesën e gjashtë, pasi alternativat që ata kanë zgjedhur shkojnë në kundërshtim me sa janë përgjigjur më lart sa i përket shkallës së përdorimit të shqipes standarde dhe të varieteteve të tjera nga mësimitdhënësit në bashkëbisedim me nxënësit në mjedisin shkolle. P.sh., kur janë

pyetur se me cilin varietet gjuhësor i kuptojnë më lehtë nxënësit, 65 % (43) prej tyre kanë zgjedhur alternativën: *berë në standard e berë në dialekt sipas nevojës*, ndërsa vetëm 23 % (15) alternativën: *në gjuhën standarde*. Alternativën: *në gjuhën dialektore* e kanë zgjedhur 4% (3), ndërsa 8% (5) kanë zgjedhur të mos përgjigjen fare.

Më tej, kur janë pyetur për shkallën e vështirësisë së përdorimit të shqipes standarde në komunikimin e tyre me nxënësit, në kërkesën: *Komunikimi në shqipen standarde për mua si mësimdhënës/-e është* – ata kanë zgjedhur të përgjigjen midis alternativave: *i lehtë* 47 % (31 të anketuar) dhe *jo aq i lehtë* 29 % (19), ndërsa komunikimin në shqipen standarde si *tepër të lehtë* e kanë vlerësuar vetëm 9 % (6) prej tyre dhe 8 % (5) si *jo aq të vështirë*, vetëm 1 % (1) si *të vështirë* dhe asnjë prej tyre nuk e ka vlerësuar si *tepër të vështirë*. Por, siç do t'i shohim më poshtë, këto të dhëna shkojnë ndesh me ato çfarë të anketuarit kanë performuar lidhur me shembujt individualë të sprovimit në pyetjen e tetë dhe me rastin e korigjimit të një teksti me gabime në kërkesën e nëntë të anketës.

3.2. Interpretimi i rezultateve të pyetjes së 8-të

Siç u tha më lart, mësimdhënësit janë sprovuar me 10 shembuj individualë, për të cilët ata është dashur të japin alternativat e sakta të shkrimit të tyre në shqipen standarde. Shembujt e dhënë në anketë pasqyrojnë shkallë të ndryshme të vështirësisë së zgjidhjes së tyre, gjë që manifestohet edhe në rezultatet e përgjithshme.

Lidhur me shembullin e parë jokorrekt: *ai do të punon*, 48 të anketuar ose 73 % kanë dhënë zgjidhje të pasaktë dhe 18 prej tyre ose 27 % kanë dhënë zgjidhje të saktë;

Për vektorin e vetës së parë: *un*, 52 prej tyre ose 79 % kanë dhënë zgjidhje të saktë dhe 14 prej tyre ose 21 % kanë dhënë zgjidhje të pasaktë;

Për variantin e paskajores geqe: *me lexu*, 51 prej tyre ose 77 % kanë bërë zgjidhje të pasaktë dhe vetëm 15 të anketuar ose 23 % kanë dhënë zgjidhje të saktë.

Për trajtën geqe me /n/ të parotacizuar të fjalës *syni*, 56 prej tyre ose 85 % kanë dhënë zgjidhje të saktë dhe 10 sish ose 15 % kanë bërë zgjidhje të pasaktë;

Më tej, 46 prej tyre ose 70 % kanë dhënë zgjidhje të pasaktë për trajtën e shumësit të fjalës *student (disa student)* dhe 20 sish ose 30 % kanë bërë zgjidhje të saktë (*disa studentë*);

Për trajtën e gabuar të përemrit të pacaktuar: *githëqka*, 39 prej tyre ose 59 % kanë dhënë zgjidhje të pasaktë dhe 27 sish ose 41 % kanë bërë zgjidhje të saktë;

Për trajtën korrekte të emrit *tenxhere*, 36 të anketuar ose 55 % e kanë vlerësuar saktë, ashtu siç është dhënë në anketë dhe 30 prej tyre ose 45 % kanë bërë zgjidhje të pasaktë;


Për trajtën jogramatikore të shumësit të shquar: *miqët*, 35 të anketuar ose 53 % kanë dhënë zgjidhje të pasaktë dhe 31 sish ose 47 % kanë dhënë trajtën e saktë përkatëse: *miqtë*;

Për trajtën jokorrekte të foljes: *kam ndejtur*, 47 të anketuar ose 71 % kanë dhënë zgjidhje të pasaktë dhe 19 prej tyre ose 29 % kanë bërë zgjidhje të saktë;

Për rastin e fundit të kësaj pike të anketës, që është trajta jokorrekte e shumësit të emrit: *shkopinjë*, 55 prej tyre ose 83 % kanë dhënë zgjidhje të pasaktë dhe vetëm 11 të tillë ose 17 % kanë dhënë trajtën e saktë të shumësit: *shkopinj*.

Në përgjithësi, për këta 10 shembuj, 57 % janë përgjigjur pa saktë dhe 43 % saktë.

Grafikoni 1. Pyetja e 8-të: 10 shembujt individualë



Si përfundim i kësaj pjese, sa u takon këtyre 10 rasteve, mund të konstatohet se disa prej tyre, sidomos trajtat jokorrekte gramatiki: *ai do të punon* (73 % pa saktë), *disa student* (70 % pa saktë), *kam ndejtur* (71 % pa saktë), *shkopinjë* (83 % pa saktë), si dhe paskajorja gege: *me lexu* (77 % pa saktë), duke qenë se, pra, pasqyrojnë përqindje të lartë (mbi 70 %) të pasaktësisë së përgjigjeve të dhëna, sinjalizojnë për nivel tepër të ulët të kompetencës gjuhësore të mësimitdhënësve të anketuar, rrjedhimisht manifestojnë shkallë të ulët të akomodimit të tyre në shqipen standarde. Ndërsa disa raste të tjera, të konsideruara si më të lehta për nga shkalla e vështirësisë, si: *un* dhe *syni*, meqenëse për to ka përqindje të lartë (mbi 70 %) të saktësisë së përgjigjeve të dhëna, pasqyrojnë nivel më të lartë të kompetencës gjuhësore të të anketuarve, rrjedhimisht shkallë më të lartë të akomodimit në shqipen standarde. Por edhe këtu, pikërisht se janë fjalë me denduri shumë të madhe në domenin e shkollës fillore e në

përgjithësi, edhe ajo përqindje e vogël pasaktësie (*un*: 21 % dhe dhe *syni*: 15 %) provon bash të kundërtën, d.m.th. kompetencën e ulët gjuhësore të mësimdhënësve të anketuar. Rastet e tjera, si: *gjihtëqka* (59 % pa saktë), *tenxhere* (45 % pa saktë), *miqët* (53 % pa saktë), që janë aty-aty për sa i takon përqindjes së saktësisë, përkatësisht të pasaktësisë, madje me një tendencë rritjeje të kësaj të fundit, ashtu siç na del edhe rezultati i përgjithshëm (57 % pa saktë), po ashtu flasin për të njëjtën gjë që u tha më lart, pra, në përgjithësi, për kompetencë të ulët gjuhësore të mësimdhënësve të anketuar të ciklit fillor të klasave nga 1 – 5.

3.3. Interpretimi i rezultateve të tekstit me gabime (Pyetja e 9-të)

Teksti i dhënë në anketë ka pasur gjithsej 49 gabime drejtshkrimore që pasqyrojnë katër parimet e drejtshkrimit të shqipes standarde: fonetik, morfologjik, historik-traditional dhe leksiko-semantik.


Rezultatet e anketimit të 66 mësimdhënësve janë klasifikuar në nivele, sipas një modeli personal të vlerësimit nga praktika e punës me studentë. Kjo është bërë me qëllim që matja e të dhënave të anketimit të pasqyrojë sa më saktë gjendjen e kompetencës gjuhësore të mësimdhënësve të anketuar. Kështu, janë veçuar katër nivele të të anketuarve. Ata që kanë bërë:

1. 0 – 3 gabime – kompetencë shumë e mirë;
2. 4 – 6 gabime – kompetencë e mirë;
3. 7 – 9 gabime – kompetencë jo e mirë
4. mbi 10 gabime – kompetencë e dobët.

Dy nivelet e para i kam konsideruar si të pranueshme, që dëshmojnë shkallë të mira të kompetencës gjuhësore, kurse dy të fundit si nivele jo të mira, që dëshmojnë shkallë jo të mirë ose të dobët të kompetencës gjuhësore.

Grafikoni 2.**Rezultatet e korigjimit të tekstit me 49 gabime**

- | | |
|-----------------------|---------------------------------|
| ■ A. 0 - 3 gabime (4) | ■ B. 4 - 6 gabime (9) |
| ■ C. 7 - 9 gabime (8) | ■ D. më shumë se 10 gabime (45) |



Vështruar në përgjithësi, del se vetëm 13 mësimdhënës ose 20 % hyjnë në dy nivelet e para me kompetencë të mirë (9 të anketuar) dhe shumë të mirë gjuhësore (4 të anketuar), ndërsa 53 prej tyre ose 80 % hyjnë në dy nivelet e dyta me kompetencë jo të mirë ose të dobët gjuhësore. Gjithashtu, duhet thënë se nuk ka asnjë mësimdhënës pa gabime fare, sikur që nuk ka as me një dhe me dy gabime.


Nga totali i të anketuarve, 45 mësimdhënës ose 68 % kanë më shumë se 10 gabime, e nga ky numër i fundit prej 45 të anketuarish, 12 mësimdhënës ose 27 % kanë më shumë se 20 gabime, gjë që përbën shkallë shumë të ulët të kompetencës gjuhësore dhe 33 respondentë ose 73% nga 10 – 19 gabime, që po ashtu pasqyrojnë kompetencë të ulët gjuhësore.

3.3.1. Krahasimi shkollë publike – shkollë jopublike

Për të parë më saktë nivelin e kompetencës gjuhësore të mësimdhënësve, një analizë e veçantë u është bërë të dhënave të dala nga dy shkollat e Prishtinës: njëra publike dhe tjetra jopublike (private).

Grafikoni 3. Rezultatet e shkollës publike


- A. 0 - 3 gabime (0)
- B. 4 - 6 gabime (1)
- C. 7 - 9 gabime (5)
- D. më shumë se 10 gabime (6)



Duke marrë sërish si kriter matës ato katër nivelet e përcaktuara më lart, nga 12 të anketuarit e shkollës publike, asnjë (0 %) prej tyre nuk hyn në nivelin e parë nga 0 – 3 gabime; vetëm 1 i anketuar ose 8 % hyjnë në nivelin e dytë nga 4 – 6 gabime; 5 të anketuar ose 42 % hyjnë në nivelin e tretë nga 7 – 9 gabime dhe 6 sish ose 50 % hyjnë në nivelin e katërt me më shumë se 10 gabime të bëra.

Grafikoni 4. Rezultatet e shkollës jopublike

- A. 0 - 3 gabime (3)
- B. 4 - 6 gabime (6)
- C. 7 - 9 gabime (2)
- D. Më shumë se 10 gabime (0)



Ndërkaq, në shkollën jopublike (private), rezultatet për 11 të anketuarit, sa i janë nënshtruar anketimit, dalin kështu: 3 të anketuar ose 27 % hyjnë në nivelin e parë nga 0 – 3 gabime; 6 të anketuar ose 55 % hyjnë në nivelin e dytë nga 4 – 6 gabime; 2 të

anketuar ose 18 % hyjnë në nivelin e tretë nga 7 – 9 gabime, ndërsa të anketuar me më shumë se 10 gabime nuk ka fare nga kjo shkollë fillore jopublike.

Kur i krahasojmë këto të dhëna në mes dy shkollave, del se mësimdhënësit në shkollën jopublike dëshmojnë kompetencë dukshëm më të lartë se mësimdhënësit e shkollës publike. Në tërësi, vetëm 1 i anketuar, që përbën 8 % të totalit të shkollës publike, hyn në nivelin e dytë me kompetencë të mirë, për dallim nga të anketuarit e shkollës jopublike, prej të cilëve 9 sish ose 82 % e totalit të grupit të tyre hyjnë brenda dy niveleve me kompetencë të mirë dhe shumë të mirë gjuhësore. Numri më i madh i të anketuarve të shkollës publike, pra, 11 mësimdhënës, që përbëjnë 92 % të totalit të grupit të tyre, hyjnë në dy nivelet e fundit me kompetencë jo të mirë dhe të dobët gjuhësore, ndërsa vetëm 2 të anketuar, që përbëjnë 18 % të totalit të shkollës jopublike, hyjnë në nivelin e tretë me kompetencë jo të mirë gjuhësore, ndërkaq nga ky grup nuk ka fare mësimdhënës që t'i përkritnin nivelit të katërt me më shumë se 10 gabime. Bazuar në këtë analizë të dhënash, mund të thuhet se mësimdhënësit në shkollën jopublike dëshmojnë kompetencë shumë më të mirë gjuhësore sesa kolegët e tyre të shkollës publike.


Po ashtu, mund të kuptohet që ky rezultat i të anketuarve të shkollës jopublike ngre edhe nivelin e rezultatit të përgjithshëm të anketimit, pasi nga numri i përgjithshëm prej 13 mësimdhënësish ose 20 %, që hyjnë në dy nivelet me kompetencë të mirë dhe shumë të mirë gjuhësore, 9 prej tyre janë nga kjo shkollë jopublike dhe vetëm 4 nga të gjitha shkollat publike të qendrave të tjera ku është realizuar anketimi.

3.3.2. Rasti i paskajores geqe

Vlen të përmenden të dhënat e dala nga kjo anketë për përdorimin e paskajores geqe. Nga katër rastet e dhëna në tekst: *me lexue, me luejt, me dalë, me organizue*, rezultatet e zëvendësimit të tyre qoftë me trajtat e lidhores, qoftë me paskajoren e tipit *për të lexuar* dalin kështu:

Grafikoni 5. Rezultatet e zëvendësimit të paskajores geqe

- A. Nuk e kanë ndryshuar fare (25) ■ B. E kanë ndryshuar në 1 rast (6)
- C. E kanë ndryshuar në 2 raste (4) ■ D. E kanë ndryshuar në 3 raste (4)
- E. E kanë ndryshuar në të 4 rastet (27)



- a. Nuk e kanë ndryshuar fare 25 vetë ose 38 %
- b. E kanë ndryshuar në një rast 6 vetë ose 9 %
- c. E kanë ndryshuar në dy raste 4 vetë ose 6 %
- d. E kanë ndryshuar në tri raste 4 vetë ose 6 %
- e. E kanë ndryshuar në të katër rastet 27 vetë ose 41 %

Në tërësi, sa i përket kësaj të dhëne, rezultatet dalin 50 me 50, që do të thotë se gjysma e mësimdhënësve tipin e paskajores geqe e kanë përshtatur me trajtat e shqipes standarde (me lidhoren ose paskajoren e standardit) dhe gjysma tjetër del se paskajoren geqe e kanë konsideruar formë foljore të shqipes standarde.

4. Përfundime

Siç u tha më lart, shkolla përbën një nga domenet më të rëndësishme të përdorimit publik të shqipes dhe në të vërtetë gjuha në shkollë parakupton para së gjithash përdorim të varietetit standard të saj, mirëpo, siç është provuar përmes këtij hulumtimi, janë gjetur shembuj që provojnë raste të përdorimit të varieteteve të tjera gjuhësore të shqipes, të cilat në gjuhën e mësimdhënësve bashkekzistojnë me shqipen standarde.

Prandaj, mund të thuhet se edhe në shkollë, sipas rezultateve të hulumtimit, del se kemi situatën diglosike të përdorimit të varieteteve të ndryshme: shqipe standarde, gegërishte letrare, gegërishte dialektore (lokale), të cilat bashkekzistojnë varësisht nga

situatat e komunikimit formal e joformal që mund të krijohen në shkollë, ani pse në këtë domen të komunikimit formal synohet të përdoret varieteti *high*. Kjo dukuri e bashkekzistencës dhe e përzierjes së kodeve varësisht nga situatat e komunikimit, që mund të shihet si pjesë përbërëse e një *continuumi* gjuhësor brenda të njëjtës gjuhë, vihet re jo vetëm sa i përket asaj çfarë të anketuarit deklarojnë, por edhe me rastin e hetimit të elementeve dhe formave dialektore, si, p.sh., përdorimi i paskajores dhe i së ardhmes geqe. Përzierjet e tilla gjuhësore të gjuhës standarde me varietet jostandarde janë shpesh manifestime të ndryshimit të stilit të folësit (style shifting), nxitur nga nevoja për t’u përshtatur audiencës në shkollë me të cilën është i lidhur komunikimi, sipas asaj që A. Bell-i (1984, 1991) e quan “audience-design”, pra rregullim i gjuhës sipas audiencës.

Kompetenca gjuhësore e mësimeve, e hetuar në mënyrë sasiore dhe cilësore, ka dalë e një niveli të ulët gjuhësor. Marrë në përgjithësi, nga ky hulumtim dalin këto përfundime:

- Sa i përket sasisë dhe dendurisë së përdorimit të shqipes standarde, del se mësimeve i përdorin atë gjithmonë në bashkëbisedim me nxënësit në çdo mjedis shkollor, për tema mësimore e tema të lira në çdo orë të cilësdo lëndë mësimore;
- Megjithatë, u pa se pjesa më e madhe, për t’u kuptuar më mirë, u flasin nxënësit *berë në standard e berë në dialekt sipas nevojës*;
- Sa i përket shkallës së vështirësisë/lehtësisë së përdorimit, shqipja standarde është një varietet i lehtë për t’u përdorur, sikur shprehen ata;
- Megjithatë, rezultatet e hulumtimit e dëshmojnë të kundërtën: përdorim edhe e varieteteve të tjera të shqipes dhe performancë e dobët gjuhësore;
- Sa i përket cilësisë së përdorimit, me gjithë deklaratimet e tyre se e përdorin më shumë shqipen standarde, rezultatet japin të kuptojmë se cilësisht shqipja standarde lë shumë për të dëshiruar;
- Niveli i kompetencës gjuhësore dallon dukshëm ndërmjet mësimeve të shkollës publike dhe jopublike, edhe për shkak të përzgjedhjes në punë dhe nivelit të kualifikimit të mësimeve;
- Shkalla e ulët e kompetencës gjuhësore del edhe si pasojë e arsimimit të pamjaftueshëm të mësimeve. Shumica prej tyre (44) janë me shkollë të lartë pedagogjike, 12 me bachelor dhe vetëm 8 prej tyre janë të diplomuar në nivelin master.

Referencat

- Bajçinca, Isa (2006). Shqipja standarde dhe probleme rreth saj. (Ligjëratë me mësuesit e shqipes në shtetet skandinave, 11-12 maj 2006, Landskrona, Suedi). Marrë në: <http://modersmal.skolverket.se/albanska/index.php/component/content/article?id=78> (Qasja më 19.11.2015).
- Beci, Bahri (2007). Probleme të mësimit të gjuhës amtare në shkollë. (Ligjëratë me mësuesit e shqipes në shtetet skandinave, 15-16 maj 2007, Landskrona, Suedi). Marrë në: <http://modersmal.skolverket.se/albanska/index.php/36-konferenca2/77-prof-dr-bahri-beci-qprobleme-tal-malsimit-tal-gjuhals-amtare-nal-shkollalq> (Qasja e fundit më 19.11.2015).
- Bell, Allan (1997). *Language Style as Audience Design*, Sociolinguistics – A Reader. Edited by Nikolas Coupland and Adam Jaworski, St. Martin's Press, New York.
- Chomsky, Noam (2008). *Gjuha dhe problemet e njohjes*. Toena, Tiranë.
- Draçini, Rrezarta (2013). *Përftimi i shqipes përmes dialektit dhe standardit*. Fiorentia, Shkodër.
- Fishman, Joshua A. (1978). *Sociologjia jezika*. Svijetlost, Sarajevo.
- Hudson, Richard A. (2002). *Sociolinguistika*. (përktheu: Mariana Ymeri). Dituria, Tiranë.
- Islamaj, Shefkije. (2004). *Gjuha ligjërimi dhe fjala*. Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë.
- Ismajli, Rexhep (1991). *Gjuhë dhe etni*. Rilindja, Prishtinë.
- Ismajli, Rexhep (2005a). *Gjuhë standarde dhe histori identitetesh*. ASHSh, Tiranë.
- Ismajli, Rexhep (2005b). *Për zhvillimet në fushën e gjuhës standarde*. (Ligjëratë e mbajtur në Konferencën e mësuesve të gjuhës amtare shqipe, 10 – 11 mars 2005, Landskrona, Suedi). Marrë në: <http://modersmal.skolverket.se/albanska/index.php/49-ligjeresitane/80-akademik-rexhep-ismajli-palr-zhvillimet-nal-fushaln-e-gjuhals-standarde> (Qasja e fundit më 5. 12. 2015).
- Këshilli Ndërkademi për Gjuhën Shqipe (2014). *U mbajt në Tiranë mbledhja e Këshillit Ndërkademi për Gjuhën Shqipe*. (Bashkëkryetarë, akad. Jani Thomai dhe akad. Rexhep Ismajli). Mbajtur më 20 qershor 2014 në Tiranë. Marrë në: <http://www.ashak.org/?cid=1,2,471> (Qasja e fundit më 6. 12. 2015).
- Lloshi, Xhevat (2011). *Shqipja, gjuhë e hapur dhe dinamike*. Onufri, Tiranë.
- Munishi, Shkumbin (2013). *Probleme të shqipes standarde në Kosovë*. ZeroPrint, Prishtinë.

- Munishi, Shkumbin (2015). Shqipja në epokën e globalizimit. ZeroPrint, Prishtinë.
- Paçarizi, Rrahman (2011). Shqipja standarde në parametrat psikolinguistikë. Kosova Pen Center, Prishtinë.
- Trudgill, Peter (2000). Sociolinguistics – An Introduction to language and Society, Fourth Edition, First Published in Pelican Books 1974, Penguin Books.

Kadire BINAJ

DEIKSI VETOR NË GJUHËN SHQIPE

0. Hyrje

Në këtë punim do të analizohen format dhe mënyrat e shprehjes së deiksit vetor në gjuhën shqipe. Interpretimi i shprehjeve deiktike varet nga karakteristikat e caktuara të situatës së shprehjes apo aktit të të shprehurit. Çdo shprehje gjuhësore sendërtohet në një vend dhe në një kohë të caktuar. Ajo kryhet nga një person i caktuar (folësi) dhe i drejtohet një personi tjetër (të adresuarit). Shprehjet e tilla që kanë referencë kryesore pjesëmarrësit në komunikim, folësin dhe të adresuarin, hyjnë në grupin e deiksit vetor. Pra, përmes deiksit vetor identifikohet roli i pjesëmarrësve në komunikim, si adresues apo si i adresuar. Adresuesi dhe i adresuari gjuhësisht shprehen përmes kategorisë së vetës. Veta e parë i referohet folësit (apo folësve), ndërsa veta e dytë i referohet të adresuarit apo të adresuarve. Ndryshe nga veta e parë dhe e dyta, veta e tretë nuk është kategori deiktike sepse nuk u referohet pjesëmarrësve në komunikim, por atyre për të cilët flitet e që nuk janë të pranishëm në situatën e komunikimit.

Qëllimi i këtij hulumtimi është të përshkruajë dhe të analizojë deiksin vetor në gjuhën shqipe. Për këtë arsye kemi përzgjedhur një korpus i cili përbëhet nga një intervistë televizive dhe nga skenari i pjesës së parë të filmi *Zoti i unazave*. Përmes këtij hulumtimi do të identifikohen shenjuesit karakteristikë të deiksit vetor në gjuhën shqipe dhe rastet e përdorimit të tyre në situata të caktuara. Gjithashtu, do të analizohen rastet kur shenjues të njëjtë formalë mund të shërbejnë si elemente deiktike ose si anafora. Përcaktimi i tyre në njërin grup apo në tjetrin varet nga referenca e tyre kontekstuale, përkatësisht kontekstuale. Por, shpesh ndodh që një shenjues i caktuar të luajë rol të dyfishtë, si anaforë - duke iu referuar një elementi që është përmendur më herët në tekst (ose më vonë, në rastin e kataforave), dhe si deiks vetor- duke shenjuar pjesëmarrës-in/-it në situatën e komunikimit. Duke i analizuar mundësitë e ndryshme të realizimit të deiksit vetor, do të shihet se sa janë të shpeshta shprehjet deiktike në tekstet e përzgjedhura dhe cili është roli i tyre. Gjithashtu do të shihet se sa mund të ndikojnë ato apo edhe sa mund ta pasqyrojnë raportin ndërmjet pjesëmarrësve në komunikim.

1. Sfondi teorik

Deiksi vetor, krahas atij kohor dhe vendor, përbën tri kategoritë tradicionale deiktike. Krahas këtyre tri llojeve, studiues si Fillmore (1975: 39- 40), Levinson (1983: 62), Lyons (2001: 259-264) etj., dallojnë edhe deiksin tekstual apo të diskursit dhe deiksin social. Deiksi social ka një lidhje shumë të ngushtë me deiksin vetor. Këtë raport të ngushtë ndërmjet tyre do ta shohim edhe gjatë analizës së shembujve nga korpusi.

Charles Fillmore (1975: 38), thotë se disa shprehje gjuhësore mund të interpretohen në mënyrë të drejtë vetëm nëse fjalitë në të cilat ato bëjnë pjesë, janë të inkuadruara në një kontekst social i cili është i përcaktuar në atë mënyrë që të identifikojë pjesëmarrësit në aktin e komunikimit, vendodhjen e pjesëmarrësve të komunikimit në hapësirë dhe kohën kur ndodh ky akt komunikimi. Këto aspekte gjuhësore që kërkojnë këtë lloj kontekstualizimi për t'u interpretuar në mënyrë korrekte, Fillmore i quan deiktike. Edhe sipas Lesley Stirling-ut dhe Rodney Huddleston-it (2002: 1451), referenca e shprehjeve të caktuara varet apo përcaktohet nga karakteristikat e caktuara të situatës së shprehjes apo aktit të të shprehurit, siç janë: koha, vendi dhe pjesëmarrësit në komunikim, në rolin e folësit dhe në rolin e të adresuarit. Dukuria e tillë kur shprehjet gjuhësore interpretohen duke iu referuar karakteristikave kontekstuale të situatës së shprehjes, njihet si deiks dhe shprehjet e tilla njihen si shprehje deiktike.

Rëndësia e informatave deiktike për interpretimin e shprehjeve të caktuara vërehet sidomos në ato raste kur të dhënat deiktike mungojnë dhe si rrjedhojë nuk mund t'i interpretojmë ato shprehje, thotë Fillmore (1975: 38). P.sh.: si do të interpretohej kjo shprehje: *Nuk po flas me ty, por me ty, dhe nuk po flas për këtë, por për atë.*, nëse gjatë kësaj situatë të të shprehurit nuk ka drita dhe është errësirë dhe janë disa njerëz të pranishëm? Si do të dihej se kujt i drejtohet folësi, (përderisa në një situatë të tillë referenca përcillet edhe me gjeste) apo kush është i adresuari, i cili shenjohet nga veta e dytë e përemrit vetor (ti). Dhe pastaj, dëftorët *këtë* dhe *atë*, a janë referencë për ndonjë person të pranishëm në situatën e komunikimit apo janë objekte për të cilat flitet. Situata të tilla e shfaqin rëndësinë e deiktikëve dhe rëndësinë e njohjes së kontekstit të situatës së komunikimit.

Çdo shprehje gjuhësore sendërtohet në një vend dhe në një kohë të caktuar. Ajo kryhet nga një person i caktuar (folësi) dhe i drejtohet një personi tjetër (të adresuarit). Shprehjet e tilla që kanë reference kryesore pjesëmarrësit në komunikim, folësin dhe të adresuarin, hyjnë në grupin e **deiksit vetor**. Pra, përmes deiksit vetor identifikohet roli i pjesëmarrësve në komunikim, si adresues apo si i adresuar. Përveç

adresuesit dhe të adresuarit, Charles Fillmore (1975: 40) e trajton si kategori të tretë të deiksit vetor edhe audiencën e synuar me të cilën nënkupton njerëzit që mund të konsiderohen si pjesë e grupit komunikues, por që nuk janë as në rolin e folësit e as të të adresuarit.

Adresuesi dhe i adresuari gjuhësisht shprehen përmes kategorisë së vetës. Veta e parë i referohet folësit (apo folësve), ndërsa veta e dytë i referohet të adresuarit (apo të adresuarve). Ndryshe nga veta e parë dhe e dyta, veta e tretë nuk është kategori deiktike sepse nuk u referohet pjesëmarrësve në komunikim, por atyre për të cilët flitet e që nuk janë të pranishëm në situatën e komunikimit. Sipas Lyonsit (2001:262), veta e tretë, njëjës apo shumës, në krahasim me të parën dhe të dytën, jo vetëm që mungon në situatën e komunikimit, por edhe mund të mbetet e paidentifikuar.

Për raportin ndërmjet tri vetave, Benveniste (te Tahiri, 2006: 89) thotë se kuptimi i vetës i takon vetëm vetës së parë dhe të dytë: aspekti pragmatik i dallon ato nga fjalët e tjera: ‘unë’ dhe ‘ti’ janë prodhime të realitetit të ligjërimit dhe mund të identifikohen vetëm nga ligjërimi që i përmban ato, përderisa *ai/ajo* gjenden jashtë ligjërimit, është si një ‘jo-vetë’ për të cilën flitet. Raportin ndërmjet vetës së tretë në krahasim me dy të parat, David Kaplan (te Sarah Zobel, 2014: 1) e sheh nga një këndvështrim tjetër. Ai thotë se veta e tretë është më e lirë në raport me referentët e mundshëm të cilëve u referohet.

1. A to B: I like sushi – A likes shushi.
2. A to B: You like sushi – B likes sushi.
3. A to B: He/ she likes sushi- X (whoever A intends to refer to) likes sushi.

Skema sipas David Kaplan (po aty).

Pasi që veta është shenjuesi tipik i deiksit vetor, pjesëmarrësit në komunikim mund të identifikohen përmes përemrave vetorë, përemrave pronorë (kur hyjnë në raport me folësin apo të adresuarin) dhe përmes mbaresave vetore të foljeve. Gjithashtu, shenjues të tjerë që i referohen të adresuarit janë emrat në funksionin e thirrorit dhe titujt e caktuar në këtë funksion, duke shenjuar njëkohësisht edhe deiksin social.

Shprehjet e caktuara interpretohen duke u nisur prej një pike bazike apo fillestare (ground zero, origo) e cila ndryshe quhet qendër deiktike. Qendra deiktike zakonisht është e orientuar drejt folësit, domethënë interpretimi shihet prej perspektivës së folësit. Shprehjet deiktike, sipas Levinsonit (1983: 64), zakonisht organizohen në një mënyrë egocentrike. Ai thotë se personi apo veta kryesore i referohet folësit; koha së cilës i referohemi është koha në të cilën folësi flet apo vepron; qendra vendore është vendi në të cilin ndodh akti i komunikimit; qendra e

diskursit është pika në të cilën folësi ndodhet; dhe qendra sociale është statusi social i folësit në raport me të adresuarin.

Egocentriciteti duket edhe me shkëmbimin e roleve në komunikim. Sapo roli i folësit, në një bisedë, kalon nga një pjesëmarrës te tjetri, ndërron edhe qendra e sistemit deiktik (ku *unë* përdoret nga çdo folës për t'iu referuar vetvetes, kurse *ti* për të shënuar të adresuarin). Bienveniste (1971: 226), duke përshkruar këtë raport thotë se *unë* ka referencë vetëm momentale, pasi që *unë* mund të thotë çdokush dhe se realiteti të cilit i referohet kjo referencë, është realiteti i diskursit dhe si e tillë ajo mund të identifikohet vetëm brenda diskursit në të cilin përdoret. Folësi është, si të thuash qendra e situatës në të cilën bëhet shprehja, thotë Lyons (2001: 259).

P.sh: 1. *Nuk mund të shkoj në qytet, sepse është shumë larg.* – larg, interpretohet si larg folësit (unë)

2. *Këtë libër e kam filluar para pesë vjetësh.* – para pesë vjetësh, llogaritet distanca kohore prej kohës kur libri kishte filluar të shkruhej deri në kohën kur është shkruar kjo fjali, e që është koha e folësit, do të thotë koha kur folësi shkruan. Koha e të adresuarit, domethënë koha kur lexohet ky mesazh, është e parëndësishme në këtë rast.

Por, qendra deiktike mund të ndryshojë prej një folësi te tjetri në bashkëbisedim:

A: *Mua po më pëlqen kjo këmbishë.* B. *Mua më shumë po më pëlqen kjo këmbishë.*

Kjo, te fjalia e parë interpretohet në raport me folësin A dhe afërsinë me të, ndërsa *kjo* të fjalia e dytë, interpretohet në raport me folësin B dhe afërsinë me të. *Kjo-ja* e A-së për B-është *ajo*, dhe anasjelltas.

Por, përveç rasteve kur qendra deiktike fokusohet te folësi, ka raste kur qendra deiktike është e orientuar drejt të adresuarit: p.sh. në një shënim: *Tani laji duart.* (si porosi e shkruar) – *tani* nuk nënkupton kohën kur është shkruar mesazhi, por kohën kur lexohet, e që është koha kur i adresuari e sheh mesazhin.

2. Analiza e deiksit vektor në gjuhën shqipe

Analizën e deiksit vektor ne e kemi bërë në dy tekste të ndryshme: një intervistë në emisionin *Rubikon* të Adriatik Kelmendit, në të cilin ka qenë i ftuar Albin Kurti; dhe teksti tjetër është skenari i filmit *Zoti i unazave*. Intervista e mbajtur më 19 dhe 20 nëntor 2014 (ishte e realizuar në dy pjesë), përmban gjithsej 14.796 fjalë. Nga ky numër i përgjithshëm i fjalëve, 917 fjalë apo 6.19% shenjojnë deiksin vektor. Ndërsa në skenarin e pjesës së parë të filmit *Zoti i unazave*, i cili përbëhet nga 11.371 fjalë, 1404 apo 12.34% prej tyre janë shprehje deiktike vetore. Në të dy tekstet kemi të bëjmë me

situata të gjuhës së folur, edhe pse ne i kemi marrë në formë të shkruar. Në intervistë janë të pranishëm vetëm dy bashkëbisedues, ndërsa te skenari i filmit pjesëmarrësit në situatat e komunikimit janë në numër më të madh dhe kjo krijon edhe nevojën më të madhe për t'u përcaktuar më me saktësi rolet e pjesëmarrësve në komunikim.

Teksti i parë, intervista, përgjithësisht nuk e shfaq shkëmbimin e roleve nga adresues në të adresuar, pasi që edhe kur gazetari është folësi, fjalitë janë të drejtuara/orientuara nga i adresuesi, në këtë rast i intervistuari. Kështu që në raste të tilla nuk është adresuesi ai që e përbën qendrën deiktike, por është i adresuari.

Ndërsa në skenarin e filmit, ky rol ndryshon. Në bashkëbisedimin e zhvilluar aty, nëse folësi në një situatë është A-ja dhe marrësi është B-ja, ky rol përmbysset në rastin e replikës duke ndryshuar kështu edhe qendra deiktike. P.sh.:

A: - *E kalova testin. Do të tretem tani, do të ik.* (veta e parë njëjësi, folësi 1)

B: - *Nuk mund ta bëj këtë i vetëm.* (veta e parë njëjës, folësi 2)

Unë e A-së është *ti* e B-së, dhe *unë* e B-së është *ti* e A-së.

2.1. Deiksi vetor në intervistë

2.1.1. Veta e parë

Njëjës

Por, kur unë insistova nja dy tri herë, atëherë e panë se askush nuk e thotë një datë të tillë nëse njëmend nuk e ka dhe në këtë rast më kishte rastisur mua.

Natyrisht se zemërimi i tyre vazhdoi, por ky ishte ai mini-episodi i parë, i cili e bëri të rëndësishme datëlindjen time.

Në të dy fjalitë e mësipërme, veta e parë i referohet drejtpërdrejt folësit në situatën e komunikimit. Në fjalinë e parë folësi është i shprehur përmes përemrit vetor (*unë, mua, më*) dhe mbaresave vetore të foljes (*insistova*), ndërsa në fjalinë e dytë folësi identifikohet përmes përemrit pronor (*time*). Qendra deiktike është e orientuar te folësi, sepse të gjitha të dhënat interpretohen duke u nisur nga perspektiva e folësit.

Por, në shembullin e poshtëshënuar, veta e parë njëjës nuk shënon folësin në situatën e komunikimit (i cili është Albin Kurti), por fjalët e një vete të tretë, në një kohë të mëhershme:

...Ejup Statovci ... dhe ka qenë një nga madhështitë e tij, i cili ishte gjysbi ynë dhe jo prindi dhe thotë se unë dal i fundit dhe jo të dal para dikujt tjetër.

Këtu kemi ngatërrimin e ligjëratës së drejtë me të zhdrejtën. Pas foljes *thotë* është lidhëza *se*, pas së cilës do të pritej që folësi të përdorte ligjëratën e zhdrejtë, përkatësisht të bënte zhvendosjen në vetë dhe në kohë, por në rastin konkret kjo nuk

ndodh. Folësi i citon drejtpërdrejt fjalët siç i ka thënë një vetë e tretë (burimi) në një kohë të mëhershme, por duke mos i përdorur elementet strukturore tipike të ligjëratës së drejtë.

Veta e parë shumës - Ne

Veta e parë shumës i referohet një grupi prej dy apo më shumë vetash ku bën pjesë edhe folësi. Pra është si *unë dhe një apo shumë persona të tjerë*. Te personat e tjerë mund të përfshihet i adresuari ose jo. Sipas rrethanës nëse i adresuari përfshihet në vetën e parë shumës ose jo, dallohen dy përdorime të vetës së parë shumës: përdorimi *përfshirës (inclusive)* dhe *jo-përfshirës (exclusive)* (Lyons, 2001: 261), (Huddleston, 2002: 1465) etj.

- a. *Aryeja pse **ne vazhdonim të punonim** edhe pse ata kishin shkuar Rambouillet, ishte për shkak se pikërisht Thaçi i thoshte bacës Adem se nuk do ta nënshkruajë.*

Veta e parë shumës në këtë rast përfshin folësin dhe të tjerët. Ajo është jo-përfshirëse në raport me dëgjuesin (të adresuarin).

- b. *E para është ajo e 2 korrikut 1990 si politikë për rezistencë, për shkak të këtij pushteti që **kishim** pas pavarësisë, republika e dytë doli si republikë për shitje, qoftë për privatizim, qoftë për negociata dhe tash po **na** nevojitet një republikë për zhvillim.*

Në këtë rast, veta e parë, përveç që përfshin folësin dhe të tjerët, përfshin gjithashtu edhe dëgjuesin (të adresuarin). Domethënë në këtë rast kemi: *unë + ti+ të tjerët*.

- c. *Ju e përsëritni se nuk duhet të bëni fare parti politike për disa pasoja, por për këtë **do të flasim** më vonë.*

Në këtë rast *ne* përfshin folësin dhe dëgjuesin (të adresuarin). Por këtu nuk hyjnë edhe *të tjerët*, pasi që në një intervistë ku është i ftuar vetëm një person, ai mund të flasë vetëm me të, dhe jo edhe me të tjerët. Ndërsa në rastin: ***Mos të barrojmë** se gjatë kohës sa ju nuk donit të dilnit në zgjedhje, thosht se gjithë ata që nuk kanë dalë në zgjedhje mund të jenë përkrabësit tuaj.*, veta e parë, përveç folësit dhe dëgjuesit, mund t'i përfshijë edhe *të tjerët*, duke i ftuar kështu edhe ata që të jenë *dëshmitarë* apo *një lloj mbështetjeje* për këtë që thuhet nga folësi.

Veta e parë shumës shpesh mund të interpretohet në dy mënyra njëkohësisht: si deiktike dhe si anaforike. Dallimi mes deiksit dhe anaforës është se deiksi i referohet pjesëmarrësit në komunikim, në rolin e folësit apo të adresuesit, ndërsa anaphora i

referohet paraprijësit të tij të përmendur më herët në tekst (anaforë) ose edhe më vonë, si kataforë (Huddleston dhe Stirling (2002: 1455).

Ç. *U takuat atëherë me Ibrahim Rugovën? Po, u patëm takuar dy here.. – u patëm takuar (ne)* përfshin një grup prej dy personash, folësi dhe Ibrahim Rugova, dhe mund të interpretohet edhe si deiktike, duke përfshirë folësin në këtë grup (*unë*) dhe si anaforike, duke iu referuar një paraprijësi që është përmendur më herët në tekst-*Ibrahim Rugova*.

Ndërsa rasti në vijim mund të interpretohet njëkohësisht edhe si deiks e edhe si kataforë: *Mirë jena. Arën po e punoj me fëmijët.* – ku folja *jena* (jemi), veta e parë shumë interpretohet si deiktike pasi që përfshihet edhe folësi në atë grup, dhe si kataforike, pasi që u referohet *fëmijëve*.

2.2. Veta e dytë

2.2.1. Veta e dytë njëjës

Veta e dytë njëjës i referohet apo shenjon të adresuarin në situatën e komunikimit.

... si e **arrite** këtë vendim?

Veta e dytë njëjës i drejtohet marrësit, apo të adresuarit. Në këtë tekst, ky është rasti i vetëm kur gazetari i drejtohet mysafirit me *ti*. Duke qenë se në të gjitha rastet e tjera ai përdor përemrin *ju*, për t'iu drejtuar mysafirit, duke bërë kështu që biseda të jetë më formale dhe duke shprehur në të njëjtën kohë respektin për mysafirin, nuk besojmë se me një rast të vetëm ka dashur të ndërrojë qëndrim, por mund të ketë qenë thjesht një lëshim i rastit.

Në anën tjetër, shpesh nga mysafiri përdoret **veta e dytë njëjës joreferenciale**, duke shënuar kështu një referencë të përgjithshme, dhe jo një marrës të vetëm.

... *njerëzit që kanë qenë aty e dinë se prej torturave nuk të habet buka, port të pibet uji dhe ne nuk kishim ujë aty.* – **të (ty, të)**, nuk është referencë për një marrës të vetëm, në këtë rast për gazetarin që është i pranishëm në bashkëbisedim, por është referencë e përgjithshme për të gjithë ata që do të ndodheshin në një situatë të atillë.

2.2.2. Veta e dytë shumës

Veta e dytë shumës shenjon një grup vetash (dy a më shumë) me të cilët bisedojmë, bashkëbiseduesit, thuhet në Gramatikën I (2002: 220). Por, jo gjithmonë të gjithë personat të cilëve mund t'u referohemi si *ju* janë të pranishëm në situatën e komunikimit. Kështu, në këtë aspekt, Lyons (2002: 261) dallon edhe te veta e dytë

shumës përdorimin *përfshirës* dhe *jopërfshirës* të përemrit. Në përdorimin *përfshirës* ai i fut dëgjuesit që janë të pranishëm, ndërsa përemri *ju* thotë se ka përdorim *jopërfshirës* në qoftë se lidhet me një ose shumë dëgjues, ose me një e shumë persona të tjerë. Meqë në tekstin që po e analizojmë, i ftuar është vetëm një mysafir, përdorim *përfshirës* të përemrit shumë nuk mund të ketë. Por, ne kemi hasur dy raste të përdorimit të kësaj vete: si *jopërfshirëse* dhe si formë respekti apo formaliteti:


1. *I fushnin edhe ata në dhoma me ju?* (+ i adresuari, + të tjerët)
2. *Zakonisht, bisedat i nisim nga aktivitetet, por me ju zotëri Kurti, dua ta nis nga data juaj e lindjes...* (+ i adresuari, - të tjerët)

Në rastin e parë, *ju* përdoret për t'iu referuar jo vetëm një dëgjuesi, por një dëgjuesi të pranishëm dhe të tjerëve që në situatën për të cilën flitet kanë qenë bashkë. Në këtë rast, *ju* është referencë për z. Kurti, por edhe për të burgosurit e tjerë shqiptarë, ndërsa në fjalinë e dytë, përemri *ju* i referohet vetëm z. Kurti, i cili është pjesëmarrës në bashkëbisedim. *Ju* në rastin e dytë nuk lidhet më shumë me rolin e pjesëmarrësve në situatën gjuhësore, por me statusin shoqëror. Përmes kësaj reference, folësi dëshiron ta shprehë raportin shoqëror me marrësin, atë të respektit.

Shprehjet gjuhësore përmes të cilave mund të shprehet raporti shoqëror ndërmjet bashkëbiseduesve hyjnë në kuadër të deiksit social. Sipas Levinsonit (2006: 119), ky raport mund të shprehet si referencë direkte apo e tërthortë e statusit shoqëror të pjesëmarrësve në komunikim. L. Rugova (2014: 5), duke iu referuar ndarjes që bën Levinsoni, thotë se në gjuhën shqipe mund të dallohen dy lloje të deiksit social: deiksi social absolut dhe ai relativ. I pari u referohet disa karakteristikave sociale të referentit, të cilat janë të tilla pavarësisht raportit ndërmjet folësve, mund të jenë thjesht një referencë e një statusi absolut social të të adresuarit, si z. Kryetar etj., ndërsa deiksi social relativ ka të bëjë me raportin social ndërmjet folësit dhe të adresuarit, audiencës, referentit etj., në një kontekst përtejgjuhësor (extralinguistic context). Në këta terma, në rastin e lartëshënuar, kemi të bëjmë me një rast të deiksit social relativ. Gjatë gjithë bisedës folësi i drejtohet të adresuarit me *ju* duke shprehur kështu respektin ndaj tij dhe njëkohësisht formalitetin e situatës. Vetëm një herë, folësi i drejtohet të adresuarit me z. *Kurti*, e cila gjithashtu përbën një shprehje të deiksit social relativ, pasi që duke zgjedhur këtë mënyrë të të drejtuarit ndaj bashkëbiseduesit (dhe jo ndonjë tjetër, si p.sh.: Albin), folësi përcakton edhe raportin social ndërmjet tyre dhe formalitetin e situatës.

Denduria e përdorimit të deiksit vetor në intervistë

Veta I.nj. 35.98%; v.I.nj.p.pronor 1.85%; v.I.sh. inkluzive 1.52%; v.I.sh. unë + të tjerët 0.54%; v.I.sh. unë+ti+të tjerët 1.52%; v.I.sh. ekskluzive 35.98%, v.I.sh. p. pronor 2.18%, *ne* për një folës 0.54%; v. II shumës, ju, mirësjellje 10.79 %; Ju, shumës (edhe si anaforike) 3.27%; v. II sh. përemër pronor 0.76%; v.II sh. p. pronor, respekt 0.43%; v.II nj. 1.74%; v.II. nj. joreferenciale 2.72% (gjithsej 917 herë).



3. Deiksi vetor te skenari i filmit “Zoti i unazave”

Në këtë tekst shprehjet deiktike vetore përbëjnë 12.34% të tekstit. Rastet që dalin të njëjta si te intervista nuk do t’i trajtojmë, por do të ndalemi vetëm te ato që nuk i kemi hasur në intervistë.

Ndryshe nga intervista, te skenari i filmit ka shumë raste kur referenca vetore ndryshon varësisht prej rolit të pjesëmarrësit në situatën e komunikimit. Këtu dëshmohet shumë shpesh ajo që Bienveniste (1971: 226), e quante referencë momentale të vetës së parë *unë*, p.sh.:

- a. *Ku do të shkoni kaq shpejt? Nuk po kuptoj!*
- b. *As unë nuk po kuptoj! Mbaje fshehtë! Ruaje!*

Siç shihet nga shembujt, kemi të bëjmë me dy folës të ndryshëm. Një folës në A, dhe një tjetër në B. Unë e A-së është ti e B-së, ndërsa Unë e B-së është ti e A-së.

Në të dy rastet qendra deiktike është e orientuar nga folësi, por me shkëmbimin e rolit folës, shkëmbëhet edhe qendra deiktike rrjedhimisht.

Edhe deiksi i shprehur përmes përemrit pronor është karakteristikë mjaft e shpeshtë e këtij teksti.

P.sh.: *elipsë (ti je) E çmuara ime!* – (duke mbajtur unazën në dorë)

Përemri *ime* ka funksion deiktik në këtë rast, pasi që unaza së cilës i drejtohet folësi duke e subjektivizuar, shërben si referencë në kuptimin e të adresuarit (v. II) dhe është prezente në situatën e komunikimit. Ajo gjendet afër folësit, dhe përmes përemrit *ime* vihet në pah edhe roli i folësit në situatën e komunikimit.

Veta e dytë shumës përfshirëse (inclusive)

Tërbiquni! Rrini afër Gandalfit! – në intervistën e analizuar nuk kemi hasur në asnjë rast në vetën e dytë shumës përfshirëse. Por, në skenarin e filmit, rastet e tilla janë mjaft të shpeshta, si në shembullin e lartshënuar. Në këtë rast, veta e dytë shumës ka përdorim përfshirës sepse u referohet të adresuarve që janë të pranishëm në situatën e komunikimit. Domethënë, këtu *ju* nuk u referohet: *ti + të tjerët* që nuk janë të pranishëm në situatën e komunikimit, por *ju* u referohet të gjithë të adresuarve që janë të pranishëm në situatën e komunikimit, pa përfshirë në këtë rast edhe *të tjerë* si audiencë e synuar.

Referenca përmes thirrorëve

Me emra

Frodo, shih kush është në derël – emri i përveçëm shërben si mënyrë e të drejtuarit ndaj të adresuarit. Përmes kësaj mënyre të të drejtuarit vërehet edhe raporti social ndërmjet folësit dhe të adresuarit. Folësi ka një raport mjaft të afërt me të adresuarin, pasi që i drejtohet atij me emër të parë. Kjo fjali meqë është e orientuar nga i adresuari, qendër deiktike ka të adresuarin dhe interpretohet duke u nisur nga perspektiva e tij kohore dhe hapësinore.

Raporti relativ social ndërmjet folësit dhe të adresuarit shihet edhe në këtë rast të bashkëbisedimit:

A. Natën e mirë, **Sem!**


B. Natën e mirë, **zoti Frodo!**

Në rastin e parë folësi i drejtohet të adresuarit me emër të parë, duke shprehur kështu raportin më të afërt social me të, ose edhe dominancën sociale ndaj tij, ndërsa në rastin e dytë, kur rolet e pjesëmarrësve ndryshojnë nga *unë* në *ti* dhe anasjelltas, e

shohim se folësi i B-së/ përkatësisht i adresuari i A-së i drejtohet të adresuarit të B-së, përkatësisht folësit të A-së në formën *zoti Frodo*, duke zgjedhur kështu formën formale apo me nderim për t’iu drejtuar. Mënyra se si i drejtohen pjesëmarrësit në komunikim njëri-tjetrit në këtë rast, tregon edhe raportin social ndërmjet tyre. Fillmore (1975: 13) thotë se në raste të tilla, si te i adresuari i B-së, përderisa ai e pranon këtë formë të të drejtuarit, domethënë se ai e pranon statusin dominant ndaj folësit B, dhe anasjelltas, folësi B e merr si të mirëqenë dominancën sociale të folësit A.

Denduria e përdorimit të deiksit vetor në skenarin e filmit “Zoti i unazave”

Teksti i ka gjithsej 11.371 fjalë. 1404 fjalë kanë funksionin e deiksit vetor, apo 12.34%. V. I. nj. 24.85%, v.I.nj. p. pronor 3.27%; v. I.sh. inkluzive 8.47%; v.I. sh. ekskluzive 0.78%; v.I.sh. p.pronor 1.49%; v.II.nj. 28.70%; v.II.nj. joreferenciale 1.28%; v.II.sh. 7.68%; v.II.sh. shprehje respekti 0.78%; v.II.sh. p.pronor 0.49%; thirrros: emër 12.10%; tituj të caktuar 5.05%.



4. Përfundime

Në këtë punim është përshkruar dhe analizuar kategoria e deiksit vetor në korpusin që përbëhet nga një intervistë televizive dhe nga pjesa e parë e skenarit të filmit “Zoti i unazave”. Përmes deiksit vetor identifikohet roli i pjesëmarrësve në

komunikim, si adresues apo si i adresuar. Adresuesi dhe i adresuari gjuhësisht shprehen përmes kategorisë së vetës. Veta e parë i referohet folësit (apo folësve), ndërsa veta e dytë i referohet të adresuarit (apo të adresuarve). Ndryshe nga veta e parë dhe e dyta, veta e tretë nuk është kategori deiktike sepse nuk u referohet pjesëmarrësve në komunikim, por atyre për të cilët flitet e që nuk janë të pranishëm në situatën e komunikimit. Pasi që veta është shenjuesi tipik i deiksit vetor, pjesëmarrësit në komunikim në gjuhën shqipe mund të identifikohen përmes përemrave vetorë, përemrave pronorë (kur hyjnë në raport me folësin apo të adresuarin) dhe përmes mbaresave vetore të foljeve. Gjithashtu, në tekstet e analizuara, shenjues të tjerë që i referohen të adresuarit janë emrat në funksionin e thirrorit dhe titujt e caktuar në këtë funksion.

Në skenarin e filmit “Zoti i unazave”, 12.34% e tekstit përbëhet nga shprehjet deiktike vetore që shenjojnë rolin e pjesëmarrësve në situatën e komunikimit, ndërsa në intervistë 6.19% të shprehjeve shenjojnë deiksin vetor. Pjesëmarrësit në situatën e komunikimit, në rolin e folësit apo të adresuarit, identifikohen më së shpeshti përmes mbaresave vetore të foljeve.

Në intervistë, ku kemi të bëjmë me një situatë formale të komunikimit, vërejmë se bashkëbiseduesit përdorin më shumë numrin shumë, qoftë kur kemi të bëjmë me shprehje deiktike të drejtuara nga folësi, qoftë kur i adresuari përbën qendrën deiktike. I intervistuari, në rolin e folësit, 35.98% të rasteve e përdor vetën e parë shumë. Kjo mund të interpretohet edhe si përpjekje për ta shmangur subjektivitetin, duke përfshirë kështu te *ne* veten + *të tjerët*, por edhe mund të jetë që përmes përfshirjes së *të tjerëve* në këtë grup të shmangë ndonjë përgjegjësi personale, duke e bërë atë grupore. Në anën tjetër, intervistuesi, kur e përdor *ne*, e përdor në kuptimin përfshirës (inclusive), duke përfshirë edhe të adresuarin aty. Edhe veta e dytë shumë, *ju* e respektit, që përdoret vetëm nga intervistuesi, është tregues i situatës formale dhe shmanges së subjektivitetit. Vetëm një herë intervistuesi i drejtohet të intervistuarit me *ti*.

Te skenari i filmit “Zoti i unazave” nuk kemi të bëjmë më shumë me ndonjë situatë formale. Në këtë tekst, numri shumë nuk përdoret për të shmangur subjektivitetin, por del në kuptimin përfshirës (inclusive) në raport me të adresuarin (*ne*= folësi + i adresuari). Nga 9.25% sa përdoret *ne*, 8.47% del me përdorim përfshirës dhe vetëm 0.78% si jopërfshirëse në raport me të adresuarin. Në këto raste ajo del edhe si deiktike, por edhe si anaforike. Shumësi i vetës së dytë *ju*, në këtë tekst përdoret vetëm 0.78% si shprehje respekti. Shprehja e respektit bëhet më shumë përmes titujve të caktuar, si *zoti* etj, me 5.05%.

Bibliografia

1. Benveniste, Emile (1971). *Subjectivity in Language*, në <https://www.princeton.edu/~ereading/Benveniste.pdf>, qasja për herë të fundit më 30 shtator 2015
2. Dibra, K., Varfi N. (1999). *Gjuhësi teksti*, SHBLU, Tiranë
3. Fillmore, Charles J.(1975). *Santa Cruz Lectures on Deixis 1971*, Indiana University Linguistic Club, Bloomington
4. Huddleston R., Pullum G. (2002). *The Cambridge Grammar of the English Language*, Cambridge University Press, London
5. Levinson, Stephan C. (1983). *Pragmatics*, Cambridge University Press, New York
6. Levinson, Stephan C. (2006). *Deixis*, In: Horn Laurence, Ward Gregory (ed.) *The Handbook of Pragmatics*, Blackwell Publishing, Oxford
7. Lyons, John (2001). *Hyrje në gjuhësinë teorike*, Dituria, Tiranë
8. Palmer, F. R. (1976). *Semantics - A New Outline*, Cambridge University Press, Cambridge, London, New York, Melbourne
9. Rugova, Lindita (2014). *Deixis in spoken vs written Albanian*, së shpejti në <http://www.press-su.com/>
10. Tahiri, Lindita (2006). *Monologu, personazhi dhe autori*. PEN Qendra e Kosovës, Prishtinë
11. Tahiri, Lindita (2013). *Gjuha dhe lufta e ideve*, Naimi, Tiranë
12. Werlich, Egon (1983). *A Text Grammar of English*, Quelle & Meyer, Heidelberg
13. Zobel, Sarah (2014). *On the non-uniformity of pronouns:1st sg, 2nd sg, and impersonal pronouns*, në <http://wwwuser.gwdg.de/~szobel/materials/zobel-non-uniformity-first-second-071114.pdf>, qasja për herë të fundit më 30 shtator 2015

Flutura MEHMETI

PIKËPAMJE TË MAKSIMILIAN LAMBERCIT PËR PERIU DHËN HIPOTETIKE TË SHQIPES

Në studimin monografik “Periudha hipotetike në gjuhën shqipe” albanologu austriak Maksimilian Lamberg ka bërë një punë shtruese duke plotësuar dhe skajet gramatikore sintaksore të ndërtimit të periudhës me fjalë të varura kushtore. Duke shqyrtuar ndërtimin e fjalëve të varura kushtore, ai është marrë me probleme të rëndësishme të periudhës hipotetike të shqipes, siç janë: periudha me fjalë të varura kushtore të ndërtuara me lidhëzën hipotetike “ndë”, fjalitë kondicionale që zëvendësohen me konstruksione të tjera, fjalitë kondicionale që përdoren për të kryer funksione të tjera, bashkimin e shumë fjalëve kondicionale, fjalitë kondicionale që korrespondojnë me kuptimin disjunktiv si dhe me probleme të tjera. Të gjitha këto çështje në këtë studim Lamberg i ka mbështetur në materiale të teksteve të reja e të vjetra të folklorit shqiptar dhe në tekste të literaturës së shkruar shqipe. Andaj, me të drejtë studiues të njohur të gjuhësisë shqiptare e të huaj Lambergin e konsiderojnë njohës të mirë të gjuhës shqipe, ndërkaq veprën e tij si model për trajtimin e gjerë dhe të imtë në aspektin strukturor e kuptimor të periudhës hipotetike të shqipes.¹

Vepra “Periudha hipotetike në gjuhën shqipe” shtrihet në tetë kapituj dhe disa nënkapituj të tjerë. Vëmendje kyçe në këtë studim i është kushtuar lidhëzës hipotetike “ndë” (në) në fjalitë reale (indikative) dhe në fjalitë joreale (konjunktive). Kjo lidhëz konsiderohet më e përdorura në gjuhën shqipe krahasuar me lidhëzat e tjera. Lidhëza hipotetike, ndë në studim më tutje është shqyrtuar së bashku me format kohore e mënyrore të foljeve në protazë dhe apodozë. Në këtë pikëpamje autori arsyeton ndërtimin strukturor e kuptimor të fjalëve hipotetike si dhe raportin që ato krijojnë mes dy a më shumë gjykimeve. Atëherë, nëse gjykimi në fjalinë e parë është i vërtetë, patjetër duhet të pranohet si gjykim i vërtetë dhe ai i fjalisë së varur. Pra, lidhëza hipotetike “ndë” në këtë studim trajtohet e gërshetuar me mënyrat dhe kohët foljore, me rendin sintaksor të fjalisë së varur në raport me fjalinë kryesore, si dhe me përmbajtjen e supozimeve si reale apo potenciale. Të gjitha këto ndërthurje mes fjalisë

¹ Lambertz, Maximilian: Periudha hipotetike në gjuhën shqipe, vlerësime të gjuhëtarëve shqiptarë dhe të huaj për Max Lambertz-in, f.291-299. Botimet albanologjike, Tiranë, 2011

kryesore dhe asaj të varur që realizojnë periudhën hipotetike në gjuhën shqipe përmes lidhësit hipotetik “ndë”, Lamberci i sheh në akset protazë dhe apodozë. Përveç lidhëzës “ndë” si lidhëza hipotetike në këtë studim, Lamberci njih edhe lokucionet sinonimike hipotetike: ndë qoftë se, andë, ndë se, ndëqe si dhe mjete të tjera që bëjnë lidhjen sintaksore mes fjalive të periudhës hipotetike: poqë, sikur, kur, ku, si, sikur në etj.²

Krahas lidhëzave, lokucioneve sinonimike dhe mjeteve të tjera që e bëjnë lidhjen mes fjalisë kryesore dhe fjalisë së varur hipotetike të shqipes vend të rëndësishëm në studimin e Lambercit zë dhe *periudha me fjali hipotetike asindete*. Në rendin e periudhave me mjete lidhëse zero, të cilat bashkimi i dy njësive predikative bëhet pa mjete sindetike, autori grupon fjalitë që nisin me pjesëzën “të” të lidhores, fjalitë kondicionale të ndërtuara me paskajoren geqe e me gerendum, fjalitë e ndërtuara me participin e tipit “për pa” dhe fjalitë e konstruksionet prepozicionale të ndërtuara nga parafjalët “me” dhe “mbë”³.

Në studimin e Lambercit rëndësi të posaçme kanë dhe *fjalitë kondicionale të shqipes, të cilat përdoren për të kryer funksione të tjera*. Në këtë mes hyjnë konstruktet fjalish që qëndrojnë ndërmjet fjalive kondicionale dhe koncesive (lejore). Përdorimi i fjalive kondicionale, të cilat kryejnë funksione koncesive është një dukuri sintaksore e semantike e pazakontë e shqipes që vihet në dukje për herë të parë nga Lamberci. Periudhat me lidhëza kondicionale që kanë strukturë semantike koncesive për nga ndërtimi dallohen prej periudhës me fjali lejore. Megjithatë, fjalia pjesore e tyre paraqet supozim.⁴

Meqë punimi ynë ka për qëllim trajtimin e disa pikëpamjeve të Lambercit për periudhën hipotetike të shqipes, atëherë mund të thuhet se si çështje e rëndësishme e këtij studimi është dhe problematika e *fjalive kondicionale korresponduese me kuptimin disnjunktiv*. Këto fjali ndërtohen nga partikujt disnjunktivë, siç janë: “o-o, ndo-ndo, deç-n’deç, hoj-hoj”. Sipas autorit pjesët disnjunktive paraqiten në optativ apo me prezent a imperfekt të indikativit. Fjalitë kondicionale, të cilat korrespondojnë me kuptimin disnjunktiv kanë dy posibilitete. Në rastin e parë fjalia e varur në formë pozitive e kundërshton fjalinë kryesore, ndërkaq në rastin e dytë e mohon atë. Autori nënvizon më tutje se “ajo mohon të parën qoftë tue përsërit verbin bashkë me negacionin, qoftë tue përdorë vetëm shprehjen, - në qoftë se jo-“.⁵

² Po aty, f.25-196

³ Po aty, f.197-219

⁴ Po aty.

⁵ Po aty, f.24

Përfundimisht, duhet të ceket se të gjitha këto dhe çështje të tjera komplekse dhe shumëdimensionale të fjalisë së varur kushtore të shqipes në lëmin e sintaksës, Lamberci i ka trajtuar me kompetencë shkencore të pakapërcyeshme deri më tani.

Ardita BERISHA

MODALITETI I SHENJUAR PËRMES FOLJEVE MODALE “*mund*” DHE “*dubet*” NË GJUHËN SHQIPE

Abstrakt

Në këtë punim do të paraqitet modaliteti i shenjuar me anë të foljeve modale *mund* dhe *dubet*. Modaliteti si kategori semantike që e shpreh qëndrimin e folësit ndaj vlefshmërisë së propozicionit i shenjuar me anë të foljeve modale (do, mund duhet, dhe kam), në gjuhën shqipe realizohet përmes modeleve të ndryshme. Varësisht nga konteksti modalja *mund* mund të dalë në të tria modelet: si epistemike duke shprehur bazën e vërtetësisë për vlefshmërinë e propozicionit, për të cilën folësi mbështetet në fakte të caktuara: *Tani ajo mund të vijë* (pasi që e ka mbaruar punën); si deontike – si lejim për përmbushjen e një veprimi të shprehur nga folja në propozicionin e dhënë: *Tani ajo mund të vijë* (pasi që i kreu detyrat); dhe si dinamike, si mundësi apo aftësi e varur nga vetë subjekti: *Tani ajo mund të luajë mirë me kitarë* (pasi që ka përfunduar kursin). Modalja *dubet* realizohet në modelin epistemik si supozim i mbështetur në njohuritë paraprake: *Ajo dubet të jetë në punë tani* (pasi që është orari i punës) dhe me modelin deontik si detyrim apo urdhër: *Ajo dubet të jetë në punë* (është e domosdoshme që ajo të jetë në punë, e ka për detyrë). Në këtë punim do të paraqiten modelet e përdorimit të modalitetit, cili nga këto modele përdoret më shpesh në tekste të caktuara duke e shenjuar njëkohësisht edhe shkallën e modalitet në propozicionet e dhëna, si qëndrime apo pretendime më të fuqishme apo më pak të fuqishme të folësve.

Fjalët çelës: modalitet, modele, epistemik, dinamik, deontik, folje modale.

1. Modaliteti

Modalitetit është konsideruar si një koncept semantik apo semantik-gramatikor. Palmeri (2001:1) e shpjegon nocionin e modalitetit (në anglisht) duke e krahasuar me nocione të tilla si nocioni i kohës gramatikore (tens) dhe të aspektit. Që të tria këto kategori kanë të bëjnë me ngjarjen, veprimin apo situatën e shprehur (në pohim) dhe që të tria, përgjithësisht, por jo gjithmonë, janë të shenjura brenda kompleksit verbal.

Duke cituar Comrien (1976:3) ai thotë se kategoria e kohës ka të bëjë me kohën e kryerjes së veprimit, aspekti ka të bëjë me natyrën e kryerjes së veprimit, ndërsa modaliteti, ka të bëjë me statusin e propozicionit që e përshkruan ngjarjen. D.m.th. ai nuk i referohet drejtpërdrejt ndonjë karakteristike të veprimit ose të ngjarjes së shënuar përmes foljes kryesore, por thjesht statusit të propozicionit.

Qasje të ndryshme (sintaksore, semantike, strukturore, pragmatike e funksionale) kanë dhënë përkufizime të ndryshme për modalitetin, e rrjedhimisht edhe kategorizime dhe nënkategorizime të ndryshme brenda kësaj kategorie. Megjithatë qasje të ndryshme, ato bashkohen në faktin që koncepti i modalitetit i referohet diçkaje si "qëndrim", "përfshirje" "angazhim" apo edhe "subjektivitet" i folësit që i shtohet veprimit të shprehur nga folja, pa qenë vetë pjesë e atij veprimi (Palmeri, 2001:1). Të gjitha këto qasje, po ashtu, vijnë në përfundim se brenda kategorisë së modalitetit ekzistojnë sisteme të ndryshme modale. Kështu ato bëjnë kategorizimin e modalitetit duke marrë si kritere fakticitetin e shprehur dhe aktualizimin e situatës (epistemik, evidencialitet vs. deontik, dinamik (boulomaik) (Huddleston/Pullum, 2002; Palmer, 2001; Simpson, 1993; etj.)

Për ta përkufizuar nocionin e modalitetit Halliday (Badran, 2002:85) nisat nga kriteri funksional, pa qe siç thotë ai "që ta shpjegojmë strukturën e gjuhës na nevojitet që ta marrim në konsideratë përdorimin e saj". Kështu ai e bën dallimin midis modalitetit dhe modulimit (Sejdiu-Rugova, 2015:453 i përdor termet modalizim dhe modulim) dhe i paraqet dallimet gramatikore midis të dyja grupeve. Me termin modalitet ai i referohet vlerësimit të folësit për propabilitetin (i cili përfshin mundësinë dhe sigurinë) dhe parashikueshmërinë, ndërsa termi modulim nuk ka të bëjë me qëndrimin apo përfshirjen e folësit në aktin e të folurit por ka të bëjë me shprehjen e dëshirës së tij ndaj diçkaje e cila më tutje përmban në vete koncepte të tilla si aftësi, prirje, leje, detyrim apo edhe shtërngim për të bërë diçka. Halliday këtu e bën edhe dallimin e shkallës së shprehjes së këtyre nuancave brenda këtyre dy grupeve të modalitetit në nivel të ulët, të mesëm dhe nivel të lartë. Sejdiu-Rugova (2015:453) thotë se interpretimi gjuhësor i modalitetit që bënë Halliday është shumë e rëndësishëm për qasjen pragmatike të analizës së cilës ai i paraprin.

Duke e studiuar modalitetin në lidhje me këndvështrimin Simpsoni (1993:47-50) e ndan atë në modalitet epistemik dhe në modalitet deontik. Kështu modaliteti epistemik ka të bëjë me praninë apo mungesën e besimit folës në presupozicionin e dhënë, ndërsa modaliteti deontik, para së gjithash ka të bëjë me shprehjen e qëndrimit folës ndaj shkallës së obligimit që shprehet në presupozicion. Më tej, modaliteti perceptiv është nënkategori e modalitetit epistemik dhe paraqet aftësinë e folësit për ta pranuar si të vlefshme atë që shprehet në fjali, duke u mbështetur në disa referenca

perceptive: Është *e dukshme/e qartë* që ata nuk e pëlqejnë njëri-tjetrin., dhe modaliteti boulomaik është nënkategori e modalitetit deontik dhe ka të bëjë me shprehjen e dëshirës së folësit ndaj një koncepti (*shpresoj, uroj* etj.).

Duke e marrë si kritere bazë aktualizimin e veprimit apo të situatës, gjenden faktike të saj dhe subjektivitetin e folësit, Palmeri (2001:8) kategorinë e modalitetit e ndan në dy grupe të modaliteteve, modalitet propozicional dhe modalitet të ngjarjeve.

Modaliteti propozicional përfshin në vete ato lloje modalitetesh që kanë të bëjnë me shprehjen e qëndrimit folës për vlerën e vërtetësisë apo statusin faktual të propozicionit dhe pëmban në vete dy lloje kryesore: modalitetin epistemik dhe modalitetin evidencial. Modaliteti epistemik ka të bëjë me shprehjen e gjykimit të folësit për statusin faktual të propozicionit. Brenda modalitetit epistemik ekzistojnë tri grupe gjykimesh: një që shpreh pasiguri e cila mund të identifikohet si supozim (Supozim, pasiguri) 1. *Ai mund të jetë në qytet tani.*, një që shpreh një përfundim të nxjerrë nga evidenca apo fakte evidente, e që mund të identifikohet si konkluzion: 2. *Ai dubet të jetë në qytet tani.* (pasi që nuk është në shtëpi, dhe zakonisht në këtë kohë del në qytet- përfundim i bazuar në fakte, deduksion) dhe një që tregon një konkluzion të arsyeshëm, konkluzion të cilin e nxjerrim duke u mbështetur në njohuritë e përgjithshme, pragmatike dhe do të identifikohet si konkluzion i arsyeshëm: 3. *Ajo do të/ dubet jetë në spital tani* (pasi që ajo është mjeke dhe është koha kur ajo është në punë) (Palmer, 2001:24). Nëse u referohemi me terme të Hallidayt duke e matur shkallën e nuancës modale brenda sistemit epistemik, në shembullin e parë baza e vërtetësisë së shprehur qëndron në një nivel të ulët, nivel supozimi, ndërsa në dy shembujt e tjerë baza e vërtetësisë paraqitet në një nivel të lartë, pasi që presupozimet janë rrjedhojë e konkluzioneve të caktuara. Evidencialiteti apo modaliteti evidencial ka të bëjë me shprehjen e evidencave (dëshmime) që folësi i posedon për atë që e thotë: Shtëpia *qenka* e vjetër ose *Shihet qartë që shtëpia është e vjetër.*

Modaliteti i ngjarjeve ka të bëjë me ngjarje ende të paaktualizuara, ngjarje që nuk kanë ndodhur ende, por thjesht janë potenciale dhe pëmban në vete dy tipa kryesorë modalitetesh: modalitetin deontik dhe atë dinamik. Modaliteti deontik ka të bëjë me një detyrim apo leje që buron nga një faktor i jashtëm. Tipin më të rëndomtë të modalitetit deontik e përbëjnë detyrimet, urdhërat: 1. *Ai dubet të kujdeset për fëmijët.* (detyrë) dhe lejimi 4. *Ai mund të dalë jashtë.* (leje). Ndërsa modaliteti dinamik ka të bëjë mundësinë si aftësi dhe dëshirën, me vullnetin e individit në fjalë. Faktorët që e kushtëzojnë realizimin e veprimit tanimë janë të brendshëm, varen nga individi. Dy tipat kryesorë të këtij lloji modaliteti konsiderohen ato që shprehen si aftësi: 5. *Tani ai mund/ di të luajë me kitarë shumë mirë* (pasiqë e ka mbaruar kursin e kitarës) dhe si dëshira: 6. *Mbrëmjeve, ai dëshiron të luajë me kitarë* (Palmer, 2001:71-77).

Për shpjegimin dhe klasifikimin e kategorisë së modalitetit Badran (2002:114,115) mbështet një qasje pragmatike dhe funksionale. Duke iu referuar Lakoffit se modalet "semantikisht janë shumë të parregullta dhe të paparashikueshme" ai thotë se një qasje më fleksibile për interpretimin e modaleve, do të ishte ajo që mbështetet më haptas në kontekst, siç është qasja funksionale e Hallidayt (1970) dhe e Johannessonit (1978).

Modaliteti mund të shenjohe me mjete të ndryshme gramatikore dhe leksikore. Në gjuhën shqipe ai mund të shprehet me mjete gramatikore siç janë foljet ndihmëse modale: *mund, dubet, do* që shprehin lloje të ndryshme modalitetesh dhe folja ndihmëse *kam* kur përdoret në struktura foljore për të shprehur kohën e ardhme: *kam me punu(e)* a *kam për të punuar* që shpreh modalitet deontik, në formë të një detyre apo obligimi dhe mënyrat e foljes të cilat shprehin modalitete të ndryshme lidhorsa, habitorja dhe dëshirorja (mundësi, habi, dëshirë); pastaj me mjete leksikore, ku hyjnë foljet leksikore si *lë, lejon, bën, di dhe guxoj: Ai di të luajë me kitarë* - si modalitet dinamik, *Le të shkojnë të gjithë...* - modalitet i deontik, lejim ose urdhër, varësisht nga konteksti etj.; ndajfoljet modale: *mundësisht, patjetër, domosdoshmërisht, ndoshta, qartë* etj., pjesëzat: *po, jo* etj., mbiemrat: *e domosdoshme, e mundshme, e sigurt* etj. dhe emrat modale: *gjasë, aftësi, siguri* etj. (Rugova, Sejdiu, 2015:179).

2. Modaliteti i shenjuar me foljet *mund* dhe *dubet*

Ky trajtim për modalitetin e shprehur me foljet modale *mund* dhe *dubet* në gjuhën shqipe është mbështetur kryesisht në trajtimin dhe klasifikimin që e bën Palmeri duke iu referuar edhe koncepteve të Hallidayt dhe të Huddlestonit e Pullumit për paraqitjen e shkallës së modalitetit në modele të ndryshme brenda sistemeve modale.

Hulumtim është përqendruar në tri tekste argumentuese të nxjerra nga tri intervista të realizuara në emisionin Rubikon në KTV, të transkriptuara dhe të botuara në përmbledhjen "Kapërcimi i Rubikonit drejt pavarësisë" me autor Adriatik Kelmendin (2015). Qëllimi i këtij hulumtimi nuk është të paraqesë qëndrimin e folësëve si pjesë të ideologjisë së tyre, por thjesht hulumtimi i shprehjes së qëndrimit folës përmes këtyre dy foljeve modale në gjuhën shqipe. Këto shenjuese të modalitetit janë përdorur në 206 raste, modalja *dubet* del 85 herë apo 41%, ndërsa modalja *mund* 119 herë apo 58,33%.

- modalja *dubet*: - në modelin deontik del në 85 raste apo 98,83%
- në modelin epistemik del në 1,16% raste
- modalja *mund*: - në modelin epistemik 96 herë apo 80,67%

- 19 herë apo 19,79% shpreh supozime, shprehet pasiguria e folësve për atë që e thonë;
- 72 herë apo 82, 75% shpreh përfundime duke u mbështetur në fakte të caktuara;
- në modelin deontik 9 raste 9,35%;
- polisemike në 12 raste apo 12,5%

Duhet	Deontike	Epistemike
Folësi 1	95%	5%
Folësi 2	100%	---
Folësi 3	100%	---

Tab. 1

Mund	Epistemike	Epistemike, si përfundim	Epistemike, si supozim
15 herë	93,75%	73,66%%	26,66%
40 herë	67,5%	85,18%	14,81%
61 herë	87,30%	71,42%	24,44%

Tab.2

	Mund	Epistemike	Epistemike, si përfundim	Epistemike, si supozim	Deontike	Si polisemike
Folësi 1	15 herë	93,75%	73,66%%	26,66%	6,25%	--
Folësi 2	40 herë	67,5%	85,18%	14,81%	15%	17,5%
Folësi 3	61 herë	87,30%	71,42%	24,44%	3,17%	7,93%

Tab. 3

Folja modale *mund* sipas semantikës së saj shpreh mundësi, ndërsa modalja *dubet* para së gjithash shpreh domosdoshmëri, detyrë. Megjithatë, duke u nisur nga fakti që modalet karakterizohen nga parregullësia semantike e tyre, që të dyja këto folje mund t'i përkasin të dy, konkretisht të tri sistemeve modale duke bërë kështu që i njëjti shenjues modal varësisht nga konteksti në të cilin gjendet të shenjojë vlera modale të ndryshme epistemike, deontike apo dinamike. Pra, në këtë mënyrë foljet *mund* dhe *dubet* mund të krijojnë modele të ndryshme të modalitetit brenda sistemeve të ndryshme modale. Nisur nga kriteri semantik Palmeri (1986:51) e sqaron këtë dukuri kur e shpjegon sistemin epistemik të modalitetit duke thënë se termi "epistemik" nuk ka të bëjë thjesht me një sistem modal i cili në thelb përmban nocionin e mundësisë,

por kemi të bëjmë me një sistem i cili në vete përmban shkallën e qëndrimit të folësit ndaj asaj që thotë. Kjo nënkupton që ky sistem duhet të përfshijë gjykimet e folësit për statusin e propozicionit si: supozime (shprehje të pasigurisë), si konkluzione (të nxjerra nga faktet, deduksion) dhe si konkluzione të arsyeshme, të nxjerra nga informata apo dije të përgjithshme. Sistemi deontik i modalitetit, gjithashtu, nuk ka të bëjë thjesht me nocionin e detyrës dhe të obligimit, por në vete përmban edhe konceptin e mundësisë së varur nga faktorë të jashtëm. Te Huddleston dhe Pullum (2002:176-177) kjo dukuri shpjegohet përmes dobësimit pragmatik të modales *dubet* dhe fortësimit pragmatik të modales *mund*. Kështu modalja *dubet* semantikisht shpreh modalitet të fuqishëm: *Dubet të shkosh menjëherë*. – urdhër për t'u realizuar veprimi, ndërsa *mund* shpreh modalitet të dobët: *Mund ta veshësh këtë fustan sonte*. - mund të interpretohet si një propozim i folësit. Mirëpo, në kontekste të caktuara *dubet* mund të realizohet si modale e dobët – dobësim pragmatik: *Ti dubet ta kesh njërin nga këta fustana* – si një propozim apo sugjerim i folësit, dhe *mund* mund të realizohet si modale e fuqishme – forcim pragmatik: *Mund të dalësh jashtë tani* – që mund të interpretohet si leje për të dalë jashtë (në raporte të tilla siç është ai profesor-nxënës).

2.1. Modeli deontik

Si urdhër, detyë, obligim dhe si lejmim

1. *Akademia nuk mund të injorohet, sepse në qoftë se është me ato potenciale, ato potenciale do ta gjejnë rrugën ta thonë fjalën e tyre. Ndërkaq kritikëkat po, ka shpesh kritika të këtilla ose të atilla. Por, në këtë rast kritikëkat **dubet të jenë** po aq serioze dhe po aq të mbështetura që të thonë diçka.* (f. 126)

Përdorimi i njëres apo tjetres folje modale e paraqet qëndrimin e folësit në shkallë të ndryshme modale. Modalja *dubet* paraqet një shprehje më të fortë të qëndrimit të folësit në presupozicionin e dhënë se sa folja *mund*, pasi që folja *dubet* semantikisht është më e fuqishme shpreh detyrë, urdhër, domosdoshmëri në krahasim me foljen *mund* që brenda sistemit deontik shpreh lejmim ose pajtim për mundësinë e realizimit të një veprimi. Kështu që deonticitetit është më i shenjuar në rastin kur folësi e përdor modalen *dubet* sesa në rastin kur e përdor foljen *mund*. Në fjalinë e parë, të shembullit të parë *nuk mund të injorohet = nuk lejohet të injorohet*, modalitetit deontik pëmes foljes *mund* e shfaq qëndrimin e folësit në formë lejmimi, konkretisht moslejimi. Me terme të Huddlestonit dhe Pullumit kemi forcim pragmatik të modales *mund*. Ndërsa në fjalinë e dytë të shembullit të parë: *dubet të jenë* modaliteti deontik shprehet si detyrë e domosdoshmëri e folësit në një shkallë të lartë modale.

2.2. Modeli epistemik

- Si supozim, përfundim i mundshëm por jo i sigurt:

1. Ngase *ka* analistë që e vlerësojnë se në Ballkan **mund të ketë** luftëra të reja (f.96)

2. *Luftëra nuk e besoj që mund të ketë, por mund të ketë* fërkime të vogla, rrebelime të vogla të intensitetit të ulët, por luftëra nuk do të ketë. (f. 96)

Përveç fjalisë së parë të shembullit të dytë, e cila paraqet një përfundim të folësit – karakterin epistemik të së cilës e thekson folja *mendoj*, në të dy shembujt e dhënë shkalla e besueshmërisë së vërtetësisë në presupozicion është në nivelin e supozimit ...*mund të ketë luftëra/mund të ketë fërkime të vogla = ndoshta?* Duke u nisur nga fakte të caktuara folësi vjen në një përfundim, i cili megjithatë mbetet në nivel hipotetik që d.m.th. se baza e vërtetësisë së shprehur është në nivel të ulët. Ky model i modalitetit brenda sistemit të modalitetit epistemik sipas klasifikimit të pare që e bën Palmeri në një rën anë afrohet me modalitetin njarjeve, në kuptimin që përmes tij shprehen gjykime të folësit për veprime ende të paaktualizuara, veprime që i referohen të ardhmes, ndërsa, në anën tjetër, ky lloj modaliteti qëndron brenda sistemit të modalitetit propozicional, modalitetit epistemik, në kuptimin që gjykimet e shprehura këtu kanë një bazë vërtetësie pasi që rezultojnë si gjykime të mbështetura në fakte të caktuara edhe pse shkalla e faktivitetit është e ulët.

- Si përfundime, përfundime duke u mbështetur në fakte të caktuara ose duke u mbështetur në njohuritë pragmatike

1. *Sa i përket Kosovës, situata mund të menaxhohet me kategorinë e të drejtave për pakicat, meqë pakicat janë të papërfillshme në Kosovë.* (f. 87)

3. *Ata fillimisht kanë qenë anëtarë të PPD, pastaj janë bërë anëtarë tonë, pastaj janë bërë të BDI-së, kështu që nuk mund të thuhet që ishin anëtarë të kaësaj apo të asaj partie.* (f. 95)

Ky model në gjuhën shqipe mund të shprehet me foljet *mund* dhe *dubet*. Natyrisht, dallohet shkalla e besueshmërisë së vërtetësisë varësisht nga përzgjedhja e njëres apo tjetres folje. Sipas koncepteve të Palmerit të dy shembujt paraqesin modalitet epistemik si deduksione bazuar në fakte të caktuara. Në të dy shembujt e mësipërm vërehet se shkalla e besueshmërisë së vërtetësisë së shprehur është në një nivel të lartë pasi që ajo rezulton si përfundim i mbështetur në një shkallë të lartë të faktivitetit. Në të dy shembujt e dhënë këto fakte i gjejmë në kontekst: në shembullin e parë në fjalinë e varur shkakore ...*meqë pakicat janë të papërfillshme në Kosovë dhe në shemullin e dytë në fjalinë kryesore* *Ata fillimisht kanë qenë anëtarë tanë, pasatj të PPD-së...*

Modalja *dubet* me kuptim epistemik në këtë hulumtim është gjetur vetëm një herë. Në këtë shembull të gjetur shohim që folësi e shpreh qëndrimin e tij si një përfundim duke u mbështetur në fakte të njohura për të, kështu që bën që shkalla e

besueshmërisë për vërtetësinë e asaj që folësi e thotë të jetë në një nivel të lartë. Palmeri (2001:8) thotë se përdorimi i modales *dubët* si epistemike sugjeron se përfundimi bazohet në evidenca. Duke iu referuar Coatas ai shton se " në përdorimin më të zakonshëm të saj epistemikja *dubët* e përcjell besimin e folësit për atë që është duke e thënë, duke u bazuar në një deduksion, nga fakte që ai i ka të njohura", të cilat në shembullin e marrë këtu nuk janë kontekstuale, por mbesin të nënkuptuara për njohësitë e kontekstit shoqëror në të cilin gjendet folësi.

2. *Të tjerët i druben kësaj ideje, por mendoj se edhe këtu **dubët të jetë** një forcë apo strukturë politike që i afirmon këto ide.*

2.2.3. Disa modele polisemike

Pasi që modalet kanë karakter semantik shumë të parregullt për interpretimin e tyre një rol shumë i rëndësishëm padyshim që i atribuohet kontekstit. Mbështetur në këtë fakt Badrani (2002: 114,115) propozon një qasje më fleksibile për interpretimin e modeleve e që do të mbështetej haptas në kontekst. Megjithatë, modalet shpesh mbesin të pakategorizuara sipas njërës apo tjetrit sistem apo model modaliteti, kështu që ato mund të interpretohen sipas të tria modeleve njëkohësisht, si epistemike, si përfundim ose si supozim, si deontike, detyrim apo lejim dhe si dinamike, si mundësi e varur nga subjekti. Kështu, shpesh ato janë ambigje ose edhe polisemike kuptimisht, të pazbërthyeshme në këtë apo atë kuptim dhe mund të interpretohen sipas të tria modeleve. Në këtë mënyrë ato bëhen shumë të përshtatshme për ta fshehur apo për ta modifikuar qëdrimin e folësit të shprehur në presupozicion, rrjedhimisht shumë të përshtatshme për të manipuluar me situata të ndryshme diskutive (në diskursin e reklamave, në politikë etj.).

1. *Hartimi i politikave, politikat u takojnë atyre institucioneve që merren me politikat. Institucioet shkencore **mund të merren** me hartimin e programeve, **mund të marrin** pjesë në hartimin atyre e programeve për ta ndihmuar stabilizimin, ligjvënësit, qeverinë e të tjera stabilizime të Kosovës të cialt kanë kompetenca dhe pa nënshkrimin e tyre nuk **mund të bëhet** asgjë. (133)*

3. *Duke pasur parasysh këto dhe duke pasur parasysh edhe pozitën që e ka Akademia, me ligjin për Akademinë e Shkencave, Akademia është institucion që **mund të ketë** vetëm qendra të bulumtimit, bërthama të vogla, por jo institute. (131)*

Folja modale *mund* në shembullin e parë lë mundësi të interpretohet sipas të tria modeleve të modalitetit: në modelin epistemik me nivel të lartë të faktivitetit, pasi që gjykimi i folësit për statusin faktik të presupozicionit paraqitet si një përfundim i mbështetur në fakte të caktuara kontekstuale (që ato institucione përfaqësojnë nivelin

më të lartë intelektual dhe institucionet e tilla, normalisht do të mund të merreshin me punë të tilla); në modelin deontik, në kuptimin që atyre institucioneve u lejohej apo do të duhej t’u lejohej të merren me çështje të tilla, pra në kuptim lejimi dhe në modelin dinamik, ku nisur nga fakti që këto institucione përfaqësojnë një nivel të lartë intelektual do të nënkuptohej që ato kanë aftësi, i kanë të gjitha predispozitat për t’u marrë me çështje të tilla.

Shembulli i dytë e ilustron ambiguitetin e shprehjes së modalitetit. Si modalitet epistemik ku shkalla e faktivitetit paraqitet në një nivel të lartë, meqë folësi këtë konkluzion të tij e mbështet në fakte të caktuara. Këto fakte i gjejmë te fraza: *Duke pasur parasysh këto – konkretisht te përemri dëftor këto*, i cili si mjet i realizimit të kohezionit gramatikor u referohet disa fakteve që përmendura), pastaj pozita e Akademisë që përmendet këtu (dhe nënkuptohet nga konteksti), dhe del si deontike, si moslejimi...*me ligjin për Akademinë e Shkencave, Akademisë i lejohe = mund të ketë vetëm qendra hulumtimi (...ajo mund të ketë...).*

Përfundim

Në këtë hulumtim përdorimi foljes *mund* si epistemike është më i madh se sa ai i foljes *dubet*, si epistemike dhe si deontike. *Dubet* si epistemike përdoret vetëm në një rast kur folja *dubet* nënkupton faktin që folësi mbështet në një evidencë të qartë, duke e rritur shkallën e sigurisë për atë që e thotë. Përdorimi epistemik i foljes *mund* kur folësit i shprehin përfundimet e tyre duke u bazuar në fakte të caktuara është më i madh se sa ai ku ata shprehin supozime dhe se sa përdorimi deontik. Përdorimet e tilla tregojnë se shkalla e sigurisë për vërtetësinë e presupozicioneve është në një nivel të lartë të folësit. Këtu janë gjetur edhe modele të tilla të përdorimit të modaleve ku konteksti nuk ndihmon për t’i klasifikuar sipas një sistemi modal por ato njëkohësisht mund të interpretohen sipas të tria sistemeve: epistemike, deontike dhe dinamike. Si të tilla ato janë shumë të përshtatshme për t’u përdorur në diskurse të ndryshme për ta fshehur apo për ta modifikuar qëndrimin e folësit.

Korpusi: Kelmendi, A. (2015) *Kapërcimi i Rubikonit drejt pavarësisë*. Prishtinë: Koha

Bibliografia

1. Badran, D. (2002) *Ideology through Modality in Discourse Analysis*. The Nottingham Linguistic Circular.

2. Halliday, M.A.K. (1973) *Explorations in the Functions of Language*. London: Edward Arnold.
3. Huddelston R, Pullum G. K. (2002) *The Cambridge Grammar of the English Language*. Cambridge University Press, UK
4. Ismajli B. (2000) *Modaliteti dhe mënyra në studimet gramatikore të shqipes*. Në: Semianri i 28 Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare. Prishtinë: Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Filologjisë.
5. Lyons, J. (1977) *Semantics*. Cambridge: Cambridge University Press.
6. Nuyts J. (2001) *Epistemic Modality, Language and Conceptualization – A Cognitive-Pragmatic Perspective*. Amsterdam/Philadelphia: John Benjamins Publishing Company.
7. Palmer F.R. (1996). *Mood and Modality*. Cambridge University Press, Cambridge
8. Palmer F.R. (1996). *Mood and Modality*. Second Edition. Cambridge University Press, Cambridge.
9. Palmer. F. R. (1990) *Modality and the English Modals*. London and New York: Longman.
10. Rugova L. (2015) *Ideologjia e shprehur nëpërmjet modalitetit në studimet për “pastërtinë e shqipes”*. Në: Seminari e 33-të Ndërkombëtar për gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare. Prishtinë: Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Filologjisë.
11. Simpson P. (1993) *Language, Ideology and Point of View*. London: Academic Press.

Veton MATOSHI

RIMARRJA E KUNDRINAVE NË TË FOLMET E GEGËRISHTES VERILINDORE – DISA REZULTATE PARAPRAKE

1. Hyrje

Rimarrja e kundrinave në gjuhën shqipe paraqet një mënyrë të të shënjuarit të kundrinës së drejtë dhe të zhdrejtë me anë të formave të patheksuara të përemrave vetorë në rasën dhanore dhe kallëzore. Kjo dukuri gjuhësore dëshmohet edhe në një varg gjuhësh të tjera evropiane; ndër to bën pjesë shumica e gjuhëve ballkanike dhe romane. Ndër gjuhët ballkanike që shfaqin dukurinë e rimarrjes së kundrinave duhen përmendur përveç shqipes, bullgarishtja, maqedonishtja, greqishtja e re, rumanishtja, arumanishtja si dhe torlakishtja (e folme e serbishtes). Gjithsesi faktorët, të cilët kushtëzojnë përdorimin e trajtave të shkurtra të përemrave vetorë, janë të ndryshëm për secilën nga këto gjuhë. Një vështrim më i imët shpalos madje edhe dallime mes të folmeve të ndryshme të gjuhëve të lartpërmendura. Unë do të ndalem këtu vetëm në rastin e gjuhës shqipe¹ dhe në dallimet në përdorimin funksional të trajtave të shkurtra në të ashtuquajturën gjuhë standarde, të cilën në këtë rast do ta trajtoj si të barasvlershme me të folmet toske, dhe në të folmet e gegërishtes verilindore. Përfundimet e paraqitura në këtë punim janë vetëm rezultatet e një studimi ende në shpërgënj, i cili bazohet kryesisht mbi një numër të kufizuar tregimesh popullore nga Drenica. Si i tillë ai nuk mëton të jetë përfaqësues për gjithë hapësirën dialektore në fjalë. Pra rezultatet e arritura duhet të vlerësohen më tepër si një hap i parë drejt kërkimeve gjithëpërfshirëse në nivel makro, për të nxjerrë në dritë dallimet e shkallëshkallshme funksionale të një dukurie gjuhësore në aksin jug-veri të hapësirës kompakte shqipfolëse².

¹ Këtu bëhet fjalë në radhë të parë për rastin e bullgarishtes, maqedonishtes dhe serbokroatishtes, të cilat në tërësinë e tyre formojnë një hapësirë kompakte të sllavishtes ballkanike.

² Një ndarje të tillë tendenciale vëren edhe Sh. Demiraj (1985: 591) tërthorazi, i cili thotë për rregullat e ndërlikuara të rimarrjes së lidhorit që: “Kështu, p. sh., te ndonjë autor prej Shqipërisë Veriore rimarrja e përemrit lidhor që në funksionin e kundrinës së drejtë është pasojë e ndikimit të së folmes përkatëse, që në këtë pikë ka shkuar shumë më përpara në krahasim me të folmet e tjera të shqipes (nënvizimi nga V. M.). Kështu mund të shpjegohet, p. sh., rimarrja e lidhorit

1.2. Disa vështrime të përgjithshme lidhur me rimarrjen e kundrinave

Si në të gjitha gjuhët ballkanike, edhe në gjuhën shqipe gjatë zhvillimit të saj janë përfutur trajta të shkurtra apo të patheksuara, të cilat për nga statusi i tyre sintaksor paraqesin klitika të përemrave vetorë në rasën dhanore dhe kallëzore³. Ndërmjet gjuhëve ballkanike shqipja përfaqëson një sinkretizëm mjaft të zhvilluar duke mos bërë asnjë dallim rasor tek format e patheksuara në vetën e parë dhe të dytë, njëjës dhe shumës; khs. tabelën vijuese:

	Dhanore	Kallëzore
1 nj.	më	
1 sh.	na	
2 nj.	të	
2 sh.	ju	
3 nj.	i	e
3 sh.	u	i

Rimarrja e kundrinës në gjuhën shqipe lidhet drejtpërdrejt me ekzistencën e një artikulli të çfarëdo lloji në rrafshin morfologjik (Kallulli 2014: 17). Sipas Bošković-it (2008) një ndërlidhje e ngushtë mes ekzistencës së një kategorie morfologjike të shquarsisë në formë të artikuljeve dhe të dukurisë së rimarrjes së kundrinave duket të ketë vlerë universale. Në këtë mënyrë, të dubluarit e kundrinave pa ndonjë nyjë në shprehje të zakonshme si: *bëj mubabet, pi ujë, ha bukë, marr guxim* etj., përjashtohet plotësisht (khs. edhe § 3.2.). Një relacion i tillë nuk është i habitshëm, po të merret parasysh fakti që klitikat përemërore s'janë gjë tjetër veçse forma të shkurtra të përemrave vetorë, të cilët, nga ana tjetër, zënë vendin e emrave ose referentëve të përmendura më parë, pra të njohura dhe në njëfarë mënyre edhe të shquara, në diskursin gjuhësor. Pohimi i Friedman-it (2006:662) që rimarrja e kundrinave në gjuhët ballkanike lidhet drejtpërsëdrejti me shquarsinë, referencialitetin dhe animacitetin (shkallën e të qenit frymor) e mbështet këtë fakt. Lidhur me këtë ai bën një ndarje të pjesëve të ligjëratës dhe të gjymtyrëve në fjali, të cilat kanë gjasë më të madhe të dublohen dhe e paraqet këtë shkallë:

në këtë fjali të nënrenditur me vlerë caktuese: - Kalca s'është *ajo që e ke lënë ti këtu e pesë vjet më parë.* (S. Drini, *Midis dy kobëve*, 325)."


³ Në vijim do të përdoret termi *klitikë* (përemërore) në mënyrë sinonimike me termat tradicionale *format/trajtat e shkurtra/patheksuara* (përemërore).

1. Përemrat vetorë (*për shkak të semantikës së tyre inherente janë të shquar dhe të paktën në të dyja vetat e para edhe humane*)
2. Kundrinat e zhdrejta (*zakonisht humane dhe shpesh zënë vendin e temës, pra janë të topikalizuara*)
3. Kundrinat e drejta dhe të shquara
4. Kundrinat e drejta, të specifikuara ose të topikalizuara

Një vështrim i tillë ofron edhe një shpjegim për faktin e shpeshpërmendur që topikaliteti, të paktën në gjuhët ballkanike, paraqet shpesh një faktor të qenësishëm për dublimin e kundrinës. Sipas përkufizimit të përgjithshëm renditen ato gjymtyrë të fjalisë si pjesë të topikës apo temës në fjali, të cilat janë të përmendura më parë apo të njohura në diskursin gjuhësor, pra shfaqin një shkallë më të lartë të individuacionit. Lidhur me këtë do përmendur edhe hierarkia e topikalitetit sipas Givón-it (1974: 152), e cila, për sa u përket argumenteve të foljeve (apo roleve tematike), paraqitet si vijon:

AGENS/SUBJECT (EMËRORE) > INDIRECT OBJECT (DHANORE) > DIRECT OBJECT (KALLËZORE)

Të gjitha këto përsiatje, të vështruara nga një perspektivë më e përgjithshme, na shpien te shkalla apo hierarkia e shquarsisë (*definiteness scale*) dhe e animacitetit (*animacy hierarchy*), të cilat Kiparsky (2008) i bashkon në të tijën „hierarki të D-së (shquarsisë)“⁴.



Kallulli (2014: 19) e konsideron këtë skemë si bazë mjaft premtuese për të shqyrtuar dhe shpjeguar funksionet e rimarrjes së kundrinave në gjuhën shqipe. Meqë hierarkia e D-së mbërthen në vetvete të gjithë faktorët thelbësorë të përmendur më sipër në lidhje me rimarrjen e kundrinave, ajo do të zbatohet edhe në vijim për të parë se në çmasë mund të shpjgohet rimarrja e kundrinave në të folmet e gegërishtes verilindore sipas këtij këndvështrimi.

⁴ Në fakt dhe siç shprehet vetë Kiparsky, *D-hierarchy* s'është gjë tjetër veçse një riemërtim për *animacy hierarchy*. Ai e vlerëson këtë emërtim si më të qëlluar meqë skema nuk pasqyron bash shkallën e animacitetit, por shkon më tej, duke përfshirë kategori të tjera, si p. sh. gjasën e të qenit tema e fjalisë etj., por që të gjitha përshtajnë shkallën e individuacionit e një referenti.

2. Rimarrja e kundrinave në gjuhën shqipe standarde

2.1. Rimarrja e kundrinës së zhdrejtë

Përdorimi i trajtave të shkurtra në rasën dhanore paraqitet mjaft transparent: Rimarrja e kundrinës së zhdrejtë është gjithmonë e detyrueshme (Buchholz & Fiedler 1987: 444; Agalliu et al. 2002: 227). Kemi të bëjmë pra me një mjet shtesë sintaksor për të shënjuar rasën dhanore apo kundrinën e zhdrejtë; khs. shembujt që vijojnë:

(Buchholz & Fiedler 1987: 445)

- 1) Unë **i** jam mirënjohës **Agimit**.
- 2) **I** dërgova fjalë një **shoku**.

Dublimi i detyrueshëm i kundrinës së zhdrejtë përshtatet me hierarkinë e topikalitetit sipas Givón-it (khs. § 1.2), sipas së cilës kundrinat e zhdrejta kanë gjasë të jenë më shpesh pjesë e topikës së fjalisë, sesa kundrinat e drejta. Sipas këtij këndvështrimi, me kalimin e kohës rimarrja e kundrinës së zhdrejtë ka ardhur duke u përgjithësuar në të gjitha kontekstet sintaksore. Ky zhvillim duhet të ketë ndodhur në një fazë më të vonë të shqipes, meqë autorët e vjetër (Buzuku, Matrënga, Budi, Bogdani) dëshmojnë mjaft raste ku kundrina e zhdrejtë nuk shoqërohej nga asnjë formë e patheksuar (Sh. Demiraj 1985: 585-586)⁵.

2.2. Rimarrja e kundrinës së drejtë

Përdorimi i trajtave të shkurtra në rasën kallëzore nuk mund të trajtohet në mënyrë aq të përmbledhur siç është rasti për rimarrjen e kundrinave të zhdrejta, por kërkon një shqyrtim më të detajuar meqë këtu kalojmë në rrafshin pragmatik të gjuhës shqipe, pra në fushën renditjes së informacionit (*information structure*). Kohë më parë rimarrja e kundrinës së drejtë ka tërhequr vëmendjen e një numri të madh gjuhëtarësh, të cilët e kanë trajtuar atë në gramatikat deskriptive apo preskriptive (si p. sh.: Sheperi 1927; Agalliu et al. 2002 etj.), si dhe në punime të mirëfillta shkencore (Buchholz 1977; Kallulli 2000; Tomić 2006 etj.). Buchholz (1977: 3) vë në pah që në pjesën më të madhe të literaturës përkatëse është theksuar vetëm vështirësia e përcaktimit të

⁵ Megjithatë, duhet konsideruar edhe fakti se kemi të bëjmë me tekste të përkthyer nga latinishtja dhe italishtja kështu që numri i madh i rasteve ku nuk kemi dublim të kundrinës së zhdrejtë mund të jetë pjesërisht rezultat i përpjekjeve të autorëve të vjetër për t'iu përmbajtur sa më mirë teksteve origjinale.

rregullave për rimarrjen e kundrinave në gjuhën shqipe, pa bërë ndonjë analizë për t'i sqaruar faktorët që (pa)mundësojnë dublimin e kundrinës së drejtë⁶.

Kur flasim për rimarrjen e kundrinës së drejtë si një mjet sintaksor për renditjen e informacionit, e kemi fjalën vetëm për dublimin e një kundrine të drejtë në vetën e tretë. Për vetën e parë dhe të dytë, njëjës si dhe shumës, vlejnjë të njëjtat rregulla si për kundrinat e zhdrejta, me fjalë të tjera dublimi është papërzjashtimisht i detyrueshëm, në të gjitha kontekstet sintaksore; khs. shembujt në vijim:

(Buchholz & Fiedler 1987: 440)

3) Gjyshja **më** mori **mua** për dore.

4) Unë **ju** njoh **ju** prej kohësh.

Edhe kjo përputhet plotësisht me mendimet e Friedman-it, të parashtruara më parë për kategorinë e shquarsisë, meqë veta e parë dhe veta e dytë janë gjithmonë humane dhe – veta e dytë në shumicën e rasteve – të njohura dhe të shquara për folësin në diskursin gjuhësor, siç pasqyrohet edhe në hierarkinë e D-së. Për më tepër, përdorimi i ngjashëm i formave të patheksuara të vetave të para në rasën dhanore dhe kallëzore e bën më të kuptueshme mënjanimin e dallimeve rasore të tyre. Por do pasur parasysh se tekste më të vjetra (si p. sh. “Albanische Texte” të Pedersenit) dëshmojnë se dublimi i këtyre përemrave nuk ka qenë kurdoherë i detyrueshëm (Sh. Demiraj 1985: 588; Buchholz 1977: 134).

Rimarrja e kundrinave në vetën e tretë është diçka më e ndërlikuar dhe mbetet edhe sot e kësaj dite objekt trajtimi në gjuhësinë ballkanike⁷. Buchholz & Fiedler (1987: 440) e lidhin këtë me renditjen e kundrinës së drejtë si temë të fjalisë. Sipas këtij

⁶ Sh. Demiraj (1985: 590-581), për sa u përket luhatjeve në rimarrjen e përemrit lidhor që në letërsinë shqipe, nuk e përjashton mundësinë që kemi të bëjmë me dallime (nën-)dialektore që depërtojnë në gjuhën standarde. Siç dëshmojnë shembujt 26-28 mbi rimarrjen e përemrit pyetës *kë*, ky supozim është i saktë.

⁷ Shih p.sh. diskutimi nëse aspekti i specifitetit luan një rol në rimarrjen e kundrinës në gjuhën shqipe. Tomić (2006: 314) kundërshton Kallullin, sipas së cilës specifiteti nuk luan asnjë rol në rimarrjen e kundrinës së drejtë, dhe sjell këto dy shembuj:

Ana donte ta blejë një fustan. (që e kishte parë në dritaren e dyqanit, pra një fustan specifik)

Ana donte të blejë një fustan. (s'ka rëndësi se çfarë fustani, pra një fustan jospecifik)

Për fat të keq, dhe siç është fare e zakonshme në punime shkencore të këtij lloji, shembujve të Tomić-it u mungon konteksti gjuhësor për të vlerësuar se në ç'masë ndikon faktori i specifitetit në përdorimin e formave të patheksuara. Për këtë arsye si dhe për faktin se nuk sjell asnjë tjetër argument bindës në të mirë të mendimit të saj, mund t'i konsiderojmë shembujt e saj po aq mirë si dëshmi për faktorit kryesor *theks logjik* sipas Kallullit etj. (shih më poshtë) duke e shpjeguar përdorimin e formave të patheksuara në këtë mënyrë:

Ana donte ta {blejë një fustan}_F. (Çka donte të bëjë Ana?)

Ana donte të blejë një {fustan}_F. (Çka donte të blejë Ana?)

shpjegimi rimarrja e kundrinës së drejtë ndodh nëse a) kundrina e drejtë është pjesë e temës së fjalisë dhe b) nëse theksi kryesor (gjerm. *Hauptakzent*)⁸ nuk bie mbi kundrinën e drejtë. Megjithatë, Buchholz (1977: 192) cek që ky shpjegim nuk vlen për të gjitha rastet pa rimarrje të kundrinës së drejtë⁹.

Sot e kësaj dite është pranuar në përgjithësi që rimarrja e kundrinës së drejtë (në vetën e tretë) varet kryesisht nga vendosja e theksit logjik (Kallulli 2000: 217; Agalliu et al. 2002: 227); sipas këtij shpjegimi përjashtohet rimarrja nëse theksi logjik bie mbi kundrinën e drejtë.¹⁰ Për të pasqyruar këtë rregullsi, marrim shembullin e sjellë nga Kallulli (2002: 218): *Ana (e) lexoi librin*. Vendosja e klitikës *e* në këtë rast varet nga qëllimi i folësit për të theksuar veprimin e të lexuarit (*e* librit) ose vetëm librin, gjë që pasqyrojnë pyetjet pararendëse, të cilat krijojnë edhe një kontekst gjuhësor.

(5a) *Çfarë lexoi Ana?* *Ana (*e) lexoi {librin}F.*

(5b) *Çfarë bëri Ana me librin?* *Ana *(e) {lexoi}F librin.*

Për më tepër, kjo shpjegon edhe pse rimarrja e përemrave pyetës *ke* dhe *çka* është e pamundur si p. sh. në: *Ke (*e) ke parë?* dhe *Çka (*e) ke parë?*. Nëse e rikujtojmë hierarkinë e D-së, shohim që faktori *frymor/animat (ke) – jofrymor/jo-animat (çka)* zë një pozicion fare të ulët në hierarkinë në fjalë, kështu që edhe ndikimi i kategorisë së animacitetit rezulton të jetë i paqenë – të paktën në gjuhën shqipe standarde.

3. Rimarrja e kundrinave në të folmet e gegërishtes verilindore

3.1. Përzgjedhja e korpusit

Duke pasur parasysh arealin mjaft të madh ku fliten të folme të ndryshme të gegërishtes verilindore dhe zonave kalimtare ku gjejmë të folme që, përveç veçorive të gegërishtes verilindore, ndajnë edhe tipare të gegërishtes veriperëndimore dhe qendrore, kuptohet vetvetiu se një paraqitje e detajuar e rimarrjes së kundrinave në arealin shqipfolës në fjalë kërkon kërkime gjithëpërfshirëse brenda kësaj hapësire. Megjithatë, qëllimi kryesor i këtij studimi në fillim është që të paraqiten në vija të

⁸ Është e vështirë të përcaktohet se në ç’kuptim përdoret termi *Hauptakzent* (‘theks kryesor’) në gramatikën e tyre, por pas gjithë gjasash është fjala për theksin logjik (angl. *focus*, gjerm. *Fokus*).

⁹ Ndër të tjera, sjell këtë shembull: *Atëherë bretku u zhyt në ujë; pas pak doli përsëri dhe hodhi në bar topin e artë.*

¹⁰ Kam vënë re që nuk qartësohet dallimi mes *remës* dhe *theksit logjik*, sidomos në lidhje me rimarrjen e kundrinave në gjuhën shqipe. Edhe pse në shumicën e rasteve theksi logjik bie mbi remën, pra informacionin e ri, kjo nuk do të thotë që s’ka raste kur tema, informacioni i vjetër, mund të bart theksin logjik.

trasha dallimet kryesore në përdorimin e trajtave të shkurtra në të folmet e gegërishtes verilindore përkundrejt gjuhës standarde. Kjo tumirte plotësisht që të përqendrohesha, si fillim, vetëm në një areal më të kufizuar brenda kësaj hapësire të madhe dhe të mos i përfshija dallimet që ekzistojnë mes të (nën-)dialekteve të ndryshme të gegërishtes verilindore, të cilat ka gjasë që shtrihen edhe në rrafshin sintaksor (rimarrja e kundrinave). Si të folme rajonale për studimin tim përzgjedha të folmen e Drenicës, këtë për dy arsye kryesore: 1. Drenica gjendet pak a shumë në qendër të Kosovës, rrjedhimisht e folmja që flitet në këtë rajon mund të konsiderohet pak a shumë si përfaqësuese për gegërishten verilindore që flitet në Kosovë. Një përzgjedhje e tillë sigurisht që e kufizon vlefshmërinë e rezultateve të nxjerra vetëm brendapërbrenda Kosovës duke anashkaluar të tjera të folme të gegërishtes verilindore që fliten në Shqipëri dhe Maqedoni. 2. Për më tepër dhe për fat të mirë kemi një numër mjaft të madh tregimesh popullore nga Drenica, të vjela dhe shkruara, ndër të tjerë, nga Anton Çetta.

Janë pikërisht tregimet nga libri *Prozë popullore nga Drenica I* (1990, Anton Çetta) që janë përdorur si korpus për këtë studim. Janë analizuar gjithsej gjashtë tregime, të cilat listohen në tabelën poshtë, ku shënohet edhe numri i fjalëve për secilin tregim:

Tregimi	Fjalë
Gjarpni dhandërr	1128
Jetimja	1401
Vllau kapruell	922
Çavër, Çavër, Çelma Derën	431
Breshka nuse	408
Breshka nuse 2 (motërzim)	1515
Gjithsej	5805

Përdorimi i këtyre tregimeve për të nxjerrë informacione paraprake në lidhje me rimarrjen e kundrinave në gegërishten verilindore arsyetohet me autenticitetin e këtyre teksteve. Të gjitha tregimet janë shkruar në të folmen përkatëse vendëse; tek-tuk mund të vërehen disa ndërhyrje ortografike, fonologjike dhe gramatikore nga ana e autorit, por që këto nuk shkojnë aq larg sa për të vënë dyshim faktin që autori është përpjekur të ruajë stilin e tregimit gojor. Saktësia e autorit dëshmohet sidomos në shënimin e trajtave të patheksuara përemërore në tekst, madje edhe në ato raste, ku ato paraprihen nga një tingull me vlerë të njëjtë fonetike, si në: *Grueja e përbejti me e qitë likurën n'zjerm* (Gjarpni dhandërr); *Kur ja dha lamsbat njerkeës, kësaj i erdh çudi qysh kish mujtë me e punu aq mirë Jetimja e vogël*. (Jetimja) etj.

3.2. Rimarrja e kundrinës së zhdrejtë

Lidhur me rimarrjen e kundrinës së zhdrejtë të dhënat nuk dëshmuajnë ndonjë dallim nga gjuha standarde: Në të gjitha rastet kundrina e zhdrejtë u shoqërua nga një formë e patheksuar; khs. shembujt në vijim:

- 5) Kur ja dha lamshat njerkes, **ksaj i** erdh çudi qysh kish mujtë me e punu aq mirë Jetimja e vogël. (Jetimja)
- 6) Shkoi vllau i parë e **j-a** lypi çikën **begut** e begu ja dha. (Breshka nuse)
- 7) **I** thot ni ditë plaka **plakut**: Masi s'kena evlad, a **i** lutmi **zotit** ne t'na e fal ni evlad? (Gjarpni dhandërr)

Duket se përgjithësimi i trajtave të shkurtra si mjete sintaksore për të shënjuar rasën dhanore ka qenë një zhvillim që ka përfshirë të gjithë arealin kompakt shqipfolës.

3.3. Rimarrja e kundrinës së drejtë – rezultate paraprake

Për sa i përket rimarrjes së kundrinës së drejtë vlejnjë të njëjtat kufizime që janë bërë për gjuhën standarde: Me interes na paraqitet vetëm përdorimi i trajtave të shkurtra të vetës së tretë, njëjës dhe shumës, ngase vetëm aty shfaqen luhatje përdorimi. Lidhur me vetat e tjera, korpusi nuk shfaq asnjë rast ku trajtat e shkurtra nuk e zënë vendin e përemrave përkatës ose i shoqërojnë ata në mënyrë redundante. Edhe këtu nuk mund të vërejmë asnjë dallim nga të folmet e tjera të shqipes apo shqipen standarde; khs. shembujt që vijojnë:

- 8) **M'**merrni edhe **mue** se une nuk dahna prej motre. (Vllau kapruell)
- 9) Kur u ba natë duel kaprolli n'stom t'detit e po bërtet: Zejnije, oj moter, **ty** t'ka shti n'deti artakja e t'ka përbi peshku, e tash edhe **mue** po do me **m'**pre. (Vllau kapruell)
- 10) Apet u çue djali e shkoi. I thot mreti: A e di pse t'kam thirrë? (Breshka nuse 2)

Përveç kësaj, duhen përjashtuar edhe ato raste ku kemi një rimarrje të një kundrine të drejtë në vetën e tretë, të cilat, në të gjitha dialektet e shqipes, s'janë të kushtëzuara nga faktorë pragmatikë (theksi logjik etj.), por paraqesin vetëm përdorimi të ngurtësuar frazeologjike. Në këtë mes duhet të përmendet sërish (khs. § 1.2) kushti bazal, sipas të cilit rimarrja varet nga ekzistenca e një artikulli në rrafshin morfologjik (paravendosur: *ni, do, disa* etj. apo prapavendosur: *-i, -u, -a, -ja, -t(ë)* etj.). Rrjedhimisht

ndërtime të shpeshta në korpus, të tipit: *ban mubabet, pin uj, ban selam* etj., nuk përfshihen në këtë analizë; këtë e dëshmon më së miri shembulli vijues:

- 11) Çohen nesrit, e baba **merr rrugë** pej shpije. Para se me u da, i tha begut: Sod ni javë vade, mik. **E merr rrugën** baba i gjarpnit. (Dhandrri gjarpën)

Për më tepër, trajtat e shkurtra duhet të kenë funksion rimarrës apo referencial, kështu shprehje idiomatike pa kundrinë koreferenciale, siç shihet në shembujt poshtë, konsiderohen si përdorime tërësisht të leksikalizuara (Friedman 1994: 103), të cilat si të tilla po ashtu nuk përfshihen në këtë analizë.

- 12) Begu **ja** ban për hajr (Gjarpni dhandërr)
 13) Hajt se ksaj pune kollaj **ja** bajmë. (Jetimja)
 14) Kta tuj mënuë se qysh me **ja** ba (...) (Vllau kapruell)

Dhe, së fundmi, mund të përjashtohen të gjitha rastet me një përdorim krejtësisht anaforik të trajtave të shkurtra, d.m.th kur ato zënë vendin e një referenti të përmendur më parë sepse një përdorim i tillë përkon krejtësisht me funksionet e zakonshme të përemrave vetorë; khs. shembullin vijues:

- 15) Goditet me ta për me ja ruejtë **gjanë** e krejt shehrit. Dit për dit **i** çojke n'mal edhe **i** bike si â ma mirë.

Pas kësaj përzgjedhjeje kemi një numër mjaft të madh prej 311 frazash¹¹, të cilat i përmbushin të gjitha kriteret. Distribucioni i tyre nëpër tekstet e analizuara pasqyrohet në tabelën vijuese:

	Tokens	Frazat që i përmbushin të gjitha kriteret	Me dublim
Gjarpni dhandërr	1128	51	49 ≈ 96 %
Jetimja	1401	87	81 ≈ 93 %
Vllau kapruell	922	48	42 ≈ 88 %
Çavër, Çavër, Çelma Derën	431	30	29 ≈ 97 %
Breshka nuse	408	17	16 ≈ 94 %
Breshka nuse (2)	1515	78	69 ≈ 89 %
	5805	311	286 ≈ 92 %

¹¹ Fraza në këtë rast konsiderohen të gjitha ndërtimet sintaksore, të cilat mund të përmbajnë format e patheksuar *e* dhe *i*. Bëhet fjalë pra për ndërtime me një formë të shtjelluar foljore, të tipit (KRYEFJALË) + FOLJE + KUNDRINË, por edhe për format e pashtjelluara foljore, si *me (e/i) pa, tu (e/i) pa* etj.

Nga 311 frazat që u analizuan, shfaqin 286 dublimin e kundrinës së drejtë, që bën një mesatare relative prej rreth 92 %. Një mesatare kaq e lartë është një evidencë që rimarrja e kundrinës së drejtë në gegërishten verilindore nuk është e kufizuar prej të njëjtëve faktorë si në gjuhën shqipe standarde, por lejohet në më shumë kontekste sintaksore.

Të dhënat dëshmojnë se, njashtu si në gjuhën standarde, rimarrja nuk kushtëzohet nga shquarsia morfologjike e kundrinës së drejtë; khs. shembujt që vijojnë, ku të gjitha kundrinat janë të pashquara:

- 16) Tuj ecë **e** gjetën **ni fërkem** t'kaprollit. (Vllau kapruell)
- 17) Dit mas ditsh ni mik i tyne n'kojshi **e** kish pa' bā **ni gosti t'madhe**. (Jetimja)
- 18) I luten zotit e **jau** fal zoti **ni djalë gjarpën**. (Gjarpni dhandërr)

Denduria e përdorimit të formave të patheksuara dëshmon se ato nuk kanë funksionin e të shënjuarit të theksit logjik mbi kundrinën koreferenciale. Edhe pse fakti që kemi vetëm tekste të shkruara, dhe jo transkribime të incizimeve të drejtpërdrejta, na pamundëson të bëjmë konstatime lidhur me intonacionin dhe pozicionin e theksit kryesor, prapë se prapë ka mjaft raste të njëkuptimshme ku shihet qartë që theksi logjik bie një kundrinë të drejtë, ndonëse ajo paraprihet nga një klitikë përemërore; khs. shembujt që vijojnë:

- 19) Ishin kanë pas tubue do çika me kallxu prralla. Tha njana: Kush nuk **e** din **asni prrallë**, i met' nana Larë.... (Jetimja)
- 20) Dit pej ditsh njerka ja dha **ni shllungë lesh** Jetimes edhe i tha (...) (Jetimja)
- 21) Vjen e ama e e sheh. Kur e pa, u gzue e dogri shkon tu plaku e po i kallxo edhe atij: Njeri, **e** kishim **ni evlad** qi s'e kish kush. Çu, shko e shihe me sy t'tul! (Gjarpni dhandërr)
- 22) I kan marrë të dy, kaprolli me gjithë motër, e i kan çue tu pasha. Pasha **e** kish pasë edhe **ni grue**. Kur e muer edhe kët çikën, pashës ju banë dy gra. (Vllau kapruell)

Njëkohësisht bëhet e qartë se dublimi nuk ndodh vetëm atëherë kur kundrina koreferenciale renditet si tema e fjalisë: në shembujt (20) deri (22) përmenden referentet *ni shllungë lesh*, *ni evlad*, si dhe *ni grue* për herë të parë në tregimet përkatëse, rrjedhimisht ato renditen si rema e fjalisë.

Por ka edhe mjaft raste pa dublimin e kundrinës së drejtë. Për t'i shqyrtuar ato na vjen në ndihmë hierarkia e D-së sipas Kiparsky-të, si dhe vështrimi i hollësishëm i përemrat pyetës *kë* dhe *çka*. Siç u shpjegua më lart, në shqipen standarde përemrat

pyetës *kë* dhe *çka* nuk mund të shoqërohen assesi nga një klitikë përemërore. Kjo përputhet deri diku edhe me të dhënat e teksteve të analizuara. Në të gjitha rastet me përemrin *çka* si kundrinë e drejtë, nuk ka dublim; khs. shembujt që vijojnë:

- 23) Dikur, para se me i nisë gjanë Jetimja kah shpija, çika e njerksës u nis e shkoi e i(...) kallxoi nanës vet krejt **ça** kish pa. Njerka u gzue qi e mur vesh se kush po ja punon Jetimes leshin e i tha t'bijës: (Jetimja)
- 24) Kur erdh burri n'mramje, e gjet t'shoqen ratë. E dveti: **Çka** (...) kie? (Jetimja)
- 25) Kur e çoi koritën, e gjet Jetimen aty nër koritë me disa tesha t'kqija. E veti: **Çka** po (...) ban ti ktu? (Jetimja)

Për fat të keq, tekstet nuk përmbajnë asnjë rast me përemrin pyetës *kë*, gjegjësisht *kân*. Por sipas introspeksionit, si dhe të pyeturit e folësve nga Kosova, del që përemri *kân* jo vetëm që mund të dublohet, por madje duhet të dublohet në të gjitha kontekstet sintaksore. Këtë e dëshmon edhe një kërkim fare i shpejtë nëpër korpusin kombëtare të gjuhës shqipe¹² dhe gazetave kosovare, ku gjenden mjaft shembuj me dublimin e përemrit pyetës *kë*; khs. shembujt që vijojnë:

- 26) Ndihmohen fëmijët e Drenicës: Ja **kë e** falënderon e **kë e** shan Milaim Zeka. (Kosova sot)
- 27) Por nuk e di se sa do të vazhdoj në këtë mënyrë. Por nëse një ditë zgjohem dhe ndjehem ndryshe rreth asaj se **kënd e** konsideroj tërheqës, atëherë e dua mbështetjen tuaj. (Zëri)
- 28) Sistemi jodemokratik zgjedhor i sjell zgjedhësit në pozitë që të mos e dinë **kënd e** zgjedhin, më mirë të thuhet për kënd votojnë, ndërsa delegatët që të mos kenë kujt t'i japin përgjegjësi për punën e tyre. (Spastrimet etnike: politika gjenocidale serbe ndaj shqiptarëve: shqyrtime, komente, elaborate, dokumente; Islami, Hivzi)

Nëse i vëmë këto të dhëna në relacion me hierarkinë e D-së, del që një faktor potencial për dublimin e kundrinës së drejtë në gegërishten verilindore mund të kërkohet tek dallimi i kategorive *frymor/animat-jofrymor/inanimat*. Shumica e rasteve të tjera pa dublim të kundrinës së drejtë flet në të mirë të këtij shpjegimi, khs. shembujt që vijojnë:

- 29) Kap **shtagën** baba e shko tu begu. (Gjarpni dhandërr)

¹² <http://web-corpora.net/AlbanianCorpus/search/>

- 30) **E** muer Lara **leshin** edhe e tor me brinat e veta, e bani lamsh e ja dha. Jetimja u gzue, muer **lamshin** e, dikur kah akshami, nisi me i çue lòpt kah shpija. (Jetimja)
- 31) Dikur i ra n'men qi ishin mushë tri javë qysh se i kish shti nën prag eshtnat e Larës. Shkoi me i nxjerrë e n'ven t'tyne gjeti **ni sanek plot me tesha t'mira**. (Jetimja)
- 32) Jan shkue e jan fsheh ushtarët, e halla ka marrë **ni qerep, ni sanxhak e ni tepsi me mill**. Ka ardhë përfuni lisit edhe e ka dhezë zjermin e po don me ba bukë. (Vllau kapruell)

Përfaqësimi leksikor dhe sintaksor i kategorisë universale gjuhësore të animacitetit në gjuhën shqipe në korpus mund të pasqyrohet – në mënyrë të thjeshtësuar – në këtë skemë:

Kategori gjuhësore	Human	Animate	Inanimate
Përfaqësimi leksikor	<i>kân (kë)</i>	<i>çka, çfarë</i>	
Përfaqësimi sintaksor	me dublim	me ose pa dublim	

Megjithatë, luhatjet e dukshme, si p. sh. në shembullin (31) ku *leshin* dublohet, ndërsa *lamshin* jo, tregojnë se jo të gjitha njësitë me veçorinë semantike [jofrymor/inanimat] nuk dublohen në pozicionin sintaksor të kundrinës së drejtë. Ka gjasë që në këtë kategori emrash përdorimi i klitikave përemërore u nënshtrohet rregullave pragmatike të ngjashme si ato që janë në fuqi edhe në shqipen standarde, duke e bërë dublimin vetëm atëherë të domosdoshëm nëse kundrina e drejtë është temë ose nuk bart theksin logjik të fjalisë. Korpusi nuk lejon të bëjmë konstatime përfundimtare.

Në fund dhe për hir të plotësisë duhen cekur edhe ato raste pa dublim, të cilat nuk mund të shpjegohen me hipotezën e mësipërme, të cilat janë:

- 33) Ni natë shkoi me e rue mullinin jetimja qi s'kish **kërkan**. (Çavër, Çavër, Çelma Derën)
- 34) Ni burrë kish pasë **ni djalë e ni çikë**. Grueja i kish pas dekë e thmitë kishin metë jetima. Mas do kohe ky burri muer **ni grue tjetër**. Njerka nuk i dojke hiç thmitë e t'shojt. Ish kanë e shtirë shum. (Vllau kapruell)

Sidomos shembulli (34) bie në sy, duke qenë se në të gjitha rastet e tjera në tekste me formulime të ngjashme (*kishte një djalë, vajzë* etj.), ndodh rimarrja e kundrinës, si në:

- 35) Ish kanë ni grue tu jetu n'ni shpi'e e kish pasë **ni çikë**. **E** kish pas majtë n'shpi edhe **ni çikë jetime**, t'pa nanë e t'pa babë. (Çavër, Çavër, Çelma Derën)

Këto raste kërkojnë studime më të hollësishme mbi bazë të një korpusi më të gjerë.

4. Përfundim

Edhe pse rezultatet e nxjerra nga analiza e korpusit nuk lejojnë konkluzione përfundimtare lidhur me kriteret funksionale të rimarrjes së kundrinave (të drejta) në gegërishten verilindore, ose të paktën në të varietetin e Drenicës, u qartësua kahja e zhvillimit të veçantë që ka ndodhur në zonat verilindore të arealit kompakt shqipfolës, i cili shkon drejt një përdorimi të domosdoshëm të klitikave përemërore në të gjitha kontekstet sintaksore. Siç na dëshmojnë autorët e vjetër, një zhvillim i tillë ka ndodhur në tërë arealin kompakt shqipfolës me format e shkurtra të dhanores. Meqë tek shkrimet më të vjetra gjejmë disa shembuj pa dublimin e formave të plota përemërore të kallëzores: *mua, ty, ne, ju* (Sh. Demiraj 1985: 588), diçka që sot është e pamundur, tregon se ky zhvillim ka rrokur deri një masë të caktuar edhe format e shkurtra të kallëzores. Më të qëndrueshme ndaj këtij zhvillimi u treguan ato të vetës së tretë të kallëzores: Në gjuhën shqipe standarde përdorimi i tyre u nënshtrohet si gjithnjë rregullave të caktuara pragmatike, ndërsa në dialektet verilindore është e vështirë të përcaktohen rregulla të prera, të paktën mbi bazë të korpusit të përdorur. Megjithatë, rezultatet tregojnë se një faktor vendimtar mund të gjendet tek dallimi kategorial *frymor-jofrymor* duke lejuar mosvënien e klitikave përemërore vetëm në rast se referenti përkatës shfaq veçorinë semantike [jofrymor]. Analiza të mëtutjeshme të një korpusi më të gjerë, duke përfshirë edhe materiale nga gjuha sotme, do të sjellin një përgjigje përfundimtare.

Referenca

- Agalliu, Fatmir; Demiraj, Shaban; Domi, Mahir (2002): *Gramatika e gjuhës shqipe*. Tiranë: Botimi i Akademisë së Shkencave.
- Bošković, Željko (2008): „What will you have, DP or NP?“ In: North East Linguistic Society (NELS) 37, ed. by Emily Elfner and Martin Walkow, 101-114. Amherst, MA: Graduate Linguistic Student Association of the University of Massachusetts at Amherst.

- Buchholz, Oda (1977): *Zur Verdoppelung der Objekte im Albanischen*. Linguistische Studien. Reihe A. 34. Berlin.
- Buchholz, Oda; Wilfried Fielder (1987): *Albanische Grammatik*. 1.Auflage. VEB Verlag Enzyklopädie Leipzig.
- Çetta, Anton (1990): *Prozë popullore nga Drenica*. Vëllimi I. Mitrovica: Ndermarrja Grafike „Progres – Svetozar Gjorgjeviq”.
- Demiraj, Shaban (1985): *Gramatike historike e gjubës shqipe*. Tiranë: Shtëpia Botuese „8 Nëntori”.
- Dilo Sheperi, Ilia (1927): *Grammatika dhe sindaksa e gjubës shqipe sidomos e toskënishtes (për shkolla të mesme)*. Vlorë.
- Friedman, Victor A. (1994): „Variation and Grammaticalization in the Development of Balkanisms”. In: CLS 30 Papers from the 30th Regional Meeting of the Chicago Linguistic Society, Volume 2: The Parasession on Variation in Linguistic Theory. Chicago: Chicago Linguistic Society. 101-115. (Reprinted in *Studia Albanica*, Vol. 32, 1995-99, 95-110).
- Friedman, Victor A. (2006): „Balkans as a Linguistic Area”. In: Keith Brown, (Editor-in Chief): *Encyclopedia of Language & Linguistics*. Second Edition. Bd.1. Oxford: Elsevier. 657-672.
- Givón, Talmy (1976): „Topic, Pronoun and Grammatical Agreement”. In: Charles Li (ed.) *Subject and topic*. New York: Academic Press. 149-188.
- Kallulli, Dalina (2000): „Direct object clitic doubling in Albanian and Greek”. In: Frits Beukema & Marcel den Dikken (eds.) *Clitic Phenomena in European Languages*. [Linguistik Aktuell/Linguistics Today 30] 209-248. Amsterdam: John Benjamins.
- Kiparsky, Paul (2008): „Universals constrain change, change results in typological generalizations”. In: Jeff Good, (ed.): *Linguistic universals and language change*, OUP.

Bahri KOSKOVIKU

STRUKTURA DHE FUNKSIONET GRAMATIKORE TË SINTAGMËS PARAFJALORE NË GJUHËN SHQIPE

1.Hyrje

Në këtë punim shkencor mëtojmë të përshkruajmë strukturën dhe funksionet gramatikore të sintagmave parafjalore të shqipes, sipas modelit sintaksor që mbështetet në teorinë e strukturës së sintagmës. Sipas këtij modeli të analizës sintaksore, do të vihet në dukje natyra e objekteve që përzgjedhin parafjalët, duke bërë klasifikimin e tyre nga aspekti strukturor, semantik dhe funksional.

Nga ky këndvështrim sintagmat parafjalore të shqipes vështrohen si një kategori e veçantë sintagmatike në strukturën hierarkike të fjalisë. Struktura e tyre themelore përbëhet nga një parafjalë që është elementi bazë i sintagmës, në funksion të kokës sintaksore dhe nga një plotës i detyrueshëm i saj.

Sikundër dihet, në traditën sintaksore të shqipes, përshkrimi i njësisve sintaksore bëhet sipas analizës që mbështetet në *teorinë e togfjalëshit*. Ky model i përshkrimit gjuhësor, duke pasur parasysh *përparësinë e përmbajtjes ndaj formës*, (Gramatika e Akademisë, 2002:59), *funksionin* e shih si tiparin më të rëndësishëm të një fjale, si element përcaktues mbi bazën e të cilit bëhet edhe klasifikimi i njësisve sintaksore në shqipe, ndërsa anën formale – strukturore e vë në plan të dytë. Brenda këtij kuadri teorik, parafjalët përkufizohen si fjalë shërbyese që shprehin marrëdhënie sintaksore varësie midis dy gjymtyrësh të një togfjalëshi apo fjalie (Gramatika e gjuhës shqipe I - Morfologjia, 2002:381).

Përkufizimi i togfjalëshit sipas skemës së Floqit si *bashkim i së paku dy fjalëve kuptimplote*, (Konferenca e Dytë Albanologjike, 1968), pohimi i Çelikut se objekt i studimit të sintaksës janë vetëm fjalët emërtuese (*Sintaksë e Gjuhës Shqipe – përbërësit sintaksorë*, 2012:16)), i Domit se struktura e një togfjalëshi karakterizohet vetëm nga fjalë kuptimplote (Vepra 1. Studime sintaksore: 123), siç pohon L.S. Rugova, përjashton ndërtimet me parafjalë të tipit: *me fustan, nën urë, në fshat, mbi tavolinë, pa droje, për fitore* etj. të cilat përbëjnë bazën e studimeve strukturaliste gjuhësore në sintaksë. (Konferencë shkencore kushtuar Agna Desnickajës, 2012:2).Rrjedhimisht, mospranimi

i ndërtimeve parafjalore në shqipe buron pikërisht nga ky koncept që mbështetet në këto argumente:

- a. Parafjalët nuk janë fjalë më vete nga pikëpamja e funksionit në rrafshin sintaksor.
- b. Kuptimi i tyre kushtëzohet nga një fjalë tjetër, zakonisht nga një emër apo fjalë e emëruar.
- c. Nuk janë fjalë emërtuese - nuk kanë marrëdhënie reference me realitetin objektiv, tipare këto që e karakterizojnë konceptin e një gjymtyre.

Sipas këtij përkufizimi, ndërtimet parafjalore nuk mund të jenë një kategori sintaksore më vete, sepse nuk përmbushin asnjërin nga kushtet e mësipërme, rrjedhimisht atyre nuk u njihet aftësia për të qenë element përcaktues në strukturimin e një njësie sintaksore. Por, nga ana tjetër, tërhiqet vërejtja se *nuk duhet menduar se parafjalët janë të zhveshura krejtësisht nga kuptimi leksikor, edhe po të vështrohen jashtë togfjalëshit*, (Gramatika e gjuhës shqipe 1- Morfologjia, 2002:382), porse ky kuptim, siç thuhet mësipër, është i kushtëzuar nga një fjalë tjetër, kryesisht nga një emër apo një fjalë e emëruar, e në kushte të caktuara sintaksore edhe nga një mbiemër a ndajfolje. Pra në ndërtimet: *në fshat, në rrugë, drejt shtëpisë*, dhe të tjera si këto, parafjalët vështrohen thjesht elemente në rolin e një konektori ndërmjet dy gjymtyrësh të një togfjalëshi, kurse emrat na dalin elemente kryesore në rrafshin semantik dhe atë gramatikor. Praktikisht funksioni i parafjalëve është i ngjashëm me atë të një lidhëze funksionale që shpreh vetëm raporte nënrenditëse në një fjali të përbërë.

Nëse i analizojmë elementet përbërëse të një SP-je, do të shohim se parafjala është elementi bazë që përcakton strukturën e kësaj njësie sintagmatike edhe në rrafshin semantik, p.sh: *E hudhim në votim amandamentin, kush është për (propozimin) dhe kundër (propozimit)*. Parafjalët *për* dhe *kundër* janë elemente vendimtare nga pikëpamja e kuptimit në realizimin e këtij veprimi, nëse do të miratohet ose jo një *amandament* dhe jo emri *propozim*, i cili në pikëpamje të kuptimit është neutral. Në vazhdim japim disa shembuj të tjerë për ta shtjelluar më tej këtë ide: *mbi apo nën tavolinë, afër apo larg shtëpisë, brenda dhe jashtë shkollës, me apo pa ty*. Në të gjithë shembujt e dhënë, parafjalët janë ato që ndërtojnë raporte antonimike, kundërvënëse nga pikëpamja e kuptimit dhe jo emrat kuptimisht neutralë.

Duke i vështruar SP-të si një koncept strukturor, duke i parë parafjalët në funksion të kokës sintaksore, mund të themi se ato nuk kushtëzohen apo varen nga objektet e tyre, siç interpretohen në gramatikat shqipe në përgjithësi, përkundrazi nga pikëpamja sintaksore relacioni është i kundërt: objektet varen nga koka parafjalore si elementi bazë i sintagmës. Ky realcion i parafjalës me plotësorët e saj duhet

interpretuar si aftësi e parafjalëve për të përzgjedhur tipa të ndryshëm plotësorësh, një veti kjo e çdo koke leksikore. Thënë më saktësisht, në një SP plotësori është element i detyrueshëm, sepse këtë e kërkon valenca e parafjalëve. Prandaj, përdorimi i termit *emër parafjalor* në shumë gramatika të shqipes edhe sot, mendojmë se është i gabuar, sepse syjeron emrin si elementin me peshën kryesore dhe jo parafjalën si qendër të sintagmës.

Përpara se të bëjmë kategorizimin e SP-ve në nivele të ndryshme përshkrimi, mendojmë se do të ishte e rëndësishme të vëmë në dukje disa nga vetitë e parafjalëve si elementi bazë i sintagmës:

- a. Parafjalët kanë aftësinë për të shenjuar funksionin e një sintagme tjetër, gramatikusht të varur nga koka parafjalore. A. Martinet i quan monema funksionale, *monemat që shërbejnë për të shenjuar funksionin e një moneme tjetër* (Elemente të gjuhësisë së përgjithshme, 1974: 143).
- b. Parafjalët kanë aftësinë të përzgjedhin tipa të ndryshëm komplementësh, njësoj si çdo kategori tjetër leksikore në përbërjen e një sintagme.
- c. Parafjalët, duke qenë njësi të kuptimshme të gjuhës, përcaktojnë funksionet semantike të plotësorëve të tyre.

Konsiderojmë se këto tri elemente duhen parë të ndërlidhura mes vete: parafjalët nuk mund t'i caktojnë rasë një elementi që nuk është përzgjedhur prej tyre, por një elementi të përzgjedhur prej parafjalës dhe, rrjedhimisht, duke qenë i përzgjedhur nga parafjalët, ato u caktojnë role semantike plotësorëve të tyre.

Duke iu përmbajtur koncepteve të analizës mbështetur në teorinë e sintagmës do të përshkruajmë strukturën dhe funksionet e sintagmës parafjalore në shqipe në rrafshin strukturor, semantik dhe funksional

2.1. Klasifikimi strukturor

Në rrafshin strukturor, mbështetur në konceptin e fjalës drejtuese, parafjalët si kokë e sintagmës parafjalore mund ta drejtojnë një SE, SM, SNd, një caktuesor, një fjali të nënrenditur.

- a) një sintagmë emërore *Yt atë po zgjidhet për Prijës të ardhshëm. Suzana e kishte parë me sy të çakërritur.*
- b) një sintagmë mbiemërore; *Erdhëm për të mirë, s'ke pse frikësohesh, s'dubet të të shkojë mendja për të keq*
- c) Një sintagmë ndajfoljore *Ajo nuk dinte si t'i merrte ato fjalë. Herë i dukeshin për mirë, herë për keq.*

- d) Fjali të varura që kanë për bazë një folje të shtjelluar: *Ne ishim të përgatitura, përpara se të viniv hetuesit*
- e) Një sintagmë parafjalore: **Brenda në sallë** të stuatit i prisnin të tjera surpriza.
- f) Një sintagmë me vlerë zero Trimi hyri **brenda** (shtëpisë), kurse Agroni, i nervozuar doli **jashtë**
- g) Një sintagmë, *koka e së cilës është një morfemë me vlerë emërore apo një fjalë e emërzuar. Ajo kishte kohë që nuk ishte takuar me të dhe nuk i pëlqente nga unë të merrte informata. Atë e kishin propozuar për kryetar. Me këtë hapësin rrugët për të vepruar më tej. Me të tijtë jemi takuar që moti. Ishte e martë e egër, por që kishte ndërkaq brenda saj, një butësi që vinte prej së hënës. Ti përmende për mua fjalën tjetër. (Pasardhësi, I. Kadare)*

2.2. Klasifikimi semantik

Në rrafshin semantik sintagmat parafjalore të shqipes, varësisht edhe nga lloji dhe kuptimi i parafjalëve realizojnë role të ndryshme semantike:

- a. veprues: *Të gjitha hetimet ishin bërë nga hetuesia.*
- b. mjet: *Kishte mbërritur me një tren që do të besojë se qe krijuar enkas për të.*
- c. shoqërim: *kishte shkuar me miq në atë mbrëmje të çakërdisur.*
- d. vend: *Te dera ia kishte plasur vajit dhe nëpër shkallë tek rendte për në dhomën e saj, i dukej se lotët binin çurg. Herë- herë ajo vështrota nga tribuna qendrore.*
- e. kohë: *I gori baba, do ta merrte shpërblimin me vonesë.*
- f. mënyrë: *Suzana kishte dëgjuar me kryet ulur.*
- g. qëllim: *Do të shkoj për punën e djalit tim.*
- h. shkak: *Megjithatë ajo po flijojë për karrierën e babait.*
- i. *kuftizim: Atë mund ta shquajë nga pamja.*
- j. sasi: *Për një orë mbrijmë në Maliq. Për pak para nuk kërrus shpinën.*
- k. cilësi: *Djaloshi me bluzë të kaltër kishte treguar sekretin e saj.*
- l. kusht: *Me një këmbngulje më të madhe, do t'i detyrojmë të lëshojnë pe.*
- m. lëndë: shportë me rrush të zi
 - lejim: si i kanë ndërtuar këto mure pa mjetet e teknikën e sotme
 - mungesë: lexon pa syze
 - objekt: Foli për jetën e Xhuanit, studim për pjellorinë e tokës.
 - Subjekt: foli për veprën e De Radës.
 - veçim: ndër ta, shqubej Agroni.
 - origjinën: vij nga Skrapari.

3. Funkcionet strukturore sintaksore

Sintagmat parafjalore të shqipes, janë një kategori strukturore dhe duke i parë lidhjet e saj nga ky këndvështrim vëmë në dukje edhe funksionet e tyre gramatikore. Pra fillimisht bëhet kategorizimi me bazë strukturore, pastaj nënkategorizimi me bazë funksionale. Nga kjo pikëpamje SP kryejnë funksione të ndryshme sintaksore:

Modifikuesi: a) *Vajza me flokë kaqurrela, hodhi një vështrim të egër drejt tij.*

Komplement:

- plotësi predikativ: b) *Atë e dimë për mik të singertë. Genci ishte me shokë. Djali u bë me Shkollë. Mos u frikësoni, ato janë me mësuesin e tyre.*

- Kundrinor c) *U dhashë fëmijëve nga një karamele*

- rrethanor d) *Shkoj në fshat.*

Adjunkt:

- rrethanor: e) *Shkuam në fshat me makinën e xhaxhait tim.*

f) *Atë e shquaje nga pamja, kur ishte me shokë fliste me guxim.*

g) *Këtë veprim nuk e pritja nga Agroni.*

Përfundime

Sintagmat parafjalore të shqipes janë njësi strukturore e semantike që kanë po ato tipare që kanë sintagmat e tjera. Parafjala si koka e këtij përbërësi sintagmatik ka po ato tipare sikurse foljet, emrat, mbiemrat dhe ndajfoljet: aftësinë për të shenjuar funksionin e një sintagme gramatikusht të varur, aftësinë për të përzgjedhur komplementë dhe t'ua përcaktojë funksionet semantike objekteve të tyre të brendshme. Në të vërtetë, siç u tha mësipër, mbi këtë bazë përlligjet ekzistenca e ndërtimeve parafjalore në shqipe si një entitet i pavarur strukturor dhe njëkohësisht eliminon problemet dhe mangësitë që paraqet teoria e togfjalëshit.

Përkufizimi i gjymtyrëve është ai që bazohet në mëvetësinë e fjalëve emërtuese. Në të vërtetë, përkthyer me terma të gjuhësisë moderne ndërtimi *shkoj në...* është jogramatikor, për shkak se mungon argumenti që kërkon koka parafjalore *në*, por kjo nuk qon në konkludimin se parafjala *në* është e kushtëzuar nga një fjalë tjetër, më saktësisht kuptimi i saj. Por në konkludimin se parafjala *në* në këtë rast kërkon një emër që do të shenjojë një hapësirë, një destinacion, apo në të rrallë edhe një mjet për ta realizuar marrëdhënien e saj gramatikore.

Bibliografia

1. Grup autorësh (2002). *Gramatika e gjuhës shqipe I*. ASHSH, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë. Tiranë.
2. Grup autorësh (2002). *Gramatika e gjuhës shqipe 2*. ASHSH. Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë.
3. Prifti, Stefan (1971). *Sintaksa e gjuhës shqipe*. ETMMK. Prishtinë.
4. Domi, Mahir (1971). *Sintaksa e gjuhës shqipe*. ETMMK. Prishtinë.
5. ASHARSH (1995). Instituti i Gjuhësisë. *Gramatika e Gjuhës Shqipe (Morfologjia)*. Tiranë.
6. ASHARSH, (1997). Instituti i Gjuhësisë. *Gramatika e Gjuhës Shqipe II*.
7. Huddleston, Rodney and Pullum, Geoffrey (2007). *English Grammar*. Cambridge University press.
8. Çeliku, Mehmet (2012). *Sintaksë e gjuhës shqipe (Përbërësit sintaksorë)*. Tiranë.
9. Koleci, Flora dhe Turano, Giuseppina, (2011), *Hyrje në sintaksën gjenerative*, Tiranë, SHB e Librit universitar.
10. Graffi, Giorgio (2003). *Sintaksa*. Tiranë. SHB Dituria.
11. Agani, Hilmi (1975). *Ç' shoh të diskutueshme në çështje të teorisë së togfjalëshit*. Fjala. Prishtinë.
12. Martinet, Andre (1974). *Elemente të gjuhësisë së përgjithshme (përkthim nga Rexhep Ismajli)*. Prishtinë. Rilindja.
13. Linditë Rugova, Bardh Rugova, (2012). *Sintagmat parafjalore të shqipes* (Konferencë shkencore kushtuar 100-vjetorit të lindjes së Agna Desnickajës). Shën Petërburg. Rusi.

Afërdita KASOLLI

CLEFT SENTENCES IN THE SUBJECT POSITION AND EXTRA-POSED SUBJECT

0. Abstract

This research investigates the topic - comment arrangement of the constituent elements in a clause or a sentence. In order to be able to analyse the information conveyed, the speaker/listener must master the knowledge of English and Albanian language at the same time, so that one can contrast and compare the common phenomenon of the two languages. The theoretical part will be given alongside the empirical research in which the comparison and contrastive analysis will be given regarding the selected corpus. Hence, the research will investigate the importance of the word order in both languages focusing mainly in the complex sentences in which *THAT* clause is basically post position due to the presence of the *IT* subject or *DUMMY* subject as some grammarians refer to it. Hence, the subject position as well as extra- posed subject will take the main part of the research focusing mainly on the linguistic syntactic structure.

The most important part of this research is to presents the results of the similarities and differences regarding the topic-comment or comment - topic syntactic structures of English and Albanian sentences.

Key words: cleft sentences, subject clauses, extraposed subject clauses.

1. Introduction

A sentence consists of two or more clauses. In complex sentences consist of two or more clauses (a main clause and a subordinate clause) with a non symmetrical relation among them (NuhIU (2012:125). According to Huddleston and Pullum (2007:174) subordinate clauses characteristically function as dependent within some larger constructions. The next higher clause in the structure is called the matrix clause. Thus, in the complex sentence a cleft clause is a constituent element or part of the matrix sentence. Subordinate clauses have different structures and may have different functions in a sentence (like subject clauses, object clauses, complement clauses,

adverbial clauses and modifiers), thus the research will focus mainly on the functions of that clauses, paying greater details to the function of a subject and extra-posed subject expressed by means of *that* clauses. The aim of this research paper is to find out the cleft sentences in the function of the subject that basically take the initial position within a sentence which is considered to be the normal position for a subject. Despite taking the initial position subject clauses in English may also be postponed to the final position of the complex sentence that are referred to as extra posed subject leaving an empty space for the IT impersonal subject. In this case the subject is moved from its normal position to the final position of a sentence. Therefore, the research seeks to verify the hypotheses below:

What is the word order of the topic- comment arrangement constituent elements in a sentence?

In order to verify the hypothesis, the research requires an investigation and exploration of the syntactic field in order to give answers to the following research questions:

If *that clauses* can be modifiers of various constituent elements, which elements do they modify?

Can a subordinate clause take the extra-posed subject position in English and Albanian?

In which functions of *that clause* is the topic-comment arrangement used?

1.1 Research methodology

To conduct a research a wide and appropriate methodology is required; hence this research methodology will be divided into several stages. Firstly, the theoretical description and definition is required and it will be selected from books listed in the reference list. Hence, the quantitative method will be used for the theoretical framework. Having selected the theory, the research will use the inductive and deductive methods for finding the examples of *that clauses* in the function of the subject and extra-posed subject. The examples will be taken for the novel “Steppenwolf” written by Herman Hesse (as the translation in English is considered to be a good translation). After the identification of the examples in the corpus, the analysis of the examples will take place. *That clauses* will be analyzed regarding the structure and their function within the sentences. Hence, a combination of the qualitative and quantitative method will be applied in the research.

2. Theoretical description

Cleft sentence is a sentence in which an element is emphasized by being put in a separate clause, with the use of an empty introductory word such as *IT* or *THAT* (Crystal D. 2008:79). He describes it as a grammatical construction in which a clause can be divided into separate sections each with its own verb. Hence, it can be redefined that a cleft sentences is a way of emphasizing a word or words by reordering the information in a sentence. For example, sentences like:

- | | |
|---------------------------------|--|
| 1. A) It is money we want. | 2. A) We want money. |
| B) It was today that I saw him. | B) I saw him today. / Today I saw him. |

In these sentences the subject is removed from its normal position to leave an empty space for the dummy subject which is fulfilled with an empty subject/ impersonal *IT*.

As can be seen in sentences 1A and 1B we have complex sentences, whereas sentences 2A and 2B are simple sentences/ clauses based on their syntactic structure even though the meaning they convey is rather similar than different. It is the emphasis that a speaker emphasizes to different information conveyed in the sentence, which makes a sentence have a specific word order, either by placing the topic-comment arrangement or comment- topic arrangement of the constituent elements of a sentence.

2.1 Topic-comment or theme-rheme arrangement in a sentence

According to Werlich (1983:26) the initiating thematic text base is usually established in the subject slot of the sentence, which contains the ***theme (given information)*** whereas, the other constituent elements that follow the subject, which are predicator, complements and adjuncts, contain the ***rheme (the new information)*** of the sentence. ***Theme*** is the ***topic*** of the sentence whereas ***rheme*** is the ***comment*** of the sentence. While topic is related to subject, comment is related to the predicate (including all other constituent elements despite subject, like predicator, complements, and adjuncts). The same attitude has got Downing (2006:240) as well regarding *theme* and *rheme*. The information contains an obligatory “new” element which is associated with the focus of information. There can also be optional “given” element of information which is associated with the rest of the tone unit. The given element is concerned with the information that the speaker represents as recoverable by the hearer, either from linguistic co-text, that is what has been said before, or because it

can be taken as “known” from the context situation or the context of a culture. The new element is concerned with whatever information the speaker presents as not recoverable by the hearer (Halliday & Hasan, 1976:27). Basically the theme takes the initial or subject position which is followed by the rheme.

Theme/Given	Rheme/NEW	
Jim has bought	a new CAR.	<i>-It is a new car that Jim has bought.</i>
Jamie has got	CHICKEN- POX	<i>It is the Chicken Pox that Jamie has got.</i>
That she is the best dancer is a fact.		<i>-It is a fact that she is the best dancer.</i>
That you missed my performance	is really a disappointment.	<i>-It is really a disappointment that you missed my performance.</i>

As indicated in the sentences below written in italics, all sentences can place the rheme in the initial position which is followed by theme which is made possible by the usage of dummy subject. Hence, the examples support Rugova (2015:120) statement who claim that it is not obligatory for a subject to express the topic. In English the object takes the subject position and expresses the topic of the sentence.

2.2 Dependent *That* clauses in English

According to Downing the subordinate status of a finite dependent clause is normally signaled by means of subordinate conjunctions (subordinators) such as: that, which (in relative clauses) when, before, as (in circumstantial clauses).

Mary took one of the umbrellas *that her mom bought in the morning.* (that relative clause)

As soon as she arrived in London, Ann phoned her mother. (circumstantial clause)

Nominal clauses fulfill the function of a subject, object and complement in clause structure (Downing, A. 2006:14). If the sentence *He saw that the bottle was empty* is analyzed the clause *that the bottle was empty* is a nominal clause and in the given example it is a direct object clause. Being a part of a sentence, nominal clause becomes constituent elements of a sentence.

Even though the relative clause and *that* clause look superficially quite similar, in fact they are quite different. The *that* clause which complements a noun is a content clause, not a relative clause. *That* is not normally omitted from complement clause.

The news (that) we received was worse than expected. *Relative clause admits zero connector*

The news *that the President has fled the country* was expected. – *that* complement clause

While relative clauses can modify all types of nouns, complement clauses are dependent on a relatively small number of abstract nouns such as: *fact, belief, suggestion, hope, idea, expectation, wish*. These can take a content clause as a dependent, whereas general nouns like *house, bicycle, institution* can take only relative clause.

According to Dhima (2005:156) a subordinate *that* clause is a sentence in which the subordinate clause initiates or clarifies the meaning of the basic part of sentence where it may function as a subject clause, direct object clause, and of a complement clause within a sentence.

When the verb is **intransitive** or **passive verb** the clause functions as a **subject clause**, when the verb is **transitive** verb the clause becomes **direct object clause**.

Based on the linking device the subordinate sentence structure may be of two types: the conjunctive type (which uses conjunctions like *që, se, në, nëse, sikur*, and zero conjunction) and pronoun or synthetic type (which uses indefinite relative pronouns like: *kush, cili, ç, çfarë, sa*)

Iu kujtua **se** *prindërit do të shkonin për një urim fejese*. – conjunctive type- *se*

He recalled *that parents would go to an engagement congratulation*. –*that* relative pronoun

Le të marrë **cilën** *e pelqen*. –pronoun/synthetic type

Let him get *which one (the one) he likes*.- pronoun which one or zero conjunction

There are different types of nominal clauses functioning as different constituent element of a sentence.

That clause - *That the night was cold in July* was a surprise to him. –subject clause

It has already been proven *that she is a wise girl*. –extra-posed subject cl.

Wh-nominal relative clause -He told me *what I already knew*. –DO clause

Dependent **wh** interrogative clause - *Whether he will come on time* is not known yet. –subject clause

That clauses sometimes may drop the subordinator/ complementiser and the meaning does not alter. According to Downing (2006:103) the omission of *that* happens:

a) when the verb of the main clause is the mono-transitive verb *Say* or *think* for ex. *I think (that) he is nice*.-DO cl.

b) when the subject of the main and subordinate clauses refer to the same entity, as in the example -*Tim promised (that) he would do it*. –DO cl.

c) when there is a pronoun rather than a noun in that clause, - She knew (that) *he would do it.* -DO cl.

2.2.1 That clauses in Subject position

The subject clause is also considered to be equal to any noun phrase that basically functions as a subject. Therefore, the dependent or subordinate clauses that perform the function of a subject in a complex sentence are called subject clauses (Nuhiu, 2012:130). While subject can be expressed by various means such as, relative that clause, *mb* clause, dependent questions, introductory there, finite and non finite clause, the focus will be mainly on the pattern of that clause. One of the main features of the subject clause is that it normally takes the initial position of a complex sentence and it precedes the predicator and any other optional constituent element of the main clause. Considering the below example:

That she was angry was evident.

Që ishte e zemruar ishte e dukshme.

Ishte e dukshme *se/që* ishte e zemëruar.

In both languages the same sentence may take the initial position. The difference is that in Albanian language the subordinate clause can only use the conjunction *që* in initial position; whereas when positioned in the final position of a complex sentence the dependent clause may either use the conjunction *që* or *se* which does not affect the meaning or the word order.

2.2.2 That clauses in extra-posed subject position

Sometimes the subject of a sentence is shifted from its normal (initial) position beyond the predicator, to the end of the sentence. Such linguistic phenomenon is called *extraposition*. In cases like this, the usual place of a subject is filled by the so-called *anticipatory, introductory or dummy subject IT*. (Nuhiu, V. 2012:131) The extraposed subject is allowed when the real subject is an infinitive clause, gerundial clause or that clause.

It is embarrassing *to hear what he says*.

It is strange *seeing you with him*.

It was a good idea *that I applied in the Seminar*.

That clause in the function of extra-posed subject is quite often found with the syntactic constructions with the copular verb **to be + adjective/noun/predicator +that clause**. Some of the verbs used are *be found, be known, be assumed, be said, be*

shown, etc. Basically, these constructions are followed by *that* clauses which function as extra-posed subject.

It will be found soon *that he lied to her*.

It had been known *that they will go on a tour for holiday*.

It is said (*that*) *whoever comes is welcomed*. (that may also be dropped)

Despite having the verb to be or a linking verb as a main verb, *that* clauses functioning as extraposed subject may also follow some proper adjectives like: difficult, easy, essential, important, useful stupid, good, bad, wrong, right, hard, hopeless, polite, (im)possible, rude, etc. or some participial adjectives like: alarming, surprising, disgusting, shocking, interesting, fascinating, embarrassing, astonishing, terrifying etc.

a) It is **surprising** *that he passed the exam*.

b) It is **known** *that he will pass the exam*.

c) It is the best **student** *that passed the exam*.

Therefore it can be said that ***that clauses*** can function as complements of adjectives as in sentence a, complements of predicators as in sentence b, and complements of nouns or noun phrases as in sentence c.

3. Findings

According to the linguistic rules it was seen that *that* clauses can have various syntactic functions like, subject clauses, extra-posed subject clauses, direct object clauses, complement clauses as well as modifier clauses. The analysis of the examples found in the corpus will be given alongside their syntactic structures and functions.

3.1. *That* clauses in subject clause position

The following examples are the one in which *that* clause takes the initial position of a sentence functioning as the subject of the cleft sentence. In the examples below the cleft sentences have the topic comment arrangement. The topic is expressed by *that* clauses, whereas the comment of the above examples have various syntactic structure.

That I should laugh at you doesn't matter.

That he was a good looking man couldn't be denied.

That Goethe did not really look like this was only his opinion.

That every time my wife was shattered in this way was the thing I could not bear.

That we thought, however, of dying by my hand had been her own inspiration and wish.

That I was too old and stiff and would never learn to dance was a conviction of mine.

That the way towards it has only been covered for a very short distance made him furious.

That I had not been feeling very fit is the reason I didn't visit you up to today.

That we must all soon be dead make the whole of life flat and stupid.

The given information is expressed in cleft sentences which are followed by the new information. Hence, in *subject- that clause*, the constituent elements have got a topic-comment arrangement in all the above examples.

3.2. That clauses in extraposed subject position

As stated earlier the subject clause takes the normal position of a cleft sentence, but sometimes it may be shifted after the predicator leaving an empty space which is filled in with the IT dummy subject and takes the final position of a cleft sentence. As a result, the examples of extraposed subject basically take the final position which is preceded by different syntactic structures of the main clause. Hence, the examples have a comment- topic arrangement of the clauses.

It was against himself *that he directed during his whole life the whole health of his fancy, the whole of his thought.*

It was soon obvious *that his days were spent with his thoughts and his books.*

It is also known *that man consist of a multitude of soul.*

It is only for amusement *that I look on at the business now and then.*

It occurred on my dream *that I had to shut her eyes.*

It is possible *that Harry will one day be led to this latter alternative.*

It is possible *that he will learn to know himself* one day.

It is clear *that this weak and anxious being cannot maintain himself.*

It is seen *that he had in him strong impulses both to be a saint and a profligate.*

It was forgotten *that these blessed children are beset of conflict and complexities and capable of all suffering.*

It was clear *that he put himself out to please me and to show me good will.*

It was discovered *that one-fold of the body is not inhabited by one-fold of the soul.*

It seemed to me *that it was not her own thought.*

It seemed to her *that it wished to recall something.*

It appeared *that I could not bear my loneliness any longer.*

The last sentence "It appeared *that I could not bear my loneliness any longer.*" has a comment-topic arrangement as that clause is posited in the final position of the cleft

sentence. If rewritten as a subject clause, it takes the initial position and there occurs a change of the verb *appeared* which becomes *apparent* -an adjective. Hence, the topic-comment of the clauses takes place, whose syntactic structure is *that clause*+V+SC.”*That I could not bear my loneliness any longer* is apparent.”

In the following example, the adverbial *as* it is the only element that can be positioned prior to the subject in order to emphasize the time of the action which is followed by the subject, followed by the predicator that precedes the extraposed subject expressed by means of *that* clause. “Later, I found out *that his health was poor*.” The cleft sentence has the comment-topic arrangement. If trying to give a topic-comment arrangement than the sentence will be *That his health was poor* was found out later. As it happens with the example below:

It may be unforgivable *that I lived to be eighty two*.

That I lived to be eighty two may be unforgivable. When analyzing the above examples in which *that* clause functions as extraposed subject, we may see that ***that*** *clause* is used as a predicative complement more often than noun complement which is followed by the usage of adjective complement.

3.3. *That* clauses in other syntactic functions

Despite being a subject clause or extraposed subject clause, *that* clauses may have other syntactic functions like direct object clauses, complement clauses.

3.3.1. *That* clauses in the function of Direct Object

One of the common functions of *that* clause in the corpus was the function of the direct object. Therefore, listed are the examples in which *that* direct object clause follows the indirect object; the structure is S+ P+ IO+ *that* clause.

She told me *that she had taken the rooms*.

He had told her *that he thought of spending some months in our town*.

It told me *that I ought never to have come*.

It did not seem to me *that I had learned anything in dancing*.

Basically *that* clauses, when found in the direct object syntactic function, serve as noun phrase complement whose head is a pronoun.

3.3.2 That clauses in the function of a Complement

Complement is a constituent element of a sentence which refers to/ or completes the meaning of a subject, direct object, verb, or even the adverbial adjunct. In our corpus that sentences are found in all syntactic functions. Thus in the example below that clause function of an object complement clause with this syntactic structure: S+V+ DO+ OC (that clause).

It was a look *that did simply criticize the lecturer.*

That clause functioning as a complement of the verb *remarked* whose structure is:

I remarked *that I had been to the concert*, but he did not follow up the topic.

Another function of *that* clause is that it is also found as a modifier of the head noun of a noun phrase. In the examples listed below that clause functions as an adjectival clauses expressed by apposition to modify the indefinite pronoun *all* – the head of the noun phrase.

All *that is cowardly stupid and apish, stupid and meanwhile to the wolf*, only because he did not succeeded.

All *that is wild in himself* he calls wolf and considers it wicked and dangerous and the long bear of a decent life.

3.3.3 That clauses functioning as subject complement clauses

When the main verb of a main clause is either to be or any linking verb, that clause functions as a subject complement clause. That subject complement clause completes the meaning to the subject of the main clause whose syntactic structure is: S+ be/LV+ that clause.

I felt *that I must have recourse to the opium.*

The only request he made was *that his arrival should not be notified to the police.*

In the examples below the complement clause adds meaning to the adverbial of time/place, thus it follows the structure: **It +be+ adverb of time / place+ that clause**

It was then *that my solitude had its beginning.*

It was here *that his strength and virtue rested.*

That clauses may function as various syntactic sentence elements, but at the same time they may also be structured of various syntactic elements within them.

4. Conclusion

That clauses are subordinate clauses of a cleft /complex sentence which may be structured with various constituent element and may function various syntactic functions within a sentence. That clause when placed initially in a complex sentence takes the subject position by using a topic comment arrangement of clauses. The research showed that the subject clause can also be shifted from the initial position beyond the predicator and in such cases the clause arrangement changes the flow of information by giving comment-topic arrangement.

The corpus was a narrative text in which the author mostly uses the passive constructions, therefore, *that clauses* were more frequently found in extraposed subject position than in the subject position. Thus, the structure in which they were used is: It+ Be+ X+ That clause. However, *that clause* was also found in other syntactic functions like: direct object clause, complement clauses. Hence, the topic- comment arrangement of clauses has been found in other syntactic functions of *that clauses* with an exclusion of extraposed subject clauses.

That clauses may function as noun complements, adjective complements and predicative complements. *That clauses* are more frequently found as predicative complements than as noun or adjective complements.

References

- Briton, J. Laurel**, *The Structure of Modern English*, A Linguistic Introduction, John Benjamins, 2000
- Crystal, David**, *A Dictionary of Linguistics and Phonetics*, 6th edition, Blackwell Publishing, 2008
- Çeliku, M. at al.** *Gramatika e gjubës shqipe*, Botim i akademisë së shkencave, Tiranë, 2002
- Chomsky, Naom**, *Aspects of the Theory of Syntax*, the MIT Press, Massachusetts, 1965
- Chomsky, Naom**, *Syntactic structures*, Mouton & Co publishing, Netherland, 1957
- Dhima, Thoma**, *Gjuba shqipe, Sintkasa*, SHBLU, Tiranë, 2005
- Downing, Angela & Locke, Philip**, *English Grammar: A University Course*, 2nd edition, Routledge, 2006
- Finegan, Edward**, *Language: Its structure and Use*, 6th edition, Wodsworth 2012
- Halliday, M.A.K. & Hasan Ruqaya**, *Cohesion in English*, Pearson publication, Malaysia, 1976
- Hesse, Herman**, *Steppenwolf*, Henry Holt and Company, 1957

Nuhiu, Vesel, *English Syntax*, 5th edition, Prishtina, 2012

Totoni, Menella, *Sintkasa e gjuhës shqipe- Frazja e përbërë*, Arbëria, 2012

Werlich, Egon, *A text Grammar of English*, Quelle & Meyer Heidelberg, 1983

Rugova, Bardh & Rugova-Sejdiu, Linditë, *Hyrje në gramatikën e tekstit të gjuhës shqipe*, Trembelat, Prishtinë, 2015

Senad NEZIRI

SHQIPJA NË DOMENET E SHKOLLAVE MIKSE

Abstrakt

Shqipja është gjuhë e parë zyrtare në Republikën e Kosovës, por së bashku me shqipen, nëpër disa komuna e lokalitete, përdoren edhe gjuhë të tjera ku mësimi nëpër shkollat zhvillohet në dy e më tepër gjuhë, si: shqipe, boshnjake, turke dhe serbe. Nga kjo gjendje na krijohen kolektive shkollore bilinge e trilinge, ku në domenet e këtyre shkollave shqipja me status zyrtar në disa raste e ruan këtë status, ndërsa në disa raste ka vështirësi ta ruajë këtë zyrtaritet. Rolin e shqipes dhe funksionimin e saj përballë gjuhëve të tjera do ta vëzhgojmë në katërmbëdhjetë shkollat e komunës së Prizrenit, ku në tri prej tyre shqipja përdoret vetëm në domenet shkollore, ndërsa në domenet familjare ose në lokalitetet ku funksionojnë këto shkolla përdoret ndonjë gjuhë minoritare. Prandaj, objekti ynë do të jenë këto kolektivet e shkollave mikse, kryesisht në komunën e Prizrenit, dhe raportet e tyre gjuhësore me gjuhë të rendit të dytë. Qëllimi i këtij punimi do të jetë argumentimi i statusit të shqipes në këto kolektive mikse, mënyra e përdorimit të shqipes, por edhe të gjuhëve të tjera përballë shqipes, dhe rezultatet e vlerësimit të shqipes nga shqipfolësit dhe joshqipfolësit për statusin e saj në këto domene shkollore.

Fjalë kyçe: shqipja, gjuhët minoritare, statusi i gjuhëve, domenet shkollore.

1.Hyrje

1.1 Qëllimi

Qëllimi i hulumtimit ka qenë të verifikojmë dhe pasqyrojmë statusin e shqipes në domenet e shkollave ku mësimi zhvillohet në dy gjuhë mësimore, shqipe dhe boshnjake ose edhe turke, të pasqyrojmë përdorimin real të gjuhës në terren të komunitetit shumicë dhe komuniteteve pakicë, pastaj qëllimi ynë ishte që ta pasqyrojmë përdorimin e shkronjave shqipe në shkrimin e të folmes boshnjake, ku kemi organizuar një diktim të një teksti në gjuhën boshnjake, por edhe procesin e theksimit të fjalëve, ku kemi bërë incizimin e bisedave. Gjithashtu, kemi dashur të shohim se sa e shpeshtë është dukuria e ndërrimit të kodeve gjuhësore në shoqërinë

shumëgjuhëshe, ku brenda një përgjigjeje ose fjalie kemi një proces të ndërrimit të kodeve, pra një fjali me fjalë nga të dy gjuhët. Duke u bazuar në qëllimin tonë gjatë punës tonë monitoruese, jemi munduar që ta pasqyrojmë statusin e shqipes në kolektive dhe klasa të kombinuara, sidomos në shkollat ku mësimi zhvillohet në gjuhën shqipe, ndërsa nëpër domenet familjare përdoret një e folme tjetër, pastaj edhe mënyrën e përdorimit të shqipes në këto kolektive dhe vëzhgimin e situatave, ku na krijohen gjendjet e ndërrimit të kodeve të shqipes në kontakt me gjuhën e atij komuniteti i cili jeton afër shkollës ose personave të komunitetve pakicë që janë në marrëdhënie pune nëpër këto kolektive.

1.2 Metodologjia

Për ta realizuar këtë punim, kemi bërë një hulumtim në të cilin pjesën fillestare e kemi hulumtuar gjatë vitit 2010 dhe pjesën e dytë gjatë vitit 2015. Ndërkaq, sa i përket metodologjisë së mbledhjes së materialit dhe punës tonë, kemi bërë një diktim në gjuhën boshnjake, në shkollat ku mësimi zhvillohet në dy gjuhë mësimore, në të cilin diktim i kemi përfshirë nxënësit, por në disa raste edhe mësimdhënësit, bilingjë të cilët shkollohen në gjuhën shqipe. Këto grupe ishin të synuara, por kemi përdoruar edhe mostrat e rastit. Nxënësit e përfshirë në këtë diktim ishin të klasave të teta dhe të nënta të shkollave të mesme të ulëta. Në këtë diktim i kemi përfshirë 150 nxënës dhe 23 mësimdhënës, prej tyre 92 meshkuj dhe 81 femra. Hulumtimi është kryer në shkollat e mesme të ulëta në komunën e Prizrenit, saktësisht në shkollë e Lubizhdës, Skorobishtit, Gërçarit, Mushnikovës dhe pjesërisht nëpër shkollat e qytetit ku mësimi zhvillohet në më tepër se në një gjuhë zyrtare të Kosovës.

Në këtë hulumtim të opinionit publik, nga të responentët kemi marrë informata për përkatësinë etnike, gjuhën amtare, gjininë, prejardhjen regjionale dhe vendbanimin, por së pari kemi kërkuar leje nga drejtorat e shkollave për ta kryer këtë hulumtim. Drejtorave të shkollave ua kemi sqaruar që hulumtimi bëhet për qëllime studimore të karakterit sociolinguistik dhe që informatat e marra prej tyre do të përdoren vetëm në kuadër të këtij studimi dhe do të mbeten e drejtë e autorit të studimit, meqë e dëshmon edhe fakti që responentëve u është dhënë mundësia të mbeten anonimë, pa e dhënë emrin e tyre, por duke u mjaftuar me të dhënat tjera, pra jemi munduar t'i respektojmë kriteret etike të punës në terren. Përzgjedhja e tekstit në gjuhën boshnjake ishte përzgjedhja e rastit dhe pa kurrfar qëllimi e prapavije, bile në disa raste i kemi diktuar edhe fjali të dëgjura në atë regjion ku e kemi bërë diktimin.

Përveç diktimit, kemi realizuar edhe disa incizime të bisedave ose situatave ku e kemi evidentuar procesin e ndërrimit të kodeve gjuhësore, dhe të shqiptimit të fjalëve

shqipe jashtë rregullave ose shprehive të të folmeve sllave ose serbe/boshnjake. Incizimin e kemi bërë në shkollat dhe regionet e njëjta ku e kemi kryer diktimin. Edhe për këtë veprim kemi kërkuar leje nga drejtorat e shkollave, por nuk i kemi njoftuar personat me të cilët kemi kontaktuar ose bisedur, me qëllim që t'i evidentojmë shprehjet dhe mostrat reale e origjinale në terren. E njëjta gjë është kryer edhe për faktin e regjistrimit të fjalëve shqipe brenda të folmeve boshnjake ose për procesin e ndërrimit të kodeve gjuhësore dhe krijimin e fjalive me fjalë të dy gjuhëve ose të folmeve, shqipe dhe boshnjake.

2. Shqipja në domenet e shkollave mikse

Sa për të sqaruar, do ta përdorim fjalën “mikse” në titullin e kësaj kumteseje, meqë në dokumentet zyrtare të komunës me këtë shprehje emërtohen shkollat ku mësimi zhvillohet në dy e më tepër gjuhë mësimore.

Duke u nisur nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës (2007), Rregulloret për Statusin dhe Përdorimin e Gjuhëve në Komunën e Prizrenit (dokument zyrtar, 2009), shqipja është gjuhë e parë zyrtare në Republikën e Kosovës, por së bashku me shqipen, nëpër disa komuna e lokalitete, përdoren edhe gjuhë të tjera ku mësimi nëpër shkollat zhvillohet në dy e më tepër gjuhë mësimore, si: shqipe, boshnjake, turke dhe serbe (Neziri, 2014). Komuna e Prizrenit është një komunë shumëgjuhëshe, ku edhe mësimet zhvillohen gati në të gjitha gjuhët e të gjithë komuniteteve, përpos komunitetit RAE. Nga kjo gjendje na krijohen kolektive dhe klasa shkollore bilinge e trilinge, ku në domenet e këtyre shkollave shqipja me status zyrtar në disa raste e ruan këtë status, ndërsa në disa raste ka vështirësi ta ruajë këtë zyraritë.

Statusin e gjuhës së parë zyrtare shqipja e ruan nëpër shkollat e mesme të larta në qytetin e Prizrenit dhe nëpër shkollat e qytetit ku mësimi nuk zhvillohet në ndonjë gjuhë të minoriteteve, si të turqishtes ose boshnjakishtes e pasvitit 1999 (Neziri, 2014; Ismajli, 2005; Munishi, 2009, 2010). Gjithashtu edhe nëpër regjionet e Vërrinit, Hasit, Përdrinisë dhe pjesërisht në regjionin e Podgurit. Ndoshta shkollat e qytetit, duke u bazuar në simbolikën e qytetit të Prizrenit si qytet ku më së shumti respektohen dhe përdoren gjuhët e komuniteteve të ndryshme, në një farë mënyre edhe zyrtarisht obligohen në përdorimin edhe të ndonjë gjuhe tjetër, përpos shqipes, sidomos stafi udhëheqës, ose kemi hasur raste të cilat gjatë punës tonë hulumtuese na kanë treguar mësimdhënësit, që ndonjë herë janë të obliguar të komunikojnë me prindërit e nxënësve të cilët në domenin familjar janë folës të turqishtes ose boshnjakishtes, ndërsa në vazhdimësi shkollohen në gjuhën shqipe, ku medoemos krijohet një situatë bilinge. Kjo dukuri është e shprehur edhe te fëmijët e këtyre prindërve, sidomos deri

në klasën e tretë ku, sipas mësimeve, fëmija i përshtatet ambientit shkollor dhe gjuhësor ose i përshtatet përkufizimit të Hudsonit (2004) i cili për përvetësimin e gjuhës thotë që, gjuha e mësuar dhe e përdorur mund të jetë edhe gjuha e kujdestares, pra në këtë rast na paraqitet gjuha e domenit shkollor.

Ndërsa nëpër lokalitetet dhe shkollat e fshatrave të Podgurit, si: Lubizhdë (këtu shqipja përdoret edhe nëpër familje), Skorobisht, Gërçar; dhe Grykës së Lumbardhit, si: Mushnikovë, Drajçiqi dhe Struzhë (këtu shqipja përdoret edhe nëpër familje si gjuhë amtare) etj., statusi i shqipes si gjuhë e parë zyrtare zbatohet vetëm në situatat zyrtare dhe nëpër shkolla, ndërsa në raste të tjera shqipja në këto regjione e humb statusin e gjuhës së parë zyrtare dhe kalon si gjuhë e përdorimit dytësor, pra i përngjan klasifikimit të dytë të Klosit (sipas Munishit, 2010), ku nga një gjuhë e vetme zyrtare për shkaqe të ndryshme kalon në gjuhën e dytë zyrtare. Për statusin e gjuhës shqipe kundruall gjuhëve minoritare Friedman (2003, 2005) na jep një pasqyrë të përdorimit të dygjuhësisë dhe statusit të gjuhëve në regjionet e Prizrenit ose përgjithësisht në territoret dygjuhëshe.

Qasjen e këtij përdorimi të gjuhës në kolektivet dhe klasat e shkollave dygjuhëshe ose mikse, e kemi shqyrtuar në bazë të argumenteve në praktikën e përdorimit të shqipes në fshatrat: Lubizhdë, Skorobisht, Gërçar e në territorin e Grykës së Lumbardhit (Zhupës së Prizrenit), ku nga informatat dhe nga dokumentet zyrtare kemi vërejtur se në këto anë fliten gjuhë të ndryshme, si: shqipja (nga etniteti shqiptar), boshnjakishtja ose dialektet e sllavishteve jugore (nga etniteti shqiptar dhe ai boshnjak), dhe në disa familje turqishtja (nga etniteti shqiptar), sipas modelit që e përshkruan edhe Ibrahim (2005).

Rezultatet e monitorimit të punës tonë në periudhën e caktuar janë të shumta dhe të ndryshme, por duke u bazuar në kohën e kufizuar të kumtimit dhe të faqeve për botim, do t'i përmendim vetëm disa. Përpos proceseve të ndërrimit të kodeve dhe krijimit të situatave të ndërndikimeve të shumta gjuhësore (shih Neziri, 2015), duke u nisur nga politika e zbatimit të Rregullores për respektimin dhe të drejtën e përdorimit të gjuhës së çdo komuniteti, kemi hasur në raste interesante nga nxënësit e shkollave ku mësimi zhvillohet në dy gjuhë ose ku nxënësit janë bilingë ose trilingë, duke mos i anashkaluar edhe arsimtarë.

Situata na ka obliguar ta organizojmë një diktim të një teksti në gjuhën e minoriteteve. Pas kontrollimit të shkrimeve, kemi vërejtur që gjatë shkrimit, sidomos të fjalëve që i kanë shkronjat e shqipes dhe të cilat nuk i ka gjuha minoritare, në këtë rast boshnjakishtja, si fonemat: **x, y, ë, th**, por edhe ato që në shqipen shkruhen ndryshe si: **sh, q, gj, ll** etj., kemi vërejtur se në 93 për qind të rasteve nxënësit të cilët

janë bilingë, ndërsa shkollohen në gjuhën shqipe i kanë përdorur shkronjat e shqipes edhe pse teksti ishte i diktuar në gjuhën boshnjake, si:

Përdorimi i shkronjave shqipe brenda fjalëve boshnjake/serbe	Si duhet të përdoren shkronjat boshnjake/serbe
<i>Vidim noqam xvezde</i>	<i>Vidim nočam zvezde;</i>
<i>Ylber došof u shkolla</i>	<i>U/Ilber došof u škola;</i>
<i>Idemo u shkollu</i>	<i>Idemo u školu</i>
<i>Çekiç je težbok</i>	<i>Čekič je težok</i>
<i>Idemo u Prishtinu</i>	<i>Idemo u Prištinu,</i>
<i>Nasha shkolla</i>	<i>Naša škola etj.</i>

Këtë diktim nuk e kemi bërë vetëm në një shkollë, por jemi bazuar, posaçërisht, nëpër shkollat ku e kemi hasur të shprehur dhe të zbatuar procesin e multi-etnicitetit të dygjuhësisë ose trigjuhësisë, si në: Lubizhdë, Skorobishtë, Gërçar, Mushnikovë, por edhe në disa shkolla të qytetit.

Pastaj, kemi vërejtur që fëmija biling (boshnjakfolës në familje), por që shkollohet në gjuhën standarde shqipe, fiton një shprehje të përdorimit të gjuhës dhe të fjalëve të shqipes në zëvendësim të fjalëve boshnjake. Prandaj, ndodh që individi boshnjakfolës gjatë bisedës krijon dukurinë e ndërrimit të kodeve gjuhësore, ku gjatë një fjalisë përdor fjalët e të dy gjuhëve, si të shqipes, ashtu edhe të boshnjakishtes, ku gjatë parashtrimit të pyetjeve në gjuhën boshnjake, marrim përgjigje me kode të ndryshme p.sh.

Pyetje	Përgjigje
<i>Šta ste učili danas?</i>	<i>Danas smo učili kryefjala i kallëzuesi.</i>
<i>Gde idete?</i>	<i>Idemo na sbëtitje.</i>
<i>Čija je ova učionica?</i>	<i>Ova klasa je naša.</i>
<i>Ko recituje pesmicu?</i>	<i>Ona recitova vjershu.</i>
<i>Koja je strana od teksta?</i>	<i>Tekst je na faqe 56.</i>
<i>Gde je Elban?</i>	<i>Otišov na valle.</i>

Nga vëzhgimi i bërë, kemi vërejtur se ky proces i krijimit të situatave të ndërndikimeve gjuhësore dhe dukurisë së ndërrimit të kodeve gjuhësore, vjen nga ndikimi i domenit familjar në një rënë anë, por edhe nga domeni shkollor, pas moshës pesëvjeçare. Raste gati të njëjta i kemi hasur edhe te mësimdhënësit të cilët punojnë në

këto shkolla, ndërsa në domenin familjar janë folës të një gjuhe tjetër në dallim nga domeni shkollor.

Pra, nga këta shembuj të cekur, vërejmë se, ka ndikim të gjuhës shqipe, prandaj edhe statusi zyrtar i shqipes, edhe pse ndoshta në përdorim dytësor, prapëseprapë lë gjurmë të ndikimit duke krijuar intrerferenca të ndryshme gjuhësore, sepse individi, i cili vetëm në familje është boshnjakfolës, i përdor trajtat bazë të shqipes standarde *kryefjala i kallëzuesi* në vend të *subjekat i predikat*, *shëtitje* në vend të *izljet*, *klasa* në vend të *učionica*, *recitova vjershu* në vend të *recituje pesmicu*, *faqe* në vend të *strana*, *valle* në vend *oro* ose *kolo*, ndërsa trajtat e boshnjakishtes i përdor vetëm ato themelere, të cilat i përdor në familje.

Nga vëzhgimi kemi hasur edhe në ndikime të theksit. Shqipja standarde i përket grupit të gjuhëve me theks të lirë, ku “theksi bie mbi këtë ose atë rrokje sipas rregullash komplekse që varen nganjëherë nga kritere gramatikore” (Beci, 2004: 116). Duke u bazuar në gjuhën standarde shqipe individi biling që shkollohet në gjuhën shqipe e në familje është boshnjakfolës, jo vetëm që i përdor fjalë të shqipës në vend ta fjalëve të boshnjakishtes, por ato i shqipton edhe me theks të gjuhës standarde shqipe e jo me atë të boshnjakishtes edhe pse ato i boshnjakizon me mbaresa të boshnjakishtes, si:

Mótra Adelina ishte te na – *Mótra* Adelina bila kod nas;

Kur kisha *lexúar* – Kad som *lexóvar*;

Zija prítën – Stani mu na *prítu*;

Vjen *pleqnia* e katundit. Ide seoska *pleqnia*, por edhe *pléqnia*.

Pra, gjatë mbledhjes së materialit për këtë temë kemi konstatuar se fjalët që përdoren në gjuhën boshnjake jo vetëm që huazohen duke e marrë një fjalë dhe duke e përdorur me të njëjtën kuptim edhe në gjuhën e marrësit, por ajo fjalë huazohet dhe përdoret me intonacin dhe theksim të njëjtë me atë të shqipes.

3. Përfundime

Duke u bazuar në qëllimin tonë gjatë punës tonë monitoruese, jemi munduar që ta pasqyrojmë statusin e shqipes në këto kolektive dhe klasa të kombinuara, sidomos në shkollat ku mësimi zhvillohet në gjuhën shqipe, ndërsa nëpër domenet familjare përdoret një e folme tjetër, pastaj edhe mënyrën e përdorimit të shqipes në këto kolektive dhe vëzhgimin e situatave ku na krijohen gjendjet e ndërrimit të kodeve të shqipes në kontakt me gjuhën e atij komuniteti i cili jeton afër shkollës ose personave të komunitetve pakicë që janë në marrëdhënie pune nëpër këto kolektive. Nga ky material kemi hasur dendurinë e përdorimit të shkronjave shqipe në vend të

përdorimit të shkronjave boshnjake/serbe, krijimin e dukurisë së ndërrimit të kodeve gjuhësore brenda një fjalie me fjalë të përziera nga të dy gjuhë ose dialektet e atyre gjuhëve, por edhe mënyrën e përdorimit të theksit sipas rregullës së shqipes ose shqiptimit të fjalëve shqipe.

Literatura

1. Beci, Bahri (2004). *Fonetika e gjuhës shqipe*, EDFA, Tiranë.
2. Friedman, Victor (2003). *Vendi i gegënishtes në gjuhën shqipe dhe në Ballkan*, e përkohshme kulturore Phoenix, viti VII, nr. 1-6 (33-38) ff. 40-56, Shkodër.
3. Friedman, Victor (2005). *Albanian in the Balkan Linguistic League: a reconsideration of theoretical implications*, Studia Albanica, vol. 1, pp. 33-43.
4. Hudson, Richard (2004). *Sociolinguistika*, Dituria, Tiranë.
5. Ibrahim, Sami (2005). *Ndikimi i gjuhës shqipe në turqishten e folur në Maqedoni dhe në Kosovë (rrafshi fonologjik)*, Logos-A, Shkup.
6. Ismajli, Rexhep (1991). *Gjuhë dhe etni (artikuj dhe ese)*, Rilindja, Prishtinë.
7. Ismajli, Rexhep (2005). *Gjuhë standarde dhe histori identitetesh*, ASHSh, Tiranë
8. *Kushtetuta e Republikës së Kosovës*, 2007, Prishtinë
9. Munishi, Shkumbin (2009). *Barazja e gjuhëve në Kosovë dhe perspektiva evropiane*, Kongresi Ndërkombëtar Ballkanik, 11-16 maj 2009, Prishtinë.
10. Munishi, Shkumbin (2010). *Planifikimi i statusit të gjuhëve në Kosovë*, Prishtinë.
11. Neziri, Senad (2014). *Rrethet sociolinguistike e sociopolitike të shqipes në komunën e Prizrenit*, në Albanologji 4/2013, vëllimin I, Instituti Albanologjik i Prishtinës, ff. 267 – 276, Prishtinë.
12. Neziri, Senad (2015). *Ndërrimi i kodeve gjuhësore brenda shoqërive shumëgjuhëshe* në Konferencën e Tretë Ndërkombëtare e organizuar nga Qendra e Studimeve Albanologjike në Tiranë “KËRKIME GJUHËSORE”, 11 korrik 2014, ff. 491 – 502, ISBN: 978-9928-14-131-6.
13. *Rregullore pe Përdorimit të Gjuhëve në Prizren*, 2009, Prizren.

Vaide KQIKU-HOXHA

PËRDORIMI I PJESORES DHE DERIVATEVE TË SAJ NË DEBATET TELEVIZIVE NË TELEVISIONET E KOSOVËS

Pjesorja është formë sintetike e trashëguar indoevropiane, me tipare karakteristike emërore dhe foljore. “Pjesorja në gjuhën shqipe ka një përdorim të kufizuar si gjymtyrë më vete. Ajo shërben më fort si pjesë përbërse formash foljore analitike dhe sintetike. Ajo shërben, p.sh., për të formuar kohët e përbëra të së shkuarës, të tashmen dhe të pakryerën e habitores dhe kohën e tashme të dëshirores së disa foljeve. Me pjesëmarrjen e saj ndërtohen edhe format e pashtjelluara të tipit *pa nunuar, duke punuar* (dhe *me punue* e të folmeve gege). (GA, 2002:332). Pjesorja shërben edhe për të formuar formën e pashtjelluar të tipit *për të mësuar*. Si gjymtyrë më vete pjesorja mund të shërbejë: a. si përcaktor kallëzuesor i kryefjalës ose i kudrinës; b. si përcaktor i veçuar; c. pas foljeve me vlerë modale *do* dhe *dubet*; (GA, 2002:332). Pjesorja formohet duke i shtuar temës foljore prapashtesat: -rë/r, -ur, - ë dhe – në. (Beci B., 2004:134). Me- ë: bërë, hyrë, vjelë, dalë etj; Me –në: vënë, shtënë, zënë, qenë, dhënë etj; Me –rë/r: larë, fshirë, vrarë, pirë, parë, mësuar, lyer etj; Me-ur: gjetur, mbajtur, hapur, vendosur, njohur, ditur, pasur, dashur etj. Siç dihet shqipja e sotme i ka të trashëguar në realitetin aktual gjuhësor këto tri variante kryesore të pjesores: një të toskërishtes (të normëzuar) dhe dy të gegërishtes (të panormëzuar: disa trajta të zgjeruara dhe një trajtë të shkurtër), si p.sh 1. tosk. punuar, pëlqyer, matur, radhitur, pritur, blerë, pirë, shuar, nxënë, marrë (trajtë e normëzuar); 2. geg. (trajta të zgjeruara): punuem punuemun a punuen, pëlqyem a pëlqyemun pëlqyenen, matun maten, radhitun radhiten, pritun priten, blemë blemum blenun, pimë pimun pinun, shuem shuemun shuenun, nxanun nxanen, marrun marren; 3. geg. (trajtë e shkurtër): punue, pëlqye, matë, radhitë, pritë, ble, pi, shue, nxënë, marrë. (Veselaj, N. 2006:91-92). Pjesorja, sipas gramatikës tradicionale, duke u mbështetur para së gjithash në Gramatikën ... e Akademisë së Shkencave të Republikës së Shqipërisë, nga ku del se kjo është një problematikë komplekse, qoftë në kuptimin diakronik, qoftë në kuptimin sinkronik, madje edhe si problematikë drejtshkrimi apo si problematikë e diferencimit dialektor të shqipes.

Objekti i studimit është shtruar në rrafshin gjuhësor, i cili pretendon që përmes monitorimit të sqarojë dendurinë e përdorimit të pjesores së shkurtër, kundrejt

përdorimit të pjesores së zgjeruar, në mënyrë që të shihet se cila formë mbisundon në ligjërimin e folësve të standardit që varietet të parë kanë gegërishten. Kemi zgjedhur televizionet për ta realizuar këtë hulumtim sepse mediat kanë vend të rëndësishëm në përdorimin dhe interpretimin e gjuhës. Prestigji medial është bazë e përdorimit të gjuhës. Punimi përfshin gjashtë debate televizive të shkëputura nga emisionet: “Subvencion” në RTK, “Click” në TV 21 dhe “Rubikon” në KTV. Monitorimi është zhvilluar në fillim të muajit mars deri në fund të prillit (2015) dhe përfshin emisione ku janë trajtuar tema të ndryshme nga aktualiteti. Gjithsej janë përfshirë 24 debatues, nga të cilët 5 kanë qenë femra dhe 19 meshkuj. Pjesa dërmuese e debatuesve kanë qenë të moshës 30 deri 60 vjeç. Profesionet e tyre janë të ndryshme, shumica janë të punësuar në institucione të ndryshme të Republikës së Kosovës. Të gjitha debatet janë studiuar drejtpërdrejt në ballafaqim me gjuhën standarde. Pas grumbullimit të materialit kemi përdorur përshkrimin, krahasimin dhe vlerësimin e tyre. Pjesëmarrësit e debateve televizive nuk kanë qenë në dijeni se ligjërimi i tyre po bëhej objekt i analizës së monitorimit tonë, prandaj rezultatet e këtij hulumtimi janë të qëndrueshme. Duke studiuar, hap pas hapi, gjuhën e pjesëmarrësve të debateve televizive, vihet re që pjesorja e shkurtër qëndron në raport dallues më e mëkëmbur ndaj pjesores së zgjeruar. Në këtë hulumtim kemi trajtuar dhe pasqyruar në mënyrë të përgjithshme pjesoren dhe përdorimin e saj në debate televizive në tri televizionet e Kosovës, po ashtu, përdorimin e formave foljore të shtjelluara që formohen me pjesore në debate televizive në këto tri televizione dhe kemi trajtuar përdorimin e formave foljore të pashtjelluara që formohen me pjesore në debate televizive në tri televizionet e Kosovës, në zgjedhim, në veta dhenë formatë ndryshme.

Rezultatet e hulumtimit tonë na përforcojnë bindjen se megjithëse pjesorja e shkurtër është jashtë standardit, ajo në debatet televizive, por edhe në ligjërimin e përditshëm përdoret dendur si rrjedhojë edhe e paskajores së tipit *me mësu*. Me vetëdije, por edhe me lëkundje, pjesëmarrësit e debateve televizive shmangen nga standardi. Përdorimi i dendur i pjesores së shkurtër, në vend të pjesores së zgjeruar tregon sesa e ngulitur është pjesorja e shkurtër ndër folësit të cilët varietet të parë kanë gegërishten. Te pjesëmarrësit e debateve, të cilat i kemi monitoruar në fillim të bisedës së tyre, vërehet që i kanë kushtuar më shumë vëmendje të folurit të tyre, si rezultat kanë përdorur më shumë formën e pjesores së zgjeruar, por vetëm pas disa fjalive i kanë kushtuar më pak vëmendje të folurit të tyre, ata kanë përdorur formën e pjesores së shkurtër (të reduktuar) deri në fund. Ky fakt tregon më së miri sesa e ngulitur është pjesorja e shkurtër ndër folësit gegëfolës. Në gjashtë debatet televizive të cilat i kemi monitoruar, pjesëmarrësit e debateve kanë përdorur fare pak pjesoren si gjymtyrë më vete. Debatuesit kanë përdorur vetëm 8 herë pjesoren si gjymtyrë më vete. Ata kanë

përdorur 6 herë pjesoren e plotë, ndërkaq 2 herë pjesoren e shkurtër ose 75% me 25% në favor të pjesores së plotë si: fillu, punu, ndërsa pjesorja e plotë p.sh. punuar, pasur, filluar, etj.

Format e shtjelluara foljore të formuara me pjesore dhe përdorimi i tyre në debatet në televizionet e Kosovës, e kemi shqyrtuar paraqitjen e pjesores si pjesë e formave të shtjelluara, duke i përshkruar ato nëpër mënyra dhe nëpër kohët e përbëra të foljeve ku del pjesorja. Mënyra lidhore dhe mënyra dëshirore nuk është përdorur në asnjë rast në këto gjashtë debate të analizuar. Ndërsa habitorja është përdorur vetëm në një rast, në kohën e kryer, në zgjedhimin vepror, në vetën e tretë, si: paska marrë.

Nga të gjitha kohët e përbëra, koha e kryer e mënyrës dëftore është përdorur me dendurinë më të madhe nga pjesëmarrësit e debateve. Në gjashtë emisionet e tipit të debatit, të cilat i kemi monitoruar, pjesëmarrësit kanë përdorur 645 herë kohën e kryer të dëftores. Nga 645 përdorime të kohës së kryer të mënyrës dëftore, të cilat i kemi monitoruar, pjesëmarrësit kanë përdorur 97 herë kohën e kryer të mënyrës dëftore të formuar me pjesore të zgjeruar të standardit. Ata kanë përdorur 354 herë kohën e kryer të mënyrës dëftore të formuar me pjesore të shkurtër apo 78% me 22% në favor të pjesores së shkurtër, të tipit *kam punu* kundrejt formës së plotë të tipit *kampunuar*. Shembuj si: p.sh. kam pa, kemi ba, është kthy, kanë preferu, ka potencu, ka rezultu, etj., në vend se kam parë, kemi bërë, është kthyer, kanë preferuar, ka potencuar, ka rezultuar, etj.

Koha e kryer e mënyrës dëftore e formuar me pjesore të shkurtër, nuk shpreh aspak ndryshim kuptimi nga koha e kryer e mënyrës dëftore e formuar me pjesore të zgjeruar, veçse ka favor, ngase është më e shkurtër, më e thjeshtë dhe më me lehtësi shqiptimi sesa ajo e standardit. p.sh.


1. Populli i Kosovës *kapërcakto* me votë vullnetin e tyre.



Pjesëmarrësit e debateve televizive 191 herë ose 29% të tjera kanë përdorur kohën e kryer të mënyrës dëftore të formuar, kundrejt raporti 465 ose 71% kohës së kryer të mënyrës dëftore me pjesore.

- a. Me pjesoret e foljeve të nënklasës I të klasës II, të zgjedhimit të II, si p. sh. vjelë, dalë, sjellë, nxjerrë, marrë etj.,
- b. Me pjesoret e foljeve të klasës I të zgjedhimit të III, si p. sh. vënë, zënë, nxënë etj.,
- c. Me pjesoret e foljeve të parregullta si p. sh. qenë, ngrënë, thënë, dhënë etj.

Kjo pjesë del të jetë ndër pjesët më interesante, meqë kemi arritur të ofrojmë të dhëna kryqëzore për përdorimin e pjesores. p. sh. sipas studimit, del se koha e kryer e dëftores që është rasti i parë ku paraqitet pjesorja, është përdorur 645 herë në gjashtë

debate televizive, me ç'rast 475 apo 74% është përdorur zgjedhimi vepror, kundrejt 170 apo 26 % zgjedhimi jovepror, pastaj del se në 465 apo 72 % të rasteve është përdorur veta e tretë, në 172 apo 27 % veta e parë, ndërsa veta e dytë 8 apo vetëm 1 %.Ndërsa,trajtat e tjera ku janë përdorur 451 herë, si forma e tipit *kam punuar* 97 apo 22% dhe forma e tipit *kam punu* 354 apo 78%. Shembujkonkretë si: është parapa, janë dëmtu, janë hapë, kemi ba etj., në vend është parapërë, janë dëmtuar, janë hapur, kemi bërë etj. Në grafikët e më poshtëm janë pasqyruar rezultatet sipas zgjedhimeve, vetave dhe formave të tjera, të cilat i ilustrojnë më së miri konstatimet që u bënë pak më parë.






Koha më se e kryer e mënyrës dëftore

Koha më se e kryer e dëftores ka gjithsej 16 përdorime, tek më se e kryera e dëftores raporti ndërmjet vetave ndryshon, me ç'rast veta e tretë përdoret 8 apo 50 % të rasteve, veta e parë 7 apo 44 %, ndërsa veta e dytë 1 apo 6 % të rasteve, p.sh kishim pasë, kishte vendosë, ishim largu, etj, në vend të kohës më se e kryer e mënyrës


dëftore të formuar me pjesore të zgjeruar p.sh kishim pasur, kishte vendosur, ishim larguar, etj. Zgjedhimi vepror ka 11 përdorime dhe zgjedhimi jovepror 5 përdorime ose 69% me 31%. Te më se e kryera e dëftores kemi raportin e përdorimit ndërmjet pjesores së zgjeruar dhe pjesores së shkurtër, forma e tipit *kisha mësuar* është përdorur 1 herë, ose 6%, ndërsa tipi *kisha mësu* 15 herë ose 94%. Shembuj nga monitorimi si: kishim pasë, kishim përfitu, kishte vendosë, ishim largu, kishim kriju, kisha transmetu, kisha sqaru, etj., në vend të kohës më së të kryer të mënyrës dëftore të formuar me pjesore të zgjeruar si: kishim pasur, kishim përfituar, kishte vendosur, ishim larguar, kisha falur, kishim krijuar, kisha trasmetuar, kisha sqaruar, etj.

Më se e kryera e dëftores, raporti vepror/jovepror




■ Zgjedhimi vepror ■ Zgjedhimi jovepror

Më se e kryera e dëftores - shpërndarja sipas përdorimit në veta



■ Veta e parë ■ Veta e dytë ■ Veta e tretë

Më se e kryera e dëftores - Raporti i përdorimit ndërmjet pjesores standard-zgjeruar dhe pjesores së shkurtuar



■ Forma e tipit kisha mësuar ■ Forma e tipit kisha mësu


Koha e kryer e tejkshkuar e mënyrës dëftore

Në gjashtë debatet e monitoruar pjesëmarrësit e kanë përdorur fare pak kohën e kryer të tejkshkuar të dëftores, vetëm dy raste. Duke ditur të dhënë që kjo kohë në gjuhën standarde përdoret fare pak, nuk kemi pritur që do të hasim më shumë përdorime të saj në debate televizive. Këto dy raste janë përdoruar në zgjedhimin vepror, në vetën e tretë, p.sh. pati thënë dhe pati bërë.


Koha e ardhme e mënyrës dëftore

Në gjuhën e sotme shqipe përdoren dy tipa të së ardhmes. Duke pasur parasysh se vëmendja e jonë në këtë hulumtim ishte përqendruar te forma e përdorimit të pjesores, vetëkuptohet që edhe tani fokusimi ynë ka qenë në tipin e dytë të kohës së ardhme të dëftores të formuar me formën e pashtjelluar të tipit *kampër të mësuar*. Krahas formave të lartpërmendura, përdoret edhe një formë e kohës së ardhme të mënyrës dëftore, forma e tipit *kam me mësu(e)* e cila formohet duke i paravendosur paskajores së tipit *me mësu (e)* format vetore të kohës së tashme të foljes ndihmëse kam p.sh. *kam me mësu (e)*. Forma joveprore formohet me pjesëzën –u- p.sh. *kam me u mësu (e)*. Shembuj të monitorimit: kam me punu, ka me shku, kemi me hezitu, kanë me kërku, kemi me u tërheq, ke me u ulë, keni me shty, kanë me u bashku etj., në vend të kohës së ardhme të mënyrës dëftore të tipit *kam për të mësuar* si: kam për të

punuar, kam për të shkuar, kemi për të hezituuar, kanë për të kërkuar, kemi për t'u tërhequr, ke për t'u ulur, keni për të shtyrë, kanë për t'u bashkuar etj. Siç shihet debatuesit gjatë të folurit të tyre, pothuajse në të gjitha rastet kanë përdorur kohën e ardhme të mënyrës dëftore të tipit ***kam me mësu***. Në gjashtë debatet e monitoruara kemi regjistruar 14 përdorime të formës së tipit ***kam me mësu***. Nga 14 rastet debatuesit kanë përdorur 9 apo 64% në zgjedhimin vepror, ndërsa, 5 apo 36% në zgjedhimin jovepror. Veta e tretë prin me numrin e përdorimit 11 apo 79%, veta e dytë 2 apo 14% si dhe veta e parë vetëm një përdorim, apo 7%. Forma e tipit ***kam për të mësuar*** 1 apo 7% e pasuar nga forma e tipit ***kam me mësu*** me 13 apo 93%. Këto rezultate janë të pasqyruara në vijim.




E ardhmja e dëftores - raporti i përdorimit sipas vetave



■ Veta e parë ■ Veta e dytë ■ Veta e tretë

Raporti i përdorimit ndërmjet formave kam për të mësuar dhe kam me mësu





■ Forma e tipit kam për të mësuar ■ Forma e tipit kam me mësu

Koha e ardhme e përparme e mënyrës dëftore

Koha e ardhme e përparme e mënyrës dëftore e tipit *do të kem mësuar* dhe ajo e tipit *kishapër të mësuar*, nga pjesëmarrësit e debateve nuk është përdorur fare. Përveç këtyre formave përdoret edhe një formë tjetër, forma e tipit *kisha me mësu* (e), e formuar nga e pakryera e dëftores së foljes kam dhe paskajorja e mirëfilltë e tipit *me mësu* (e). P.sh.: kisha (kishe, kishte, kishim, kishit, kishin) me mësu. Ndërsa forma

joveprorë formohet me pjesëzën –u-. P. Sh.: kisha (kiske, kishte, kishim, kishit, kishin) me u mësu (e). Në gjashtë debatet e monitoruara pjesëmarrësit kanë përdorur 8 herëvetëm formën e tipit **kisha me mësu**, në zgjedhimin vepror 6 apo 75%, ndërsa në zgjedhimin jovepror 2 apo 25%. Veta e tretë del më e përdorur me 6 apo 75%, e pasuar nga veta e parë 2 apo 25%, ndërsa veta e dytë nuk shtë përdorur asnjëherë. Siç shihet pjesëmarrësit e debateve televizive, gjatë të folurit të tyre kanë përdorur kohën e ardhme të mënyrës dëftore të tipit **kisha me mësu** 100%. Shembuj nga monitorimi: kishte me pasë, kishin me përcaktu, kishte me menu, kishin me shku, kishte me intervenu etj., në vend të kishte për të pasur, kishin për të përcaktuar, kishte për të menduar, kishte për të shkuar, kishte për të intervenuar, etj. Këto të dhëna janë të ilustruar në grafikë e mëposhtëm.








MËNYRA KUSHTORE

Koha e tashme e mënyrës kushtore

Është përdorur në formën *kisha me mësu*. Mirëpo, krahas formës *do të mësoja* përdoret edhe forma e dytë, e formuar nga e pakryera e dëftores së foljes kam dhe forma e pashtjelluar e tipit *për të mësuar*. Vëmendja e jonë është përqendruar në formën e dytë të kohës së tashme të mënyrës kushtore, të tipit *kisha për të mësuar*. Në debatet televizive, të cilat i kemi monitoruar, pjesëmarrësit nuk e kanë përdorur asnjëherë formën e tipit *kisha për të mësuar*. Duke u mbështetur në të dhënën që ky tip i kohës së tashme i mënyrës kushtore përdoret fare pak, një rezultat të përafërt e kemi pritur. Krahas formave të lartpërmendura, përdoret edhe një formë e kohës së tashme të mënyrës kushtore, forma e tipit *kisha me mësu(e)*, e formuar nga e pakryera e dëftores së foljes kam dhe paskajorja e mirëfilltë e tipit *me mësu(e)*. P.sh kisha (kische, kishte...) me mësu-e nëveprore. Forma joveprore fomohet me pjesëzën –up.sh.: kisha (kische, kishte...) me mësu (e). Në gjashtë debatet e vëzhguara folësit kanë përdorur 5 herë formën e tipit *kisha me mësu*. Në zgjedhimin vepror kjo formë është përdorur 4 herë apo 80%, ndërkaq në zgjedhimin jovepror është përdorur vetëm një herë apo 20%, poashtu, në vetën e tretë është përdorur 4 herë apo 80%, nëvetën e dyte 1herë, apo 20% dhe nëvetën e parë asnjë përdorim nuk është regjistruar. Folësit e

kanë përdorur 5 herë apo 100% formën e tipit *kisha me mësu*, në vend të formës së tipit *kisha për të mësuar*. Shembuj nga monitorimi, si: kisha me potencu, kishte me gjetë, kishte me ndiku, kishim me përfitu, kisha me sqaru etj., në vend kisha për të potencuar, kishte për të gjetur, kishte për të ndikuar, kishim për të përfituar, kisha për sqaruar etj., e cila në debatet televizive nuk është përdorur në asnjë rast. Më poshtë po japim grafikët përkatës me të dhënat që i kemi regjistruar.






FORMAT E PASHTJELLUARA

Format e pashtjelluara me pjesore dhe përdorimi i tyre në debatet televizive në televizionet e Kosovës është pjesë shumë e rëndësishme e këtij punimi, pasi këtu shpërfaqen dallimet e përdorimit të formave të pashtjelluaratë foljeve mbi bazën e pjesores. Në këtë pjesë kemi analizuar përdorimin e paskajores dhe përcjellores dhe variacioneve me të cilat shfaqen ato në të folurit formal që synon të jetë të folur standard, por që duke qenë gjuhë e folur shpeshherë rrëshqet në të folur vernakular apo dialektor. Dallimet kryesore shfaqen te përdorimi i paskajores gege dhe asaj standarde, ndërkohë që nga studimi del e qartë që në mentalitetin e folësve të gegërishtes mbizotëruese është paskajorja gege e cila gjatë përpjekjes për përdorim sipas shqipës standarde ajo gjithmonë zëvendësohet natyrshëm dhe drejt nga alternativat që ofron shqipja standarde, përkatësisht nga paskajorja standarde e tipit *për të* dhe lidhorja. Kështu raporti ndërmjet *për të + pjesore e plotë* dhe *me + pjesore e shkurtër* del 84 % me 16% në favor të formës *me + pjesore e shkurtër*, që edhe mund të jetë e natyrshme, kur dihet se në këto debate shumica dërmuese e pjesëmarrësve janë të arealit gegëfolës. Mirëpo nuk ndodh e njëjta gjë me rastin e përcjellores, kur forma standarde **duke mësuar** shfaqet 75% të rasteve të monitoruara, ndërkaq format **duke mësu** dhe **tu mësu** dalin së bashku 25%. Në gjashtë debatet e analizuarë folësit kanë përdorur 32 herë paskajoren e standardit. Në formën veprorë 30 apo 94% dhe 2 apo 6% në formën joveprorë. Shembuj nga monitorimi, si: për të cilësuar, për të penguar, për të parë etj. Këto të dhëna janë të pasqyruara në grafikon.



Në gjashtë debate televizive pjesëmarrësit gjatë të folurit të tyre në disa raste kanë përdorur formën e paskajores së tipit për të + pjesore e shkurtër, në vend të pajkajores së tipit për të + pjesore e zgjeruar. Shembuj nga monitorimi, si: për të pengu, për të refuzu, për të tërheqë, për të garantu, për të cilësu, për të pa, etj., në vend për të penguar, për të refuzuar, për të tërhequr, për të penguar, për të cilësuar, për të parë etj. Këto të dhëna tregojnë për një ndikim të pjesores së shkurtër për t'u integruar në standard, krahas asaj të zgjeruar të standardit. Forma e tipit **për të mësuar** 24 përdorime apo 75%, ndërsa forma e tipit **për të mësu** 8 përdorime apo 25%. Të dhënat në grafikun ilustrojnë më së miri këto rezultate.



Forma e tipit me mësu

Paskajorja e tipit *me mësu* (e), përdoret edhe si përbërëse e kohës së ardhme të dëftores ose të kohës së tashme të kushtores, të ndërtuara me foljen ndihmëse **kam** në kohën e tashme, përkatësisht në kohën e pakryer të mënyrës dëftore p. sh.: kam me mësu (e), kisha me mësu (e). Në gegërishte ekziston edhe një tip tjetër i paskajores, forma *për me punu* (e), që ka ardhur nga kontaminimi i paskajores për të punu (e) me paskajore me punu (e). (Gjinari, J., Shkurtaj, Xh., 2003:241).


Në gjashtë debatet televizive, të cilat i kemi vëzhguar pjesëmarrësit e debateve kanë përdorur dendur paskajoren e tipit *me mësu*. Debatuasit kanë bërë gjithsej 125 përdorime.

Në forma veprare është përdorur 112 herë, apo 90%, ndërsa forma joveprare 13 përdorime, apo 10%. Shembuj nga vëzhgimi, si: me hy, me kriju, me imponu, me shpëtu, me pa, me shku, me ndërru, me gabu, me dialogu, me zbërthy, me u ballafaqu, etj. Këto rezultate janë të pasqyruara në grafikun.



Në gjashtë debatet e monitoruara, forma e tipit *me mësu* është përdorur 108, apo 86%, ndërsa forma e tipit *për të mësu* 17 përdorime 14%. Është shumë e rëndësishme të theksojmë se pjesëmarrësit e debateve televizive kanë përdorur formën e paskajores së tipit *me mësu* dhe jo *me mësuë*, apo formën e tipit *për me mësu* dhe jo *për me mësuë*. Pra, forma e pjesores del e reduktuar deri në fund. Ne nuk kemi regjistruar asnjë rast të përdorimit të paskajores me + mësuar (me + pjesore e standardit). Shembuj, si: me hy, me kriju, me imponu, me shpëtu, me pa, me shku, me ndërru, me gabu, me dialogu, me zbërthy, me u ballafaqu, etj., si dhe, për me ndryshu, për me marrë, për me ndërtu, për me bisedu, për me jetu, për me kriju, për me pagu, etj. Grafiku i mëposhtëm pasqyron rezultatet.


Paskajorja - raporti ndërmjet pwr tw + pjesore dhe me + pjesore




- Forma e tipit me mësu (me + pjesore e shkurtwr)
- Forma e tipit për të mësu (për të + pjesore e shkurtwr)

PËRCJELLORJA

Forma e dytë e pashtjelluar e foljeve në gjuhën e sotme shqipe është përcjellorja, që shfaqet në dy trajta: *duke ardhur* dhe *pa ardhur*. (Çeliku, M. 2000:57). Forma veprorë e përcjellores formohet duke i paravendosur pjesores së foljes pjesëzën *duke*. P.sh.: duke mësuar, ndërsa formës joveprorë i shtohet edhe pjesëza *u* p.sh.: *duke u mësuar*. Në mohore përcjellorja merr pjesëzën *mos*, që vihet para pjesores, p.sh.: duke mos mësuar. Në gjashtë debatet e analizuara, përcjellorja është përdorur gjithsej 48 herë. Në formën veprorë 40 përdorime, apo 83%, ndërsa në formën joveprorë 8 përdorime, apo 17%. Këto të dhëna janë të paraqitura në grafikun e mëposhtëm. Shembuj, si: duke lejuar, duke kërkuar, duke pasur, duke kompletuar etj.




Në këto debate të analizuara, forma e tipit *duke mësuar* është përdorur 36 herë, apo 75%, forma e tipit *duke mësu* 7 përdorime 15%, si dhe forma e tipit *tu mësu* 5 përdorime 10%. Shembuj, si: duke kërkuar, duke lexuar, duke biseduar, etj., duke fillu, duke leju, duke kompletu, duke diskutu, etj., tu shiku, tu plasu, tu u bazu, tu punu etj. Grafiku i mëposhtëm ilustron rezultatet.



FORMA E TIPIT PA MËSUAR

Kjo formë në debatet e analizuara nuk ka përdorim të dendur, gjithsej 6 përdorime, të gjitha janë përdorur në veprorë. Debatuesit kanë përdorur formën e tipit *pa mësuar* 3 herë, apo 50%, poashtu edhe formën e tipit *pa mësu* 3 herë 50%. Grafiku i mëposhtëm ilustron rezultatet.



Bibliografia

1. **Agalliu, Fatmir, et al.** Gramatika e gjuhës shqipe, I, II, Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, Tiranë, 2002.
2. **Beci, Bahri,** Gramatika e gjuhës shqipe për të gjithë, Tiranë, 2004.
3. **Bokshi, Besim,** Pjesorja e shqipes, vështrim diakronik, Prishtinë, 1998.
4. **Çeliku, Mehmet,** Format e pashtjelluara në gjuhën e sotme shqipe, SHBLU, Tiranë, 2000.
5. **Demiraj, Shaban,** Gramatikë historike e gjuhës shqipe, Rilindja, Prishtinë, 1988.
6. **Gjinari, Jorgji & Shkurtaç, Gjovalin,** Dialektologjia, SHBLU, Tiranë, 2003.
7. **Topalli, Kolec,** Gramatikë historike e gjuhës shqipe, 2011.
8. **Veselaj, Nuhi,** Paskajorja dhe standardizimi i gjuhës shqipe, Prishtinë, 2006.
9. http://sq.wikipedia.org/wiki/Format_e_pashtjelluara_t%C3%AB_foljes,qasja_për_herë_të_fundit 25.10. 2014).

10. [http://sq.wikipedia.org/wiki/Rreth_infnitivit_\(paskajores\)_t%C3%AB_Shqip%C3%ABs](http://sq.wikipedia.org/wiki/Rreth_infnitivit_(paskajores)_t%C3%AB_Shqip%C3%ABs), qasja për herë të fundit 12.12.2014.

Shemsi HAZIRI

SHKËMBIMI GJUHËSOR GJATË BISEDËS NË QENDRAT KOMUNIKUESE TË POLICISË SË KOSOVËS

Abstrakt

Me anë të këtij punimi sociolinguistik, të realizuar në vitin 2014 përmes një pilot-projekti, kam për qëllim që të paraqes gjendjen reale në terren (Kosovë), gjegjësisht në të folurit zyrtar të shqipes në Policinë e Kosovës. Pas anketimeve, incizimeve dhe mbledhjes së materialeve të rëndësishme në këtë fushë, i kam shtjelluar disa veçori sociolinguistike, si:

- Përdorimi dhe ndikimi i fjalëve të huaja gjatë komunikimit zyrtar në Qendrat Komunikuese të PK-së;
- Përdorimi i varianteve dialektore (krahinore);
- Analiza e fillimit dhe të mbarimit të bisedave zyrtare në Qendrat Komunikuese të PK-së;
- Analiza e brendshme e bisedave;
- Të dhënat e të anketuarve dhe incizuarve sipas analizës sociolinguistike;
- Kapaciteti i incizimeve dhe analizimi i tyre;
- Paraqitja e incizimeve sipas përqindjes, përmes figurës rrethore.

Në fund kam nxjerrë ca përfundime dhe rezultate shkencore, si dhe kam dhënë ca rekomandime, të cilat kanë për qëllim (deri - diku) zgjidhjen e problemeve komunikuese e sociolinguistike.

Fjalët kyçe: Shkëmbim gjuhësor, komunikim zyrtar, sociolinguistik, fjalët e huaja, dialektizmat, fillimi, mbarimi i bisedës, zhvillimi i bisedës, analiza gjuhësore, shqipja standarde.

1. Përdorimi i fjalëve të huaja në Qendrat Komunikuese të PK-së

Kur flasim për përdorimin e fjalëve të huaja, gjatë incizimeve dhe anketimeve në Qendrat Komunikuese të PK-së, konstatojmë se huazimet e fjalëve nga anglishtja vërehen sidomos tek shifrat thirrëse të tipit *Alfa Kontroll*, *Bravo Kontroll*, *Delta Baza* etj., por edhe te emërtimet e objekteve, vendeve, te mjetet shprehëse të pohimeve dhe

mohimeve gjatë bisedave etj. Më poshtë janë të specifikuar fjalët e huazuara nga anglishtja, apo të ndikuara prej saj, [shih më gjerësisht: *Nubiu, V.: 2013, 2008, Munishi, Sh.: 2008-2013, Paçarizj Rr.: 2011, Rugova, B.: 2010, Trudgill, P.: 2001*], por në të njëjtën kohë jam përpjekur që t'i bëj shpjegimet dhe interpretimet e tyre kuptimore në gjuhën shqipe. **QK-PRISHTINË: Lokal** (shitore, kafene¹); **market** (treg, shitore); **Alfa kontroll** (shifër thirrëse e trashëguar nga policët ndërkombëtarë të UNMIK-ut). **FERIZAJ: Lokacioni** (vendi se ku gjendet); **parkim ilegal – parkingje ilegale** (parkime të parregullta, joligjore); **tiketë** (gjobë, dënim me të holla - para); **negativ**. **GJILAN: pozitiv** (po, në rregull, kam pranuar); **konfirmo** (pohoje, njofto, raportto). **PEJË:** Gjatë incizimeve nuk ka pasur përdorime të terminologjisë së huaj. **MITROVICË: Çarlli Baza, Bravo Kontroll** (shifra thirrëse të trashëguara nga policët ndërkombëtarë të UNMIK-ut në periudhën 1999-2008), **parkingu** (nga ang. Parking place = vend-parkimi i automjeteve), **n'lokal** (kafene, bufe, pijetore). **PRIZREN: regjion** (rajon); **okej** (nga ang. OK = në rregull); **Romeo Baza, Alfa Baza, Delta 2** (shifra thirrëse të trashëguara nga policët e UNMIK-ut).

2. Përdorimi i varianteve dialektore

Varietetet dhe format dialektore janë pjesë integrale e sistemit gjuhësor në tërësi. Ato (varietetet) gjatë përdorimit gjuhësor në zonat rurale dhe në zonat urbane, fillojnë të zbehen dhe transformohen në forma më të përafërta, të cilat çdoherë përafrohen drejt standardit gjuhësor, apo të përshtatjes së përdorimit më të gjerë të bashkësive folëse. [*Shih Labor, W. 2006 si dhe Wardhaugh, R. 2006: 44-45, Munishi, Sh. 2008, 2011, 2013, Paçarizj, R. 2006, 2008. 2010, 2012, Rugova, B. 2007-2011, Ismajli, R. 1998, 2003*]. Dialektet dhe varietetet gjuhësore vijnë në shprehje duke u ndikuar nga shumë faktorë, si: ideologjikë, shoqërorë, kulturorë, e shpeshherë edhe politikë [*Wardhaugh, R. 2006: 34*]. Përdorimi i varianteve dialektore (krahinore) vjen në shprehje në të gjitha Qendrat Komunikuese të PK-së, diku më shumë e diku më pak, por që ato mbizotërojnë përkundrejt *formave standarde* të gjuhës shqipe. Unë i kam nxjerrë në përgjithësi të gjitha variantet e përdorura gjatë incizimeve në Qendrat Komunikuese të PK-së, të cilat do t'i shtjelloj edhe me format standarde të shqipes. Natyrisht se format standarde të cilat do t'i përpiloj, mund të jenë të diskutueshme, sepse standardi gjuhësor është çdoherë në zhvillim e sipër, ashtu sikurse edhe gjuha si e tillë, e cila zhvillohet nëpërmes raporteve shoqërore në përgjithësi. [shih *Memushaj, R.*

¹ Në rastin konkret jam munduar që të jap shpjegimin dhe interpretimin në pajtim me kontekstin e përdorimit, sepse në disa raste termi LOKAL/E, interpretohet në shqipen me VEND, VENDOR/E etj.

2002: 324, Hudson, R. 2002: 43-45, Lyons, J., 2001: 51-54, Rugova, B.: 2012, Paçarizj, Rr.: 2011, Munishi, Sh.: 2012]. Variantet e përdorura dialektore do të specifikohen sipas Qendrave Komunikuese veç e veç.

2.1. Veçoritë dialektore në Qendrat Komunikuese të PK-së

Gjatë analizës së varianteve dialektore të realizuara nga të gjitha qendrat e thirrjeve në Policinë e Kosovës, kam hasur në veçori dialektore, të cilat i karakterizojnë qendrat komunikuese nga njëra-tjetra. Për këto dukuri, janë veçuar disa variante dialektore, të cilat janë specifike gjatë incizimeve, dhe të cilat janë më se të shprehura në shumë raste të përdorimit në të folurit zyrtar. Më poshtë po japim disa shembuj të veçorive dialektore në qendrat komunikuese të PK-së: **PRISHTINË: Hale²** (në kuptimin – akoma, ende); e **kjart³** (e qartë, e kuptueshme); **qaty⁴** (aty). **FERIZAJ: Ferizajt⁵** (Ferizajt), **Gilanit⁶** (Gjilanit), **pa ajde ktu⁷** (eja këtu), **t'shlume⁸** (të lëshuar). **GJILAN: Nji⁹** (një¹⁰) **PEJË: Ndonji¹¹** (ndonjë), **s'është ardh¹²** (nuk ka ardhur). **MITROVICË: I sodit¹³** (i sotshëm), **thmi¹⁴** (fëmijë), **Skenderajt¹⁵** (Skenderajt), **koxho¹⁶** (goxha, mjaft, shumë), **psiqik¹⁷** (psikik). **PRIZREN: e di qi¹⁸** (e di që), **duhesh me shku¹⁹** (duhet të shkosh). Në vazhdim kam marrë si shembuj nga një fjalë nga gjashtë rajonet policore, si dhe jam përpjekur që ta jap format standarde të këtyre fjalëve: **QK-Prishtinë. Variantet dialektore: A bën m'um ma dhan emnin? Standarde: A mund të ma tregosh emrin tuaj? Ferizaj. Osht ni gërvishje.** Është një

² ZK (Zyrtar i Komunikimit) – mashkull nga një fshat i zonës së Llapit, rajoni i Prishtinës

³ ZK – femër nga një fshat i Lipjanit, rajoni i Prishtinës

⁴ ZK – femër nga Prishtina.

⁵ ZK – mashkull nga një fshat i Ferizajt

⁶ ZK – mashkull nga një fshat i Ferizajt

⁷ ZK – mashkull nga Kaçaniku, në kuadër të rajonit të Ferizajt

⁸ I njëjti nga Kaçaniku.

⁹ ZK – femër nga Gjilani.

¹⁰ Ndërsa në rastin konkret, varianti **ni** (një) përdoret në të gjitha rajonet tjera të Kosovës.

¹¹ ZK – mashkull nga një fshat i Deçanit, rajoni i Pejës.

¹² ZK – mashkull nga një fshat i Pejës.

¹³ ZK – mashkull nga një fshat i Mitrovicës.

¹⁴ ZK – mashkull nga Mitrovica.

¹⁵ ZK – mashkull nga një fshat i Skenderajt, rajoni i Mitrovicës (theksi bie tek a-ja – Skenderajt).

¹⁶ ZK – mashkull nga Skenderaj.

¹⁷ Po aty. (Nuk do të thotë se ky variant nuk përdoret edhe në rajonet tjera të Kosovës, por në rastin konkret vetëm është vërejtur si variant dialektor gjatë incizimeve të kryera).

¹⁸ ZK – femër nga Prizreni, punonjëse në Drejtorinë Rajonale në Prizren.

¹⁹ ZK – femër nga Prizreni, punonjëse në Stacionin e Policisë në Prizren.

gërvishtje. **Gjilan.** *Osht ni rast.* Është një rast. **Pejë.** *A e don numrin e dorës a të zyrës? A doni (kërkoni) numrin celular (mobil) apo të zyrës (fiks)?* **Mitrovicë.** *I sodit.* I sotshëm. **Prizren.** *Urdhno.* Urdhëro.

Shënim: *Format standarde* nuk janë doemos ato të cilat i kam paraqitur si më lart, sepse gjuha standarde zhvillohet vazhdimisht dhe ndikohet nga shumë faktorë shoqërorë përgjatë evoluimit. [shih *Memushaj, R.: 2005, Paçarizi, Rr.: 2011, Munishi, Sh. 2012, Rugova, B.: 2009*].

3. Analiza e fillimit dhe të mbarimit të bisedave në Qendrat Komunikuese të PK-së

Mbarimi i bisedave telefonike kryesisht realizohet me shprehjet: *hajt kalofsh mirë, hajte/ajde tung, faleminderit shumë.* Me anë të pasthirmës TUNG në shembujt e përdorur, nënkuptohet përshëndetja dhe *mbarimi i bisedës gjatë komunikimit zyrtar në Qendrat Komunikuese të PK-së.* Mbarimi i bisedave përmes radiolidhjeve bëhet kryesisht përmes formave të shkurtra të tipit: *E pranum, n'rregull, e kuptum, faleminderit, pranim, okej qe qitash,* për të cilat nënkuptohen si të tilla, për shkak se bashkëbisedimi i këtij lloji bëhet sa më me pak pasthirrma dhe sa më pak mjete shprehëse emocionuese (*Shih më gjerësisht në këtë fushë te: Bregasi, M.: 2010, 2013, Paçarizi, Rr.: 2006, Tabiri, L.: 2009, Ymeri, M.: 2005*). Shembuj: *Nëpërmjet telefonit: Fillimi i bisedës: Allo, policia ju lutem! (ZK 56-vjeçar²⁰). Mbarimi i bisedës: Hajde s'ka gjë, hajde, tung! Fillimi i bisedës: Policia, urdhno! (ZK 45-vjeçare). Mbarimi i bisedës: N'rregull, tung, tung! Nëpërmjet radiolidhjes: Fillimi i bisedës: Alfa Kontroll – S...! (shifra thirrëse²¹) (ZK 34-vjeçare). Mbarimi i bisedës: E kjart është, n'rregull.*

4. Analiza e brendshme e bisedave

Zhvillimi i brendshëm i bisedave ndërmjet ankuesve dhe zyrtarëve të Policisë realizohet me anë të shprehjeve të cilat formulojnë një mori pyetjesh gjatë bisedës telefonike, me qëllim që të nxirren sa më shumë informata për të rezultuar të vërtetën. Shembull: Shembull konkret: **Thirrësi:** *A keisha mujt me fol me dikun se e kom ni problem?* **Radiokomunikuesi:** *A bën m'u prezentue?* **Thirrësi:** *...* **Radiokomunikuesi:** *A bën m'um ma dhan emnin?* **Thirrësi:** *A din çka?!* **Radiokomunikuesi:** *Urdhno!* **Thirrësi:** *Se*

²⁰ ZK – shkurtesë për Zyrtar i Komunikimit në Policinë e Kosovës, i incizuar më 22.07.2014 në ora 09:40 në vendin e tij të punës në Prishtinë.

²¹ Alfa Kontroll dhe S... nënkuptojnë shifra të cilat janë të koduara për çështje operationale, kuptohen dhe janë të njohura vetëm nga zyrtarët e Policisë së Kosovës dhe organet mbikëqyrëse të PK-së.

për çikë diçka i kom nxan maribuanë, e me ma dhan ni numër dikun me kqyr për me shëru?
Radiokomunikuesi: A bën emnin e juv? **Thirrësi:** S... **Radiokomunikuesi:** S... *kushit?*
Thirrësi...(flet - nuk dëgjohet mirë) **Radiokomunikuesi:** Ku jetoni ju?..”²² Ndërsa, krejtësisht ndryshe qëndron situata e zhvillimit të brendshëm të bisedës (telefonike dhe radiolidhjeve) ndërmjet kolegëve të PK-së, pasi që ka shumë më pak pyetje për sa i përket temës kryesore të zhvillimit të bisedës. Kjo ndodh mu për shkak të besueshmërisë së ndërsjellë të punonjësve policorë (kolegëve) në mes vete. Shembull: **“Radiokomunikuesi:** Baza e Gjilanit lajmërov për XK (shifrën thirrëse). **Baza e Gjilanit:** Vazhdo... **Radiokomunikuesi:** Baza e Gjilanit, kemi marrë një informatë se n’fshatin X..... te, shtëpia e parë, është një ankes XY., i cili raporton për një rast – dhunë n’familje. **Baza e Gjilanit:** Pranoj Baza”.²³

5. Të dhënat e të anketuarve dhe incizuarve

Janë incizuar gjashtë Qendra Komunikuese Rajonale të PK-së, ku prej secilës janë incizuar dhe anketuar nga tre zyrtarë të komunikimit të PK-së, gjithsej 18 zyrtarë në tërë Kosovën, me anë të së cilave kemi nxjerrë këto të dhëna:

Shkollim i mesëm	Shkollim i lartë	Shkollim superior	Femra	Meshkuj	Mosha mesatare	
17 (të anketuar)	1	0	7	11	41.33 - vjeçare	
Mosha prej - deri	Përvoja e punës prej - deri	Përvoja mesatare	Vend-lindja urbane	Vend-lindja rurale	Vend-banimi urban	Vend-banimi rural
31-56 vjeç	5 muaj-12 vjet	7.05-vjeçare	7	11	13	5


²² Një pjesë e shkëputur nga transkripti i incizimit të zyrtarit të komunikimit në Policinë e Kosovës, të kryer më 22.07.2014 në ora 09:40 në vendin e tij të punës në Prishtinë.

²³ Pjesë nga transkripti i incizimit të kryer më 20.08.2014, në ora 13:30, në vendin e punës në Gjilan

6. Kapaciteti i incizimeve dhe analizimi i tyre gjuhësor

Nr.	Qendrat komunikuese	Koha e incizimeve	Bisedat sipas përqindjes
1	Prishtinë	12.52	36.97%
2	Ferizaj	3.39	10.49%
3	Gjilan	2.43	7.81%
4	Prizren	8.40	24.90%
5	Mitrovicë	4.06	11.78%
6	Pejë	2.48	8.05%
	Gjithsej	34.48 minuta / sekonda	100.00%

Mesatarja e incizimeve për person (respondent) është: **1 minutë e 56 sekonda**. Numri i fjalëve të përdorura: Prishtinë: 931 fjalë; Prizren: 495 fjalë; Mitrovicë: 373 fjalë; Ferizaj: 209 fjalë; Pejë: 205 fjalë dhe Gjilan: 199 fjalë. **Gjithsej: 2,412 fjalë**. Më poshtë shihni fig. rrethore:



(Figura rrethore e paraqitur me përqindje sipas rajoneve).

Përfundim

Shkëmbimi gjuhësor në Qendrat Komunikuese në Policinë e Kosovës realizohet në dy forma: nëpërmjet telefonatave dhe radiolidhjeve. Pas anketimeve, incizimeve dhe mbledhjes së materialeve në terren, është konstatuar se:

- Shkëmbimi gjuhësor realizohet kryesisht me variantet dialektore (krahinore) me pak dallime nga njëra qendër komunikuese tek tjetra - në tërë territorin e Kosovës;
- Komunikimi në shqipe është i ndikuar kryesisht nga disa emërtime dhe thirrje me terminologji të huaj – angleze; në të cilat përfshihen: subjektet dhe objektet e ndryshme përgjatë komunikimit gjuhësor;
- Zyrtarët e komunikimit të PK-së mund të them se janë të papërgatitur për sa i përket arsimimit profesional të komunikimit gjuhësor, e me theks të veçantë, kanë mungesë të shkollimit të lartë, apo superior.
- Zyrtarët e komunikimit të PK-së kanë mungesë të të shprehurit bashkëkohor, duke treguar mungesë të njohurive elementare të rregullave të standardit gjuhësor;
- Janë paraqitur disa forma të skajshme dialektore, të cilat gjatë përpjekjes time për interpretimin e tyre në formë standarde, vërehet se ndryshon komplet koncepti i fjalisë me qëllim që të arrihet forma standarde e komunikimit të përgjithshëm në shqipe: shembull: *Osh! nis patrulla* [Është duke ardhur patrulla], *A bën m'um ma dhan emnin?* [A mund të ma tregosh emrin tuaj?] etj.;
- Nisja e bisedave bëhet kryesisht me format dialektore të pasthirmave: *urdhno, allo, Policia e Skenderait, Ferizait etj.*,
- Mbarimi i bisedave bëhet me shprehjet e tipit: *hajde kalo mirë, hajde tung, u ba etj.*
- Zhvillimi i bisedave *zyrtar i komunikimit – qytetar/ankues* bëhet përmes një mori pyetjesh dhe nën-pyetjesh për të realizuar së fundmi thelbin e çështjes apo temës së caktuar, për të arritur qëllimin e bisedës apo shkëmbimit gjuhësor;
- Zhvillimi i bisedave *zyrtar i komunikimit – njësitë policore në terren* realizohet me një lehtësi dhe relaksim të shprehjeve të stilit bisedor, duke përdorur shumë pak pyetje dhe nën-pyetje, por vijnë në shprehje përdorimet e skajshme dialektore dhe krahinore.

Conclusion

Language exchange in Communication Centres in Kosovo Police is realized in two forms: through phones and radios. Surveys, recordings and other material gathered in the field, have shown that:

- Language exchange is mainly realized through (regional) dialects with few distinctions between communication centres – Kosovo wide;
- Communication in Albanian is mainly influenced by several nominations and foreign – English terminology; where there are included: different subjects and objects during language communication;
- In general, I dare say, KP communication officers are unprepared when it comes to professional education of language communication, and particularly they lack superior education (from 18, none of them has superior education);
- KP communication officers lack expressions of contemporary communication, showing to a certain extent lack of basic knowledge of rules of language standard;
- Several extreme dialectical forms were noticed, and after my efforts to make their interpretation in standard form it was noticed that the concept of sentence changes in order to achieve the standard form of general communication in Albanian: *Osh! nis patrulla* [Është duke ardhur patrulla], *A bëh m'um ma dhan emnin?* [A mund të ma tregosh emrin tuaj?] etc.;
- Beginning of conversations is mainly done through dialectal forms of exclamations: *urdbno, allo, Skenderaj Police, Ferizaj Police* etc.;
- Ending of conversations is done through expressions like: *hajde kalo mirë, hajde tung, u ba, pralum* etc.;
- Conversations between *communication officers – citizens/complainants* is done through several questions and sub questions in order to achieve in the end the main goal of the issue or topic, to achieve the objective of conversation or language exchange;
- Conversations between *communication officers – police units in the field* are realized with an ease and relaxed style of conversation style, by using very few questions and sub questions, but there are noticed extreme uses of dialectical and regional dialects.

Rekomandime

- Të avancohen kriteret e përzgjedhjes së zyrtarëve të komunikimit në Qendrat Komunikuese të PK-së, duke përfshirë: shkollimin profesional, trajnimet që kanë të bëjnë me respektimin e normave gjuhësore në të folurit zyrtar.
- Të lehtësohet komunikimi në pajtim me rregullat standarde gjuhësore, duke u hartuar një UDHËZUES (DORACAK) - për radiokomunikuesit në qendrat e thirrjeve telefonike dhe radiolidhjeve, me mjetet shprehëse gjuhësore, duke përfshirë: fillimin, zhvillimin dhe mbarimin e bisedës me palën ankuese, bashkëpunuese apo bashkëbiseduese.
- Të hartohet një strategji e komunikimit të Policisë së Kosovës brendapërbrenda organizatës dhe jashtë saj, duke përfshirë trajnimin e vazhdueshëm të zyrtarëve të komunikimit, në të cilën do të përcaktoheshin: kostoja, kohëzgjatja dhe palët e përfshira për zbatimin e strategjisë.
- Të ngritet profesionalizmi dhe imazhi i Policisë së Kosovës, përmes komunikimit profesional në përputhje me standardet bashkëkohore, duke respektuar standardin gjuhësor.

Bigliografia

- Beci, Bahri (2003), Probleme të politikës gjuhësore dhe të planifikimit gjuhësor në Shqipëri, Dukagjini, Pejë.
- Bregasi, M. (2010), Biseda në debatet televizive politike në Shqipëri dhe Kosovë, Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare 29/1, Prishtinë.
- Bregasi, M. (2013), Analiza e bisedës në debatet publike (disertacion i doktoratës) i mbrojtur në UP, Fakulteti i Filologjisë, Prishtinë.
- Holmes, Janet (2001), An Introduction to Sociolinguistics, Lancaster University.
- Hudson, A. Rich. (2002), Sociolinguistika, përkth. nga Mariana Ymeri, DITURIA.
- Labov, William (2006), The Social Stratification of English in New York City, Second Edition, Cambridge University Press.
- Lyons, John (2001), Hyrje në Gjuhësinë Teorike, përkthyer nga dr. Ethem Likaj, botim i parë në shqip nga DITURIA.
- Lloshi, Xhevat (2000), Stilistika dhe Pragmatika, Tiranë.
- Memushaj, Rami (2002), Hyrje në gjuhësi, DITURIA.
- Munishi, Shkumbin (2013), Mbi drejtimit e mundshme të zhvillimit të studimeve sociolinguistike të shqipes, Language and Society, (në internet).
- Munishi, Sh. (2013) Gjuha, kombi dhe identiteti te shqiptarët, Lang. and So. (internet).

- Munishi, Sh. (2008), Gjuha standarde dhe variacioni sociolinguistik, po aty (në internet).
- Munishi, Shkumbin (2011), Gjuha dhe ideologjia, Filologji 18, UP.
- Munishi, Sh. (2008), Roli i faktorëve shoqërorë në përcaktimin e gjuhëve, Language and Society (në internet).
- Munishi, Sh. (2008), E ardhmja gjuhësore e Evropës, Lang. and Society, (në internet).
- Munishi, Sh. (2012), Probleme të zbatimit të dygjuhësisë shqip-serbisht në Kosovë, Language and Society, (në internet).
- Nuhiu, Vesel (1990), Ndikimet ndërgjuhësore, Prishtinë.
- Nuhiu, Vesel (2013), Ndikimi i anglishtes në gjuhën shqipe, ASHAK.
- Nuhiu, Vesel (2008) Shqipja dhe huazimet angleze sot, Thesis Kosova nr.1.
- Ismajli, Rexhep (2003), Standarde dhe identitete, Dukagjini, Pejë.
- Ismajli, Rexhep (1998), Në gjuhë dhe për gjuhë, Dukagjini, Pejë.
- Trudgill, Peter (2000), Sociolinguistics an introduction language and society, England.
- Wardhaugh, R. (2006), An Introduction to Sociolinguistics, Fifth edition, UK.
- Paçarizi, Rrahman (2006), Gjuha e mesenxherit, Filologji 14, Prishtinë.
- Paçarizi, Rr. (2008), Shqipja – globalizimi dhe glocalizimi, SNGJLKSH 27/1, Prishtinë.
- Paçarizi, Rr. (2009), Interferenca ndërmjet gjuhës së folur dhe gjuhës së shkruar gjatë prodhimit gjuhësor, SNGJLKSH 28/1, Prishtinë.
- Paçarizi, Rr. (2010), Natyra psikologjike e gjuhës si veti unike njerëzore, SNGJLKSH 29/1, Prishtinë.
- Paçarizi, Rr. (2010), Rruga e zhvillimit të shqipes standarde në raport me nevojat e komunikimit, Shqipja në etapën e sotme: politikat e përmirësimit dhe të pasurimit të standardit, Qendra e Studimeve Albanologjike, Tiranë.
- Paçarizi, Rr. (2011), Shqipja standarde në parametrat psikolinguistikë, PEN Qendra e Kosovës, Prishtinë.
- Rugova, Bardh (2007), Parimet e rregullave të tekstit të titujt e gazetave, SNGJLKSH 26/1, Prishtinë.
- Rugova, Bardh (2009), Gjuha e gazetave, Koha, Prishtinë.
- Rugova, Bardh (2011), Pozita dhe statusi i shqipes kundruall gjuhëve të tjera të Ballkanit, Shqipja dhe gjuhët e Ballkanit, ASHAK, Prishtinë.
- Tahiri, Lindita (2009), Përdorimi i ligjërimeve bisedore në gjuhën e mediave në Kosovë, SNGJLKSH 28/1, Prishtinë.

- Ymeri, Mariana (1993), Raportet gjuhë standarde-dialekt në opinionet e studentëve, Gjuha jonë 1-4, Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, Tiranë.
- Ymeri, Mariana (2005), TËiparet e ligjërimit të folur në chat, Gjuha jonë 1-4/, ASHSH, Tiranë.

Manjola LUBISHTANI

ZOTËRIMI I NORMËS DREJTSHKRIMORE NGA NXËNËSIT DHE MËSIMDHËNËSIT NË SHKOLLAT FILLORE

Hyrje

Gjuha standarde ka hyrë tashmë në dekadën e pestë të kodifikimit e të funksionimit të saj si gjuhë e prestigjit në të gjitha sferat publike ku shkolla, si institucion themeltar i edukimit gjuhësor, zë një vend të rëndësishëm për përdorimin dhe kultivimin e këtij varieteti. Me gjithë periudhën e gjatë në të cilën ka kaluar standardizimi i gjuhës shqipe dhe të përpjekjeve për pranim e zotërim, zbatim i saj në praktikë (në të dyja format themelore: në të folur e në të shkruar) nuk është i kënaqshëm.

Sh. Islamaj (2010) radhit një sërë faktorësh që përcaktojnë sot zhvillimin e shqipes standarde dhe, rrjedhimisht, edhe problemet që shfaqen në këtë rrafsh, disa prej të cilëve, si: cilësia e shkollës shqipe, (duke përfshirë këtu procesin e mësimdhënies), përgatitja e kuadrove, cilësia e teksteve mësimore, shkalla e ulët e kulturës gjuhësore, i adresohen pikërisht shkollës dhe funksionit të saj. Ndërsa Rr. Paçarizi (2011: 119) vë theksin në ndarjen e thellë ndërmjet elitave intelektuale, politike dhe kulturore në Prishtinë dhe Tiranë, një hendek ky që ka ndikuar edhe finalizimin e normimit të drejtshkrimit të gjuhës standarde, si kusht themelor i standardizimit dhe i proceseve përcjellëse. Ai (2008: 108) e sheh shtrirjen e gjuhës standarde të përqendruar kryesisht në shkollë, në një pjesë të letërsisë dhe në medie, duke e cilësuar pranimin e saj nga qarqet intelektuale në Kosovë si nevojë identitare e jo si një proces të natyrshëm standardizimi (shih: Hudson, 2001: 43), i cili do të garantonte funksionalitetin dhe pranueshmërinë e gjerë në domenet përkatëse të përdorimit.

“Duke qenë se gjuha e folur, - konstaton R. Memushaj (2009: 188), - i nënshtrohet më me vështirësi kodifikimit, në stadin e sotëm të gjuhës standarde shqipe drejtshkrimi luan një rol udhëheqës ndaj drejtshqiptimit: përcaktimi normativ i gjuhës së shkruar do t’u hapë rrugë normave të gjuhës së folur”. Edhe sipas Sh. Munishit (2006: 116) “planifikimi gjuhësor, si përpjekje e vazhdueshme e një bashkësie shoqërore për të pasur një gjuhë standarde, fillon me normimin e drejtshkrimit”.

Pikërisht, në këtë punim ne do të ofrojmë një pasqyrë të shkallës së zotërimit të normës drejtshkrimore nga nxënësit dhe mësimdhënësit, si faktorë dominues të nxënies dhe të transmetimit të suksesshëm të saj. Mostrën tonë e përbëjnë 150 nxënës të ciklit të lartë dhe 14 mësimdhënësit të ciklit të ulët, rezultatet e përpunuara të të cilëve do t'i vjelim nga analizimi i eseve me temë “Përshtypjet e mia nga ekskursioni i fundvitit” të shkruara nga nxënësit, si dhe nga rubrikat e procesverbalet e ditareve të mësimdhënësve të shkollës fillore “Vezir Jashari” në qytetin e Ferizajt, e cila është formuar para shtatë vjetësh me përzgjedhjen e mësimdhënësve dhe të nxënësve nga dy shkolla të tjera të këtij qyteti: “Tefik Çanga” dhe “Gjon Serreqi”, shkolla me një traditë mbi 60-vjeçare në fushën e arsimit fillor.

Për realizimin e hulumtimit kemi përdorur këto metoda: metodën e analizës teorike, metodën përshkruese, metodën statistikore dhe metodën krahasuese.

Të dhënat e përfuara do t'i shërbejnë argumentimit të mëtejshëm e të nevojshëm për të krijuar një bazë të shëndetshme e frytdhënëse në konsolidimin e standardit të shqipes në domenin arsimor, si një nevojë e kërkesë emergjente e funksionimit të tij.

1. Norma drejtshkrimore në procesin arsimor

Shkolla është institucioni që lidhet drejtpërdrejt me edukimin e mirëfilltë gjuhësor të nxënësve. Por, krahas formimit gjuhësor të tyre, ajo luan një rol të rëndësishëm edhe në përsosjen e vazhdueshme të vetë mësimdhënësve, veçanërisht të atyre që ligjërojnë gjuhën shqipe si në ciklin e lartë, ashtu dhe në atë të ulët (fillor). “Shkolla, shkruan S. Kuçi (2006: 306), sipas parimit tradicional, e ka për detyrë që t’u mësojë nxënësve normat e gjuhës së shkruar dhe gjuhës së folur. Formimin fillestar gjuhësor e marrin njerëzit që më vonë ushtrojnë profesione të ndryshme, si: të mësuesit, aktorit, shkrimtarit, folësve në radio e televizion, politikanit, gazetarit e të tjerëve”. Një rol të tillë bazik shkollës i atribuon edhe F. Raka (2005: 9), i cili shkruan se “ rregullat e veçanta të normës së gjuhës standarde individit fillon t’i mësojë në shkollë dhe vazhdon t’i zgjerojë gjatë gjithë jetës së tij”.

2. Analizë e zotërimit të normës drejtshkrimore nga nxënësit

Norma drejtshkrimore përbën një nga hallkat e procesit normëzues të një gjuhe. Drejtshkrimi ose ortografia (nga gr. *orthos* – i drejtë dhe *grapho* – shkruaj) është një sistem rregullash që përcaktojnë: 1) shkrimin e fjalëve dhe të morfemave të tyre (rrënjëve, parashtesave, prapashtesave, mbaresave); 2) shkrimin e fjalëve njësh, ndaras

dhe me vizë në mes; 3) përdorimin e shkronjave të mëdha; 4) ndarjen e fjalëve në fund të rreshtit (Dodi, 204: 234). Edhe argumentimet tona për shkallën e përvetësimit të normës i kemi mbështetur në analizimin e përdorimit të këtyre rregullave nga vetë nxënësit. Tema e esesë, me qëllim të konstatimit të përdorimit të trajtës së emrit *ekskursion*, nuk u është shkruar në tabelë, por u është transmetuar gojarisht. Nga analiza dhe përpunimi i të dhënave kemi hasur **749** raste të thyerjes së normës drejtshkrimore nga nxënësit, të cilat do t'i paraqesim ashtu si janë shkruar, ndërsa në kllapa do të japim trajtat korrekte normative.

2.1. Shkrimi i fjalëve dhe i morfemave të tyre (trënjëve, parashtesave, prapashtesave, mbaresave)

a) Shkeljet e normës drejtshkrimore gjatë përdorimit të zanoreve

Gjatë hulumtimit kemi konstatuar **494** raste të shkeljes së normës lidhur me drejtshkrimin e zanoreve ose 72.55% të 681 rasteve të hasura në këtë kategori (përfshirë edhe drejtshkrimin e bashkëtingëlloreve) dhe 65.96% të thyerjes së normës nga nxënësit në të gjitha kategoritë e analizuara. Prej tyre: 351 raste ose 71.05% të thyerjeve të normës brenda grupit të zanoreve e përbëjnë shkeljet gjatë përdorimit të zanores **ë** të patheksuar. Rënia e kësaj zanoreje haset në pozicion paratheksor, në pozicion pastheksor dhe në pozicion fundor te një numër fjalësh të evidentuara.

- **ë-ja paratheksore:** Shkeljet e konstatuara përfshijnë 45 raste ose 12.82% të mosshkrimit të *ë-së* në këtë pozicion, p.sh.: *gjelbrim (gjelbërim)*, *knaqsi (kënaqësi)*, *prshlytje (përshlytje)*, *udbtim (udbëtim)*, *shtitjes (shëtitjes)*, *fatkeqsisht (fatkeqësisht)*, *vallëzanim (vallëzënim)* etj.

- **ë-ja pastheksore:** 38 raste ose 10.83% të trajtave jonormative të konstatuara, p.sh.: *nxënsit (nxënësit)*, *lojra (lojëra)*, *mirpo (mirëpo)*, *njerziti (njerëziti)*, *mbresëlense (mbresëlënëse)* etj.

- **ë-ja fundore:** 268 raste ose 76.35% të trajtave jonormative, p.sh.: *bardhuc (bardhucë)*, *dit (dië)*, *gryk (grykë)*, *shkoll (shkollë)*; *jon (jonë)*, *vet (vetë)*, *un (unë)*; *i qet (i qetë)*, *e vërtet (e vërtetë)*; *pam (pamë)*, *do të kalojm (do të kalojmë)*, *të vizitojm (të vizitojmë)*, *ka rën (ka rënë)*, *kan (kanë)*, *jan (janë)*; *shum (shumë)*, *ngadal (ngadalë)*; *gjat (gjatë)*, *bashk me (bashkë me)* etj.

- Në 95 raste ose 19.23% të shkeljeve në grupin e zanoreve kemi konstatuar dukurinë e shtimit të zanores së patheksuar **ë** në të tria pozicionet: paratheksor (9 raste), pastheksor (4 raste) dhe fundor (82 raste). Këto shkelje i kemi hasur në disa pjesë të ligjëratës, si: **emra** (diellë, vitë, vendë, heronjë, planë, e enjëte, pasardhësitë,

Prizëren, Jezercë, krosë, miqë, mjerimë etj.; **mbiemra** (i madhë, ujë mineralë, mikëpritës, i pijëshëm, shqipëtare, i paharruarë etj.); **folje** (kaluamë, ishimë, jamë, kamë, ishim ulurë, (ai) mbanë, (unë) ta kalojë etj.); **ndajfolje** (lartë, shpejtë, drejtë, mjaftë, pakë etj.); **përemra** (gjithëçka, e tijë); **parafjalë** (përë); **lidhëza** (porë); **pjesëza** (nukë, veq(ë)anërishtë, dotë). Po ashtu, kemi hasur pak raste të shfaqjes së trajtave jonormative me **ë** në vend të atyre me **e**: *nisjën (nisjen), të premtën (të premtën), shogët (shoqet), ishtë (ishtë), të rritëmi (të rritemi)*.

- **Grupet ua, ue**: Kemi hasur 8 raste ose 1.62% të shkeljeve të normës në lidhje me shkrimin jo të plotë- në fushën e emrave, të mbiemrave e të foljeve- të grupeve **ua / ue**: *kron (krua), përro (përrua); të gëzjur (të gëzuar); fillum (filhuam); të mrekullshëm (të mrekullshëm)*.

- **Apostrofi**: Duke u mbështetur në rregullat e përdorimit të apostrofit (1974: 67) gjatë hulumtimit kemi hasur 40 raste ose 8.1% të shkeljeve të normës lidhur me: a) mospërdorimin e tij: **ti** *harrojmë, ti presim; për tu nisur; sdo ta harronte, smund të ecja, si dëjjoja, sna mungonte, se kemi pasur; çti bësh* etj., dhe b) përdorimin e gabuar të tij: **i'a vlente (ia vlente)** etj.

b) Shkeljet e normës drejtshkrimore gjatë përdorimit të bashkëtingëlloreve

Në fushën e drejtshkrimit të bashkëtingëlloreve janë konstatuar **187** raste ose 27.45% të thyerjeve të normës lidhur me shkrimin e fjalëve dhe të morfemave të tyre, dhe 24.97% të thyerjes së normës nga nxënësit në të gjitha kategoritë e analizuara. Prej tyre po veçojmë:

a) 27 raste (14.43%) trajtash jonormative të shkrimit të **j-së**, te të cilat, përveç dy rasteve të mospërdorimit të **j-së** ndërzanore: *batanie (batanije), nevoitej (nevojitej)*, dominon shkrimi jonormativ i kësaj bashkëtingëlloreje në pozicion ndërzanor te: a) trajtat e emrave të gjinisë femërore që dalin më zanoren e theksuar **-i**, si: *bukurija (bukuria), gjamija (xhamia)*; b) trajta e përemrit pronor *e mija (e mia)*, trajtë të cilën e kemi hasur në 20 raste të shfaqjes së saj; c) trajta e shkurtër e përemrit vetor të vetës së tretë **i** e cila bashkohet me pjesëzën **u** të pësore-vetvetores përpara foljes (Drejtshkrimi, 1974: 79): *ju morën mendtë (iu morën mendtë)*; b) 52 raste (27.8%) të përdorimit në vend të njëra- tjetrës të bashkëtingëlloreve **ç / q** dhe **xb / gj** me mbizotërimin e 46 rasteve të përdorimit të **q-së** në vend të **ç-së**: *u qudita, qantën, qaste, qika, plaqkat, qdo, gjithqka, diqka, siq, përveq, veqanërisht* etj.; *çëndronin (qëndronin); gjami(j)a (xhamia); dëxhova (dëjjoja)*, dhe 3 raste të përdorimit të **gj-së** në vend të **ç-së**: *gjdo (çdo)*; c) 91 raste (48.67%) të shkrimit jonormativ të fjalëve me prejardhje të huaj, prej tyre: *voliboll (volejball); profesjoniste (profesioniste); egzistonte (ekzistonte); autobus (autobus)*, të cilën e kemi hasur edhe

në këto forma: *aftobusi, autubusët* që, gjithsesi, shfaqin shmangie të normës. Një dominancë të theksuar shfaq në këtë grup edhe prania e 83 rasteve të trajtave jonormative të fjalës *ekskursion* (fjalë bosht e eseve të analizuara) kundrejt 27 rasteve të përdorimit normativ të kësaj fjale. Disa nga trajtat jonormative i kemi hasur në këto forma: *ekskurzion (48 raste), eksurzion (11 raste), eskurzion (7 raste)*; dhe me nga një rast të shfaqjes së tyre: *ekzurionit, eksursionit, eskruzion, eksuzion, ekskerzion, eksksion, eskursion, eskurzjonit, ekzurzionit, ekskusionit, eskusion, ekursion, erskurzion, ekzurcion, ekskurcionin, ekskuzionin, ekuzionin, eksursion.*

2.2. Shkrimi i fjalëve njësh, ndaras dhe me vizë në mes

A. Shkruhen njësh, si një fjalë e vetme, pa vizë në mes: a) fjalët me parashtesa; fjalët e përbëra e të përngjitura (Drejtshkrimi, 1974: 126-127). **15** raste ose 2% të thyerjes së normës nga nxënësit në të gjitha kategoritë e analizuara, pasqyrohen në disa pjesë të ligjëratës, si: **mbiemra** (6 raste): *të pa harrueshme, i pa harruar etj.*; **përemra** (1 rast): *gjith(ë) çka (gjithçka)*; **ndajfolje** (3 raste): *për tokë (përtokë), një herë (njëherë), pak sa (paksas)*; **lidhëza** (3 raste): *tek sa (teksas), me që (meqë), po sa (posas).*

B. Shkruhen me vizë lidhëse në mes: a) formimet e përfutuara nga përsëritja e një fjale në të njëjtën trajtë ose në trajta të ndryshme (1974: 133). Kemi hasur vetëm 2 raste të trajtave jonormative **të përemrit të pacaktuar**: *njëra tjetra (njëra – tjetra), njëri tjetrit (njëri – tjetrit).*


2.3. Përdorimi i shkronjave të mëdha

Janë konstatuar **25** raste (3.33%) të shmangies së normës drejtshkrimore gjatë përdorimit të shkronjës së madhe. 17 raste (68%) i referohen përdorimit të shkronjës së vogël në vend të asaj të madhe: *jezerc, vezir jashari, prekazi, pejë, prizren, donika, editën* etj.; 8 raste (32%) shfaqin përdorimin jonormativ të shkronjës së madhe në vend të së voglës: *Babit, Mamit, e Premtja, Motrës, (dëgjoja) Muzikë, (me) Arsimitarët.*

2.4. Ndarja e fjalëve në fund të rreshtit

Ndarja e fjalëve në fund të rreshtit mbështetet kryesisht në ndarjen e fjalëve në rrokje, duke marrë parasysh edhe strukturën morfologjike të fjalës (Drejtshkrimi, 1974: 161). Në punim kemi pasqyruar **28** raste (3.74%) të thyerjes së normës në ndarjen e fjalëve në fund të rreshtit. Kështu: 13 raste (46.42%) të lënies në fund të rreshtit të një shkronje të vetme, bashkëtingëllore a zanore: *ecni-m, çanta-t, të gjith-a, tim-e, u nisë-m, ta*

ngjisni-m, ditë-t, rrug-a, duk-e etj.; 11 raste (39.28%) të mosrespektimit të rregullës së kalimit të bashkëtingëllores intervokalike me zanoren pasardhëse (1974: 162): *Jeze-rc, e buk-ur, rreth-onte, qesh-arake, mal-et, bashkëmosh-atarëve, grumb-ullin* etj.; 2 raste (7.14%) kur bashkëtingëllorja *j* e ndjekur nga një bashkëtingëllore tjetër nuk është lënë me zanoren që i prin (f. 163): *vole-jboll, duke lua-jtur*; 1 rast (3.57%) të ndarjes së shkronjave të një dyshkronjëshi (f.165): *ud-bëtim*; 1 rast (3.57%) të ndarjes së fjalës së formuar me parashtesë njërrrokëshe: *duke përf-unduar (duke për-funduar)*.



Grafiku 1

Të dhënat e paraqitura në grafikun e mësipërm pasqyrojnë një shkallë të lartë dominuese të thyerjeve në shkrimin e zanoreve (**65.96%**), e cila ndiqet nga thyerjet në drejtshkrimin e bashkëtingëlloreve (**24.97%**), duke përbërë edhe **90.93%** të shkeljeve të normës nga nxënësit, të cilat pasohen nga **3.74%** të thyerjeve që i takojnë ndarjes së fjalëve në fund të rreshtit; **3.33%** të thyerjeve në përdorimin e shkronjave të mëdha, dhe **2%** të thyerjeve në shkrimin e fjalëve njësh, ndaras e me vizë në mes, vlera dëshmuose mjaft të larta për shkallën e moszotërimit të normës drejtshkrimore nga nxënësit e shkollës fillore.

3. Analizë e zotërimit të normës drejtshkrimore nga mësimdhënësit

E thamë edhe më lart se shkolla luan një rol të rëndësishëm në njohjen dhe zotërimin e normës drejtshkrimore e drejtshqiptimore. Formimi profesional, vullneti, ndërgjegjësimi dhe përgjegjësia e mësimdhënësve në përmbushjen e këtij misioni themelor për edukimin e brezave të rinj, i shndërron ata në hallkën kryesore të këtij procesi ndërmarrëdhënior (nxënës – mësues). Gjatë hulumtimit të realizuar nga vëzhgimi i rubrikave të ditareve, të cilat shërbejnë për të shënuar njësitë mësimore për

çdo orë dhe çdo lëndë, dhe të procesverbaleve të mësimdhënësve të ciklit fillor kemi konstatuar **397** raste shkeljesh të normës drejtshkrimore.

3.1. Shkrimi i fjalëve dhe i morfemave të tyre (rrënjëve, parashtesave, prapashtesave, mbaresave)

a) Shkeljet e normës drejtshkrimore gjatë përdorimit të zanoreve

Janë konstatuar **253** raste të shkeljes së normës lidhur me drejtshkrimin e zanoreve ose 74.41% të 340 rasteve të hasura (përfshirë edhe drejtshkrimin e bashkëtingëlloreve) dhe 63.72% të thyerjes së normës nga mësimdhënësit në të gjitha kategoritë e analizuar. Prej tyre: 153 raste (45%) të thyerjeve të normës brenda grupit të zanoreve e përbëjnë shkeljet gjatë përdorimit të zanores **ë** të patheksuar, rënia e së cilës është hasur në të tria pozicionet. Kështu, **ë-ja paratheksore** shfaqet në 42 raste (27.45%) të thyerjes së normës, p.sh.:

(1) *Smundjet parazitore* (2) *Të flasim: Pushimet dimrore* (3) *Historia e njerzimit* (4) *Udhtimi dikur dhe tani* (5) *Përpunimi i tekstit: Ngatrrresa gjubësore* (6) *Pjestimi i numrave* etj.

- **ë-ja pastheksore**: 18 raste ose 11.77% të trajtave jonormative të konstatuara, p.sh.: (1) *Lojra stafetore* (2) *Principata e Shkodrës, e Durrsit dhe e Artës* (3) *Drejt këndshi dhe sipërfaqja drejt këndshe* etj.

- **ë-ja fundore**: 93 raste ose 60.78% të trajtave jonormative të këtij grupi, p.sh.: (1) *Veçorit e artit figurativ* (2) *Mbledhja e numrave dyshifror pa kalim të dhjetëshes* (3) *Hedhja e topit përmbi rrjet të volejbollit* (4) *Dëgjojmë muzik* (5) *E dini sa stin ka viti?* (6) *Numri i dyfisht* etj.

- Në 68 raste ose 26.87% të shkeljeve në grupin e zanoreve kemi konstatuar dukurinë e shtimit të zanores së patheksuar **ë**, p.sh.: *mishëshitës, drejtëshkrim, drejtëkëndëshi, fatëkeq, tregëtar*, si dhe te një numër emrash, mbiemrash, foljesh e ndajfoljesh në pozicion fundor: (1) *Kam një mace, kam një qenë* (2) *Testë vlerësues* (3) *Automobili, ndotës i madhë* (4) *Në Vlorë u shpallë pavarësia e Shqipërisë* (5) *Kërce më shpejtë* etj.;

- 10 raste ose 3.95% të trajtave të cilat grupet **ua / ue** nuk janë shkruar drejt ose janë shkruar të paplota, p.sh.: *gjuetjia (gjuajtja); muj (muaj); pastruse (pastruese)* etj.;

- 22 rastet e konstatuara ose 8.69% e trajtave jonormative të zanoreve pasqyrojnë: a) mospërdorimin e apostrofit: *do tia dalim, ti shoqërojnë, për tu përmendur; çdubet ditur* etj.; dhe b) përdorimin e gabuar të tij: *Ç'ka janë vetëdija dhe sjellja (çka), ç'do njeri (çdo njeri)* etj.

b) Shkeljet e normës drejtshkrimore gjatë përdorimit të bashkëtingëlloreve

Nga përpunimi i të dhënave kemi konstatuar **87** raste ose 25.59% të thyerjeve të normës lidhur me shkrimin e fjalëve dhe të morfemave të tyre, dhe 21.91% të thyerjes së normës nga mësimdhënësit në të gjitha kategoritë e analizuara. Këtu po paraqesim vetëm disa nga shembujt që pasqyrojnë thyerjet në këtë kategori:

- a) **Materjalet** ndërtimore; *Vizatim: Lagja ime (lagja); ...gjatë këti viti shkollor (këtij);*
- b) *Kënga: Po len qeni (leh); Lëngjet avullojnë, vlojnë dhe ngriten vetvetiu (ngrihen);*
- c) *rathë (rrathë), rokjet (rrokjet), rinë (rrinë), burë (burrë), rimarje (rimarrje), rradha (radha);*
- ç) *ngrënjes (ngrënies), qenjet (qeniet), mësimxënjes, mësimdhënjes (mësimdhënies)*
- d) *akvarium (akuarium), bibliotekë (bibliotekë), aeroport (aeroport);*

Po ashtu, shmangie të normës kemi hasur edhe në 7 raste (8.05%) të përdorimit të zanoreve **z** e **c** në vend të asaj **s** në fjalët: *diciplina / disciplina (disiplina), diverziteti (diversiteti), univerzitetit (universitetit), barazpeshim (baraspeshim).*

Rastet e përdorimit në vend të njëra- tjetrës të bashkëtingëlloreve **ç / q** dhe **xb / gj** i kemi konstatuar edhe te mësimdhënësit si në rubrikat e ditarëve, ashtu edhe në tekstet e procesverbaleve. Kështu, shfaqen 36 raste (41.38%) të përdorimit jo të drejtë në një numër fjalësh: *qifte (çifte), kaluqi, qështje, diqka, Korqa, qdo, përveq, duke vequar etj.; çarkun (qarkun), shkoçitur, çershitë, miç, çershori, udhëheçja etj.; menagjer, zhurmagji(nj); maxhistër (magjistër).*

3.2. Shkrimi i fjalëve njësh, ndaras dhe me vizë në mes


Janë konstatuar **10** raste (2.52%) të thyerjes së normës: a) në shkrimin njësh, si një fjalë e vetme, pa vizë në mes të fjalëve me parashtesa; të fjalëve të përngjitura e të përbëra. Kryesisht, kjo dukuri është shfaqur te mbiemrat: *të pa arsyeshme (ta paarsyeshme), i pa dëmtuar (i padëmtuar), i pa punë (i papunë), i pa notuar (i panotuar);* te emrat: *jo barazimet (jobarazimet), ping –pongut (pingpongut);* te ndajfoljet: *një zëri (njëzëri);* b) në shkrimin ndaras të parafjalës ose të shprehjes lidhëzore: *paarsye (pa arsye), në çoftëse (në qoftë se);* c) në shkrimin me vizë në mes të përemrit të pacaktuar: *Fjalitë ndryshojnë nga njëra tjetra (njëra – tjetra).*

3.3. Përdorimi i shkronjave të mëdha

17 trajta ose 4.29% e rasteve të konstatuara në thyerjen e normës drejtshkrimore pasqyrojnë: a) emërtimet zyrtare të institucioneve të shtetit: (1) *Hapja e universitetit dhe e akademisë së Shkencës* (2) *...të gjitha tekstet e tjera janë siguruar nga ministria e arsimit*; b) emërtime të periudhave, të ngjarjeve historike me rëndësi kombëtare ose ndërkombëtare: (1) *Personalitete të rilindjes kombëtare nga Kosova* (2) *Shqiptarët gjatë luftës së dytë botërore*; c) emërtime të shtëpive botuese: *dukagjini, libri shkollor*; ç) emërtime të festave kombëtare e ndërkombëtare: (1) Të shkruajmë: *Një qersbori* (Një Qersbori); (2) *28 nëntori – Dita e flamurit* (3) Të vizatojmë: *Viti i ri*; d) emërtimi i njëjësive mësimore: (1) Të shkruajmë: *të parët tanë* (Të parët tanë); (2) Këndimi i këngës: *trokiti vjeshta* (Trokiti vjeshta) etj.

3.4. Ndarja e fjalëve në fund të rreshtit


Numri i rasteve të konstatuara (30 raste ose 7.56%) të thyerjes së normës në ndarjen e fjalëve në fund të rreshtit nga mësimdhënësit, përqindje kjo që është mbi 2 herë më e lartë sesa te thyerjet e hasura në dorëshkrimet e nxënësve (3.74%), tregon për një situatë të pakënaqshme të zotërimit të normës, sidomos kur kemi parasysh se njësitë mësimore që i referohen kësaj kategorie të normës janë pjesë e planit dhe e programit mësimor të ciklit fillor. P.sh.: *avullo-jnë* (*avulloj-në*), *dre-jtëzat* etj.; *vrap-ime*, *ver-ore*, *kontroll-ues* etj.; *bashk-ësisë*, *vepr-im*, *numr-ave* etj.; *gabimng-rënës* (*gabim-ng-rënës*), *i përgj-itshëm* (*i për-gjithshëm*) etj.; *Fjalitë ndryshojnë nga njëra – tjetra* (*ndry – shojnë*).



Grafiku 2

Edhe në pasqyrimin e këtyre rezultateve vihet re një shkallë e lartë e mbizotërimit të thyerjeve në shkrimin e zanoreve (**63.72%**), pasuar nga thyerjet në shkrimin bashkëtingëlloreve (**21.91%**), të cilat përbëjnë **85.63%** të thyerjeve të normës nga mësimdhënësit, vlera këto mjaft të përafërta me shkeljet e normës nga nxënësit (**90.93%**).

Rezultatet krahasuese të thyerjes së normës nga nxënësit dhe mësimdhënësit



Grafiku 3

Në këtë grafik kemi paraqitur të dhënat përfundimtare të hulumtimit, krahasimi i të cilave dëshmon për një shkallë shumë të përafërt të moszotërimit të normës drejtshkrimore si nga nxënësit, ashtu edhe nga mësimdhënësit. Dallimi në drejtshkrimin e zanoreve është: **2.24%** më shumë thyerje nga nxënësit (**65.96% vs. 63.72%**); në drejtshkrimin e bashkëtingëlloreve sërish dominojnë nxënësit me **3.06%** më shumë thyerje të normës (**24.97% vs. 21.91%**); ndërsa në tri kategoritë e tjera dominojnë mësimdhënësit me: **0.52%** në shkrimin e fjalëve njësh, ndaras e me vizë në mes (**2% vs. 2.52%**); **0.96%** në përdorimin e shkronjave të mëdha (**3.33% vs. 4.29%**); dhe **3.82%** në ndarjen e fjalëve në fund të rreshtit (**3.74% vs. 7.56%**).

Ilustrime të thyerjeve të normës drejtshkrimore nga mësimdhënësit

46	Udhëzime "Matematike"	46	Shi' llin Histori
	Prurmbullakimi i nr. me "DH" dhe Q. me "te" dhe		Principata e Shkodres e Durrësit dhe Antës"
47	Shi' llin "Matematike"	20	Shi' llin Ed. qytetare

5	Ushtrime
	Ed. muzikore
	Dëgjimi muzik fq. 5

23	Shi' llin Ed. muzikore
	Kam një mace kam një qeni
22	Shi' llin

5	Ed. fizike
	Ushtrime
	formimi me rathë
65	ushtrime

liu	30	Zhvillim	61
re		Histori	M.
limi		Shigjetarë gjatë luftës së dytë botërore	Nd kur p. 140

uzikov		Ed. fizike	
retë		Lojë ngrohje- stafete	
limi	39	zhvillim	

ë t e m ë s i m			
	3		
		Njeriu dhe natyra e të njohim çarkun e thje- sthtë elektrik	K. T. n.
	51	zhvillim	2.

g.35		dhe katrorit	
shtrime	66	zhvillim	25 ush
matifë		Ed. muzikore	Ed. fi
urat në		Këngë e re:	Lojë r
në të		Potigon lala	numr
këndëshit me		bullojë	dhe t
katrorit		g.30	
shtrime	28	zhvillim	26 us

gipe	Përmësove	Ed.
ehsti	Perp. i mod-	Lojë
" në	elit nga	trësh
tuaj	letra e	katë
ime	6 Zhvillim	11
natura	Art figurativ	Englis
inor		

ne)	27	Shkollat
ueq.		
ve		Shkollat zgjedhor
re:		Shkollat është
i " 19.51		që do rryeri

4. Përfundime

Me njësimin e shqipes në Kongresin e Drejtshkrimit më 1972, e paraprakisht me Konsultën e Prishtinës më 1968, standardi i shqipes u përqaftua e u mbështet si variant zyrtar i përdorshëm në të gjitha sferat publike institucionale e arsimore edhe në Kosovë. Shkolla është institucioni themeltar i edukimit të mirëfilltë gjuhësor, por gjendja e sotme dëshmon për një situatë ku gjuha standarde ende nuk ka arritur të përvetësohet e të përdoret korrektësisht. Të dhënat e përpunuara dhe rezultatet përfundimtare pasqyrojnë një shkallë të lartë të moszotërimit të normës drejtshkrimore si nga nxënësit, ashtu edhe nga mësimdhënësit e tyre. Kryesisht, dominojnë thyerjet në drejtshkrimin e zanoreve, brenda grupit të të cilave shkallën më të lartë të thyerjeve e përfaqësojnë: a) shkrimi jonormativ i ë-së fundore; b) shtesa jonormative e kësaj zanoreje në të tria pozicionet brenda fjalës.

Dendësia e thyerjeve të normës sipas raportit: **4.99** thyerje për një nxënë (749 raste / 150 nxënë) kundrejt **28.35** thyerje për një mësimdhënë (397 raste / 14 mësimdhënë), si dhe rezultatet krahasuese të thyerjes së normës (shih: grafiku 3) dëshmojnë për një realitet shqetësues, pesha e të cilit, kryesisht, bie mbi vetë mësimdhënësit. Formimi i mangët profesional, papërgjegjshmëria dhe jovigjilënca gjatë procesit të të shkruarit janë disa nga faktorët që ndikojnë në ekzistencën e këtij

niveli mjaft të ulët të zotërimit të normës drejtshkrimore. Gjithsesi që një dozë e përgjegjësive u takon edhe institucioneve universitare, të cilat duhet të mbikëqyrin me mjaft rigorozitet ecurinë studimore të studentëve, sidomos të atyre që lidhen drejtpërdrejt me fushën e edukimit gjuhësor. Jashtë përgjegjësive nuk duhet të mbeten as DKA-të (për evidentimin e mbikëqyrjen sistematike të punës së mësimeve dhe përzgjedhjen e tyre me meritë) e as MASHT-i, i cili edhe pse ka organizuar një sërë programesh për zhvillimin profesional të mësimeve (duke përfshirë edhe programin 2-vjeçar për avancimin e mësimeve në kuadër të Fakultetit të Edukimit), nuk ka hulumtuar në terren shkallën e përfuturit të rezultateve.

Procesi i standardizimit të një gjuhe do të jetë gjithnjë i karakterizuar nga nevoja për ndryshime e përmirësime që do të mundësojnë zotërimin sa më efikas, por, nëse mësimit, si shtylla e parë e konsolidimit dhe e transmetimit të tij, nuk do të vetëdijësohen për ta nxënë korrektësisht e për ta transmetuar besnikërisht, atëherë çdo përpjekje për një standard funksional e të pranueshëm nga të gjithë do të rezultojë e mangët dhe e pazbatueshme në nivelin që e kërkojmë.

Bibliografia

1. Dhrimo, A., Memushaj, R., (2015). *Fjalor drejtshkrimor i gjuhës shqipe*, Infbotues, Tiranë.
2. Dodi, A., (2004). *Fonetika dhe fonologjia e gjuhës shqipe*, ASHSH, Tiranë.
3. Grup autorësh (1984). *Fjalor i shqipes së sotme*, ASHRSH, Tiranë.
4. Grup autorësh (1974). *Drejtshkrimi i gjuhës shqipe*, Instituti Albanologjik i Prishtinës.
5. Hudson, R., (2002). *Sociolinguistika*, Dituria, Tiranë.
6. Islamaj, Sh., (2010). Kush shkruan për shqipen standarde si për një projekt të dështuar, nuk është serioz: shqipja standarde apo modernizim, Sot News, 5 dhjetor.
7. Kuçi, S., (2006). *Kujdesi për gjuhën standarde*, Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare 25, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë.
8. Memushaj, R., (2009). *Fonetika e shqipes standarde*, Toena, Tiranë.
9. Munishi, Sh., (2006). *Gjuha standarde shqipe në Kosovë dhe drejtimet e zhvillimit të saj*,
10. Disertacion i doktoratës, Fakulteti i Filologjisë, UP, Prishtinë.
11. Paçarizi, R., (2011). *Shqipja standarde në parametrat psikolinguistikë*, Pen Qendra e Kosovës, Prishtinë.
12. Paçarizi, R., (2008). *Gjuha shqipe*, "Thesis Kosova", nr.1, AAB, Prishtinë.
13. Raka, F., (2005). *Historia e shqipes letrare*, Ribotim, Prishtinë.

Pranvera OSMANI

PËRDORIMI I VARIANTEVE TË PASKAJORES NË GJUHËN SHQIPE

Abstrakt

Në këtë punim kemi trajtuar përdorimin e varianteve të paskajores në gjuhën shqipe, në kuptimin se cila nga variantet është më e përshtatshme për t'u përdorur.

Qëllimi i hulumtimit është të verifikohet se cila nga variantet e paskajores përdoret aktualisht nga folësit e shqipes në ligjërimin e folur. Pra, qëllimi ka qenë të merret një vlerësim i përafërt lidhur me dendurinë e përdorimit të varianteve të paskajores.

Metoda e mbledhjes së materialit: anketa. U aplikua anketa e përgatitur në formë të pyetjeve të mbyllura. Anketimi është kryer gjatë muajve qershor-korrik të vitit 2015. Sa i përket metodologjisë së anketimit kemi përdorë mostra të rastit. Të anketuarit kanë qenë të moshave të ndryshme, prej moshës 17 vjeçare deri mbi 50 vjeç, të profileve të ndryshme si dhe studentë.

Respondentët që përzgjidhëm për këtë studim janë tri grupe individësh prej 30 personash, të cilët i ndamë në tri grupmosha: A (grupmosha 17-30 vjeç), B (31-50 vjeç), C (mbi 51 vjeç).

Pyetjet kërkimore që shtrohen në këtë rast është: Cila nga variantet gjen përdorim më të madh nga folësit? A kushtëzohet përdorimi i një varianti të paskajores nga faktorët jashtëgjuhësorë, si: mosha dhe arsimimi i individëve folës?

Do t'i analizojmë këto variante: *me + pjesore e shkurtër, për me + pjesore, për të + pjesore*, paskajoren e tipit *me + punua* dhe zëvendësimin e *paskajores standarde me mënyrën lidhore*.

Fjalët çelës: variante të paskajores, anketë, faktorët jashtëgjuhësorë, pjesore e shkurtër

1.1 Struktura e varianteve të paskajores

Paskajorja si trajtë e pashtjelluar e foljes shpreh një veprim a një gjendje në mënyrë të përgjithshme pa u lidhur me një kohë a vetë të caktuar, emërton një veprim si proces (Veselaj, 2000:18). Në aspektin pohor paskajorja del e mbuluar kryesisht prej

dy formash analitike: me anë të paskajores së tipit *me + pjesore* dhe me anë të paskajores së tipit *për të + pjesore*, ndërsa në aspektin mohor del kryesisht në formën *pa + pjesore* (Veselaj:18).

Tipi i paskajores në gjuhën standarde shqipe i përbërë nga pjesëzat parafjalore *për+ të* dhe emri prejfoljor asnjans i pashquar ekziston si tip i vetëm në varietein dialektor të toskërishtes, kryesisht edhe në të folmet e Shqipërisë së Mesme. Kurse në të folmet e varietetit dialektor gegë përdoret trajta e pashtjelluar e tipit *me + pjesore* e shkurtër që ka vlerë të paskajores, e përbërë nga pjesëza përemërore *me* dhe nga pjesorja e foljes gjegjëse. Po ashtu ka edhe një formë të kryer që ndeshet rrallë, formën *me pa:s punu*. Forma e pashtjelluar e tipit *me ba(m)* është përfutur nëpërmjet gramatikalizimit të togjeve të tipit parafjalë + emër prejpjesor i paparanyjzuar, emri i humbi shkallë-shkallë të gjitha tiparet gramatikore emërore (kategoritë gramatikore të gjinisë, numrit, rasës dhe shquarsisë si dhe aftësinë për të marrë përcaktorë të prapavendosur ose të paravendosur), edhe parafjala e humbi si kuptimin ashtu edhe tiparet e saj parafjalore (mundësinë për t'u përdorur me një emër në trajtë të shquar dhe të pashquar, të prirë ose jo nga një përcaktor) (Demiraj, 1988:957).

Ndërkaq sipas Gabinskut (te Bokshi, 1998:139) përdorimi i infinitivit (*me+ pjesore:me punue/me punu*) në toskërishte vërteton atë që edhe këtu është përdorë më parë ky lloj infinitivi dhe nuk mund të konsiderohet si një ndikim i mëvonshëm i dialektit gegë.

Toskërishtja për shkak se nuk e ka infinitivin e tipit *me punue*, i përdor format e lidhore ndjeshëm më dendur (ato nuk mungojnë në gegërishte), ndërsa gegërishtja përmes përdorimeve shumë më të dendura të infinitivit ka zhvilluar mundësi të stërholluara të shprehjes sintaksore dhe stilistikore në këtë drejtim (Ismajli, 2003:84). S. Riza e shihte të shpjegueshme rrethanën që në punë të përdorimit të infinitivit toskërishtja është më analitike se gegërishtja meqenëse ndryshimet në domethënie midis paskajores e pjesores nuk janë të vogla, me kohë u krijua nevoja e diferencimit të tyre morfologjik (te Ismajli, 2005:94).

Sipas T. Kelemdit (te Veselaj, 2000:57) paskajorja me pjesëzat parafjalore *për + të* është paskajore dytësore, kurse trajta tjetër e paskajores- paskajorja geqe e tipit *me + pjesore* është paskajore parësore.

Trajta e pashtjelluar analitike e paskajores e tipit *me + pjesore* ka përhapje mjaft të gjerë në shqipen e folur sot, ajo ka shtrirje në mbarë shqipen. Sipas B. Bokshit (2011:159) paskajorja *me + forma e pjesores pjesore e së kryerës* është krijuar para formimit të mbiemrit të nyjshëm, ishte e tërë shqipes; dalja nga përdorimi i kësaj paskajoreje vetëm në të folmet toske do të jetë bërë nën ndikimin e jashtëm, nën ndikimin e një gjuhe në kontakt intim që mund të ishte greqishtja e mesme. Paskajorja përbën një nga tiparet

themelore dalluese në strukturën gramatikore të varieteteve dialektore të shqipës. Ajo është përdorur dhe vazhdon të përdoret në stilet joformale të të folurit dhe në domene kryesisht jozyrtare e private. Viteve të fundit si në Shqipëri ashtu edhe në Kosovë, vërehet një prirje e përgjithshme që në stilin formal të të folurit të përdoren pjesoret e shkurtra dhe si rrjedhojë edhe përdorimi i paskajores tipike të gegërishtes. Një dukuri e tillë vërehet në vernakularët urbanë të qyteteve si: të Prishtinës, të Tiranës, Durrësit dhe qyteteve të tjera.


1.2 Rezultatet e përfutuara nga gjetjet

Shumica e folësve (të anketuarve) pjesoret i shkurtojnë, pra nuk përdoren prapashtesat e pjesoreve dhe një numër i konsideruar i foljeve dalin me pjesore të shkurtër, gjegjësisht me prapashtesën –ë, pastaj vërejmë reduktimin e pjesores nga -uar në -u: zhvillu, punu, mendu etj. Shembuj të tillë ka pafund dhe dëshmojnë se këto ndërtime janë forma aktive mund të funksionojnë pa problem në kuadër të shqipës aktuale standarde. Trajtat e zgjatura të pjesores me –ur apo –uar, karakteristike për varietetin dialektor të toskërishtes, shkaktojnë probleme gjatë përdorimit të paskajores nga folësit nativë të gegërishtes. Me ç’rast trajta e pjesores së shkurtuar del më e rrjedhshme sesa trajta e sotme normative e ngritur në gjuhën standarde.

Paskajorja e tipit **me punu (e)** dhe ajo e tipit **për me punu (e)** janë variantet që përdoren më së shumti nga të anketuarit, kurse varianti **për të punuar** më pak, njëherit edhe forma standarde. Paskajorja **me punu** ka shpërndarje të përgjithshme shumë më të lartë se forma tjetër dialektore **për me punu (e)** duke dhënë një rezultat në përqindje prej 69.57% dhe vetëm 6.38% për **(për me punu (e))**. Ndërsa pjesorja standarde e tipit **(për të punuar)** ka shpërndarje të përgjithshme më të lartë sesa lidhorja, duke dhënë një rezultat në përqindje prej 13.62% dhe 6.8% për lidhoren.

Variantet e paskajores	Përqindja	Numri i provave	Gjithsej
me punu	69.57%	160	235
për të punuar	13.62%	32	
m. lidhore	6.8%	16	
për me punu	6.38%	15	
me punue	5.11%	12	

Tabela 1. Shpërndarja e përgjithshme e varianteve të paskajores



Paraqitja e të dhënave në formë grafike

Tabela 2 tregon të dhënat mbi shpërndarjen e paskajoreve dialektore për të tri grupmoshat. Ajo paraqet frekuencën e varianteve të paskajoreve dialektore në rrjetin e fjalëve. Në përgjithësi të dhënat tregojnë dallimet ndërmjet tri grupmoshave në përdorimin e varianteve.


Variantet	Moshë					
	17-30vjeç		31-50 vjeç		51+ vjeç	
paskajoret dialektore	70	87.5%	60	78.95%	57	72.15%
paskajore standarde	10	12.5%	16	21.05%	22	27.85%
Nr. total	80		76		79	

Tabela 2. Përhapja e varianteve të paskajores dialektore dhe asaj standarde sipas grupmoshave

Nga **tabela 2** mund të konkludojmë se grupi i moshës së re ka realizuar më shumë variantin gegë (paskajoret dialektore), kurse shumë më pak paskajoren standarde duke dhënë një rezultat në përqindje prej 87.5% për paskajoren gege dhe 12.5% për paskajoren standarde.

Grupi i moshës së mesme në tërësi ka realizuar paskajoren dialektore 78.9% dhe 21.05% për paskajoren standarde.

Grupi i moshës së moshuar ka dhënë një rezultat shprehur në përqindje prej 15% për paskajoren dialektore dhe vetëm 27.8% për paskajoren standarde.




Përhapja e varianteve të paskajoreve dialektore dhe asaj standarde sipas grupmoshave

Lloji i arsimit fillor i mesëm i lartë						
Variantet	nr.	%	nr.	%	nr.	%
paskajoret dialektore	50	83.33%	57	81.42%	80	76.19%
paskajore standarde	10	16.66%	13	18.57%	25	23.8%
Nr. total	60		70		105	

Tabela 3. Denduria e përdorimit të varianteve sipas arsimit

Tabela 3 ilustron se të tri nivelet e arsimit tregojnë përdorim apo shpërndarje mjaft të lartë të paskajores gege (dialektore), të tri grupet mbi 70%. Për sa i takon shpërndarjes apo realizimit të variantit dialektor të paskajores sipas nivelit të arsimit, ndërmjet këtyre grupeve të folësve me arsim fillor dhe atij të mesëm nuk gjendet ndonjë dallim i madh statistikor, por ndërmjet këtyre të fundit dhe grupit me arsim të lartë vërehet një dallim pak më i madh.



Paraqitja grafike sipas arsimimit

Folësit me nivel fillor të arsimit kanë dhënë një rezultat të paskajores dialektore në përqindje 83.33% dhe për paskajoren standarde 16.66%.

Grupi i folësve me nivel të mesëm paskajoren dialektore e kanë përdorur në vlerë prej 81.42% dhe paskajoren standarde shumë më pak, edhe atë vetëm 18.57%.

Kurse grupi me arsimim të lartë ka realizuar më pak paskajoren dialektore duke dhënë rezultat në përqindje prej 76.19% dhe 23.8% për paskajoren standarde.

Të dhënat dëshmojnë se forma e paskajores **me+pjesore** nuk del si çështje e thjeshtë dialektore, por për arsye të specifikës formale e kuptimore që paraqet ajo, kalon në suaza më të gjera. Dhe në bazë të matjeve të bëra mbështetet nevoja e integritit të këtij varianti të paskajores në shqyrtim (*me + pjesore e shkurtër*) në shqipen standarde dhe njëherit një formë e tillë është në përdorim aktiv nga masa. Ka argumente, sipas të cilave provohet se përdorimi i paskajores gege *me+ pjesore* del jo vetëm i nevojshëm, por edhe i domosdoshëm për sfera (nënfusha) të caktuara semantike. Në fund po t'i përjasim të dhënat nga anketa dhe makina kërkimore nuk dalin të njëjtat rezultate. Nga kërkimet del që varianti standard (*për të +pjesore*) ka shpërndarje më të madhe se të gjitha variantet e tjera 65.27%, forma (*me punu-paskajorja gege*) 24.8%, varianti *për me punu* 4.6%, *me punue* 2.92%, varianti *për me punue* 1.89% dhe variant mu punua 0.47%. Nga kjo rrjedh që *paskajorja standarde* në ligjërimin e shkruar ka denduri më të lartë përdorimi, kurse në ligjërimin e folur varianti *me + pjesore e shkurtër* ka shpërndarje më të lartë se variantet e tjera të paskajores.

Bibliografia

1. Bokshi, Besim (1998). Pjesorja e shqipes (vështrim diakronik), Prishrinë
2. Bokshi, Besim (2011). Rreth problemit të paskajores në gjuhën shqipe, Shqipja në etapën e sotme: Politikat e përmirësimit dhe të pasurimit të standardit, QSA, Botimet Albanologjike, Tiranë
3. Demiraj, Shaban (1988). Gramatikë historike e gjuhës shqipe, Rilindja, Prishtinë
4. Ismanjli, Rexhep (2003). Standarde dhe identitete, Dukagjini, Pejë
5. Ismajli, Rexhep (2005). Gjuhë standarde dhe hisori identitetesh, ASHSH, Tiranë
6. Veselaj, Nuhi (2000). Paskajorja - çështje e shqipes standarde, Dardania Sacra, Prishtinë

Mensur VOKRRI

REALIZIMI I SISTEMIT RASOR TË SHQIPES NË MEDIA TË SHKRUARA NË KOSOVË

Hyrje

Sistemi rasor është një nga përbërësit thelbësorë të strukturës së një gjuhe. Me studimin teorik të tij në shqipen, si në nivelin sinkronik ashtu edhe në atë diakronik, janë marrë shumë autorë, ndër të cilët S. Riza, B. Bokshi e shumë të tjerë, që nuk do të përmenden këtu për shkak të numrit të kufizuar të faqeve dhe natyrë praktike të temës. Punimi i është referuar teorikisht *Gramatikës së gjuhës shqipe I* (Gramatika: 2002).

Hulumtimi ynë ka për qëllim të vëre në pah përdorimin e sistemit rasor të shqipes në domenin publik. Korpusi është ndërtuar mbi bazën e materialeve të publikuara në mediet e shkruara, “Kosova sot” dhe “Express”, e para e datës 2 korrik 2015, ndërsa e dyta e datës 8 gusht 2015.


Hulumtimi pasqyron përdorimin e përgjithshëm të këtij sistemi, duke specifikuar më pas në formë statistikash e grafikonesh shkarjet gramatikore, drejtshkrimore dhe teknike.

Te “Kosova sot” do të bëhet pasqyrimi i sistemit rasor të variantit të palekturuar e pastaj edhe të atij të lekturuar. Krahasimi i këtyre dy varianteve bëhet që të nxirren statistika të përdorimit jokorrekt gramatikor të këtij sistemi nga njëri variant te tjetri. Te portali “Express” hulumtimi është kufizuar vetëm në variantin e redaktuar për arsye se portali nuk lekturon materialet që i publikon. Pastaj, do të bëhet edhe krahasimi i të dy medieeve sa u përket shkarjeve të të gjitha natyrave e sidomos atyre gramatikore.

Të dhënat statistikore do të jepen me shifra dhe grafikone përkatëse.

1. “Kosova sot” - korpusi


Te gazeta “Kosova sot”, e datës 2 gusht 2015, me 32 faqe gazete, janë përdorur gjithsej 15863 pjesë emërore. Nga ky numër, 9427 janë emra, 2736 mbiemra, 1930 përemra, 931 numërorë dhe 845 trajta të shkurtra të përemrave vetorë.




Nga përdorimi i përgjithshëm i pjesëve emërore të **varianti i palekturuar** i kësaj gazete dalin gjithsej 697 shkarje në përdorimin e sistemit rasor të strukturës së shqipes standarde. Prej këtyre shkarjeve, 296 janë gramatikore, 312 drejtshkrimore, 86 teknike dhe 5 leksiko-semantike.

1.1. Përdorimi i emrave dhe natyra e shkarjeve të tyre

Nga numri i përgjithshëm i përdorimit të emrave dalin 469 gabime, prej të cilave 239 janë gramatikore, 197 drejtshkrimore, 31 teknike dhe 3 leksiko-semantike. Për tri grupet e fundit të shkarjeve gjuhësore nuk do të ndalemi më shumë, për arsye se nuk është qëllimi i punimit. Do të shqyrtohen hollësisht vetëm shkarjet gramatikore, që e përbëjnë edhe thelbin e punimit dhe njëkohësisht edhe synimin e punimit të pranishëm.



Përdorimi jogramatikor i emrave sipas rasave – Këto përdorime të emrave jepen sipas kategorisë gramatikore të rasës, gërshetuar me kategoritë e tjera relevante gramatikore, si: trajta e numri. **Rasa emërore** del e përdorur jogramatikisht 153 herë, nga të cilat 119 em. të shq. nj., 5 em. të pashq. nj., 5 em. të shq. sh, 6 em. të pashq. sh., 19 em. paraf. të shq. Përdorimi jogramatikor i **gjinore** shfaqet 32 herë, prej të cilave 26 janë gjin. të shq. nj., 6 gjin. të pashq. nj. **Dhanore** jogramatikore del 1 rast, dhe atë dhanore e shq.nj. **Kallëzorja** jogramatikore del 33 herë, nga të cilat 10 kall. të shq. nj., 17 kall. paraf. të shq. nj., 4 kall. paraf. të pashq. nj. dhe 2 kall. paraf. të pashq. sh. Përdorimi jogramatikor i **rjedhore** është evidentuar 19 herë, nga të cilat 13 rrj. të pashq. sh., 3 rrj. të pashq. nj., 2 rrj. të shq. nj. dhe 1 rrj. paraf. e shq. nj.




1.2. Përdorimi i mbiemrave dhe natyra e shkarjeve të tyre

Nga numri i përgjithshëm i mbiemrave, 110 gabime dalin te kjo pjesë e ligjëratës, nga të cilat 30 gram., 2 leksiko-sematike, 57 drejtshk. dhe 21 teknike.



Përdorimi jogramatikor i mbiemrave si mospërshtatje – Te mbiemrat dalin përdorime jokorrekte gramatikisht lidhur me përshtatjen e tyre në gjini e numër me emrat që përcaktojnë, duke mos marrë treguesit morfologjikë të kategorive përkatëse. Te mbiemrat dalin 4 mospërsht. gj. mashk. dhe 3 mospërsht. gj. fem. të mbiemrave me emrat që përcaktojnë. Pastaj hulumtimi nxjerr edhe 3 mospërsht. të nr. nj. dhe 13 të tilla të shumësit. Gjithashtu, këtu dalin edhe 4 mospërsht. gj. fem. sh., 3 mospërsht. gj. mashk. sh. Së fundi, përpos këtyre përdorimeve jogramatikore, mund të futen edhe 2 përdorimeve josemantiko-joleksikore, si psh.: mbimeri “*më e luftuar*” (Sport).




1.3. Përdorimi i përemrave dhe natyra e shkarjeve të tyre

Nga numri i përgjithshëm i përemrave dalin 62 gabime, prej të cilave 10 gram., 38 drejtshk. dhe 14 teknike.




Përdorimi jogramatikor i përemrave – Përdorimet jogram. të përemrave kanë dalë në rase të caktuara dhe si mospërshtatje kategorie gramatikore gjinie, numri e rase. Nga këto përdorime dalin 3 mospërsht. gj. fem. të përemrave me emrat që përcaktojnë, 2 mospërsht. n. nj., 2 em. Sh., 1 em. mashk. sh. dhe 1 kall. paraf. sh.



1.4. Përdorimi i trajtave të shkurtra të përemrave vetorë dhe natyra e shkarjeve

Nga numri i përgjithshëm i trajtave të shkurtra të përdorura dalin 50 gabime, ku 30 prej tyre janë jogram., 5 drejtshk. dhe 15 tek.



Përdorimi jogramatikor i trajtave të shkurtra – Te trajtat e shkurtra të përemrave vetorë dalin raste të përdorimit jogramatikor sipas kategorive gramatikore të rasës, vetës dhe të numrit, të ndërlidhura mes vete. **Rasa dhanore** është përdorur jogramatikisht 18 herë, nga të cilat 16 dhan. v. III sh., 1 dhan. v. III nj., 1 dhan. v. II sh. Ndërkaq, **kallëzorja** ka 12 përdorime jogramatikore, nga të cilat 9 kall. v. III nj. dhe 3 kall. v. III sh.




1.5. Përdorimi i numërorëve dhe natyra e shkarjeve të tyre

Nga numri i përgjithshëm i numërorëve dalin 28 gabime, prej të cilave 8 jogram., 15 drejtshk. dhe 5 teknike.





Përdorimi jogramatikor i numërorëve – Përdorimet jogram. lidhen me kategoritë gramatikore të gjinisë, numrit, trajtës e rasës. Te numërorët dalin 4 përdorime jogram. të gjin. së shq. nj., 3 mospërsht. të numërorëve në sh., dhe 1 mospërsht. në gj. fem.



Nga krahasimi i variantit të palekturuar me atë të lekturuar janë nxjerrë këto të dhëna nga matjet e bëra: për dallim nga varianti i parë, ky i fundit ka gjithsej 374 gabime, nga të cilat 242 gram., 121 drejtshk., 9 teknike. Te emrat ka 249 gabime, prej të cilave 195 gram., 54 drejtshk., 0 teknike. Nga gramatikoret dalin 87 em. të shq.nj., 3 em.shq.sh., 5 em. të pashq.nj. 6 em. të pashq.sh., 16 em.paraf. të shq.nj.; 24 gjin. të shq.nj., 5 gjin. të pashq.nj.; 1 dhan. e shq.nj.; 10 kall.shq.nj. 15 kall.paraf. të shq.nj., 3 kall. paraf. të pashq.nj., 2 kall. paraf. pashq.sh., 19 rryedh., 13 të pashq.sh., 3 të pashq.nj., 2 të shq.nj., 1 paraf.shq.nj. Te mbiemrat ka 50 gabime, nga të cilat 10 gram., 32 drejtshk., 6 teknike dhe 2 leksiko-semantike. Nga gramatikoret, 2 mospërsht. gj. mashk., 3 mospërsht. gj. fem., 2 mospërsht. sh., 1 mospërsht. nj., 2 mospërsht. gj. fem. sh. Te përemrat ka 36 gabime, nga të cilat 9 gram. 27 drejtshk., 0 teknike. Nga gramatikoret dalin 3 mospërsht. gj. fem., 2 mospërsht. nj., 2 em. sh., 1 em. nj., 1 kall. paraf. sh. Te trajtat e shkurtra ka 25 gabime, nga të cilat 23 gram., 2 drejtshk., 0 teknike. Nga gramatikoret, 10 dhan. v. III sh., 1 dhan. v. III nj., 1 dhan. v. II sh.; 8 kall. v. III nj., 3 kall. v. III sh. Te numërorët ka 14 gabime, nga të cilat 5 gram. 6 drejtshk., 3 teknike. Nga gramatikoret, 3 gjin. të shq. nj.; 1 mospërsht. sh., 1 mospërsht. gj. fem.; 6 drejtshk.






Shembuj të përdorimit jogramatikor të sistemit rasor të pjesët emërore në “Kosova sot” me raste të nënvizuara:

Një burim i “BBC”, për gazetën “Dan Wootton”, ka thënë... Në një deklaratë për Tanjug, Ianjug thotë se... BE këmbëngul që Kosova të mos ketë qasje... Ekspozimi i tyre në ambientin e Muzent Kombëtar i Shqipërisë... Sa i përket kalkulimit për vjedhje të votave nga PDK... Së pari falënderoj..., të cilët ndanë disa informata me neve. Sipas Bankës Botërore, GDP e Kosovës arriti si mesatare 4.13 miliardë dollar amerikan nga 2000... Këto dy parti kishin shumicën parlamentare e cila nuk po ju funksionon sipas... Me një fitore bindëse, tre postet kryesore... Me këmbë në tokë sa i përket objektivave. Edicioni i 102 i “Tour de France” nis të shtunën... Bush dhe Trump ngjiten lart, por Clinton kryeson. Avantazhi ndaj Donald Trump... Projektligji për dhomat e specializuar... Ata ia vënë zjarrin furrave. Projekti mund të fusë çdo qytetarë... Shumë gjakovar... Kësaj rregulloreje më së shumti u frikësohen prodhuesit. Granti prej 6 miliona euro... Këto mesazhe në spektrin politik dhe shoqëria civile e Kosovës, janë interpretuar... Buxheti 700 miliona euro...

2. Portali “Express” - korpusi


Te portali “Express”, i datës 8 gusht 2015, në 95 faqe të formatit A4 janë përdorur gjithsej 10259 pjesë emërore, nga të cilat 6687 emra, 1675 mbiemra, 922 përemra, 652 numërorë dhe 356 trajta të shkurtra të përemrave vetore




Siç është thënë edhe më lart, ky portal ka vetëm një variant, te i cili janë evidentuar gjithsej 516 gabime të të gjitha pjesët emërore të përdorura.

2.1. Përdorimi i emrave dhe natyra e shkarjeve të tyre

Nga numri i përgjithshëm i përdorimit të emrave, dalin gjithsej 360 gabime. Prej tyre 189 gram., 134 drejtshk. dhe 34 teknike.




Përdorimi jogramatikor i emrave – Edhe te portali “Express” përdorimet jogramatikore jepen sipas kategorive gramatikore relevante dhe të gërshtetimit e përshtatjes së tyre si: rasa, numri e trajta. **Rasa emërore** del me përdorim jogramatikor gjithsej 104 herë, nga të cilat 81 em. të shq. nj., 3 em. të pashq. nj., 4 em. të pashq. sh. dhe 13 em. paraf. të shq. nj. **Gjinorja** del me 37 përdorime jogramatikore, nga të cilat 32 gjin. të pashq. sh., 4 gjin. të pashq. nj., 1 gjin. e shq. sh. **Dhanorja** ka 4 përdorime jogram., prej cilave 3 dhan. të pashq. sh. dhe 1 dhan. të shq. nj. **Kallëzorja** ka 28 përdorime jogramatikore, prej të cilave 7 kall. të shq. nj., 1 kall. e shq. sh., 17 kall. paraf. të shq. nj., 2 kall. paraf. të pashq. nj. dhe 1 kall. paraf. e shq. sh. **Rrjedhorja** del me 11 përdorime jogram., prej të cilave 6 rrj. të pashq. nj., 4 rrj. të pashq. sh. dhe 1 rrj. paraf. e shq. nj.




2.2. Përdorimi i mbiemrave dhe natyra e shkarjeve të tyre

Nga numri i përgjithshëm i mbiemrave dalin 63 gabime, prej të cilave 24 përdorime jogram., 30 drejtshk. dhe 9 teknike.




Përdorimi jogramatikor i mbiemrave – Te mbiemrat jepen mospërshtatjet e tyre, sipas kategorive, me emrat që përcaktojnë. Këtu dalin 8 mospërshtatje gj. fem., 1 mospërsht. gj. mashk., pastaj 13 mospërsht. n. sh. dhe 2 mospërsht. gj. fem. sh.



2.3. Përdorimi i përemrave dhe natyra e shkarjeve të tyre

Nga numri i përgjithshëm i përemrave dalin 30 gabime gjithsej, prej të cilave 5 janë gram., 22 drejtshk., 1 dialektor dhe 2 teknike dalin rastet e mospërshtatjes në kategorinë e gjinisë, numrit, trajtës e rasës.



Përdorimi jogramatikor i përemrave – Edhe te përemrat dalin rastet e mospërshtatjes në kategorinë e gjinisë, numrit, trajtës e rasës. Në këto kategori gramatikore të ndërlidhura te përemrat del 1 gjin. nj., 2 mospërsht. gj. mashk., 1 mospërsht. n. nj., 1 mospërsht. gjin. fem. nj. dhe 1 përdorim dialektor gegë *do*




2.4. Përdorimi i trajtave të shkurtra të përemrave vetorë dhe natyra e shkarjeve

Trajtat e shkurtra jepen kategoria e rasës, vetës dhe e numrit të ndërlidhura gramatikisht. Nga përdorimi i përgjithshëm i këtyre trajtave dalin 28 gabime, nga të cilat 21 gram. dhe 7 drejtshk.




Përdorimi jogramatikor i trajtave të shkurtra – Nga 21 përdorime jogramatikore të trajtave të shkurtra, jepet klasifikimi i tyre sipas kategorisë së rasës kombinuar edhe me kategorinë e vetës dhe të numrit. **Rasa dhanore** del me 16 përdorime jogram. të v. III sh. Ndërkaq, **kallëzorja** del me 5 përdorime jogram., nga të cilat 3 kall. v.III sh. dhe 2 kall. v.III. nj.



2.5. Përdorimi i numërorëve dhe natyra e shkarjeve të tyre

Edhe te numërorët të të jepen mospërshtatjet e kategorisë së gjinisë, rasës, numrit e trajtës. Nga përdorimi i përgjithshëm dalin 35 përdorime jokorrekte, nga të cilat 8 përdorime jogramatikore, 26 drejtshkrimore dhe 1 teknik.



Përdorimi jogramatikor i numërorëve – Te kjo pjesë e ligjëratës janë dalin 8 të tilla, të cilat klasifikohen sipas kategorive përkatëse gramatikore. Si mospërshtatje në rasë, gjini, numër e në trajtë dalin 4 gjin. të shq., 3 mospërsht. gjin. gj. fem. dhe 1 gjin.sh.

Përqindja e gabimeve gram.r. gjinore e shquar te numërorët në "Express"



Shembuj të përdorimit jogramatikor të sisitemit rasor te pjesët emërore në portalin “Express”:

Shteti Islamik i ISIS ka reaguar... Të pandehurit do ta kryejnë... në shtetet e gatsbëm... Zuckerberg ishte vetëm 2 vite më i ri sesa Spiegel... Orialda, që ende nuk i ka mbushur 18-at.... Sa i përket pritjeve në disa pikëkalime kufitare... Policia e Kosovës po punon që të ju mundësojë qytetarëve... Krabasimet ndër vitë i treguesve kryesor makroekonomik... Mijëra persona firmosën një petition për t'i kërkuar zyrtarëve që t'ia jepnin ushqimin të varfërve... Andaj ju bëj thirrje atyre... Shqipëria nuk është vend miqësor me LGBT. O musliman të Shqipërisë... “Nuk ka gjë më të rëndësishme në këtë fushë”, i tha Mäkssoo DW. Pas muajsh të tërë debatesh të hidbura, protestash në rrugë, spekulime nëpër media dhe vonesa të shkaktuara nga opozita mbi legjislacionin që do të shohë ish-luftëtarëve të UÇK-së... Këshilli i Sigurimit të OKB-së... Të gjitha panelet gjykes... Rrugët e shtëpave janë të zënë... Në pyetjen drejtuar nga Kosova Press... Ajo ka konfirmuar për Kosova Press... Ky sezon e gjen Shëngjinin dhe turistët... Bashkësisë ndërkombëtare dhe Brukselit t'ia tërbeqë vëmëndjen etj.

Përfundime

Nga të dhënat e nxjerra për përdorimin e sistemit rasor në të përditshmen “Kosova sot”, të datës 02 korrik 2015, dhe në portalin “Express”, të datës 8 gusht 2015, mund të nxirren këto përfundime:

Në variantin e palekturuar të gazetës “Kosova sot”, nga gjithsej 15863 pjesë emërore të përdorura, prej të cilave 9427 janë emra, 2736 mbiemra, 1930 përemra, 845 trajta të shkurtra të përemrave vetorë dhe 930 numërorë, dalin gjithsej 697 gabime. Nga këto shkarje, 296 janë gramatikore, 312 drejtshkrimore, 86 teknike dhe 5 leksiko-semantike.

Nga të gjitha pjesët e ligjëratës frekuencë më të madhe përdorimi kanë emrat me 60%. Nga ky përdorim, më së shumti dalin shkarje gramatikore 51%, 42% drejtshkrimore, 6% teknike dhe 1% leksiko-semantike.

Vështruar sipas rasave gabimet dalin në këto përqindje: emërorja 64%, gjinorja 14%, dhanorja 0%, kallëzorja 14% dhe rrjedhorja 8%.

Mbiemrat përbëjnë 17% të përdorimit. Gabimet janë më shumë të natyrës drejtshkrimore 51%, gramatikore 28%, teknike 19% dhe leksiko-semantike 2%. Te përdorimet jogramatikore prin mospërshtatja e numrit me emrat që përcaktojnë 50%,

pastaj mospërshtatja në gjini 22%, mospërshtajtja në gjini e numër po ashtu 22% dhe mospërshtatja leksiko-semantike 6%.

Në këtë korpus hulumtimi përemrat zënë vendin e tretë të përdorimit me 12%. Më së shumti ka gabime drejtshkrimore 61%, pastaj teknike 23% dhe në fund 16% gramatikore. Te këto të fundit më së shumti ka mospërshtatje në gjini, numër e në rasë 45%, mospërshtatje në gjini 33%, mospërshtatje në numër 22%.

Përdorim relativ kanë edhe trajtat e shkurtra. Frekuenca e përdorimit është 5%. Përdorimet jogramatikore përfaqësojnë 60% të rasteve, pastaj gabimet teknike 30% dhe ato drejtshkrimore 10%.

Ndërkaq, në variantin e lekturuar, dalin gjithsej 374 gabime, prej të cilave 242 janë gramatikore ose 67%, 121 drejtshkrimore ose 33% dhe 9 teknike ose 0%.

Te portali informativ “Express” nga përdorimi i pëgjithshëm i pjesëve emërore, më së shumti përdoren emrat 65%, pastaj mbiemrat 16%, përemrat 9%, trajtat e shkurtra të përemrave vetorë 4% numërorët 6%. Nga ky përdorim, dalin gjithsej 516 dalin gabime, prej të cilave 53% gramatikore, 38% drejtshkrimore dhe 9% teknike.

Nga krahasimi i gazetës “Kosova sot” me portalin “Express” në sistemin rasor shihet një nivel i njëjtë i shkarjeve ose përdorimeve jokorrekte gramatikore, drejtshkrimore e teknike, edhe pse jo me numër të njëjtë faqesh teksti. Ky krahasim vlen sidomos për variantin e palekturuar të gazetës krahasuar me portalin, ndërkaq varianti i lekturuar del përgjysmë e më shumë i përmirësuar krahasuar edhe me variantin e parë të vetë gazetës në njëjtrën anë dhe me portalin në anën tjetër.

Literatura

Grup autorësh, (2002). *Gramatika e gjuhës shqipe I (Morfologjia)*. Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë. Tiranë.

Riza, Selman (2002). *Vepra 3 – Emrat në shqipe – Sistemi i rasavet dhe tipet e lakimit* (punim historik me dy shtojca kritike). AShAK, Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Botime të veçanta – Libri 19, Prishtinë.

Bokshi, Besim (2005). *Rruga e formimit të fleksionit të sotëm nominal të shqipes*. AShAK, Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Botime të veçanta – Libri 26, Prishtinë.

Burimet e korpusit

Gazeta e përditshme informative “Kosova sot” e datës 02 korrik 2015. (Varianti i palekturuar dhe ai i lekturuar)

Portali informativ “Express” i datës 08 gusht 2015.

Zeqije XHAFÇE

KRAHASIMI I SISTEMIT RASOR TË GJUHËS SHQIPE DHE TË GJUHËS TURKE NËPËRMJET ROMANIT TË ISMAIL KADARESË “GJENERALI I USHTRISË SË VDEKUR” DHE PËRKTHIMIT TURQISHT “ÖLÜ ORDUNUN GENERALI”

Abstrakt

Tema e këtij punimi është krahasimi i sistemit rasor të gjuhës shqipe dhe të gjuhës turke nëpërmjet romanit të Ismail Kadaresë “Gjenerali i ushtrisë së vdekur”. Analiza kontrastive është e rëndësishme për ta lehtësuar mësimin e një gjuhe të huaj. Kështu, folësi i gjuhës së huaj krahason dhe mëson, njëkohësisht, dhe me krahasim i kupton më lehtë nocionet, trajtat dhe metodat e përdorimit të gjuhës së huaj, e lehtëson adaptimin e asaj gjuhe në trurin e tij. Sa më të mëdha janë dallimet aq më akute do të jenë problemet në nxënie. Nga të gjitha kategoritë gramatikore të emrit, qoftë nga aspekti morfologjik qoftë nga ai sintaksor duket se rasa ka karakter shumë të ndërlikuar dhe abstrakt, andaj mendojmë se shtjellimi i kësaj kategorie gramatikore në mënyrë kontrastive do të jetë mjaftë interesant si për studuesit e gjuhës ashtu edhe për studentet që i mësojnë këto dy gjuhë.

Fillingisht do t'i përshterujmë sistemet rasore të dy gjuhëve duke u mbështetur në gramatikat më të praktikuar të gjuhës së sotme shqipe dhe gjuhës së sotme turke. Do ta prezantojmë strukturën morfologjike dhe sintaksore të tyre në vija të shkurtra. Si gjuhë bazë do të merret gjuha shqipe dhe kjo do të praktikohet në të gjitha rasat morfologjike përveç tek rasa e vendorës, e cila për dallim nga turqishtja nuk egziston në shqip. Nga të dhënat empirike të nxjerrura nga kjo analizë do të jemi në gjendje të shohim se si funksionon sistemi rasor në këto dy gjuhë, cilat janë dallimet dhe ngajshmëritë midis tyre, si dhe frekuencat e përdorimit të këtyre mjeteve gjuhësore. Në aneks do t'i japim të gjitha shembujt të analizuar mbi të cilat bazohet ky punim.

Hyrje

Gjatë përpjekjes sonë që ta kuptojmë fenomenin e quajtur gjuhë dhe ta ndriçojmë vendin e saj në jetën e njeriut bëjmë krahasime sinkronike ose deskriptive të gramatikës me të cilët i krahasojmë strukturat fonetike, morfologjike dhe semantike të gjuhëve, duke mos hyre në zhvillimet e saj historike. Edhe pse analizat kontrastive

historikisht janë zbatuar për përcaktimin e gjenealogjisë gjuhësore sot përdoret në shumë fusha tjera gjuhësore siç është përkthimi, mësimi i gjuhës etj.

Analiza kontrastive e gjuhës turke dhe gjuhës shqipe, dy gjuhëve që u përkasin dy familjeve të ndryshme gjuhësore – të cilët, njëra si gjuhë aglutinative, tjetra si gjuhë fleksive, nga aspekti morfologjik dhe struktural kanë dallime të dukshme – në fazën fillestare të punimit premtan rezultate të rëndësishme për studiuesit e mësimin të këtyre dy gjuhëve si gjuhë e huaj. Duke u nisur nga ky mendim në këtë punim kemi zgjedhur gjuhën e shkruar, e cila më së shumti i ruan normat gjuhësore, më saktë përkthimin e një romani shqiptar në gjuhën turke. Përkthimet janë më adekuate për përcaktimin ekuivalencës midis dy gjuhëve dhe korpusi ndihmon përmirësimin e përshkrimeve gramatikore¹. Qëllimi i këtij punimi është që të kemi një mendim më të qartë të bazuar në rezultatet e sakta e një korpusi modest, në lidhje me përgjigjen e pyetjes se a mund të përdoren mjetet gjuhësore të njejta në dy gjuhë të ndryshme dhe deri në cilën shkallë? cilat janë frekuencat e përdorimeve të mjeteve të njejta gjuhësore për nocionet e njejta? Cilat janë dallimet dhe ngajshmëritë midis tyre?

Siç argumenton edhe Leech (1997:16)²: *“fardo mospërkryerje të ketë ekuacioni i thjeshtë: “më frekuente” = “më e rëndësishme për tu mësuar”, është e vështirë të mohohet se të dhëna mbi frekuencës që vjen nga një korpusi posedon një input të rëndësishëm empirik në kuadër të materialeve të mësimin të gjuhës.”* (përkthim i lirë). Prandaj, rezultatet e kësaj analize poashtu do të jenë interesante si për studiuesit e gjuhësisë teorike, gjuhësisë kontrastive të bazuar në korpus, ashtu edhe për studiuesit e përkthimit edhe studentet që i mësojnë këto dy gjuhë. Prapëseprap, duhet të theksojmë se këto të dhëna nuk janë shumë të vëllimshme dhe si të tilla nuk duhet të mbivlerësohen. Si kategori gramatikore ku do të analizohen ekuivalenca dhe diversiteti gjuhësor i dy gjuhëve kemi zgjedhur sistemin rasor. Sistemi rasor është një kategori me cilësi morfosintaksore. Andaj pranë përshkrimit morfologjik i kemi krahasuar edhe përdorimet e rasave/funksionet e tyre në fjalë, duke u bazuar në normat gramatikore.

PËRSHKRIMI I METODËS SË PUNIMIT: Fillimisht do t'i përshkruajmë sistemet rasore të dy gjuhëve duke u mbështetur në gramatikat më të praktikuara të gjuhës së sotme shqipe dhe gjuhës së sotme turke. Do ta prezantojmë strukturën morfologjike dhe vendet e përdorimeve të tyre në vija të shkurta. Meqenëse ky punim është një punim i kufizuar me vetëm punë praktike nuk do të ndalemi në përshkrimin e teorisë së gjuhësisë kontrastive dhe atë të bazuar në korpus. Nga arsye e njejtë punimi do të realizohet vetëm mbi formën e shkruar të gjuhës dhe do të mbështetet

¹ Tony McEnery, Richard Xiao, What corpora can offer in language teaching and learning, pdf
² Leech (1997) në: Tony McEnery, Richard Xiao, What corpora can offer in language teaching and learning, pdf

në analizën e vetëm dy kapitujve të parë të Romanit “Gjenerali i Ushtrisë së Vdekur” të romansierit të shquar Ismail Kadare³ të krahasuar me përkthimin në gjuhën turke, të bërë bashkërisht, nga ana e Atilla Tokatli dhe Necdet Sander⁴. Si gjuhë bazë do të merret gjuha shqipe dhe kjo do të praktikohet në të gjitha rasat morfologjike përveç tek rasa e vendorës, e cila për dallim nga turqishtja nuk egziston në shqip. Nga të dhënat statistikore të sakta të nxjerra nga kjo analizë do të jemi në gjendje të shohim se si funksionon sistemi rasor në këto dy gjuhë, cilat janë dallimet dhe ngajshmëritë midis tyre. Në aneks do t’i japim të gjitha shembujt të analizuar mbi të cilat bazohet ky punim.

Sistemi Rasor si mjetë gjuhësor: Koncepti i rasës shfaqet si një kategori gramatikore e cila e përcakton funksionin e emrit (dhe gjymtyrave të tjera emërore) brenda fjalisë, tregon raportin e emrit me gjymtyrat e tjera të fjalisë dhe rolin e tij nga aspekti sintaksor, dhe njëkohësisht i jep emrit një veçori të caktuar nga aspekti semantik. Në shumicën e gjuhëve manifestohet nëpërmjet ndryshimit morfologjik dhe eptimit të emrit. (Aksan, 2003). Turqishtja ka gjashtë rasa morfologjike dhe këto rasa mund të arrijnë numrin 10-15 në gjuhë të tjera. Sipas A. Dilaçarit (cit. në: Aksan, 2003) gjuhë rasat e të cilave shprehen vetëm me anë të mbaresave janë 16 në finlandisht, 23 në gjeorgjisht. Gjuhët indoevropiane kanë 8 rasa kryesore.

Rasa e emërores (Lat. *nominativus*), për fjalët turke dhe shqipe është gjendja e emrit të pa eptuar. Psh. laps=kalem, lexim=okuma, ai=o.

Rasa e kallëzores (Lat. *accusativus*), është një rasë e veçantë sidomos nga aspekti i raportit midis plotësit dhe kallëzuesit. Poashtu, shërben edhe për të treguar se ajo që shënohet me emrin është një objekt i caktuar, një qenie e njohur. Psh. *e lexova libri+n=kitab+i okudum [EM+K = EM+K]*, libri këtu është një objekt i cili është njohur nga ana e folësit dhe dëgjuesit.⁵

Rasa e dhanorës (Lat. *dativus*), tregon një kahje drejtë objektit, qenies së shënuar me ndonjë emër: *Okul+a gidiyorum = Shkoj në shkollë*. Megjithatë, kjo rasë nuk shprehet me ndryshime morfologjike të fjalës. Psh. në Anglisht kjo shprehet me anë të parafjalës *to*. Në gjuhën shqipe, edhe pse rasa dhanore egziston si rasë, funksioni i saj është paksa më i kufizuar. Dhanorja e shqipes përdoret për të shprehur objektin e zhdrejt të fjalisë: *u hodhi një vështrim nxënës+ve të tij [EM+DH]= ÷grencileri+n+e [EM+AntiH+DH] bir bakış attı*. Shikuar semantikisht të dy kallëzuesë, “*shkoj*” dhe

³ Ismail Kadare, Gjenerali i ushtrisë së vdekur, botimi i pestë, Rilindja, Prishtinë, 1990.

⁴ Ismail Kadare, Ölü Ordunun Generali, Türkçesi: Atilla Tokatlı ve Necdet Sander, Can Yayınları, Stamboll, 1986.

⁵ Lyonsi (1968) thotë se në Turqisht rasa emërore mund të dallohet nga rasa kallëzore në qoftë se emri është i caktuar.

“*bodhi*”, në fakt shprehin një lëvizje drejtë kundrinës. Megjithatë, në rastin e parë në gjuhën shqipe shihet parafjala e rasës kallëzore. Përcaktimi i rasës varet edhe nga mjeti me të cilin shprehet.

Rasa e vendores (Lat. *locativus*), shpreh gjendjen brenda objektit ose mbi objektin të shënuar me ndonjë emër. Rüyam+da [*Tema+V*] gördüğüm kız = vajza të cilën e pash në + ëndër [*PF + EM+□*]. Kjo rasë moroflogjike nuk egziston në gjuhën shqipe. Siç mund të shihet edhe nga shembulli, ajo shprehet me anë të parafjalëve rasore.

Rasa e rrjedhorës (Lat. *ablativus*), sipas Brugmanit (cit. në:Aksan, 2003) kjo rasë në gjuhët indoevropiane shpreh ndarje. Në gjuhën turke përveç funksionit themelor të kësaj rase, dmth. përveç konceptit të ndarjes ajo shpreh edhe prej çka është bërë diçka, shkakun, etj. Dilaçar (cit. në: Aksan,2003) në veprën e tij “Gramer” thotë se mbaresat “-den”, dhe “-de” shprehin edhe kuptime tjera të cilat nuk përputhen me konceptin e tyre të “ndarjes dhe daljes”⁶. Rreth 30 përdorime që i përmend janë të lidhura ngusht me veçorinë e prapashtesave të turqishtës të cilat mund të kryejnë më shumë se një funksion. (Aksan, 2003)

Rasa e plotësuesit/përcaktuesit (Lat. *Genitivus*), shpreh raportin, lidhjen e një emri me një koncept tjetër. Mbaresa –in me të cilën shprehet kjo rasë përdoret shprehjen e përcaktimit e objektit të shënuar me një emër, meqenëse krijon togëfjalësha. Togfjalshat e gjuhëve botërore mund të kenë lloje të ndryshme. Një prej atyre është edhe togëfjalëshi i lidhjes gjenitive (Lat. *Genetivus possessivus*). Psh: *rrobaqepësi i grua+së* [*Nyje + EM+G*]= *kadın+in* [*EM+G*] *terzisi*. Prandaj kjo rasë në turqisht quhet rasa e plotësuesit/përcaktuesit. Në gjuhën shqipe kjo rasë quhet rasa Gjinore, për shkak se shpreh gjininë/llojinë e/përkatesinë e gjymtyrës.

Nga turqishtja e vjetër kanë mbetur rasa e instrumentalit (-le) dhe të ekuativit(-ce). Këto dy rasa sipas burimeve të shumta konsiderohen si jo funksionale. Megjithatë, Z.Korkmaz është e mendimit se në turqishtën e sotme në përdorimet siç është: *akılı+ca* [*EM+EQ*]*davranış*= sjellje e zgjuar/të sillesh si i zgjuar, midis emrit dhe kallëzuesit është krijuar një raport barazie/ekuativi. Në gjuhën shqipe kjo shprehet me anë të parafjalës “si, sikur”. Prapashtesa e vjetër e instrumentalit shprehte konceptin të cilin në turqishtën e sotme e shpreh parafjala “ile” (Sh. parafjala “me”): *otobüsle gitmek* = shkuarje me autobus.

Instrumentalja e gjuhës shqipe është zhdukur, kurse sot shprehet me kallëzoren parafjalore dhe me rrjedhoren. (Topalli, 2009)

⁶ “bir kapı+dan girdi, öbür kapı+dan çıktı” = “**hyri** nga një derë, **doli** nga dera tjetër” është shembulli i tij me të cilin e argumenton këtë. (Aksan, 2003)

SISTEMI RASOR I GJUHËS TURKE: Gunay Karaagaç në veprën e tij Gramatika e Turqishtës thotë se, në përdorimin e gjuhës, Lakimi i emrave nënkupton raporte të ndryshme e një emri me një emër tjetër ose lidhje e grupit foljor (fjalisë) me një emër ose grup emëror. Këto janë raporte të ndryshme të krijuara midis gjymtyrëve të fjalive të cilët përmbajnë njësi trajtëformuese që shprehin raporte varësie (siç janë *parafjalët/pasfjalët*) që janë ose nuk janë shëndrruar në mbaresa me të cilat eptohet emri, togëfjalëshi me anë të cilit cilësohen/përcaktohen gjymtyrat të tjera ose ndonjë njësi tjetër e cila e përcakton/plotëson kallëzuesin.

Në të gjitha gjuhët, fjalët, mund të bashkohen vetëm me këto raporte të emrave dhe çdo gjuhë këto raporte i shpreh me morfema të varura⁷. Pa i pasur së paku dy informacione siç janë emër-emër ose emër-folje nuk mund të flitet për një koncept marrëdhënieje. Qysh nga periudha e gjuhës së vjetër turke, një pjesë e lakimit të emrave bëhet me mbaresat rasore dhe një pjesë me pasfjalët rasore. Ndërkaq, sipas Gramatikës së Gjuhës Turke të Tahsin Banguoglu⁸ Emrat, në gjuhën e sotme turke kanë rreth dhjetë trajta, të cilët sipas funksionit të tyre sintaksore mund të ndahen në dy grupe: 1. Trajtat (rasat) e lakimit të brendshëm (*déclinaison interne*) dhe 2. Trajtat (rasat) e lakimit të jashtëm (*déclinaison externe*). Rasat e lakimit të brendshëm ndërtohen me mbaresat rasore dhe janë: 1. *Rasa emërore*, 2. *Rasa gjinore*, 3. *Rasa dhanore*, 4. *Rasa kallëzore*, 5. *Rasa vendore* dhe 6. *Rasa rrjedhore*. Gjatë historisë së saj turqishtja ka krijuar mbaresa të shumta për lakimin e emrit, disa prej të cilave janë bërë mbaresa pak a shumë të gjalla formuese, ndërsa disa prej tyre më shumë kanë shërbyer në derivacionin dhe pak a shumë i kanë ruajtur funksionet e tyre në lakim. Prandaj, ka prapashtesa të cilat janë më pak funksionale dhe trajtat (rasat) të cilat i krijojnë quhen trajtat (rasat) e lakimit të jashtëm. Këtu hyjnë trajta e *instrumentalit*, *sociativit*, *equativit* (-ce), *munitivit* (-li), *privativit* (-siz). Në këtë punim do t'i trajtojmë vetëm rasat e lakimit të brendshëm.

Sipas Erginit (2011) emri i gjuhës turke, pranë mbaresës së shumësit dhe asaj të pronësisë ka edhe mbaresa rasore ku përmend: *rasën e nominativit*, *gjenitivit*, *akuzativit*, *dativit*, *lokativit*, *ablativit*, *instrumentalit*, *ekuativit* dhe *direktivit*. Ai konstaton se rasat kanë dallime dhe ngajshmëri midis tyre. Së pari, *rasa e gjenitivit* është një rasë e veçantë e cila e lidh emrin me një emër tjetër, ndërsa rasat e tjera e krijojnë raporte midis emrit dhe foljes. Nga ky aspekt *gjenitivi* nuk ka karakteristika e një rase të vërtetë dhe më shumë i ngjanë prapashtesës pronësore. Përdoret si një prapashtesë e një grupi emëror e jo si prapashtesë e një grupi foljor ose si një prapashtesë e një fjalie. Përveç kësaj

⁷ Ky term i korespondon asaj që gjuhëtarët amerikan NIDA dhe HARRIS në veprën "Morphology"(1944) e quajnë "morpheme" (Aksan, 2003).

⁸ Tahsin Banguoglu, Gramatika e gjuhës turke, TDK, botimi i 9. Ankara, 2011

funksionet e mbaresave rasore të rasës së *dativit, lokativit dhe ablativit* janë të tipit të njejtë. Të trijat tregojnë vendin ose drejtimin kah të cilit ndodhet veprimi dhe si të tilla e shprehin vendin e foljes. Kurse, *instrumentali, ekuativi dhe direktivi* janë të ngjajshëm sipas funksionit të tyre. Këto tri rasa tregojnë rrethanat e foljes dhe emrat të cilave u shtohen e kanë funksionin e ndajfoljes. Këto rasa me kohë kanë humbur cilësinë e mbaresës trajtëformuese dhe kanë treguar prirje fjalëformuese dhe gjithnjë kanë pasur një fushë të ngushtë të funksionimit. Rasa më tipike padyshim se është rasa e akuzativit. Mbaresat e akuzativit e lidhin emrin me një funksion të përcaktuar shumë të qartë dhe në një mënyrë të ngushtë, ata tregojnë kundrinën e foljes. Sipas kësaj mbaresat rasore mund të klasifikohen si vijon:

Mbaresa e Gjenitivit (e lidh emrin me një emër, mbaresa rasore sekondare)

Mbaresat e Akuzativit (lidh emrin me folje në mënyrë të drejtëpërdrejtë, krijojnë kundrinën e foljes, është një mbares tipike rasore)

Mbaresat e dativit, lokativit, ablativit (lidhin emrin me foljen, tregojnë vendin e foljes)

Mbaresat e instrumentalit, direktivit, ekuativit (lidhin emrin me foljen, tregojnë rrethanat-kushtet e foljes, krijojnë ndajfolje, nuk janë funksionale, kanë marrë formën e prapashtesave fjalëformuese).

G.L.Lewisi (2000) në gramatikën e tij të gjuhës turke thotë se rasat janë gjashtë. Forma më e thjeshtë e emrit, pa prapashtesa, quhet *rasa absolute*; nuk përdoret vetëm për rasën e nominativit dhe rasën e vokativit por edhe për rasën e akuzativit të papërcaktuar. Termi *akuzativ* përdoret vetëm për atë që duhet të quhet *akuzativ i përcaktuar*. Rasat të tjera janë: *gjenitivi*, i cili shpreh përkatësi; *dativi*, i cili shpreh kundrinorin e zdhrejt dhe mbarimin e lëvizjes; *lokativi*, i cili shpreh vendin; *ablativi*, i cili shpreh ndarjen, rrjedhën, largimin nga një pikë të caktuar.“

Si përfundim mund të themi se Turqishtja i ka 6 rasa morfologjike: *emërore (/)*, *gjinore(-in, -in, -un, -ün)*, *dhanore (-a, -e)*, *kallëzore (-i, -i, -u, -ü)*, *vendore(-de, -da / -te, -ta)* dhe *rrjedhore (-den, -dan / -ten, -tan)*. Morfemat rrënjore nuk pësojnë ndryshime gjatë eptimit, kurse mbaresat rasore i kanë ndryshoret e tyre fonologjike si pasojë e harmonisë së zanoreve dhe harmonisë së bashkëtingëlloreve dhe nuk shkaktojnë apofoni. Për fjalët që mbarojnë me zanore përdoren tingujtë antihiatizues (n,y), të cilat përdoren edhe në formime të tjera (në zgjedhimin e foljeve etj.).

Turqisht:	Anne + □	anne + y + i	anne + de
Shqip:	(nënë)	(nënë) + AntiH + K	te + (nëna) + V
Turqisht:	anne + n + in	anne + y + e	anne + den
Shqip:	i,e (nën-) + antiH + GJ(-e)	(nën-) + AntiH + Dh(-e)	(nën-) + Rr(-e)

Mbaresa e rasës gjinore në turqisht kufizohet si prapashtesë e cilësuesit të lidhjes gjentive dhe si e tillë shpesh herë klasifikohet si një mbaresë e veçantë e cila trajtohet jashtë sistemit rasor. Megjithatë, kjo është një trajtë e emrit e cila i ka të gjitha karakteristikat morfologjike të rasës dhe do ta trajtojmë si e tillë. Në gjuhën turke rasat morfologjike të funksionale mund t'i kenë emrat, përemrat vetore, përemrat dëftore, përemrat pyetëse, përemrat e papërcaktuar, numëroret, gjerundet dhe fjalë tjera të nominalizuara.

SISTEMI RASOR I GJUHËS SHQIPE: Kolec Topalli⁹ në veprën e tij “Sistemi rasor i emrave të shqipës” thotë se Shqipja si një gjuhë indoevropiane¹⁰ ku sistemi rasor është mjaftë i zhvilluar ka një numër të reduktuar të numrit të rasave dhe sot janë standardizuar pesë rase morfologjike: *emërorja, gjinorja, dhanorja, kallëzorja dhe rrjedhorja*. Forma të rasës instrumentale dhe thirrore janë zhdukur. Instrumentalja sot shprehet me kallëzoren parafjalore dhe me rrjedhoren, kurse funksionin e thirrorës e kryen emri pa mbaresa. Kriteri kryesor që është marrë në përcaktimin e paradigmave të lakimit kanë qenë nyjet shquese¹¹ sepse mbështetja në trajtën e pashquar të emrit ka qenë e pamundshme. Shqipja, sipas nyjeve shquese që marrin emrat në rasën emërore ka tre lakime. Emrat janë ndarë në 4 lakime sipas nyjave –i, -u, -a, -t(ë). Brenda këtyre paradigmave emrat janë ndarë në klasa duke marrë parasysh format e trajtës së shquar dhe të pashquar. Lakimi i parë përfshinë emrat e gjinisë mashkullore që marrin nyjen e prapme –i: lis+i., Në lakimin e dytë bëjnë pjesë emrat që marrin nyjen shquese –u: mik-u. Lakimi i tretë përfshinë emrat e gjinisë femërore dhe një numër kufizuar

⁹ Kolec Topalli, *Sistemi rasor i emrave të shqipës*, Plejad, Tiranë, 2009.

¹⁰ Gjuhët indoevropiane prej të cilave buron shqipja ka pasur një sistem rasor mjaftë të zhvilluar, ku një gjuhë ka pasur shtatë, tetë rase shumica e të cilave janë ruajtur edhe në gjuhët e sotme. (Likaj, 2005)

¹¹ Emrat e gjuhës turke nuk kanë trajtë të shquar. Emri shquhet duke e përmendur drejtpërsëdrejti emrin e konceptit: çocuk dışardadır = fëmija është jashtë. Në qoftë se bëhet fjalë për çfarëdo fëmi përdoret numërori “një”: një fëmi=bir çocuk. Gjatë formimit të togfjalëshit, gjymtyrat e ndërtuara me mbarsën –in krijojnë togëfjalështa të përcaktuara (çocuğun oyuncağı= lodra e fëmijës), me anë të të cilave në një mënyrë indirekte shprehet një koncept ose një person të përcaktuar. Togëfjalshi i papërcaktuar nuk e ka këtë veçori. (Aksan, 2003)

emrash mashkullore, ku nyja e prapme del në format –a, –ja: fushën. Në lakimin e katërt bëjnë pjesë emrat e gjinisë asnjëanëse. Nyja shquese e të gjitha paradigmave ka në themel nyjen shquese –t(ë), e cila i ka variantet –it(ë), –ut(ë): krye+të, gjalpë-të, sy-të, etj. (pra, lakimi ndryshon sipas gjinisë morfologjike dhe trajtës që nuk egziston në gjuhën turke.)

Në SRSH shihet se ka shumë mbaresa rasore të sinkretizuara. Format e njëjta rasore përdoren për shprehjen e më shumë se një rase. Për shembull: një emër në njëjës, në trajtën e pashquar e ka formën e njëjtë morfologjike për rasën e emërores dhe rasën e kallëzorës (*lis*-emërore, *lis*-kallëzore) si dhe formën e njëjtë për rasën e dhanorës dhe rrjedhorës (*līs*- dhanore, *līs*-rrjedhore). Emri në nominativ shërben si temë për të gjitha rasat tjera ashtu siç shërben edhe në gjuhën turke. Në numrin njëjës dallohen format rasore sipas gjinisë, kurse në numrin shumës ka vepruar sinkretizmi duke krijuar mbaresa të përbashkëta për të gjitha gjinitë ([i,e]*lisave*– numri shumës/trajta e shquar/rasa gjinore, dhanore, rrjedhore ose [i,e] *fushave* – numri shumës/trajta e shquar/rasa gjinore, dhanore dhe rrjedhore). Përveç kësaj një fjalë e lakuar mund të ketë edhe ndryshime fonologjike. Sipas gramatikave të Gjuhës Shqipe emri ka tri lakime. Lakimi i parë përfshin emrat mashkullore që në trajtën e shquar marrin mbaresën: –i. Emrat e nyjshëm dhe emrat e gjinisë asnjëanëse lakohen si emrat e këtij lakimi, vetëm se emëroren dhe kallëzoren e trajtës së shquar i kanë të njëjta (marrin mbaresat –t/-it). Rasa gjinore njëjës dhe shumës, në të dy trajtat, përveç mbaresave merr edhe nyjet e përparme *i*, *e*, *të*, *së*, të cilët ndryshojnë sipas gjinisë, rasës, trajtës dhe numrit të emrit që kanë përpara. (Bahri Beci, 2005)¹² Lakimi i dytë përfshin emrat mashkullore që në trajtën e shquar marrin mbaresën –u. Lakimi i tretë përfshin emrat femërore që në trajtën e shquar marrin mbaresën –a. Emrat lakohen në trajtën e pashquar dhe të shquar, njëjës dhe shumës. Rasat e emrit në gjuhën shqipe janë: emërorja, gjinorja, dhanorja, kallëzorja dhe rrjedhorja.

Mbiemrat lakohen në bashkëvajtje me emrat. Gjatë lakimit mbiemri i nyjshëm pëson ndryshime (psh. *i vëllai të mirë* –*r.gjinorë*), kurse ai i panyjshëm kur vendoset pas emrit nuk pësonë ndonjë ndryshim në rasë, pra nuk lakohet (psh. *djalit mirë* – *r. gjinore*).

Përemrat vetore ndryshojnë formë sipas vetës, gjinisë dhe numrit. Psh. Veta e tretë njëjës, gjinia femërore: *ajo*, *asaj (i)*, *atë (të)* *e*, *asaj (saj)*. Për rasat kallëzore dhe dhanore përemrat vetore kanë dy trajta, një trajtë e plotë dhe një trajtë të shkurtër: psh. *mua/më*, *neve/na*, *ty/të*, *juve/ju*. Në vetën e parë dhe të dytë trajtat e shkurtra janë të njëjta për të dy rasat (*më*, *na*, *të*, *ju*); në vetën e tretë trajtat e shkurtra janë të njëjta për të dy gjinitë (*i,e/u,i*), kurse trajtat e shkurtra të rasës dhanore (*i,u*) janë të ndryshme nga ato të rasës kallëzore (*e,i*). Dy trajtat e shkurtra, mund të formojnë një trajtë të

¹² Bahri Beci, *Gramatika e Gjuhës së Sotme Shqipe*, Logos-A, Prishtinë-Shkup-Tiranë, 2005

bashkuar ma (*më+e*), ta (*të+e*) etj. Vetëm trajtat *m'i* dhe *t'i* shkruhen me apostrof. Vetëm trajtat *na e* dhe *na i* shkruhen ndaras.

Kemi thënë që rasat janë mjete sintaksore prandaj është e udhës t'i përmendemi edhe parafjalët të cilat sipas lidhjeve sintaksore mund të klasifikohen në: 1. Parafjalët e rasës emërore: *nga, te (tek)*; 2. Parafjalët e rasës gjinore: *me anë, me rastin, me përjashtim, në sajë, në vend, në të mirë, në mes, në drejtim, në vend, për faj, nga shkakun etj.*; 3. Parafjalë të rasës kallëzore: *në, me, pa, për, mbi, për, nën, ndër, në krahasim me, në përjashtim me, në lidhje me etj.*; 4. Parafjalë të rasës rrjedhore: *prej, ndaj, për, anë, majë, përveç, sipas, me anë, në mes etj.*

Mbaresat rasore (*-i, -u, -e* të rasave gjinore-dhanore njëjës, *-në* dhe *-të* të rasës kallëzore njëjës dhe shumës, *-sh* e rasës rrjedhore shumës, *-ve* të rasës gjinore-dhanore dhe rrjedhore shumës etj.), edhe pse janë kryesore nuk janë mjete të vetme dhe shqipja e sotme përveç mjeteve sintetike ka edhe mjete analitike siç janë nyjat (*i, e, të, së*), ndryshime të formës së fjalës (lakimi i përemrave vetore), pasthirrmat (moj nënë, djalo), parafjalët (në malë) etj.

PROBLEMATIKA DHE HIPOTEZA: Rasa emërore shërben për shprehjen e funksioneve të njëjta (kryfjala e fjalisë, emrat në thirrrore dhe rasat e tjera parafjalore/sintaksore) dhe në të dy gjuhë janë rasa pa mbaresa. Prandaj mendojmë se do të ketë përputhshmëri të plotë midis tyre. Funkzioni kryesor i rasës gjinore është ai i përcaktorit dhe të cilësuesit. Dallimi midis dy sistemeve rasore është se rasa gjinore e turqishtës krijon vetëm raporte midis dy emrave. Në turqisht raportet midis dy emrave mund të krijohen me anë të disa llojeve të togfjalëshave. Togfjalshi i përcaktuar ndërtohet me anë të mbaresës rasore të gjinores dhe i korrespondon togfjalshit të shqipes. Por, për dallim nga shqipja në turqisht përdoret si përcaktues që shpreh përkatësi, dhe jo cilësi (psh. *ngjyra e detit → deniz+in rengi*).

Përcaktuesi i shqipes që shpreh llojin, vendin, destinacionin e një objekti, në turqisht do të përkthehet edhe me rasën e Emërores. Psh.: *dhoma(E) e ndenjës (GJ) → oturma(E) oda(EM) + s (antiH) + ı (ppV3/njëjës-E)*

Për këtë arsye, mendojmë se gjinorja, pranë korresponduesit të saj homogjen në shumë raste do të përkthehet edhe me rasën emërore.

Përdorimi kryesor i rasës dhanore, në të dy gjuhë është kundrinori i zhdrejtë. Psh.: *Krëzimi i murit i dha shpresë dhe besim populli+t (Dh). → Duvarın yukulışı halk+a(Dh) umut ve güven verdi.*

Mbaresat rasore të turqishtës, nuk kanë vetëm një funksion dhe kjo më së shumti vërrehet tek rasa e dhanorës. Prandaj, *rasa e dhanorës* në tekstin shqip do të përkthehet me rasën dhanore në turqisht. Megjithatë, kjo rasë morfologjike u korrespondon shumë parafjalëve të shqipes, të cilat jo gjithmonë janë parafjalë të rasave

të njejta shqipe. Psh. parafjalës sintaksore “*në*” të akuzativit të papërcaktuar dhe parafjalës “*për*” të akuzativit dhe ablativit. Për këtë, mendojmë se ky fakt do të ndikojë në përkthimin e rasave kallëzore dhe rrjedhore të shqipes me rasën e dhanores. *Rasa e kallëzores* shërben për të shprehur kundrinorin e drejtë, si në gjuhën turke ashtu edhe në gjuhën shqipe. Përveç rastit të lartpërmendur nuk mendojmë që do të përkthehet me ndonjë rasë tjetër. *Rasa e rrjedhore* shërben për shprehjen e funksionit të përcaktuesit në të dy gjuhë. Në shikim të parë kjo tregon se rasa rrjedhore do të përkthehet me poatë rasë në turqisht. Por, si përcaktues e një emri të pashquar i cili shpreh destinacionin e një objekti dhe përmbajtje, rasa rrjedhore do të përkthehet me emërore. Në raste kur rrjedhorja e turqishtës përdoret për shprehjen e vendit, përkatësisht kur krijon raporte me folje që tregojnë lëvizje, rrjedhën, ndarje nga një pikë të caktuar në shqip do të zëvendësohet me rasën e emërores. Pra nuk do të jenë të pakta as përkthimet me ndonjë rasë tjetër të caktuar e cila shpreh nocionin e vendit.

Në anën tjetër, në gjuhën shqipe nuk egziston *rasa e vendorës*, e cila në gjuhën turke shprehet me mbaresën *-de, -da* që zakonisht i përgjigjet parafjalës së gjuhës shqipe: *në*, dhe në disa raste përkthehet edhe me parafjalë të tjera që tregojnë vendin dhe kohën. Meqenëse parafjala “*në*” është parafjala e rasës kallëzore, mendojmë se rasa vendore e turqishtës do të përkthehet me kallëzoren e shqipes.

Ekivalencat dhe dallimet midis përdorimeve të rasave në dy gjuhë, në bazë të gramatikave:

Rasa emërore: funksionet kryesore e rasës emërore në dy gjuhë janë: kryefjala, kallëzuesori i kryefjalisë, ndajshim. Në turqisht shpreh edhe përcaktorin e të gjitha llojeve, funksioni ky i cili në gjuhën shqipe shprehet me anë rasës gjinore e rrjedhore. Rasën pa mbaresa mund ta shohim edhe te thirrvoja dhe me disa pasfjalë (munitiv).

Rasa gjinore: në të dy gjuhë përdoret si përcaktues dhe shpreh përkatësi, lloj, vend, destinacionin e një objekti (në turqisht përdoret edhe emërorja). Përveç kësaj përdoret për të shprehur kryefjalën e sipjesorëve, kundrinorin e një lëvizjeje, përcakton një pjesë e një njësie, kallëzuesorin e kryefjalës. **Rasa dhanore:** në dy gjuhë përdoret si kundrinor i zhdrejtë (sendin apo personin, të cilit i drejtohet veprimi.) për të shprehur kahje, lëvizje për ndonjë vend, krijon trajtën e vendit. Në gjuhën turke shpreh trajtën e afrimit me nocionin e pronësisë, tregon personin ose sendin i cili pëson ndonjë dëm ose fitim, mund të tregojë pikë pamjen e një personi, përdoret si përcaktor, mund të përcaktojë përfundimin e një lëvizjeje, qëllimin a synimin, arsyen e afrimit kur përdoret me foljet që shprehin ndjenja, përdoret me foljet që shprehin marrje, blerje, shitje, dhënie, shpreh afrimin nga aspekti kohor, krahasimin me fjalët që shprehin superioritet. Përveç funksionit të kundrinorit të zhdrejtë, i cili zakonisht shprehet me anë të rasës dhanore, si në shqip ashtu edhe në turqisht, janë edhe rastet e tjera të përdorimit të **rasës Dhanore** në turqisht, të cilat në gjuhën shqipe shprehen me

parafjalën “në” të rasës **kallëzore** ose me parafjalën “për” të rasës **kallëzore/rrijdhore**. **Rasa kallëzore:** në dy gjuhë shpreh kundrinorine drejtë, kallëzuesorin e kundrinorit të drejtë. **Rasa rrjedhore:** në dy gjuhë shpreh përcaktorin e një emri të pashquar dhe tregon llojin, lëndën prej së cilës përbëhet një send, destinacionin e një objekti (turqishtja e shpreh me emëroren), përmbajtje (turqishtja e shpreh me emëroren). Në raste kur përdoret me foljet që shprehin lëvizje, ndarje ose largim prej një vendi rasa rrjedhore tregon vendin, dhe në këto raste në gjuhën shqipe përkthehet me emëroren. Me emërore (me pasfjalën *nga*) përkthehet edhe kur shpreh shkak, burim, krahasim, kryefjalë e fjalisë në pasiv etj.

REZULTATET E ANALIZËS KRAHASIMORE TË SR TË GJT DHE GJSH NË BAZË TË ROMANIT “GJENERALI I USHTRISË SË VDEKUR” DHE PËRKTHIMIT TURQISHT “ÖLÜ ORDUNUN GENERALI”

Rasa e emërores siç kemi supozuar është përkthyer me rasën morfologjike të emërores në turqisht. Këtë e dëshmon edhe përqindja të fjalëve të përkthyer (78%) me rasën e njejtë. 5% të rasës emërore janë përkthyer me rasën e rrjedhorës dhe këto janë fjali të ndërtuara me parafjalët të rasës emërore “nga” e cila i korrespondon rasës rrjedhore të turqishtes: 3% të rasës emërore janë përkthyer me rasën e gjinorës, dhe kjo vërrehet tek fjalitë të nënrenditura ku pjesa e nënrenditur filluese lidhet me pjesën kryesore me anë të lidhëzës filluese “se”. Në turqisht kjo shprehet me participin i cili në grupin e tij përfshin emrin në rasën gjinore. Rasat e tjera janë kanë peshë të korresponduesit, për shkak të përqindjes së ulët të përdorimit. **Rasa e gjinorës** është përkthyer në shumicën e rasteve me rasën e rrjedhorës (45%). Një nga funksionet e tjera të kësaj rase të shqipes në gjuhën turke shprehet me anë të rasës emërore. Sipas rezultateve kjo tregohet e saktë, sepse në 14 % të fjalëve në rasën e gjinorës janë përkthyer me rasën e emërores. 4% janë përkthyer me rasën e emërorës, në grupet emërore siç kemi supozuar. 31% të rasteve janë përkthyer në mënyrë të tjera. **Rasa e dhanorës** është përkthyer me të njejtën rasë në 47% të rasteve. Një përqindje më të lartë tregon përdorimi i rasës së rrjedhores tek grupet foljore të përbëra me folje që shprehin kuptimin e ndarjes apo largimit nga një pikë të caktuar. 26 % të rasteve të dhanores nuk janë përkthyer fare dhe 13% janë përkthyer në mënyra të ndryshme pa i përdorur gjymtyrat që lakohen. 5% të rasteve janë përkthyer me rasën e emërores, përkatësisht me pasfjalë të rasës emërore. **Rasa e kallëzores** së tekstit shqip, në shumicën e rasteve është shfaqur si kallëzorja e papërcaktuar të cilën e kemi definuar si emërore për shkak se në turqishte nuk shprehet me rasën morfologjike të kallëzores (me mbaresën -i). Andaj mund të themi se 31% të rasteve është përkthyer me emërore

siç kemi pritur. 9% të rasteve janë përkthyer me rasën gjinore Përshkak të parafjalëve rasore që në turqisht zakonisht shprehen me pasfjalë rasore të cilat nuk u përkasin rasave të njejta edhe pse kanë kuptimin e njëjtë. 15% përqind të fjalëve janë përkthyer me rasën dhanore për shkak të nocionit të vendit të cilin e shprehin këto dy rasa. % 12 përqind janë shprehur me rasën e vendorës së turqishtës (-de) nga po e njejta arsye. Rrjedhorja e turqishtës përdoret për përkthimin e rasës kallëzore të shqipes në 5% të rasteve. 16% nuk është përkthyer dhe 12% përkthimi është bërë në mënyrë të ndryshme. **Rasa e rrjedhorës** së gjuhës shqipe është përkthyer në 25% të rasteve me rasën e rrjedhorës së turqishtës. 25% të rasteve kemi përkthim me rasën gjinore të turqishtës. Këtu shihet *përkatësia* dhe *cilësia* të cilët përkthehen me këto dy rasa janë këmbyer në përqindje të barabartë. 35% të fjalëve janë përkthyer me rasën emërore të turqishtës dhe kjo për shkak të vendit të përcaktorit në togfjalësh: 10% janë përkthyer me fjalë tjera dhe 5% nuk janë përkthyer fare. **Rasa morfologjike** e vendorës së gjuhës turke në 52% të rasteve është përkthyer me rasën e kallëzores së gjuhës shqipe. Në raste tjera më së shumti janë përdorur parafjalët, përemrat, mbiemrat dhe fjalë të tjera (39%). Rasa emërore dhe rasa gjinore na shfaqen vetëm në 2% të rasteve. 5 % të kësaj rase përkthehet me folje.

Mbaresat e gjuhëve aglutinative janë shumë funksionale dhe kjo e bënë të pamundshme përputhshmërinë e plotë me mbaresat e një gjuhe fleksive e cila përdor edhe mjete të tjera gramatikore për t'i shprehur konceptet të caktuara. Sinkretizmi i mbaresave rasore të gjuhës shqipe krijon dallime të mëdha nga ato të gjuhës turke. Bazuar në rezultatet e lartëshënuara rasat e gjuhës shqipe nuk tregojnë përputhshmëri të plotë (te asnjë rasë, përveç rasës emërore (%78), përqindja e përdorimit të njëjtë nuk e kalon gjysmën e rasteve) për të thënë që mund të përkthehen me rasat e njejta të gjuhës turke. Përdorimi i mbaresave rasore është i lidhur ngusht edhe me përmbajtjen semantike të foljeve. Krahasimi i përkthimit të këtyre dy gjuhëve ka treguar dallime të mëdha midis frekuencës së përdorimit të mjeteve të njejta gjuhësore, të shkaktuar si nga struktura morfologjike ashtu edhe nga ajo semantike. Këtë e tregon edhe përqindja e fjalëve të papërkthyer. Por edhe përqindja e fjalëve të përkthyer me mjete të tjera gjuhësore.

Shembuj nga Aneksi i punimit:

RASA EMËRORE

Shqip	<i>Misioni i tij</i>		mund të kryhej vetëm me shi
		TFP R.E. [EM+ PV + □]	
Turqisht	<i>Görevi, ancak kötü havada başanabilecek bir iş gibi gelmiştir</i>		
		[E + PPV3 + □]	
Shqip	<i>Si një shpend</i>		krenar do të fluturosh
		[PF + NUM. I PASHQUARSISË + EM + □]	
Turqisht	Görkemli ve gururlu	<i>bir kuş gibi</i>	uçacaksınız
		[NUM. I	
		PASHQUARSISË + EM +	
		□ + PasF]	
Shqip	<i>Medaljoni [+□] i ushtarëve tanë!</i>	FJALI NË THIRRORE	
Turqisht	<i>Askerlerimizin taşıdikları madalyon[+□]!</i>	FJALI NË THIRRORE	
Shqip	Por edhe sikur në librin që kish lexuar të shkruhej <i>se</i> në Shqipëri <i>vjeshta</i> është me diell.		
		[LIDHËZA]	[EM+ □]
Turqisht	Ne var ki, Arnavutluk üzerine okuduğu kitap, <i>sonbahar+ın</i> burada kuru ve güneşli		
		[EM+GJ.]	<i>olacağıın+ı</i> yazmış olsa bile...
			[G]JERUND+K.
Shqip	Dukeshin <i>si copa</i> drunjësh		
		[PF + EM + □]	
Turqisht	Kurumuş odun	<i>parça + lar + ı + n + ı</i>	andırıyorlardı
		[EM	
		+PSH+ppV3+antiH+□]	
Shqip	por <i>fytira e priftit</i> ishte po	Shqip	Nga <i>xhami</i> i
	aq e nemitur dhe pa		aeroplanit
	shprehje...		
			[EM + □]
	[TF: EM + □ +EM (GJ.)]		
Turqisht	ama rahip hala put gibi	Turqisht	Uçağın
	duruyordu		<i>penceresi+n+den</i>
	[PRIFTI ENDE PO		[EM + AntiH+(-
	RRINTE SI STATUJË]		den) Rr.]

Shqip	<i>Ai</i> [PVV1 + □]	e ndoqi me sy gjersa u zhduk...
Turqisht	Kaybolup gidinceye kadar arkasından bak+ <i>ti</i>	[Prapashtesa vetore e kohës së shkuar V3 (-ti)]

RASA GJINORE

Shqip	Mbi asfaltin e zi të <i>xhade+së</i> [nyje +EM+GJ]	Shqip	... shiu kish kohën e <i>tij</i> , gjenerali e dinte [NYJE+PVV3+GJ]
Turqisht	Yol+ <i>un</i> kara asfaltını işılatıyor [EM + GJ]	Turqisht	Yağmur mevsimi olduğunu biliyordu [AI DİNTE QË ISHTE STINA E SHIUT]
Shqip	Një përfaqësonjës i <i>ministrisë</i> [NYJE + EM+GJ]	Shqip	I kish ngulur sytë grumbullit të <i>plisave</i> [NYJE+EM+GJ.SH.]
Turqisht	Bakanlık temsilcisi [EM+ □]	Turqisht	General kazıcının dibine yığılıp duran <i>topraklar+dan</i> [EM+RR.] ayıramıyordu gözlerini

RASA DHANORE

Shqip	Po vinin drejtë <i>aeroplan+it</i> [EM+DH]	Shqip	Bisedimet midis dy <i>qeverive</i> [EM+DH]
Turqisht	Uçağ+a doğru geliyorlardı [EM+DH]	Turqisht	İki hükümet arasındaki görüşmeler [EM+ □]
Shqip	T'ja shkëpuste <i>harrimit</i> dhe <i>vdekjes</i> atë [GJERUND+DH] [EM+DH]	Turqisht	Ölüme+den ve unutulup gitmek+ten kurtarmaya gelmişti [EM+RR] [GJERUND+RR]
Shqip	Ja hoqa <i>atij</i> kamën [PV/DH]	Turqisht	Palaskasındaki kasaturayı da çekip aldım [E HOQA KAMËN NGA RRYPI I TIJ]

RASA KALLËZORE

- Shqip** Ja kishin shtuar *melankoli+në*
[EM+K]
- Turqisht** ...*sıkıntısı+n+ı* büsbütün artırmıştı
[EM+AntiH+K]
- Shqip** *Për + tërbeqje+n* e eshtrave të ushtarëve të vrarë
[PasF+EM+K]
- Turqisht** Yurttaşlarının kemiklerini toplayıp yurtlarına *götürmek için*
[GJERUND+□+PF]
- Shqip** *Pamjen* kërcënonjëse e armiqësore të maleve qe munduar ta luftonte *me ndjenjën e*
[EM+K] [PF+E+K]
krenarisë së misionit të tij
- Turqisht** Bu dağların korkutucu ve düşmanca *görüntüsünün karşısına*, görevinin verdiği
[EM+GJ+PasF/DH]
gururu dikmişti.
[EM+□+p.p.V.III.]
- Shqip** Ai shkoi *në dhomën* e tij
[PF+EM+K]
- Turqisht** Kendisine ayrılan *odaya* *odaya*
[EM+AntiH+DH]
- Shqip** Më mirë të shikonte *në pasqyrën* e vogël në e kish rregull uniformën
[PF + EM+K]
- Turqisht** *Ayna+da* üniformasının düzgün olup olmadığına bakmak daha yararlı olacaktı
[EM+V]
- Shqip** Ai foli *për tradit+a+t* e bukura
[PF+E++SH+K]
- Turqisht** ...güzel gelenek+ler+den söz açtı
[EM+PSH+RR]
- Shqip** Udhëtimet i kujtonin se sa gjë e bukur ishte rehatia *në gjirinë* [PF+E+K] e familjes
- Turqisht** Bu yolculuklar, ters bir etkiyle kendi yuvasının dinginliğini, sıcaklığını hatırlatırdı.
[KËTO UDHËTIME, I KUJTONIN ME NJË EFEKT MBRAPSHIT,
REHATINË DHE NGROHTËSINË E FAMILJES]

RASA RRJEDHORE

<p>Shqip <i>Pas veturës</i> [PF+E+RR]</p> <p>Turqisht <i>Otomobil+in</i> arkasında [EM+GJ]</p> <p>Shqip <i>Pas disinfektim+it</i> [PF+E+RR]</p> <p>Turqisht <i>Dezenfekte iş+i</i> bittikten sonr [TF: EM+ □ + EM+PPV3]</p>	<p>Shqip <i>Përpara ndërtesës së aeroplanit</i> [PF+EM+RR]</p> <p>Turqisht <i>Havaalanı yapısın+dan</i> [EM+RR]</p> <p>Shqip <i>pas disa minuta+sb</i> [EM+SH+RR]</p> <p>Turqisht <i>Birkaç dakika</i> sonra [EM+ □]</p>
---	--

RASA MORFOLOGJIKE E VENDORES TË TURQISHTËS DHE KORRESPONDUESIT E SAJ NË GJUHËN SHQIPE

<p>Shqip <i>.. në dhe të</i> huaj [PF+EM+ □]</p> <p>Turqisht <i>Bu yabancı toprak+ta</i> [EM+V]</p> <p>Turqisht <i>Uzak+ta, ta uzak+lar+da...</i> [NDA]FOLJE+V] [NDA]FOLJE+SH+V]</p> <p>Shqip <i>..dhe larg, shumë larg</i> [NDA]FOLJE]</p> <p>Turqisht <i>Dağlık araziyi geri+de</i> bırakıp [NDA]FOLJE+V]</p> <p>Shqip <i>Malet i lanë prapa</i> [NDA]FOLJE]</p>	<p>Turqisht <i>..çevre+s+i+n+de</i> hepsi ayak+ta [EM+AntiH+p.p.+antiH+V] [EM+V]</p> <p>Shqip <i>Të gjithë rrinin përreth</i> si të ngrirë [FOLJE] [NDA]FOLJE]</p> <p>Turqisht <i>Şu an+da</i> anyor o [TF: PD+EM+V]</p> <p>Shqip <i>Ai tani</i> [NDA]FOLJE] <i>kërkon..</i></p>
--	--

1 në emërore dhe 1 në gjinore. 3 raste të prapashtesës vendore të kombinuar me infinitivin me *-mek* që ka dy kohë (të tashme dhe të shkuar) e njohur si *forma foljore e durativit* janë përkthyer me folje në kohën e pakryer, dhe nganjëherë duke përforcuar kuptimin me fjalën “*vazhdueshëm/më*”.

Turqisht	...arabayla [PF+EM+ □]	<i>izlemek+te+ydiler...</i> [INFINITIV+V.PK+PV]
Shqip	<i>Vinin</i> [FOLJE NË KOHË TË PAKRYER]	pas tyre në një maqinë...

SHKURTESAT

AntiH	Tingulli antihiatizues	ppV3	prapashtesa pronësore e vetës së tretë
EM	Emër	pSH	prapashtesa e shumësit
E	Rasa emërore	PF	Parafjalë
GJ	Rasa gjinore	PasF	Pasfjalë
Dh	Rasa dhanore	TF	Togëfjalësh
K	Rasa kallëzore	SR	Sistemi rasor
V	rasa vendore	GJT	Gjuhë turke
EQ	ekuativi	GJSH	Gjuhë Shqipe
INS	Instrumentali	SRSH	Sistemi rasor i shqipes
Rr	rasa rrjedhore	SRT	Sistemi rasor i turqishtës
PV	Përemër vetor		
PVV1	Përemri vetor i vetës së parë		

Literatura

- Bahri Beci, *Gramatika e Gjuhës së Sotme Shqipe*, Logos-A, Prishtinë-Shkup-Tiranë, 2005
- Doğan Aksan, *Her Yönüyle Dil (Ana Çizgileriyle Dilbilim)*, TDK, Ankara, 2003
- Ethem Likaj, *Fleksioni Indoevropian*, SHBLU, Tiranë, 2005
- Gunay Karaağaç, *Türkçenin Dilbilgisi*, botimi i 1-rë.:Ankara,2012
- G.L.Lewis, *Turkish Grammar*, Oxford – NewYork, Oxford University Press, 1967
(Second Edition 2000)
- Ismail Kadare, *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, botimi i pestë, Rilindja, Prishtinë, 1990.
- Ismail Kadare, *Ölü Ordunun Generali*, Përkthyer nga: Atila Tokatlı & Necdet Sander,
Can Yayınları, İstanbul, Prishtinë 1986.
- John Lyons, *“Introduction to Theoretical Linguistics”*, Cambridge, 1968.
- Kolec Topalli, *Sistemi rasor i emrave të shqipes*, Plejad, Tiranë, 2009.
- Kolec Topalli, *Bazat e Gramatikës Historike të Gjuhës Shqipe*, SHBLU, Tiranë, 2011
- Muharrem Ergin, *Türk Dil Bilgisi*, Bayrak, İstanbul, 2011 (Botimi i parë 1958)
- Mehdi Polisi, *Gramatika e Gjuhës Turke*, Logos, Prishtinë, 2002.
- Tahsin Banguoglu, *Türkçe Dilbilgisi*, TDK, botimi i 9. Ankara, 2011

Leech (1997) në: Tony McEney, Richard Xiao, *What corpora can offer in language teaching and learning*, pdf <https://www.youtube.com/watch?v=7CHMfboM06g>

PËRMBAJTJA

Sedat KUÇI, dekan i Fakultetit të Filologjisë
FJALA PËRSHËNDETËSE NË HAPJEN E PUNIMEVE TË
SEMINARIT XXXIV NDËRKOMBËTAR PËR GJUHËN,
LETËRSINË DHE KULTURËN SHQIPTARE.....7

Rrahman PAÇARIZI, Drejtor i Seminarit
FJALA E HAPJES E DREJTORIT TË SEMINARIT XXXIV..... 11

LIGJËRATAT 13

Bardhyl DEMIRAJ
SHQIPËRIA DHE SHQIPTARËT NË OBORRIN E HABSBURGUT –
NJË RAST I PARË I NDËRLIKJES SE SHKENCËS ME POLITIKËN..... 15

Maximiljana BARANČIĆ
LEXIS OF ZADAR ALBANIAN SPEECH AS REFLECTION OF LANGUAGES
IN CONTACT..... 27

Zef CHIARAMONTE
ÇËSHITJA E GJUHËVE AMTARE NË SHËRBESËN E SHENJTË
MESHARI I GJON BUZUKUT (1555) NË KONTEKSTIN E KONCILIT TË
TRENTOS (1545-1563)..... 43

REFERIME65

Alexandra CHIVARZINA
SISTEMI I NGJYRAVE NË GJUHËN MAQEDONASE DHE SHQIPE
NJËJSITË KRAHASIMTARE ME KUSHTET E NGJYRËS SË VERDHË DHE
TË GJELBËR..... 67

Tanja TRAJKOVIĆ ANALIZA E FRAZEOLOGJIZMAVE NË GJUHËN SHQIPE DHE BARASVLERËSVE PËRKTHIMORË TË TYRE NË GJUHËN SERBE NË FJALORIN FRAZEOLOGJIK BALLKANIK TË JANI THOMAIT	77
Giovanna NANCI PËRKTHIMET NË GJUHËN ITALIANE TË ROMANIT <i>KËSHTJELLA</i> TË ISMAIL KADARESË: PËRFUNDIMET E ANALIZËS KRITIKE	89
Emilia CONFORTI SISTEMI EMËROR I TË FOLMES ARBËRESHE TË SHËN BENEDHITIT ..	101
Aleksandër NOVIK, Marina SULLOEVA DASMA NDËR SHQIPTARËT E DEVOLLIT: MATERIALET ETNOLINGUISTIKE TË STUDIMEVE SHKENCORE NË TERREN TË VITEVE 2011 – 2014	107
Oğuzhan DURMUŞ, Rijetë SIMITÇIU EMËRTIMET GJEOGRAFIKE OSE TOPONIMET NË VILAJETIN E BERATIT SIPAS “SÛRET-I DEFTER-I SANCAK-I ARVANID” TË VITIT 835 TË HIXHRIT.....	119
SESIONE.....	127
Shkumbin MUNISHI SHQIPJA DHE ANGLISHTJA NË PEIZAZHIN LINGUISTIK TË PRISHTINËS.....	129
Milote SADIKU MODIFIKIMET E NJËSIVE FRAZEOLOGJIKE ME EMËRTIME TË KAFSHËVE NË TEKSTET E GAZETAVE DITORE.....	143
Gaz BERLAJOLLI SHQIPJA SOT: SHPËRBËRJE APO RIRREGULLIM?.....	159
Xhavit BEQIRI LATENCA E PANATYRSHME E SHQIPES.....	165

Fehmi ISMAJLI FJALORTHI I TERMAVE PËR MËSIMDHËNËS I KURRIKULËS BËRTHAMË PËR KLASËN PARAFILLORE DHE ARSIMIN FILLOR TË KOSOVËS	173
Mustafa IBRAHIMI FJALËFORMIME NË BOTËN E REKLAMAVE DHE DISKURSIN POLITIK	189
Aida KURANI RRETH FORMAVE TË SHPREHJES SË RAPORTEVE RRJEDHIMORE NË GJUHËN STANDARDE SHQIPE	201
Idriz METANI PËRDORIMI I FIGURSHËM I FJALËVE PROFESIONALE NË LIGJËRIMIN E SOTËM PUBLICISTIK.....	209
Teuta DHIMA KOMUNIKIMI VERBAL DHE JOVERBAL ME PËRDORUESIN NË BIBLIOTEKAT PUBLIKE	215
Haxhi SHABANI DOMENET PUBLIKE TË SHQIPES NË MALIN E ZI.....	229
Xhemaludin IDRIZI GJUHA SHQIPE NË SHKRIMIN E MBISHKRIMIN E FIRMAVE TË OBJELTEVE TË NDRYSHME NË KOMUNËN E ÇAIRIT ME THEKS TË VEÇANTË NË ÇARSHINË E VJETËR TË SHKUPIT.....	239
Matilda PARLLAKU KËMBIM REGJISTRASH NË KOMUNIKIMIN GJUHËSOR TË D. AGOLLIT - DEPUTET DHE SHKRIMTAR.....	249
Bade BAJRAMI FRAZELOGJIA E FUSHËS SË MJEKËSISË NË PORTALET SHËNDETËSORE NË GJUHËN SHQIPE.....	265

Julie KOLGJINI NJË HETIM LINGUISTIK RRETH TURBULLIMEVE ESTETIKE TË IDEOLOGJISË SË GJUHËS STANDARDE: RASTI I SHQIPES NË HAPËSIRAT (JO)PUBLIKE.....	273
Imri BADALLAJ PASKAJORJA GEGE E TIPIT <i>me + pjesore</i>	289
Haki HYSENAJ SHKARJE ORTOEPIKE NË SHQIPEN E FOLUR DHE STATUSI I TYRE....	295
Vjosa HAMITI, Blertë ISMAJLI “Ju” DHE “ti”: FORMAT FORMALE DHE JOFORMALE TË ADRESIMIT NË DISKURSIN PUBLIK NË KOSOVË.....	307
Berton SULEJMANI SHQIPJA STANDARDE NË SHKOLLAT E MESME TË QYTETIT TË SHKUPIT.....	319
Natasha KAZMAJ (KALEMI) GJUHA SI KOMPETENCË DHE MËSIMDHËNIA E SHQIPES	329
Carrie Ann MORGAN (RI)REGJISTRIMI I DIALEKTEVE TË SHQIPES DHE TË VEÇORIVE TË TYRE NË KONTEKSTIN E TIRANËS SË SOTME	343
Bardh RUGOVA GJUHA E SHKENCËS: SHEMBULLI I ALBANISTIKËS	353
Anton PANCHEV SHQIPJA NË DOMENIN PUBLIK BULLGAR NË FUND TË SHEK. XIX DHE NË FILLIM TË SHEK. XX.....	363
Linditë SEJDIU-RUGOVA, Lindita TAHIRI KATEGORIA E VETËS NË LIGJËRIMIN PUBLIK	369

Haredin XHAFERI PËRDORIMI I LOKUCIONEVE TË NDËRMJETME ME STRUKTURË JOTOGFJALËSHE NË GJUHËN E SOTME SHQIPE.....	381
DOKTORANTËT	393
Shpëtim ELEZI PËRDORIMI I SHQIPES STANDARDE NGA MËSIMDHËNËSIT E CIKLIT FILLOR.....	395
Kadire BINAJ DEIKSI VETOR NË GJUHËN SHQIPE	417
Flutura MEHMETI PIKËPAMJE TË MAKSIMILIAN LAMBERCIT PËR PERIUdhËN HIPOTETIKE TË SHQIPES	431
Ardita BERISHA MODALITETI I SHENJUAR PËRMES FOLJEVE MODALE “ <i>mund</i> ” DHE “ <i>dubet</i> ” NË GJUHËN SHQIPE	435
Veton MATOSHI RIMARRJA E KUNDRINAVE NË TË FOLMET E GEGËRISHTES VERILINDORE – DISA REZULTATE PARAPRAKE	445
Bahri KOSKOVIKU STRUKTURA DHE FUNKSIONET GRAMATIKORE TË SINTAGMËS PARAFJALORE NË GJUHËN SHQIPE	459
Afërdita KASOLLI CLEFT SENTENCES IN THE SUBJECT POSITION AND EXTRA-POSED SUBJECT	465
Senad NEZIRI SHQIPJA NË DOMENET E SHKOLLAVE MIKSE	477

Vaide KQIKU-HOXHA PËRDORIMI I PJESORES DHE DERIVATEVE TË SAJ NË DEBATET TELEVIZIVE NË TELEVISIONET E KOSOVËS.....	485
Shemsi HAZIRI SHKËMBIMI GJUHËSOR GJATË BISEDËS NË QENDRAT KOMUNIKUESE TË POLICISË SË KOSOVËS	505
Manjola LUBISHTANI ZOTËRIMI I NORMËS DREJTSHKRIMORE NGA NXËNËSIT DHE MËSIMDHËNËSIT NË SHKOLLAT FILLORE.....	517
Pranvera OSMANI PËRDORIMI I VARIANTEVE TË PASKAJORES NË GJUHËN SHQIPE.....	531
Mensur VOKRRI REALIZIMI I SISTEMIT RASOR TË SHQIPES NË MEDIA TË SHKRUARA NË KOSOVË	539
Zeqije XHAFÇE KRAHASIMI I SISTEMIT RASOR TË GJUHËS SHQIPE DHE TË GJUHËS TURKE NËPËRMJET ROMANIT TË ISMAIL KADARESË “GJENERALI I USHTRISË SË VDEKUR” DHE PËRKTHIMIT TURQISHT “ÖLÜ ORDUNUN GENERALİ”	551

Katalogimi në botim – (CIP)
Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

811.18(063)
821.18(063)
008(=18)(063)

Seminari XXXIV Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare = The XXXIV International Seminar for Albanian Language, Literature and Culture : Prishtinë, 17-28.08.2015 / [kryeredaktor Rrahman Paçarizi]. – Prishtinë ; Tiranë : Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” : Fakulteti i Filologjisë ; Universiteti i Tiranës : Fakulteti Histori-Filologji, 2015. – libra. ; 24 cm.

[Libri] 1. – 574 f.

1.Paçarizi, Rrahman

ISBN 978-9951-00-176-2

ISBN 978-9951-00-177-9

Botimin u financua nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve
e Republikës së Kosovës